



UNIVERSITETI I TIRANËS  
FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË  
DEPARTAMENTI I GJUHËS SHQIPE



## ***E FOLMJA E ÇAMËRJSË DJE DHE SOT***

*“Shqyrtime dialektologjike, etnolingustike dhe sociolingustike rreth gjuhës shqipe të shkruar dhe të folur prej çamëve”*

**Disertanti**  
Edlira TROPLINI (Abdurahmani)

**Udhëheqësi shkencor**  
Akad. as. Gjovalin SHKURTAJ

Tiranë, 2012

# Doktoratë

*Përgatitur nga: Edlira Troplini (Abdurahmani)*

*Për marrjen e gradës shkencore "DOKTOR"*

*Specialiteti: Sociolinguistikë (Gjuhësi)*

## ***E FOLMJA E ÇAMËRJSË DJE DHE SOT***

*"Shqyrtime dialektologjike, etnolingustike dhe sociolingustike  
rreth gjuhës shqipe të shkruar dhe të folur prej çamëve"*

**Udhëheqës shkencor: Akad. as. Gjovalin Shkurtaç**

Mbrohet më, dt. \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2012 para jurisë:

1. \_\_\_\_\_ (Kryetar)

2. \_\_\_\_\_ (Anëtar)

3. \_\_\_\_\_ (Anëtar)

4. \_\_\_\_\_ (Anëtar)

5. \_\_\_\_\_ (Anëtar)

## PARATHËNIE

### *Njohuri të përgjithshme për të folmen dhe krahinën e Çamërisë*

#### HYRJE

- I. Kufijtë natyrorë gjeografiko- etnikë të Çamërisë
- II. Prejardhja e emrit Çamëri
- III. Njohuri të përgjithshme rreth shpërnguljes së çamëve nga trojet e veta në Greqi, në Shqipërinë shtetërore.
- IV. Popullsia. Sa çamë ka sot dhe ku janë vendosur ata?

#### KREU I

##### **1.1. QËLLIMI I TEMËS DHE RËNDËSIA E STUDIMIT TË SAJ**

- 1.1.1. Objekti dhe metoda e studimit
- 1.1.2. Vlerat studimore të çamërishtes për kundrimet sociolinguistike
- 1.1.3. Të dhënat për çamërishten përmes figurave të shquara të shkencës

#### KREU II

##### **2. RËNDËSIA E TË FOLMES SË ÇAMËRISHTES PËR GJUHËSINË SHQIPTARE**

###### **2.1. Çamërishtja dëshmuese e fazave të kapërcyera të shqipes**

- 2.1.1. Sistemi foljor i çamërishtes në diakroni
- 2.1.2. Disa tipare interesante të foljeve të zgjedhimit në –mi

###### **2.2. Bashkëpërkime të elementeve gjuhësore të veprave më të hershme shqipe, me çamërishten e sotme**

- 2.2.1. Dukuri të përbashkëta midis çamërishtes dhe “Mesharit” të Gjon Buzukut
- 2.2.2. Rëndësia e kësaj të folmeje përmes “Fjalorit të Marko Boçarit”

###### **2.3. Shqipja, nën trysninë e konteksteve të caktuara historiko- shoqërore të të folmeve të diasporës**

- 2.3.1. Disa të dhëna rreth historisë së shpërnguljes së arvanitasve, gjuhës dhe emërtimit të tyre
- 2.3.2. Dukuri të përbashkëta gjuhësore midis teksteve të Reinholdit dhe çamërishtes së sotme

###### **2.4. Bashkëpërkime midis çamërishtes dhe të folmeve arbëreshe**

- 2.4.1. Disa dukuri të ngjashme midis çamërishtes dhe të folmeve arbëreshe
- 2.4.2. Një analizë rreth të folmeve arbëreshe dhe të folmeve anësore në tërësi

#### KREU III

##### **3. E FOLMJA E ÇAMËRISHTES SOT**

- 3.1. E folmja e çamërishtes në kuadrin e marrëdhënieve gjuhë standarde- dialekt**  
**3.2. Roli i standardit në unifikimin e gjuhës dhe rrafshimin e diferencave në sjelljen gjuhësore të individit**

## **KREU IV**

### **4. VLERA DIALEKTOLOGJIKE DHE SOCIOLINGUISTIKE E TË FOLMES SË ÇAMËRISHTES**

#### **4.1. Leksiku në të folmen e çamërishtes**

- 4.1.1. Procesi i zhvillimit leksikor në mjedisin çam  
4.1.2. Ruajtje leksikore në brezin e vjetër çam. Emërtime rreth disa fushave.  
4.1.3. Disa emërtime interesante të fushave të ndryshme  
4.1.4. Disa dukuri fonetike dhe morfologjike në përbërje të fjalës

#### **4.2. Ruajtje, bjerrje dhe risi në kuadër të shqyrtimeve sociolinguistike**

## **KREU V**

### **5. NDIKIMI I FAKTORËVE JASHTËGJUHËSORE NË TË FOLMEN E ÇAMËRISHTES**

#### **5.1. Trajtimi i ndryshorëve sociolinguistikë**

- 5.1.1. Moshë  
5.1.2. Përkatësia gjinore  
5.1.3. Arsimit

#### **5.2. Dukuri të tjera që kushtëzojnë ligjërimin tonë si akt identiteti**

- 5.2.1. Ndryshimi dhe pasojat që solli ai në bashkësinë çame  
5.2.2. Martesa e përzier  
5.2.3. Krenaria ndaj origjinës, si faktor jashtëgjuhësor në të folmen e çamëve  
5.2.4. A ndikon e folmja e çamëve në të folmen e banorëve (vendas) anas?

## **KREU VI**

### **6. KUNDRIME DHE PËRQASJE FONETIKE**

#### **6.1. Dukuri të ndryshme sociolinguistike që lidhen me skemat e theksimit. Zanoret e theksuara dhe të patheksuara**

- 6.1.1. Theksi sintaktik  
6.1.2. Theksi i fjalës  
6.1.3. Gjatësia e zanoreve  
6.1.4. Zanoret e theksuara  
6.1.5. Zanoret e patheksuara  
6.1.6. Togjet zanore dhe diftongjet

#### **6.3. Sistemi bashkëtingëllor**

- 6.3.1. Dukuritë fonetike

## **KREU VII**

### **7. TIPARE MORFOLOGJIKE TË SË FOLMES ÇAME**

#### **7.1. Veçori të fjalëve të ndryshueshme të ligjëratës, sipas kategorive gramatikore**

- 7.1.1. Gjinia asnjane
- 7.1.2. Kategoria e numrit
- 7.1.3. Trajtat rasore.
- 7.1.4. Shquarsia e emrave
- 7.1.5. Nyja

#### **7.2. Disa veçori të përemrave**

#### **7.3. Numërori**

#### **7.4. Sistemi foljor**

- 7.4.1. Mënyra dëftore. Koha e tashme e mënyrës dëftore
- 7.4.2. Koha e pakryer e mënyrës dëftore
- 7.4.3. Koha e kryer e thjeshtë e mënyrës dëftore
- 7.4.4. Koha e ardhme e mënyrës dëftore
- 7.4.5. Mënyra lidhore
- 7.4.6. Format e pashtjelluara foljore
- 7.4.7. Forma joveprore e foljeve

#### **7.5. Veçori të fjalëve të pandryshueshme të ligjëratës**

## **KREU VIII**

### **PËRFUNDIME**

### **KORPUS TEKSTESH NË ÇAMËRISHT**

### **BIBLIOGRAFI**

## ***PARATHËNIE***

***Njohuri të përgjithshme për të folmen dhe krahinën e Çamërisë***

*Ne kemi marrë për studim të folmen e krahinës së Çamërisë, duke e vëzhguar atë gjuhësisht, duke u nisur nga ana dialektologjike, që ishte edhe relativisht e njohur, për të kaluar më fort në anën sociolinguistike, që, ashtu si për shumë nga krahinat shqiptare, ka qenë dhe mbetet pak ose aspak e njohur. E nisëm këtë punim, me dëshirën e madhe që të hyjë në rrjedhën e atyre kërkimeve të pakta, të cilat ndjekin një rrugë tashmë të rëndësishme dhe shpresojmë të pandërprerë në fushën e sociolinguistikës shqiptare. Sikurse do ta shpjegojmë më qartë tek objekti dhe metoda e studimit, të dhëna të ndryshme të “gjuhës” çame të vjela në “terrenin” çam, brenda një bashkësie shoqërore jo çame, janë bërë për ne objekt studimi.*

*Jemi mbështetur gjithashtu, në punimet më të rëndësishme sociolinguistike të ditëve tona në Shqipëri. Në këtë kuadër, një falenderim i përket mentorit tim prof. Gjovalin Shkurtaj-t, në punimet dhe këshillat e të cilit ky studim është mbështetur prej vitesh. Pas një pune të gjatë për një të folme të karakterizuar prej prof. Çabejt “si e folmja më jugore e shqipes”, mendoj se punimet e Akademikut të Asociuar në lëmin e gjuhësisë, kanë qenë dhe vazhdojnë të mbeten një bazë e shëndoshë e studimeve sociolinguistike.*

*Sprovën e parë e kemi bërë në studimin, “Vëzhgime për të folmen e çamëve të rrethit të Durrësit,(risi dhe ruajtje), paraqitur si temë diplome në mbarim të studimeve të larta në Fakultetin e Historisë dhe të Filologjisë.<sup>1</sup>Vlerësimi i prurjeve modeste të kësaj teme na mbeti si farë e mëtejshme, të cilën, pas një varg anketimesh e mbledhjeje materiali në terren, vendosëm ta bëjmë objekt studimi në mikrotezën për gradën “Master”.<sup>2</sup> Pas këshillës dhe nxitjes së profesorëve të Fakultetit të Historisë e të Filologjisë (akad. Ethem Likaj, prof. dr. Rami Memushaj, prof. dr. Shezai Rrokaj dhe akad. as. Gjovalin Shkurtaj, që janë edhe figura të dalluara të gjuhësisë shqiptare), për të vazhduar dhe për t’u thelluar më tej tek çamërishtja, si temë me mundësi të shumta kundrimi, natyrisht, edhe me ideimin e mbështetjen e udhëheqësit tim shkencor, iu qasa me tërë zellin e pasionin tim kësaj teme dhe hartuam disertacionin e pranishëm në kërkim të gradës “Dr. i shkencave”.*

*Por, si të gjitha punimet sociolinguistike në Shqipëri edhe punimi ynë është vijim i kundrimit dialektologjik të kësaj së folmeje. Për këtë arsye, një bazë tjetër e mirëfilltë në këtë drejtim ka qenë edhe punimi dialektologjik për të folmen e Çamërisë i studiuesit, Qemal Haxhihasani, folklorist i shquar dhe dialektolog me ndihmesa të vyera e të shumta.<sup>3</sup> Por, përveç rikundrimin e rivlerësimit të tipareve dialektologjike të kësaj të folmeje për të pasqyruar gjendjen e saj të sotme dialektologjike, qëllimi ynë ka qenë gjithmonë që, përmes këtij studimi të thelluar, të hapen hapësira të reja që presin për t’u mbushur prej nesh ose prej të gjithë atyre që kërkojnë të merren me çamërishten.*

*“Historia e gjuhës, është historia e popullit që e flet atë”, - ka thënë, profesori ynë i nderuar E. Çabej. Kjo thënie nuk ka se ku e gjen më mirë mishërimin e vet, përveçse tek e folmja çame. Kjo e folme është një pasqyrë e qartë e mendësisë së rafinuar që di ta përqafojë ndryshimin kur dhe si duhet, pa cënuar aspak atë “mbyllje” të qëllimshme në vetvete, që ndër të tjera, tregon emancipim dhe nivel të lartë kulturor. Çamët janë ambiciozë për të bukurën dhe fanatikë të saj. Ata e përqafojnë atë lehtë dhe me elegancë, duke mënjanuar me zgjuarsi gjithçka të*

<sup>1</sup>Troplini, E. *Vëzhgime për të folmen e çamëve të rrethit të Durrësit,(Risi dhe ruajtje),* temë diplome,Tiranë 1999

<sup>2</sup>Troplini, E. *Vëzhgime sociolinguistike në një mjedis çam të rrethit të Durrësit,* (Mikrotezë për gradën « Master »), Tiranë , Tetor 2005.

<sup>3</sup>Haxhihasani, Q. *Vështrim për të folmen e banorëve të Çamërisë,* në “Dialektologjia Shqiptare”, vëll.I, Tiranë 1971; vëllimi II, Tiranë 1973.

*papëlqyeshme dhe negative që i rrethon. Ato janë krenarë ndaj origjinës së të parëve, krenarë pse janë çamë.*

*Çamëria është një krahinë, e cila shtrihet në jug-perëndim të Gadishullit Ballkanik, gjatë brigjeve lindore të detit Jon, nga liqeni i Butrintit dhe lumi i Pavllos në Veri dhe deri në Gjirin e Artës në Jug<sup>4</sup> apo, siç e ka përshkruar mjaft bukur, përmes gjuhës së më të vjetërve, profesor Qemal Haxhihasani: “Çamëri zihet ka lumi i Shalsit, jaram te Gurët e Zes në Prevezë”.<sup>5</sup>*

*Të gjithë studiuesit kanë rënë në të njëjtin mendim për prejardhjen e emrit Çamëri: Mendohet se ky emër e ka origjinën tek Thjamisi i lashtë antik, i cili përkon me lumin Kalama, që përshkon krahinën e Çamërisë.<sup>6</sup> Vazhdimësinë midis këtyre dy termave, **Thiamis- çam**, Çabej e shpjegon përmes ligjeve fonetike të shqipes. Nga të dhënat tona në terren, kemi spikatur tek më të moshuarit, që ato shpeshherë përmendin njërin kah të Çamërisë, “anën e ndërsme” të saj. Pra, vetë Çamëria ndahet në dy pjesë: në pjesën më të lartë lindore shtrihet e ashtuquajtura “Malësia e Çamërisë” (ana e ndërsme), kurse pjesa perëndimore shtrihet në viset më të ulta, ajo quhet “Fusha”, apo “Çamëria e vërtetë”.<sup>7</sup>*

*Çamëria e sotme është Thesprotia e lashtë ilire. Emrat e figurave mitologjike dhe historike, siç janë: “Gurët e Elimëve” (dëshmues të qytetërimit të zhdukur të elimëve, shek. 10- 12 p.e.s), amfiteatri i madh pellazgjik në Lindje të Sulit, Kalaja ilire e Currilës, Shkalla e Filatit (Zorjanit), si dhe shumë toponime të tjera, janë dëshmues të qartë të autoktonisë së kësaj krahine, si një trevë me vijimësi iliro-shqiptare<sup>8</sup>*

*Historia e shpërnguljes së çamëve nga trojet e veta etnike është mjaft tragjike. Çamëria u coptua nga kufijtë e vendosur prej Konferencës së Londrës, në Qershor të vitit 1913. Marrja e dhunshme e Çamërisë dhe e kryeqendrës së Epirit, Janinës nga forcat greke, u shoqërua me një fushatë të egër terrori dhe dhune kundër shqiptarëve në Çamëri. Në Maj 1944-ës, tensionet politike atje u rritën shumë dhe, për rrjedhojë, pasiguria e popullsisë myslimane çame u shtua mjaft. Pikërisht, këtë vit u pushtuan qytetet me radhë, ndaj të cilëve u përdor një terror i paparë dhe u bënë krime të padëgjues. Pas këtyre masakrave, familjet e shqiptarëve të shumë qyteteve të Çamërisë u detyruan të largohen për në Shqipërinë shtetërore.<sup>9</sup> Gjithçka mund të përmbledhet mjaft bukur me anë të këtyre dy rreshtave:*

***“Historia e lakmive greke mbi Shqipërinë ka faqe që të ngjallin zemërim, si ato të masakrave..”<sup>10</sup>***

*Kjo e vërtetë e dhimbshme e kësaj krahine, ende pa zgjidhje në ditët tona, ka lënë gjurmë të thella edhe në të folmen e banorit të saj. Ndërsa për studimin tonë ajo ka qenë pikë kyçe e intervistave, anketave etj., pasi vetëm nëse përmendej historia e tyre tragjike, ato harronin gjithçka, duke rrëfyer me një ligjërim të natyrshëm, natyral të së folmes çame.*

*E folmja e Çamërishtes është pjesë e dialektit të Toskërishtes jugore. Lënda që vjen nga krahina e Çamërisë, por edhe prej “diasporës” së formuar pas 44-ës në të gjithë Shqipërinë, na lejon që të kufizohemi në disa çështje me vlerë të dialektologjisë*

<sup>4</sup> SHEME, S. *Monumente natyrore dhe kulturore të Çamërisë*, Tiranë 2008

<sup>5</sup> Haxhihasani, Q. *Vështrim për të folmen e banorëve të Çamërisë*, në “Dialektologjia Shqiptare”, vëll.I, Tiranë 1971, vëllimi II, Tiranë 1973

<sup>6</sup> Mero Rrapaj, F. *Fjalori onomastik i Epirit*, Tiranë 1995.

<sup>7</sup> SHEME, S. *Monumente natyrore dhe kulturore të Çamërisë*, Tiranë 2008.

<sup>8</sup> Mero Rrapaj, F. Po aty.

<sup>9</sup> Isufi, H. “*Musa Demi dhe qëndresa çame 1800-1947*”, 2002

<sup>10</sup> Godart, J. , Paris 1922: sipas Isufi, H. në, “*Musa Demi dhe qëndresa çame 1800-1947*”, 2002

dhe sociolinguistikës në veçanti, dhe jo vetëm kaq, por edhe në të gjitha disiplinat e albanologjisë në përgjithësi.

Studiuesit gjejnë tek elementi çam dhe e folmja e tyre, shumëçka të dobishme për plotësimin e izoglozave dhe të izoergeve në planin dialektologjik e etnografik të së folmes, përmes shpjegimeve të karakterit historik e krahasimtar të shumë dukurive morfologjike, sintaksore, leksikore dhe frazeologjike të shqipës.<sup>11</sup>

Nga studimet dhe vëzhgimet për çamërishten e sotme, kemi vënë re që tek kjo e folme dallohen qartë tiparet e dy varianteve a llojeve të të folurit, variantit tradicional, ku spikat ruajtja e elementeve të qëndrueshme të sistemit të vjetër dhe variantit të ri<sup>12</sup>, që pasqyron më gjerë shndërrimet dhe ndryshimet e sistemit nën trysinë e makrosistemit.<sup>13</sup>

Por, megjithëse në dukje dy kahet a anët e procesit të zhvillimit gjuhësor në mjedisin çam, si kudo në Shqipëri, janë ruajtja (konservimi) dhe përtëritja (rinovimi) e së folmes në drejtimin e rrafshimve standardizuese dhe globalizuese, do të shtonim se, **tek kjo e folme shfaqet dukshëm edhe një proces i tretë**, i cili është po aq i rëndësishëm sa ai i pranisë së dy të parëve, -ruajtjes dhe risimit. Në mënyrë konvencionale e kemi quajtur në këtë mënyrë këtë, një proces “**ndërkomunikimi**”, i cili luan rolin e një ndërlidhësi midis të folmes arkaike dhe të folmes së moderuar çame. Dukshëm ky lloj procesi shfaqet në brezin e mesëm tek i cili ruan edhe ekuilibrin më të madh. Roli i tij në këtë brez përngjason me atë të një ure komunikuese midis dy brezash.

Për rrjedhojë, ky proces është i tillë që në vetvete përfshin risimin, përkatësisht **ndryshimin** e të folmes në brezin e vjetër, pak a shumë në atë masë sa brezi i ri **kultivon** elementin e vjetër çam, përkatësisht **ruajtjen** e të folmes në të. Ndërsa tek brezi i mesëm do të shohim **ndërturjen** midis dy të folmeve. E folmja e tyre është **ruajtëse** aq sa është edhe **rinovuese**, pasi atyre u lind si detyrë të përshtasin të folmen herë kah e folmja e më të vjetërve në moshë dhe, herë nga ajo e fëmijëve dhe e jetës jashtë familjes.

Pra, e folmja e brezit të vjetër është konservative, por nuk ka mbetur e paprekur. Ajo priret drejt ndryshimit, motorit të evolucionit të një gjuhe. Në të verejmë fjalë të standardit letrar dhe më rrallë, fjalë të bashkësisë pritëse në të cilën ato janë vendosur.

E folmja e brezit të ri është pak a shumë bashkëkohore, por nuk është krejtësisht standarde. Ajo kultivon edhe ruajtje. Në të gjejmë edhe elemente të bashkësisë pritëse, por kryesisht ajo anon nga gjuha letrare standarde<sup>14</sup>.

Ndërsa, e folmja e brezit të mesëm në bashkëpërshtatje me faktorë të ndryshëm jashtëgjuhësorë (ku rol të dorës së parë marin elementet e veprimtarisë ligjërimore në komunikim), herë përshtatet me të folmen dialektore, pra me variantin tradicional të brezit të vjetër dhe herë me variante të brezit të ri, që synojnë standardin. Në të folmen e këtij brezi, ndërfitjet (interferimet) e elementeve të bashkësisë pritëse janë më të shumta në krahasim me dy brezat përkatës.

Në këtë mënyrë, kemi mëtuar të verifikojmë mënyrën sesi varianti tradicional

<sup>11</sup> Shkurtaç, Gj. *Vlera dialektologjike dhe etnolinguistike të së folmes së Çamërisë*, në “Çështja çame dhe integrimi evropian”, Tiranë 2008.

<sup>12</sup> Shkurtaç, Gj. *Disa dukuri të së folmes së Kurbinit në dritën e sociolinguistikës*, S.F. 1998.

<sup>13</sup> Shkurtaç, Gj. *Sociolinguistika*, SHBLU, Tiranë 2000.

<sup>14</sup> Troplini, E. *E folmja e çamërishtes në kuadrin e marrëdhënieve gjuhë standarde- dialekt*, kumtesë e mbajtur në konferencën shkencore të albanologjisë, Prishtinë, Gusht- 2009; *Disa tipare ruajtëse të çamërishtes*, “Univerisi”, Tiranë 2009; *Ndikimi i disa prej faktorëve jashtëgjuhësorë në të folmen e çamërishtes*, në “Çështja çame dhe integrimi evropian”, Tiranë 2009



ka dhënë dhe ka marrë me variantin e ri, proces që vijon edhe sot e kësaj dite. Të gjitha dukuritë gjuhësore që pasqyrojnë këto variante më vete, apo që ndodhin përgjatë marrëdhënieve të tyre me njëri tjetrin, çojnë tek procesi më i rëndësishëm për sociolinguistikën, **ndryshimi gjuhësor**. Ky i fundit nxitet e përcaktohet nga zhvillimi i përgjithshëm shoqëror dhe kulturor, po natyrisht, dhe nga forcimi e shtimi përherë e më i fuqishëm i trysnisë (presionit) që ushtron gjuha me prestigj kundrejt të folmeve krahinore, prirjes së saj rrafshuese kundrejt diferencave dhe forcës unifikuese që ajo ka.

Për të parë se si ka mbërritur ajo deri në ditët tona; sa është ruajtur, por edhe çfarë ka ndryshuar në të, e kemi vëzhguar këtë të folme empirikisht, duke parë nga afër të folmen çame në breza. Gjithmonë jemi bazuar në boshtin e trajtimeve që shkon sipas formulës së J. Fishmanit: “Kush flet, me kë, kur, për çfarë dhe në cilin varietet?”<sup>15</sup>, duke e plotësuar këtë “formulë” edhe me tri elemente të tjera të rëndësishme, të cilat shkojnë sipas pyetjeve problemore dhe kyçe për sociolinguistikën: “**Si, pse dhe ku**”<sup>16</sup>. Në përfundim të këtij studimi kemi qenë më se të bindur për rolin vendimtar të faktorëve jashtëgjuhësor në jetën e një të folmeje, duke analizuar të gjithë ato faktorë, që në një farë mënyre kushtëzojnë çamërishten, ose prej të cilëve folësit e saj në ligjërim ndikohen.

## HYRJE

### I. Kufijtë natyrorë gjeografiko- etnikë të Çamërisë

Çamëria është krahina më jugore e trojeve shqiptare<sup>17</sup>, në të cilën spikasin tipare të dallueshme gjeografike. Për këto të fundit, nuk flasim vetëm të dhënat shkencore, por të gjithë ata që kanë mundësi ta shohin Çamërinë si dhe intervistuesit tanë (dëshmuesit e fundit) që i kanë shijuar dikur këto troje. Gjatë gjithë punës tonë kërkimore folësit çamë nuk kanë mundur për asnjë çast t'i shmangen faktorëve historikë, gjeografikë dhe atyre emotivë, ndër më të rëndësishmit dhe të

<sup>15</sup> Shkurtaj, Gj. *Sociolinguistika*, SHBLU, Tiranë 2000.

<sup>16</sup> Berruto, G. *La sociolinguistica*, Bologna, 1994.

<sup>17</sup> Çabej, E. *Studime Gjuhësore*, f. 98, Rilindja, Prishtinë 1976.

pashmangshmit prej tyre në këto intervista kanë qenë: historia e dhimbshme e shpërnguljes; bukuritë natyrore të vendit; malli për Çamërinë. Këto faktorë nuk kemi ngurruar t'i trajtojmë, për aq sa mund të na lejojë një studim shkencor në fushën e sociolinguistikës.

Në jug-perëndim të Gadishullit të Ballkanit, gjatë brigjeve lindore të detit Jon, nga liqeni i Butrintit dhe lumi i Pavllos në veri dhe deri në Gjirin e Artës në jug, shtrihet një trevë me tipare të veçanta të peizazhit dhe të popullimit human që e diferencojnë nga rajonet përreth...Brenda këtyre kufijve shtrihen rrethet e Filatit, Gumenicës, Margëlliçit, Paramithisë, Pargës, Prevezës, Filipiadhës (Llurit) etj....<sup>18</sup>

Në lindje dhe në jug, krahina e Çamërisë kufizohet me Greqinë: në lindje, ndahet prej tokave greke, nëpërmjet basenit të Janinës dhe lumit të Artës; në jug, kufiri natyror gjeografik dhe etnografik i Çamërisë me Greqinë kalon nëpër Gjirin e Artës ( Ambrakisë); në perëndim, Çamëria ka dalje të gjerë në detin Jon. Vija bregdetare është mjaft e përtsher, me gjire, kepa, gadishuj, dhe, në përgjithësi, ka drejtim veriperëndim- juglindje.<sup>19</sup>

Gjiri më i madh është Gjiri i Artës në jug, i cili veçohet nga deti Jon nga kepi i Prevezës në Veri (Shqipëri) dhe kepi Akeion në jug ( Greqi). Gjatë bregdetit jonian të Çamërisë janë formuar edhe disa gjire më të vogla, si: Gjiri i Sajadhës, Gumenicës, i Platares, i Pargës etj. Në këto gjire janë vendosur portet kryesore të krahinës, si Gumenica, Parga, Murto ( Vola), Sajadha, gjithashtu Preveza dhe Salahora në Gjirin e Artës.<sup>20</sup>

Në aspektin etnologjik, ajo është një vazhdimësi e popullit shqiptar në drejtim të jugut, apo një nënjesi e tij, e cila së bashku me Myzeqenë, Labërinë dhe Toskërinë, formojnë jugun e Shqipërisë. Lidhjet më të ngushta dhe afritë më të mëdha Çamëria i ka me Labërinë, me të cilën kufizohet në Veri.<sup>21</sup>

## II. Prejardhja e emrit Çamëri

Një ndër studiuesit e huaj që ka shkruar fillimisht për prejardhjen e emrit Çamëri ka qenë Uilljam Martin Liku (ËILLIAM MARTIN LEAKE). Sipas tij çamët dhe Çamëria përfshijnë tërë rajonin e jugut të lumit *Kalama*, që në kohën antike është quajtur *Thyamis*. Supozohet se prej këtij emri antik rrjedh emri i sotëm greqisht *Camuria*, shqip *Çamëria*. Vendet kryesore të kësaj krahine janë: Suli, Paramithia, Luarati, Margëlliçi, Parga, Agia etj. (këto emra autori i ka shkruar sipas emërtimeve greke)<sup>22</sup>

Ndër studiuesit shqiptarë, Çabej ka qenë i pari që ka provuar përmes ligjeve fonetike të shqipes vazhdimësinë e dy termave **Thyamis** / **Çam**, konkretisht ai

<sup>18</sup> Sheme, S. *Veçori të përgjithshme Fiziko- gjeografike, - Kufijtë natyrorë gjeografiko- etnologjikë të Çamërisë* në "Monumente natyrore dhe kulturore të Çamërisë", Tiranë 2008, f. 19

<sup>19</sup> Sheme, S. Po aty.

<sup>20</sup> Po aty.

<sup>21</sup> Po aty

<sup>22</sup> Hoxha, Sh. *Kontributi i Uilljëm Martin Likut në fushën e studimeve albanologjike*, f. 66, Prishtinë 2007.

shkruan:“ Çam – në Çamëri, Çam, Çamërisht, emri i krahinës më jugore të Shqipërisë, i banorëve të saj e i dialektit të tyre. Sikundër e pa së pari M. Leake ( *Researches in Greece. 1814, f. 13*) është refleksi i *Thyamis*, emri antik i lumit *Kallama të sotmë*. Një nga emrat topikë që vërtetojnë autoktoninë e Shqiptarëve në vendbanimet e sotme ; sh. *Bul. I Univ. Shtet. të Tiranës. Seria. Shk. Shoqërore 2 (1958) 61.*”<sup>23</sup>

F. M. Rrapaj ka sjellë edhe një fjalë tjetër e cila mbështet autoktoninë e emrit *Thiamis*, - emrin *tjamë* ( gjë e papritur, çudi, fatkeqësi) e afërt me *thagmë* (çudi, mrekulli, - fjalori i gjuhës shqipe, Tiranë).<sup>24</sup> Autori në fjalë mbështet edhe mendimin e Çabejt përsa i takon kufirit të Çamërisë dhe vijës kufitare me Shqipërinë shtetërore, i cili bëhet njësh me mendimin e Sami Frashërit se Çamëria kufizohet nga Veriu me Mollosinë, që përbëhet nga sanxhaku i Gjirokastrës, domethënë nga krahina e Labërisë dhe e çon atë më tej duke saktësuar dhe plotësuar me Sarandën dhe Delvinën. Madje ai mendonte se edhe vetë qyteti i Gjirokastrës me Delvinën ishin Çamëri.<sup>25</sup>

Për krahinën e Çamërisë përdoren krahas dy emërtime si bigëzime të njëri-tjetrit: Çamëri dhe Epir për vendin; çam dhe epirot për banorin e tij. Përsa u takon emërtimeve të vendit dhe banorit të tij u fol pak më lart, ndërsa emërtimet *Epir* dhe *epirot* i gjejmë përkatësisht në literaturën greke. Emërtimi *Epir* përdoret si emër i përgjithshëm që në kohë të lashta nga autorët grekë, për të përcaktuar pozitën kontinentale të krahinës përballë Greqisë ishullore, pasi *Epir* në greqisht do të thotë *stere* ( tokë)<sup>26</sup>.

Studiuesit S. Sheme dhe A. Hyseni lidhur me këtë çështje mbështesin mendimin e tyre përmes dy referimeve të rëndësishme: atë të studiuesit grek Georgios Nikokles dhe atij gjerman J.Ph. Fallmerayer.

- Studiuesi grek Georgios Nikokles, mbështet tezën se fjala *çam* do të thotë *pishë* ose “vendi i banorëve të pyjeve me bredha” ( është emërtim grek). Ky studiues mundohet të argumentojë se ngjashmëria e fjalëve **çam- pishë** është një dëshmi se shqiptarët kanë qenë të ngulitur në Danub dhe në kohën pas Krishtit popullsia ka kaluar në vendbanimin e ri ilirik, që grekët e quajnë “ vëndi i pyjeve me bredha”.<sup>27</sup> Ky studiues me sa shohim mbron edhe tezën e autoktonisë së pjesshme të shqiptarëve.

- Studiuesi gjerman J.Ph. Fallmerayer e kundërshtoi këtë tezë. Ai argumentoi se fjala *breth - çam* ( pylli me bredha), është një fjalë e parme turke dhe si shumë fjalë të tjera ka ardhur tek shqiptarët përmes lëvizjeve migruese dhe marrëdhënieve me turqit imigrues në Evropë. Dhe më tej vijon: *ndofta emri i provincës bregdetare shqiptare “ Çamëri” nuk është i prejardhur as nga greqishtja e as nga turqishtja, por nga emri i stërlashtë i lumit Thianies*.<sup>28</sup> Mendojmë se kjo është më e besueshme. Nga ana tjetër, greqishtja dhe turqishtja na sjellin në mëndje atë boshllëk që duhet mbushur në fushë të historisë gjuhësore rreth shkrimeve të shqipes jo vetëm me alfabetin latin, por edhe atë grek e turko-arab.

Autorët e lartpërmendur shtojnë se, emri *Epir*, meqenëse shprehte “ vendin e pyjeve me bredha” u shtri në drejtim të Veriut, të arealeve të pyjeve me bredha, deri

<sup>23</sup> Çabej, E. *Studime Gjuhësore*, f. 98, Rilindja, Prishtinë 1976.

<sup>24</sup>Rrapaj, M. F. *Fjalori onomastik i Epirit*, Tiranë 1995.

<sup>25</sup> Rrapaj, M. F. *Po aty*.

<sup>26</sup> Sheme, S dhe Hyseni, A. *Aspekte mjedisore dhe gjeopopullative të krahinës së Çamërisë*, f.19, në “Çështja çame dhe integrimi evropian”, (organ i Institutit Intelktual Çam), “Arbëria”, Tiranë 2008.

<sup>27</sup> N. G. Nikokles “ De Albanien Sium Sive Schkipitar Origine et Prosapia ( Gottingen- 1855), sipas S. Shemes dhe A. Hyseni, po aty, f 21.

<sup>28</sup> Fallmerayers, Ph. J. Elementi Shqiptar në Greqi, sipas S. Shemes dhe A. Hyseni, po aty.

në gjirin e Vlorës e më tej. Skënderbeu e quante principatën e tij pjesë të Epirit. Në këtë kuptim, Epiri filloi të njëjtësohej me një krahinë të madhe që shtrihet nga Gjiri i Artës në Jug deri në atë të Vlorës në Veri. Ndërsa, emri Çamëri mbeti në shtrirjen historike nga Gjiri i Artës në Jug, e deri afër Sarandës në Veri. Kështu bashkëjetuan këta dy emra, njëri për të shprehur një krahinë të madhe si kryenjësi dhe tjetri një krahinë më të vogël si nënjesi. Krahuina e Epirit përfshinte atë të Çamërisë si nëndarje të saj..... Këto nëndarje morën edhe emrat e tyre të veçantë. Epiri gjeografik ndahej në dy pjesë: Epiri i Veriut apo “Vorio-Epiri”, siç quhet nga grekët, i cili shtrihet nga gjiri i Sarandës deri në atë të Vlorës, dhe “Epiri i Vërtetë” apo Epiri i jugut që shtrihet nga Gjiri i Sarandës deri në atë të Artës. Epiri i Jugut ose Epiri i Vërtetë, përputhet me atë krahinë që quhet Çamëri.<sup>29</sup>

Po ashtu edhe Çamëria ndahej në dy pjesë, në drejtim meridional: në pjesën Lindore më të lartë, shtrihet “malësia e Çamërisë”, kurse pjesa perëndimore që shtrihet në viset më të ulta, quhet “fusha” apo “Çamëria e vërtetë”<sup>30</sup>

### **III. Njohuri të përgjithshme rreth shpërnguljes së çamëve nga Çamëria në Shqipërinë shtetërore.<sup>31</sup>**

Nga të dhënat historike dimë që, Çamëria u coptua nga ndarja e kufijve në Konferencën e Londrës, në Qershor të vitit 1913. Për aneksimin e të ashtuquajturit “Epiri i vërtetë” Greqia fillimisht nxiti luftën civile midis myslimanëve dhe të krishterëve. Marrja e dhunshme e Çamërisë dhe e kryeqendrës së Epirit, -Janinës nga forcat greke, u shoqërua me një fushatë të egër terrori dhe dhune kundër shqiptarëve në Çamëri.

Periudha 1913-1922 në Çamëri, u karakterizua nga rritja e presionit të qeverisë greke ndaj popullsisë. Qeveria greke në parim i njihte çamët si minoritet, por duke shfrytëzuar besimin e tyre mysliman, ajo bënte përpjekje për t'i quajtur ata si turq, në mënyrë që t'i përfshinte në një shkëmbim të mundshëm të popullsisë greko-turke. Ndërkohë flitet për një valë arrestimesh të njëpasnjëshme të krerëve të fiseve çame, të shoqëruara këto me përpjekjen e vazhdueshme të tyre për mbrojtjen e trojeve. Nuk mungoi edhe bashkëveprimi i rretheve patriotike çame me diplomacinë shqiptare.

Në maj të vitit 1944 tensionet politike në Çamëri u rritën mjaft dhe pasiguria e popullsisë myslimane çame u shtua shumë. Në këtë vit kemi pushtimin e qyteteve me radhë ndaj të cilëve u përdor një terror i paparë dhe u bënë krime të padëgjura nga bandat kriminale të Napolon Zervës. Pas këtyre masakrave, familjet e shqiptarëve të shumë qyteteve të Çamërisë u detyruan të largohen për në Shqipëri.

Kjo ishte shkurtimisht dhe historia e dhimbshme e shpërnguljes së çamëve myslimanë në Shqipëri të cilën e kemi dëgjuar, madje shumë herë më të hollësishme, në çdo intervistë që kemi bërë me folës të brezit të vjetër.

### **IV. Popullsia. Sa çamë ka sot dhe ku janë vendosur ata?<sup>32</sup>**

<sup>29</sup> Zojzi, Rr. Studime etnografike mbi Çamërinë, Tiranë 1981, fq. 10-12, sipas S. Sheme dhe A. Hyseni, *Çështja çame dhe integrimi evropian*, Tiranë 2008.

<sup>30</sup> Zojzi, Rr. Po aty.

<sup>31</sup> Për të dhëna më të hollësishme nga fusha e historisë mund të shihni veprat e historianit çam Z. Hajredin Isufi, tek të cilat për një korrektësi shkencore jemi mbështetur edhe vetë ne, pavarësisht të dhënave empirike.

<sup>32</sup>Të dhënat statistikore për popullsinë i kemi marrë nga një kumtesë e mbajtur në një konferencë të Institutit Intelektual Çam nga studiuesit S. Sheme dhe A. Hyseni, përkatësisht e titulluar, “Aspekte

Kufijtë politikë të vitit 1913 ndikuan jo vetëm në jetën ekonomike, por edhe në përbërjen demografike. Pas vendosjes së këtyre kufijve, popullsia shqiptare erdhi duke u pakësuar nga emigracionet e herëpashërshme për në shtetin amë, -Shqipëri, si dhe në Turqi, Shtetet e Bashkuara të Amerikës etj. Ky emigracion ishte pasojë e politikës shkombëtarizuese që nisi të ndjekë Greqia sapo aneksoi Çamërinë. Në përfundim të Luftës së Parë Botërore, më 1918, u hartua plani për grabitjen e tokave të popullsisë çame.

Përpjekjet e dhunshme, pas Konferencës së Lozanës të vitit 1923 për të shpërngulur me forcë popullsinë çame në Turqi, shënuan një kulm të paparë në politikën e egër shoviniste greke. Greqia arriti të dëbojë me forcë për në Turqi 35 mijë shqiptarë të Kosturit dhe Follorinës dhe 55 mijë shqiptarë myslimanë të Çamërisë. Pas zbatimit të traktatit të Lozanës e deri në vitin 1937 kanë emigruar në shtetin amë, në Shqipëri, në Amerikë dhe vënde të tjera edhe 27 mijë shqiptarë të tjerë myslimanë.

Sipas statistikave greke të vitit 1937, Çamëria kishte 279 fshatra dhe një popullsi prej 112619 banorë, nga të cilët vetëm 20200 ishin grekofonë, por edhe ata me prejardhje shqiptare. Pjesa tjetër, 92 419 banorë ishin thjesht shqiptarë. Procesi i emigracionit të popullsisë shqiptare në shtetin amë vazhdoi gjatë gjithë periudhës 1924- 1944.

Në periudhën Qershor 1944-45 bandat e organizatës ultra – nacionaliste greke “Edhes” kryen një masakër të shëmtuar kundër popullsisë civile myslimane, duke vrarë më shumë se 2800 vetë, gra, burra, fëmijë dhe pleq. Në këtë mënyrë popullsia shqiptare myslimane e Çamërisë u detyrua të lërë vatrat stërgjyshore dhe të emigrojnë në Shqipëri. Numri i emigrantëve ishte rreth 35000.

Sot popullsia çame jeton e shpërndarë në Delvinë, Sarandë, Vlorë, Fier, Berat, Lushnjë, Peqin, Rrogozhinë, Kavajë, Durrës, Shijak, Sukth, Tiranë, Fushkrujë, dhe një pakicë në Milot, Lezhë dhe Shkodër. Numëri i saj arrin në rreth 250 mijë banorë. Sot Epiri apo Çamëria ka një popullsi prej 353820 banorë (viti 2001).

Nga përllogaritja e të dhënave të popullsisë multietnike, grupi etnik shqiptar arrin në rreth 165000 banorë. Përveç treguesve statistikorë të emigracionit të popullsisë shqiptare çame në Turqi, pas Konferencës së Lozanës, si dhe në shtimin natyror të saj në 80 vitet e fundit, llogaritet që numri i kësaj popullsie në Turqi sot të ketë arritur në 300 mijë banorë. Nga të dhënat e mësipërme del se numri i popullsisë çame në Shqipëri, në Çamëri apo Epir (Greqi), Turqi dhe në diasporë (Sh. B. A) i kalon të 700 mijë banorë.

## KREU I

### 1.1. Qëllimi i temës dhe rëndësia e studimit të saj

#### 1.1.1. Objekti dhe metoda e studimit

Problematika që ngre punimi ynë është paksa e veçantë, pasi ajo është ngritur mbi bazën e një teme që ka të bëjë me një të folme anësore, të folmen e krahinës jugore të Epirit, Çamërisë.

Sikurse e vumë re edhe më lart, konteksti dramatik që për një kohë të gjatë e ka shoqëruar këtë krahinë, pashmangshëm ka lënë gjurmët e veta, por pikësëpari ato ndjehen në të folmen e banorit të çam.

Përmes studimit të së folmes çame, kemi vëzhguar probleme të tilla të rëndësishme si: ndryshimi gjuhësor, relativizmi gjuhësor dhe kulturor, bilinguizmi dialektal, mënyra e integritit, llojet e pabarazive gjuhësore, konformizmi dhe individualizmi, probleme sasiore të ligjëritit etj. Të tëra këto, i kemi parë përmes hulumtimit të tri proceseve të rëndësishme të cilat shfaqen dukshëm më së pari në sistemin leksikor të së folmes, siç janë: konservacioni, inovacioni, përzierja apo bashkëveprimi gjuhësor në breza, bjerrja dhe zëvendësimi gjuhësor etj.<sup>33</sup>

---

<sup>33</sup> Troplini, E. *Leksiku në të folmen e çamërishtes*, në “Malësia”, Podgoricë 2010, nr. 5, f.119-127.

Si një e folme konservative, çamërishtja na krijon mundësi të shumta përqaasjeje, aq më tepër që kjo e folme në fushë të studimeve gjuhësore nuk është trajtuar plotësisht.

Që të arrinim në përfundime përgjithësuese për të tre sistemet: atë fonetik, morfologjik, dhe leksikor kemi studiuar për shumë vjet të folmen çame në tre breza: brezi i ri: 18- 40 vjeç, brezi i mesëm 40-60 vjeç, brezi i vjetër 60- 90 vjeç.

Në studimin tonë, në funksion të synimeve dhe detyrave që i kemi vënë vetes, kemi parapëlqyer të ndjekim një kalim prej disa shkallësh:

1. Rëndësia e të folmes së çamërishtes për gjuhësinë shqiptare.
2. E folmja e çamërishtes në përgjithësi dhe vendi i saj në dialektologjinë shqiptare.
3. Gjuha letrare zyrtare (standarde), që qëndron sot si mëtim drejt të cilit ndihmojnë të gjithë faktorët e zhvillimit arsimor, kulturor, artistik.
4. E folmja e bashkësive pritëse dhe e rrethinave anas ku janë vendosur çamët, e cila ndikon lehtëzi, por vazhdimisht në të folmen e tyre.

Nga ana tjetër, këto nuk janë thjesht hapa apo faza, por një shtresë e fuqishme tek e cila mbështetet i gjithë punimi, nga ku burojnë të gjitha dukuritë sociolinguistike dhe dialektologjike<sup>34</sup> në të gjitha rrafshet e të folmes. Gjithashtu, kemi vëzhguar me imtësi se ç' ndodh pas përplasjes në breza dhe ndërkomunikimit midis tyre; përzierjet e vazhdueshme; marrjet dhe dhëniet jo vetëm midis varianteve të të folurit, por edhe midis folësve të së njëjtës origjinë, duke mos përjashtuar edhe folës me origjinë të ndryshme etj. Së fundmi, i kemi kushtuar kujdes të veçantë procesit të rinovimeve dhe përtëritjeve në të folur. Nuk kemi anashkaluar edhe disa sprova rreth trajtimeve të tjera sociolinguistike, që lidhen me problematika të tilla që e kanë bazën tek kritere të ndryshme sociale dhe natyrore, si: moshë, seksi, arsimit, klasa ekonomiko-shoqërore.

Gjatë gjithë punës sonë, një bazë e rëndësishme, por edhe e sigurtë ka qenë për ne terreni çam; aty ku sot ato jetojnë, të shpërndarë në të gjithë Shqipërinë. Fillimisht të dhënat për këtë punim janë mbledhur në lagjen Arapaj të Durrësit<sup>35</sup>, e quajtur ndryshe edhe "Lagjia e çamëve". Më pas hulumtimet nuk kanë munguar në zona dhe ambiente shqiptare kudo që ka çamë dhe flitet çamërisht. Përmes metodës së vëzhgimit kemi siguruar një burim të pashtershëm informacioni dhe të dhënash. Mjeti që gjithmonë ka shërbyer si karrem në punën tonë, ka qenë regjistrimi, si dhe vëzhgimi i drejtpërdrejtë i fakteve. Regjistrimet e drejtpërdrejta të materialit, na kanë dhënë mundësinë të studiojmë në imtësi shkaqet e mundshme që ndihmojnë në ndryshimin, për rrjedhojë zhvillimin e të folmes apo bjerrjen e dukurive të çamërishtes, duke çuar deri në prishjen e fizionomisë së këtij dialekti. Kjo na ka dhënë mundësinë që për këtë të folme të përkushtohemi mjaft.

Për këtë arsye shpeshherë jemi shprehur për të, me gjuhën e studiuesve<sup>36</sup>, duke e krahasuar me një ishull gjuhësor të pashfrytëzuar mirë, siç është ndër të tjera edhe rasti i të gjitha të folmeve anësore të shqipes. Megjithatë, në përfundim, do të dëshiroja të bëja një tjetër krahasim ndonëse paksa të rëndomtë: çamërishten e krahasojmë sot me një pus të thellë tek i cili edhe pse përpiqesh ta mbyllësh atë hapësirë, aq më e madhe duket ajo dhe fundin nuk arrin ta prekësh dot kurrë.

<sup>34</sup> Për këto dukuri kemi shfrytëzuar punimin e Prof. Qemal Haxhihasanit, por që një verifikim të të cilave e kemi bërë edhe përmes shembujve të vjelë në terrenin çam, në bashkësitë pritëse ku ato janë vendosur, për të arritur në përfundime konkrete të gjendjen statike të së folmes çame.

<sup>35</sup> Kjo është edhe lagjia në të cilën unë jam rritur, midis bashkëmoshatarëve çamë dhe dashamirësisë së familjeve çame.

<sup>36</sup> I pari që e ka shprehur një gjë të tillë ka qenë prof. E. Çabej

Ne kemi hulumtuar në strukturën e tre sistemeve të saj: në sistemin fonetik ( i cili ndër të tjera shfaq prurje të mëdha), në sistemin morfologjik dhe atë leksikor (sistem ky i fundit që preket më shumë përgjatë lëvizjeve mekanike të popullsisë). Në këtë këndvështrim e kemi mënjeluar me vetëdashje sintaksën, pasi ajo konsiderohet si shenjë e kohezionit në shoqëri.<sup>37</sup> Një rol të rëndësishëm në punën tonë studimore, pavarësisht nga njësitë e tjera (fonetike, morfologjike, leksikore), ka luajtur edhe shqiptimi, i cili është në një masë të vogël subjekt i standardizimit. Ky i fundit, bashkë me të gjitha elementet e tjera përbërëse, si: intonacioni, theksi, timbri etj., konsiderohen mjaft të rëndësishëm në fushën e sociolinguistikës, pasi ndihmojnë në identifikimin e grupit shoqëror të folësit.<sup>38</sup> Jo më kot edhe kërkimet më të rëndësishme sociolinguistike janë ato empirike, të mbështetura mbi bazën e ligjërit. Në këtë punim nuk përjashtojmë gjithashtu edhe disa të dhëna nga përvoja jonë personale, ndonëse janë më të pakta në numër.

Pra, kemi bërë një vëzhgim të së folmes së çamërishtes në mjedise të ndryshme çame, duke vëzhguar gjendjen e saj statike, por nga ana tjetër, ndarja konvencionale në tre breza kërkon krahasime nga njëri brez tek tjetri, si dhe vëzhgime të thelluara të dukurive jashtëgjuhësore që ndërfiten në ligjërim. Për këtë arsye i kemi kushtuar kujdes të veçantë faktorëve që kanë ndikuar drejtpërsëdrejti, në varësi të rrethanave, konteksteve të ndryshme, kontakteve etj. Përmes shqyrtimeve të drejtpërdrejta të strukturës së ligjërit kemi arritur në përfundime me vlerë rreth dukurive sociolinguistike të së folmes çame, për hulumtimin e të cilave jam ndihmuar edhe nga shfrytëzimi i literaturës përkatëse e cituar sipas referencave përkatëse dhe në bibliografi.

Siç e thamë, ne kemi vëzhguar gjendjen statike të së folmes sipas brezave, duke krahasuar të folmen e secilit brez me njëri- tjetrin. **Por, kemi bërë edhe përjasje të tjera, duke e krahasuar të folmen çame të ditëve tona me të folmen e dokumentuar çame; me të folmen e autorëve më të vjetër shqiptarë; me të folmet anësore; me të folmet më skajore, si dhe me të folmet më jugore të shqipes.** Me pak fjalë, tema jonë shihet e kryqëzuar si në aspektin diakronik dhe në atë sinkronik, ku variabilitetet e Fishmanit “*kush flet, me kë, kur, për çfarë dhe në cilin varetet*”<sup>39</sup> si, *pse dhe ku*<sup>40</sup>, ndërthuren qartë me aspektet e diversitetit gjuhësor. Studimet tona janë përqendruar edhe në analiza të imta të aktit të të folurit dhe situatave shoqërore në të cilat kryhet ai. Këto kërkime janë parë gjithmonë në përshtatje me kushtëzimet shoqërore që vendos bashkësia në të cilën ne kemi shtrirë kërkimet.

Megjithatë, nëse do të shtronim pyetjen, “A mund të grupohen të gjithë folësit çamë si folës të një bashkësie të veçantë?”<sup>41</sup>

- Për t’iu përgjigjur, na vjen në ndihmë përkufizimi për bashkësinë shoqërore sipas Lyons-it: “me bashkësi gjuhësore përkufizojmë të gjithë njerëzit që përdorin një

<sup>37</sup> Në këtë mënyrë ekziston një dallim midis sintaksës dhe pjesës tjetër të gjuhës. Ajo është më rezistente ndaj variacionit sesa fonetika, morfologjia dhe leksiku. Dallimi shihet edhe në vetë faktin që shembujt që shfaqin dallime sintaksore brenda një varieteti janë shumë të rrallë. Kemi të bëjmë kështu me një mungesë në literaturë të referimeve për dallimet sintaksore. Kjo gjë sjell në këtë mënyrë edhe vështirësinë për të studiuar dallime të tilla, pasi aty ku ato ekzistojnë, provat në mbështetje të tyre janë deri diku të rralla në ligjërimin aktual. Nga ana tjetër, numri i njësive sintaksore është më i vogël në krahasim me njësitë leksikore. Pavarësisht këtyre, në përjasjen me tekstet e Reinholdit një sprovë të tillë jemi përpjekur ta bëjmë.

<sup>38</sup> Përmes shqiptimit, ne vëmë në dukje origjinën, përkundrazi nëpërmjet morfologjisë, sintaksës apo fjalorit, pra, gjuhësisë objektive ne nuk bëjmë gjë tjetër veçse identifikojmë statusin tonë aktual.

<sup>39</sup> Shkurtaj, Gj. *Sociolinguistika*, SHBLU, Tiranë 2000.

<sup>40</sup> Berruto, G. *La sociolinguistica*, Bologna, 1994.

<sup>41</sup> E njëjta pyetje shtrohet për të gjithë çamët në Shqipërinë shtetërore.



*gjuhë të dhënë*” (John Lyons 1970). Një faktor që duhet të kihet parasysh është ai i bashkëveprimit, i cili të çon në përfundimin se, bashkësi gjuhësore të ndryshme kryqëzohen dhe përputhen me njëra tjetrën dhe, jo vetëm kaq por, “*çdo individ krijon sistemet e sjelljes së tij verbale në mënyrë të atillë që ato t’i ngjajnë atyre të grupit ose të grupeve me të cilët herë pas here mund të dojë të identifikohet.*” ( La page dhe Tabouret- Keller 1985). Sipas këtij këndvështrimi individët e vendosin veten në një hapësirë shumëdimensionale, dimensionet e së cilës përcaktohen nga grupe që ata arrijnë t’i identifikojnë në shoqërinë ku jetojnë dhe këto grupe padyshim përputhen. Sa herë që flasim ose shkruajmë jo vetëm e vendosim veten në raport me pjesën tjetër të shoqërisë, por edhe e lidhim aktin tonë të komunikimit me një skemë komplekse të sjelljes komunikuese e cila ka formën e një matrice shumëdimensionale.<sup>42</sup> Nga ana tjetër, nëse të folmen tonë do ta quanim një të folme krahinore, për t’i klasifikuar si të tilla një prej kriterëve është ai gjeografik. Mirëpo, për sa i përket të folmes së diasporës çame, e shprishur dhe e shpërndarë gati në të gjithë Shqipërinë, themi se ky është një kriter jofunksional.<sup>43</sup> Për këtë arsye, nuk na ngelet gjë tjetër veçse të themi se “*ne kemi marrë për studim, të folmen e çamërishtes sot, në disa mjedise çame të Shqipërisë shtetërore.*”

E folmja e çamërishtes i përket dialektit të toskërishtes jugore, si e tillë ajo është e varur prej standardit. Nga studiues të caktuar, studime të tilla emërtohen si të karakterit patologjik. Mirëpo është tepër e vështirë të shprehësh gjykime për të gjitha të folmet. Për sa i takon çamërishtes, pavarësisht karakterit të saj të vjetëruar, rrethanave dhe konteksteve të veçanta me të cilat ka bashkëjetuar në shekuj dhe ndaj të cilave ka treguar rezistencë, ajo gjallon ndër folës çamë me fizionominë e saj, ende në ditët tona. Të gjitha këto janë të dhëna të rëndësishme që na e prezantojnë çamërishten si një e folme me mundësi të shumta kundrimi.

Çamërishtja është një e folme me avantazhe të mëdha për një punim sociolinguistik. Dikur një e folme në kontakt të vazhdueshëm me greqishten, më pas një e folme në kontakt me një shqipe të evoluar, dhe jo vetëm, por, të shpërndanë pas 44-ës në krahina të ndryshme anekënd Shqipërisë, mund të themi , -edhe një e folme në kontakt me të folme të ndryshme dialektore, nëndialektore a të folme krahinore të bashkësive të vogla shqiptare. Përfundimisht, themi se ajo na lë shteg për t’u vëzhguar në aspekte të ndryshme sociolinguistike dhe më gjerë.

Në sociolinguistikë le të themi që kjo është një sprovë e parë. Kështu, për të arritur në konkluzione të sakta duhet të grumbullonim informacione të pasura dhe për të shkuar drejt së panjohurës, t’i vilnim ato nga burime të sigurt. Kjo nuk qe një punë e lehtë. Hulumentimet e bëra i përkasin kryesisht viteve , 1978, 1998, 2003, 2007, 2010. Të dhënat janë vjelë në radhë të parë nga folës çamë të moshuar, nga krahina të ndryshme të Çamërisë, të cilët ruanin ende në ditët tona strukturën e së folmes çame. Ky burim i gjerë informacioni është pasuruar shpesh edhe nga pjesmarrja e vazhdueshme në biseda me çamë që ende jetojnë në Çamëri, përrurime librash të autorëve çamë, përrurime këngësh çame, pjesëmarrja në dasma çame, në mbledhje të ndryshme të organizuara nga shoqata çame dhe më vonë partia çame; në konferenca shkencore të organizuara nga intelektualë çamë, në shkolla verore të organizuara prej tyre me studentë çamë, duke mos përjashtuar ndofta padashur edhe të dhëna të memorizuara që në fëmijëri në lagjen time çame në plazhin e Durrësit; nuk mund të përjashtoj gjithashtu të dhëna të vlefshme që më ka dhuruar dhe më dhuron nga dita në ditë familja ime e re çame. Të gjitha këto janë bërë burim i pashtershëm të dhënash

<sup>42</sup> Shkurtaç, Gj. Po aty.

<sup>43</sup> Rrokaj, Sh. “*Të gjithë shqiptarët duhet të flasin shqipen standarde*”, në gazetën “Panorama”, dt. 15/ 12 / 2010

për temën tonë. Duhet të theksojmë që, tekstet apo anketat kanë qenë gjithmonë të njëjta për folës të veçantë, për të arritur më pas në përfundime të sakta.

Për çamërishten ka shkruar fillimisht Çabej. Në fushën e historisë gjuhësore shpeshherë çamërishtja është marrë si argument prej tij.<sup>44</sup> E folmja e çamërishtes ka tërhequr edhe vëmendjen e disa studiuesve kryesisht çamë në fushë të dialektologjisë, onomastikës shqiptare dhe të folklorit tonë popullor. Në fakt, një punë të vyer në aspektin e saj dialektologjik, i cili ka dhënë një përshkrim të mirëfilltë dhe të hollësishëm të kësaj të folmeje, e ka kryer me shumë sukses shumë vite më parë prof. Qemal Haxhihasani në studimin e tij të mirënjohur “*Vështrim për të folmen e banorëve të Çamërisë*”, botuar në serinë “Dialektologjia Shqiptare“, vëll. I, II, III. Ky folklorist dhe dialektolog me ndihmesa të vyera, gjeti në atë mjedis lëndën e parë për një nga monografite më të gjera dialektore që është shkruar për një të folme të shqipes. Ai voli, shkencorizoi dhe nxorri në pah në studimet e veta, një sasi të madhe dukurish etnofolklorike, onomastike dhe frazeologjike çame.<sup>45</sup> Me pak fjalë ai hodhi në letra atë çka për çamët sot do të konsiderohet « thesar », për nga vlera e madhe ruajtëse e dialektit të tyre mjaft interesant, në ditët e sotme. Megjithatë, për autorët çamë dhe studiuesit e çamërishtes do të flitet në vendin përkatës.

Qëllimi ynë në këtë punim nuk ka qenë vetëm të tregojë gjendjen e të folmes së çamëve sot, por të krijojmë tek lexuesi një ide për të folmen çame në ditët tona. Pas kësaj të shpjegojmë përmes rrugëve gjuhësore se si ka arritur deri këtu kjo e folme dhe të arrijmë në një punim me vlera përgjithësuese për çamët dhe çamërishten duke dhënë disa pika referimi për të gjithë ata hulumtues që do të dëshirojnë ta studiojnë çamërishten nga pikëpamja sociolinguistike në të ardhmen.

Për të gjitha këto kemi punuar vite me radhë dhe mendojmë se erdhi çasti që punën tonë disavjeçare ta kurorëzojmë përmes doktoraturës. Shpresojmë që me anë të lëvrimin të kësaj teme t’ia kemi arritur sadopak qëllimit dhe kjo, natyrisht, në të ardhmen do të mbetet përsëri objekt i shqyrtimeve të mëtejshme.

### **1.1.2. Vlerat studimore të çamërishtes për kundrimet sociolinguistike**

Sociolinguistika është pjesë e gjuhës, por formësimi i saj si disiplinë pas viteve ’60 është sprovë e qartë e bashkëveprimit që ekziston midis gjuhës dhe shkencave të tjera, në sajë të të cilit ato shërbehen reciprokisht.

Studimi i dialekteve të shqipes ka dhënë kurdoherë ndihmesa të vyera për disiplina të ndryshme gjuhësore, veçanërisht për historinë e gjuhës sonë. Prof. E. Çabej, për rindërtimin e fazave të hershme të shqipes së dokumentuar, apo për formësimin e shqipes së njehsuar, i shihte dialektet si lëndën e parë. Përmes metodës së krahasimit të brendshëm ky studiues, shumë herë provoi të kundërtën e atyre përfundimeve që albanologë të huaj pohuan për shqipen.

Vlera e çamërishtes është e pashmangshme në këtë drejtim. Vetëm përmes metodës së krahasimit të disa dukurive që kanë ndodhur në sistemin foljor të çamërishtes me faza të kapërcyera të shqipes, gjithmonë të vëzhguara në aspektin sociolinguistik, kemi provuar, jo vetëm që çamërishtja është dëshmuar e fazave të kapërcyera të shqipes, por edhe rolin e kësaj disipline në zbulimin e mjaft çështjeve të

<sup>44</sup> Çabej, E. *Studime Gjuhësore*, f. 98, Rilindja, Prishtinë 1976.

<sup>45</sup> Haxhihasani, Q. *Vështrim i përgjithshëm mbi të folmen e banorëve të Çamërisë*, në “Dialektologjia shqiptare“, vëll. I, Tiranë, 1971, vëll. II, Tiranë 1973.

karakterit historik.<sup>46</sup> Pra, përveçse në dialektologji,<sup>47</sup> çamërishtja paraqet interes të madh edhe në sociolinguistikë, duke na servitur larmi prurjesh dhe shtresëzimesh leksikore dhe përgjithësisht në etnografinë e të folurit, të cilët nuk kemi nguruar t'i trajtojmë, por edhe t'i vërtetojmë ato përmes të dhënave

Lëvizja mekanike e popullsisë në sociolinguistikën moderne është faktor i rëndësishëm i ndryshimit dhe zhvillimit gjuhësor. Shkaqet e evoluimit të së folmes çame në gjendjen e saj të sotme statike vërtet mund ta kenë burimin tek lëvizjet e herëpashërshme mekanike të kësaj popullsie, por argumentohen edhe përmes faktorëve të tjerë, më i rëndësishmi prej të cilëve është **mënyra sesi çamët janë integruar brenda bashkësive pritëse.**

Arsyet e shpërnguljes së popullsisë çame tashmë janë të njohura nga të gjithë dhe mendojmë se kjo e folme është ndër të parat dëshmi për atë çka prof. Shezai Rrokaj me të drejtë pohon për të folmet dialektore sot. *“Shqiptarët po lëvizin lirshëm brenda trojeve tona e, bashkë me ta, idetë, traditat, fjalët. Për shumë arsye, është thyer koncepti i enklavës gjuhësore dhe territori si koncept gjeografik nuk shërben më për përkufizimin e dialektit, i cili nën trysninë e shoqërisë globale, po hyn në një marrëdhënie sociolekti me standardin dhe gjithëgjuhën.”*<sup>48</sup> Me të drejtë themi se ky pohim vendos një kufi ndarës midis dy disiplinave: dialektologjisë dhe sociolinguistikës, madje do të shtonim se përkufizon më së miri sociolinguistikën shqiptare.

Konkretisht e ilustruam këto përmes studimeve tona në vite: nëse do të flisnim për shpërnguljen e çamëve në Shqipërinë e Mesme, ky ka qenë një proces që karakterizohet nga një shpërngulje e dhunshme e popullsisë shqiptare nga viset e origjinës ( të krahinës më jugore të Shqipërisë), në një hapësirë të Shqipërisë së Mesme. Pas kësaj lëvizjeje të popullsisë çame, nuk mund të anashkalojmë edhe lëvizjet e herëpashërshme brënda vendit dhe mënyrën se si ato u përfshinë në rrjedhën e jetës që i priste, si bashkëjetuan me bashkësitë e vogla durrësake në gji të të cilave u përfshinë. E njëjta gjë ka ndodhur me integrimin e tyre edhe në bashkësitë e tjera shqiptare, veçse vështirësia e integritit sigurisht nuk ka qenë e njëjtë për të gjitha bashkësitë.<sup>49</sup> Më të lehtë e patën çamët të përshtateshin nga pikëpamja gjuhësore me jugun e Shqipërisë. Kështu, tek çamët e rrethit të Durrësit, bëhej fjalë **për integrim brenda një bashkësie shoqërore durrësake**, e cila përkonte me qendrën, por që në origjinë i përkiste një dialekti tjetër, konkretisht të folmes së gegërishtes së Shqipërisë së Mesme. Kontakti me këtë bashkësi, më vonë do të sillte edhe ndërrime të dukshme në etnografinë e të folurit apo në sjelljen gjuhësore të folësve, siç pritet të ndodhë rëndom me folës që shpërngulen dhe vijnë e ngulen në një mjedis të ri. Çamët kanë ruajtur gjithmonë me fanatizëm të folmen e vet dhe vazhdojnë ta ruajnë ende deri në ditët tona. Kjo krahinë ka qenë e zhvilluar në shumë drejtime para se të ndodhte shpërngulja; nga pikëpamja ekonomike, niveli kulturor etj. Për këtë arsye ekzistonte një hendek i madh midis bashkësisë çame dhe bashkësive pritëse ku ato janë vendosur i cili manifestohet përmes diferencave në sjelljen gjuhësore të individit ( çamërishtja ishte një gjuhë shumë më e vjetër sesa shqipja e evoluar ), mënyrë jetese, tradita, kulturë etj. Megjithatë, me këto lloj situatash çamët u përballën.

<sup>46</sup> Troplini, E. *Sistemi foljor i çamërishtes në diakroni*, kumtesë e mbajtur në Seminarin e III- të Ndërkombëtar të Albanologjisë, Tetovë, 2010.

<sup>47</sup> Shih: Haxhihasani, Q: Po aty


<sup>48</sup> Rrokaj, SH: *Të gjithë shqiptarët duhet të flasin shqipen standarde*, në gazeta “Panorama”, dt. 15/ 12 / 2010

<sup>49</sup> Këtu duhet të kemi parasysh edhe lëvizjet brenda vetë bashkësive.

Nëse do të shtrojmë pyetjen, a janë integruar lehtësisht çamët në bashkësitë pritëse? - përgjigjja do të ishte, fillimisht jo. Ata janë integruar me një lloj vështirësie e cila në vite ka ardhur duke u zbehur. Vështirësinë që krijoi përplasja midis dy të folmeve ( çamërishte – e folme pritëse), e shohim qartë në ligjërimin e përditshëm: “*Ne u thoshim ç’u dive/ mirëmëngjes/ ato na thoshin/ s’kemi thes neve jo/ s’kemi thes.*”<sup>50</sup> Nga kjo e dhënë e vogël në pamje të parë, nuk është e vështirë të dilet edhe në përfundime. Kështu nga ky pohim, pikë së pari kuptojmë vështirësinë e çamëve për t’u integruar që në fillim, si nga pikëpamja gjuhësore, ekonomike etj. dhe, nga ana tjetër, fjala *mirëmëngjes* tregon se procesi i zëvendësimit dhe orientimi kah shqipes së përgjithshme ka ndodhur që në fillim ( fjala *ç’u dive (si u gdhive)* është zëvendësuar që në fillim me atë *mirëmëngjes*. Me pak fjalë, kjo ishte pak a shumë situata e çamëve të vendosur në Shqipërinë shtetërore.

Të gjitha rrethanat e shpjeguara më lart në lidhje me lëvizjen mekanike të kësaj popullsie, por edhe me gjithë mënyrën e integrimit dhe përpjekjes së tyre për mbijetesë, për rrjedhojë, të gjitha proceset gjuhësore që prekin këtë të folme janë të dhëna jo vetëm të mjaftueshme, por që shtrajnë si detyrë lëvrimin sociolinguistik të së folmes.

Shpërnguljen e fundit të çamëve shpeshherë e kemi quajtur shpërngulje **nga Çamëria në Shqipërinë shtetërore**, dhe jemi të detyruar ta shprehim në këtë mënyrë, megjithëse nuk është aspak e thjeshtë në aspektin gjuhësor dhe atë kulturor. Pak a shumë gjatë punimit kemi pasur gjithmonë parasysh një skemë të tillë, e cila na ka ndihmuar për të kuptuar dhe hulumtuar me lehtësi:



Pra, e folmja e çamërishtes, e cila ndikohet vazhdimisht nga e folmja e bashkësive pritëse me rrethinat përreth, ndikim ky që vërtetohet që me brezin e vjetër dhe, nga ana tjetër, dy të folmet e tjera krahinore të cilat bashkohen me atë prirje që karakterizon sot të gjitha të folmet e tjera dialektore, orientimin kah gjuhës shqipe të njehsuar. Prekja e sistemit, qysh nga çasti i parë i kontaktit të folësve çamë me bashkësitë shoqërore në të cilat ato janë vendosur, pra, qysh nga kontaktet e para të çamërishtes me shqipen e evoluar nuk ka qenë e njëjtë **në kohë**. Procesi i ndikimit të standardit, si dhe ndikimi kah e reja në gjuhë, ka qenë dhe do të jetë i ndryshëm, në kohë të ndryshme, për motive, rrethana dhe kontekste të ndryshme. Një prej këtyre motiveve ka qenë edhe fakti se çamët shpesh janë karakterizuar nga lëvizje të pandërprera **edhe brenda për brenda Shqipërisë shtetërore**.

Të gjitha këto janë rrethana që sigurisht, e bëjnë më të rëndësishëm kundrimin e procesit të konservacionit apo ruajtjes së dialektit çam dhe të inovacionit apo përthithjes së dukurive nga gjuha shqipe standarde, përkatësisht edhe nga mjedisi joçam i Shqipërisë shtetërore. Madje, përveç këtyre dy proceseve siç e kemi shtjelluar edhe në 1.1., ne kemi vërejtur edhe një proces të tretë të cilin në mënyrë konvencionale e kemi quajtur **“një proces ndërkomunikimi”, që kurdoherë ndërlihd të renë dhe të vjetrën në breza**. Dukshëm ky lloj procesi shfaqet në brezin e mesëm i cili luan edhe rolin e një “koridori” komunikues midis brezit të ri dhe të vjetër.

<sup>50</sup> B. Habibi, (Plazh- Durrës), 1996

Këto procese nuk përjashtohen edhe për të folme të tjera dialektore por, nga ana tjetër, **ato janë të ndryshëm në përshtatje me jetën e secilës prej të folmeve.** Përshembull, në lidhje me të folmen e çamëve dhe atë të arbëreshëve të Italisë, një ndër faktorët e jashtëm gjuhësore me një forcë të konsiderueshme ndikuese në procesin e konservimit të këtyre dy të folmeve është faktori psikologjik që lidhet me shkakun e shpërnguljes së këtyre popullsive me fate të njëjta, që padyshim nuk është i njëjtë, por që kushtëzon njëllot të folmet. Duke e përsëritur edhe një herë atë çfarë sqaruam fillimisht në 1.1,

I gjithë ky proces është i tillë, i cili në vetvete përfshin risimin, përkatësisht edhe **ndryshimin** e së folmes në brezin e vjetër, në atë masë, që brezi i ri **kultivon** elementin e vjetër çam, përkatësisht edhe ruajtjen e së folmes në të; ndërsa tek brezi i mesëm do të shohim ndërthurjen midis dy të folmeve. E folmja e tyre është ruajtëse aq sa është edhe rinovuese, pasi atyre u lind si detyrë të përshtasin të folmen herë kah e folmja e më të vjetërve në moshë dhe, herë nga ajo e fëmijëve dhe e jetës jashtë familjes.

E folmja e brezit të vjetër është konservative, por nuk ka mbetur e paprekur. Ajo priret drejt ndryshimit. Në të vërejmë fjalë të standardit letrar dhe më rrallë, fjalë të bashkësisë pritëse në të cilën ato janë vendosur.

E folmja e brezit të ri është pak a shumë bashkëkohore, por nuk është krejtësisht standarde. Ajo kultivon edhe ruajtje. Në të gjejmë edhe elemente të bashkësisë pritëse, por kryesisht ajo anon nga gjuha letrare standarde<sup>51</sup>.

Ndërsa, e folmja e brezit të mesëm në bashkëpërshtatje me faktorë të ndryshëm jashtëgjuhësorë<sup>52</sup>, të cilët ndikojnë pa përjashtim edhe në të folmen e dy brezave të tjerë, herë përshtatet me të folmen dialektore, pra me variantin tradicional të brezit të vjetër dhe herë me variantin e brezit të ri, të cilët, synojnë standardin<sup>53</sup>. Në të folmen e këtij brezi, ndërfitjet (interferimet) e elementeve të bashkësisë pritëse janë më të shumta në krahasim me dy brezat përkatës.

Në këtë mënyrë, kemi mëtuar të verifikojmë mënyrën sesi varianti tradicional ka dhënë dhe ka marrë me variantin e ri, proces që vijon edhe sot e kësaj dite.<sup>54</sup> Të gjitha dukuritë gjuhësore që pasqyrojnë këto variante më vete, apo që ndodhin përgjatë marrëdhënieve të tyre me njëri tjetrin, çojnë tek procesi më i rëndësishëm për sociolinguistikën, tek “motorri” i evolucionit të gjuhës, **ndryshimi gjuhësor**. Ky i fundit nxitet e përcaktohet nga zhvillimi i përgjithshëm shoqëror dhe kulturor, po natyrisht, dhe nga forcimi e shtimi përherë e më i fuqishëm i trysnisë (presionit) që ushtron gjuha me prestigj kundrejt të folmeve krahinore, prirjes së saj rrafshuese kundrejt diferencave dhe forcës unifikuese që ka ajo.<sup>55</sup>

Procesi i përzjerjes apo i bashkëveprimit, i përshkruar më lart shoqërohet gjithnjë e më shumë edhe nga një proces hinkëzimi (shoshitjes) i vazhdueshëm, i cili në të tilla raste është mjaft i nevojshëm dhe është një proces mjaft natyral që vendos për ato dukuri që i nënshtrohen bjerrjes, ruajtjes, risive, shndërrimeve, ndryshimeve, situatave bilinge, shkeljeve në normën e të folurit etj. Këto të fundit gjithmonë janë të

<sup>51</sup> Për më tepër shih: Troplini, E. *E folmja e çamërishtes në kuadrin e marrëdhënieve gjuhë standarde-dialekt*, kumtesë e mbajtur në konferencën shkencore të albanologjisë, Prishtinë, Gusht- 2009; *Disa tipare ruajtëse të çamërishtes*, botuar në Seminari e II – të Ndërkombëtar të Albanologjisë, Tetovë 2009; “Universi”, Tiranë 2009; *Ndikimi i disa prej faktorëve jashtëgjuhësorë në të folmen e çamërishtes*, kumtesë e mbajtur në konferencën e Institutit Intelktual Çam, botuar në “Çështja çame dhe integrimi evropian”, Tiranë 2010.

<sup>52</sup> Rol të dorës së parë tek e folmja e brezit të mesëm marrin edhe elementet e veprimtarisë ligjërimore.

<sup>53</sup> Shkurtaç, Gj. *Disa dukuri të së folmes së Kurbinut në dritën e sociolinguistikës*, SF, 1998.

<sup>54</sup> Shkurtaç, Gj. Po aty.

<sup>55</sup> Shkurtaç, Gj. *Sociolinguistika*, Tiranë 2003

kontrolluara nga një normë zyrtare, por edhe qytetare. Pak a shumë **gjendemi në një situatë të ngjashme me atë të gjuhës standarde**. Nga ana tjetër, kjo është më se normale për sa kohë që ne vetë jemi mjaft kontradiktorë në momentin kur duam të dallojmë gjuhën nga dialektet. Gjuha duket sikur i përfshin të gjitha dialektet, por ndërkohë ajo mund të jetë vetëm një dialekt i vetëm, apo gjuha është konvencionale dhe dialektet gjuhë natyrale...; si përfundim si gjuha dhe dialektet përbushin të njëjtin funksion atë të komunikimit midis njerëzve, duke iu nënshtruar paralelisht edhe proceseve të njëjta siç është ai i ndryshimit dhe i rinovimit të vazhdueshëm.

Shtresëzimet, zëvendësimet e ndryshme sidomos në leksik, lindin bashkë me nevojat e reja komunikuese si pasojë e zhvillimeve shoqërore të një bashkësie të caktuar. Pra, ndryshimi i të folmes çame merr përmasa edhe më të mëdha po të kemi parasysh atë prirje që bashkon sot mbarë të folmet: përshtatja e saj me zhvillimin e kulturës, veprimtarinë prodhuese, mjetet e reja teknike, jetën politike-shoqërore, përparimin e shkencës, elektronikës etj.

“Nga krahasimi i inventarit gjuhësor të të folmeve, me inventarin e gjuhës letrare, del se tek të folmet ka një numër tiparesh fonetike, gramatikore, e leksikore që janë të ndryshme nga ato të normës letrare, tipare që nuk kanë arritur të ngrihen në nivelin e gjuhës letrare dhe funksionojnë sot si **dialektalizma.....**”<sup>56</sup> Për sa i takon të folmes së çamërishtes, të ashtuquajturat “dialektalizma” **nga Gjinari, për ne përbëjnë të ashtuquajturin bosht a fizionomi të kësaj të folmeje.**

Kjo masë jo e vogël dialektalizmash e mbetur jashtë normës letrare vihet në lidhje të dyanshme me gjuhën letrare; një pjesë e saj i nënshtrohet veprimit të gjuhës letrare dhe tretet dalngadalë, pjesa tjetër hyn kohë pas kohe në përbërjen e gjuhës letrare për pasurimin e saj. Të dyja pjesët e kësaj mase të dialektalizmave ndjekin rrugën e konvergjitimit me gjuhën letrare, por duke u sjellë në mënyra të ndryshme: njëra pjesë tërhiqet për t’u lënë vendin tipareve të gjuhës letrare, kurse pjesa tjetër lëviz në drejtim të gjuhës letrare për të hyrë e për të zënë vend atje e që të bëhet pjesë përbërëse e saj.”<sup>57</sup>

Në këtë lloj tërheqjeje (me shumë humbje, pasi ajo është edhe konservuese, por edhe integruese në bashkësitë pritëse) fiton ndryshimi, si dhe orientimi kah gjuhës me prestigjin më të madh, siç është gjuha zyrtare standarde.<sup>58</sup> Në këtë drejtim ajo bashkohet me atë prirje që përbashkon sot mbarë të folmet, por siç edhe e përmendëm të folmet krahinore nuk orientohen të gjitha njëjloj kah gjuhës standarde. Çamërishtja ndihmohet në këtë drejtim më shumë se të tjerat edhe sepse ajo është pjesë e dialektit të toskërishtes.

Nga ana tjetër nga e gjithë kjo analizë e hollësishme nuk mund të anashkalohen kurrësesi **zhvillimet e vetvetishme të brendshme të një të folmeje.**

P.sh, në kohën e pakryer të së folmes së çamërishtes ndërmjet mbaresave të hershme të vetës së parë dhe të dytë të shumësit dhe temës përkatëse, kemi tingullin mbështetës –i në vënd të tingullit mbështetës –ë. Pra tek çamët kemi: *thoshi, thoshe, thosh, thoshimë, thoshitë, thoshinë*. Kjo është një dukuri e cila vihet re vetëm tek folja *thom/them*, por jo tek foljet e tjera.

Tek dy foljet e tjera në vetën e parë dhe të dytë shumë vërejmë mospraninë e –ë-së mbështetëse, përkatësisht: *keshmë, jeshmë/ keshtë, jeshtë*. Shembujt që vërtetojnë një gjë të tillë janë të panumërt, dhe do të trajtohen gjatë gjithë punimit në të tri sistemet: fonetik, morfologjik dhe atë leksikor, por sa për ilustrim të asaj çfarë

<sup>56</sup> Gjinari, J. *Marrëdhëniet e sotme të gjuhës letrare me dialektet*, S.F., 1985.

<sup>57</sup> Gjinari, J. Po aty.

<sup>58</sup> Shkurtaç, Gj. Po aty

pohuam dhe për lehtësi studimi përmendim disa shembuj nga sistemi foljor i çamërishtes.

Kështu, foljen *shoh* e gjejmë në trajtat: *she, sheh, shoh, shomi*. Tek këto trajta foljore që i gjejmë në çamërishten e viteve '78, vërejmë dysorësi në të folur, ku herë përdoret trajta *she dhe herë trajta sheh*. Pra, në të folmen e çamëve vërejmë, si trajtën e hershme *she, e cila* përkon me trajtën e shqipes së vjetër, ashtu edhe trajtën e shqipes së sotme *sheh*, si risi në këtë të folme. Risi përbën edhe folja *shoh* e saj. Karakteristike është trajta e hershme *shomi* e çamërishtes në vënd të trajtës *shohim*, për të cilën mendojmë se përdoret **në analogji** me trajtën *thom/thomi*;

Dysorësi në përdorim vërejmë edhe tek foljet *bie/ bije*. Megjithëse në çamërishte në më të shumtën e rasteve *j*-ja antihiatizuese mungon, në këtë rast ajo shfaqet.

Tek foljet me temë në bashkëtingëllore në vetën e dytë shumës na tërheqin vëmendjen disa dukuri për të cilat mendojmë se **janë zhvillime brenda të folmes**, p.sh: (*ju*) *hapi, marri/merri, flisi, vrisi/vriti etj*.

Si e tillë konsiderohet edhe shtimi i *ë*-së fundore tek folja *duamë, për të cilën mendojmë* se është bërë për analogji me ato fjalë tek të cilat *ë*-ja fundore ruhej dhe vazhdon të ruhet ende në këtë të folme. **Ë**- në fundore e vumë re edhe tek folja *jam* në vetën e tretë, *ishtë*<sup>59</sup>

Ndër folës të moshave të ndryshme janë vënë re edhe disa dukuri pa kurrëfarë origjine e shpjegimi. E tillë është edhe mbaresa foljore e vetës së tretë e së kryerës së thjeshtë ( e foljeve me temë në zanore) që përdoret për analogji me dy vetat e para, p.sh: *punova, punove, punovi; mësova, mësove, mësovi; luftova, lutove, luftovi*.

“Procesi i tretjes së dialektalizmave nuk kryhet në një kohë të shkurtër dhe me ritme të njëjta në të gjitha grupet, shtresat dhe brezat e shoqërisë”<sup>60</sup>. Gjithashtu nuk është e njëjtë për të gjitha tiparet dialektore qëndresa ndaj trysnisë së gjuhës letrare, disa tipare tërhiqen më shpejt nga dialekti e disa më vonë, disa më lehtë e disa më me vështirësi. Kjo varet nga funksioni dhe vendi që zë njëri ose tjetri tipar dialektor në sistemin e gjuhës.

“Të parat që tërhiqen prej dialekteve, janë veçoritë që nuk e prekin sistemin, nëse ato dalin jashtë të folmeve, duke u zëvendësuar me tiparet e gjuhës letrare...”<sup>61</sup> Kështu për çamërishten përmendim foljen **ban(j)** të vetës së parë të shqipes së hershme e cila në çamërishten e sotme del në trajtën **bi**, dhe në raste më të rralla ajo del edhe në trajtën **bij**. Mendojmë se **në çamërishte** *nj*-ja e kohës së Buzukut ka rënë dhe rishfaqja e saj nuk ka të bëjë me evoluimin e *nj*-së në *-j*, por *j*-ja e këtyre foljeve, është risi e mëvonshme e shqipes së përgjithshme nga kontakti i mëvonshëm midis dy të folmeve.<sup>62</sup> Të njëjtën gjë vërejmë edhe tek folja *mbaj*; edhe ajo shfaqet në trajtën *ba* ( *e ba mënd?* / *e mbaj mënd* ), madje tek kjo folje shohim edhe një tjetër dukuri; vihet re rënia e *n*-së fundore të temës ( pak a shumë si tek *zâ* (*zan-ë*), rishfaqja

<sup>59</sup> Ruajtjen e *ë*-së fundore në çamërishte e kemi parë edhe në punimin “*Bashkëpërkime midis të folmes së çamërishtes dhe të folmes së autorëve të vjetër të shqipes*“, Alb- Shkenca, 2009, dukuri të cilën e vërejmë edhe tek Buzuku.

<sup>60</sup> Shkurtaç, Gj. *Rreth ndryshimeve në gjuhën e fshatit të sotëm të Veriut*, në “St. fil.” 4, 1969; *Vëzhgime mbi shtresat leksikore dialektore dhe letrare në të folmen e Lezhës*, në “St. fil.” 3; (1984) *Shtresëzime dhe risi gjuhësore në qytetin e Lezhës*, në “St.fil.” 2, 1984

<sup>61</sup> Gjinar, J. *Marrëdhëniet e sotme të gjuhës letrare me dialektet*, S.F., 1985.

<sup>62</sup> Pas shpërnguljes së dhimbshme të çamëve më 1944-ën, çamërishtja vazhdon të ruhej mirë prej folësve të kësaj krahine. Kujtojmë se e njëjta gjë ka ndodhur me shqipen e diasporës apo me të folmet anësore në përgjithësi të cilat kanë bashkëjetuar dhe vazhdojnë të bashkëjetojnë nën trysninë e një gjuhe tjetër. Me shpërnguljen e çamëve në Shqipërinë shtetërore tashmë ajo u gjend përballë një shqipeje të evoluar.

e së cilës mendojmë se ndodh për të njëjtat arsye, pra nga kontakti me shqipen e përgjithshme. Të njëjtat vërejtje vlejné edhe për foljen **vij** etj.<sup>63</sup>

Nga ana tjetër, në gjithë këtë proces një rol të rëndësishëm kanë luajtur gjithmonë dhe vazhdojnë të luajnë faktorët jashtëgjuhësore.<sup>64</sup>

Karakterit ruajtës i disa tipareve të veçanta të çamërishtes si, grupet e moçme *kl, gl*, (*klumushti, gluha, i glatë, të gletë*); ruajtja e *l*-së së pajotizuar (*valë, bilë, golë, fëmilë*) etj; mungesa e zanores *-y* në sistemin fonetik të kësaj të folmeje, trajta e vjetër *-u*, e vetës së parë të përemrit vector *unë*, format e hershme të foljeve të zgjedhimit në *– mi, keshë, keshe, jeshë, jeshë, thom, thomi*, etj., të cilat janë dukuri që gjenden “**në fjalë të veçanta të së folmes, ose që lidhen me pjesë të sistemit**”<sup>65</sup> dhe, për rrjedhojë, duhet të ishin të parat që mund të tërhiqeshin përballë variantit letrar; këto dukuri të cilat i gjejmë edhe në librin e parë të gjuhës sonë “Meshari”, por që i gjejmë edhe në disa të folme anësore të shqipes si e folmja e arbëreshëve etj.; të gjitha këto, duam apo s’duam ne janë pjesë e fizionomisë së kësaj të folmeje, për sa kohë që ato gjallojnë ende ndër çamë në ditët tona. Këto tipare interesante kurdoherë kanë tërhequr vëmendjen e dialektologëve sot, por edhe të gjithë atyre që merren me historinë e gjuhës shqipe, me fonetikën historike dhe përgjithësisht me studimet e kulturës popullore shqiptare.

Pa dashur të zgjatemi në shembuj të tjerë bashkëpërkimesh midis të folmes çame dhe asaj arbëreshe apo arvanitase, për të shmangur edhe ndonjë përsëritje të dukurive që do të rendisim më poshtë ( pasi kemi parasysh këtu edhe afrinë e të folmes së autorëve të vjetër me të folmet arbëreshe), por edhe sepse i kemi trajtuar në një kapitull më vete, po kalojmë shkurtimisht tek mendimi i studiuesit Emil Lafe për të folmet e autorëve të vjetër: “*një vlerë tjetër e madhe e autorëve të vjetër, përveç synimit (fort të vështirë) “ en së dashunit së botësës sanë” dhe “me zditunë pak mendetë” e popullit të vet “ ndë Arbant”*; është se ata na dëshmojnë me veprat e tyre *një fazë të gjuhës sonë kur dy kryedialektet e saj ishin më afër me njëri-tjetrin dhe vetë gegërishtja ishte më e njësishtme.*<sup>66</sup>

E folmja e çamërishtes ruan deri diku në një shkallë të gjerë, tipare të një faze të kapërcyer të shqipes, tipare që në rrjedhë të moteve, në shumë nga krahinat qëndrore dhe përgjithësisht në shqipen e sotme, janë bjerrë dhe tjetërsuar shumë. Pjesorja e foljes *bëj* në këtë të folme vërteton më së miri atë çfarë studiuesit kanë pohuar shpesh për të folmen e autorëve të vjetër, si edhe për çamërishten. Kjo është një dukuri e cila bëhet dëshmuese e asaj faze në të cilën dukuria e rotacizmit nuk ishte shfaqur ende. P.sh: *Ç’ke bënë / jam mërztur*, se kam kaq kohë me si billur. Po ti xerë i keshe baba. Ai është hoxha që më ka bënë mua të gjitha këto hupe.

Në sistemin foljor meritojnë të përmenden disa dukuri si:

- dukuria e aoristit sigmatik, e cila shfaqet edhe në kohë të tjera foljore: *pāçë, lāçë, u qorruaç* (joveprore) etj

- format që ende ekzistojnë, - të së pakryerës së foljeve të zgjedhimit në *–mi, jeshë/ jeshë*, të cilat janë edhe argument i fortë i disa shpjegimeve gjuhësore historike siç është ai i shpjegimit të ndërrimit të temave *ja/je*, tek foljet e këtij zgjedhimi, gjoja përmes metafonisë.

- në çamërishten e hershme, por edhe në atë të ditëve tona, gjithmonë na kanë

<sup>63</sup> Për më tepër shih: Troplini, E. *Sistemi foljor i çamërishtes në diakroni*, në “Aktet” e Seminarit të dytë ndërkombëtar të Universitetit shtetëror të Tetovës.

<sup>64</sup> Shkurtaç, Gj: *Sociolinguistika*, shblu, Tiranë 2002

<sup>65</sup> Sipas argumentimit të prof. Jorgji Gjinarit, po aty f. 45

<sup>66</sup> Lafe, E: *Rëndësia e autorëve të vjetër për shqipen e sotme*, po aty, f.28. Përveç studiuesit në fjalë ky është një mendim i pranuar në tërësi nga të gjithë gjuhëtarët.



tërhequr vëmendjen format foljore të foljes **vete** në të kryerën e thjeshtë: *vata, vate, vate/ vati; vāmë, vātë, vānë*; mjaft interesante janë edhe trajtat e hershme *dolla, duallë* etj, si dhe dukuritë e ndryshme fonetike në temat dhe mbaresat e foljeve, përkatësisht: *xora (nx>x), prinë (tn>n), hamnë (pn>mn), sellkëdis (sekëlldis)* etj.

Fjalët **hinë, klan, pjesin, drojnë, grihet**, flasin qartë për praninë në to të dukurive tipike fonetike të çamërishtes, përkatësisht: **asimilimi mb (mbaj), nd,ng > m (baj), d, g**; rënia e *ë-së* së patheksuar *dërroj> droj; kl, gl, > q/ k, gj; mungesa e zanores y* dhe përdorimi në vënd të saj i zanores *-i: hinë/ hynë*; prania në këtë të folme e diftongjeve të tilla si diftongu *ie*, që gjendet tek folja *pjesin*; në këtë grup foljesh spikasin edhe ndërrime të tjera si; *punoj> pënoj, sjell> sell* etj;

Prapangjitja karakteristike e pjesëzës **-te**, vihet re sot kryesisht tek foljet *bëj, vij, shoh, pres*, në kohën e ardhme të mënyrës dëftore, si: *do bite, do vite, do preste, do shote*; foljet *bëj* dhe *vij* me këtë prapashtesë i hasim edhe në të tashmen e lidhores, *të bi-te, të vi-te*. Më të rralla janë këto përdorime në kohën e tashme të dëftores: *e bite ù ; vite ù*. Për kohën e tashme spikat folja *shoh: Pse, shote u?* (Pse shoh une). Kjo dukuri ka ardhur duke u bjerrë po të krahasojmë çamërishten e sotme me shembujt nga punimi i Prof. Q. Haxhihasanit. Kështu kjo prapashtesë nuk përdoret më në fjalët, *them (-te), jam (-te), los (-te), kam (-te)*.

Shpeshherë, në trajtimin e disa temave radhazi për çamërishten, kemi pikuar shpesh rreth pikëtakimeve të elementeve antike të çamërishtes së sotme me ato të veprave më të hershme, si dhe tek rëndësia e kësaj të folmeje në fushë të studimeve gjuhësore. Kështu nga përçasja e të folmes së çamërishtes sot, me një prej veprave më të hershme të shqipes, “*Mesharit*” të Gjon Buzukut (1555) kemi vënë re mjaft ngjashmëri të karakterit fonetik, morfologjik edhe leksikor. Studiues të hershëm si edhe ato të kohës së sotme, pohojnë bindshëm rëndësinë e veprës së Buzukut, por edhe të dialekteve njëkohësisht. Albanologu **K. Topalli** e quan veprën e Buzukut “*monument të lashtë që mbetet si i vetmi burim prej të cilit mund të mësohen tiparet e shqipes në gjysmën e shekullit XVI.*” Por, nga ana tjetër, ai shton se “*dihet që gjuha e një populli ekziston përmes dialekteve dhe të folmeve të veçanta.... Studimet duhet t’i nënshtrohen një krahasimi shumë palësh me botime të tjera të hershme të shqipes dhe me të dhënat e dialekteve të sotme.*”<sup>67</sup>

Kështu, si tek e folmja e çamëve të vjetër sot, ashtu edhe tek “e folmja” e Buzukut, përveç dukurive të lartpërmendura si: ruajtjen e zanoreve të gjata; mungesën e zanores y; trajtën e përemrit vector **unë** pa epitezën *-në*, pra në formën e shkurtuar **u** (*atah nëh janë xhudhi edhe u jam...*,-Buzuku; *ù të kam si vajzat e mia tashi; ..ù kam qënë nxënës shkollë n’atë kohë*,- çamërishtja e sotme); ruajtjen e **l-së** së vjetër ndërzanore; ruajtjen e togjeve bashkëtingëllore **kl, gl** kryesisht në fjalë të tilla si: *kle- qe* (ishte), *kleçë- qeshë, glisht- gisht, klumusht (qumësht), i glatë* (i gjatë), *kliçe* (kyçe), *glëmbi (gjëmbi), i shklier* (i shqyer), *i shklarë* (i shqarë- i shkarë), *klishë* (qishë-kishë) etj. Tek “Buzuku” përkatësisht do të kemi: **i glatë, endiglo, gluhë, clissë, klai/ klanjinë, glunjë** (*me zdrinë mendetë e atyne qi të ndiglonjinë*); pra, përveç këtyre dukurive të ngjashme midis dy të folmeve, na kanë tërhequr vëmendjen edhe të tjera dukuri si: <sup>68</sup>

- ruajtja e bashkëtingëllores fundore **-t** për rasën dhanore;
- mbaresa inovuese **-imë** tek Buzuku, për foljet e vetës së parë shumës, të kohës së tashme, mënyrës dëftore, diatezës veprare, e cila gjendet edhe sot në të

<sup>67</sup> Topalli, K: *Veçori të shqipes së shek. XVI përmes “Mesharit” të Buzukut*, po aty, f.42

<sup>68</sup> Që sigurisht nuk janë të vetmet; për më tepër shih: Troplini, E. “*Bashkëpërkime midis të folmes së çamërishtes dhe të folmes së autorëve të vjetër të shqipes*”, botuar nga instituti albanologjik Alb-Shkenca, 2009; shih gjithashtu në këtë punim temën me të njëjtin titull f. 65- 71

- folmen e brezit të vjetër çam. Kështu tek Buzuku kemi: *na qi baimë* 11a4, *porsi edhe na lironimë*; ndërsa tek çamët kemi: *bimë, pënoimë, klaimë* etj;
- një tjetër bashkëpërkim midis dy të folmeve e gjejmë edhe tek të ashtuquajturat folje të zgjedhimit në **mi: kam, jam**, (thom). Kështu tek Buzuku kemi: *...qi ù keshe lenë..* ; *i kish ardhunë hera e ti 104a4..*; *e ù në mos arkëshe e ù në mos keshë thanë atyne, të mos paskishnë kuat171b5*; ndërsa në çamërishte e sotme kemi: **jesha, jeshe, ish/ jeshëm, jeshët, ishnë; kesha, keshe, kish/ keshëm, keshët, kishnë**;
  - në praninë e dikurshme tek dy të folmet të trajtave të vjetëruara: **kleva, kleve, kle**, etj. *jeshën e vashëza të tëra..*; *keshën vrarë..*; *në dasmëra atje keshe qejf të shooje..*;
  - mbaresat e foljeve joveprore me temë në zanore dalin me të njëjtën formë sikurse foljet me temë në bashkëtingëllore, p.sh: **Buzuku: ù nçonem** 69b8, *a do të pagëzonesth* 34b6, *ai...qi ndë muo mos skandalixonetë* 38a7, *porsi kthenetë torrenti*5b45, *a nukë shihni se gja nukë shumonemi; banemi, kthenemi, shkurtonenë* etj. Çamërishte e sotme: **vineshin** *katër pesë kaurrë .. diku bënej shaka ...*; *martonej djali .. / kur vineshin njerzt e burrit / kur vineshin që niseshin..*; *rregullonesthin, shtroneshin pajtoneshin* etj.;
  - trajtat e aoristit sigmatik janë të pranishme tek të dyja të folmet etj. P.sh: tek Buzuku kemi: **u mbeç** *me ta* 23a9; *u Gjoni gjegjish, u di kaha erdhshë*87b31; *ù paçë pësuotë* 174a45; **u gëzuoshë, u mplakshë, u rrëfyeshë, u bashë** etj., ndërsa në të folmen e çamëve të moshuar kemi: **i thaçë, ia thaçë ù, t'e thaçë ù më parë, do viç me mua; do të shkruaç ti; do t'incizoç ti..**; **u bëç** (*u bëra*), **u mplakç, u merruaç, u lodhç, u poqç** (*n'diell*) etj.;
  - prania e foljes **gjegjem** dhe përdorimi i shpeshtë i kësaj foljeje ende në çamërishten e sotme.....etj.<sup>69</sup>

Nuk mund të anashkalojmë faktin që çamërishtja dikur ka qenë një e folme në kontakt me greqishten. Nisur nga kjo, e folmja çame ka vlera dhe jep dorë mjaft edhe për shqyrtime rreth gjuhëve në kontakt, mundëson për të parë se në çfarë shkalle ka qenë dhe është dygjuhësia dhe gërshetimi etolinguistik, forca ruajtëse si dhe raportet e tjera dhënëse e marrëse etnolinguistike.

Të gjitha këto, jo vetëm e veçojnë çamërishten nga të folme të tjera me të cilat ajo ka qenë dhe është në kontakt, por e dallon atë edhe nga vetë standardi i sotëm letrar, me gjithë afrinë që mund të paraqesë kjo e folme si pjesë e toskërishtes, variantit që pati fatin të ngrihej në normë.

Qëllimi i punimit tone, fillimisht ishte që të vështronim se në ç'masë ka vepruar ndryshimi gjuhësor në të folmen e çamëve, si pasojë e ndryshimit shoqëror dhe kulturor, duke hulumtuar thellë mbi të ashtuquajturin bilinguizëm dialektal. Të gjitha dukuritë gjuhësore që pasqyrojnë këto variante brenda të folmes, apo që ndodhin përgjatë konvergjencës së tyre me njëri- tjetrin, çojnë pa dyshim, tek **ndryshimi gjuhësor**. Siç e theksuam më lart ky i fundit nxitet e përcaktohet nga zhvillimi i kulturës, veprimtarisë prodhuese, mjeteve të reja teknike, jetës politike-shoqërore, përparimit e shkencës, elektronikës etj., nën trysninë e të cilit është edhe vetë gjuha standarde, dhe, **për sa kohë kjo e fundit do të jetojë së bashku me dialektet**, gjithmonë do të ekzistojë një lidhje dhe bashkëveprim i dyanshëm midis tyre. Për këtë arsye, nëse njëri prej varianteve do të gjendet i kushtëzuar nga rrethana të caktuara historike, ekonomike, shoqërore, kulturore etj., patjetër që edhe varianti tjetër do të gjendet përballë së njëjtës situatë. Sigurisht gjuha standarde ka prirje

<sup>69</sup> Një zhvillim më i plotë i kësaj teme gjendet në kapitullin përkatës ku pasqyrohet përfaqësja e detajuar midis dy të folmeve.

unifikuese kundrejt të folmeve krahinore sot.<sup>70</sup> Pikërisht është ky dallim në funksion që e bën gjuhën letrare si një gjuhë me “prestigj” që ngrihet mbi dialektet.<sup>71</sup>

Të gjitha ndryshimet, më së pari vihen re **në fushën e leksikut**, i cili preket më shumë nga ndryshimet dhe zhvillimet ekonomike, shoqërore, të lidhura me faktorë jashtëgjuhësorë që konsiderohen po aq të rëndësishëm. Sistemi leksikor shfaq interes në këtë të folme, por edhe në përgjithësi, madje paraqitet me diferencime të dukshme në krahasim me sistemet e tjera. Megjithatë nuk mohojmë dot faktin që kund më shumë e kund më pak edhe sistemet e tjera janë të prekshme. Vjetërimi apo humbja e termave të ndryshëm si dhe shndërrimet semantike dhe kuptimore në favor të një leksiku më të ri, përbën edhe pikëvështrimin e të folmeve dialektore sot.

Kështu, jo vetëm tek të rinjtë, por edhe tek brezi i vjetër, është vënë re që shumë fjalë të cilat përdoren dikur në Çamëri, nga fusha e bujqësisë dhe blegtorisë (vënd me një bujqësi të zhvilluar dhe blegtori po aq të zhvilluar), kanë humbur. Pra, po të vërejmë të folmen e çamërishtes tradicionale, shumë fjalë nuk do t'i hasim të përdorura edhe tek brezi i vjetër sot.

Nga ana tjetër, në fushën e zhvillimeve leksikore vërejmë edhe ruajtje të jo pak fjalëve të dialektit çam edhe në ditët e sotme. Ato janë shumë më të mëdha në brezin e vjetër, vijnë duke u pakësuar në brezin e mesëm dhe, sigurisht fare të pakta janë ato në brezin e ri. Vihen re konkretisht disa emra të lidhjeve farefisnore, disa huazime, emra nga fusha e gatimit, emra bimësh aromantike; disa emra topikë, antroponimikë dhe patronimikë etj. P.sh: *kallmar* (lloj embëlsire në shije e ngjashme me bakllavanë), *qahi* (byrek me djathë), *bazin* (kaçamak); *skaminë* (mana), *purtek* (thupër me të cilën rrihet kafsha), *mirgale* (bajame, së cilës i thonë edhe *mingladhë* në disa zona), *llapsana* (barishte të egra që përdoren edhe për të ngrënë), *cukunidha* (hithra), *maraj* (kopër); *tumane* (brekushe), *konoxhup* (xhup), *podhe* (përparëse që përdorin amvisat shtëpiake); *xhixho* (xhaxha), *xhexhé* (xhaxheshë), *nu* (nënë, por për më të rinjtë në moshë fjala ka marë edhe kuptime të tjera)<sup>72</sup>, *dajkël* (nuse e dajës), *thapë* (thonj), *koca* (gërshet), *çeç* (vëllai i madh), *kumbi* (kopsë), *qomstek* (orë xhepi), *stromë* (dyshek), *papllomë* (jorgan), *sini* (tepsi e madhe bakri e cekët), *pirosti* (mbajtëse e enëve në zjarr), *ikua* (vëndi ku stivohen jorganët, dyshekët etj.), *cimidh* (mashë), *sinor* (kufi), *vorua* (oborr), *çapele* (fiq të thatë), *karkanaqe* (lloj embëlsire e ngjashme me gurabijet), *kukulle* (bukë misri, por që ndryshon me këtë të fundit pak në gatim), *bòkall* (fik i papjekur), *dhili* (të fikët), *kalistir* (kep, vegël pune që prashit), *foti* (kandil) etj.

Në brezin e mesëm dhe të ri vërejmë një lloj reduktimi në masë të këtyre emërtimeve, le të themi që do të mbeten vetëm disa gjurmë përdorimi. Këtu, natyrisht vërejmë disa emërtime të marrëdhënieve gjinore familjare, disa cilësime dhe antroponime të ndryshme (përdorimi i këtyre emrave lidhet me traditat e ndryshme të vendosjes së emrave), përdorime të ndryshme nga fusha e gatimit. Këtë të fundit do ta gjejmë të trashëguar edhe tek brezi i ri, ndonëse emërtimet nga çamërishtja janë fare të pakta. Nuk mund të mohojmë dot faktin që transmetimet në planin emotiv tek ky brez janë ende të shumta. Numri i paktë i ruajtjeve të fjalëve tek brezi i mesëm dhe i ri, na çojnë vetvetiu tek procesi i rinovimit, përtëritjes, risimit, apo shtreszimeve të ndryshme në të folmen çame. Pra, çamërishtja na tërheq vëmendjen për praninë e një leksiku të përzier.

<sup>70</sup> Shih për më tepër në këtë punim temën, *Gjuha standarde, rrafshuese e diferencave etnike në të folur*” f. 116- 120

<sup>71</sup> Gjinar, J. *Marrëdhëniet e sotme të gjuhës letrare me dialektet*, në S.F., 1985.

<sup>72</sup> Kjo fjalë sot përdoret edhe me kuptimin e fjalës gjyshe. Kështu mund të thërriten edhe të moshuarit e tjerë në shenjë respekti.

Herë pas here, gjatë ligjërimit tek folës të ndryshëm, kemi vërejtur zëvendësimin e fjalëve të dialektit, me fjalë të shqipes së përgjithshme, si një proces që me kohë nis të shfaqet edhe në brezin e vjetër, për të vazhduar me hapa më të shpejta në brezat më të rinj. Me pak fjalë, këtu na tërheq vëmendjen ajo dukuri që ka tërhequr vëmendjen e mjaft studiuesve sot dhe që është mjaft e diskutueshme, bilinguizmi dialektal. Shembujt për këtë janë të panumërt:

*I thomi katua bodrumit* neve (katua-bodrum) ; *Atje bëmë çadre me velënxa* , -i thomi ne , *ju i thoni batanije*, po ne i thoshim *velënxa leshi* (velënxa- batanije, normalisht fjala velënxë nuk përkon me fjalën batanije, por nuk duhet të harrojmë që kemi të bëjmë me folës të paarsimuar mirë) ; **Do t' vesh me kët, a do viç me mua** ( vesh-vish<viç- aoristi sigmatik) ; *E* (edhe) *kutu tani t'vesh gjakundi humb mënen* ( mëndjen ) e *kokës* ; *Se e mba mend / se kam ikur dhjetë vjeçe* ( nd>d) ; Madje ndodh që folësi ndonjëherë edhe ngatërrohet : *Përpara visheshin me dimiq* ( e folmja e Shqipërisë së mesme ), *ju i thoni tumene*( e folmja çame); dimiq/ tumane- çitjane.

Pra, fjalët e çamërishtes pak nga pak fillojnë të zëvendësohen ose, përkrah tyre, përdoren po të njëjtat fjalë sipas shqipes së përgjithshme dhe zhvillimit të përditshëm, me një ndërhyrje sigurisht nga dialekti vendas. Kështu p.sh. në vend të fjalëve, *potiqe, tumene, parathire, sendon, dhaskal, jenë ,lazëme, stromë,def,* etj (apo qoftë dhe krahas tyre), përdoren sot tek brezi i vjetër (megjithëse në masë më të vogël) edhe fjalët gjegjëse, si *shapka/ pandofla, dimiq,dritare/ penxhere,dyshek/ dushek* (kjo fjalë u është përshtatur rregullave fonetike të dialektit çam, y-u), *mësues , fëmijë, qokë/sebep, dysheme/dusheme/disheme, dajre.*

Shqyrtimi që ne i kemi bërë kësaj të folmeje, lidhet me një periudhë kohore që u përket viteve të gjysmës së dytë të shek. XX, domethënë pas shpërnguljes, por këto procese nuk i kanë fillimet e veta këtu. Nuk mund të anashkalojmë për asnjë çast, bashkëjetesën e detyruar të saj me popullin grek. Në këtë mënyrë kuptojmë edhe shfaqjen e dukurisë së bilinguizmit qysh herët. Jo më kot kemi verifikuar ende edhe sot e kësaj dite tek moshat më të vjetra të brezit të vjetër, përdorime dysore të fjalëve.

Ajo çfarë na ka tërhequr vëmendjen tek kjo e folme është edhe **ritmi** i këtij ndryshimit. Sikurse do ta shohim më hollësisht në kapitullin përkatës, pas çdo procesi të hinkëzimit nga brezi në brez ndodh edhe e ashtuquajtura dukuri e filtrimit të dukurive në secilin prej tyre. Përcjellja e fjalëve të dialektit në brezat pasardhës është e mangët, gjë që flet qartë për ato procese të ripërmendura edhe më lart: përtëritjes, risimit, rinovimit apo shtresëzimeve të ndryshme në të folmen e banorëve çamë.

Kemi të bëjmë pra me një larmi faktorësh të cilët na çojnë në konkluzione me interes rreth marrdhënieve të sotme dialekt - gjuhë shqipe standarde, dialekt - e folme krahinore e një tipi të caktuar (në rastin tonë, çame), përballë një të folmeje tjetër të Shqipërisë shtetërore.

Duke dashur që të jemi më largpamës, nuk kemi parë thjesht raportin dialekt-gjuhë zyrtare, por këtë lloj raporti jemi munduar ta shohim edhe si një raport ndërmjet një kulture krahinore dhe një kulture qytetare. Lidhja e gjuhës me kulturën e një bashkësie të caktuar është e pashmangshme, pasi kultura është ajo që pasqyrohet gjithmonë përmes gjuhës, por edhe e tejkalon atë<sup>73</sup> Për këtë, jemi përpjekur të shohim në veçanti një aspekt të rëndësishëm të saj, pikërisht atë që lidhet me mënyrën e sjelljes kulturore të kësaj bashkësie, duke parë në këtë mënyrë se çfarë kanë sjellë me vete ato nga mjedisi i lashtë çam, çfarë ka ndryshuar tek ata, çfarë ka lulëzuar e re në mjedisin e ri të bashkësisë ku ato janë vendosur etj.

<sup>73</sup> Shkurtaj, Gj. *Sociolinguistika*, Tiranë 2003.

Megjithatë, si përfundim të gjithë asaj çfarë përshkruam përmes trajtimit të një teme të tillë, e folmja e Çamërisë, ashtu si shumë prej krahinave të tilla që ndodhen në anët a pikat më skajore të shtrirjes së një kombi, deri aty ku ndahet kufiri me kombe e gjuhë të tjera, përveçse ka mbijetuar, vazhdon të ruajë ende, në shkallë deri diku të gjerë, tipare të një faze të kapërcyer të shqipes<sup>74</sup>, tipare që, në rrjedhë të moteve, në shumë nga krahinat qendrore e përgjithësisht në shqipen e sotme, janë bjerrë e tjetërsuar aq shumë, saqë sot na befasojnë<sup>75</sup>. Edhe më të rinjtë në moshë, kur i dëgjojnë, u duken sikur lexojnë librin e parë shqip të Gjon Buzukut.<sup>76</sup> Sigurisht këto dukuri mund t'i ndeshim vetëm në ndonjë të folme të diasporave arbëreshe sot.<sup>77</sup> Ky karakter ruajtës(konservativ)<sup>78</sup> dhe tipare të tjera të veçanta të çamërishtes janë një apel i mirë për dialektologët<sup>79</sup>, por edhe për historianët e gjuhës shqipe, fonetikanët<sup>80</sup> dhe studiuesit e kulturës popullore etj.

### 1.1.3. Të dhënat për çamërishten përmes figurave të shquara të shkencës shqiptare dhe asaj të huaj

Si një e folme me interes<sup>81</sup>, çamërishtja ka tërhequr vëmendjen e studiuesve të shumtë, të fushave të ndryshme, si historianëve, dialektologëve, etnologëve, shkencëtarëve etj., por mbi të gjitha ajo është lëvruar prej kohësh nga studiues në zë të gjuhësisë shqiptare. Edhe ne jemi munduar të ndjekim të njëjtën rrugë të këtyre arritjeve, duke u përqendruar në fushën e gjuhësisë.

Studimet dhe botimet e autorëve që janë marrë me çamërishten, si dhe vetë studiuesit çamë, specialistë të fushave të ndryshme dhe veçanërisht të gjuhësisë, na kanë ndihmuar shumë në qartësimin e ideve në lidhje me të dhëna të vjela ndër çamë të vjetër sot. Ato na kanë ndihmuar të kuptojmë çështje me mjaft rëndësi të karakterit historik, jetik apo kulturor, pikërisht sepse ato lidhen ngushtë me gjuhën,- të folmen çame dhe evoluimin e saj.

<sup>74</sup> Një gjë të tillë e kemi provuar dhe argumentuar në punimin e me temë, *Sistemi foljor i çamërishtes në diakroni* kumtuar dhe botuar në organin përkatës të Seminarit të III-të Ndërkombëtar të Albanologjisë, Tetovë 2010.

<sup>75</sup> Argumentuar në punimin me temë, *Çamërishtja në kuadrin e shqipes standarde*, kumtuar dhe botuar në “Seminarin e XXIX Ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare”, Prishtinë 2010

<sup>76</sup> Argumentuar në punimin me temë, *Bashkëpërkime midis të folmes së çamërishtes dhe të folmes së autorëve të vjetër të shqipes*, botuar nga instituti albanologjik Alb- Shkenca, 2009.

<sup>77</sup> Shih në këtë punim temat: *Bashkëpërkime midis çamërishtes dhe të folmes së arbëreshëve*, si dhe *Bashkëpërkime midis çamërishtes dhe të folmes allvanitase*, si dhe nëntemat përkatëse, f. 74-104. Për më tepër shih edhe Shkurtaç, Gj. Ligjërimet arbëreshe “Gjuha e bukës” dhe “Gjuha e zemrës” (Shqyrtime dialektologjike dhe sociolinguistike në ngulimet arbëreshe të Italisë), Tiranë,( Julvin), 2006.

<sup>78</sup> Troplini, E. *Disa tipare ruajtëse të çamërishtes*, botuar në Seminarin e II – të Ndërkombëtar të Albanologjisë, Tetovë 2009

<sup>79</sup> Nga të parët që ka dhënë vlerësime rreth tipareve dialektore të çamërishtes është studiuesi danez Holger Pedersen, i cili, qysh në fund të shek. XIX dhe shumë kohë para se të fillonin hetimet e studimit dialektologjike vendase, në librin e tij “*Albanesische Texte mit Glossar*” (Leipzig, 1895) trajtoi disa nga çështjet themelore të kësaj së folmeje, porse edhe aty, duke mos pasur një studim të plotë dhe duke u mbështetur kryesisht në materiale të mbledhura vetëm në zonën më veriore të Çamërisë, në Mursi, nuk mund të merrej një kuadër i plotë i saj.

<sup>80</sup> Shih: E.Çabej, *Kuantiteti i zanoreve të theksuara të shqipes*, “Buletin i Universitetit shtetëror të Tiranës”, Seria shkencat shoqërore, 1957, nr.2, f.207-213 dhe *Për historinë e konsonantizmit në gjuhën shqipe*, “Buletin i Universitetit shtetëror të Tiranës”, Seria shkencat shoqërore, 1958, nr 1, f.31-75.

<sup>81</sup> Vlerat e kësaj të folmeje për sociolinguistikën shqiptare i kemi trajtuar f. 20 në temën me të njëjtin titull në këtë punim.

Në këtë këndvështrim kemi menduar të trajtojmë disa prej figurave më të njohura të gjuhësisë dhe albanologjisë në përgjithësi, të cilët kanë dhënë kontributin e tyre qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë për studimin e thelluar të kësaj të folmeje.

Fillimisht përmendim kontributin e prof. **Çabejt**, i cili, përmes ligjeve fonetike të shqipes ka provuar vazhdimësinë e dy termave Thyamis / Çam. Konkretisht ky studiues thotë: “Çam – në Çamëri, Çam, Çamërisht, emri i krahinës më jugore të Shqipërisë, i banorëve të saj e i dialektit të tyre. Sikundër e pa së pari M. Leake<sup>82</sup> (Researches in Greece. 1814, f. 13) është refleksi i Thyamis, emri antik i lumit Kallama të sotmë. Një nga emrat topikë që vërtetojnë autoktoninë e Shqiptarëve në vendbanimet e sotme ; sh. Bul. I Univ. Shtet. të Tiranës. Seria. Shk. Shoqërore 2 (1958) 61.”<sup>83</sup> Ndërsa përsa i takon kufirit të Çamërisë dhe vijës kufitare me Shqipërinë shtetërore Çabej bashkohet me mendimin e Sami Frashërit se “kufizohet nga Veriu me Mollosinë, që përbëhet nga sanxhaku i Gjirokastrës, domethënë nga krahina e Labërisë dhe e çon atë më tej duke saktësuar dhe plotësuar me Sarandën dhe Delvinën. Madje ai mendonte se edhe vetë qyteti i Gjirokastrës me Delvinën ishin Çamëri.”<sup>84</sup>

Nuk mund të anashkalojmë punën shumëvjeçare e plot përkushtim për të folmen e Çamërisë të prof. **Qemal Haxhihasanit**, folklorist e dialektolog, punë të cilën e ka mbështetur në vjeljen dhe hetimet empirike të çamëve të shpërngulur në Shqipëri, duke e kurorëzuar më pas me një monografi shkencore<sup>85</sup>. Ky studiues shkroi dhe arriti të botonte në përmbledhjen “Dialektologjia shqiptare” një studim të plotë dhe shumë interesant, duke vënë në dorë të studiuesve një testament shumë të vlefshëm nga një e folme e cila megjithëse në pamje të parë duket arkaike, servir të dhëna interesante edhe në aspektin rinovues, përtëritës. Punimi i prof. Q. Haxhihasanit ka shërbyer si një baze e mirë edhe për punimin tonë, të cilit shpesh i jemi referuar.

Për sa paraqitëm më lart mendoj se studimet për çamërishten, kanë të njëjtën vlerë studimore sikurse të gjitha të folmet anësore të shqipes. Ato duhet të ndjekin pak a shumë të njëjtën rrjedhë përkrah studimeve për të folmet e arbëreshëve, me qëllim që të ndriçohen aspekte të ndryshme gjuhësore që janë lënë pa u shqyrtuar, por edhe dukuri bashkëkohore të shkencave më të reja gjuhësore. Vlera që kjo e folme mbart ka qenë edhe arsyeja që, për shumë vjet radhazi, në planin afatgjatë të hetimeve dhe të anketimeve dialektologjike (të organizuara ose individuale) çamërishtes dhe onomastikës çame i janë qasur me aq pasion e zell jo vetëm Eqrem Çabej dhe Qemal Haxhihasani, për të përmendur dy figura nga më të mëdhatë e më të ndreruarat në albanologji, po edhe mjaft të tjerë.

Po theksojmë se përpos studimit madhor të së folmes së Çamërisë nga Qemal Haxhihasani, kemi edhe një punim monografik mjaft interesant për të folmen e Konispolit nga **Fatmir Muça**, që ka punuar për disa vjet me përkushtim e zell të posaçëm për atë studim<sup>86</sup>. Po ashtu, në kuadër të anketimeve për Atlasin Dialektologjik të Gjuhës shqipe, nga grupi realizues i kësaj vepre madhore, janë bërë anketime të plota në disa pika që përfaqësojnë të folmen e Çamërisë dhe të banorëve

<sup>82</sup> Hoxha, Sh. Kontributi i Uilljëm Martin Likut në fushën e studimeve albanologjike, f. 66, Prishtinë 2007.

<sup>83</sup> Çabej, E. Studime Gjuhësore, f. 98, Rilindja, Prishtinë 1976.

<sup>84</sup> M. Rrapaj, F. “Fjalori onomastik i Epirit” (vëll. I Çamëria), Tiranë 1995.

<sup>85</sup> Haxhihasani, Q. Vështrim i përgjithshëm mbi të folmen e banorëve të Çamërisë, në “Dialektologjia shqiptare”, vëll. I, Tiranë, 1971, vëll. II, Tiranë, 1973.

<sup>86</sup> Shkurtaç, Gj. Vlera dialektologjike dhe etnolinguistike të së folmes së Çamërisë, në “Çështja çame dhe integrimi evropian”, Tiranë 2008.

të saj. Gjithashtu, mbledhje materialesh dhe studime me interes janë bërë edhe për onomastikën çame, ku, në mënyrë të veçantë, duhet të përmendim punën shumë të vlefshme që ka bërë **Fatos Mero Rrapaj**. Po citojmë disa rreshta. “Toponimia është pjesë e kulturës etnike, historike, gjeografike, gjuhësore, shoqërore e një populli. Mbledhja, sistemimi shkencor dhe botimi i tyre, është një domosdoshmëri, sa shkencore aq edhe *atdhetare*”, -thotë autori.<sup>87</sup> Sikurse e shohim, në studimet për Çamërinë dhe çamërishten, kudo, në çdo rresht, varg apo strofë, në studime dhe tubime shkencore të fushave të ndryshme, nuk mund të shmanget emotiviteti. Shkrimet mund të jenë letrare, gjuhësore, historike etj, por nëse bëhet fjalë për çamët dhe krahinën e tyre, studiuesit janë në të njëjtën kohë edhe atdhetare.. Nëse përmendet fjala çam ose Çamëri dhe gjithçka që mund të ketë lidhje me to, gjithkujt dhe jo vetëm çamëve, i shkon mendja tek çështja e tyre me rrenjë të hershme sa dhe vetë e folmja e kësaj krahine. Siç ka thënë edhe filozofi gjerman, Imanuel Kant, *cënimi i së drejtës në një vend, pashmangshëm do të ndjehet në të gjitha vendet e tjera*.<sup>88</sup>

Pavarësisht nacionalizmit, studiuesi Fatos Mero Rrapaj ka bërë një studim me interes për onomastikën çame, siç thotë edhe prof. Shkurtaj për të “ njeri i dashuruar pas gurrës folklorike e onomastikës çame” i cili, për mbledhjen e toponimeve dhe antroponimeve është mbështetur kryesisht tek çamët e shpërngulur me dhunë më 1944-ën, por pjesërisht siç deklaroi edhe ai vetë në çamë të krishterë që rrojnë ende në trojet e tyre, sigurisht edhe në literatura përkatëse. Tek të gjithë studiuesit vërejmë pa përjashtim të njëjtat vështirësi studimi nëse flitet për krahinën e Epirit jugor; vazhdimisht ato janë penguar nga shteti grek. Të njëjtën pengesë kemi hasur edhe ne edhe sot e kësaj dite. Pasojat e këtij veprimi mizor ndjehen edhe në fushën e shkencës. Përmendim këtu veprën madhore jo vetëm për shkencën gjuhësore, por për të gjithë shqiptarët dhe kombin; vepër e cila denjësisht na përfaqëson kudo në botë siç është Atlasit Dialektologjik i Gjuhës shqipe, konkretisht mangësitë që gjejmë lidhur me të folmen e kësaj krahine, për të njëjtën arsye. Mgjithatë në kuadër të anketimeve për Atlasin dialektologjik të gjuhës shqipe, dhe punës së palodhur nga grupi realizues i kësaj vepre madhore, janë bërë anketime në disa pika që përfaqësojnë të folmen e Çamërisë dhe të banorëve të saj. Edhe studiuesi Fatos Mero Rrapaj që në fillim të veprës së tij “*Fjalori onomastik i Epirit*” (vëll. I Çamëria), na njeh me të njëjtat probleme. Pavarësisht të gjithave “*Çamëria e sotme është Thesprotia e lashtë ilire , është shtrirja anësore e jugut të thellë shqiptar prej Sarandës në Prevezë. Ajo përben grupin e katërt të krahinave etnografike që formojnë toskërinë. Banori i Çamërisë thirret çam.*”<sup>89</sup>

”Botime të tjera të këtij studiuesi janë: “*Këngë popullore nga Çamëria*” , botim i Institutit të Kulturës Popullore, Tiranë 1983; “*Rënkimet e Çamërisë*” , Tiranë 1995.

Çamërishtja dhe fati i popullit çam, izolomi i tyre larg truallit mëmë, largimi prej trojeve të veta, si dhe lëvizjet mekanike të herëpashërshme brenda truallit pritës, përngjan shumë me fatin e arbëreshëve larg trojeve të tyre, gjë që e vërtetojnë më së miri edhe tiparet gjuhësore të përbashkëta midis këtyre dy të folmeve edhe sot e kësaj

<sup>87</sup> Rrapaj, M. F. me vëllimet: “*Këngë popullore nga Çamëria*” (botim i Institutit të Kulturës Popullore, Tiranë 1983, 848 faqe), “*Rënkimet e Çamërisë*” (1995) dhe “*Fjalori onomastik i Epirit*” (vëll. I Çamëria), prej gati 660 faqesh (1995).

<sup>88</sup> Qosja, R. *Çështje e të gjithë shqiptarëve pjesmarrësve të tubimit shkencor çështja çame dhe integrimi evropian*, në , “Çështja çame dhe integrimi evropian”, Instituti i studimeve për çamërinë, ( Arbëria) Tiranë 2005.

<sup>89</sup> Rrapaj, M. F. “*Fjalori onomastik i Epirit*” (vëll. I Çamëria), Tiranë 1995, f. 8

dite. Lidhur me këtë, një ndihmesë të madhe na kanë dhënë edhe studime të cilat përshkruajnë të folmet arbëreshe të Italisë e të folmet arvanitase të Greqisë, si të folme po kaq interesante. Përmendim këtu librin **“Ligjërimet arbëreshe”**<sup>90</sup> të prof. **Gjovalin Shkurtajt**- t, të cilin e kemi shfrytëzuar mjaft për të bërë përjasjet midis çamërishtes dhe të folmes së arbëreshëve.

Vlerat e të folmes së çamërishtes dalin në pah edhe nese shqyrtojmë veprat e **At Antonio Belushit ; Mesharin e Gjon Buzikut; veprat e humanistëve të parë shqiptarë; veprat e letërsisë së vjetër shqiptare: Budit, Bogdanit etj**, pa përjashtuar edhe mbështetjen që na ka dhënë literatura gjuhësore shqiptare dhe ajo e huaj, të cilat nuk do t’i lëmë pa përmendur në vëndin e posaçëm të bibliografisë së këtij punimi.

Një tjetër studiues me një kontribut të madh për çamërishten dhe shkencën gjuhësore në tërësi është edhe studiuesi **Niko Stylo** i cili me guxim nxjerr në pah disa etimologji sipas tij të gabuara të fjalëve. Kështu kemi regjistruar fjalë për fjalë nga një diskutim i tij: “për fjalën *tema* gjuhëtarët thonë se latinët e kanë marrë nga grekët *tema: thema*, por në të vërtetë *temë* vjen nga *thom / thaçë* ; pra folja *them*. Ndërsa për fjalën *dilemë* albanologët thonë se vjen nga greqishtja, ndërkohë që në çamërishte kemi *jam në dihë: Jam në dilemë.....*etj. Studiuesi **Niko Stylo** është jo vetëm një albanolog i cili përmes çamërishtes ka bërë studime me vlerë në fushën e shkencës gjuhësore, por nga ana tjetër, është për ne edhe dëshmues i së folmes çame në kuadër të dygjuhësisë. Për këtë arsye gjithmonë interesi ynë për të ka qenë i dyfishtë. Gjithmonë kam kundruar me shumë interes veprat, **por edhe ligjërimin e tij**.

Dr. Moikom Zeqo në një tubim shkencor të organizuar nga intelektualët çamë thotë se, *nuk mund të ketë histori në kuptimin e përgjithshëm për Çamërinë , pa studiuar zanafillat antike, pra referencat e arkeologjisë. Për fat të keq, ka një boshllëk të madh në këtë rrafsh. ....nuk mund të lihen pas dore studimet filologjike gjuhësore, ato mitike , të folklorit, të arkitekturës, dhe të kulturës popullore në shekuj.* Siç e dimë, referencat e arkeologjisë si dhe shkrimet përkatëse në këto gjetje, ndihmojnë mjaft edhe shkencën gjuhësore. Nëse autori në fjalë flet për një modul arkitektonik iliro-epirot, në fushën të gjuhësisë një sprovë të tillë mendojmë se po përpiqet ta bëjë studiuesi çam Niko Stylo.

Fillimisht, ndër studimet e këtij autori na ka tërhequr vëmendjen kumtesa me titull **“Gjuha e ilirëve – gjuhë e shqiptarëve”**. Po shkëpusim vetëm fillimin nga kjo kumtesë: “Kur u rrita dhe fillova të merresha me historinë e Çamërisë ose të T(h)esprotisë, në librin historik të Apollodorit e gjeta të shkruar këtë tekst, të cilin po e paraqes fjalë për fjalë: “*Kadmi, bashkë me Harmoninë, braktis Tebën (Thevën, Thivën) dhe vjen te enkelejtë në një kohë që pësonin sulme prej ilirëve dhe morën një profeci, që t’i besonin udhëheqjen Kadmit dhe Harmonisë nëse donin të fitonin. Dhe ata u bindën dhe i bënë prijës dhe fituan. Kështu Kadmi u bë mbret i ilirëve dhe lindi një djalë, Ilirin (Ilyrion).*” (Apoll. 3, V. 4).... Për gjuhën e mbretit Ilir, si dhe të mbretërisë së tij, duke marrë parasysh se i ati, Kadmi, ishte mbret i Tebës beotase, mund të them se ishte gjuha shqiptarëve, sepse në këtë vend edhe sot gjuha e banorëve të tij është gjuha shqipe.”<sup>91</sup>

Një testament mjaft i vlefshëm, dëshmues i kësaj diglosie është edhe libri tjetër i po të njëjtit studiues, *Fjalori i Marko Boçarit*, një fjalor greqisht- shqip, i cili për herë të parë ka dalë në shtyp nga mendimtari i shquar Mithat Frashëri (1926). Ky

<sup>90</sup> Shkurtajt, Gj. “Ligjërimet arbëreshe” ( Shqyrtime dialektologjike dhe sociolinguistike në ngulimet arbëreshe të Italisë), Tiranë 2006

<sup>91</sup> Stylos, N. *Gjuha e ilirëve – gjuhë e shqiptarëve*, kumtesë e mbajtur në Seminarin e II-të Ndërkombëtar të Albanologjisë, Ohër 2008.



fjalor është një sprovë për të kërkuar gjurmë nga shqipja e hershme, siç thotë edhe prof. Bashkim Kyçyku në parathënien e kësaj vepre duke e e parë atë si nxitje “ *që të kërkohet kudo për të gjetur, aty ku janë gjymtyrët e shpërndara të shqipes, si në periudhat e afërta, pra edhe më të qarta, ashtu edhe në periudhat më të largëta, rrjedhimisht, të mjergulluara ose fare të errta.*” Siç e ka deklaruar edhe ai vetë “ arrita me dialektin tim amtar të gjuhës shqipe të lexoj shumë prej këtyre mbishkrimeve jo vetëm në hapësirën greke, por edhe jashtë saj, konkretisht në Itali e Turqi” Autori hedh fillimisht në letër duke i botuar ato në Athinë më 2003, në librin me titull “Elemente prehistorike në tekste shumë të lashta shqipe i cili qarkullon më pas në Prishtinë (2004), në librin e titull, *Historia e shenjtë e arvanitëve, dokumente parahistorike*. Për leximin e këtyre mbishkrimeve autorit i lind e nevojshme të hulumtojë ndër alfabetet e hershme të shkruara në gjuhën shqipe ku gjen fjalë dhe germa që e ndihmojnë në deshifrimin e tyre, njëri prej të cilëve ishte edhe *Fjalori i Marko Boçarit*, cili qarkullon në Tiranë më 2007-ën. Puna me këtë vepër e shtyn studiuesin drejt kërkimeve të mëtejshme. Kështu, siç e ka deklaruar edhe ai vetë gjatë konferencave dhe tubimeve të ndryshme shkencore është marrë shumë gjatë edhe me *Fjalorin Greqisht-Shqip të Panajot Kupitorit*, tekst i cili para pak ditësh ka parë dritën e botimit. Madje ky studiues për herë të parë ka prezantuar ndër ne edhe njërën prej emrave të mëdhenj të Akademisë italiane që ka shkruar edhe në shqip,- shkrimtaren e viteve 1800 në Itali, Angjelika Palin, e cila ndër të tjera ishte edhe çame. Vepra me të cilën ai e realizoi këtë ishte **Angjelica Palli, Vajza çame e dhjaspora.**

Autori vitet e fundit është marrë gjatë edhe me etruskishten. Në veprën tjetër , *Etruskishte – Toskërishte ( ETRUSKISHTA)*, studiuesi mbron mendimin e tij se “gjuha e etruskëve është gjuha e gjithë shqiptarëve”. Sigurisht këtë e bën përmes argumentash të shumtë. Autori sjell para lexuesit një vajtim çam të shekullit të 5-të p.e.s. të gjetur në Peruxha ( Perugia) në një gur të shkruar. Sipas tij ky tekst në etruskisht lexohet përmes gjuhës së arvanitasve. Teksti i vajtimit transkriptohet prej poetit dhe vjen tek lexuesi në shqipen e sotme.<sup>92</sup>

Nën të njëjtën vazhdë studimi ecën edhe vepra e **Nermin Vlora Falaschi-t**. Nga studimi i saj<sup>93</sup> ndër të tjera kemi veçuar: “Iliria është vendi i parë i njerëzve të lirë i cili në Veri shtrihej nga Mesdheu deri në lumin Danub. Edhe në Itali , në Lacio, gjendet lumi Liri , mali Liri, dhe fshati Liri, - emër i ruajtur në shekuj me prejardhje të fiseve të ndryshme pellazgo- ilire, si p.sh: Etruskët, Venetët, Pikenët, Meshapët, Daunët, etj., që rrezatuan në Gadishullin Italik..... Shqiptarët e sotëm njihen si të vetmit dhe autentikë mbijetues të atij qytetërimi pellazgjik shumë të lashtë ....., ....pra gjuha e të parëve tanë të përbashkët, fort të lashtë, ka mbijetuar në djepin e saj të qëmotshëm , e mbrojtur nga malet viganë dhe të paarrtshëm të Ilirisë, ku këmba e pushtuesit kishte mundësi të shkelte vetëm trojet bregdetare, por jo ato male të rrepta që ....., kanë mbajtur dhe mbrojtur në gjirin e tyre gjuhën e të parëve. Sipas saj një gjë e tillë shpjegon edhe faktin pse etruskishtja u zhduk krejtësisht dhe ilirishtja mbijetoi: Etruskishtja i dha shtytjen kulturës latine dhe “gjenet” e saj pësuan një ndryshim të madh, kurse ilirishtja, mbas rrezatimeve të para, u mbyll në vetvete....., duke e ngrirë kulturën e vet, ndryshe nga kulturat e tjera që u shteruan krejtësisht.....”<sup>94</sup>

Me mjaft interes për studimin e shqipes janë veprat më të hershme të autorëve të huaj si Johan Georg Von **Hahnit**, përkatësisht “Albanesische Studien” (Studime shqiptare); Franz **Boppit**, si , “Mbi gjuhën shqipe në lidhjet e saj

<sup>92</sup> Stylos, N. “Etruskishte – Toskërishte” ( ETRUSKISHTA), (Ëest Print), 2010.

<sup>93</sup>Vlora (Falaski), N.: *Prona gjuhësore dhe gjenetike* , (Probabilitetet e Monogjenezës Embrionale të Fjalëve), Toena, Tiranë, 1997.

<sup>94</sup> Po aty, 63.

farefisnore”; Karl Heinrich Theodor **Reinholdit** me titullin “ Noctes pelasgicae” (Netët pellasgjike) etj, Ëilliam Martin **Leake** (1777-1860), Fransua **Pukëvili**, (François Pouqueville, 1770-1838); Holger **Pedersen**, (1867-1953)...etj. Sigurisht, për arsye të kufizimeve që na vendos një temë e tillë, mendojmë të trajtojmë disa prej tyre:

**Holger Pedersen, (1867-1953)** profesor i gjuhësisë në Universitetin re Kopenhagenit; linguist, indoevropianist, komparatist, studiues i gjuhëve kelte, armene, tokare e sllave, u mor edhe me studimin e shqipes. Të dhënat më poshtë lidhen me Çamërishten, siç thotë edhe gjuhëtari i njohur Rexhep Ismajli, “ qysh në dekadën e fundit të shekullit të 19-të, ai ndërmori regjistrimin dhe përshkrimin serioz të shqipes , të dialektit çam , duke bërë njëherësh dhe një punë me peshë për kulturën...”<sup>95</sup> Kryesisht, duke u nisur nga studime gjuhësore në lëmin e shqipes, ka mbledhur **një material të vlefshëm folklorik më 1893**, në Korfuz dhe në Shqipëri. Këtë të fundit e ka botuar në veprën *Albanesische Texte mit glossar*, 1895. Ai përbëhet prej 35 përrallash dhe prej më shumë se 230 këngësh, megjithëse në këtë tekst u botuan vetëm 12 përralla, 18 gjëgjëza, 12 këngë dashurie, një këngë historike dhe disa besime popullore. **Gjuha e tyre është e folmja e Çamërisë.**<sup>96</sup> Materiali folklorik është botuar edhe në gjermanisht , në veprën *Zur Albanesische Volkskunde*, Copenhagen 1898; disa përralla janë botuar edhe në anglisht në veprën *Triscks of Ëomen and other Albanian Tekxsts*. Po përmendim disa prej tyre: *Djali, q’i bij tamburait, Kizmetin e gjën përpara, Birbil gjizari, Arap uzengjia, Kaçi, Këngë dashurije* etj. Mbyte me shembuj tekstesh për doktoratën

**Pukëvili**<sup>97</sup>(1770- 1838) ka lënë tri vepra madhore: “Udhëtim në More, në Kostandinopojë dhe në Shqipëri”, botuar më 1805 (tri vëllime); “Udhëtim nëpër Greqi”, botuar më 1820; “Histori e ringjalljes së Greqisë”, botuar më 1824. Këto vepra janë ribotuar edhe më pas. Vepra e tij është mjaft e pasur me informacion të vlefshëm nga pikëpamja historike sidomos rreth pushtetit politik të Ali Pashë Tepelenës, pasi Pukëvili ishte konsull i përgjithshëm i Francës në Janinë. Kështu ai njohu nga afër shqiptarët, zakonet, fetë, gjuhën e tyre si edhe të popujve të tjerë që “bashkëjetonin në jugun e Ballkanit”.

Pukëvili si historian dhe arkeolog u mor edhe me emrin e atyre qyteteve të moçme të cilave u zbulonte rrënojat. Vepra e Pukëvilit është shumë e rëndësishme pasi na njeh edhe me Çamërinë e kohës së Ali Pashë Tepelenës. Teksa kishte qenë rob në Kostandinopojë ai kishte mbajtur një ditar, të cilin kishte mundur ta fshihte. Mbi bazën e këtij ditari shkroi vëllimet e para të veprës së tij... Që në fillim të vëllimit për Shqipërinë ai shkruan se do të flasë “ *për një vend që ndodhet në portat e Evropës dhe të panjohur deri më sot , apo rreth të cilit janë botuar vetëm gjëra të vagullta e të rreme.*”<sup>98</sup>Sipas Serge Metais, Pukëvili ka regjistruar 841 fshatra në Epir të cilët i ka ndarë në katër provinca: sanxhaku i Janinës, sanxhaku i Delvinës, **sanxhaku i Shamurisë (chamouri)** dhe vojvodllëku i Artës. Sipas të dhënave nga ky studiues

<sup>95</sup> Pedersen, H. *Studime për Gjuhën shqipe* , në Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës ( botime të vecanta XLVIII , Seksioni i gjuhësisë dhe i letërsisë , libri 20).

<sup>96</sup> Këto të dhëna rreth veprës së filologut danez janë marrë nga: 1. *Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar ( 1635- 1912)*, Instituti i folklorit, Tiranë 1961; 2. Holger Pedersen , *Studime për Gjuhën shqipe* , në Akademia e shkencave dhe e arteve e Kosovës ( botime të vecanta XLVIII , Seksioni i gjuhësisë dhe i letërsisë , libri 20).

<sup>97</sup> Të dhënat rreth veprës së Fransua Pukëvilit ( François Pouqueville) janë marrë nga Serge Metais: *Epiri dhe Çamëria në kohën e Ali Pashës, sipas Pukëvilit*, në “Abedin Dino dhe Çështja çame sot”, Instituti I Studimeve për Çamërinë , Arbëria 2010.

<sup>98</sup> Pouqueville, F. *Voyage en Morée, à Constantinople et en Albanie*, Paris, 1805, f.2; sipas Metais, S. , po aty.

**Pukëvili ka përdorur termat Shamuri- Çamëri; shamid- çam.**<sup>99</sup>Gjatë këtyre dhjetë viteve në Epir, Pukëvili u interesua mjaft edhe për gjuhën shqipe. Në dorën e tij ra edhe fjalori i Marko Boçarit të cilin me sa duket ai e botoi si një fjalor **shqip-greqisht- frëngjisht**, për të cilin i detyrohet luftëtarit suliot për Pavarësinë e Greqisë (1821), Marko Boçarit.<sup>100</sup> Pukëvili mendon gjithashtu se dialektet e mëdha të shqipes janë katër dhe jo dy, duke klasifikuar si dialekte më vete edhe atë të japigëve ( labëve) dhe atë të shamidëve ( çamëve)<sup>101</sup>. Për vitet në të cilat veprat e Pukëvilit janë shkruar, mendojmë se ato kanë një interes të madh, jo vetëm për studimin e çamërishtes dhe për të folmet jugore të shqipes, por për shkencën e albanologjisë në tërësi.

Ndërkohë si **Pukëvili** ashtu edhe **Liku** përkrahajnë me detaje jugun e Shqipërisë, ndërsa anashkalojnë përkrahimin e Veriut të Shqipërisë. Bashkohemi në njëjtin mendim me studiuesin kur thotë se në përgjithësi zonat atje ishin jashtë kontrollit të Ali Pashë Tepelenës. Nga ana tjetër, mendojmë se kjo ka qenë edhe arsyeja pse M. Liku nuk shkruan ( ose shkruan fare pak) për Veriun e Shqipërisë.

**Uilljëm Martin Liku**<sup>102</sup> ishte kolonel i artilerisë angleze dhe, njëkohësisht, përfaqësuesi diplomatik i Anglisë në Pashallëkun e Janinës gjatë dhjetëvjeçarit të parë të shek. XIX. Sipas studiueses Shpresa Hoxha, Liku dhe disa udhëtarë të tjerë anglezë i vizituan viset e Shqipërisë, kryesisht ato Jugore, gjatë gjysmës së dytë të shek. XVIII dhe fillimit të shek. XIX. Ndër ta ishin: Gj. G. Bajroni, J. Hobhauzi, H. Hollandi, Th. S. Hjuzi, E. Dodëlli, J. Besti, D. Erkharti, E. Spenseri, E. Liri etj. Martin Liku, i kushtoi një rëndësi mjaft të madhe gjuhës shqipe dhe origjinës së saj: shqiptarët i konsideron si pasardhës të ilirëve. Autori është një hartues i një fjalori greqisht – latinisht – shqip, i mbështetur në fjalorin e Teodor Kavaliotit. Kontribut i veçantë është dhënë lidhur me fjalët e huazuara të shqipes nga gjuhët e tjera.

Veprat më të njohura nga bibliografia e zgjedhur e botimeve të Likut janë: *Researches in Greece*, (Kërkime në Greqi) Londër 1814, *Remarks on the Trojan Controversy*, in : *Classical Journal*, 1817. 141-50 (Shënime për polemikën trojane), *The Topography of Athens* (Topografia e Athinës), Londër 1821, e botuar në tetë vëllime, *An Historical outline of the Greek Revolution* (Një përmbledhje historike e Revolucionit grek) Londër 1825, *Travels in the Morea* (Udhëtime në More), Londër 1830, në tri vëllime, *Travels in Northern Greece*, (Udhëtime në Greqinë e Veriut), Londër 1835, në katër vëllime, *Journal of a tour in Asia Minor* (Ditar përreth Azisë së Vogël), Londër 1824, *Peloponnesiaca* (Peloponezika), Londër 1846, është plotësim i veprës “Udhëtime në More”, *Greece at the end of tëenty-three years Protection* (Greqia në fund të viteve të njëzet e treta të mbrojtjes), Londër 1851, *Numismata Hellenica* (Numizmatika helenike), Londër 1854, vepër kjo të cilën e shkroi së bashku me bashkëshorten e vet, “Journey through some provinces of Asia Minor in the year 1800”, in: *Travels in Various Countries of the East*, ed. R. Ēalpole, London 1820. 185-263. (“Udhëtimi nëpër disa krahina të Azisë së vogël në vitin 1800”, në: Udhëtimet në vendet e ndryshme të Lindjes), *Essay of a Map of Asia Minor Ancient and Modern*, London 1820. (Skica e një harte të Azisë së vogël të vjetër dhe të re), *Les principaux Monumens Egyptiens du Musee britannique* (ëith C.P. York), London 1827, *On some disputed Questions of Ancient Geography*, London 1857. (Mbi disa çështje kundërthënëse të gjeografisë antike) etj.

<sup>99</sup> Po aty f. 43

<sup>100</sup> Për më tepër për këtë fjalor dhe lidhjes midis Pukëvilit dhe Marko Boçarit shih Niko Stylo, “ Fjalori i Marko Boçarit.

<sup>101</sup> Po aty.

<sup>102</sup> Të dhënat për M. Likun dhe veprën e tij i kemi marë nga vepra, *Kontributi i Willjëm Martin Likut në fushën e studimeve albanologjike* i studiueses Dr. Shpresa Hoxha; Prishtinë 2007.

Lidhur me zhvillimin ekonomik të Çamërisë në veprën e tij thuhet: “Krahina e Çamërisë, kishte prej kohësh një nivel të kënaqshëm të zhvillimit ekonomik dhe të fuqizimit të shtresës së lartë feudale shqiptare. Krahas zhvillimit të sistemit çifligar filloi edhe zhvillimi i madh i tregtisë. Një qendër e rëndësishme e këmbimit tregtar u bë Arta, Paramithia, Janina, e njohur që në gjysmën e parë të shekullit XVIII si qendër tregtare. Qyteti i Janinës prej shumëkujt quhej me emrin “Marseji epirot” dhe se ishte nyje e gjashtë rrugëve shumë të rëndësishme tregtare. Lidhte detin Adriatik me detin Jon dhe shërbente si një nyjë lidhëse ndërmjet Shqipërisë, Greqisë dhe Maqedonisë<sup>103</sup>. Lulëzimi i Janinës, depërtoi edhe në Çamëri, kryesisht në Filat me familjen e njohur feudalo-shqiptare Zjuguri; në Mazarak (sot Mazrek) oxhaku shqiptar Pronja, në Margëlliç (Margëllëç), oxhaku i njohur Çapari, etj”<sup>104</sup>.

Tek M. Liku gjejmë edhe njohuri për kolonitë shqiptare më në zë, siç janë ato të Moresë, të Beotisë, të ishujve Hidra dhe Speca. Ndërkaq një vëmendje relativisht të veçantë u kushton fshatarëve shqiptarë të Atikës. Për këtë ai thotë se, e ruajnë të gjallë gjurmën e origjinës së tyre<sup>105</sup>. Ai përmend njëkohësisht edhe dy krahina të vogla malore në More, Lalën dhe Bardunin.<sup>106</sup> Sipas tij Himara është një krahinë që ka disa fshatra të mëdha dhe të cilat shtrihen përballë detit në anën perëndimore të maleve Akrokeravina. Liku u interesua edhe për organizimin e brendshëm shoqëror të shqiptarëve, si p.sh. të himarjotëve. Lidhur me këtë ai bën të ditur se Himara ka 300 familje, të cilat ndahen në pesë vëllazëri (bashkësi) kryesore fisesh<sup>107</sup>. Më 28. VI. 1805, pas vizitës shumëditëshe në Artë dhe në Prevezë, Liku arriti në sarajin e Ali Pashës, në kështjellën e Janinës. Ai kalon përmes fshatit Kiafa ( shqip: Qafa), më pas nëpër fshatin e rrënuar të suljotëve, Avarika dhe në majën e Malit Zalongji, pikërisht aty ku kishte ndodhur faza e fundit e tragjedisë së suliotëve, përkatësisht vallja e vdekjes së gjashtë burrave dhe njëzet e dy grave, të cilët nga shkëmbi i këtij fshati u hodhën në greminë për të mos i rënë në dorë Ali Pashë Tepelenës. Gjatë vrojtimit të terrenit të Sulit, Liku përshkroi edhe ndarjen e suljotëve në fise, ndër të cilët më të njohurit ishin: Boçarenjtë, Buzbatët, Zervatët, Zhavelasit dhe Dhrakasit.

Për sa i përket bashkësisë së suljotëve, Liku konsideron se këta kishin qenë kolonë shqiptarë të ardhur në fillimin e shek. XIV, të cilët i ishin shmangur Janinës, si dhe Artës e brigjeve të lumit Kalamas (tek Liku: Kalama, f. 257, 408), duke u ngulitur në malet e zhveshura të Sulit. Autori përmend një seri emrash shqiptarë, si Thyamis ose Kalama ( lum në Çamëri, Dyrhachium, Dúres (Durrësi), Deabolis, Devóli (Devolli), Ioánina (Janina), Naupactus (qytet antik), Albanon, Arbanon, Albanopolis (qytet mesjetar i Shqipërisë, sipas të gjitha gjasave afër Krujës së sotme, sipas K. Ptolomeut).<sup>108</sup>

Sipas tij çamët dhe Çamëria përfshijnë tërë rajonin e jugut të lumit **Kalamas, që në kohën antike është quajtur Thyamis**. Sipas tij mund të supozohet se prej këtij emri antik rrjedh emri i sotëm greqisht **Camuria, shqip Çamëria**. **Vendet kryesore të kësaj krahine janë: Suli, Paramithia, Luarati, Margëlliçi, Parga, Agia etj.** Këto emra autori i ka shkruar sipas emërtimeve greke, por jo edhe në

<sup>103</sup> G.Vaudoncourt, Mémoire annexé à carte de la Turquie d'Europe, Munic, 1818, 71-72, 79-81; F.Beaujour, Voyage militaire dans l'Empire Othoman, Paris 1829, vol. I, 296; Historia e popullit shqiptar I, Prishtinë 1969, 381, sipas Hoxha, SH.: *Kontributi i Uilljam Martin Likut në fushën e studimeve albanologjike*, Prishtinë 2007.

<sup>104</sup> Ibrahim Manzour-Effendi, Mémoires sur la Grèce et l'Albanie pendant le gouvernement d'Ali Pacha, Paris 1828, p.XXIV, sipas pot ë njëjtës autore.

<sup>105</sup> W. M. Leake, *Researches in Greece*, (Kërkime në Greqi) Londër 1814, f. 254.

<sup>106</sup> Hoxha, SH.: *Kontributi i Uilljam Martin Likut në fushën e studimeve albanologjike*, Prishtinë 2007.

<sup>107</sup> Po aty, f. 84.

<sup>108</sup> Kërkime në Greqinë veriore

gjuhën shqipe. Kështu, Korça shkruhet *Koritza*, Himara- *Khimara*, Gjirokastra- *Argirokastro*, Çamëria- *Camuria*, etj.

Për sa i takon origjinës së shqiptarëve dhe shqipes, Liku dëshmon tezën e origjinës së shqiptarëve prej ilirëve, përkatësisht të origjinës së shqipes prej ilirishtes.

Para se të kalojmë tek vepra e **Reinholdit** po trajtojmë disa autorë të tjerë shqiptarë dhe të huaj.

Mendimit se dokumentet e hershme të shqipes së shkruar duhen kërkuar jo vetëm tek shkronjat latine por edhe ato greke i janë bashkuar tashme edhe studiues të tjerë njëri prej të cilëve është edhe prof. **Arben Llalla**. Këtë mendim autori i librit “Gjurmë të letërsisë së vjetër të shqiptarëve të greqisë 1860- 1889” e mbështet në lidhjet e vjetra që populli shqiptar kishte me Greqinë e lashtë. Autori sjell përpara nesh shkrime të vjetra të gjuhës shqipe, me shkronja greke të gjetura në arkivin e “Lidhjes së Arvanitasve të Greqisë”. Bashkohemi me këtë studiues në disa mendime:

E para autori shprehet se ka vërejtur bashkëpërkime midis të folmes së Malësisë së Tetovës dhe Rekës së Epërme me shumë fjalë shqipe që përdorin arvanitasit e Greqisë. Faktin e atakimit të skajeve apo të bashkëpërkimeve midis të folmeve anësore si edhe midis të folmeve të diasporës shqiptare e kemi përmendur shpesh në punimet tona që kemi prezantuar gjatë këtyre viteve të fundit, pasi këto të folme janë një pasuri e madhe që shoqërohen gjithmonë me frikën dhe rrezikun e zhdukjes në të ardhmen. Pra, dy kryedialektet tona nuk kanë qenë të afërt vetëm në kohë të hershme, por kjo afri i ka shoqëruar edhe më vonë, gjë e cila vihet re edhe në ditët tona.

Së dyti, edhe autori në fjalë sikurse studiuesja Falaschi mendon se, mbyllja në vetvete e këtyre të folmeve ka edhe një avantazh tjetër të madh, konservimin e pastër të shqipes së vjetër.

Për rrjedhojë, aty ku na vjen në ndihmë arvanitishtja nuk mund të na vijë në ndihmë arbërishtja dhe aty ku na vjen në ndihmë çamërishtja nuk mund të na vijë në ndihmë të folme të tjera krahinore. Pra, për studimin e gjuhës sonë, secila prej të folmeve të shqipes luan rol të rëndësishëm, pavarësisht rrethanave dhe konteksteve të caktuara, mjedisit në të cilat ato mbijetojnë ose rrezikojnë..., apo mjedisit në të cilat ato zhvillohen, përtërihen dhe bëhen njësh me standardin etj.

Të dhënat për arvanitasit e Greqisë i gjejmë të larmishme tek studiuesi në fjalë. Mjaft përshtypje na ka bërë shpjegimi i përdorimit të termave me anë të të cilave janë quajtur shqiptarët që jetojnë ende në vendin e tyre të stërlashtë, por i përket sot territorit grek. Sipas tij, dallimi i emërtimeve të shqiptarëve, arvanitas- allvanos, lidhet me një fakt historik: atë të mbetjes jashtë territorit të Greqisë së sotme pas shpalljes së pavarësisë së saj më 1821-in, - krahinës së Çamërisë, e cila në vitet në vazhdim mbeti nën drejtimin e Turqisë. Kjo që edhe arsyeja sipas tij që çamët u quajtën “allvanos” dhe jo “arvanitas”. Nga ana tjetër, emërtimin “arvanitas” dhe jo arbëreshë autori e shpjegon me faktin se grekët shkronjën B të alfabetit latin e lexojnë V. Ndërkohë që turqit arvanitasit i quajtën “arnaut” ose “arnavud”, kurse arvanitasit ortodoksë të Kostandinopojës dhe të Egjiptit i quajtën “greci”. Vijimin e këtyre termave autori e lidh me emërtimin e hershëm të tyre “Shqiptarët e lashtë, nga njerëzit që u morën me letërsi, dituri dhe fe, quheshin ilirë dhe më vonë albanë. Ilirët dhe albanët vetëquhen: arbër, arbanë, arbëreshë, shqiptarë, kurse atdheun e tyre e quajtën Arbëri, Shqipëri, e kurrë nuk e quajtën atdheun e tyre Iliri dhe Albani.” Ky i fundit është një term që përdoret edhe sot e kësaj dite nga bota përendimore por jo nga vetë shqiptarët.<sup>109</sup>

<sup>109</sup> Llalla, A. *Gjurmë të letërsisë së vjetër të shqiptarëve të greqisë 1860- 1889*, (Tringa desidn), Tetovë, 2006

Po shkëpusim shkurtimisht disa pohime të fuqishme të këtij studiuesi nga kumtesa me titull: ..... *Arvanitasit – Çamët në etnikumin shqiptar në Greqi (arvanitasit themeluesit dhe drejtuesit e greqisë moderne 1821-2005)*<sup>110</sup>

“Politikanët dhe historianët grekë, e gjithë struktura shtetërore greke, janë munduar të mohojnë kontributin e figurave të shquara arvanitase për pavarësinë e Greqisë më 1821, me qëllim mohimin e tyre.....Arvanitasit janë një realitet në shtetin Grek. Ata kanë luftuar në Kryengritjen e vitit 1821 bashkë me grekët kundër osmanëve turq, për formimin e shtetit grek. Arvanitasit e quajnë veten e tyre zotër të Greqisë.... Disa nga arvanitasit heronj të Kryengritjes së vitit 1821 ishin: Gjeorgjio Kundurioti, Kiço Xhavella, Andoni Kryezi, Teodor Kollokotroni, [Marko Boçari](#), Noti Boçari, Kiço Boçari, Laskarina Bubulina, Anastas Gjirokastriti, Dhimitër Vulgari, Kostandin Kanari, Gjeorgjio Karaiskaqi, Odise Andruço, Andrea Miauli, Teodor Griva, Dhimitër Plaputa, Nikolao Kryezoti, Athanasio Shkurtanioti, Hasan Bellushi, Tahir Abazi, Ago Myhyrdani, Sulejman Meto, Gjeko Bei, Myrto Çali, Ago Vasiar.....”<sup>111</sup>

“Arvanitasit ishin para së gjithash njerëz të përparimit. ....Arvanitasit ishin profesorët e parë që themeluan Akademinë e Athinës.....Nga gjiri i familjeve arvanitase dolën shumë intelektualë të shquar<sup>112</sup> Nga fara arvanitase, dolën shumë piktorë...<sup>113</sup> Elementi kryesor i cili dallon arvanitasit nga popujt e tjerë që përbëjnë shtetin e sotëm grek, është gjuha shqipe, që ata flasin brenda në rrethin familjar. Deri në shekujt e mëparshëm gjuha shqipe nuk shkruhej nga masa e gjerë e popullit të saj, nuk përbënte gjuhën e shkollimit, këtë gjuhë e flisnin njerëzit e pashkolluar, ishte gjuhë e jetës së përditshme, prandaj arriti të përcillej nga brezi në brez. Një nga mënyrat e rrualtjes së gjuhës, pra, është kënga. Kështu, shumë ngjarje të përditshme dhe ngjarje historike u përcollën brez pas brezi nëpërmjet këngës popullore si në vargjet e mëposhtme:

Gjuha jonë vetëm thuhet  
nuk e lanë që të shkruhet  
bëmë këngë këshillat e urta  
që të mos harrohet gjuha.

Tek kjo kumtesë gjejmë edhe disa vlerësime të të huajve për gjuhën shqipe. Po veçojmë një rën prej tyre.

Pedagogu i gjuhësisë në Universitetin e Çikagos, **Eric Pratt Hamp**, në ligjëratën e tij për rëndësinë e gjuhës shqipe thotë: “Gjuha shqipe ka një kontribut unik me pasuri të veçantë në shumë drejtime të rëndësishme, dhe Greqia është po aq me fat që ka këtë burim të pasur në tokën e vet dhe ndërmjet qytetarëve të saj. Gjuha arbërishte ndodh që të ruajë historikisht, me saktësi më të madhe se çdo trajtë tjetër e gjuhës shqipe, tingujt e saktë të të gjitha rrokjeve që janë në fjalorin e shqipes 1500 vjet më parë. Kjo përbën vetëm një shembull të mënyrës me të cilën arbërishtja ka rëndësi unike dhe të pakrahasueshme për gjuhën shqipe në tërësi, kështu që të kuptojmë familjen e madhe indoevropiane në të cilën bëjnë pjesë po ashtu greqishtja dhe anglishtja ime, dhe më në fund disa anë të qytetërimit humanitar në tërësinë e Euro-Azisë”.

<sup>110</sup>Llalla, A. *Arvanitasit – Çamët në etnikumin shqiptar në Greqi (arvanitasit themeluesit dhe drejtuesit e greqisë moderne 1821-2005)*, kumtesë e mbajtur në Seminarin Ndërkombëtar të Albanologjisë, Tetovë-Ohër, 16-23 Shtator 2007.

<sup>111</sup> Po aty.

<sup>112</sup> Po aty.

<sup>113</sup> Po aty.

Pavarësisht nga pësimet dhe fatet historike të pamira të një treve e krahine aq të bukur si Çamëria, çamët, edhe në kushtet e trysnive të shfrenuara e të parreshtura shkombëtarizuese e denigruese, kanë mbetur kudo që gjenden dinjitarë e kryelartë, njerëz të punës, të kulturës dhe të arteve. Prej sish kanë dalë deri maja të larta të shkencës e të letrave shqipe, që nga Hoxha Tahsini, nipi i tij Bilal Xhaferri, të lindur në fshatin Ninat të Çamërisë. Në gjurmët e hullinë e mbarë të tyre shkon edhe një brez i sotëm studiuesish të përkushtuar, veprimtaria dhe shkrimtaria e të cilëve i bëjnë nder Çamërisë dhe përpiqen të shfrytëzojnë të gjitha hapësirat e mundshme demokratike për t'i dalë zot çështjes çame, për të kontribuar në rrjedhat e mbara të qartësisimit dhe të zgjidhjes të së drejtave të çamëve.

**Hoxha Hasan – Tasini (1812-1881)** Mësimet e para i kreu në vendlindje. Shkollën e mesme ( medresenë) në Stamboll. Më 1857 u dërgua në Paris për studime universitare. Gjithmonë është mbiquajtur “tahsin” (shembullor). U regjistrua në degën e shkencave të natyrës pranë Universitetit të Sorbonës, ndërkohë ndjek leksionet në Filozofi, shkenca shoqërore etj. Bashkëpunoi gjatë gjithë kohës me dijetarë të tjerë francezë, anglezë, gjermanë e turq. Më 1689-ën Porta e Lartë e ngarkon me drejtimin e të parit universitet në Stamboll. Sami frashëri, Mithat frashëri dhe shumë dijetarë të tjerë të asaj kohe e vlerësojnë atë për “një gojëtar të pashembullt” dhe botë të gjerë, “gjithmonë i gatshëm për t'i treguar kujtdo me orë të tëra të fshehtat e shkencës”, “boshti i ajkës intelektuale të Stambollit, “ me pjekuri të plotë në teologji”, “me dashuri të madhe ndaj atdheut dhe kombit , me dëshirë për t'i shërbyer Shqipërisë” etj. Ai ishte pjestar i komisionit të krijuar më 1867 për hartimin e abc-së, përkrah K. Kristoforidhit, I. Qemalit, e P. Vasës.<sup>114</sup>

Ky dijetar për të shkruar në gjuhën shqipe bëri përpjekje disa vjeçare. Të gjithë e dimë që me shumë sakrificë ai hartoi abc-në shqipe. Ai e ndërton atë me 28 shkronja ( gërma dhe shenja arabe), 3 zanore dhe 25 bashkëtingëllore, duke shkruar më pas një abetare prej 32 faqesh. Në pamundësi të përmbushjes së nevojave që gjuha jonë parashtronte autori riharton një tjetër abc me 38 gërma (harfe); 2 zanore dhe 36 bashkëtingëllore. Duke qenë i bindur se një abc me gërma latine nuk mund të ishte aspak e përshtatshme për gjuhën tonë, pasi sipas tij ato nuk ishin të përshtatshme edhe për vetë gjuhët latine, ai i përkushtohet me vendosmëri kësaj vepre ku tingujve të shqipes t'i përgjigjeshin me përpikmëri gërmat. Më në fund ai arrin të ndërtojë edhe abc-në e dëshiruar e përbërë nga 39 gërma: 30 bashkëtingëllore dhe 8 zanore + 1 hundore. Ajo çfarë na bën më tepër përshtypje është pranëvendosja në të e bashkëtingëlloreve të shurdhëta me ato të zëshme pranë njëra- tjetrës, si dhe gjykimi “ *Sado që janë të vogla si këmbët e milingonës, gërmat janë arma më e fuqishme e përparimit dhe e diturisë. Prandaj t'i pranosh ato pa treguar kujdes të veçantë, është më e dëmshme se të zgjedhësh një armë e, pa e provuar, të luftosh me të.*” Ky dokument mjaft i rëndësishëm për gjuhën tonë u botua më 1872 në Paris dhe u shpërnda më pas fshehurazi në Shqipëri<sup>115</sup>

Kujtojmë gjithashtu disa prej veprave të tjera të këtij autori: *Jeta dhe Historia e Popujve; Projekti ( skica) e Abëcës së Gjuhës Shqipe; Përmbledhje vjershash persisht, arabisht, e osmanisht dhe përbërës të tjerë; Bazat e gjithësisë; Ora Diellore... ; Gjithësia, Bota; Shkenca Ekonomike; Psikologjia; Kubeja Qiellore; Shtegtimet e Guliverit ( përkthyer ..) ; Pasqyra qiellore; Edukimi i Fëmijëve; Fshehtësitë e Natyrës ( përkthim); Historia e Shkronjave etj; Historia e krijimit ( të botës, gjithësisë, rruzullimit).* Për fat të keq sa që gjallë nuk mundi të botonte asnjë

<sup>114</sup> Hoxha, D. I. *Enciklopedi Jug- shqiptare I ( A-H)*, f. 692-703; Shoqata kulturore shqiptaro- turke, Tiranë, 2006.

<sup>115</sup> Hoxha, D. I. po aty, f. 15-16.

prej këtyre veprave, por vetëm disa shkrime. Prof. Nexhip P. Pula, kryetar i degës së Shoqatës Kulturore Shqiptaro-Turke në Turqi dekoruar me urdhërin “ Naim Frashëri” Kl. I, lidhur me madhështinë e Hoxha Tahsinit shkruan: **“Hoxha Tahsini ndërtoi të parin lëmshtokësor në Turqi...Burrat e mëdhenj janë si malet e lartë. Për të dalluar mirë madhështinë e vet, duhet t’u largohemi nga rrëza e tyre.”**<sup>116</sup>

Një figurë tjetër e shquar çame është edhe poeti, tregimtari, romancieri dhe publicisti i njohur disident **Bilal Xhaferri**, nip i dijetarit të shquar Hasan Tahsini. Megjithëse i censuruar nga diktatura komuniste, ky shkrimtar i madh, në veprat e veta trajtoi çështje me vlerë kombëtare, si çështja çame, pasojat e totalitarizmit komunist, si edhe problematika që lidhen me trojet etnike të shqiptarëve kudo që ndodhen. Disa prej veprave letrare të këtij autori janë: "Njerëz të rinj, tokë e lashtë", -tregime (1966); "Lirishta e kuqe", - poezi (1967); "Dashuri e përgjakur", - romancë (1992); "Krastakraus", - roman (1967), (botimi pas vdekjes) **Shtëpia Botuese “Bilal Xhaferri”**, (1993); "Eja trishtim", - poezi (1995); "Ra Berati", - roman, (1995); "Përtej largësive" - prozë e publicistikë (1996).

Përveçse, si një shkrimtar të talentuar, na pëlqen të ritheksojmë edhe një herë atë pjesë jo shumë të përmendur deritanimë, atë çfarë shkruhet për këtë atdhetar nga prof. Shkurtaj me të cilin ndajmë të njëjtin mendim<sup>117</sup>, duke nxjerrë në pah edhe një tjetër karakteristikë të veprës së tij<sup>118</sup>: Bilal Xhaferri, përveç të tjerash është edhe “njohës e përimtues i zellshëm i fjalës shqipe”..... lëvrues “ i pasurisë dhe larmisë së shqipes së moçme e të re.. ..Vepra e Bilal Xhaferrit “paraqet interes edhe për gjuhëtarin që kundron prozën e tij nga pikëpamja e vlerave gjuhësore dhe stilistike..... Aty vërehet “ sinonimia e pasur leksikore dhe sintaksore ku shquajnë vargjet e foljeve dhe të togfjalëshave foljorë, të mbiemrave dhe të togfjalëshave emër plus mbiemër cilësor si dhe frazeologjinë e pasur me gurrë popullore e nga një gjeografi e hapët gjithëshqiptare.... me shumë vetjakësi i qaset ky autor edhe përpunimit të onomastikës artistike të veprës “ Krastakraus”, duke veçuar emrat e përonazheve dhe toponiminë artistike të veprës së tij.....etj

Mjaft interesante për studimin e çamërishtes na është dukur edhe vepra e **Muhamed Çami-it (Kyçyku)**, konkretisht “Erveheja”<sup>119</sup> dhe “ Jusufi e Zelihaja” (Dashuri përvëluese)<sup>120</sup>. Vepra e tij është mjaft e rëndësishme jo vetëm për çamërishten, pasi aty gjejmë fjalë dhe terma nga çamërishtja e hershme që sot kanë humbur, por me mjaft rëndësi është edhe origjinali i veprës së tij, si dëshmi e shkrimit të shqipes qysh herët edhe **me alfabetin turko- arab, përveç atij latin e grek.** Mendojmë që veprën e tij ta studiojmë edhe në këtë këndvështrim në të ardhmen.

Këtyre veprave dhe botimeve për Çamërinë, kohët e fundit u janë shtuar edhe libri **“Çamëria, vendi, popullsia dhe jeta ekonomike”** i **prof. as. dr. Selman Shemes**, i cili paraqet një pamje të hapët e të dëshirueshme rreth krahinës së Çamërisë, duke na njohur me vendin dhe pamjen truallësore të saj, me popullsinë dhe jetën ekonomike të asaj treve për të cilën, siç e thamë, për shumë vjet radhazi ka qenë shkruar e folur pak ose aspak. Autori ka bërë aty një paraqitje të hapët e duke ndërthurur natyrshëm të dhënat natyrore e mjedisore ose mirëfilli gjeografike e demografike me prurje e “ekskurse” të thukëta historike, etnokulturore dhe ekonomike.

<sup>116</sup> Po aty, f. 692-703

<sup>117</sup> Shkurtaj, Gj. *Gazeta* “Republika”, 14 Maj 1995

<sup>118</sup> Shkurtaj, Gj. *Ta duam dhe ta ruajmë gjuhën tonë të bukur*, shblu, “Stevla”, Tiranë, 1998.

<sup>119</sup> Çami, M. “Erveheja”, Transkriptuar nga origjinali turqisht me shkronja arabe nga Zyber Hasan Bakiu, “Maluka”

<sup>120</sup> Çami, M. “Jusufi e Zelihaja” (Dashuri Përvëluese) sh. B.- “Hasan Tahsini”, Tiranë 1992.



Me rëndësi për të folmen e Çamërisë është edhe vepra e **Karl Heinrich Theodor Reinholdit**, për të cilën flasin qartë edhe referencat përkatëse që shpesh i janë bërë këtij autori në punime të shumta për çamërishten të cilat që në fillim të punës sonë i kemi hasur në punimin dialektologjik të prof. Q. Haxhihasanit. Jo vetëm atje, por edhe në ditët tona vërejmë mjaft bashkëpërkime midis çamërishtes dhe gjuhës së arvanitasve të Greqisë. Këtë e shpreh mjaft bukur edhe transkriptuesi dhe shpjeguesi i këtyre teksteve në shqip studiuesi **A. Klosi** që në parathënie, ku herë – herë flet me gjuhën e autorit: “*1/3 e popullsisë së steresë....; “shtiti urët kundër jatroit”* etj. Mjafton të shfletojmë fletët e këtij libri<sup>121</sup> dhe menjëherë provohet ajo që shpesh e kemi thënë se çamërishtja, përkatësisht shqipja e hershme, gjallon ndër çamë ende në ditët tona.

Dorëshkrimet e Reinholdit për autorin dhe jo vetëm, duken si mjaft të vlefshme. Të njëjtën ndjesi kemi provuar kur na kanë rënë në dorë disa shënime të patrajtuara ndonjëherë dhe të cilave shpesh u jemi referuar<sup>122</sup>, të viteve ‘78 për të folmen e çamërishtes, të mbledhura nga historiani i njohur i një serie librash për historinë e çamërisë dhe heronjve çamë, z. **Hajredin Isufi**<sup>123</sup>.

Shenimet e Reinholdit janë një testament mjaft i vlefshëm i shqipes së mesjetës së vonë. Këto të dhëna fillimisht janë quajtur tepër të vlefshme nga studiues dhe gjuhëtarë të huaj si: Gustav Mayer, Gustav Èiegandi, Emilio Teza etj, të cilët edhe duke u bazuar në këto shkrime kanë dalë në përfundime të caktuara për gjuhën tonë. Sigurisht, këto të fundit shpesh kanë qenë të kritikueshëm nga studiues shqiptar, njëri prej të cilëve ka qenë edhe prof. Çabej, i cili duke qenë partizan fillimisht i metodës së krahasimit të brendshëm, kritikon çështje që lidhen me etimologjinë e gjuhës shqipe në veprën “Studime etimologjike në fushë të shqipes”.

Së fundmi ato i merr në dorë studiuesi Ardian Klosi i cili shprehet: “*qysh në vitet ‘30 fillon edhe gjumi më i gjatë i dorëshkrimeve që përfundon sot, më 2005, pikërisht në përvjetorin e 150-të, të “Netëve pellazgjike”. Gjatë gjithë kësaj periudhe Reinholdi ka qenë më e madhja e fshehtë e ditur e albanologjisë, mister me disa të njohura, dëshirë botimi, por asgjëkundi më shumë sesa fjala desideratum”, duke përmendur dy autorë të fundit si Claus Haebler me monografinë e tij: “Gramatikë e dialektit shqiptar të Salaminës” (Èiesbaden, 1965), dhe vepra e Hans –Jurgen Sasses “Arvanitka”(Këln 1991); “Të dyja këto e kapin arvanitishten në një fazë të përparuar të dekadencës apo vdekjes gjuhësore, tek shkrihet thuajse në të gjitha elementet e saj në lëndën greke”, - shprehet autori. Sipas autorit nëse ky material do të përpunohej nga filologë, e gjithë kjo pasuri,- arbërishtja e Greqisë do të njihej në shkollat tona po aq sa edhe arbërishtja e Italisë. ...ndoshta shkaku ka qenë edhe politik.....(f. 13).*

Sikurse e thamë edhe më lart po të vërejmë Atlasin Dialektologjik të Shqipes, veprën madhështore të viteve të fundit, ajo pjesë e cila i përket të folmes së Epirit jugor, -çamërishtes, nuk ka një lëvrim të plotë për një të folme të tillë. Sa herë e kemi ngritur si problem, përgjigjja ka qenë: nga mungesa e hulumtimeve të drejtpërdrejta në terrenin çam të kësaj krahine. Ishte e pamundur të depërtoje atje. Të gjithë jemi në të njëjtën mendje kur themi se “gjuhën standarde duhet ta pasurojmë me fjalë të të

<sup>121</sup> Klosi, A. Netët Pellazgjike të Karl Reinholdit ( Tekste të vjetra shqipe të Greqisë mbledhur nga Karl Reinholdi 1850-1860, (K&B), Tiranë, 2005.

<sup>122</sup> Troplini, E. *Sistemi foljor i çamërishtes në diakroni*, kumtesë e mbajtur në Seminarin e III- të Ndërkombëtar të Albanologjisë, Tetovë, 2010.

<sup>123</sup> Përpara se të bëhej kaq i njohur në fushën e historisë studiuesi në fjalë mendonte se mund të studionte të folmen çame. I mbledh këto të dhëna gjuhësore, duke u këshilluar edhe me mikun e tij, Çabej. Por fusha e historisë e tërhiqte më shumë dhe shënimet e tij të atyre viteve mbeten të patrajtuara.

folmeve dialektore ”, por nëse çamërishtja nuk njihet sa duhet përmes shkencës, atëherë kjo do të ishte mjaft e vështirë sot dhe në të ardhmen. Për këtë arsye shpesh i kemi mbyllur kumtesat tona duke nxjerrë në pah vlerat e të folmes së çamërishtes. Në mbyllje të kësaj çështjeje, po rendisim disa prej këtyre mendimeve përfundimtare të kumtesave tona.

1.“Së fundmi, po e përfundojmë kumtesën pikërisht me njerin prej synimeve të studiuesit të madh Selman Riza siç është interesi për një shqipe të njesuar...(ai ishte për një gegërishte letrare ), e cila ..... “*të jetë përfundimi i bashkëpunimit të ndëngëgnishteve të ndryshme simbas kriterit: ku të jetë e mundshme, të njajtësimi dhe, ku të mos jetë, të gjegjësimi të drejtëpërdrejtshëm me toskënishten letrare*”, duke përqafuar dhe duke i qëndruar mendimit se, **është detyrë e lartë të punosh për standardin dhe normën<sup>124</sup>, por duke mos lënë mënjanë mirëmbajtjen e dialekteve a të folmeve, sidomos kur ato janë bartës të vlerave të rëndësishme për shkencën gjuhësore.**

2.“Si përfundim mund të themi se **vërtet sot shqyrtojmë shqipen nën rrjedhat e globalizimit dhe gjithmonë kemi brohoritur për mbrojtje të standardit dhe pasurimin e tij, por nuk mund të anashkalojmë për asnjë çast vlerat e dialekteve. Pra, sot duhet marë seriozisht edhe sëmundja globale e zhdukjes së tyre.** Shumë studiues, të huaj dhe shqiptarë kanë pohuar dhe pohojnë rëndësinë e dialekteve si burime me vlerë për pasurimin e gjuhës letrare. Të të njëjtit mendim kanë qenë edhe mendimtarët me te shquar të kombit tonë, si Fishta, konica, Mithat Frashëri kur kanë thënë se: “Tharmi i gjuhës shqipe ruhet në të folurit e popullit”<sup>125</sup> Për këtë dhe vlera të tjera që dialektet mbartin, mendojmë se në radhë të parë duhet luftuar për mbrojtjen e gjuhës së mirëfilltë të një kombi dhe, më pas të luftohet fuqishëm për mbrojtjen e gjuhës së tij simbol, por të krijuar.” (Prishtinë)

---

<sup>124</sup> Troplini, E. *Si nuk duhet të shkruajmë dhe të flasim shqip. “SOS” për gjuhën tonë të bukur shqipe*, “Gjuha Shqipe”, Prishtinë, 2009.

<sup>125</sup> Hamiti, S. *“Letërsia moderne shqiptare”*, Tiranë 2000.

## KREU II

### 2. Rëndësia e të folmes së çamërishtes për gjuhësinë shqiptare

#### 2.1. Çamërishtja dëshmuese e fazave të kapërcyera të shqipes

##### 2.1.1. Sistemi foljor i çamërishtes në diakroni<sup>126</sup>

Lidhja dhe bashkëveprimi midis disiplinave të ndryshme të së njëjtës fushë si dhe ngjashmëria e pashmangshme midis tyre, herë- herë duhet të provohen edhe përmes studimeve të ndryshme shkencore. Rrezja e kësaj ngjashmërie rritet edhe më shumë nëse flasim për disiplina në kapërcyell. Siç e kemi pohuar më lart, e tillë është edhe sociolinguistika, disiplinë gjuhësore e formësuar pas viteve '60. Ajo është pjesë e gjuhës megjithëse formësimi i saj si disiplinë është provë e qartë e bashkëveprimit që ekziston midis gjuhës dhe shkencave të tjera. Kështu mendojmë se, **më parë, në shërbim të gjuhës së një kombi duhet të hetojmë mirë ndër lidhjet dhe ndihmën e ndërsjelltë midis disiplinave të së njëjtës fushë**, për të arritur në përfundime mbi afritë dhe pikëtakimet midis shkencës gjuhësore dhe shkencave të tjera.

Studimi i dialekteve të shqipes ka dhënë kurdohere ndihmesa të vyera për disiplina të ndryshme gjuhësore, veçanërisht për historinë e gjuhës sonë. Profesor Çabej është shprehur në studimet e tij se “metoda krahasimtare na vë në gjendje të ngjitemi shkallë- shkallë në histori të gjuhës ...Sipas tij duhen krahasuar së pari dialektet e sotme me njëri- tjetrin dhe këto dialekte njëkohësisht me gjendjen më të vjetër të shqipes siç dëshmohet ajo **tek dokumentet e moçme dhe të folmet e kolonive shqiptare**, duke formuar një ide të shqipes mesjetare. Kështu ne do të formojmë një ide sesi ka qenë shqipja në mesjetë...; dhe së dyti duhet të kërkojmë e të hetojmë sesi mund të ketë qenë gjuha dhe zhvillimi i saj gjatë mesjetës dhe antikitetit, për të cilën nuk kemi dokumente të shkruara të saj .....duke studiuar lidhjet dhe kontaktet që ka pasur shqipja në kohë të hershme me gjuhët fqinje të Gadishullit

<sup>126</sup> Troplini, E. *Sistemi foljor i çamërishtes në diakroni*, kumtesë e mbajtur në Seminarin e tretë Ndërkombëtar të Albanologjisë, Tetovë, 2010, botuar në organin përkatës “Aktet...”, Tetovë 2011.

Ballkanik..., duke u përpjekur të ndriçojmë këtë periudhë të errët. ... etj”<sup>127</sup>

Me këtë studiuesi synonte rindërtimin e historisë së gjuhës me lëndën që kemi në dorë, duke depërtuar deri në prehistori. Siç e shohim, nga këto dy pika, çamërishtja është një e folme e cila na vjen shumë në ndihmë dhe këtë e kanë provuar studiues të hershëm si: Pedersen, Jokli, Çabej, Q Haxhihasani etj. Nga ana tjetër, kemi të bëjmë me dy shkallë, pa kapërcimin e të cilave nuk mund të shkojmë dot tek e treta, në periudhën e mugët historike.

Studimi i dialekteve në këndvështrimin sociolinguistik apo studimi i të folmeve si vijim dialektologjik i çështjeve ndihmon po ashtu në zgjidhjen e **problemeve në fushë të historisë gjuhësore**.

“Këto dy plane, dukuritë e ruajtura dhe risitë, janë me rëndësi të veçantë në studimin e ishujve gjuhësore. Ato ndihmojnë, nga njëra anë për të përvijuar historinë e gjuhës prej së cilës është shkëputur një degë gjuhësore; nga ana tjetër, ato përcaktojnë rrethanat e reja në të cilat ka ndryshuar një e folme, një dialekt i shkëputur. Për këtë arsye, për vlerat e paçmuara që paraqet një ishull gjuhësor, sidomos për historinë e gjuhës dhe dialektologjinë, e folmja e Zarës, ashtu si edhe të folmet e ngulimeve të tjera, janë bërë objekt studimesh të gjithanshme veçanërisht nga historianët, gjuhëtarët, folkloristët, etnografët etj.”<sup>128</sup>

Studimi për sistemin foljor të çamërishtes është objekt dhe argument i mirë për të arritur në përfundime me vlerë edhe për historinë e gjuhës sonë dhe mbarë gjuhësinë shqiptare.

Në këtë fazë studimore, **sistemin foljor e kemi vëzhguar përmes përqsasjeve dhe krahasimit konkret të dukurive të kësaj të folmeje me dukuri të fazave më të hershme të dokumentuara të gjuhës sonë**. Për këtë të fundit kemi shfrytëzuar të dhëna nga gramatika historike e gjuhës shqipes<sup>129</sup>, kemi parë paraprakisht dukuri të cilat përkohjnë me faza të kapërcyera të shqipes, me dukuri të së folmes së autorëve më të vjetër shqiptarë si Buzuku, Bardhi, Budi, Bogdani etj; kemi parë gjithashtu dukuri të çamërishtes tradicionale që janë bjerrë në faza të caktuara të evoluimit të saj; ndërhyrjet e mundshme dhe të pashmangshme tek kjo e folme, si dhe zhvillimet e brendshme të saj që vijnë nga një shumësi burimesh; ndërfitje të ndryshme të motivuara nga faktorë të ndryshëm gjuhësorë dhe jashtëgjuhësorë; zhvillime brenda të folmes; zhvillime pa kurrëfarë arsye etj.

Përveç të dhënave të vjela nga çamërishtja e ditëve tona, për të bërë një punë të tillë jemi mbështetur edhe tek disa hulumtime empirike të vjela në terren në vitet 1978; kemi shfrytëzuar gjithashtu edhe disa njohuri të marra nga studiues të hershëm, siç është punimi i prof Q. Haxhihasani-it. Duke hulumtuar thellë tek elementet e vjetra të sistemit të saj, disa prej të cilave i gjejmë ende sot, falë forcës ruajtëse të së folmes çame<sup>130</sup>, ne nxjerrim edhe një here në pah vlerat e kësaj të folmeje krahinore.

**Sistemi foljor** është një ndër sistemet më të ndërlikuara të kësaj të folmeje, me larmishmëri trajtash, formash dhe dukurish. Tek foljet në përgjithësi na kanë tërhequr vëmendjen temat dhe mbaresat e posaçme gjatë zgjedhimit, konkretisht kemi trajtuar disa dukuri specifike të foljeve të zgjedhimit në **o/ io; kemi arritur gjithashtu edhe**

<sup>127</sup> Çabej, E. *Hyrje në Historinë e gjuhës shqipe* (1962, ribotuar më 1988 si tekst mësimi nga Universiteti i Tiranës), pjesa e parë, Gjerdan librash drejtuar nga L. Shkreli- Shamku, Tiranë 2008.

<sup>128</sup> Neziri, Z. e Stipçeviç, A. “*Historia dhe bibliografia e arbëreshëve të Zarës*”, Shkup, 1997; cituar nga Topalli, K. “*Për kronologjinë e disa dukurive fonetike në të folmen e arbëreshëve të Zarës*”, S.F. 3/ 4 2006.

<sup>129</sup> Demiraj, Sh. *Gramatikë Historike e gjuhës shqipe*, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë.

<sup>130</sup> Troplini, E. *Disa tipare ruajtëse të së folmes së çamërishtes*, botuar në revistën “AKTET” e Seminarit të Dytë Ndërkombëtar të Universitetit Shtetëror të Tetovës.

në disa përfundime për të ashtuquajturat folje të zgjedhimit në *-mi*, përkatësisht *kam, jam, thom*.

E nisim fillimisht me paraqitjen e hershme të formave foljore, si dhe paraqitjen tradicionale të formave të çamërishtes për të studiuar ndryshimin që në fillesat e veta. “Këto dy plane: dukuritë e ruajtura dhe risitë, janë me rëndësi të veçantë në studimin e ishujve gjuhësorë. Ato ndihmojnë nga njëra anë për të përvijuar historinë e gjuhës prej së cilës është shkëputur një degë gjuhësore, nga ana tjetër ato përcaktojnë rrethanat e reja në të cilat ka ndryshuar një e folme, një dialekt i shkëputur.”<sup>131</sup>

Sigurisht, ndryshimi diakronik i një gjuhe nuk mund të njohë kufij të prerë, por shqyrtimi i tij në faza të caktuara të evoluimit të saj, përkatësisht çamërishtes, në varësi të informacionit që kemi, na lejon që përmes këtij krahasimi me format arkaike, të krijojmë një ide për sistemin foljor çam; të arrijmë në përfundime për atë çfarë ka ndryshuar, por edhe si ka ndryshuar, ne ç’rrethana etj, duke vënë theksin tek vlera e dukurive.

Zgjedhimi i parë/ Koha e tashme<sup>132</sup>

Format arkaike,	forma e çamërishtes tradicionale	format e reja letrare
Ban(j)	bi- j	bë-j
Ban	bë-n	bë-n
Ban	bë-n	bë-n
Ban(j) -ë-më	bi- më	bë- jme
Ban -i	bi-ni	bë-ni
Banj -ë-në	bi-në	bë-jnë

Nga kjo tabelë ne shohim se evoluimi për të tashmen ka ndodhur si në mbarë shqipen, me përjashtim të një ndryshimi që ne e kemi vënë re në të dhënat e ’78-ës. Në raste tepër të rralla shohim se, në vetën e parë folja del me mbaresën *-j*. Mendojmë se **në çamërishte** *nj*-ja e kohës së Buzukut ka rënë dhe rishfaqja e saj nuk ka të bëjë me evoluimin e *nj*-së në *-j*, por *-j*-ja e këtyre foljeve, është një ndërhyrje nga shqipja e përgjithshme nga kontakti i mëvonshëm midis dy të folmeve.<sup>133</sup>

Po kështu kemi edhe foljen **mbaj**, e cila shfaqet në trajtën **ba** ( *e ba mënd? / e mbaj mend* ), pra tek kjo folje shohim edhe një tjetër dukuri; vihet re rënia e *n-së* fundore e temës ( pak a shumë si tek *zâ* (*zan-ë*), rishfaqja e së cilës mendojmë se ndodh për të njëjtat arsye, pra nga kontakti me shqipen e përgjithshme. Të njëjtat vërejtje vlejné edhe për foljen **vij**. Për të qenë më bindës po rendisim disa shembuj: *Ç’bën? – I tha djali, – ja bi* (bëj) *dru, -i tha*.<sup>134</sup>; *E ba* (mban) *mend Durdul ku u ka qorruar babai?*; *Uaa! -tha Moskovi, me shtatë vetë do bi* (do bëj)<sup>135</sup> *luftë ki* (ky) *me*

<sup>131</sup> Neziri, Z. e Stipçeviç, A. ne “ *Historia dhe bibliografia e arbëreshëve të Zarës*”, shkup, 1997; cituar nga Topalli, K. “ *Për kronologjinë e disa dukurive fonetike në të folmen e arbëreshëve të Zarës*”, S.F. 3/ 4 2006.

<sup>132</sup> Likaj, E. *Zhvillimi i eptimit në gjuhën shqipe*, ShBLU, Tiranë, 2003

<sup>133</sup> Pas shpërnguljes së dhimbshme të çamëve më 1944 çamërishtja ishte ruajtur mirë nga folësit e kësaj krahine, siç ndosh në raste të tilla apo siç ka ndodhur me të folmet anësore shqipe dhe ato të diasporës të cilat kanë bashkëjetuar dhe vazhdojnë të bashkëjetojnë nën tryshninë e një gjuhe tjetër. Me shpërnguljen e çamëve në Shqipërinë shtetërore tashmë ajo u gjend përballë një shqipeje të evoluar.

<sup>134</sup> Nga përralla “ *Plaku dhe plaka*”, 1978

<sup>135</sup> Në këtë rast nuk na intereson kohae foljes, sa na intereson trajta foljore.

mua?<sup>136</sup>; Të **bjell** (mbjell) spinaq me surratin tënd në sabah e të **bi** (bij/ bëj) bureq në aksham... Ja **ba** vesh/ tha kali djali/ tani do biç prapë çish të then ti; ...edhe u me ti do **vi** i tha ai burri; ç'bën i tha djali/ ja **bi** dru i tha / ku i merr dot ti/ i tha djali/ ke të më veç nja di akoma/ i tha ai.

Siç e shohim edhe nga shembujt, një dukuri fonetike e cila i ka rezistuar kohës dhe gjallon mjaft karakteristike ndër çamë sot është edhe ndryshimi i zanores –ë të theksuar në –i. Në sistemin foljor të çamërishtes, një tjetër folje që na tërheq vëmendjen përkrah foljes “bëj”, në kuadrin e –ë-së në –i, është dhe veta e tretë njëjës e së tashmes së dëftores së foljes “jam”( isht). Kjo është një trajtë e vjetër që haset në përdorim jo vetëm tek e folmja e çamërishtes, por ruhet edhe sot e kësaj dite në ndonjë prej të folmeve arbëreshe të Italisë, çka tregon edhe vetinë konservuese të tyre. Megjithë ndryshimet e mundshme, kjo dukuri shfaqet dukshëm edhe në çamërishten e ditëve tona gjë të cilën e dëshmojnë edhe shembujt: *histori e Çamërisë kjo isht..; epo ja!- në ndjekje isht ajo punë... , fshatrat na ndihmuann'çik ç'isht e vërteta... ..se në luftë kshu isht..; / ç të kapin vritej.., po ç jetë isht kjo nusa Petritit? – fëmilë e ndarë/ shtëpia ka shtëpia; .u ka bën sëmure po isht mirë.., bum ktë copëzë shtëpi..../... qi ish kaq e bukura.*<sup>137</sup>

Për kohën e tashme të dëftores të foljes *jam*, kemi bërë një përjasje të kësaj forme me format e sotme të shqipes dhe me ato të dokumentuara të saj. Nga kjo përjasje kemi vënë re se në vetën e tretë folja *jam* nuk del në trajtën e saj *është*, por në trajtën *isht* dhe *ishtë*, ku në më të shumtën e rasteve ë-ja fundore bie. P. sh: *ú do te dergoj di kobeza mollë / po i njohe çila isht e vjema / çila e sivjema/ nuk do hapim luftë .. ú do te dergoj di pela/ po i njohe çila isht nana çila ishtë bila nuk kemi luftë / drishe do nis luftë; ku isht/ i tha ai / merre selle kutu; ç'ishtë ajo i tha Veizi/ ishtë gugusha e bukrës dheut.* Nga këto shembuj vërejmë gjithashtu se ka një ndryshim fare të vogël në formë midis trajtës *isht* dhe *ishtë* të vetës së tretë të së tashmes dhe asaj *ish* të vetës së tretë të së pakryerës. Nga ana tjetër, shembujt janë dëshmues të dukurisë së dysorësisë në përdorim që në 78-ën, një dukuri e cila tek të folmet në kontakt është e pashmangshme, si: *të mari një kazan me ujë e ti hedhi / ajo që të vejë në fund është e sivjeme / ajo që do betej bi ujë është e vjema.*

E folmja e çamërishtes është e mbushur me trajta “dysorësie”<sup>138</sup> në të folur, pasi siç e kemi argumentuar në punimet tona për të, ajo është një e folme dikur në kontakt me greqishten, më pas në kontakt të vazhdueshëm me shqipen e përgjithshme dhe më pas e favorizuar nga faktorë të ndryshëm (të brendshëm dhe të jashtëm), e tërhequr herë kah konservimit, herë kah ndryshimit. Ruajtja është nxitur përherë e më shumë nga faktorë të jashtëm , njëri prej të cilëve është faktori psikologjik që lidhet konkretisht me historinë e shpërnguljes së tyre dhe mallin për vendin e të parëve.

Ndryshimi në të folmen çame orientohet kah dy poleve: gjuhës standarde nga njëra anë dhe e folmja e bashkësive pritëse në të cilat çamët janë vendosur (me të cilat janë integruar), nga ana tjetër. Në këtë lloj tërheqjeje (me shumë humbje, pasi ajo është edhe konservuese, por edhe integruese në bashkësitë pritëse) fiton ndryshimi, si dhe orientimi kah gjuhës me prestigjin më të madh, siç është gjuha zyrtare standarde. Në këtë drejtim ajo bashkohet me atë prirje që përbashkon sot mbarë të folmet<sup>139</sup>, **por duhet të theksojmë se të folmet krahinore nuk orientohen të gjitha njëlloj kah**

<sup>136</sup> Nga përralla “ *E bukura e dheut*”, 1978, të regjistruara nga prof. Hajredin Isufi, ( historian)

<sup>137</sup> Këto shembuj janë shfrytëzuar edhe për punimin *Disa tipare ruajtëse të së folmes së çamërishtes* , botuar në revistën “AKTET” e Seminarit të Dytë Ndërkombëtar të Universitetit Shtetëror të Tetovës.

<sup>138</sup> Term i huazuar

<sup>139</sup> Shkurtaj, Gj. *Disa dukuri të së folmes së Kurbinit në dritën e sociolinguistikës*, SF, 1998; *Sociolinguistika* , SHBLU, Tiranë 2000.

**gjuhës standarde.** Çamërishtja ndihmohet në këtë drejtim më shumë se të tjerat<sup>140</sup> edhe sepse ajo është pjesë e dialektit të toskërishtes. Kështu, tek shembujt e mëposhtëm do të vihen re jo vetëm disa ruajtje, por edhe ndryshimet në temë dhe mbaresë të foljeve, si dëshmi e qartë e evoluimit të së folmes qysh herët, si dhe e disa zhvillimeve të brendshme të vetë gjuhës.

*Na ish një plakë dhe një plak/ na kishin një djalë pesmet vjeç/ djali na she një nëndërr një natë/ hënzën në krahë të djathtë e djellin në krahë të mënjër ....; -ja ta shoh një çikë / e pa e vuri në xhep Veiz....; Kjo hap qepengjinë / e sheh hoxha e i thotë/ më do tani Xhiko..... ne nuk e shomi munasip ashtu po të hedhiç nigjah.....; edhe u kushtu e shoh munnaasip (munafik, fjalë e besimit islam e huazuar nga arabishtja)....vete bërna e i she gjithë ato që duej ajo.... etj; Na i vete xhikos në katua e i bije qepengjisë ..kush i bie portës tha ajo... u i prëmshmi (mbrëmshmi)i tha ai.. Kush i bie portës i tha ajo/ u i njënatshmi i tha ai ..... Nuk duamë u thotë djali .. Zakonë që kemi tani bej i thotë ajo.....; Merr një kazane të madhe me ujë e vë në zjarr e e lë sa zien glluk.....; Xhikua valoj një kazan me ujë/ pa t'ja kthen hoxhës mbë/ hoxha thotë/ e merr ka këmet e e hedh poshtë... po pjete edhe për xhikon pesë i hinë e dhjetë i dalin.....; Në saba grihet (forma joveprore) u thotë “ babajt e nanës”/ kam parë një nëndërr u tha.....Pse klan more vëlla.....; Breti i thotë djalit madh: do veç të më theriç xhikon... hoxha për t'i bërë keq xhikos na bën një llagëm në shtëpi.....; Pjesin ku ka nonjë vënd për dënjël/ se të gënë e të pirë kemi vetë u thonë.....;I drojmë plashkat / i thotë djali // u druan.....*

Mjafton të analizojmë këto shembuj dhe arrijmë në këto përfundime:

- foljen **shoh** e gjejmë në trajtat: **she, sheh, shoh, shomi**. Tek këto trajta foljore që në vitet '78 vërejmë dysorësi në të folur të foljeve **she/ sheh**. Gjithashtu vërejmë përkatësisht trajtën e hershme **she** të çamërishtes që përkon si me trajtën e shqipes së vjetër, ashtu edhe me trajtën e shqipes së sotme **sheh**, si risi në këtë të folme. Risi përbën edhe trajta **shoh** e saj. Karakteristike është trajta e hershme **shomi** e çamërishtes në vënd të trajtës **shohim**, për të cilën mendojmë se përdoret në analogji me trajtën **thom/ thomi**;
- dysorësi në përdorim vërejmë edhe tek foljet **bie/ bije**. Megjithëse në çamërishte në më të shumtën e rasteve **j**-ja antihiatizuese mungon, në këtë rast ajo shfaqet. Mendojmë se më shumë sesa një dukuri që i përket çamërishtes së viteve '78, kjo ka të bëjë me të folmen karakteristike të ndonjë zone të veçantë, përderisa Çamëria është një krahinë e madhe me variante të ndryshme të të folurit;
- shtimi i **ë**-së fundore tek folja **duamë** mendojmë se është bërë për analogji me ato fjalë tek të cilat **ë**-ja fundore ruhej, por edhe ruhet ende në këtë të folme. **Ë**- në fundore e vumë re edhe tek folja **jam** në vetën e tretë, *ishtë*<sup>141</sup>
- foljet, **vë, lë, merr, hedh, dalin, thotë, bën** janë shembuj të qartë të bashkëpërkimeve midis të folmes së çamërishtes dhe shqipes letrare, si variant i toskërishtes<sup>142</sup>;
- foljet **hinë, klan, pjesin, drojnë, grihet**, flasin qartë për praninë në to të

<sup>140</sup> Një gjë e tillë vihet re sidomos tek brezi i ri çam të cilët janë më të suksesshëm në përvetësimin e standardit sesa brezat e rinj të bashkësive pritëse që nuk i përkasin toskërishtes.

<sup>141</sup> Ruajtjen e ë-së fundore në çamërishte e kemi parë edhe në punimin “Bashkëpërkime midis të folmes së çamërishtes dhe të folmes së autorëve të vjetër të shqipes (Alb- Shkenca, 2009), -dukuri të cilën e vërejmë edhe tek Buzuku.

<sup>142</sup> Fakti që çamërishtja është variant i toskërishtes nuk na pengon aspak në hulumtimin e kësaj të folmeje, falë forcës izoluese të saj.

dukurive tipike fonetike të çamërishtes, përkatësisht: **asimilimi mb (mbaj), nd,ng > m (baj), d, g** ; rënia e **ë**-së së patheksuar **dërroj> droj; kl, gl, > q/ k, gj; mungesa e zanores y** dhe përdorimi në vënd të saj i zanores **-i: hinë/ hynë**; prania në këtë të folme e diftongjeve të tilla si diftongu **ie**, që gjendet tek folja **pësin**; në këtë grup foljesh spikasin edhe ndërrime të tjera si; **punoj> pënoj, sjell> sell** etj;

- në studimet dialektologjike për çamërishten, për foljen **ngrij**, deri tani kemi këto të dhëna. **unë ngrij, ti/ ai ngrin, ne ngrimë, ju ngrini, ata ngrinë**. Format e ndryshme të mbaresave foljore sipas paradigmës së zgjedhimit i marim si të mirëqena, me të vetmin dyshim në lidhje me mbaresën foljore **-j** e cila në të dhënat tona, ndonjëherë nuk shfaqet. Sigurisht, duke ditur se j-ja është një zhvillim i mëvonshëm i shqipes dhe duke pasur parasysh faktin që foljet me temë në zanore, në të tashmen e dëftores në këtë të folme, në përgjithësi dalin pa mbaresën **-j**, arrijmë ne përfundimin se dikur në çamërishte kjo mbaresë nuk ka qenë e pranishme edhe tek kjo formë foljore. Nga ana tjetër, është e pashmangshme të mendohet folja në fjalë pa asimilim të grupit **ng. Û grij/gri... gopej** për **ngopej** (e pakryer).
- E njëjta vërejtje vlen edhe për foljen **ndjell** të cilën sot ndër çamë të vjetër e gjejmë në trajtën **(unë/ ti) djell, ai djell/ dill, (ne) djellëm, (ju) dillni, ata/ato djellën**.

Duke marrë shkas nga kjo folje, pavarësisht shembujve të lartpërmendur, vijojmë me një tjetër dukuri karakteristike për mbaresat e shumës të kohës së tashme në çamërishte, -ruajtjen e këtyre mbaresave, të cilat i gjejmë edhe në çamërishten e sotme.

Kujtojmë nga gramatika historike: **banj-ë-më...** në çamërishte (për foljet e vetës së parë shumës, të kohës së tashme, mënyrës dëftore, diatezës veprorë) kemi sikurse tek Buzuku mbaresën inovuese **-imë** ( e cila gjendet edhe sot në të folmen e brezit të vjetër çam). Kështu tek Buzuku kemi: **na qi baimë** 11a4, **porsi edhe na liroimë**<sup>143</sup>; ndërsa tek çamët kemi: **bimë, pënoimë, klaimë, droimë, griimë** etj.

Prapangjitja karakteristike e pjesëzës **-te**, vihet re sot kryesisht tek foljet **běj, vij, shoh, pres**, në kohën e ardhme të mënyrës dëftore, si: **do bite, do vite, do preste, do shote**; foljet **běj** dhe **vij** me këtë prapashtesë i hasim edhe në të tashmen e lidhores, **të bi-te, të vi-te**. Më të rralla janë këto përdorime në kohën e tashme të dëftores: **e bite ù ; vite ù** Për kohën e tashme spikat folja **shoh: Pse, shote u?** (Pse shoh une ). Kjo dukuri ka ardhur duke u bjerrë po të krahasojmë çamërishten e sotme me shembujt nga punimi i Prof. Q. Haxhihasanit. Kështu kjo prapashtesë nuk përdoret më në fjalët, **them (-te), jam (-te), los (-te), kam (-te)**.

Për sa i takon mbaresës të së pakryerës së foljeve që dalin me temë në **-n** do të vërejmë:

- Tek Buzuku: **na në banjim** 103b42, **na donjim** 94b44; **e fort tue patë ata bainë maravejë** 44a33<sup>144</sup>
- Në të folmen çame sot kemi:<sup>145</sup> **Dojëm të hajëm/ e bijëm bukën vetë/ bijën bukë të mira aqere../ me ushqim që hajëm rrugës; kalojëm me lundra ; ..me hi lajëm/ na lajën nanat në darkë...// në Shqipëri aq morr ziijem...sa...Krahaso: banjim: bijëm,**

<sup>143</sup> Të dhënat dhe shembujt e trajtuar nga gjuha e Buzukut prej nesh, janë marrë nga vepra me vlerë studimore e albanologut Selman Riza, *Pesë autorët më të vjetër të gjuhësisë shqiptare, \_Krestomati thjesht gjuhësore,* “Gjon Buzuku” ( 1555).

<sup>144</sup> Riza, S: po aty, f.393

<sup>145</sup> Gjithmonë e kemi fjalën për të folmen e brezit të vjetër



Mendojmë se këto zhvillime të mbaresave foljore kanë të bëjnë me evoluimin e gjuhës në të cilën, *i > ë*; ndërsa ndryshimet në temën e foljes *ba: bi*, mendojmë se kanë të bëjnë me një ndryshim dialektor.

Në çamërishte gjenden edhe trajtat bilinge, *klajin, thoshjim*, ndërkohë që tek *Meshari* vërejmë: *-thoshnjim, -klanjinë* etj.

Çamërishtja është një e folme tek e cila në sistemin e saj foljor ndodhin shumë “kontraktive”<sup>146</sup>. Duke parë të folmen sot mund të mendohet se kjo ndodh për shkak të zhvillimeve të brendshme të saj dhe për rrjedhojë edhe të prishjes së të folmes krahinore. Kjo është një mundësi e cila nuk përjashtohet, por gjetje të tilla tek punimi dialektologjik i Q. Haxhihasanit dhe të të dhëna të hershme (1978) në terren na bëjnë të mendohemi pak lidhur me këto dukuri që nuk mungojnë as në shqipen e Reinholdit as tek arbëreshët.

**Koha e pakryer** sikurse e kemi dëshmuar 10 vjet më parë në temën e diplomës, preket më shumë nga kjo dukuri. Rrallë mund të ndodhë që ajo të përdoret saktë tek më të moshuarit: *ikë e ikë/ e gjen një burrë që dizet mulli bluajnë (bluante) e dizet furra pijnë (piqte)/ e ai nuk gopej/ lëpin (lëpinte) fillaqinë e mullirit // çbën more / i tha djali / ha/ sh’ nuk gopej (ngopesh, forma joveprore) mor derr i tha / që dizet mulli bluajnë (bluan) e dizet furra pjekin (pjek) // mos ke nonjë copë t’ më japiç.*

Nga këto shembuj vërejmë që foljet *bluajnë* dhe *pijnë*, përdoren në të njëjtat forma edhe në të tashmen. Folja *gopej* e vetës së tretë, që është në formën joveprore është një përdorim i saktë i kësaj forme, ndërkohë që më poshtë, e njëjta formë përdoret edhe për vetën e dytë njëjës.

Për foljet e vetës së tretë të së pakryerës nuk gjejmë aspak gjurmë të formantit *-t* indoevropian, si dhe mbaresën e re të shqipes *-(n)te*. Kjo do të thotë që kemi të bëjmë me një fazë të kapërcyer të shqipes e cila dëshmohet edhe sot, p. sh: *Erdhi nek ai qe vëzhdrin përprjeti / një grusht lira edhe atij ; ai breti kish një mall mërguarë edhe bum ktë copëzë shtëpi.../... qi ish kaq e bukura...; o merre selle bërna / vete bërna/ e she gjithë ata që duej ajo// Djali pa gënë pa pirë / atje ai// ka ligësia ajo/ kur i shpi bukën i jati asaj / ajo i li ka një çikë pjesë të haj breti.*

Në të folmen çame na tërheqin vëmendjen mbaresat e shumësit të së pakryerës, të cilat ruajnë ende tingullin mbështetës *i* midis temës dhe mbaresës së foljes, p.sh: numri njëjës (unë) *bija*, (ti) *bije*, (ai/ajo) *bi/* (ne) *bijim*, (ju) *bijit*, (ata) *bijin*. Në shqyrtimin e shumësit vërejmë se *ë*-ja fundore ka rënë, *nj*-ja ka rënë (ajo është zëvendësuar në rrjedhë të viteve me *j*-në e shqipes së përgjithshme) *ë*-ja e theksuar ka dhënë *-i* si në mbarë çamërishten.

**Në të kryerën**, dhe **më se të kryerën** folja ndihmëse del sipas formave të saj të së tashmes dhe të së pakryerës, ndërsa pjesorja del njëlloj në të dyja kohët, p. sh: *I jati nuk kish parë çish kish vënë jati poshtë// ashtu bëri/ hapi qepengjinëe sheh atë atje ...// e vuri djalin atje / e / harroi çish kish vënë atje// më keshe vënë efandi/ se kesh parë një nëndër // iku më përtej që kish lënë dhe malin me dru / këtej kish çelur zjarrë / e vetë kish hirë në zjarr bërna. Etj krahaso Alb- shkenca. Mora vajzën e brettit / tani kam ardhur të marr vajzën tënde; kam kohë që më ka zënë agusa/ e do dal në bretëri të tjera; ka dalë në ballkon e festen e ka në kokë. M’u ka qorruar babai; e ba mend Durdul ku u ka qorruar babai// Në shembullin e fundit shohim se në vënd të foljes *jam* për të kryerën përdoret folja *kam*. Kjo është karakteristike jo vetëm për çamërishten, por edhe për të folme të tjera si ajo e arbëreshëve, arvanitasve etj.*

<sup>146</sup> Shkëmbime formash dhe rimarrje dukurish nga njëra fjalë tek tjetra të cilat vijnë si rrjedhojë e ndryshimit të së folmes.

Ndërkohë rendisim disa shembuj për të parë se ç'ndodh me **të kryerën e thjeshtë**.

E **muarrë** hoxhën/ e **grinë** si duhani në havan; ata **ignë** / dhe çish i lipseshin ja **suallë** bërna, **damkosën** portën e mori djeltë e iku; Ja **hipi** e **u nis/ vate** jam në Simuar të bukrës dheut; **pāçë** të bukurën e dheut e **u qorruaç/** po ktheu të vete në shtëpi; pse **u ktheve** baba i thanë djeltë/ **pāçë** të bukurën e dheut/ e **u qorruaç** ; **u kthe** prap në shtëpi/ nuk e gjeta baba; vate edhe ai / po u kthe pa gjë. S' **pāçë** ka sit do shoh ka vetullat i tha babai. Iku i vogli **vate** ne kali.... //njëherë **hegëlliti** kali , **u hamnë** podhetë e pallatit/ i hodhi dorën në feste/ ja merr asaj / e/ hëë **bëri Duallë** ka kufia/ aramnë moj u tha hizmeqarëve / se ma **muarrë** Gugushenë/ ; e **priti** Veziri, e **shpunë** bërna/ **hëgrën** e **pinë/** djali / ka **vate të mirr** kutinë ka xhepi i feksi gugusheja. Djali **vate** ne kali në katua. Pse e **xore** në mejdan ti / i tha kali, tani do biç prap çish të then ti / ëëëë. ...tha djali , Tani do veç ka vate të mirr kutinë ka xhepi i **feksi** gugusheja.; mos **u sellkëdis** / tha kali; ti veri di pelat në avlli / të veri pajtarët e ti rrahin pot e pot e pot ; **vanë** prapë në kufi të bukrës dheut; më të meseet (të nesërmen) në saba i tha kali / çish vajte// **dolla** mirë/; hiri djali / ajo u gjend në mes të shtëpisë / e **poqi** djalin; kjo e **blodhi** mall e gjë se kish ; **pjenë** për vënd ku do flinë // ajo **zglodhi** një vënd të bukur / prof e prof **u bëri** duarve nja di herë / e **bëri** brup pallatin e ri

Duke analizuar shembujt e mësipërm arrijmë në këto përfundime:

- Në të folmen e çamërishtes ruhen mbaresat e **hershme të shumësit: më, të, në**, si: *igmë, igtë, ignë, grinë, shpunë, pinë, dersinë, vanë, pjenë, hamnë* (hapnë), *prinë* etj;
- Nga shembujt e mësipërm vërejmë se, ndonjëherë ndodh që në vetën e tretë shumë, sidomos tek foljet me temë në bashkëtingëllore, **n**-ja e mbaresës bie, p. sh: *muarrë, suallë* etj;
- Vërejmë gjithashtu disa folje si, *hegëlliti, pijti* etj., tek të cilat na bën përshtypje mbaresa vetore. Për këtë të fundit mendojmë se tingulli –t, është një tingull fundor i temës së foljeve *mat, mat-a* etj., që me kalimin e kohës është bërë pjesë e mbaresës, *ma-ta*<sup>147</sup>
- Në çamërishten e hershme, por edhe në atë të ditëve tona, gjithmonë na kanë bërë përshtypje format foljore të foljes **vete** në të kryerën e thjeshtë: *vata, vate, vate/ vati; vāmë, vātë, vānë* . Këto forma përveçse tëk arvanitasit, i vëmë re edhe tek të folmet arbëreshe <sup>148</sup>;
- Mjaft interesante janë edhe trajtat e hershme *dolla, duallë* etj, si dhe dukuritë e ndryshme fonetike në temat dhe mbaresat e foljeve, përkatësisht: *xora* (nx>x), *prinë* ( tn>n), *hamnë* ( pn>mn), *sellkëdis* ( sekëlldis) etj.
- Në të kryerën e thjeshtë meriton të trajtohet edhe dukuria e aoristit sigmatik, e cila shfaqet edhe në kohë të tjera foljore: *pāçë, lāçë, u qorruaç* (joveprore) etj.

Çdo gjë në gjuhë është relative dhe sigurisht, jo të gjitha dukuritë shkojnë sipas rrjedhës së parashikuar prej nesh: standardit, të folmes së bashkësisë pritëse, apo refuzimit të tyre, për rrjedhojë,- konservacionit. Evoluimi i një të folmeje të caktuar pranon në vetvete edhe dukuri herë- herë të pashpjegueshme që janë zhvillime të brendshme të së folmes, të cilat sigurisht nuk e kanë burimin tek e folmja e çamërishtes së sotme por ato janë gjithmonë pjesë e një gjuhe a një të folmeje.

Në të folmen e çamërishtes marrin rëndësi disa zhvillime brenda saj:

<sup>147</sup> Likaj, E. *Zhvillimi i Eptimit në Gjuhën Shqipe*, ShBLU, Tiranë, 2003

<sup>148</sup> Shkurtaç, Gj. "Ligjërimet arbëreshe" ( Shqyrtime dialektologjike dhe sociolinguistike në ngulimet arbëreshe të Italisë), Tiranë 2006.

- Folja *běj*, në të kryerën e thjeshtë në vetën e parë del në trajtën *bëri*. Por, në të folmen çame vërejmë që shpesh përdoret e njëjta formë, me të njëjtin kuptim gramatikor, por jo leksikor. Le të krahasojmë: *i hodhi dorën në feste/ ja merr asaj / e/ hëë bëri ; prof e prof u bëri duarve nja di herë / e bëri brup pallatin e ri*. Dy format e para zëvendësojnë kuptimin gramatikor dhe leksikor të ndonjë folje tjetër, p.sh: *u bëri duarve* është e barabartë me *fërkoj duart*. Këtë dukuri e theksojmë me bindje pasi e hasim shpesh edhe tek të rinjtë e sotëm çamë.
- Një tjetër dukuri në këtë drejtim është edhe mbaresa foljore e vetës së tretë e së kryerës së thjeshtë ( e foljeve me temë në zanore) që përdoret për analogji me dy të parat, p. sh: *punova, punove, punovi; mësova, mësove, mësovi; luftova, lutove, luftovi*. Analogjia është një dukuri e cila vihet re shpesh në të folmen e çamërishtes. Ky është një zhvillim i cili ka një përdorim të shpeshtë tek çamët dhe është trashëguar mirë tek brezi i ri.

Për **kohën e ardhme**, vërejmë se në asnjë rast ( me ndonjë përjashtim të rrallë) nuk shfaqet pjesëza të. <sup>149</sup> Një tjetër dukuri për këtë kohë është edhe ajo e **aoristit sigmatik** në vetën e dytë njëjës, që është karakteristike edhe për lidhoren: *kam kohë që më ka zënë agusa ( sikleti, halli)/ e do dal në bretëri të tjera; hajde tani Durdul se do dalim bashkë një herë i tha breti..; do vete u tha djali madh; do vete u tha djali mesëm ; do vete u tha i vogli; tani/ tha kali do më bāç vesh mua; këtë do njohiç për zot. Po më munde do më xerix sitë, po të munda do të krej di sitë. Hënëza në krahun e djathët / do maç vajzën time / diellin në krahun e mënjër do maç vajzën e Moskovit// ku do veç/ i tha breti / do vete të marr vajzën e Moskovit i tha//do më japiç shtat mushka...//; Breti që erdhi ka gurbeti do marton djalën e madh....; ù do shkoj një vërdallë Saraive e do hegëllij/ ajo do dalldisi / ti ti hedhiç dorën në feste e t'ja maaç ( marrish)/ se ù do higëllij aq fort/ sa do bien podhet e shtëpisë bedhe ( mbedhe> mbidhe,- përtokë); Pse e xore në mejdan ti / i tha kali, tani do biç prap çish të then ti / ëë .../tha djali / tani do veç ka vate të mirr kutinë ka xhepi i feksi gugusheja; tani do veç si musafir e do flasiç arap//*

Disa shembuj në **lidhore**: *hoxha e pa kur vate në haman ajo / hoxha zuri vënd që të mos dil xhikua....; për tri katër ditë na shkon një bret tjetër atje ne krua/ të piin ujë me zagarë edhe gjatorë...// ...po ktheu të vete në shtëpi; ti t' i hedhiç dorën në feste e t'ja maaç ( marrish). Pjesin / ku ka nonjë vend për dënjël / se të gënë e të pirë kemi vetë u thonë ; ka vate të mirr kutinë ka xhepi i feksi gugusheja. tani do biç prap çish të thenë ti / të bjell spinaq e të bi bureq. Të bjell spinaq me surratin tënd në saba/ e të bi bureq në aksham ; Arapi me një si në ballë i lidhur ne porta nuk lii njeri as të hin / as të dil ka porta. / ku i merr dot ti/ i tha djali/ ke të më veç nja di akoma/ i tha ai ; breti i thot djalit madh / do veç të më theriç xhikon/ të më sjelliç një filxhan gjak te pi.....*

Ruajtja e *i-së* së hershme mbështetëse vihet re edhe tek këto dy kohë, si: *do japiç* ( do të japësh); *të sjelliç* ( të sjellësh)

Tek **urdhërorja** na bëjnë përshtypje disa folje si: *dal, sjell*, që në vetën e dytë njëjës dalin në format: *del, selle*, p.sh: *Ktheu durdul i thotë breti; ja (pa) hipi kalit, pa selle të bukrën e dheut; del këtej / i tha breti ; o merre selle bërna / vete bërna e she gjithë ata që duej ajo*

Tek forma joveprore e foljeve në përgjithësi, na tërheq vëmendjen mbaresa e së tashmes dhe e së pakryerës së foljeve me temë në zanore, ku *h-ja* e mbaresës zëvendësohet gjithmonë me *n*. Kjo është një dukuri e ngulitur, saqë ajo në ligjërimin e

<sup>149</sup> Për këtë arsye edhe argumentimi se e ardhmja formohet nga folje në lidhore plus pjesëzën *do* nuk mendojmë se është i saktë. Ndoshta do të ishte më mirë të thonim nga pjesëza *do të* plus një folje në dëftore siç e kemi mësuar edhe ne në fëmijërinë tonë të hershme.

çamëve sot është përgjithësuar edhe për fjalë që s'mund të marin një mbaresë të tillë, p.sh: *thermë more vëlla hallall ti bënet gjaku im babait ; tani burazer/ i tha ai i shkëmit/ u do kthenem .. / një grusht lira atij // erdhën ne mulliri / do kthenem ù tani se më ka marë uja ( uria) / një grusht lira edhe atij// kthenemi kutu të flemë Xhiko/ si të deç hoxhë / i thotë xhiko. Mirpo shtëpi e hoxhës edhe e brettit vineshin karshi për karshi; hoxha e pa kur vate në haman ajo; )/ e ai nuk gopej/ lëpin ( lëpinte) fillaqinë e mullirit; me gugushet e saj shëronen malsitë e babajt tënd. Vini re foljen vineshin.*

**Pjesorja** në përgjithësi përkon me standardin. Por, edhe këtu spikat një dukuri mjaft domethënëse për gjuhën shqipe. Pjesorja e foljes bëj ruan trajtën e hershme të shqipes. Ajo bëhet dëshmuese e asaj faze në të cilën dukuria e rotacizmit nuk ishte shfaqur ende, p.sh: ç'ke **bënë** / jam mërziur , se kam kaq koho me si **billur**// po ti xerë i keshe baba// Ai ishte hoxha që më ka **bënë** mua të gjitha këto hupe. Shumë e fortë shfaqet kjo dukuri edhe në çamërishten e sotme.

Kemi bindjen se në përgjithësi çamërishtja është një e folme mjaft emfatike, sikurse gjuha e autorëve më të vjetër, veçanërisht gjuha e Buzukut. Për këtë të fundit është thënë shpesh se kjo dukuri ka të bëjë me **shqiptimin individual emfatik të Buzukut**. Emfatike paraqitet ende çamërishtja e sotme; Këtë tipar mendojmë se çamërishtja e ka trashëguar qysh herët. Për këtë arsye, mendojmë gjithashtu se edhe tek Buzuku, kjo ka të bëjë me një tipar të shqipes së vjetër.

Së fundmi, përderisa studimi i sistemit foljor të shqipes ka qenë mjaft i vështirë për atë fakt tashmë të njohur, të mungesës së dokumenteve të hershme, mendojmë se do të ishte e udhës të bëhej një studim mirëfilli jo vetëm në aspektin kronologjik të saj, por edhe për qasës midis të folmeve anësore të shqipes, në faza të caktuara të tyre; **sidomos në ato faza ku ato paraqesin kulmin e afrisë midis njëra tjetres**.<sup>150</sup> Mendojmë se është pikërisht ky momenti më i përshtatshëm i studimit. Kjo metodë studimi, nga njëra anë na ndihmon të depërtojmë në prehistori, nga ana tjetër, duke i studiuar ato nga gjendja e dokumentuar dhe sot, arrijme të kuptojmë ndryshimet gjuhësore në sistemet përkatëse të këtyre të folmeve, sipas kontakteve me gjuhë a të folme të tjera, me të cilat ato kanë bashkëjetuar në shekuj. Vetëm në këtë mënyrë ne arrijmë të bëjmë një studim mirëfilli diakronik.

Sikurse e vërtetuar në disa raste, faza më e përshtatshme për t'i studiuar këto bashkëpërkime është për qasja midis gjendjes më të hershme të dokumentuar të tyre dhe dokumenteve të shqipes së hershme. Një punim për qasës në këtë këndvështrim, mendojmë ta trajtojmë në të ardhmen, duke mos lënë mënjandë edhe studimin e këtyre të folmeve në gjendjen statike të tyre, pra një vështrim të shkurtër edhe sinkronik të të folmeve në kuadrin e për qasjes me njëra tjetrën. Vështrimi sinkronik i tyre është gjithmonë në shërbim të këndvështrimit diakronik, pasi siç e dimë përmes tij fiksohen edhe faza të caktuara të një të folmeje.

Gjithmonë kemi qenë për një gjuhë standarde, madje, në kuadrin e kontakteve të shqipes së sotme jemi për një politikë ripërtëritëse të herëpashërshme të saj, e domosdoshme kjo për situatën në të cilën gjuha jonë ndodhet, por dialektet a të folmet duhen ruajtur edhe për hir të respektit që duhet të kemi për gjuhën e lindur të një kombi. Në këtë drejtim, rëndësia e të folmeve anësore sot, është më e madhe se kurrë.

<sup>150</sup> Pak a shumë të njëjtën metodë që prof. Likaj këshillon rreth studimit të bashkëpërkimeve midis gjuhëve indoevropiane, në librin e tij "Zhvillimi i eptimit në gjuhën shqipe", ShBLU, Tiranë 2003

## 2.1.2. Disa tipare interesante të foljeve të zgjedhimit në –mi

Sikurse e pamë edhe më lart sistemi foljor i çamërishtes është një ndër sistemet më të ndërlikuara, me larmishmëri trajtash, formash dhe dukurish. Me anë të një teme tjetër, po përpiqemi të tregojmë edhe një herë rëndësinë e së folmes çame për gramatikën historike dhe për historinë e gjuhës shqipe në tërësi, kësaj radhe përmes studimit të të ashtuquajturave të foljeve të zgjedhimit në –mi.

Ngjashmëritë midis dukurive çame dhe dukurive gjuhësore të fazave të kapercyera të gjuhës sonë, tek foljet e këtij zgjedhimi janë edhe më të spikatura. Larmi përqaqjesh vërehen edhe me të folmet e autorëve të vjetër shqiptarë, të cilët siç e theksuam edhe më lart, na kanë lejuar të arrijmë në përfundime konkrete lidhur me këtë të folme, por edhe në përfundime të përgjithshme rreth ndryshimit diakronik të së folmes.

Tek kjo nënçështje jemi përqendruar tek disa dukuri specifike të foljeve ndihmëse sipas kohëve dhe zgjedhimeve përkatëse, duke ndjekur pak a shumë të njëjtën mënyrë studimi siç vepruam më lart (me sistemin foljor në tërësi), pra duke u nisur nga njohja e përgjithshme e formave të hershme foljore të shqipes, në përqaqje me format më të hershme foljore të çamërishtes.

Sipas gramatikës historike nga e cila kemi shfrytëzuar edhe për këtë temë të dhëna me rëndësi, foljet e zgjedhimit në –mi kanë ndikuar shumë tek njëra-tjetra.<sup>151</sup> Kjo mënyrë studimi mendojmë se sjell prurje të reja të cilat mëshojne edhe një herë mbi rëndësinë dhe vlerat e të folmeve anësore të gjuhës sonë.

Fillimisht, me qëllim që të orientohet edhe lexuesi po parashtrijmë format e dokumentuara të foljeve të zgjedhimit në –mi, sipas gramatikës historike.

Mënyra dëftore ,- koha e tashme

Format e dokumentuara të shqipes së hershme<sup>152</sup>

Tema/mbaresa	Tema/mbaresa	Formantet indoevropiane	Tema/mbaresa	Formantet indoevropiane
Ka- m	Ja- m	-mi	Tho/the- m	-mi
Ke	Je	-si	Thua	-si
Ka	Ash-të/ është	-ti	Tho- të	-ti
Ke-mi	Je-mi	-mes/-mus	Tho/the- mi	-mes/-mus
Ke-ni	Je-ni	-ta/ -te	Tho-ni	-tha ( ka rënë)
Ka-në	Ja-në	-nti	Tho-në	-në

Po rendisim në përqaqje me këto të dhëna, disa shembuj interesantë në sistemin foljor të këtij zgjedhimi:

Për foljen *kam* nuk vihet re ndonjë dukuri e veçantë. Format foljore të kësaj foljeje përkrijnë si me format e dokumentuara ashtu edhe me format e sotme foljore të shqipes, p.sh: *Ej i tha djali / ç' shikon i tha/ kam treqind vjet q' e kam hedhur purtekën e dufeqin e tani pres t' e bije.*

Për foljen *them*, mund të themi se në të folmen e çamërishtes gjallon forma e hershme *thom* e ngjashme me fazat e kapercyera të shqipes: P. sh: *në saba grihet u*

<sup>151</sup> Edhe për këtë temë përveç të dhënave të lartpërmendura, kemi shfrytëzuar disa të dhëna të tjera prej studimeve të autorëve më të hershëm të kësaj të folmeje; të dhëna nga e folmja çame të vjela në terrenin shqiptar në vitet 1978. Gjithashtu, kemi vënë re edhe ndryshime në kohë duke parë edhe të folmen e çamëve të sotëm.

<sup>152</sup> Likaj, E. *Zhvillimi i Eptimit në Gjuhën Shqipe*, ShBLU, Tiranë, 2003

*thotë* babajt e nanës/ kam parë një nëndër/ u tha / thuejna/ i thanë ata / nuk ua **thom**//  
i **thomi** katua budrumit neve...; ...sebeq **thomi** neve/ u bu një kristian/ seee kish edhe  
çam kristian atje; mor ame( epimë, ma jep) i tha djali/ se kam babanë sëmure

Koha e pakryer

Tema/ mbaresa JAM	Formanti indoev.	Tema/ mbaresa KAM	Formanti indoev.	Tema/ mbaresa THOM	Formanti indoev.
Jesh-ë	-m	Kesh-ë	-a (-m)	Thosh-ë	-a (-m)
Jesh-e	-s	Kesh-e	-s	Thosh-e	-s
Ish	-t	Kish	-t	Thosh	-t
Jesh-ë-më	-mes/mos	Kesh-ë-më	-me/-mo	Thosh-ë-më	-me/-mo
Jesh-ë-të	-ta	Kesh-ë-të	-ta	Thosh-ë-të	-ta
Ish-në	-nt	Kish-në	-nt	Thosh-ë-në	-nt

Format e dokumentuara të shqipes së hershme<sup>153</sup>

Në këtë të folme na tërheq vëmendjen ngjashmëria midis dy formave; të së tashmes dhe të së pakryerës së vetës së tretë të foljes *jam*: **isht dhe ish**. Për efekt studimi po rendisim edhe njëherë shembujt e trajtuar më lart: *ú do te dergoj di kobeza mollë / po i njohe çila isht e vjema / çila e sivjema/ nuk do hapim luftë .. ú do te dergoj di pela/ po i njohe çila isht nana çila ishtë bila nuk kemi luftë / drishe do nis luftë; ku isht/ i tha ai / merre selle kutu; ç'ishtë ajo i tha Veizi/ ishtë gugusha e bukrës dheut.*

Prania e trajtës *isht* në të tashmen, në këtë të folme mund të argumentohet në dy mënyra, ndër të cilat e para është më e pranueshme. Në të tashmen trajta *isht* ka të bëjë me trajtën e shqipes së përgjithshme *është*, tek e cila ka ndodhur dukuria shndërrimit të zanores *ë* në *i*, sikurse ka ndodhur tek folja *běj/ bi(j)*. Por, nga ana tjetër, ekziston edhe mundësia e një analogjie me të pakryerën e vetës së tretë *ish*, siç thotë edhe profesor E. Likaj, ndryshimet në sistemin foljor kanë pasur arsye fonetike, morfologjike, ose analogjike.

- Meqenëse jemi tek e pakryera format ekzistuese ende të çamërishtes *jesh*/*jesh* janë edhe argument i fortë i disa shpjegimeve gjuhësore historike siç është ai i shpjegimit të ndërrimit të temave *ja/je*, tek foljet e këtij zgjedhimi, gjoja përmes metafonisë.

- Në kohën e pakryer të së folmes së çamërishtes ndërmjet mbaresave të hershme të vetës së parë dhe të dytë të shumësit dhe temës përkatëse, kemi tingullin mbështetës *-i* në vënd të tingullit mbështetës *-ë*. Pra tek çamët kemi: *thoshi, thoshe, thosh, thoshimë, thoshitë, thoshinë*. Kjo është një dukuri e cila vihet re vetëm tek folja *thom/them*, por jo tek foljet e tjera. Tek foljet *kam* dhe *jam* në vetën e parë dhe të dytë shumë të vërtetë mospraninë e *-ë-së* mbështetëse, përkatësisht: *keshmë, jeshmë/ keshhtë, jeshhtë*.

- Pra, format foljore *kam* dhe *jam* të vetës së tretë shumë, në çamërishten e dokumentuar, por edhe në atë të sotme nuk përkojnë me ato të formave të dokumentuara. Foljet *kam* dhe *jam* në vetën e tretë shumë në të folmen e çamërishtes shfaqen në format *jeshën, keshën/ jeshnë, keshnë*. Po japim disa shembuj për ilustrim: *atje nek e vuri ne hops ( burg) përsiprazej ish vajza e bretit / I jati nuk e kish parë çish kish vënë poshtë;.. edhe qi u murzit se nuk i njeh dot çila ish e vjema e çila e sivjema;hë këtu e hë atje / kudo që i thoshin thuaje / nuk e thosh / se nuk i thosh njeri*

<sup>153</sup> Likaj, E. *Zhvillimi i Eptimit në Gjuhën Shqipe*, ShBLU, Tiranë, 2003

*hajr; na ish e diç na ish/ na ish një bret / na kish tre djelm/ kish edhe një kalë / ja thoshin Durdul etj.*

Sikurse e kemi përmendur shpesh në punimet tona për çamërishten megjithë forcën ruajtëse të kësaj të folmeje, e nxitur shpesh nga faktorë të jashtëm karakteristikë të të folmeve anësore të shqipes, risitë në të janë të pashmangshme, pasi s’do të mund të flisnim dot më pas, as për ndryshime të sistemeve tek të folmet. Për rrjedhojë, me gjithë forcën ruajtëse të saj, sidomos tek foljet e zgjedhimit në –mi, ne vërejmë praninë e risive që vijnë si shkak i orientimit kah shqipes së përgjithshme. Ja një shembull: *na ish një plakë dhe një plak/ na kishin ( në vend të kishnë) një djalë pesmet vjeç.*

#### Koha e kryer e thjeshtë

Tema/mbaresa JAM	Formant i indoev.	Tema/mbaresa KAM	Formanti indoev.	Tema/mbaresa THOM	Formanti indoev.
Kle-sh-ë	-ā	Paç-ë	-ā	Tha-sh-ë	-ā
Kle	-s	Pat-e	-s	Tha-e	-s
Kle	-t	Pat	-t	Tha	-t
kle- më	-me/mo	Pat- më	-me/-mo	Tha- më	-me/- mo
kle- të	-ta	Pat- të	-ta	Tha-të	-ta
Kle- në	-nt	Pat -në	-nt	Tha-në	-nt

Format e dokumentuara të shqipes së hershme<sup>154</sup>

Tek format e numrit shumëz gjejmë një bashkëpërkim midis çamërishtes dhe formave të hershme të dokumentuara. Kemi një përputhje edhe midis njëjësit, por në folës të moshave krejt të thyera vërehen edhe trajtat *kleva, kleve, kle, pava, pave, pat* ( e njëjta trajtë ekziston edhe për foljen shoh). Për njëjësin vërejmë ndonjëherë gjithashtu të pranishme edhe dukurinë e asimilimit të grupit bashkëtingëllor *kl* në *q*: *qeva, qeve*. Ndërsa, vetës së parë të foljes *thom* i përgjigjet forma foljore *thashë> thaçë* dhe vetës së dytë forma *the*. Shembuj: *ja shih more arap, i thotë e bila hoxhës/ foli edhe ti e hamallos edhe ti/ se mos qesh edhe ai/ se po kle zoti inë/ ka një dhëmb të florimtë në golë..; Në saba grihet u thotë babajt e nanës / kam parë një nëndër u tha / thuejna i thanë ata/ nuk ua thom.....Kam parë një nëndër...*

Në çamërishte janë ruajtur trajtat e hershme të aoristit sigmatik, por në këtë të folme *sh-ja* e aoristit sigmatik në bashkëveprim me temën ka dhënë ç. Kjo është ndër dukuritë më të spikatura të çamërishtes, të cilën e gjejmë jo vetëm tek foljet e këtij zgjedhimi por, në të gjitha ato folje ( dhe jo vetëm ) që në praninë e tyre kanë aoristin sigmatik: *kam parë një nëndër e nuk ja thaçë gjithëve / nuk ua the/ mua do t’ma thesh/ po edhe breti nuk i tha hajr etj.*

Meqë mënyra lidhore nuk ka shumë ndryshim nga dëftorja, e shqyrtojmë atë përmes përqasjes së formave foljore të tyre. Kjo është një mënyrë e cila nuk paraqet ndonjë ndryshim të madh edhe nga format e hershme të dokumentuara të shqipes, përkatësisht:

të je- m, të je- sh, të je- të/ të je- mi, të i- ni, të je- në;  
të ke- m, të ke- sh, të ke- të/ të ke- mi, të ki-ni, të ke-në;  
të tho- m, të thuo- sh, të tho- të/ të tho-mi, tho- ni, të tho-në.

Në çamërishten e sotme vërejmë se foljet e zgjedhimit në –mi në të tashmen e lidhore në përgjithësi dalin me temë në –e : *je, ke, the*. Kjo përlligjet edhe për vetën e

<sup>154</sup> Likaj, E. *Zhvillimi i Eptimit në Gjuhën Shqipe*, ShBLU, Tiranë, 2003

dytë shumë të foljeve *jam/ kam*, të cilat në format e hershme të dokumentuara të shqipes e gjejmë në trajtën **të ini, të kini** si dhe për të gjitha vetat e foljes *them*, përveç vetës së parë shumë (*thom*), për të cilën në formantin e hershëm do të gjejmë trajtat, *të thuo- sh, të tho- të/ të tho-mi, tho- ni, të tho-në*. Pra në vënd të trajtave *të ini, të kini* në çamërishte do të gjejmë trajtat e shqipes së përgjithshme: *të jeni, të keni*.

Nga të dhënat tona, shohim se mbaresa *-sh* e vetës së dytë e foljes *them*, në më të shumtën e rasteve është shndërruar në *-ç*. Për foljet *jam* dhe *kam* për vetën e dytë kemi: *të jesh/jeç, të kesh/keç* dhe mendojmë se për analogji me këto forma shfaqet edhe trajta *të thesh> të theç*. *Do ma theç se do të vë në hops/ le të më vesh/ nuk ta thom/ e mori e vuri në hopsane..// Të veç t'i theç babait/ po mos ja thuaj që të thaç u...*

Pra siç e shohim, analogjia është një dukuri e cila vihet re shpesh në të folmen e çamërishtes.

Së fundmi themi se, përveç dukurive të trajtuara jo pak të rëndësishme janë edhe ato dukuri të cilat janë të ngjashme me ato të të folmeve të tjera të toskërishtes, si dhe me trajta dhe forma të shqipes së përgjithshme. Por, sikurse e pamë, shumë prej tyre kanë evoluar, siç ishte rasti i evoluimit të këtyre foljeve në të tashmen e dëftores dhe në të tashmen e lidhores: të )ini, (të) kini. Evoluimi i një të folmeje ndër të tjera është i pashmangshëm, siç ilustron edhe përmes shembullit që prof. E. Likaj sjell nga gjuha e autorëve më të vjetër: “ *trajta më e vjetër e së kryerës së thjeshtë kle- e foljes jam, del tek Buzuku, te Bogdani del trajta tjetër e evoluar kje- , por evolucioni i mëtejshëm kje- në qe- del qysh te Budi.*”

Nga e gjithë kjo çfarë shqyrtoam për foljet e këtij zgjedhimi, përforcojmë edhe një herë mendimin tonë, se puna më e mirë është të bëhet një studim përqasës midis trajtave më të hershme dhe atyre më të reja të të folmeve të hershme të shqipes. Për këtë arsye, gjithmonë jemi të mendimit se në studimin e hershëm duhet përcaktuar faza e duhur që në rastin tonë ka të bëjë me fazën kur ato shfaqin kulmin e bashkëpërkimeve midis tyre.

## **2.2. Bashkëpërkime të elementeve gjuhësore të veprave më të hershme shqipe me çamërishten e sotme.**

### **2.2.1. Dukuri të përbashkëta midis çamërishtes dhe “Mesharit” të Gjon Buzukut.**

Siç e pamë gjatë shqyrtimit të dukurive në sistemin foljor të çamërishtes, në brezin e vjetër çam gjallojnë sot elemente të shqipes antike. Një gjë e tillë sot është e vërtetueshme përmes përqasjes midis të folmes së çamërishtes dhe të folmes së autorëve më të vjetër shqiptarë. Duke mos dashur të zgjatemi, nuk po lëvrojmë gjuhën



e secilit prej tyre, por jemi thelluar në formën e një përfaqseje me gjuhën e dokumentit të parë të plotë të shqipes së shkruar, “Mesharit” të Gjon Buzukut.

Edhe për trajtimin e një teme të tillë, shfrytëzuar të dhënat nga hulumtimet e kryera në terren, gjithmonë duke u mbështetur në çamërishten në breza.<sup>155</sup> Pavarsisht këndvështrimit tonë sociolinguistik<sup>156</sup> dhe jo krejt të shkëputur nga përfundimet e nxjerra deritanimë, po mundohemi të argumentojmë, atë çka vetëm e kemi pohuar ose argumentuar përciptazi deri tani në lidhje me këto dy të folme:

1. Rreth pikëtakimeve të elementeve antike të çamërishtes së sotme me ato të veprave më të hershme (*Meshari* i Gjon Buzukut (1555));

2. Të kuptojmë rëndësinë e pohuar shpesh prej nesh, për të folmen e çamërishtes në fushë të studimeve gjuhësore.

3. Të tregojmë nevojën që ajo shfaq për t’u studiuar për sa kohë që këto elemente të rëndësishme gjallojnë ende ndër çamë në ditët tona.

Ajo që gjithmonë na ka tërhequr tek e folmja çame, është ajo çfarë vë re qoftë edhe një dëgjues i rëndomtë, përkatësisht dukuritë e veçanta, ato të cilat “**ngjajnë ndryshe**” nga dialektet e tjera të bashkësive pritëse me të cilët ato kanë qenë në kontakt. Këto dukuri janë pjesë e të folmes së origjinës, të cilat janë bërë më vonë dhe pikënisja e të gjitha studimeve tona për çamërishten dhe në veçanti për këtë punim.

Përpara se të rendisim shembujt përkatës, dëshmuar të bashkëpërkimeve midis të folmes së Buzukut dhe asaj të çamërishtes, po citojmë më parë disa të dhëna me vlerë për veprën e Buzukut të cilat vlejshëm shumë edhe për çamërishten<sup>157</sup>, duke dashur të zemë atë hapësirë boshe që çamërishtes i takon në lëvrimin e temave të tilla. Studiuar të hershëm si edhe ato të kohës së sotme, pohojnë bindshëm rëndësinë e veprës së Buzukut, por bashkë me të ato sjellin tërthorazi edhe vlerën e të folmeve të veçanta<sup>158</sup> të shqipes.

Studiuesi **Shaban Demiraj** shprehet se, *gjuha e Buzukut është përfaqësuese e një faze relativisht të vjetër të evolucionit të shqipes, kur ndryshimet midis dialekteve të kësaj gjuhe ishin më të pakta se në gjendjen e sotme.... . libri i Buzukut paraqet një interes të madh edhe për dokumentimin e hershëm të një vargu risish të rëndësishme të gjuhës sonë ( siç është rasti i përdorimit të mënyrës lidhore në ndërtime, ku në gjuhët e pajisura me paskajore përdoret rregullisht kjo formë, ose përdorimi i formave të habitores, a të ashtuquajturës lidhore- habitore..... . “Natyrisht vepra e tij paraqet një rëndësi edhe më të madhe për dokumentimin e disa trajtave arkaike si edhe të fjalëve dhe shprehjeve të vjetra të gjuhës sonë.”<sup>159</sup>*

Sudiuesi **Emil Lafe** ndër të tjera thotë: “ një vlerë tjetër e madhe e autorëve të vjetër, përveç synimit (fort të vështirë) “ en së dashunit së botës së sanë” dhe “me zditurë pak mendetë” e popullit të vet “ ndë Arbant”; është se ata na dëshmojnë me

<sup>155</sup> Ndarja në breza është bërë sipas idesë së Prof. Dr. Gjovalin Shkurtaj, ide kjo e praktikuar nga shumë studentë si dhe asistentë apo lektorë të cilët kanë vijuar kërkime shkencore në fushën e dialektologjisë dhe sociolinguistikës. Puna për studimin e të folmes së çamërishtes nis me këshillimin si temë e një detyre të thjeshtë kursi në dialektologji, njëkohësisht me qëllimin e mirë të një studimi më të thelluar në të ardhmen. Nxitja e parë e këtij profesori që më se e mjaftueshme për të vazhduar më tej, duke e zhvilluar atë si temë diplome dhe më pas si temë masteri në gjuhësi.

<sup>156</sup> Troplini, E. *Disa tipare ruajtëse të çamërishtes*, në Aktet e Seminarit II Ndërkombëtar të Albanologjisë, Shtator, Tetovë, 2008.

<sup>157</sup> Universiteti i Ejl, *Buzuku dhe shkrimet e hershme shqipe*, Sesioni Shkencor Ndërkombëtar për Gjuhën dhe Letërsinë Shqiptare, Tetovë 2006.

<sup>158</sup> Term i huazuar nga prof. Kolec Topalli.

<sup>159</sup> Shih: Demiraj, Sh: *Dokumentimi i disa risive gramatikore të shqipes te Gjon Buzuku*, në, “Buzuku dhe shkrimet e hershme shqipe”, Sesioni Shkencor Ndërkombëtar për Gjuhën dhe Letërsinë shqiptare, Universiteti i Ejl, Tetovë 2006.

veprat e tyre një fazë të gjuhës sonë kur dy kryedialektet e saj ishin më afër me njëri-tjetrin dhe vetë gegërishtja ishte më e njësishtme.<sup>160</sup>

Studiuesi **Kolec Topalli** thotë se ky monument i lashtë mbetet i vetmi burim prej të cilit mund të mësohen tiparet e shqipes në gjysmën e shekullit XVI. Por dihet, se gjuha e një populli ekziston përmes dialekteve dhe të folmeve të veçanta... Studimet duhet t'i nënshtrohen një krahasimi shumë palësh me botime të tjera të hershme të shqipes dhe me të dhënat e dialekteve të sotme.<sup>161</sup>

Studiuesi **Seit Mansaku**: “Të gjitha strukturat gjuhësore të një periudhe të caktuar ose të një teksti të caktuar, janë rezultat i zhvillimeve gjuhësore të periudhave të mëparshme”<sup>162</sup>.

Studiuesi **Zeqirja Neziri**: “Kjo është një indicie që na nxit të mendojmë se ky libër është shprehje e dijes origjinale, pra përzgjedhje e vetë Buzukut, pra është përpjekja e parë për hartimin e librave mësimorë në gjuhën shqipe.”<sup>163</sup>

Përgjithësisht, të gjitha citimet e mësipërme, të çojnë në një pikë të vetme, tek **afria midis dy kryedialekteve të shqipes; përpjekja për shkrimin e parë shqip; tradita e shqipes parabuzukiane; tiparet e shqipes në gjysmën e shekullit XVI etj.** Siç e thamë edhe më lart tek të gjitha këto citime ne shohim edhe çamërishten, pasi në këtë të folme e shohim të përafërt me gjuhën e Buzukut. Krahasimi i të folmes së çamërishtes me gjuhën e Buzukut, verifikimi i këtyre ngjashmërive sot në të folmen e gjallë të çamëve të vjetër, janë një përgjigje e mirë edhe e çështjeve të lartpërmendura.

Ndër autorët që e kanë studiuar të folmen e Buzukut, kemi preferuar të mbështetemi në veprën e studiuesit Selman Riza, “Pesë autorët më të vjetër të gjuhësisë shqiptare, -Krestomati thjesht gjuhësore” “Gjon Buzuku” (1555).

Nga ky krahasim vërejmë:

1. Ruajtjen e zanoreve të gjata.

a. Në të folmen e çamërishtes ruhen ende zanoret e gjata:

....ka shtatëmbëdhjetë e rëpjete i mblodhi eksorī, ... edhe Habibi pësaj se dëroi, u ngrē/ e bëri bolorī ...sī të(sytë) mbëluar deri këtu( tregon me gjeste)/vajzat ; joo...mīr u kish sēllē/ me greg u kish sēllē mīrē; kemi shkuar njëmīlē halle rruguve; mbēmē që nātānē llogarait// rāmē në një fshat; .....qē të na zāpojnë vēnin...; ...edhe kalamajt në lum i hīdhën moj të keqen...; ); .. ikēm vāmē në Ninat.../ qem të zōt'e vetes vetë neve; ..ja / vāte një moshatarja ime //164;

b. Tek “ Meshari” i Gjon Buzukut vërejmë të njëjtën gjë;

a: *Chaa meh chleneh* 188/31; *baasi* 4b28; *teh paah lih tatti tpaemenit* 29b42 etj;

e: *aih teh formonee* 12b45; *Galileesse* 11a29; *teh desmuometeh e reesimeh* 74a38

i: *geučūite* 90b41; *stepūineh* 172a35; *fuħii* 25a42; *eəaiiah* 74a7; *hiir plota* 1a1 etj<sup>165</sup>.

<sup>160</sup> Shih: Lafe, E: *Rëndësia e autorëve të vjetër për shqipen e sotme*, po aty, f.28

<sup>161</sup> Shih: Topalli, K: *Veçori të shqipes së shek. XVI përmes “ Mesharit” të Buzukut*, po aty, f.42

<sup>162</sup> Shih: Mansaku, S. *Veçori morfosintaksore të shqipes mesjetare në “Mesharin e Gjon Buzukut”* po aty, f.76

<sup>163</sup> Shih: Neziri, Z. *Libri i parë shqip dhe bashkëkohësia*, po aty, f.128

<sup>164</sup> Shembujt nga çamërishtja janë përdorur edhe në punimin me titull, “Disa ruajtje karakteristike të së folmes së çamërishtes”, Universi (nr. 11), Tiranë 2009, në këndvështrimin dialektologjik të kësaj të folmeje. Disa prej tyre janë përmendur edhe në punimin me titull: “Hulumtime sociolinguistike në disa mjedise çame të rrethit të Durrësit” në, “Aktet” e Seminarit II Ndërkombëtar të Albanologjisë, UShT, Maqedoni 2008, në këndvështrimin sociolinguistik të saj.

Dukurinë e ruajtjes së zanoreve të gjata e gjejmë edhe në ato të folme që paraqesin afri me çamërishten, siç janë, disa zona të izoluara të toskërishtes, labërishtes, gjuha e arbëreshëve etj. Arbëreshët e Italisë edhe sot e kësaj dite ruajnë në repertorin e tyre fjalë me zanore të dyfishuara (det- *deet*)<sup>166</sup>

2. Shkronjat që përdor Buzuku në shkrimet e tij janë përgjithësisht: shkronja latine si edhe shkronja jolatine. Disa prej tyre kanë dy ose tri vlera fonetike. Kështu p. sh shkronja **u** përdoret me vlerën fonetike të shkronjave **y, u, v**<sup>167</sup>; nga ana tjetër, në sistemin fonetik të së folmes së çamërishtes në brezin e vjetër çam vërejmë në repertorin e tyre mungesën e zanores **y**.<sup>168</sup> Për të shënuar këtë zanore përdoren zanoret **i, u**, p. sh: *sutë emii* 4b4l ( të cilën e gjejmë edhe në trajtën e një zanoreje, përkatësisht suute emii), - Buzuku; *n'at qitet qi t'thash ù ti; baba im hapi duqan/ në dark e billëm duqanin...*(çamërishtja)

Tek Buzuku vërejmë edhe disa shembuj të tjerë si: *jo ata ta ç hin për gojë pëgan nierinë, por ata qish del* 74a15. Ky shembull dhe shumë të tjerë, flasin qartë për ngjashmërinë midis gjuhës së Buzukut dhe disa të folmeve të gegërishtes veriore. Ndërsa, shembujt nga çamërishtja provojnë atë fakt të shumëpërmendur tashmë nga studiuesit për, **atakimin e skajeve**<sup>169</sup>.

Pra, afria midis dy kryedialekteve vërtetohet edhe në ditët tona. Pavarësisht se ato mund të jenë larguar paksa, kjo afri e cila vihet re edhe sot e kësaj dite na çon të mendojmë se shqipja edhe sot mbetet një gjuhë arkaike; bashkë me këtë pohim thellohet edhe “misteri” i shqipes.

3. Në gjuhën e Buzukut trajta **u** është e barazvlefshme me emrin **ujë** të gegërishtes dhe **uri** të toskërishtes. Ajo zëvendëson gjithashtu edhe katër trajtat përemërore **unë, juve, atyne, vehten**. Ajo çka na intereson është trajta e përemrit vetor **unë**, të cilën edhe në çamërishte e gjejmë pa epitezën –në, pra në trajtën e shkurtuar **u**: *atah nëh janë xhudhi edhe u jam...*(Buzuku); *ù të kam si vajzat e mia tashi; ..ù kam qënë nxënës shkolle n'atë kohë* (çamërishtja e sotme). Lidhur me këtë dukuri nuk mund të lemë pa përmendur edhe atë çfarë kemi mësuar nga gramatika historike, sipas së cilës, forma e hershme **-ù** e ka prejardhjen nga një vetor “**sëe**” i indoevropianishtes. Duke shkuar më tej, këtë trajtë e gjejmë edhe tek disa të folme të tjera, si p.sh tek të folmet arbëreshe, disa të folme të anëve të Tiranës, në disa dialekte ekstreme të Veriut, apo të Malësisë së madhe<sup>170</sup>.

4. Në çamërishten e sotme ruhet ende **l-** ja e vjetër ndërzanore sikurse tek Buzuku. Kështu na tërheqin vëmendjen fjalë të tilla si: **fëmilë** (fëmijë), **bilë** (bijë), **kuel** (kuaj), **rrumulë** (rrëmuje), **milë** (mijë), **palë** (pajë), **valë** (vajë), **golë** (gojë) etj. Tek arbëreshët e Italisë, spikasin në përdorim edhe sot e kësaj dite fjalë të tilla si: **valë** (vaj), **palë** (pajë)<sup>171</sup> etj.

<sup>165</sup> Riza. S. “Gjon Buzuku (1555)”, Pesë autorët më të vjetër të gjuhësisë shqiptare, *Krestomati thjesht gjuhësore*, f.378.

<sup>166</sup> Shih në disertacion temën “Bashkëpërkime midis çamërishtes dhe të folmes së arbëreshëve”.

<sup>167</sup> Në rastet kur dyvlefshmëria fonetike e shkronjës latine do të vështirësonte leximin e drejtë, Buzuku në vend të saj ka përdorur edhe shkronjën sllave *š* p.sh: *chšchaa chuu meh voteh* ( ku ka ky me votëh) 89b15

<sup>168</sup> Nuk duhet të harrojmë se, në këtë të folme elementet ruajtëse mbizotërojnë ( “E folmja e çamërishtes në quadrin e mardhënieve gjuhë- dialekt”, temë e trajtuar në, Seminarin Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, Kosovë 2009), por për shkak të kontekstit specifik të evoluimit të kësaj të folmeje nuk mungojnë edhe rastet e dysorësisë në të folur ku shpeshherë kemi vëne re edhe shfaqjen e zanores –y në repertorin e folësve.

<sup>169</sup> Ky është një argument mjaft i rëndësishëm të cilin mendojmë ta trajtojmë gjatë në të ardhmen.

<sup>170</sup> Gjinari. J & Shkurtaç. Gj: *Dialektologjia*, Shtëpia Botuese e Librit Universitar, Tiranë, 1997.

5. Në çamërishte vihen re ende disa përdorime, në të cilat mungon **j**-ja antihiatizuese, p. sh: tek disa fjalë me theks fundor, si: *shtëpi-shtëpia*, *qevërriqevërria*, *Çamëri- Çamëria*, *Parmëthi- Parmëthia*<sup>172</sup> etj; tek shquarsia e disa emrave të përveçëm si: *Hasimea*, *Gjulea*, *Fatimea* etj; parapëlqejmë të trajtojmë si shembull edhe dukurinë e rënies të nyjës së prapme të emrave femërorë të së pashquarës, kur ato shquhen, si: *nuse- nusa*, *dele- dela*, *lule- lula*, *maçe- maça* etj. Buzuku **e**- në enklitike me **o**-në e foljes në urdhërore e bashkon edhe pa bashkëtingëlloren antihiatizuese **j**: *huchoe*.

6. Një tjetër dukuri tipike në sistemin bashkëtingëllor të fonemave të çamërishtes të cilën e gjejmë edhe tek gjuha e Buzukut, është edhe ruajtja e togjeve bashkëtingëllore **kl**, **gl** kryesisht në fjalë të tilla si: *kle- qe* ( ishte), *kleçë- qeshë*, *glisht- gisht*, *klumusht ( qumësht)*, *i glatë( i gjatë)*, *kliçe* (kyçe), *glëmbi (gjëmbi)*, *i shklier* (i shqyer), *i shklarë* (i shqarë- i shkarë), *klishtë ( qishë-kishë)* etj. Përkatësisht tek “Buzuku” i Selman Rizës do të gjejmë fjalë të tilla si: *i glatë*, *endiglo*, *gluhë*, *clissë*, *klai/ klanjinë*, *glunjë (me zdtunë mendetë e atyne qi të ndiglonjinë)*. Edhe ruajtja e këtyre togjeve vihet re tek arbëreshët e Italisë. Ai që e ka konfirmuar këtë ka qenë Solano më 1979. Tek tri bashkësitë arbëreshe të Siçilisë, pesë bashkësitë e Katanxarës, pesë bashkësitë arbëreshe të provincës së Potencës, ai spikat pikërisht ruajtjen e togjeve të vjetra bashkëtingëllore **kl**, **gl**, **pl**, **bl**, **fl**.

7. Mendojmë se thellimi rreth pohimit të mësipërm për “skajet atakuese” është i domosdoshëm në të ardhmen, pasi edhe numri i dukurive të njëjta nuk është i pakët midis disa të folmeve të toskërishtes dhe të folmeve të gegërishtes. Kështu shndërrimin e grupeve bashkëtingëllore **gjt**, **qt** në **jt** të cilat Selman Riza i quan karakteristike për gegërishten veriore i njeh edhe Buzuku<sup>173</sup>. Nga të dhënat tona empirike të viteve 1999 kemi vënë re pikërisht këtë dukuri nga një përfaqësuese e brezit të vjetër ( më e vjetra në moshë, - N. Habibi, palzh/ Durrës). Dukeqenëse e kemi hasur si dukuri vetëm tek një folës i vetëm, nuk e kemi trajtuar atë më parë në punimet tona. Kështu në ligjërimin e saj vërejmë fjalë të tilla si: *mijtë* ( miqtë), *fijtë* ( fiqtë), *plejtë* ( pleqt), *zojt* (*kufi/ kufi me turqi e këto saa kur ishën atje këndojën edhe zojt ( zogjtë) e turkut*) etj. Po tek e njëjta folëse kemi vërejtur edhe përdorimi i bashkëtingëllores **j** në vënd të bashkëtingëllores **gj** (*jermani na vinej.../ çu thonë ... / me tankse // i binte me tope.... etj*). Kjo e fundit mendojmë se ka lidhje me grupin bashkëtingëllor **gjt**, dhe është një inovacion që ka ardhur për analogji të shndërrimeve më të hershme *gjt > jt* që kanë ekzistuar në këtë të folme.

8. Sipas Selman Rizës, kur shumësi i një emri mbaron në bashkëtingëllore, atëherë mbaresa e dhanores shumësh tek Buzuku është **-e**; anasjelltas, kur shumësi i një emri mbaron në zanore, atëherë mbaresa e dhanores shumësh është **-ve**. P.sh: *gjaku i qevet e i sjepet, t parëvet priftënet përpara nierëzet e përpara gravet*. Në këtë shembull përveç mbaresave **e/ ve** na bën përshtypje edhe bashkëtingëllorja fundore **-t** e cila sot nuk haset më. Tek e folmja çame sot do të vërejmë disa shembuj karakteristike të cilët dëshmojnë praninë e dukurisë së mësipërme dikur në këtë të folme, por edhe evoluimin e gjuhës:<sup>174</sup> *Radhnë e parë fillova bujqsinë ù për vete time /*

<sup>171</sup> Shih trajtimin e temës “Bashkëpërkime midis çamërishtes dhe të folmes së arbëreshëve”(pjesë e studimit të pranishëm).

<sup>172</sup> Tek çamërishtja shohim se megjithëse kanë depërtuar fjalë të reja leksikore, dukuritë fonetike janë ruajtur. Shumë fjalë të reja i janë nënshtruar fondit gramatikor të së folmes së çamërishtes.

<sup>173</sup> Të dhënat dhe shembujt e trajtuar nga gjuha e Buzukut prej nesh, janë marë nga vepra me vlerë studimore e albanologut Selman Riza “Pesë autorët më të vjetër të gjuhësisë shqiptare, \_Krestomati thjesht gjuhësore”, Gjon Buzuku ( 1555)

*kisha tufn' e kafshet/ jeshëm me bagtinë tonë....*<sup>175</sup> ; *Ishën me pushkë malevet; e thertën e vartën n' fikt/ në fikt e vartin...; uleshim n'bina t'ullinjvet; ramë në katua nevet etj*<sup>176</sup>

9. Mbaresa inovuese **-imë** e Buzukut, për foljet e vetës së parë shumës, të kohës së tashme, mënyrës dëftore, diatezës veprore, gjendet edhe sot në të folmen e brezit të vjetër çam. Kështu tek Buzuku kemi: *na qi baimë* 11a4, *porsi edhe na liroimë*; ndërsa tek çamët kemi: *bimë, pënoimë, klaimë* etj.

10. Për kohën e pakryer shumës për foljet që në njëjës dalin me mbarsë 0 tek Buzuku kemi: *nvrasmë, shohmë, flitëni, shihëni, viedhënë* etj<sup>177</sup>; në çamërishten e sotme kemi: *edhe kalamajtë në lum i hidhën/ që s'do hidhën leckat*, (ë-ja fundore ka rënë); *nuku thirrëm noonjë neve...; kur prisën rrobat e dhënërrit....;*

Këto trajta në çamërishte përbëjnë risi. Trajtat e dikurshme të saj kanë qenë: **thirmë, hidhnë** të cilat shfaqen edhe sot në trajta dysore përkrah të parave (ë-ja fundore ka rënë dhe midis dy bashkëtingëlloresh është vendosur një **-ë** mbështetëse).<sup>178</sup>

11. Për sa i përket të pakryerës së foljeve që mbarojnë me zanore a bashkëtingëllore që dalin me temë në **-n** do të vërejmë: tek Buzuku: *na në banjim*103b42, *na donjim* 94b44; *e fort tue patë ata bainë maravejë* 44a33<sup>179</sup>(f 393); në të folmen çame kemi:<sup>180</sup>**Dojëm të hajëm/ e bijëm** bukën vetë/ **bijën** bukë të mira *axere.../ me ushqim që hajëm rrugës; kalojëm me lundra ; ..me hi lajëm/ na lajën nanat në darkë...// në Shqipëri aq morr ziiëm...sa... .* Krahaso: *banjim: bijëm*. Ndër të tjera, mendojmë se këto zhvillime të mbaresave foljore kanë të bëjnë me evoluimin e gjuhës në të cilën, *nj> j* dhe *i>ë*; ndërsa ndryshimet në temën e foljes *ba: bi*, mendojmë se kanë të bëjnë me një ndryshim dialektor. Gjithashtu në çamërishte gjenden edhe trajtat bilinge, *klajin, thoshjim*; tek Buzuku kemi: *-thoshnjim, -klanjinë* etj.

12. Një përputhje të dukshme midis dy të folmeve e gjejmë edhe tek të ashtuquajturat folje të zgjedhimit në **mi: kam, jam**, (thom). Krahasoni përmes këtyre shembujve foljet përkatëse:

**Buzuku:** *një gruo qi ish ardhunë* 59b36; *e shumë n xhudhisht qi klenë ardhunë* 87a9, *qi ishnë ardhunë* 94b40, *ke em bir kle ndekunë...*; *në keshe kun mbë ndonjë vend fëjyem* 188/36, *me kthyem* 6a4 etj; *...qi ù keshe lenë..* ; *i kish ardhunë hera e ti* 104a4...; *e ù në mos arkëshe e ù në mos keshë thanë atyne, të mos paskishnë kuat*171b5; Çamërishtja e sotme: **jesha, jeshë, ish/ jeshëm, jeshët, ishnë; kesha, keshe, kish/ keshëm, keshët, kishnë**; rrallë vihen re edhe format: **kleva, kleve, kle**, etj.: *Dokumentat i kish e motra/ pooo.. nuku kish vajzë në pashaportë ójo; ish më mirë ; ...e rrëmihtë ish; jeshën e vashëza të tëra...; keshën vrarë...; në dasmëra atje keshe qejf të shooje...; ku keshëm neve të vajzs/ nuku thirrëm noonjë neve ; kadife i keshëm...; me tumene jeshëm; tri-kat ditë jeshëm pa ngrënë* etj.

<sup>174</sup> Edhe kjo është një dukuri që është vënë re vetëm tek folës të veçantë, për këtë arsye në punimet tona e kemi konsideruar si bjerrje. Por, nuk mohojmë dot faktin që e gjallë paraqitet kjo dukuri edhe tek të folme të tjera të toskërishtes.

<sup>175</sup> R. Jaho, plazh, Durrës 1999

<sup>176</sup> B. Habibi Plazh, Durrës 1999

<sup>177</sup> Riza, S: "Gjon Buzuku (1555)", Pesë autorët më të vjetër të gjuhësisë shqiptare, *Krestomati thjesht gjuhësore*,f.392

<sup>178</sup> Këto ndryshime janë më se të pranueshme nëse do të kemi gjithmonë parasysh evoluimin e kësaj të folmeje.

<sup>179</sup> Riza, S: po aty, f.393

<sup>180</sup> Gjithmonë e kemi fjalën për të folmen e brezit të vjetër.

13. Mbaresat e foljeve joveprore me temë në zanore dalin me të njëjtën formë sikurse foljet me temë në bashkëtingëllore, p.sh: Buzuku: *ù nçonem 69b8, a do të pagëzonesh 34b6, ai...qi ndë muo mos skandalixonetë 38a7, porsì kthenetë torrenti5b45, a nukë shihni se gja nukë shumonemi; banemi, kthenemi, shkurtonenë* etj.: Çamërishte e sotme: *vineshin katër pesë kaurrë .. diku bënej shaka ...; martonej djali .. / kur vineshin njerzt e burrit / kur vineshin që niseshin..; rregulloneshin, shtroneshin pajtoneshin* etj.

14. Edhe në çamërishten e sotme gjenden trajtat e aoristit sigmatik, madje sikurse tek Buzuku kjo trajtë shfaqet edhe për folje të formës veprorë. Kështu tek Buzuku kemi: *u mbeç me ta 23a9; u Gjoni gjegjsh, u di kaha erdhshë87b31; ù paçë pësuo të 174a45; u gëzuoshë, u mplakshë, u rrëfyeshë, u bashë* etj. Në të folmen e çamëve të moshuar kemi: *i thaçë, ia thaçë ù, t'e thaç ù më parë, do viç me mua; do të shkruaç ti; do t'incizoç ti..; u bëç (u bëra), u mplakç, u merruaç, u lodhç, u poqç n'diell* etj.

15. Prania e foljes *gjegjem* dhe përdorimi i shpeshtë i kësaj foljeje në çamërishten e sotme na sjell të freskët ende para nesh gjuhën e vjetër të “Mesharit”

16. Sikurse studiuesi Selman Riza veçon në të folmen e Buzukut disa elemente tipike buzukjane edhe në të folmen e çamërishtes vërejmë disa elemente karakteristike tipike të çamërishtes. Të tilla janë disa përemra , disa pjesë të pandryshueshme të ligjëratës përkatësisht pasthirrma, theksi karakteristik që për vijimësi po e quajmë siç e kanë quajtur më parë studiues të tjerë, sintaktik (logjik)<sup>181</sup>, si: *shklata, çish, eni, oj, nek; jo moj/ çish i strehōjv:m?*

Studimi për të folmen e çamërishtes vjen në ndihme edhe për të sqaruar ndonjëherë mendime të pranueshme deri diku nga studiuesit. Kështu në veprën Gjon Buzuku të studiuesit Selman Riza në një kapitull më vete trajtohen “Lëkundjet grafiko- ortografike”, p.sh:

*a: Chaa meh chleneh 188/31, cha meh stuo 138/32; baasi 4b28, basi 35a12; teh paah lih tatti tpaemenit 29b42* etj;

*e: aih teh formonee 12b45, aih te formone 12b4; Galileesse 11a29, hallillesse 57b25; teh desmuometeh e reesimeh 74a38, tue baam bee resim 28b32;*

*i: gëuçiite 90b41; hëuçiite 61a1; stepiineh 172a35, iaste stepine 45a34; fuhi 25a42, fuhi 3ab; eeaiiah 74a7, icaise 87a33; hir plota 5b28, hiir plota 1a1* etj.

Duke studiuar mirë ligjërimin e të folmes së çamërishtes së sotme, e cila ka evoluar, por nuk ka ndryshuar tërësisht, duke pasur parasysh edhe mungesën e një tradite shkrimore të mëparshme, shohim se dukuria e **lëkundjeve në shënimin e gjatësisë së zanoreve dhe në shënimin e tingujve, është gjithashtu pjesë e kësaj të folmeje**. Pra, jemi plotësisht dakort me autorin kur thotë se ortografia e Buzukut në përgjithësi riprodhon besnikërisht **shqiptimin real të gjuhës shqipe në epokën përkatëse**, por, duke pasur parasysh këtë përvojë disavjeçare të studimit të ligjërimin të një të folmeje si çamërishtja, në të cilën mungon tradita shkrimore, nuk ndaj të njëjtin mendim me autorin për shpjegimin e disa dukurive si **pasqyrë e shqiptimit individual emfatik**. Emfatike paraqitet ende çamërishtja e sotme; Këtë tipar mendojmë se çamërishtja e ka trashëguar nga shqipja e hershme dhe nuk ka lidhje me shqiptimin individual të Buzukut, apo Boçarit, patër Vasilin, apo çamëve të vjetër sot. Sikurse nuk jemi plotësisht të të njëjtit mendim edhe me faktin tjetër, sipas të cilit, emrave të porsahuazuar nga latinishtja apo italishtja Buzuku ka pasur prirje t’ua ruajë gjininë e gjuhës origjinare.<sup>182</sup> Kjo mund të jetë e vërtetë për emrat e përveçëm, por për

<sup>181</sup> I pranuar konvencionalisht si term

<sup>182</sup> Riza, S.: “Gjon Buzuku (1555)”, *Pesë autorët më të vjetër të gjuhësisë shqiptare, \_Krestomati thjesht gjuhësore.f.378.*

sa i takon rastit të shqyrtuar në vepër si dhe fakteve që na vijnë sot nga çamërishtja e hershme, shohim se disa emra sikurse tek Buzuku ruajnë trajtën e veçantë në shumës, p.sh: *vineshin ushtartë e vrarë / ata gregtë na purzun ka shtëpitë.. / kÿta na mbrojn fëmiltë / që t'kalojnë fëmiltë dhe gratë // të gjithë fëmiltë atje i linda ù // ern tërë aropllantë e shkuajtën mbi fshatnë tonë etj.* Tek Buzuku përveç fjalëve të huaja *xhakontë, soldattë, kemi edhe, punëtorëtë, përintë ( prindtë), etj.*

Të gjitha përqasjet e trajtuara më lart nuk bëjnë asgjë tjetër, veçse dëshmojnë afrinë midis dy të folmeve, për rrjedhojë, afrinë midis dy dialekteve tona në fazat më të hershme parabuzukiane, por nga ana tjetër kjo është një afri e cila është trashëguar.

Së fundmi, për vlerën e madhe që ky tekst ka<sup>183</sup>, po e përfundojmë kumtesën pikërisht me njerin prej synimeve të studiuesit të madh Selman Riza siç është interesi për një shqipe të njesuar...(ai ishte për një gegërishte letrare ) e cila ..... “*të jetë përfundimi i bashkëpunimit të ndengegënishteve të ndryshme simbas kriterit: ku të jetë e mundshme, të njajtësimit dhe, ku të mos jetë, të gjegjësimit të drejtëpërdrejtshëm me toskënishten letrare*”, duke përqafuar dhe duke i qëndruar mendimit se, është detyrë e lartë të punosh për standardin dhe normën<sup>184</sup>, por duke mos lënë mënjanë mirëmbajtjen e dialekteve a të folmeve, sidomos kur ato janë bartës të vlerave të rëndësishme për shkencën gjuhësore.

### 2.2.2. Rëndësia e të folmes së çamërishtes përmes “Fjalorit të Marko Boçarit”

Vërtet studiuesit kanë pohuar se vepra e Buzukut tejkalon periudhën e dëshmive **eksplicite**, si ajo e Guilielm Adës, e vitit 1332 se, *shqiptarët kanë një gjuhë tjetër nga latinët, por në librat e tyre përdorin alfabetin latin*, e të tjera hipoteza; ndërsa në tërësinë e vet kjo vepër mbart një varg dëshmish **implicite**, fakte që shumë bindshëm dëshmojnë për një traditë shkrimi edhe më të hershme<sup>185</sup>, por, **përmes të folmes së çamërishtes studiuesit kanë shkruar edhe më tej.**

Kështu, në veprën “ Fjalori i Marko Boçarit”, studiuesi synon të pasqyrojë dhe dokumentojë me vërtetësi vlerat e panjohura të shqipes së lashtë. Përmes të folmes së origjinës ai arrin në konkluzionin se shumë fjalë të greqishtes janë të pellazgjishtes dhe shumë fjalë të shqipes së përgjithshme janë të shqipes së lashtë. Në këtë mënyrë ai i shtrin hulumtimet edhe përpara kohës së Buzukut deri në lashtësi, duke kërkuar elemente të shqipes së lashtë apo të pellazgjishtes tek greqishtja: “*vlerat gjuhësore të arvanishtes nuk nënçmohen vetëm duke e përballëvënë me latinishten, por edhe me greqishten dhe me turqishten, si dhe me gjuhë të tjera*”, - thotë autori.

Niko Stylo shpjegon se shumë fjalë të konsideruara si greke si, *perister, varka..etj*, janë fjalë të pastra arvanite. Kështu, *për er ster*, do të thotë se u hodh për

<sup>183</sup> Vlera e “Mesharit” është shumë e madhe, por duhet gjithmonë të kujtojmë dokumentimin e vonë të shqipes, si një disavantazh të madh për gjuhën tonë.

<sup>184</sup>Troplini, E.: *Si nuk duhet të shkruajmë dhe të flasim shqip. “SOS” për gjuhën tonë të bukur shqipe*, “Gjuha Shqipe”, Prishtinë, 2009.

<sup>185</sup>Gega & Nesimi: *Disa veçori morfologjike në fjalorin e Frang Bardhit* në, “Buzuku dhe shkrimet e hershme shqipe”, Sesioni Shkencor Ndërkombëtar për Gjuhën dhe Letërsinë shqiptare, Universiteti I EJJ, Tetovë 2006.

erë, duke nënkuptuar mbretëreshën e madhe të pellazgëve ose të shqiptareve, Peristerën, e cila mban një kurorë me flatrat e pëllumbit. Fjala *varka* vjen nga fjala arvanite *bark* që nënkupton lundrën me fund të harkuar me bark<sup>186</sup>, siç shkruan edhe Homeri.<sup>187</sup>

Një dokument tjetër është edhe “*Mbishkrimi i dymbëdhjetë pllakave të Gortinës*” i shkruar para vitit 500 para Krishtit. Në këtë mbishkrim janë përdorur 15 gërma simbol të cilat do t’i gjejmë edhe në mbishkrime të tjera të mëvonshme që janë shkruar me të njëjtin alfabet të Fjalorit të Marko Boçarit. I tillë është mbishkrimi i 1793 në të cilin gjejmë simbolin e kryqit për të shënuar fjalën me të njëjtin emër, tek i cili thuhet: “ më 1793 u vendos kryqi i Xhevos ( i Shën Premtes).

Një tjetër shembull është edhe mbishkrimi që sipas autorit është dokumentuar përpara dëshmisë së Metropolitit Gulielm të Barit për gjuhën shqipe, që është gjendur në një pllakë varri në vendbanimin Huvjan të qytetit Paramthia<sup>188</sup>, i cili mendohet të jetë shkruar në shekullin V pas Krishtit <sup>189</sup> konkretisht:

ve sine vla	uë sinë ula
pre si in lv cteo	pre si inj lu këteo
eis pa rentes	ais pa rëntes

unë sytë ula,  
pres, teksa hyj në rrotullimet e diellit,  
gjithnjë pa rënkuar

Interesante është edhe mënyra sesi autori interpreton mozaikun që stoliste dyshe-menë e një kisha të vogël bazilike, pranë një kështjelle në fushën e Shushicës, në juglindje të Vlorës e cila datohet në shekullin VI pas Krishtit dhe sot ndodhet në Muzeun Historik Kombëtar në Tiranë. Këtu na jepet një figurë, një person përbri figurës dhe një tekst, të cilin studiuesit e kanë marë si emrin e personit që është në figurë, që sipas autorit është i urti i madh, mbreti i tetë i pellazgëve, me emrin Beot.

Teksti i transliteruar me alfabetin latin është: ***a paq ke ash ose a paq ke atsh (aç)***. Pra, *ha pak, ke të hash*, që është edhe baza e filozofizë spartane lidhur me mënyrën e jetesës....dhe shumë pohime të tjera të ngjashme.....

Dhe së fundmi, tek “Fjalori i Marko Boçarit”, na terheq vëmendjen edhe një element sociolinguistik; aty pohohet se suljotët përdorin edhe disa forma të përbashkëta me gegërishten, siç janë trajtat, *vinj, lenj, njeri*, apo *bjej, gju, fjamë* ( në vend të toskërishtes *blej, glu, flamë*). Kjo afërsi me gjuhën e Buzukut lidhet me një të vërtetë të familjes së Boçarëve, të cilët, janë vendosur në Sul pasi u dëbuan nga Veriu<sup>190</sup>. Pra, mendojmë se Boçarët shumë elemente i kanë trashëguar nga origjina e tyre e hershme, pavarësisht integritit të pashmangshëm në bashkësinë pritëse të Sulit.

<sup>186</sup> Kujtojmë këtu argumentin për “terminologjinë e huazur detare” të shqipes nga mbrojtësit e tezës trake.....

<sup>187</sup> Stylos, N.: *Fjalori i Marko Boçarit*, Tiranë, 2007, f. 23.

<sup>188</sup> Qytet në Çamëri

<sup>189</sup> Po aty, f. 53.

<sup>190</sup> Stylos, N. *Fjalori i Marko Boçarit*, f. 40, Tiranë, 2007.



### **2.3. Shqipja, nën trysninë e konteksteve të caktuara historiko-shoqërore të të folmeve të diasporës.**

Nga dita në ditë jemi edhe më të bindur se për studimin e gjuhës shqipe luan një rol të padiskutueshëm secila prej të folmeve të saj, pavarësisht rrethanave dhe konteksteve të caktuara, mjedisit në të cilin atyre u është dashur të mbijetojnë (bashkë me rrezikun e zhdukjes), por që nga dita në ditë edhe zhvillohen, bashkë me tendencën që të bëhen njësh me standardin. Pra, për gjuhën shqipe dhe historinë e zhvillimit të saj, aty ku na vjen në ndihmë arvanitishtja, nuk mund të na vijë në ndihmë arbërishtja dhe aty ku na vjen në ndihmë çamërishtja nuk mund të na ndihmojnë të folmet e tjera krahinore.

Në studimin e një të folmeje të caktuar, në rastin tonë të çamërishtes, përkapen menjëherë ngjashmëritë që mund të ekzistojnë midis saj dhe të folmeve të tjera të shqipes. Pikërisht, kjo ka qenë edhe arsyeja pse shpesh në punimet tona të viteve të fundit kemi përmendur edhe faktin e spikatjes së dukurive të ngjashme me të folme të tjera të shqipes jugore (padiskutim), veriore , të folmeve anësore, apo të folmeve të tjera të diasporës shqiptare. Për të gjitha këto kemi mëshuar fort tek vlerat e tyre, me qëllim përkapjen e këtyre dukurive para se ato t'i nënshtrohen procesit të zhdukjes. Pa i hyrë rrugës së vëzhgimit të detajuar, sikurse kemi vepruar me të folmet e tjera të diasporës apo me të folmet e autorëve të vjetër, mjafton të dëgjojmë të folmen e Dibrës dhe menjëherë dallojmë disa dukuri fonetike të përbashkëta me çamërishten.

Nga ana tjetër, mendojme se mbyllja në vetvete e të folmeve anësore ka edhe një avantazh tjetër të madh, konservimin e pastër të shqipes së vjetër. **Forca që karakterizon të folmen e çamërishtes, të folmen arvanitase apo atë të arbëreshëve të Italisë, është nga njëra anë, -ruajtja, konservimi dhe nga ana tjetër, -zhvillimi i këtyre të folmeve nën trysninë e faktorëve gjuhësorë dhe jashtëgjuhësorë etj.** Mendoj gjithashtu se ky tipar nuk është vetëm i çamërishtes, por

i të gjitha pakicave shqiptare kudo qofshin: Të gjendura në mesin e ambienteve të ndryshme, të një kulture, gjuhe dhe mënyre jetese të ndryshme, nën trysninë e një situatë diglosie të vazhdueshme, ato janë puse të thella pafund, tek të cilat sa më shumë futesh, aq më shumë tërhiqesh prej boshllëkut që të krijojnë.

Megjithëse gjenden vazhdimisht nën trysninë e një italishteje, greqishteje, maqedonishteje etj, qoftë edhe nën trysninë e një bashkësie pritëse të një shqipeje të evoluar (siç është dhe rasti i çamërishtes); nën trysninë e konteksteve dhe rrethanave të caktuara të jashtme gjuhësore, vendimtare në ndryshimin e një të folmeje, përsëri ato mbeten padyshim në plan të parë për t'u studiuar, për nga forca ruajtëse. Nga çfarë kemi trajtuar dhe kuptuar për çamërishten, por edhe nga ajo që do të trajtojmë ende në të ardhmen, nuk është aspak e rastit që në ditët tona sot ne të hasim në këto të folme bashkëpërkime, megjithëse jeta e tyre është e ndryshme njëra nga tjetra.

Kështu p.sh. nëse marim të folmen e arbëreshëve të Italisë, megjithë traditën pesëqind vjeçare të tyre dhe situatën sociolinguistike, zhvillimin gjuhësor, letrar, kulturor që ato kanë etj, përveçse rinovues, mbeten edhe ruajtës.

Mendojmë se konservacioni është një tipar i cili kryekëput i bashkon në një emërues të përbashkët të gjitha këto të folme. Mjafton të përmendim një faktor të përbashkët jashtëgjuhësor, faktorin psikologjik të “shpërnguljes” prej dheut amë, ne kuptojmë një nga motivet e asaj mbylljeje në vetvete. Sigurisht në ruajtjen e një të folmeje ndikojnë pashmangshëm edhe faktorë të tjerë jashtëgjuhësore me rrënjë tek i pari, po aq vendimtar për këtë proces, si: dashuria për vendin e të parëve, krenaria e të qenit arbëresh, arvanitas, shqiptar, çam, motivi i shpërnguljes etj.

*“Ne emigruam. Mëmat tona na flisnin arbërisht, ndërsa në shkolla mësohej gjuha italiane..... . Më kujtohet që nëna më rrihte nëse i flisja italisht në shtëpi..... ishte dashuria për rrënjët.....ndaj u mbajt gjithçka; dashuria për gjuhën e mëmës. Vec kësaj kulti për të vdekurit, dashuria për të parët, etërit tanë, që bënë sakrifica për të përparuar ne, ndikoi mjaft në këtë ruajtje. Kultura arbërore ishte një kulturë, që ndikoi mjaft në ruajtjen e gjuhës. Ne mbajme ritin bizantin të të parëve tanë dhe nëpërmjet këtij mbajtem dashurine për kombin, gjuhen. Por Atdheu ishte dhe është mungues, pasi nuk shihej ndonje perkrashje prej tij, por ishte nostalgjik. Ne nuk patem kurre nje atdhe. Per kete arsye ne e deshiruam nje atdhe.”<sup>191</sup>*

*Edhe e folmja e çamërishtes është një pasqyrë e qartë e kësaj mendësie, madje më e rafinuar, që di ta përqafojë ndryshimin kur dhe si duhet, pa cënuar aspak atë “mbyllje” të qëllimshme në vetvete, që ndër të tjera, tregon emancipim dhe nivel të lartë kulturor. Çamët kanë qenë dhe janë ambiciozë për të bukurën dhe fanatikë të saj. Ato e përqafojnë atë lehtë dhe me elegancë, duke mënjanuar me zgjuarsia gjithçka të papëlqyeshme dhe negative që i rrethon. Ato janë krenarë ndaj origjinës së të parëve, krenarë pse janë çamë.<sup>192</sup>*

Mbështesim mendimin e prof. Altimarit, apo prof.Kostallarit dhe shumë të tjerëve kur pohojnë se, në këto të folme nuk kemi faza, nuk kemi zhvillim kah shqipes së përgjithshme siç ndodh me të gjitha të folmet dialektore të gjuhës shqipe në tërësi. Por nga ana tjetër, mendojmë se zhvillimi kah shqipes së përgjithshme nuk mungon, **por ku më shumë dhe ku më pak ai përkufizohet i ngadaltë.** Për sa i përket rrezikut të zhdukjes së këtyre të folmeve, nuk mund të mohojmë edhe sot faktin se, të folmet anësore kurdoherë kanë trashëguar dhe trashëgojnë një bazë të përbashkët që i identifikon me shqipen.

<sup>191</sup> Bellusci, A. *Ju tregoj 900 katundet Arvanitase në Greqi*, intervistuar nga Magdalena Alla, 12/02/ 2011, në [ëëë.kosovarimedia.com](http://ëëë.kosovarimedia.com)

<sup>192</sup> Shih në punim *Hyrje. Njohuri të përgjithshme për krahinën e Çamërisë.*

Po paraqesim shkurtimisht disa të dhëna nga studiuesi Viktor A.Friedman<sup>193</sup>, i cili ka bërë krahasimin e shumë fjalëve të mbledhura në fshatrat Arkadia (Greqi), Ukrainë, Mandrica (Bullgari) të popullatave që flasin gjuhën popullore shqipe, me shqipen e sotme standarde.

Arkadia	Ukraina	Mandrica	Gjuha standarde
Djelë	d'il	djellë	diell
Çili	cil'i	çili	cili
Ni	n'i	ni	një
Likurë	l'ikurën	lëkurë	lëkurë
Çupejtë	shpejt	shpejt	shpejt
Pëshkëj	pël'qen	pëlqyen	pëlqej
Pjesi	pjy	pjosë	pyesë
Minges	minues	mëngjes	mëngjes
Moi	mui	muoj	muaj
Baba	tati	tate	baba, tatë
Ljupë	l'opë	lopë	lopë
Ljutë	l'ot	lot	lot
Fortë	hortë	hortë	fortë
Krie	kry	kruve	krye
Bje	bi	bje	bie
Vshatë	vshatë	fshat	fshat
Ga	ga	nga	nga

Siç pohohet më pas edhe në këtë studim<sup>194</sup>, gjuha që flasin arvanitasit në këto fshatra, dhe gjuha letrare e sotme shqipe kanë të njëjtë rrënjët dhe kuptimësinë, pavarësisht se kanë kaluar qindra vjet që janë ndarë në pjesë të ndryshme të botës nga trangu mëmë i familjes.

Sigurisht, struktura e gjuhës preket tek këto të folme, por dukuritë karakteristike të fizionomisë së tyre gjallojnë ende sot. Pra, ato karakterizohen vërtet nga dy pole të fuqishme dhe krejtësisht të kundërt, përkatësisht ruajtja dhe risimi, por nga ana tjetër, në studimin për çamërishten dhe një vëzhgimi të detajuar të këtyre të folmeve vërehet se tërheqja e dy poleve në njëfarë mënyre sjell ekuilibër. Për këtë arsye, ato kanë qenë, janë dhe do të jenë, nese ne arrijmë të kuptojmë vlerat e tyre studimore, duke punuar pikërisht për forcimin gjithnjë e më të madh të atyre dy forcave që i kanë karakterizuar këto të folme në shekuj: ruajtja dhe zhvillimi.

Marim rastin e çamërishtes; duke u nisur nga vetë konteksti në të cilin ajo ka mbijetuar në shekuj, e mbyllur nën atë guackën e saj, e gjithmonë e motivuar nga faktorë të jashtëm gjuhësorë<sup>195</sup>, kjo e folme një ditë u gjend në një tjetër kontekst, përballë asaj shqipeje e cila gjallonte në shqipfolës autoktonë të Shqipërisë shtetërore,

<sup>193</sup> Lllalla, A. *Arvanitasit – Çamët në etnikumin shqiptar në Greqi (arvanitasit themeluesit dhe drejtuesit e greqisë moderne 1821-2005)*, kumtesë e mbajtur në Seminarin Ndërkombëtar të Albanologjisë, Tetovë-Ohër, 16-23 Shtator 2007.

<sup>194</sup> Lllalla, A. *Gjurmë të letërsisë së vjetër të shqiptarëve të Greqisë 1860- 1889*, (Tringa desidn), Tetovë, 2006

<sup>195</sup> Gjithmonë e kemi vënë theksin tek rrethanat historike, ekonomike, kulturore të zhvillimit të një vendi në përgjithësi. Për rrjedhojë, rrethana dhe kontekste të caktuara nuk duhen anashkaluar kurrë në ruajtjen dhe ndryshimin e një të folmeje, përkundrazi mendojmë se ato kanë një peshë vendimtare dhe për këtë japin shembullin më tipik siç është dhe rasti i folmes së çamërishtes.

që, megjithëse diktatoriale ishte ende një shtet me të drejta dhe ky është një privilegj i madh për gjuhën e një kombi. Çamërishtja ka qenë një e folme në kontakt të kahershëm me greqishten, nën suazën e një shteti të huaj, e, për më tepër iu desh së fundmi t'i mbijetonte edhe fatit të jabanxhiut të paqenë edhe në Shqipërinë shtetërore, si dhe gjithë asaj rrethane të vështirë që shoqëron raste të tilla. E gjithë kjo ka ndihmuar në kultivimin e së folmes, kulturës, traditave etj.

Për të provuar një gjë të tillë po radhisim më poshtë disa dukuri të përbashkëta **midis çamërishtes së sotme dhe të dhënave të mbledhura nga M. Liku:**<sup>196</sup>

- Shndërrimi i zanores –y në –i<sup>197</sup>. Tek Liku gjejmë jo vetëm dukuritë, por edhe të njëjtat fjalë si bartëse të këtyre dukurive, njëlloj me çamërishten e sotme: *dier* (dyer), *ki* (ky), *këtire* (këtyre); në çamërishte kemi edhe trajtën *këtire*, *i tire*, *i ture* (i tyre), *lier* (lyer), *drise* (ndrishe/ ndryshe); në çamërishte sot, *drishe*, *ill* (yll), *krie* (krye) etj.

Sipas të dhënave, tek Liku gjejmë edhe fjalë në të cilat gjendet zanorja y, sikurse tek disa të folme të arbëreshëve apo siç ka dëshmuar edhe studiuesi Klosi në tekstet e Reinholdit. Në çamërishten e hershme por edhe të vonë zanorja y mungon në sistemin e saj fonetik.

- Ruajtja e ë-së së patheksuar<sup>198</sup>, si: *fëmërë*, *të dëshurë*, *hédhurë*, *ishnjinë*, *të mîrënë*, *të mîrëtë*, *së mîrësë*, *të mîratë*, *kártësë*, *kártënë*, *dérésë*, *dérënë*, *diertë* etj.

Ndërsa në çamërishten e sotme ekzistojnë ende dëshmi të asaj faze të kapërcimit të shqipes, në të cilën dukuria e rotacizmit nuk ishte shfaqur ende, tek Liku nuk kemi mbeturina të mosshfaqjes së kësaj dukurie<sup>199</sup>. Gjithashtu tek Liku nuk hasim grupet *kl*, *gl*, *lk*<sup>200</sup>, të cilat gjallojnë ende ndër çamë të sotëm.

- Sikurse në çamërishten e sotme<sup>201</sup>, bashkëtingëllorja e vjetër ndërzanore *l* në veprën e Likut në disa fjalë ruhet si e tillë, d.m.th. nuk është jotizuar në j, p.sh. : *bile* (*bilë*), e cila sot shqiptohet *bijë*; *val* (328, sot *vaj*), etj<sup>202</sup>.

- Ajo çfarë na ka tërhequr vërtet vëmendjen është pjesorja *váte* ose *vátur*, të cilat gjallojnë ende në çamërishten e sotme<sup>203</sup>, trajta *thom* etj.

- Pjesoren *hédhurë*, sipas studiuses, Liku rregullisht e ka shkruar me një *h*, para tingullit *k*, pra *kheth*, *khedhëmë*, *khodha* etj. Lidhur me këtë të fundit shtojmë se, këtu bëhet fjalë për tingullin *χ* të greqishtes, gjurmë të të cilit i gjejmë edhe tek disa folës çamë sot. Liku, pohon se *kh* - ja paraqet tingullin *h* të greqishtes moderne, i cili i përgjigjet edhe *h*-së së shqipes. Mendoj se këtu bëhet fjalë pra, për tingullin *χ* të greqishtes.

- Për foljen *dal*, trajtat e tri vetave të njëjësit me *ll*, *dólla*, *dólle*, *dólli*, janë edhe të çamërishtes.

- Trajtën e pjesores *rarë* tek M. Liku e gjejmë ende në çamërishten e sotme.

- Ndër pjesët e pandryshueshme të ligjëratës të përdorura tek Liku, në çamërishten e sotme do të gjejmë pashirrmën *uákh – ah* (*alas!*); pjesëzat: *ió*, *núke* (*nuku*, në çamërishte), *mos* (= *jo*, *nuk*, *mos*); parafjalët *de* (*ndë*), *dë*, - në çamërishte (sot, - *në*); *bi* / *mbi*; *gákha* për *ngaha* (sot *nga*); *pre* / *prej*, *për*; *dái* / *ndaj* (near to),

<sup>196</sup> Hoxha, Sh.: “Kontributi i Uilljëm Martin Likut në fushën e studimeve albanologjike, Prishtinë 2007.

<sup>197</sup> Hoxha, Sh.: Po aty f. 88

<sup>198</sup> Hoxha, Sh. Po aty, f. 89

<sup>199</sup> Po aty, f 91

<sup>200</sup> Po aty, f. 94

<sup>201</sup> Shih në të njëjtin punim kreun për **sistemin fonetik** të çamërishtes së sotme.

<sup>202</sup> Hoxha, Sh. Po aty f. 94.

<sup>203</sup> Po aty f, 123.

*der, dër*, - në çamërishte ( *sot, -ndër*) etj. Mjaft përshtypje na bën folja *ndih* (tek Liku *dikh*) – folje; fjala *ndihmës* (tek Liku *dikhmes*) – emër njeriu.

Në Fjalorin *GREQISHT – ANGLISHT – SHQIP* të U. M. LIKUT hasim disa fjalë të huazuara që përdoren edhe sot tek folësit çamë si, **nga greqishtja**: *kersi* (qersh), *keramidhe* (qeramidhe), *dhespót* (= despot); **nga bullgarishtja**: *darovít* ( dhuroj); nga **serbo- kroatishtja**: *buiár* ( bujar).....etj. Ndër fjalët greke të përkthyer në anglisht sipas Likut, të cilat autori nuk i ka përkthyer në shqip, ato të cilat i gjejmë ende në çamërishten e sotme janë fjalët, *vrómi* (tërshërë), *lemóni* ( *lemon* - çamërisht, limon), *begendó* (*bejenis*- çamërisht, begenis), *patúna* (*patomë* - çamërisht, shputë e këmbës), *sendhomi* (*sendomë* -çamërisht, çarçaf) etj.

Pas këtyre shembujve mendojmë se me mjaft interes për t’u shqyrtuar janë greqizmat që gjenden ende sot në çamërishte, duke i verifikuar ato me origjinalin e M. Likut, origjinalin e teksteve të Reinholdit dhe dokumenteve më të hershme të së folmes së arbëreshëve.

Pas gjithë kësaj analize mendojmë se për t’u nënvizuar mbeten disa dukuri si: shfaqja e zanores *y* në të folmen e M. Likut dhe jo zëvendësimi i saj me *i* ose *u* ( pra mungesa e saj në sistemin zanor) si në të folmen e çamërishtes; mungesa e grupeve *kl, gl, lk*; trajta *sjellë* e pjesores së foljes *sjell* dhe jo *sellë*; moszhvillimi i dukurisë së rotacizmit dhe të tjera si këto, mund të na çojnë në mendimin se çamërishtja shfaqet edhe më arkaike sa e folmja e dokumentuar e Likut. Gjithësesi ky mund të jetë një përfundim pasi të nxjerrim në pah arkaicizmat e të gjitha të folmeve arkaike.

### 2.3.1. Disa të dhëna rreth historisë së shpërnguljes të arvanitasve, gjuhës dhe emërtimit të tyre

Para se të kalojmë tek disa të dhëna me vlerë rreth historisë së shpërnguljes së arvanitasve, fillimisht është e udhës që të rikujtojmë edhe njëherë mënyrën sesi janë quajtur shqiptarët në shekuj. Të dhënat për këtë i gjejmë gjithkund<sup>204</sup>, por njohuritë e para në këtë drejtim i kemi marrë në auditor gjatë kursit të Historisë së Gjuhës Shqipe nga një prej profesorëve të nderuar të këtij universiteti prof. Seit Mansaku.<sup>205</sup> Për këtë arsye, do të dëshiroja të citoja pikërisht ato.

“Shqiptarët përmenden për herë të parë me emrin e tyre të lashtë në shekullin II të erës sonë nga gjeografi grek Ptolemeu i cili në hartën e tij botërore shënon një fis ilir me emrin “Albanoi” dhe qytetin e tyre Albanopolis, në një zonë të Shqipërisë së Mesme prapa Durrësit. Arkeologët janë përpjekur ta identifikojnë këtë qytet me fshatin Zgërdhesh të Krujës, ku janë gjetur rrënojat e një qyteti antik. Ai fillon të përmendet në shekullin XI nga kronistët greko-bizantinë në veprën “Aleksiada” me emrin Arvanitas dhe Arvanon. Me këtë emër të lashtë janë quajtur shqiptarët që ikën nga trojet e tyre që në kohën e Skënderbeut, sidomos pas rënies nën Perandorinë osmane, në Itali , - arbëreshët dhe në Greqi,- arvanitasit. Ky emër ruhet sot edhe në disa toponime p.sh: Arbana (fshat në Tiranë). Emri i Ptolemeut erdhi dhe u përgjithësua për të gjithë vendin dhe popullin e ka mbetur i gjallë deri sot, duke dëshmuar një vazhdimësi të shqiptarëve në këto troje nga antikiteti deri në ditët tona. Me këtë emër na njohin dhe na quajnë të huajt edhe sot e kësaj dite. ....”<sup>206</sup>

<sup>204</sup> Që nga Lajbnici, Tunman, Liku e deri tek Çabej, Demiraj...etj.

<sup>205</sup> Përfijto nga rasti të falenderoj të gjithë profesorët e gjuhësisë së Universitetit të Tiranës për përkushtimin në dhënie e njohurive dhe përçimin e dijes.

<sup>206</sup> Mansaku, S. *Leksione të kursit Histori e gjuhës shqipe*, Tiranë 1997.

Tek Liku, lidhur me një çështje të tillë gjejmë se “me emrin Albanoi / Alvanoi, Albanites ose Arvanites grekët i quanin më parë të gjitha fiset ilire fqinje, të cilat flisnin një dialekt të përbashkët, kishin zakone të njëjta dhe mënyrë të njëjtë jetese me fisin Albanoi. Më vonë emrin Albania, Albani e morën italianët prej grekëve dhe pastaj prej këtyre të fundit popujt e tjerë të Evropës”<sup>207</sup>.

Sipas studiuesit A. Llalla, ilirët më vonë u quajtën albanë. Ilirët dhe albanët vetëquhen: arbër ( ar+ bërës), arbanë, arbëreshë, shqiptarë, kurse atdheun e tyre e quajtën Arbëri, Shqipëri, e kurrë nuk e quajtën atdheun e tyre Iliri dhe Albani.” Ky i fundit është një term që përdoret edhe sot e kësaj dite nga bota përëndimore por jo nga vetë shqiptarët.<sup>208</sup>

Me sa duket, rreth faktit se si na quajnë jashtë Shqipërisë, të gjithë arrijnë në të njëjtin përfundim, ndërsa më të pakta janë të dhënat që shpjegojnë etimologjinë e fjalës **shqiptar....**

Ndërsa për historinë e arvanitasve tek Liku gjejmë disa të dhëna, kur ai flet për bashkësinë e Suljotëve sipas të cilit më vonë u ndanë në fise, ndër të cilët më të njohurit ishin: Boçarenjtë, Buzbatët, Zervatët, Zhavelasit dhe Dhrakasit. Për sa i përket bashkësisë së suljotëve, Liku shprehet se këta kishin qenë **kolonë shqiptarë** të ardhur në fillimin e shek. XIV, të cilët i ishin shmangur Janinës, si dhe Artës e brigjeve të lumit Kalamas (tek Liku: Kalama, f. 257, 408), duke u ngulitur në malet e zhveshura të Sulit.<sup>209</sup>

Sipas A Klosit valët më të mëdha të zbritjes shqiptare drejt Greqisë fillojnë aty nga mesi i shek. XIV. Princi bizantin Manuel Kantakuzenos që si despot i Moresë (1348-1380), arriti pavarësi ndaj pushtetit qendror të Kostandinopojës, në luftën e tij kundër baronëve frankë mori në shërbim luftëtarë shqiptarë, por tërhoqi edhe kolonë të shumtë, për të zëvendësuar humbjet e mëdha të popullsisë nga luftërat dhe shkatërrimet. Këta i përqendroi në Arkadi, Lakoni dhe në kufijtë jugorë të zotërimeve të tij.....<sup>210</sup>

Viojmë përsëri përmes citimeve,

“Nga një analizë e pjesshme e dialekteve të gjuhës shqipe, që fliten ende sot në tokën kontinentale greke dhe në ishujt, është gjetur se kjo valë përmytëse, të paktën në Peloponez dhe në ishujt e lundërtarëve Hidra, Spacia dhe Poros, vihej në lëvizje vetëm nga kolonistë toskërishtfolës nga Shqipëria Qendrore dhe Jugore.”<sup>211</sup> Për humbjen e kontakteve të tyre me atdheun, Heabler shkruan se “ prej përfundimit të migrimit shqiptar drejt Greqisë, kontakti i kolonëve dhe pasardhësve të tyre me atdheun shqiptar u ndërpre njëherë e përgjithmonë.”<sup>212</sup> Edhe Sasse në veprën e tij “Arvanitika” shkruan : “ pasardhësit e kolonëve mesjetarë shqiptarë në Greqi të mesme e në Peloponez, me përfundimin e zhvendosjes në krahinat përkatëse, e humbën, si në pikëpamje gjuhësore ashtu edhe kulturore, çdo lidhje me pjesën tjetër të

<sup>207</sup> Hoxha, Sh. “Kontributi i Uilljëm Martin Likut në fushën e studimeve albanologjike, Prishtinë 2007.

<sup>208</sup> Llalla, A. Po aty.

<sup>209</sup> Hoxha, Sh. Po aty.

<sup>210</sup> D. A. Zakythinos, “Le despotat grec de Morée”, T. I, Paris 1932 f. 101-103, Hopf, “Geschichte Griechenlands”, II, Leipzig 1867, f. 37; Sipas Klosi, A: *Netët Pellazgjike të Karl Reinholdit* ( Tekste të vjetra shqipe të Greqisë mbledhur nga Karl Reinholdi 1850-1860, f. 23, (K&B), Tiranë, 2005.

<sup>211</sup> J.Ph. Fallmerayer, “ Das Albanesische Element in Griechenland” II, 1860, përkth shqip: “ Elementi shqiptar në Greqi”, Tiranë 2003f. 138; sipas Klosit, po aty f. 24.

<sup>212</sup> Haebler, C. “ Gramatik der albanischen Mundart von Salamis Eiesbaden 1965 , f. 16-17, po aty.

trevës shqipfolëse, duke shpënë kështu si enklavë, për më shumë se një gjysmë mijëvjeçari, një jetë të mëvetshme<sup>213</sup>

Pas këtyre shpjegimeve lidhur me historinë e arvanitasve po japim disa të dhëna që rishikojnë emërimin e tyre. Përkrah emërtimit *arvanitas* shpesh kemi hasur edhe termin *allvanitas*. Dallimi midis këtyre termave, sipas studiuesit Llalla i cili është marrë gjatë me çështjen e arvanitasve, qëndron në mënyrën **se si na thërrasin popujt e ndryshëm.....**“*Dallimi i emërtimeve të shqiptarëve, arvanitas- allvanos, lidhet me një fakt historik, atë të mbetjes jashtë territorit të Greqisë së sotme pas shpalljes së pavarësisë së saj më 1821-in, të krahinës së Çamërisë, e cila në vitet në vazhdim mbeti nën drejtimin e Turqisë. Kjo që edhe arsyeja sipas tij që çamët u quajtën “allvanos” dhe jo “arvanitas.”* Nga ana tjetër, emërtimin “arvanitas” dhe jo “arbëresh” autori e shpjegon me faktin se grekët shkronjën B të alfabetit latin e lexojnë V; ndërsa turqit arvanitasit i quajtën “arnaut” ose “arnavud”, kurse arvanitasit ortodoksë të Kostandinopojës dhe të Egjiptit i quajtën “greci”.<sup>214</sup>

Studiuesi Llalla vë theksin edhe tek kontributi i arvanitasve për shtetin grek: “Politikanët dhe historianët grekë, e gjithë struktura shtetërore greke, janë munduar të mohojnë kontributin e figurave të shquara arvanitase për Pavarësinë e Greqisë më 1821, me qëllim mohimin e tyre.....Arvanitasit janë një realitet në shtetin Grek. Ata kanë luftuar në Kryengritjen e vitit 1821 bashkë me grekët kundër osmanëve turq, për formimin e shtetit grek. Arvanitasit e quajnë veten e tyre zotër të Greqisë....”<sup>215</sup>

Disa nga arvanitasit heronj të Kryengritjes së vitit 1821 ishin: Gjeorgjio Kundurioti, Kiço Xhavella, Andoni Kryezi, Teodor Kollokotroni, [Marko Boçari](#), Noti Boçari, Kiço Boçari, Laskarina Bubulina, Anastas Gjyrokastri, Dhimitër Vulgari, Kostandin Kanari, Gjeorgjio Karaiskaqi, Odise Andruço, Andrea Miauli, Teodor Griva, Dhimitër Plaputa, Nikolao Kryezoti, Athanasio Shkurtanioti, Hasan Bellushi, Tahir Abazi, Ago Myhyrdani, Sulejman Meto, Gjeko Bei, Myrto Çali, Ago Vasiar.....”<sup>216</sup>

Një tjetër kërkues, ndofta më i përkushtuari në këtë drejtim është edhe studiuesi Niko Stillo.

Siç e ka deklaruar edhe ai vetë “ arrita me dialektin tim amtar të gjuhës shqipe të lexoj shumë prej këtyre mbishkrimeve jo vetëm në hapësirën greke, por edhe jashtë saj konkretisht në Itali e Turqi” Autori fillimisht i hedh në letër duke i botuar ato në Athinë më 2003, në librin me titull “Elemente prehistorike në tekste shumë të lashta shqipe i cili qarkullon më pas në Prishtinë në 2004.ën, në librin e titull *Historia e shenjtë e arvanitëve, dokumente parahistorike*. Për leximin e këtyre mbishkrimeve autorit i lind e nevojshme të hulumtojë në **alfabetet e hershme** të shkruara në gjuhën shqipe, ku gjen fjalë dhe germa që e ndihmojnë në deshifrimin e tyre. Një prej këtyre alfabeteve ishte edhe *Fjalori i Marko Boçarit*, cili qarkullon në Tiranë më 2007-ën. Puna me këtë vepër e shtyn autorin drejt kërkimeve të mëtejshme. Kështu ai siç edhe e ka deklaruar gjatë konferencave dhe tubimeve të ndryshme shkencore është marrë shumë gjatë edhe me fjalorin greqisht-shqip të Panajot Kupitorit. Nga libri i tij mësojmë se një nga heronjtë e lartpërmendur Marko Boçari, gjatë luftës për çlirimin e

<sup>213</sup> Po aty, f. 24.

<sup>214</sup> Llalla, A. *Arvanitasit – Çamët në etnikumin shqiptar në Greqi (arvanitasit themeluesit dhe drejtuesit e greqisë moderne 1821-2005)*, kumtesë e mbajtur në Seminarin Ndërkombëtar të Albanologjisë, Tetovë-Ohër, 16-23 Shtator 2007.

<sup>215</sup> Llalla, A. “Gjurmë të letërsisë së vjetër të shqiptarëve të Greqisë 1860- 1889”, Tetovë , 2006

<sup>216</sup> Llalla, A.: *Arvanitasit – Çamët në etnikumin shqiptar në Greqi (arvanitasit themeluesit dhe drejtuesit e greqisë moderne 1821-2005)*, kumtesë e mbajtur në Seminarin Ndërkombëtar të Albanologjisë, Tetovë-Ohër, 16-23 Shtator 2007.

Grequisë shkroi fjalorin greqisht- shqip me qëllim që t'u vinte në ndihmë burrave epirotë dhe moraitë, ushtarë të regjimentit që kishin formuar francezët në Korfuz, të cilëve mesa duket nuk e dinin mirë greqishten. Si shembull ka përdorur fjalorin e Daniel Voskopojarit, "Fjalor katërgjuhësh"<sup>217</sup>

Gjithashtu nuk mund të anashkalojmë edhe faktin se Fjalori i Marko Boçarit ka ardhur për herë të parë në shqip nga mendimtari Mithat Frashëri.

Në parathënien e kësaj vepre Prof. Bashkim Kyçyku e quan fjalorin e Marko Boçarit një sprovë për të kërkuar gjurmë nga shqipja e hershme, nxitje që të kërkohet kudo për të gjetur, aty ku janë gjymtyrët e shpërndara të shqipes, si në periudhat e afërta, pra edhe më të qarta, ashtu edhe në periudhat më të largëta, rrjedhimisht, të mjergulluara ose fare të errta.<sup>218</sup>

Fjalorët e hershëm të shqipes janë mjaft të rëndësishëm për gjuhën tonë e cila është e dokumentuar mjaft vonë.

M. Liku shkruan Fjalorin Greqisht- Anglisht- Shqip. Në parathënien e këtij fjalori autori thekson se para shkrimit të tij kishte në dorë dy fjalorë të gjuhës shqipe, fjalorin e Teodor Kavaliotit nga Voskopoja, i cili ishte botuar në Venedik në vitin 1770, dhe fjalorin katër gjuhësh, vllahisht, bullgarisht, shqip për përdorim të grekëve. Për fjalorin e Kavaliotit, Liku thotë se ishte i shkurtër dhe i shkruar në mënyrë jo të përsosur, mirëpo pasqyronte tingujt e shqipes. Fjalori katërgjuhësh përmban lëndë nga greqishtja (Romaic), shqipja (Albanian), arumanishtja (Ëallachian) dhe bullgarishtja (Bulgarian) dhe folësve të këtyre tri gjuhëve u shërbente për ta mësuar e për ta përdorur greqishten.<sup>219</sup>

**Marko Boçari ka qenë një ndër kryengritësit për pavarësinë e Grequisë më 1821 dhe fjalori i Teodor Kavaliotit është shkruajtur para këtyre viteve. Për rrjedhojë, arrijmë në përfundimin se fjalori i Teodor Kavaliotit është shkruar para Fjalorit të Marko Boçarit, ndërsa përsa i përket Fjalorit të Panajot Kupitorit i cili është shkruar më vonë, pas një rruge të errët ai vjen sot përsëri nga studiuesi Nyko Stylos.**

Po citojmë më poshtë disa të dhëna nga studiuesi A. Llalla, rreth fjalorëve të hershëm të shqipes,

Sipas tij, Marko Boçari ka qenë një ndër kryengritësit për pavarësinë e Grequisë dhe Fjalori i tij është shkruajtur para vitit 1821. Fjalori i Teodor Kavaliotit (1718-1787) është shkruar para fjalorit të Marko Boçarit. Sipas Llallës para këtij fjalori ( të Marko Boçarit gjatë shekullit XVIII), ishin botuar: fjalori tregjuhësh; greqisht-arumanisht-shqip i Teodor Kavaliotit më vitin 1770 me 200 fjalë i cili u quajt

<sup>217</sup> Stylos, N: " Fjalori i Marko Boçarit", ( Arbëria), Tiranë 2007.

<sup>218</sup> Stylos, N: " Fjalori i Marko Boçarit", parathënia e veprës ( nga B. Kyçyku),( Arbëria), Tiranë 2007.

<sup>219</sup> Sipas studiuseses, Hoxha, në veprën e Likut thuhet se T. Kavalioti i njohur si hartues i teksteve të ndryshme mësimore-shkencore, studioi në Janinë ndërmjet viteve 1732 –1734, është i njohur me hartimin e një doracakut shkollor "Protopiria", (Mësimet e para), botuar në Venedik në vitin 1770, që përmban, lutje, këngë e vargje (praktika) kishtarë, tregime biblike dhe ungjillore, sentenca dogmatike, tekste të shkurtra morale etj., të gjitha në gjuhën greke. Protopiria përmban edhe një fjalor tri gjuhësh greqisht - arumanisht – shqip me rreth 1170 fjalë (nga faqja 3 – 59). Si një ndër fjalorët e parë shumëgjuhësh , bashkohemi me të njëjtin mendim me autoren për rëndësinë e këtij fjalori për leksikografinë shqiptare. Në veprën e tij "Researches in Greece" (Kërkime në Greqi), ai herë pas here përmend edhe disa autorë shqiptarë dhe veprat e tyre si Frang Bardhin, - fjalorin e tij, Teodor Kavaliotin dhe fjalorin e tij, Danil Adam Haxhiun dhe fjalorin e tij, etj. Në mënyrë të veçantë çmonte lart njohuritë arsimore dhe kulturore të Evstrat Vithkuqarit. Me këtë rast ai pranon se ka marrë njohuri të llojllojshme prej tij për hartimin e Gramatikës shqipe dhe të Fjalorit greqisht – anglisht – shqip."



“Protopirinë”<sup>220</sup> dhe u botua në fillim në Voskopojë më 1760 dhe më pas më 1770 në Venedik.

Në shekullin XIX, një tjetër shkencëtar, Panajot Kupitori, veç veprës së njohur “Studime shqiptare” (1878), kishte hartuar një fjalor të gjuhës shqipe, vepër që për më shumë se një shekull mbeti si dorëshkrim në bodrumet e Akademisë së Shkencave të Athinës<sup>221</sup>. Panajot Kupitori, ishte arvanitas nga ishulli i Hidrës. Ai mbaroi studimet në Universitetin e Athinës. Pas studimeve punoi mësues i letërsisë në gjimnaz në Athinë ku më vonë u bë drejtor i kësaj shkolle. Në vitin 1860 Kupitori botoi “Abetare të gjuhës shqipe” dhe më vonë fjalorin greqisht-shqip të cilin në vitin 1882 e bleu konsulli francez në Janinë A. Dozan. Në vitin 1926 fjalorin greqisht-shqip të Panajot Kupitorit e riblendu Ndërmarrja Historike dhe Etnologjike e Greqisë.

Një tjetër fjalor për të folmen e gjuhës shqipe të Atikisë që ishte hartuar nga Taso Nerukos (1826-1892), do të mbetet i panjohur dhe i pakapshëm. Pas vdekjes së Nerukos, vejusha e tij ia dha dorëshkrimin gjuhëtarit të madh gjerman, G.Meyer dhe ai e botoi në veprën e vet “Albanesich Studien V” faqe 67-94, pjesën nga A-ja deri tek L-ja, si shqip-gjermanisht.

Një e dhënë tjetër, lidhet me arvanitasin nga ishulli i Salaminës, Anastas Kullurioti (1822-1887), në vitet 1879-1880 themeloi gazetën “Zëri i Shqipërisë”. Ai botoi më 1882 dy libra në gjuhën greke “Ankimet shqiptare” dhe “Klumësht për foshnjat”. Veprimtaria e këtij arvanitansi të shquar u ndërpre mbasi qeveria greke e arrestoi dhe e burgosi në Athinë. Në vitin 1887 Anastas Kullurioti vdiq i helmuar në burgun e Athinës.

Lidhur me arvanitishten, Sasse thotë se një ndër tiparet dalluese të arvanitasve ka qenë gjuha shqipe e cila gjithmonë është konsideruar si “gjuhë e familjes” për to.<sup>222</sup> Duke e quajtur me këtë term, duket sikur vendosim një vijë paralele midis të folmeve dialektore dhe asaj arvanitase, megjithëse arvanitishtja ka qenë shumë herë më e “pafat”<sup>223</sup> në të gjitha drejtimet.

Pedagogu i gjuhësisë në Universitetin e Çikagos, Eric Pratt Hamp, në ligjëratën e tij për rëndësinë e arvanitishtes thotë: “Gjuha shqipe ka një kontribut unik me pasuri të veçantë në shumë drejtime të rëndësishme, dhe Greqia është po aq me fat që ka këtë burim të pasur në tokën e vet dhe ndërmjet qytetarëve të saj. Gjuha arbërishte ndodh që të ruajë historikisht, me saktësi më të madhe se çdo trajtë tjetër e gjuhës shqipe, tingujt e saktë të të gjitha rrokjeve që janë në fjalorin e shqipes 1500 vjet më parë. Kjo përbën vetëm një shembull të mënyrës me të cilën arbërishtja ka rëndësi unike dhe të pakrahasueshme për gjuhën shqipe në tërësi, kështu që të kuptojmë familjen e madhe indoevropiane në të cilën bëjnë pjesë po ashtu greqishtja dhe anglishtja ime, dhe më në fund disa anë të qytetërimit humanitar në tërësinë e Euro-Azisë”<sup>224</sup>.

Pas kësaj, duket sikur vendosim një vijë paralele midis të folmeve dialektore dhe asaj arvanitase, megjithëse arvanitishtja ka qenë shumë herë më e “pafat”<sup>225</sup> në të gjitha drejtimet. Një nga mënyrat e ruajtjes së arvanitishtes, ka qenë kënga.<sup>226</sup> Në tetor të vitit 2002, pas një pune 17 vjeçare kërkimesh, [muzikologu dhe këngëtari i njohur](#)

<sup>220</sup> Gjë të cilën e gjejmë edhe tek Liku , siç vërehet edhe nga citimi I studiueses Hoxha.

<sup>221</sup> Siç e përmendëm edhe më lart, kjo është një vepër e cila sheh dritën e botimit nga studiuesi N.

Stylo, 2011.

<sup>222</sup> Llalla, A. po aty

<sup>223</sup> Term i huazuar nga Altimari

<sup>224</sup> Po aty

<sup>225</sup> Term i huazuar nga Altimari

<sup>226</sup> Po aty

[arvanitas Thanasi Moraiti botoi antologjinë e parë të teksteve të këngëve arvanitase të Greqisë me titull “Antologjia e këngëve arvanitase të Greqisë”](#), një libër shkencor, me vlera të mëdha historike dhe kulturore për kombin e arbërit.<sup>227</sup>

Të gjitha këto janë vetëm një dëshmi jo e vogël historiko- gjuhësore, që flet për vlerat intelektuale të kombit tonë, përmes diasporës tashmë “të pazë dhe të padukshme”<sup>228</sup>, por jo e zhdukur, e arvanitasve të Greqisë.

### 2.3.2. Dukuri të përbashkëta gjuhësore midis teksteve të Reinholdit dhe çamërishtes së sotme

Gjatë studimit të çamërishtes së sotme nuk mund të shmangim të përbashkëtat me të folmen e arvanitasve të Greqisë. Tekstet e Reinholdit janë mjaft interesante për studimin e çamërishtes. Për këtë flasin qartë referencat që shpesh i bëhen këtij studiuesi në punime të shumta për çamërishten, të cilat fillimisht i kemi hasur në punimin dialektologjik të prof. Q. Haxhihasanit. Si pikë referimi sot, lidhur me këtë çështje kemi pasur tekstet e Reinholdit të transkriptuara në shqip. Dorëshkrimet e Reinholdit i kemi gjetur në Institutin Shkencor të Historisë dhe Gjuhësisë. Me mjaft vlerë na është dukur edhe transkriptimi i tyre prej studiuesit Ardian Klosi i cili që në parathënie të veprës “Netë Pellasgjike”<sup>229</sup>, herë –herë flet me gjuhën e arvanitasve: *1/3 e popullsisë së steresë...; “shtiti urët kundër jatroit”* etj. Që me këtë frazë provohet ajo që shpesh kemi pohuar: çamërishtja, përkatësisht shqipja e hershme, gjallon ndër çamë ende në ditët tona.

Dorëshkrimet e Reinholdit për autorin dhe jo vetëm, janë mjaft të vlefshme. Sipas Klosit ato nuk janë mbledhur në terren nga vetë Reinholdi, por nga miku i tij Patër Vasil Saqelari i cili i dorëzon rregullisht Reinholdit tekste shqipe ( këngë, përralla, anektda etj), të shkruara me shkronja greke dhe, flitet që kjo mbledhje të jetë bërë përpara Thimi Mitkos, Zef jubanit, ose Zef Skiroit). Më pas Reinholdi ( mjek) i kthen ato në alfabetin e vet latin.<sup>230</sup>

Të njëjtën ndjesi kemi provuar në momentin që na kanë rënë në dorë disa shënime të patrajuara ndonjëherë të çamërishtes së viteve 1978, të cilave shpesh u jemi referuar<sup>231</sup>, të mbledhura nga një historian i njohur për historinë e Çamërisë, Z. Hajredin Isufi<sup>232</sup>.

Shenimet e Reinholdit janë një testament mjaft i vlefshëm i shqipes së mesjetës së vonë. Këto të dhëna fillimisht janë vlerësuar nga studiues dhe gjuhëtarë të huaj si; Emilio Teza, Gustav Mayer, Gustav Ęeigandi etj<sup>233</sup>, të cilët edhe duke u bazuar në këto shkrime kanë dalë në përfundime të caktuara për gjuhën shqipe. Sigurisht, këto të fundit shpesh kanë qenë të kritikueshme nga studiues shqiptar, njëri prej të cilëve ka qenë edhe prof. Çabej, i cili me të drejtë, duke qenë përkrahës i

<sup>227</sup> Po aty

<sup>228</sup> Term i huazuar

<sup>229</sup> Klosi, A: Netët Pellasgjike të Karl Reinholdit ( Tekste të vjetra shqipe të Greqisë mbledhur nga Karl Reinholdi 1850-1860, (K&B), Tiranë, 2005.

<sup>230</sup> Po aty

<sup>231</sup> Troplini, E. *Sistemi foljor i çamërishtes në diakroni*, kumtesë e mbajtur në Seminarin e tretë Ndërkombëtar të Albanologjisë, Tetovë, 2010, botuar në organin përkatës “Aktet...”, Tetovë 2011

<sup>232</sup> Përpara se të bëhej kaq i njohur në fushën e historisë studiuesi në fjalë mendonte se mund të studionte të folmen çame. I mbledh këto materiale për këtë të folme, duke u këshilluar edhe me mikun e tij të madhin Çabej. Por fusha e historisë e tërhiqte më shumë dhe shënimet e tij të atyre viteve mbeten të patrajuara.

<sup>233</sup> Klosi, A: po aty

metodës së krahasimit të brendshëm, kritikon çështje që lidhen me etimologjinë e gjuhës shqipe në veprën “Studime etimologjike në fushë të shqipes”.

Së fundmi ato i merr i dorë autori në fjalë i cili shprehet :“*qysh në vitet '30 fillon edhe gjumi më i gjatë i dorëshkrimeve që përfundon sot , më 2005, pikërisht në përvjetorin e 150-të , të “Netëve pellazgjike”. Gjatë gjithë kësaj periudhe “Reinholdi” ka qenë më e madhja e fshehtë e ditur e albanologjisë, mister me disa të njohura, dëshirë botimi , por asgjëkundi më shumë sesa fjala desideratum*”; duke përmendur dy autorë të fundit si Claus Haebler me monografinë e tij: “Gramatikë e dialektit shqiptar të Salaminës” ( Eiesbaden, 1965), dhe vepra e Hans –Jurgen Sasses “Arvanitka”(Këln 1991); “*Të dyja këto e kapin arvanitishten në një fazë të përparuar të dekadencës apo vdekjes gjuhësore, tek shkrihet thujse në të gjitha elementet e saj në lëndën greke*”.<sup>234</sup>

**Ndër tiparet fonetike më të spikatura që autori ka trajtuar nga tekstet e Reinholdit<sup>235</sup> dhe që përkojnë me ato të çamërishtes së sotme janë:**

- *H*-në e fortë ( $\chi$ ) sipas tij, të ndikuar nga greqishtja, e ndryshme nga një *h* e fortë e shqipes Reinholdi e shënon herë me  $\chi$  dhe herë me *ch*. Klosi e ka dhënë këtë tingull rregullisht me *h*;
- Sipas A. Klosit grupi *ng* përfaqëson një tingull të veçantë të cilin Reinholdi herë e shënon me *č* e herë me *k*, por që autori këtë tingull e ka shënuar thjesht me *ng*: *nga, ngalkonj*. Lidhur me një dukuri të tillë, duke e studiuar çamërishten prej vitesh, ne mendojmë se këtu bëhet fjalë për asimilim të grupit *ng*, që ndodh edhe në çamërishte, si rezultat të të cilit kemi herë *k* e herë *g*: *nga > ka, ngarkoj > garkonj*;
- Përdorimi i rregullt i një *-i*-je në vend të fonemës *y*, ndodh në të dyja të folmet, me një përjashtim që, tek Reinholdi ndonjëherë në raste të rralla kjo zanore shfaqet: *tharëtyrë, vërtyt, fëndyell, detyrë* etj; në të folmen e çamërishtes në vend të saj ndonjëherë gjejmë zanoren *u*: *dusheme, duqan* etj;

Shtojmë se ndërsa tek Liku dhe Reinholdi gjejmë edhe shfaqjen e zanores *y*, përsërisim se çamërishtja lidhur me disa tipare shfaqet edhe me arkaike.

- Ruajtja e *ë*-së së patheksuar në pozicion fundor: *dhelpërë, këmbëtë, gjatorëtë, të parëtë* etj;
- Shndërrimi i zanores *-ë* në *-i*, në rrënjë të fjalës: *një,- njiut , njira* etj. Nga të dhënat sot në çamërishte kemi *njira, nji-it*.
- Ruhen grupet *gl, kl*: *i glatë, klishë, klumësht* etj. Tipar që e gjejmë edhe tek Buzuku.<sup>236</sup>
- *Gj*-ja nistore shpesh përkëmbet me *-j*- në të dyja këto të folme ( *jashtë, jalpin, jakun* , sipas Klosit; Në çamërishte kemi vetëm një rast të vetëm tek fjala *jermani*).

Pra, siç e shohim, për disa dukuri çamërishtja shfaqet më inovative se në të dhënat e Likut apo të Reinholdit.

**Kjo do të thotë se, për të folme të tilla për sa i takon arkaicizmit të secilës mund të arrihet në përfundime të sigurta vetëm përmes statistikave të sakta, pasi edhe zhvillimet e secilës prej tyre janë bërë në kontekste të tilla që kanë motivuar në mënyra të ndryshme zhvillimet brenda të folmeve.**

<sup>234</sup> Të dhënat për librin dhe autorin janë vjelë nga vetë teksti.

<sup>235</sup> Bashkëpërkime të tjera të vjela nga shembuj origjinalë të Reinholdit me çamërishten e sotme mendojmë t'i trajtojmë në të ardhmen.

<sup>236</sup> Troplini, E.: “*Bashkëpërkime midis të folmes së çamërishtes dhe të folmes së autorëve të vjetër të shqipes*“, Alb- Shkenca, 2009.

- Për sa i takon dukurisë së asimilimit njëlloj si tek Reinholdi kemi asimilimin e grupeve bashkëtingëllore:  $mb > b$  ( R: *banj*; çamërishte: *bi* );  $nd > d$  (*donjë*),  $nx > x$  (*xuar*)  $xv > x$  (*xarris*). Për sa u takon grupeve,  $mb > m$  ( mërda),  $pm > m$  (jammë); në çamërishte kemi  $mb > b$  (bërna),  $pm > mn$  (jamnë).<sup>237</sup>
- Metateza është një dukuri e shpeshtë edhe në çamërishte, megjithëse shembujt e trajtuar nga Reinholdi nuk na thonë gjë, mendojmë se kjo ka qenë një karakteristikë e hershme e shqipes.
- Edhe në çamërishte  $q > ç$  dhe  $c > ç$  (*qysh- çish*; *cili- çili*)
- Metafonia është një dukuri po aq vepruese edhe në çamërishte madje tek të njëjtat fjalë, p.sh: *kulaç- kuleçe*, *çurap- çurepe*, *shatë- shetër*, *peshq- pishq*, *i glatë- të glet* etj.
- Edhe në çamërishte kemi shmangie të rasave dhanore dhe rrjedhore si: *vuante ka uria*, *e muarë sish* (Reinholi: *jashtë nga mëkati*);
- Mbaresa e rasës kallëzore për emrat mashkullorë është *në*. Kjo e fundit shpesh asimilohet në *ë*, sikurse në çamërishte: *ciapnë*, *varrnë*, *gjatorë*, *burrë* etj.
- Foljet joveprore të së kryerës së thjeshtë sikurse tek Reinholdi kanë shpesh mbaresën *sh*: *u dogjsh*, *u poqsh*, *u zushë* etj, trajtë e cila dëshmohet edhe tek Buzuku.<sup>238</sup>
- Mbaresa e së pakryerës në vetën e tretë ka mbetur po ajo e shqipes së Peloponezit edhe sot ndër çamë të vjetër: *lij*, ( *linte*), *mbaj* (mbante), *vej* ( *vente*), *vdis* ( *vdiste*), *piq* (piqte) etj. <sup>239</sup>
- Per sa i përket së kryerës së thjeshtë, mbaresa 0 e vetës së tretë njëjës, vërtetohet në çamërishte sot tek foljet që pësojnë diftong *xuar*, *muar*, *suall* etj.
- Përsa i përket ndërtimeve me *pa* ato janë mjaft të pranishme edhe në çamërishte. Mendojmë se nga shembujt e trajtuar të Reinholdit *pa të pienj*, *pa t'e ndiejmë*, nuk bëhet fjalë për trajtat *pa pyetur*, *pa ndierë* ( siç shpjegohet nga autori), por për një trajtë të veçantë të çamërishtes të cilën e dëgjojmë mjaft mirë edhe sot : *pa t'e ndoqi me vrap*, *pa t'ia dha të qarit* ( *pa* = menjëherë), *pa t'e qëlloi* etj.

Në tekst, kundrejt veçorive sintaksore gjejmë shprehimisht këtë arsytim: “Përsa i takon veçorive sintaksore, siç shprehet edhe autori “nuk janë të mëdha ndryshimet në strukturën e frazës dhe fjalisë të SHPP nga çka njohim prej të folmeve toske , e sidomos ato çame.”<sup>240</sup> Kështu është e vështirë të dallosh pjesët folklorike nga ato origjinale të atë Vasilit.”

Mendojmë se për sa i takon “gjallërisë dhe ritmit të gjuhës së folur”, kjo është një karakteristikë e shqipes së vjetër e cila në të folur është edhe më e pranishme. Pra, bëhet fjalë për atë tipar që studiuesi i njohur Selman Riza e klasifikon si tipar të shqiptimit individual të Buzukut, por në të vërtetë si njohëse dhe studiuese prej vitesh e çamërishtes mendoj se nuk kemi të bëjmë as me shqiptim individual, as me gjallëri dhe ritëm të Patër Vasilit, po me një veçori karakteristike të vjetër të gjuhës sonë.

<sup>237</sup> Një punim më të thelluar tek i cili mund të studiojmë bashkëpërkimet midis çamërishtes dhe të folmes së Reinholdit, mendojmë ta bëjmë në të ardhmen në të ardhmen, pasi për të arritur në përfundime të sakta lidhur me këtë çështje, duhet patjetër që krahasimi të bëhet midis të dhënave për çamërishten dhe origjinalit të veprës së Reinholdit .

<sup>238</sup> Klosi, A.: f.19

<sup>239</sup> Për më tepër shih në njëjtin punim temën, *Sistemi foljor i çamërishtes në diakroni* , f. 48, si dhe Troplini, E. *Sistemi foljor i çamërishtes në diakroni*, kumtesë e mbajtur në Seminarin e tretë Ndërkombëtar të Albanologjisë, Tetovë, 2010, botuar në organin përkatës “Aktet...”, Tetovë 2011

<sup>240</sup> Për të folmen çame i referohet me të drejtë Pedersenit “ Albanesische Texte mit Glossar”, Leipzig 1895.

Edhe në çamërishte parapëlqehet ndërtimi i bashkërenditur ndaj atij të nënrenditur i tipit, *i shoqi kish një karrocë e me atë nxirr bukë' e gojës; ish një herë një plakë e kish një djalë.( përsëritja e shpeshtë e lidhëzës e)*<sup>241</sup>, ku strukturat me nënrenditje mënjanojnë herë- herë lidhëzat.

Shkrija e trajtave të shkurtra, të cilat janë edhe në funksionin e kundrinës së drejtë me pjesëzat e lidhores që e gjejmë mjaft të pranishme tek Reinholdi, është një dukuri tipike edhe e dialektit të çamërishtes. Kjo është ndër të tjera një dukuri tipike edhe në ditët tona sot, së cilës nuk mund t'i shpëtojnë edhe më të rinjtë në moshë, konkretisht: *t'e marr, t'e shoh, t'e hajë* etj.

Vihet re në çamërishte sot, ende sikurse tek Reinholdi mungesa e nyjës para emrit, mbiemrit, përemrit pronor : *djali tia, djelvet saj, qan t'ëmënë, gëzon t'anë* etj.

Sikurse në tekstet e Reinholdit kemi paravendosjen e përcaktorëve edhe në çamërishte: *të këqinj njerëz që janë; më të prapë djel s'më kanë zënë sitë; më të keqe nuse nuk kam parë, të mbëdhenj fiq* etj. Mendojmë se si tek Reinholdi ashtu edhe nga shembujt e çamërishtes këtu bëhet fjalë për mbiemra të një shkalle të caktuar.

Për sa i takon fushës së fjalëformimit, fjalë që mbartin parashtesa fosile (siç i quan studiuesi) sot në çamërishte kemi: *nglatem, mpleks, rkuall* etj.

Ndër prapashtesat që ruhen ende në çamërishte na bën përshtypje prapashtesa *-ëlë* (të cilën tek Reinholdi e gjejmë në trajtën *-ëlië*), në fjalët: *mbretëlë, vdekëlë, hamëlë* etj; prapashtesa *eps*: *hajdheps, zileps* etj;

Çamërishtja është një ndër ato të folme që pasi e ke njohur mirë të bën përshtypje të veçantë për një "pasuri të madhe në fjalë dhe frazeologji", sikurse e folmja e Patër Vasilit, tek vepra e Reinholdit.

Disa prej fjalëve që sot kanë humbur në përdorim ose kanë marë tjetër kuptim, në çamërishte ruhen ende ose ruajnë ende kuptimin e dikurshëm. Të tilla janë: *dej, krunde, gjeq, kërmë, botë ( dhe), bletë (koshere), çel (ndez), falem (lutem)*<sup>242</sup>, *qesh (vë në lojë, tall)*, *i shtrenjtë (dorështërnguar)*. Edhe në çamërishten e sotme përdoren ende shprehje të tilla frazeologjike, si: *ku të dhëmb e ku të ther, të ndahet gruri ka egjëra, vë krietë ndë trastë, qeni qepën të hajë, mali me mal nuk piqen, e muar sish, nglati këmbët sa ke papllomnë* etj.

Sikurse e kemi trajtuar më lart, një bashkëpërshtatje **midis çamërishtes dhe të folmes së Buzukut**<sup>243</sup> e kemi bërë në punimin me titull "*Bashkëpërkime midis të folmes së çamërishtes dhe të folmes së autorëve të vjetër të shqipes*". Edhe studiuesi Klosi ka bërë një përjasje midis të folmes së Buzukut dhe të folmes së Reinholdit. Kështu, përmes këtij krahasimi, filtrojmë më poshtë disa dukuri të përbashkëta leksikore **midis të folmeve në fjalë dhe çamërishtes së sotme**, konkretisht.<sup>244</sup>

*Botë ( dhe), çep ( sqep), dreq( drejt), nglaturë( shtrirë), nguq( skuq), fëmilë ( R.-fëmiljë: familje), glanë ( ngjanë), gjator ( gjahtar), gjegj ( dëgjoj), nuku ( R. nëkë: nuk), njegulli ( R. mnjegull: mjergull), parë ( përpara), pluhurë (R. plëhurë: pëlhurë), pishq (peshq, -tek çamët në Çamëri), qesh ( vë në lojë), thom ( them), u (unë), u-ja ( urija)* etj.

Një toponim interesant që i përbashkon arvanitasit dhe arbëreshët, për rrjedhojë dy të folmet përkatëse si dëshmuese të fazave të kapërcyera të shqipes, është

<sup>241</sup> Për më tepër shih tekstet nga çamërishtja në fund të punimit.

<sup>242</sup> Kemi të bëjmë me një konceptin fetar të fjalës dhe, nuk mendojmë se duhet futur në këtë kategori emrash.

<sup>243</sup> Klosi, A. Po aty f.26

<sup>244</sup> Theksojmë se, renditja e fjalëve të njëjta në këto tri të folme behet për të treguar lidhjet e afriisë midis tyre, por në tekstet e Reinholdit shohim shumë fjalë të tjera të ngjashme me çamërishten, të cilat nuk i kemi nxjerrë në pah, pasi kjo nuk lidhet me synimet bazë të punës sonë.

konkretisht Shën Mitri i Koronit,- një emërtim i ruajtur prej arbëreshëve të Italisë së Jugut me origjinë Morenë (Peloponezin e sotëm në Greqi). Ky toponim, ndër të tjera është një element historik, që tregon prejardhjen e vërtetë të shumicës së arbëreshëve të Italisë së Jugut. Siç e lartpërmendëm, sipas të dhënave dhe dokumenteve historike, tregohet se arbëreshët, bij të tokës arbërore, ndodheshin në këto zona për t'u shërbyer perandorëve bizantinë, pasi ishin luftëtarë shumë të mirë dhe trima. Ka të dhëna se ata janë vendosur aty rreth viteve 1200, domethënë 200 vjet para se të largoheshin prej andej, për t'u vendosur në Italinë e Jugut, duke e vlerësuar More-ne si atdhe të tyre. Prej këtyre vendeve, pikë referimi është Koroni, i cili ndodhet në Messini-Peloponez të Greqisë, ku ndodhet edhe sot e kësaj dite Kalaja e Koronit. Prandaj edhe arbëreshët e larguar prej andej, kanë ruajtur toponimin e tyre, duke e quajtur njërin prej qendrave më të rëndësishme dhe komuniteteve më të mëdha arbëreshe: Shën Mitri i Koronit-San Demetrio Corone.<sup>245</sup>

Bëmë këtë sqarim të shkurtër, pasi morëm shkas nga përqsaja që studiuesi i bën me të drejtë të folmes së Lekë Matrëngës me atë të shqipes së Peloponezit perëndimor.

Lekë Matrënga (1560) , ishte nga Hora e Arbëreshëve në Sicili, një ngulmim i krijuar në vitet 1480 me kolonë të ardhur nga Shqipëria<sup>246</sup>, por i shtuar sidomos në vitin 1534 nga një shtresë e dytë që vinte prej Peloponezi, më saktë prej Koronit.<sup>247</sup> Veçojmë përsëri **dukuritë e përbashkëta të dy të folmeve me çamërishten**. Ndonëse kësaj radhe numri i fjalëve është më i paktë, bashkëpërkimet nuk mungojnë. Të tilla fjalë të përbashkëta midis dy të folmeve janë:

*Botë* ( dhe) *glas* ( ngas), *helmonem* (helmohe), *ishtë* ( është), *klënë* ( qënë), *psonj* (M. mbsonj, R. mbsonj, mpsuaritë,- mësoj), *nuku* (M/R. nëkë, nuk), *përzierë* ( takuar) *pra* ( pasataj), *rerazë* ( gënjeshtër), *sherti* ( M. sherëtinj, R. sherëti, psherëti), *dergjej* ( lengonte), *thom* ( them), *u* ( unë), *u-ja* (urija), *vashëzë* (vajzë), *vetëhe* ( veten), *jatri* ( barë, ilaç, në çamërishte kemi edhe jatro<sup>248</sup>,- mjek), *kurm* (trup), *pisë* ( i zi sterr).

**Disa bashkëpërkime midis të folmes së Marko Boçarit, shqipes së Peloponezit perëndimor dhe çamërishtes së sotme:**

*Brekth* ( B/ R. brëtek, bretkosë), *botë* (dhe), *dej* (në çamërishte kemi nestër , dej, kasdej/ nesër, pasnesër, mbipasnesër); *dergjem* (B. derkem), *djelm* (djem), *dreq* (drejt), *gjator* ( gjahtar) *gjeqem* ( dëgjohe), *gjikonj* ( gjykoj), *hje* (B/ R he h-ja e fortë ( X) e greqishtes); *ledh* ( mur); *marrësonem*(R. marësirë), *bledh* (B/R. mbëledh)bërna ( B. bërtë; R. mbërda), *brazëtë* ( B. mbrazurë; R. mbrazëtë), *bretëlë* ( B. mbretëlë; R. mbretëlië); *menatë* ( B. R: mëngjes; çamërisht natën), *mëlshi* (mëlçi), *pësuarë* ( B. mbësuarë; R. mbësuarë/ mpësuarë), *nguç* (skuq), *pluhurë* ( B/R. plëhurë), *plasëlë*( B.R. plasëljë), *rëposh* ( përposh), *zgliedh* ( zgjedh), *shëndre* ( dhjetor), *shkepëtimë* ( në çamërishte sot fjala përdoret edhe me kuptim të figurshëm u.. i raftë shkepëtimë i raftë) *shtuar* ( rrinte më këmbë), *thom* ( them) , *u* ( unë), *u-ja* (uria), *val* ( vaj), *vartur* ( varur), *vashaztë* (vajzat), *vdekëlë* ( e vdekur fare), *veshël* (B.R. veshëljë).

Huazimet greke janë të shumta në gjuhën shqipe dhe, nga historia e gjuhës shqipe kemi mësuar se rrjedha kronologjike e tyre i përket periudhave të ndryshme, për rrjedhojë ato i gjejmë në të dy dialektet.

<sup>245</sup>Jeronim De Rada, -*kushtuar 107 vjetorit të vdekjes së poetit arberesh*, në [ceb.arberiaonline.com](http://www.ceb.arberiaonline.com)

<sup>246</sup> Përveç studiuesve të huaj këtë fakt e përmend edhe çabej kur studion huazimet greke në gjuhën shqipe.

<sup>247</sup>Klosi, A. Po aty

<sup>248</sup> Shumë fjalë të tjera si kjo janë huazime greke në të tre të folmet.

Sipas prof. Çabejt<sup>249</sup>, pjesa më e madhe e këtyre huazimeve gjenden në toskërishte, sidomos në pjesën më jugore të saj. Të pasura me elemente greke janë edhe dialektet arbëreshe të Italisë jugore, të Siçilisë, tek të cilat gjenden greqizma që nuk i gjejmë edhe në toskërishte. Sipas këtij studiuesi së pari, shumica e kolonistëve kanë ardhur nga Jugu i Shqipërisë, së dyti një pjesë e tyre kishin shkuar më parë nga Shqipëria në Greqi, dhe prej andej kaluan në Itali.<sup>250</sup> Greqizmat sipas Çabejt ato i morën edhe në Itali, nga dialektet greke (o italiane) që i rrethojnë, mbeturina të fundit të kolonive të vjetra greke. Por, sipas tij, më të thellin ndikim të greqishtes nuk ka dyshim se e kanë ndier dialektet shqiptare të Greqisë, të cilët janë atje që nga shekulli XIV dhe rrojnë si ishuj gjuhësorë<sup>251</sup> brenda mjedisit grek. Madje autori përmend edhe një fakt tjetër të rëndësishëm që ka të bëjë me ndikimet “anas”: *Elementi shqiptar është përhapur në krahina të ndryshme të kontinentit grek e të ishujve të tij.*

Për rrjedhojë një ndër problemet madhore të një gjuhe rrjedh prej kontakteve të saj me gjuhë a të folme të tjera,. Sikurse shqipja në shekuj është kontaktuar nga gjuhët fqinje në faza të ndryshme të jetës së saj duke filluar që me ilirishten dhe kontaktin e saj me trakishten greqishten makedonishten etj.; ajo jo vetëm është ndikuar, por është vërtetuar prej studiuesve që ajo edhe ka ndikuar në to. Është e pamundur që një gjuhë vetëm të preket, por dashur pa dashur ajo edhe prek.

Një gjë të tillë e kemi vënë re edhe tek bashkësia çame.<sup>252</sup> Kështu, edhe për sa i përket çamëve të grupuar (ne kemi çamë të grupuar por edhe çamë më vete, më të paktë janë këto të fundit) jo vetëm janë ndikuar por edhe kanë ndikuar tek banorët anas.

Duke iu rikthyer çështjes, disa prej greqizmave të përbashkëta të të folmeve të filtruara prej Klosit, fliten ende në çamërishten e sotme. Përmendim disa prej tyre:

*aguridhe* (e papjekur), *allonar* (korrik), *dhaskal* (mësues), *dhimon* (R/ B. dhemon, - shosh), *dhipllo* (dyfish), *fahji* (h-X, B. /R: faji/fagi,- gjellë), *farmëk* (e hidhur), *kallmar* (B./ R. kallamar,- lloj ëmbëlsire), *kallathe* (shportë), *karfos* B./R. mbërthej, gozhdoj; çamërishte qepje me gjilpërë të madhe gjëra të trasha: *i karfosa dushekët*), *kurm* (trup), *lavomë* (plagë, nuk shihet me sy), *migladhë* (B./R: migdhale), *nikoqir* (i zoti shumë), *pis* (skëterrë), *qerdhes* (fitoj, e qerdhese- e fitove), *taks* (taks diçka dikujt).

Nga e gjithë kjo përfaqje na tërheqin vëmendjen edhe disa fjalë për të cilat mendojmë se dikur në çamërishte mund të kenë qenë njëlloj si në të folmet e Buzukut, Reinholdit, Boçarit etj, por që sot në këtë të folme ato kanë ndryshuar sipas shqipes së përgjithshme. Kështu është rasti i fjalës *qell*, të cilën në çamërishte e gjejmë në trajtën *sell* (shqip folja sjell), *shtrenjtirë / të shtrenjtëtë*; në çamërishte: *ngursier* (i kursyer, kursimtarë), *fufjuakë/ fufuvajkë*; në çamërishte: *kukumjaçe* (kukumjaçkë); i halkomtë; në çamërishte, *bakwër* (bakër); amarti: në çamërishte: *gjunah* (gjnah, mëkat) etj.

Këto elemente janë dëshmi e qartë e lidhjes së vjetër midis arbëreshëve të Horës dhe vendit të tyre të hershëm Moresë, përveç këngës së famshme “Moj e bukura More”. Kjo është edhe arsyeja pse mendojmë se pikëtakimet më të mëdha çamërishtja i paraqet me të folmen e arbëreshëve të Horës në Siçili.<sup>253</sup> Siç shprehet edhe A. Klosi se “dialektet arbëreshe të Italisë afrojnë në shumë pika me shqipen e

<sup>249</sup> Çabej, E. *Studime Gjuhësore*, f. 98, Rilindja, Prishtinë 1976.

<sup>250</sup> Dëshmi e largimit të arbëreshëve mbetet kënga “Moj e bukura More”, vënd të cilit grekët ia ndryshuan emërtimin, që përkon me Peloponezin e sotëm në Greqi.

<sup>251</sup> Term i përdorur shpesh edhe prej nesh për çamërishten

<sup>252</sup> Përdorim termin bashkësi gjuhësore duke iu referuar gjithmonë përkufizimit për bashkësinë të Lyons- it “*te gjithë njerezit qe perdorin nje gjuhe te dhene, ose dialekt.*” (John Lyons 1970, f. 326)

<sup>253</sup> Mendojmë se një punim më të thelluar midis këtyre të folmeve të bëjmë në të ardhmen.

Porosit e të Hidrës, për vetë faktin se një shumicë kolonësh vinin nga Moreja – siç e morëm edhe dëshminë gjuhësore nga krahasimi me Matrëngën<sup>254</sup>

Pas përjasjes së çamërishtes së sotme me të folmen arvanitase të Reinholdit, në planet tona për të ardhmen mbetet një studim i të folmeve ( të arbëreshëve, arvanitasve, dhe çamërishtes) në gjendjen e tyre të sotme statike; për të cilin mendojmë se do të shkojë drejt një monografie më vete.

## **2.4. Bashkëpërkime midis çamërishtes dhe të folmeve arbëreshe**

### **2.4.1. Disa dukuri të ngjashme midis çamërishtes dhe të folmeve arbëreshe**

Çabej mbron mendimin se si arvanitishtja ashtu edhe arbërishtja i përkasin toskërishtes jugore, me pika të shumta takimi me labërishten dhe çamërishten, por ai thotë se “ *me barazim arbërisht- toskërisht nuk shpjegohet gjithçka në këtë problematikë. ... Aty ka vënd për diferencime nga më se një pikëpamje....*” Megjithëse: “*masa dërrmuese e themeluesve të ngulimeve arbëreshe rrjedh prej bregdetit ç’mban*

---

<sup>254</sup> Reinhold. C. H. T. *Këngë popullore të arbëreshëve të Greqisë* “Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar”, Instituti i Folklorit, 1961; Klosi, A: *Netët Pellazgjike të Karl Reinholdit* ( Tekste të vjetra shqipe të Greqisë mbledhur nga Karl Reinholdi 1850-1860, f. 40, (K&B), Tiranë, 2005



*afërsisht prej anëve të Vlorës deri në anët e Prevezës në Çamëri dhe prej Hinterlandit përkatës.”*

Që masa dërrmuese vjen prej bregdetit duket qartë nga bashkëpërkimet midis të folmeve arbëreshe dhe çamërishtes. Sidomos kur bëhet fjalë për krahina të tilla për të cilat vetë faktet historike bëhen dëshmuere e këtyre bashkëpërkimeve. Sikurse e përmendëm edhe në studimin për arvanitishten, bashkëpërkimet më të mëdha çamërishtja i shfaq me të folmen e arvanitasve, ndërsa përta i përket të folmes së arbëreshëve, afrinë më të madhe ajo e shfaq me të folmen e atyre trevave që i përbashkon jo vetëm i njëjti fat historik, por edhe i njëjti ngulmim i përbashkët i dikurshëm.

Kujtojmë edhe një herë fatin e arbëreshëve të komunitetit arbëror të Shën Mitrit të Koronit- it dhe fshatrave që ndodhen përreth tij në Kalabri (Jug të Italisë)<sup>255</sup>, si dhe ngjashmëritë gjuhësore midis çamërishtes dhe të folmes së arbëreshëve të Horës, të cilat i trajtuam pak më lart<sup>256</sup> në temën për arvanitasit e Greqisë për arsytet që i lartpërmendëm. Kjo trevë ndërkaq, duhet parë jo vetëm si vatër , por edhe si një kryeurë prej nga mërguan edhe ardhës nga vise të tjera shqiptare (qëndrore apo veriore).<sup>257</sup>

Kjo nuk do të thotë që në çamërishten e sotme nuk gjejmë pika takimi midis saj dhe të folmeve të tjera të diasporës shqiptare në Itali. Mendojmë se përveç faktit historik të Moresë, një tjetër arsye e fortë e këtij bashkëpërkimi mbetet fakti që këto të folme i përbashkon i njëjti emërues i përbashkët,- ruajtja e fazave të kapërcyera të shqipes. Nga ana tjetër, shqiptarët, arbëreshët apo arvanitasit kanë të përbashkët faktorin jashtëgjuhësor të shpërnguljes, megjithëse motivet e kësaj shpërnguljeje janë të ndryshme.

Lamerci arriti jo vetëm të bënte përshkrimin e të folmeve arbëreshe të Molizes, por edhe depërtoi në hollësitë e të përbashkëtave dhe të diferencimeve të tyre.... Sipas tij këto të folme pavarësisht nga disa dallime e diferencime, kryesisht të pjesshme ndërmjet tyre, përbënin një tip dialektor që afrojnë me toskërishten.<sup>258</sup>

Sigurisht nuk mbështesim kurrësesi mendimin se arbërishtja është një formë dialektore më vete, por mendojmë se kemi të bëjmë me një variant të një të folmeje. Nga ana tjetër edhe ky mbete një emërtim konvencional nëse do t'i referoheshim *fondit të saj kryesor të krijuar nga elementi i sjellë me vete.*

Më poshtë po japim shkurtimisht tri tekste dhe, menjëherë në pamje të parë kemi nënvizuar aty dukuritë e përbashkëta që vihen re.

### **Nga Reinholdi<sup>259</sup>**

*Prindi me **tri vashazë**, edhe mbreti.*

<sup>255</sup> Prej këtyre vendeve pikë referimi është Koroni, i cili ndodhet në Messini-Peloponez të Greqisë, ku ndodhet edhe sot e kësaj dite Kalaja e Koronit ([www.arberiaonline.com](http://www.arberiaonline.com))

<sup>256</sup> Në të njëjtin punim: *Ngjashmëri midis të folmes allvanitase dhe asaj arvanitase ( Dukuri të përbashkëta gjuhësore midis teksteve të Reinholdit dhe çamërishtes së sotme)*, f. 18

<sup>257</sup> Shkurta, Gj. “Ligjërimet arbëreshe” ( shqyrtime dialektologjike dhe sociolinguistike në ngulimet arbëreshe të Italisë), Tiranë, 2006.

<sup>258</sup> Shkurta, Gj. Po aty f. 125

<sup>259</sup> Reinhold. C. H. T. *Këngë popullore të arbëreshëve të Greqisë* “Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar”, Instituti i Folklorit, 1961; Klosi, A.: *Netët Pellazgjike të Karl Reinholdit*, (Tekste të vjetra shqipe të Greqisë mbledhur nga Karl Reinholdi 1850-1860”, përralla, f.177), (K&B), Tiranë, 2005.

**Ish** një hérë një print, e **kish tri** vashazë të pa-martuame. – e ashtu **mbréti** i tîre atë vit **griti** luftë me një **tiatrë** mbrét e **kërkon** nga mbretëria e ti', të **mbëlidh** trima: - **kërkoj** edhe **t'a'në këtime** vashëzavet, prë të vëj ndë luftë. E ashtu, i vreruarë **vate** ndë shtëpi të **tia**, e rri, ndë një onda i helmuarë. Atié **vate** vaiza e parë, e i thotë: “ pce rri, tatë, kaqë i helmuarë? – çë ke? – ai i thotë: çë të të thém, vashëzo!.”<sup>260</sup> mbreti ka luftë , e më **ftoj** edhe mua të vete.” – Ashtu prëgjëgjhetë vaiza e i thotë: “ **të vesh** e të mos prirhesh!: **ù** thojë, mos çove **donjë** burrë, të më martonje?” – Edhe iku.

-Ashtu me një çikë **vate** e **mesmea**, e i thotë: “tatë!, çë ké? Çë rri i vreruarë?”

-Prindi i thotë: “çë më **pien**? Ashtu më **piejti** edhe é-ot motrë e madhea, e i-a thashë, e më **shaiti**: -çë do edhe ti , çë kërkon? **Limëni** të më diegë pika .” -“ Jo tatë, i thotë ajo, nëkë të **shanj**, po të të shëronj ato çë ke”- Prindi i thotë: “ ashtu tha edhe aio nd'arhis; po më **shaiti** .”- “Né, tatë, po **ù** s'të **shanj**.” –Ashtu i thotë prindi : “ na! Ce çë kam: **mbréti** ka luftë e më kërkon edhe mua **të véte**, e jam i vreruarë, ku t'u lë juve.” – **Prëgjëgjhetë** vaiza e i thotë : “ **të vësh** e të mos prirhesh: **ù thojë** , mos **jéshe** i vreruarë, çë s'munt të ço'sh **donjë** burrë prë mua.” – e u **ngré** e iku. **Véte** edhe e trëtëtea **vaizë** e i thotë: “ tatë, pce ri kaqë i vreruarë? Nëkë më thua? “- i thotë prindi : çë të të thém, vashëzë, çë edhe të tiëravet motravet t'ënde e thashë, po më **shaitinë**: - ashtu do më sha'sh edhe ti: po ikë!” – “Jo, i tha prindi. – i thotë vaiza. “tatë, po të të **shanj**, si ato, s'jam vaiza é-otë”: - uratënë t'ëndë edhe tri të vëshura **burrërishte**: e **ù** véte prë ti.”- Ashtu prindi i dha **tri** të vëshura burrërishte edhe **uratënë....** etj.

### Çamërishte

Na **ish** një plakë dhe një plak// na kishin një djalë pesmet vjeç// Djali na **she** një **nëndër** një natë/ **hënzën** në krahë të djathtë e djellin në krahë **të mënjër**. Në saba **grihet** u thotë babajt e nanës/ kam parë një **nëndër u** tha/ thuejna i thanë ata/ nuk **ua thom**// e shtërguan shumë / se nuk i thanë **hair** ata/ zunë e rrahinë/ djali iku/ hë këtu/ hë atje/ kudo që i thoshin thuaje nuk e **thosh**/ se nuk i **thosh** njeri **hair**// arrin e **vate ne breti**/ aq e shtërnguan mileti // pse të rrahin bota i tha **breti** / se kam parë një **nëndër** e nuk ja **thaçë** ø gjithëve //nuk ua the/mua do **t'm'e thesh**/ po edhe **breti** nuk i tha **hair**// do **m'e theç** se do të vë në haps// le të më veç/ nuk ta **thom**// e mori e vuri në hapsane// atje nek e vuri në haps **përsiprazej ish vajza** e bredit// i jati nuk e kish parë **çish kish** vënë jati poshtë/ ashtu bëri/ e hapi **qepengjinë** e sheh atë atje// pse je **kutu** oreee/ i tha / këtu më ka vënë **babaj it** / i tha // pse të ka vënë në burg/ nuk e di i tha djali// djali pa **gënë** pa pirë atje ai / **ka** ligësia ajo kur i **shpii** bukën i jati asaj/ ajo i **lii** ka një çikë pjesë **të haj** / breti e vuri djalin atje e harroj **çish kish** vënë atje// një ditë e ka ditë i dërgon Moskovi **bretit**: **ù** do të dërgoj di kobëza mollë / po i njohe **çila isht** e **vjemea çila** e **sivjemea** nuk do hapim luftë / ndrishe do të hap luftë // edhe **qi** u murzit se nuk i **njuh** dot **çila ish** e **vjema** e çila e **sivjema**// vajza i tha: ç'ke baba që je **sellkëdisur**// A moj vajzë **kutu** e **kutu**/ më ka dërguar Moskovi// u **mërzit** edhe vajza / e **vate** në dhomën e saj e e harroi edhe djalin pa pjesë buke// të vesh t'i **thesh** babait po mos ja thuaj që të thash **ù**/ të marri një kazan me ujë e t'i hedhi/ ajo që ø **të vejë** në fund është e **sivjema**/ ajo që do **betet bi** ujë është e **vjema**// **breti** e bëri këtë e ja dërgoi **bretit** të Moskovit// për **di** tre muaj i dërgon prapë **breti** i Moskovit/ do të dërgoj di pela po i njohe çila **isht** nana/ çila **ishtë bila**/ nuk kemi luftë / **drishe** do nis luftë// **vate** vajza e sheh t'anë të mërzitur// pse je mërzitur prapë baba i tha/ **kutu-kutu** i tha ai/ ku do i njoh **ù** këto i tha babai/ edhe **ka** boj edhe **ka qima** jan **barabar**//

<sup>260</sup> Në këtë tekst kemi respektuar shenjat e pikësimit të autorit.

iku vajza e mërzitur e e harron pa bukë djalin// pse më harrove pa bukë i tha djali/ kutu kutu i tha vajza djalit// i thotë djali **t'i theç** babait/ veri **di** pelat në avlli/ të veri pajtarët t'i rrahi pot e pot e pot/ do ø **dersinë** ato/do ø vejë e **bila** t'i veri hundët në gji ø s'ëmës/ babai t'i veri **simadhin** e t'ia **dërgoj** Moskovit..... etj.

Në këto dy tekste përveç dukurive të përbashkëta, na tërheqin vëmendjen edhe disa dukuri të tjera të cilat duken paksa të diskutueshme.

- Grupet e bashkëtingëlloreve *mb, ng, nd* tek teksti i Reinholdit nuk janë asimiluar, ndërkohë që në çamërishte kjo dukuri shfaqet qartë d.m.th: *mb, nd, ng > m, d, g*. Në mënyrë më të detajuar mund të themi se në tekstin arvanitisht grupin *mb* e gjejmë të paasimiluar; grupin *ng* herë të asimiluar, herë jo; grupin *nd* e gjejmë të asimiluar.
- Një tjetër dukuri për të cilën mendojmë se përbën risi në këtë të folme është shndërrimi i zanores *-i* në gjysmëzanoren *-j* (*kërkoj/ kërkoi; ftoj/ ftoi*), kur ajo ndodhet pas një zanoreje tjetër. Edhe në çamërishte kemi: *dërgoj, babaj, vajza*). Ndër të tjera, shfaqja e kësaj dukurie në çamërishte, mendojmë se ka të bëjë thjesht me ligjërimin e përditshëm.
- Në të njëjtin kontekst, për çamërishten vërejmë se ekziston tendenca e mospërdorimit të pjesëzave (të lidhore, të së ardhmes, nyjat e gjinore etj.). Kështu vërejmë trajtat: *ja thaçë (të) gjithëve; ajo që (do) të vejë në fund; do (të) dersinë ato; do (të) vejë e bila; t'i veri hundët në gji (të) s'ëmës; drishe do (të) nis luftë etj.*

Lidhur me këtë të fundit, në një kumtesë të studiuesit Haki Ymeri në të cilën trajtohej problematika: “Standardi nuk duhet ndërruar, por duhet ndryshuar”, ndër të tjera autori ngre problemin e së ardhmes, sipas të cilit pjesëza *do* është më se e mjaftueshme për të ardhmen...etj.

Siç e dimë, jo vetëm shqipja e vjetër, por edhe shqipja e ligjërimin të sotëm të përditshëm shfaq probleme në përdorimin e pjesëzave. Lidhur me këtë dukuri megjithëse paksa jashtë teme mendoj se, jo vetëm fjalët e një gjuhe, por edhe dukuritë e saj, me kalimin e kohës mund të bëhen pjesë e fondit pasiv të gjuhës. Nëse një fjalë apo dukuri e caktuar në varësi të konteksteve të caktuara ose jo ka qenë zhvillim i mëvonshëm i saj dhe më vonë zgjedh përsëri të kalojë në harresë<sup>261</sup>; një gjë e tillë ndodh pasi vetë gjuha e ndien një nevojë të tillë. Ky është vetë ligji i gjuhës. Herë pas here ajo ndien nevojën e kthimit në origjinë. Duke qenë në të njëjtin mendim me studiuesin në fjalë, mendoj se standardi nuk duhet “ngurosur”, por duhet të respektojë disa zgjedhje të lira të vetë gjuhës, nëse ato nuk janë të dëmshme.

Tek tekstet që (në mënyrë sipërfaqësore) po i analizojmë, nuk bëhet fjalë për shkelje në normë. Në dy tekstet e mësipërme, vemë re përdorimin e numërorit **tre** sipas gjinisë së duhur, si në çamërishte (*tri vashazë*, - Reinholdi) dhe përdorimin e trajtës së shkurtër **u** sipas rregullave drejtëshkrimore (*kam parë një nëndër u tha*, - çamërisht). Këtody dukuri në masën më të madhe të shqipfolësve sot nuk përdoren saktë, madje mospërdorimi i saktë i tyre vihet re edhe tek shkruarit me një farë përvoje.

Megjithatë lidhur me nënvizimet e bëra në tekstet përkatëse, si edhe me shembujt e trajtuar në veçanti, arrijmë në të njëjtin përfundim se, **për të folme të tilla nuk mund të arrihet në përfundime të sigurta përsa i takon arkaicizmit të secilës, pasi edhe zhvillimet e secilës prej tyre janë bërë në kontekste të tilla që**

<sup>261</sup> Një shembull i tillë tipik janë edhe fjalët leksikore të fondit fetar.

## kanë motivuar në mënyra të ndryshme dhe të pakushtëzuara zhvillimet brenda të folmeve.

Nga këto tekste vërejmë afrinë midis çamërishtes së sotme dhe arvanitishtes, megjithëse midis tyre dhe të folmes së arbëreshëve ekziston një farë diference.

Për të parë ndryshimin, po japim edhe një herë një tjetër material nga arvanitishtja, duke shënuar disa fjalë apo dukuri që i hasim ende sot në 2011-ën në çamërishte, si dhe duke vijuar më pas me një tekst nga arbërishtja e ditëve të sotme.

Vijojmë me tekstin e tretë

367

**Diqe**, e pse kaqe shpejt?  
Ç'u **dhiase** e shkove?  
Thuaj, përse pate keq?  
**Jeshe** ngusht' a në nevolë,  
Këceje e preje **dhromë**;  
**Jeshe** pa aspër ndë qese,  
Dalje dhe këputje qese,  
S'**keshe** ti? E, pun' e madhe;  
**Keshën** bota dhe ti marrje.

368

Të trembeshin bota gjithë,  
ç'pate që **dique**?  
Ç'pate që diqe, armiqtë do lëshojnë **dhënt'** pa frikë.  
**Keshe** hijenë të rëndë,  
gruaja qiri në këmbë.  
Fjala dysh nuk t'u bë kurrë,  
s'**jeshe** burrë si çdo burrë.

369

Diqe, **vate** nd'atë jetë,  
**Vate** puna jote, vate!  
Po thuaj Shën Pjetrit vetë  
Paradhisin të ta çeltë.  
**Piete** ani, ç'**bënetë**  
me turqit atje, me qentë:  
t'i ketë a mos t'i ketë  
ndë **pisë** thellt' e më thelltë  
që na cfilitënë dreqtë!<sup>262</sup>

Arbëreshët e Italisë <sup>263</sup>

### Prallëza e pëlhurës

<sup>262</sup> Sipas A. Llalës, vajet i drejtohen një burri të vdekur në një nga fshatrat arbëreshë në Greqi, mbledhur këto nga Franku La Guiletieri në vitin 1669.

<sup>263</sup> Costantina, Florio. *Prallëza e pëlhurës* (nga Qefti), në revistën tremujore "Jetë Arbëreshe", 61/Janar- Mars 2009., f. 10

Ishi një herë një horë e vogël ku gjithë njerzit **shurbejën**. Burrat **vejën** jasht e **punojën dherat** e grat **bëjën shurbisat** e shpisë e edhe **shurbejën** me argalinë për të bëjën pëlhurat. Te një bukur shpi me muret të zbardhura e me një **parathire** plot me lule, rroji një 0 bukur vajzë, çë ishi nuse e re e **kish** martuor një trim i mirë, punëtor e i **pafolur**.

**Ki** burrë i **kish** blerë për dhuratë së shoqes një **argali**, ashtu kur ai ishi e punoju jash, ajo mund shkoi në me atë tua menduor të shoqin e tua bërë ndonjë pëlhurë për shpinë e **tire**.

Te të parët ditë nusja zuri fill të shurbei pëlhurën te argalia; pas pak ditë pa ke lodhshi shumë e ng' i **pëlqejti** më të bëji atë shubërtirë e kishtu çdo ditë tiri dica e jiki jash: nani veji e gjeji shoken e saj m' e ngushtë për të shihi çë bëji; pas shkoju te kumbari për të diji si ndjehëshi; pas shkoju te ndrikua për të bëji një **dorëz** këshill, ashtu i shkoi dita e bëshshi natë.

I shoqi pa ke te argalia pëlhura ngë rritëshi, atëhera një mbrëmë e **pjesi** nusen psë ngë rritëshi ajo pëlhurë. E e shoqja shpejt ju përgjegj:

-Gjindjet të liga më morën shishë, për këtë pëlhura ngë ecën! Ka **vete** te kisha e ka parkalesinjë Zotin të më nxjerr shishën.

E ashtu bëri e **zuri të veji** te kisha kur ng' ishi mosnjari. Te kisha, te dora e djathtë ishi një kriqe e madhe me Krishtin të vdekur, e nusja, sa hiji, i përgjunjëshi përpara e i tjoji:

- Krisht oj, të më rritet pëlhura! Krisht oj, të më rritet pëlhura!

E rriji orë e orë të thoju ashtu. **Sakrëstani** çë e njih mirë e **diji** kush ishi ajo, do dini çë bëri një **menatë**? I pari ke kjo popa të përgjunjëshi përpara kriqes e **zëji fill** të lipi ke t' i rritëshi pëlhura, ai u fsheh prapa Krishtit e, pas çë ajo kish bëjtur pjëthjen e saj, ju përgjegj e i tha:

- shurbë, shurbë, ashtu pëlhura rritet!

Nuses ng' i **pëlqejti** përgjegja e krishtit e tha:

- për këtë të vuren te kriqa! Për këtë gjuhë e ligë çë ke!


E kishtu jiku si varë e ng' u pror prapë mangu **për të bëji** kriqën kur erruri te dera, para ke të dili te kisha. E verteta ngë mund thuhet, pse mosnjari do t' e **gjegjinj**.

Sikurse e vërejmë edhe me anë të kësaj pjese, bashkëpërkimet midis të folmes së çamërishtes dhe asaj arbëreshe nuk mungojnë, por siç shihet edhe nga vetë teksti, ato janë më të pakta në numër. Kjo shpjegohet edhe me faktin se kjo e folme i përket zonës së Qeftit. Nga ana tjetër, ilustrimet e mësipërme nuk mjaftojnë për të bërë një përjasje shkencore të mirëfilltë midis të folmeve, aq më tepër që vetë të folmet paraqesin diferencime të mundshme ndërmjet njëra- tjetrës që lidhen në radhë të parë me elementin që ato kanë sjellë më vete, siç pohon edhe prof. Shkurtaç: *dokumentet historike përmendin shtegtime drejt Italisë së shqiptarëve nga Kruja, Shkodra, Durrësi etj., na bindin se edhe mjaft trajta fonetike, morfosintaksore e, sidomos, leksiku i të folmeve arbëreshe, me përkimet e shumta që kanë jo vetëm me të folmet e toskërishtes jugore ( labërishten e çamërishten), por edhe me ato të gegërishtes, marrin vlerë për të faktuar atë proces të gjatë e të ndërlikuar të ndryshimeve e të përzierjes dialektore që kanë ndodhur në ato të folme në periudhën pas shpërnguljes së arbëreshëve e vendosjes së tyre në dhe të huaj.*<sup>264</sup>

Në të ardhmen mendojmë t' i lëvrojmë këto të folme në gjendjen e tyre statike, për të arritur përmes statistikave në përfundime konkrete rreth arkaicizmit të secilës si

<sup>264</sup>Shkurtaç, Gj. "Ligjërimet arbëreshe" ( shqyrtime dialektologjike dhe sociolinguistike në ngulimet arbëreshe të Italisë), Tiranë, 2006.

dhe risimit që ato sjellin duke shqyrtuar tek secila atë proces të tretë ekuilibruës midis të resë dhe të vjetërës, duke shqyrtuar faktorët jashtëgjuhësor për secilën etj. <sup>265</sup>



Për të plotësuar një boshllëk të trajtimeve të mësipërme, duke iu referuar përfundimeve rreth çamërishtes<sup>266</sup>, më poshtë nxjerrim në pah disa prej dukurive të përbashkëta midis çamërishtes dhe të folmes së arbëreshëve, përmes dukurive të nënvizuara nga prof. Shkurtaç në studimin tij të thelluar për të folmen e arbëreshëve. Në shqyrtimin që studiuesi i bën kësaj të folmeje shohim se dukuritë e çamërishtes gjenden gjithkund. Kështu na tërheqin vëmendjen:

- Mungesa e fonemës *y* dhe përdorimi në vënd të saj i fonemës *i*: *grika, frin, gjims, bin etj* (Lamberci<sup>267</sup>, Demiraj<sup>268</sup>, Solano<sup>269</sup>, Altimari<sup>270</sup>)
- Ruajtja e grupeve të vjetra *kl, gl*: *gluha, glishti, klisha, kliçi, kloft etj.*
- (Lamberci<sup>271</sup>, Demiraj<sup>272</sup>, Solano<sup>273</sup>)
- Ruajtja e tingullit *l* në fjalë të tipit *bilë, golë, ndëlesë etj*, dukuri kjo e cila paralelisht shfaq risi në të dyja të folmet: si në të folmen e çamërishtes ashtu edhe në të folmen e arbëreshëve të Horës.<sup>274</sup>
- Lidhur me dy dukuritë paraprijëse, si areale ruajtëse Solano konsideron edhe ruajtjen bashkëtingëllores *l* në grupet *pl, bl, fl, pl*: *plak, plëh, bluanj, blenj, flutur, flamur* (Solano<sup>275</sup>)
- E ashtuquajtura rasë vendore: *ndë dhet, ndë kamaret* (Demiraj<sup>276</sup>)
- Ruajtja e zanoreve të gjata në rrokje të hapur (*dhe: , gra: , shpi: , shi: etj.*) dhe të mbyllur (*bi: r, mi: r, shka: l, pa: l etj.*)

Në këtë pikë jemi plotësisht dakort me mendimin e Jakobsonit se në këtë të folme dhe në të folmet e tjera arbëreshe kemi një dukuri prozodike “pertinente”, por jo “distintive”, pasi ajo mbart vetëm përmbajtje shprehëse ose emotive në komunikimin gojor<sup>277</sup>; të njëjtën dukuri vërejmë edhe në çamërishte. Këtu flitet

<sup>265</sup> Pra një punimi cilësor dhe sasior

<sup>266</sup> I referohemi kryesisht kapitujve: fonetik, morfologjik dhe leksikor

<sup>267</sup> Sipas Shkurtaç, Gj: *Kërkimet e M. Lambercit rreth të folmeve arbëreshe të Italisë*, në “Ligjërimet arbëreshe” f. 126, Tiranë, 2006.

<sup>268</sup> Shkurtaç, Gj: *Shaban Demiraj për dialektologjinë arbëreshe*, në “Ligjërimet arbëreshe” f. 134, Tiranë, 2006.

<sup>269</sup> Shkurtaç, Gj: *Ndihmesa të F. Solanos për të folmet arbëreshe të Italisë*, në “Ligjërimet arbëreshe” f. 140, Tiranë, 2006.

<sup>270</sup> Shkurtaç, Gj: *Ndihmesa e F. Altimarit në lëmin e dialektologjisë arbëreshe*, në “Ligjërimet arbëreshe” f. 142, Tiranë, 2006.

<sup>271</sup> Shkurtaç, Gj: Po aty

<sup>272</sup> Po aty

<sup>273</sup> Po aty

<sup>274</sup> Shkurtaç, Gj: *Shaban Demiraj për dialektologjinë arbëreshe*, në “Ligjërimet arbëreshe” f. 134, Tiranë, 2006.

<sup>275</sup> Shkurtaç, Gj: *Ndihmesa të F. Solanos për të folmet arbëreshe të Italisë*, në “Ligjërimet arbëreshe” f. 141, Tiranë, 2006.

<sup>276</sup> Po aty

<sup>277</sup> Shkurtaç, Gj: *Ndihmesa e F. Altimarit në lëmin e dialektologjisë arbëreshe*, në “Ligjërimet arbëreshe” f. 145, Tiranë, 2006.

për atë dukuri që fillimisht është trajtuar nga Q. Haxhihasani në studimin për të folmen e çamërishtes të cilën e ka quajtur “theks sintaktik”: *ku do të vesh more dja:l?; ai është nj-burr i mi: r* ( arbërisht, - sipas Altimarit).

- Përbashkësia e diftongjeve ngjithës: /aj/: *pstaj* (çamërisht: *psaj*); /ej/: *vej, atej; /ij/: pij, frij; /ëj/: bëj, vëj, xëj* etj.<sup>278</sup>; diftongut zbritës *ue: kuelj* (çamërisht, - *kuel*); shqiptimi i grupeve zanore *ua, ie, au, eu, iu* në dy rrokje të veçanta: *thua, miell, shkau, rrëmbeu, siu.* ( E folmja e Maqit sipas F. Altimarit)
- Në përshkrimin e zanoreve afrikate që Altimari i bën të folmes së Maqit, më shumë sesa kjo dukuri na kanë tërhequr vëmendjen fjalët në të cilat ato duke u bërë objekt dukurish të ndryshme fonetike njëjloj si në çamërisht, p. sh: *xathur* (zbathur), *maçe* ( mace), *xheshur* (zhveshur), *xë* ( nxë, mësoj) etj.
- Frikativja velare e zëshme /gh/: *ghare* ( hare, gëzim), *shogh* ( shoh), të cilën e gjejmë edhe tek Solano: *gjugha, gha, shogh, bëghem*<sup>279</sup>, mendojmë se ka të bëjë me shkronjën greke *X* që e gjejmë edhe në çamërishte.
- Gjatë vëzhgimit të këtyre dukurive na tërheqin vëmendjen disa fjalë të ngjashme në formë me çamërishten si: *gjegjinj, thom, jatri* (ilaçe), *stisa* (ndërtova), *rist* ( të qeshurit), *rrusht* ( e folmja arbëreshe e Maqit)<sup>280</sup>
- Hundorja velare vetëm para mbyllores qiellzore të zëshme /g/, si: *nge* ( nge , kohë në dispozicion), *mëng* ( mëngë)

Megjithatë këto dukuri, por edhe të tjera lidhur me të folmet e arbëreshëve të Italisë i gjejmë të detajuara edhe në “Atlasin dialektologjik të gjuhës shqipe” (ADGJSH), prania e të cilave vërteton se “të folmet arbëreshe të Italisë paraqesin një strukturë fonologjike dhe morfologjike e sintaksore , po edhe leksiko-frazeologjike, të përbashkët në krahasim me njëra tjetrën, dhe, të gjitha së toku, me atë të mbarë shqipes prej nga ato janë shkëputur prej kaq shekujsh”<sup>281</sup>. Përmes kësaj veprë të rëndësishme për gjuhësinë dhe gjithë shqiptarët “ na jepet mundësia për herë të parë t’i shohim të folmet arbëreshe jo në vetvete, por në gji të krejt sistemit të shqipes prej nga ato kanë dalë.”<sup>282</sup>

Në atlas gjejmë një sërë dukurish të cilat tregojnë se “të folmet arbëreshe përkojnë plotësisht me masivin më të gjerë të toskërishtes”<sup>283</sup> Po nga i njëjti tekst shtojmë edhe disa të tjera dukuri të përbashkëta midis të folmeve arbëreshe dhe çamërishtes të cilat i gjejmë tek pjesë nga monografia “Të folmet arbëreshe të Italisë”<sup>284</sup>

Tek e folmja e **Marçeduzës** vihen re këto bashkëpërkime<sup>285</sup>:

- Për sa i takon zanoreve verehen pothuajse të njëjtat dukuri midis të folmeve: mungesa e fonemës /y/; fonemat /a/, /e/, /i/, /o/, u në pozicione para dhe pastheksore janë të shkurtra edhe në çamërishte; të gjata vihen re ato kur janë të theksuara; fonema /ë/ në pozicion paratheksor ka të njëjtën prirje edhe në çamërishte, të kalojë në /i/ (kijo); edhe në çamërishte ruhet ende –ë-ja fundore: *bukënë, ditënë* etj.

<sup>278</sup> Po aty f. 146

<sup>279</sup> Solano f. 141

<sup>280</sup> Altimari F 148

<sup>281</sup> Shkurtaç, Gj. *Vendi i të folmeve arbëreshe të Italisë në izoglosat e ADGJSH- së*, në “Ligjërimet arbëreshe” f. 81, Tiranë, 2006.

<sup>282</sup> Po aty f. 82

<sup>283</sup> Për më tepër lidhur me këto dukuri shih po aty f. 83-89.

<sup>284</sup> Shkurtaç, Gj. “Ligjërimet arbëreshe” ( shqyrtime dialektologjike dhe sociolinguistike në ngulimet arbëreshe të Italisë), f. 151, Tiranë, 2006.

<sup>285</sup> Shkurtaç, Gj. Po aty, f. 153

- Në përbërje të fjalës spikat togu *ua* me theks tek *u-ja*: *dual, martuarë, ndërtuarë, grua, duamë* etj; *ie* me theks tek *i-ja*: *shërbier, krietë, ngrie (griçamërishte), thier, shklier* etj.
- Ruajtja e grupeve të vjetra *kl, gl*; përdorimi i trajtës së shkurtuar *u* të përemrit vetor “*unë*”<sup>286</sup>.

Tek e folmja e **San Marcanos** përveç dukurive në fjalë vihen re këto bashkëpërkime:

- Kalimin e *e-së* së theksuar në *-ë*: *dhëmb, brënda (bërna), gjëmb (glëmb), zëmbra* etj; kalimi i *-ë-së* paratheksore në *-u* dhe i *-o-së* së patheksuar në *-u*: *shurbej, kushtu; urizi* etj.;
- Ruajtja e gjatësisë së hershme të zanoreve të theksuara, sidomos tek rrokjet e hapëta fundore
- Ruajtja e gjinisë asnjane në disa fjalë si: *të parët, të klarët*
- Veçojmë disa paradigma zgjedhimi të formave foljore krejtësisht të ngjashme me çamërishten e sotme (të cilat nuk janë të vetmet):  
*U vata, ti vate, ai/ajo vati ; ne vatëm, ju vatët, ata/ ato vatën;*  
*u pava , ti pave, ai/ajo pavi; ne pavëm, ju pavët, ata/ ato pavën.*  
*U trëmbemë, ti trëmbë, ai/ajo trëmbetë; ne trëmbemi, ju trëmbeni, ata/ato trëmbenë.*
- Trajtat e se shkuarës në pësore: *u ka bënë*<sup>287</sup>
- Ngjashmëritë janë të shumta edhe tek ndajfoljet, parafjalët, numërorët, lidhëzat etj.<sup>288</sup>

#### Disa bashkëpërkime leksikore

Edhe në leksik vihet re një numër i madh fjalësh të ngjashme me të folmen arbëreshe. Po përmendim disa prej tyre:<sup>289</sup>

*Dhez, gjegj, dërsinj, duami, frin, glemb, glisht, klumusht, klič, krie, kushtu, ljip (lip), nguqet ( skuqet), nxiret ( nxihet), si, shomi, urja ( uja, uria), valje ( valë, vaj), ve: ( vezë), ble:t ( koshere), gjellë ( jetë), se di:j ( se dinte)*

Përqafojmë gjithashtu edhe mendimin e Demirajt sipas të cilit: “*Te folmet e katundeve arbëreshe të Italisë në përgjithësi kanë karakteristika gjuhësore të përbashkëta, por ato kanë edhe ndryshime midis syresh*”<sup>290</sup> Faktin e ndryshimit të dukurive të ndryshme ai e shpjegon me faktin e prejardhjes së shqiptarëve nga vise të ndryshme<sup>291</sup> “*Themelonjësit e katundeve Hora e Arbëreshëve , Pallac Adrianit etj., kanë qenë shpërngulur prej visesh të Shqipërisë , ku grupet e bashkëtingëlloreve **kl, gl**, në kohën e shpërnguljes së tyre ruheshin të paevoluara, kurse themelonjësit e katundeve të tjera si Makji, Shën Mitri, Mbuzati etj. kanë qenë prej visesh të Shqipërisë, ku këto grupe bashkëtingëlloresh në kohën e shpërnguljes së tyre kishin evoluar në q, gj.*”<sup>292</sup>

Autori sjell si shembull tiparin e ruajtjes së zanores **a** para bashkëtingëlloreve hundore në të folmen e Vakaricos që e diferencon këtë të folme nga të folmet e tjera; për të cilën edhe Erik Hemp megjithëse mendon se “*i përket grupit të të folmeve të*

<sup>286</sup> Në këtë të folme sipas autorit vihet re edhe përdorimi një trajte tjetër të përemrit vetor *unë* , trajta *ure*

<sup>287</sup> Edhe këtu pjesorja e foljes *bej* del njëlloj si në çamërishte.

<sup>288</sup> Shkurtaj, Gj.: po aty , f. 181.....

<sup>289</sup> Këtu kemi përfshirë edhe fjalët që dallohen nga tipare fonetike karakteristike të të dyja të folmeve.

<sup>290</sup> Shkurtaj, Gj. “Ligjërimet arbëreshe” ( shqyrtime dialektologjike dhe sociolinguistike në ngulimet arbëreshe të Italisë), Tiranë, 2006.

<sup>291</sup> Po aty

<sup>292</sup> Po aty



*toskërishtes.....*<sup>293</sup>, trajton tek kjo e folme tiparin e hundorësisë, konkretisht refleksin /ae/ të fonemës *a*, si divergjencë e kësaj të folmeje.

Nga e gjithë kjo analizë e vlefshme e prof. Shkurtajt, mendojmë se në këtë çështje mjaft delikate që vazhdon ende të kërkojë përgjigje, **duhet trajtuar problemi që në origjinë të shpërnguljeve**, pra faktori i përzierjes së shqipfolësve si pasojë e depërtimit të arbëreshëve matanë kufijve në faza të ndryshme kohore. **Ndofta këto elemente gege nuk janë gjë tjetër veçse refleksi e kësaj situate. Një gjë e tillë provohet përmes studimeve të thelluara që lidhen vetëm me një çështje të tillë.**

Arrijmë në këtë përfundim duke kujtuar gjithmonë se arbërishtja nuk është një formë dialektore më vete dhe as variant i një të folmeje, gjithmonë duke iu referuar *fondit të saj kryesor*, të krijuar nëpërmjet *elementit të sjellë me vete*.

#### **2.4.2. Një analizë rreth të folmeve arbëreshe dhe të folmeve anësore në tërësi**

“Përsa i përket nivelit të ruajtjes së gjuhës ...për aktivitetin tyre kulturor dhe shoqëror, në të cilin pasqyrohet e gjithë vetëdija kombëtare, për lidhjen e pandërprerë me vendin amë, një vend të veçantë zë diaspora arbëreshe e Italisë. Ato janë shquar dhe do të shquhen në përpjekjen e tyre për të ruajtur gjuhën mëmë, për krijimin e një letërsie origjinale me vlera të larta dhe për studimin gjithmonë e më të thelluar të së folmes arbëreshe dhe gjuhës shqipe në tërësi. Pjesë e këtyre përpjekjeve është edhe lëvizja aktuale gjuhësore dhe kulturore e arbëreshëve për të ruajtur vlerat kombëtare të trashëguara të traditës dhe, në veçanti përpjekja për të asimiluar sadopak gjuhën letrare kombëtare, një gjuhë e unifikuar dhe e përbashkët për të gjithë; duke e bërë atë mjet të pazëvendësueshëm të vetkonservimit etnik dhe në të njëjtën kohë, mjet të zhvillimit dhe të progresit në fushën e arsimit dhe të kulturës; duke ndjekur gjithnjë shembullin e traditës kombëtare.”<sup>294</sup>

Mendoj se, për të folmen e arbëreshëve gjithçka thuhet në këto rreshta.

Diaspora shqiptare kudo qoftë, kurdoherë është udhëhequr nga prirja për të ruajtur në radhë të parë gjuhën, kulturën dhe traditat e hershme të tyre dhe të parëve tanë. Ajo kurdoherë ka qenë dhe do të jetë përçuesja më e mirë e vlerave kombëtare.

<sup>293</sup> Po aty

<sup>294</sup> Kostallari, A.: *La diaspora albanese, il dialetto e la lingua letteraria nazionale unificata*, Kongresi I (4/7), Palermo 1985.

Në gjithë këtë prirje, rol vendimtar kanë luajtur ato faktorë të cilët ndonëse të jashtëm për gjuhësinë, kanë qenë gjithmonë mjaft të brendshëm dhe gjithmonë të pranishëm në jetën e tyre të përditshme. Për këtë arsye, është mjaft e rëndësishme që e folmja e arbëreshëve të trajtohet në aspektin sociolinguistik.

..Bota arbëreshe është mjaft e pasur në forcë intelektuale, me një formim të lartë shkencor dhe letrar të cilët janë në gjendje të zgjidhin problemin e asimilimit të gjuhës letrare kombëtare si gjuhë kulture për gjithë shqiptarët e diasporës arbëreshe. Tradita, **rezultatet pozitive të sociolinguistikës së kohës sonë**, bashkëveprimi midis gjuhëtarëve shqiptarë dhe atyre arbëreshë, kanë çuar në zgjidhjen e mjaft problemeve gjuhësore siç janë dy më të mëdhatë e shekullit tonë: **alfabeti dhe drejtshkrimi.**<sup>295</sup>

Nuk janë të folmet dialektore ato me anë të të cilave sociolinguistika përfaqësohet. Ajo në vetvete trajton një tërësi problematikash. Por, mendoj se, kjo disiplinë në kapërcyell është në gjendje t'u vijë në ndihmë të gjitha të folmeve për zgjidhjen e mjaft çështjeve. Edhe më e madhe është ndihma e saj përkundrejt të folmeve anësore, apo të folmeve të diasporës.

Këtë e thotë mjaft hapur që më 1985 edhe autori i artikullit që më lart cituam. Për sa i takon gjuhës letrare për gjithë arbëreshët, duke parë edhe tendencën e saj për ndryshim nën efektin gjithnjë edhe më të madh të italishtes dialektore dhe asaj letrare, sipas Kostallarit lidhur me këtë problem, për të vënë që në fillim gurët në vendin e duhur duhet që çështja të trajtohet në dy aspekte: -në aspektin teorik dhe historik, - gjuhësor dhe **sociolinguistik** si dhe në aspektin praktik dhe metodologjik.....

Sociolinguistika në të tilla raste na vjen mjaft mirë në ndihmë pasi ajo hedh vështrimin herë kah e e vjetra herë kah e reja dhe herë merret me konvergjencën midis tyre, gjithnjë duke verifikuar dhe shqyrtuar. Përmes procesit të hinkëzimit ajo arrin në përfundime konkrete rreth një të folmeje të caktuar, duke shqyrtuar edhe raportin midis tyre dhe gjuhës letrare standarde.

Mendojmë se përpos studimeve të bëra në dialektologjinë shqiptare dhe punës madhore për studimin e të folmeve (punë e cila është manifestuar mjaft mirë edhe me Atlasin Dialektologjik Shqiptar), për të provuar faktin se asnjë variant i gjuhës shqipe përfshirë edhe diasporën shqiptare nuk arrin të krijojë autonominë e vet pra, shkëputjen nga sistemi i gjuhës kombëtare, aq sa këto të dalin mënjanë me një strukturë të vetën, pra si gjuhë më vete<sup>296</sup>; për të arritur në konkluzione të tilla na vjen në ndihmë edhe një herë sociolinguistika.

Nga ana tjetër, përmes sociolinguistikës ne kuptojmë se, megjithë afërsinë midis të folmeve dialektore të shqipes, nuk mund të vendosim kurrësesi një paralele midis të folmeve shqiptare brenda Shqipërisë shtetërore dhe të gjitha të folmeve tjera të trojeve etnike shqiptare, pavarësisht bazës së përbashkët që ato kanë.

Sigurisht që prania e isoglosave është e pashmangshme, por nuk mund të mohojmë për asnjë çast ndryshimet e mëdha leksikore në secilën prej tyre. **Kjo gjë ka bërë që diferenca kuptimore midis të folmeve të jetë e madhe.**<sup>297</sup> **Për rrjedhojë edhe gjuha letrare standarde nuk qëndron pranë të gjitha të folmeve njëlloj.** Sigurisht që ajo është më afër të folmeve të toskërishtes dhe më e largët paraqitet ajo me të folmet kalimtare si dhe me të folmet e gegërishtes në tërësi.

Sa më shumë thellohet hendeku midis gjuhës letrare standarde apo shqipes së përgjithshme dhe këtyre të folmeve, aq më të mëdha bëhen edhe dallimet semantike midis tyre. Kjo gjë sjell më pas edhe vështirësi në komunikimin midis tyre.

<sup>295</sup> Kostallari, A.: po aty

<sup>296</sup> Po aty, f. 168

<sup>297</sup> Po aty, f. 170

Të gjithë e dimë që me një arbëresh jo të shkolluar nuk është e lehtë të komunikosh, e njëjta gjë mund të ndodhë me një individ që i përket toskërishtes veriore apo jugore.<sup>298</sup> E njëjta gjë na ndodh edhe me një arvanitas apo me një arbëresh të Zarës, një shqiptar të Ukrainës etj. Në vështirësi ndjehet edhe një shqipfolës i thjeshtë në komunikim me një çam të moshuar, por **shkalla e vështirësisë në komunikim midis këtyre folësve nuk është e njëjtë.**

Është e vërtetë se vështirësi në komunikim hasin edhe një i moshuar i gegërishtes veriore dhe një i moshuar i labërishtes, por tek shqiptarët jashtë atdheut, shkalla e rrezikut të zhdukjes është më e madhe, pasi sado i varfër, i mbyllur dhe i vuajtur nën diktaturën e totalitarizmit komunist të jenë shqipfolësit brenda Shqipërisë shtetërore (pasojat e të cilit kanë qenë të pashmangshme edhe në gjuhë)<sup>299</sup>, një faktor i jashtëm ndihmues për ta ka qenë, të qenurit individë të një shteti me të drejta.

Mendoj se kjo duhet të jetë edhe arsyeja bazë pse studiuesit arbëreshë ngrenë me të madhe problemin e ruajtjes së të folmeve arbëreshe apo arvanitase. Madje, e folmja arvanitase, mund të jetë nga të parat që rrezikon të zhduket tërësisht.

Për këtë arsye, mendojme se jemi ende në kohë që të punohet me qëllim që këto të folme të ruhen. Mendoj se studimet që lëvrojnë tema të tilla duhet të zenë vendet e para në planet e studimeve albanologjike në të ardhmen. Sigurisht këtu futet edhe e folmja e çamërishtes.<sup>300</sup>

Sigurisht të folmet edhe zhduken dhe lindin te folme të reja, por për asnjë çast nuk duhet të harrojmë që të folmet anësore në tërësi mbartin të dhëna me vlerë që mund të shfrytëzohen dhe shërbejnë për zgjidhjen e problemeve ende të pazgjidhura në gjuhën shqipe.

Për këtë arsye, një pjesë e temës së doktoratës i ngjan “një reforme” e cila mbështetet në metodën e përfaqësimit midis çamërishtes dhe të folmes së autorëve të vjetër; çamërishtes dhe të folmeve të arbëreshëve të Italisë; çamërishtes së sotme dhe të së ashtuquajturës arvanitishte, çamërishtes dhe të folmeve të tjera të skajit jugor të shqipes etj.; për të provuar në radhë të parë, atë çfarë shpesh e kemi pohuar rreth vlerave të saj, si dhe për të treguar se të gjitha gjuhët e kombit tonë i bashkon një bosht i vetëm, nën të njëjtin emërtim, “gjuhë shqipe”.

Në të folmen e arbëreshëve të Italisë, nga njëra anë studimet për këto të folme dhe nga ana tjetër, roli i shqipes së shkruar dhe i shqipes standarde (më vonë) kanë luajtur dhe vazhdojnë të luajnë një rol të dorës së parë, në dokumentimin si duhet dhe me kohë të kësaj të folmeje, pra në zhvillimin dhe kultivimin e saj njëkohësisht.

Kujtojmë tri fazat e përshkruara nga Kostallari për të folmen arbëreshe:

Faza e parë është ajo e shek. XVI- XVIII, ku letërsia në këto vite kishte karakter religjioz dhe, për rrjedhojë gjuha e shkruar ishte tejet e kufizuar, por e rëndësishme sipas tij është që shqipja tek arbëreshët **shkruhej.**

Faza e dytë i përket periudhës së shpërthimit artistik dhe shkencor si një rizgjim kombëtar dhe zhvillim kulturor, e gjithë kjo e pasqyruar përmes gjuhës në veprat e De Radës, Gavril Dara i Riu, V. Dorsa, F.A. Santori, Z. Serembe, Dh. Kamarda etj.

<sup>298</sup> Shkurtaç, Gj. *Rreth ndryshimeve në gjuhën e fshatit të sotëm të Veriut*, në “St. fil.” 4, 1969; *Vëzhgime mbi shtresat leksikore dialektore dhe letrare në të folmen e Lezhës*, në “St. fil.” 3; (1984) *Shtresëzime dhe risi gjuhësore në qytetin e Lezhës*, në “St. fil.” 2, 1984; *Disa dukuri të së folmes së Kurbinit në dritën e sociolinguistikës*, SF, 1998; *Sociolinguistika*, Tiranë 2003.

<sup>299</sup> Troplini, E.: *Si nuk duhet të shkruajmë dhe të flasim shqip. “SOS” për gjuhën tonë të bukur shqipe*, “Gjuha Shqipe”, Prishtinë, 2009.

<sup>300</sup> Përfitoj nga rasti të falenderoj **profesorin tim udhëheqës** prof. Gjovalin Shkurtaç, si këshilluesi i parë i kësaj teme, si dhe të gjithë **profesorët e gjuhësisë** që gjithmonë janë treguar shkencërisht të drejtë, duke e mbështetur një temë të tillë.

Në fazën e tretë spikat, bashkëveprimi i arbëreshëve për një gjuhë kombëtare të unifikuar ( Tiranë 1972). Të gjitha këto zhvillime kanë gjetur mishërimin e tyre në radhë të parë në gjuhë.

Këto tri faza nuk e kanë larguar aspak të folmen e arbëreshëve, por e kanë afruar edhe më shumë me gjuhën letrare shqipe dhe me gjithë shqiptarët. Mendoj se këto tri faza luajnë një rol të rëndësishëm edhe në ruajtjen e të folmes.

- *Arbërishtja dhe shqipja sipas Altimarit,*<sup>301</sup>

*nuk janë dy gjuhë paralele, por dy variante gjuhësore brenda një gjuhe të përbashkët...., me një status të ndryshëm sociolinguistik....., me të njëjtin sistem fonologjik dhe morfologjik, me dallime që janë të dukshme sidomos në leksik...*

*Arbërishtja sipas tij është një degë e gjuhës shqipe në një fazë të bllokuar të zhvillimit të saj për shkak të rrethanave historike që e bënë atë një gjuhë të folur në një mjedis ekonomiko-shoqëror të ngushtë, me tiparet e "kodit të ngushtë", sipas sociolinguistikës, ndërsa shqipen ai e sheh si variant ballkanik të asaj dege që rrodhi gjithashtu nga albanishtja, por që me kohë mori ( sidomos pas formimit të Shtetit të pavarur shqiptar), tiparet e "kodit të përparuar."*

Ky, ndër të tjera është një lloj përkufizimi i cili vendos një hendek të madh midis dy varianteve. Me gjithë dëshirën e madhe për të përqafuar standardin ky është një lloj deficiti i cili trashëgohet edhe sot e kësaj dite. Mjaft mirë gjendja e arbërishtes dhe e arvanitishtes përveç bilinguizmit pjesë e të cilit pashmangshmërit ato janë, në kuadrin e shqipes së përgjithshme përfshirë edhe diasporën e të folmet anësore kudo që flitet shqip dhe gjenden shqiptarë, mund të përkufizohet edhe si diglosike. Me një përjashtim të vogël se, arbëreshët konsiderohen më të privilegjuar në këtë drejtim sesa arvanitasit. Një gjë të tillë e pohojnë edhe vetë atdhetarët, studiuesit, kontribuesit më të mëdhenj të botës arbëreshe sot.

Po citojmë disa prej mendimeve të tyre për të parë se cila ka qenë dhe është gjendja e kësaj të folmeje.

A. Belusci: "Ne jemi koka e emigrimit. Ne u ndjeme gjithmone superiore ne Kalabri, edhe nga emri i Skenderbeut. Me gjak e kemi ndihmuar shtetin italian, Garibaldin e famshem, gje qe do te kishim dashur ta benim edhe ketu ndaj turqve. U ndjeme krenare per kujdesin qe patem me pas, **si shperblim**, pasi u hapen shkollat, si kolegji i San Adrianit, ku kane studiuar A.Xhuvani, A.Rustemi etj, pra qe u bene burim drite, e me gjithë ate kulture te madhe qe morem ne u ndjeme si nje diell, krenare....."<sup>302</sup>

F. Altimari: Pakica jonë pati fatin të gëzojë një rol historikisht të rëndësishëm, politik dhe kulturor, brenda shoqërisë italiane, që prej kohësh - në pjesën e parë të shekullit XVIII - kur u themeluan në Kalabri dhe në Sicili ato të dy 'Vatra' të mëdha arsimore shqiptare për mbrojtjen e kishës arbëreshe bizantine dhe të identitetit tonë ....<sup>303</sup>

Po nga këto të dhëna kuptojmë, pse sot vazhdojnë ende të shtohen lidhjet midis kësaj bote të shkëputur siç e quan autori dhe pjesës tjetër.

Duke bërë një krahasim midis arbëreshëve të Italisë dhe arvanitasve të Greqisë, mendojmë se këto të fundit me të vërtetë janë "të pafat"

**...Arvanitasve u munguan dy kushte:**

<sup>301</sup> Po aty

<sup>302</sup> Bellusci, A.: *Ju tregoj 900 katundet Arvanitase në Greqi*, intervistuar nga Magdalena Alla, 12/02/ 2011, në [che.kosovarimedia.com](http://www.che.kosovarimedia.com)

<sup>303</sup> Altimari, F.: *Arvanitasit e greqisë, më të pafat se arbëreshët e italisë*, intervistuar nga, Lorenc Rabeta, gazeta "SHQIP"

1. Dallimi fetar me grekët , me të cilët ata bashkëjetojnë dhe një mit përforcues dhe themelues identitar, siç ka qenë për arbëreshët miti i Skënderbeut.....

....në Greqi klima politike dhe kulturore ndaj arvanitasve, ndoshta edhe për efekt të kontekstit dhe të kushtëzimeve ballkanike, nuk u dëftua historikisht ashtu tolerante siç ndodhi në Itali. Dhe është e çuditshme se kjo vazhdon të jetë edhe sot gjendja e arvanitasve, të cilët megjithëse flasin gjuhën e tyre, krahas gjuhës greke, nuk trajtohen nga Shteti grek si minoritet, vetëm pse kanë të njëjtën fe të krishterë ortodokse si grekët! Por ky qëndrim i politikës greke, bie ndesh me respektin e multikulturalizimit dhe të multilinguizmit të institucioneve evropiane, që është praktikë e shoqërisë sonë moderne.....<sup>304</sup>

Në njëfarë mënyre nga pikëpamja historike mund të vendoset një paralele midis arvanitasve dhe arbëreshëve, por ajo përfundon këtu. Pavarësisht fateve të njëjta, jeta e “të pafatëve”<sup>305</sup> nuk ka qenë njëlloj, përfshirë këtu ruajtjen, zhvillimin dhe kultivimin e gjuhës së tyre.

Antonio Belusci: “Në Shqipëri askush nuk pohon të verteten për komunitetin e arvanitasve, madje politikanet shqiptare shprehën se "diaspora shqiptare po cenon interesat e Shqipërisë". Por a mund të leme të shkelen me kembe 900 katunde arvanitase, që deri me sot janë keshtu, të mohuara. Nderkohe që shteti ynë amë, iu friksohet vetëm 4 fshatrave greke në Dropull. Në librat e mia studimore mbi keto treva paraqiten 150 fotografi, letra të banoreve të këtyre katundeve në gjuhën shqipe, të cilat janë bomba të verteta. I kam shetituar me këmbë 120 katunde, kam marrë dëshmi me magnetofon në bare, rrugë, kam intervistuar 500 njerëz dhe kam verteturar se 90 katunde janë arvanitase. Kam gjetur mëse 3 mijë toponime dhe mikrotoponime. Në lëndën e mbledhur përfshihen intervista, anekdota, besime, histori, kënge, lojra popullore, lutje arbërore, përralla, të dhëna për punën dhe vdekjen, që janë ruajtur në arkivin personal në dyqind bobina të incizuara në magnetofon. Në këtë përfundim kam arritur pas një pune 40-vjeçare.”<sup>306</sup>

Për këtë arsye Altimari shprehet: *... e kemi si obligim t'i rrisim përpjekjet tona për ta vlerësuar sa më thellë dhe sa më mirë këtë thesar të përbashkët gjuhësor që e begaton trashëgiminë tonë kulturore dhe shpirtërore. ...*<sup>307</sup>

Nga e gjithë kjo gjen shpjegim edhe qëndrimi racional i disa gjuhëtarëve ndofta në momente të caktuara edhe yni në lidhje me ruajtjen e këtyre të folmeve.

C. Fortino: *Era e ndryshimeve dhe e kontakteve gjithnjë e më të shpejta ndërmjet elementit italian dhe atij arbëresh fryn me furi dhe tenton të përlejë identitetet lokale..... . ....Kërkohet një ndërgjegjësim i familjeve dhe i tërë komunitetit, një angazhim spontan e bindës në të mirë të gjuhës amtare që sot është e kërcënuar..... . ...Një rol jo më pak të rëndësishëm në mbrojtjen e të folmeve të kërcënuara e luajnë gjuhëtarët, ose më gjerë studiuesit.*<sup>308</sup>

Pra, në njëfarë mënyre, pavarësisht prirjeve të secilit, të dy studiuesit janë për ruajtjen e asaj pasurie që të folme të tilla kanë privilegjin të kenë.

Mendojmë se prirjet e tyre (ruajtja dhe risimi ) në të folme të tilla nuk përjashtojnë njëra- tjetrën, por ushqejnë njëra tjetrën. Duke e përsëritur edhe një herë **mendojmë se, ajo çfarë të folmet anësore kanë arritur me të vërtetë të ruajnë**

<sup>304</sup> Altimari , F.: Po aty

<sup>305</sup> Term i përdorur nga Altimari

<sup>306</sup> Bellusci, A.: *Ju tregoj 900 katundet Arvanitase në Greqi* , intervistuar nga Magdalena Alla, 12/ 02/ 2011, në [ëëë.kosovarimedia.com](http://www.see.kosovarimedia.com)

<sup>307</sup>:Altimari , F.: Po aty.

<sup>308</sup> Fortino, C. I.: *Era e ndryshimeve tenton të përlejë identitetet locale*, intervistuar nga, Merita Bruci 14/ 02/ 2011, gazeta “Shekulli”

**është pikërisht ekuilibri midis dy forcave: ruajtjes dhe zhvillimit në brendësi të të folmeve, si dhënie e marrje midis brezave, si dhe ruajtja dhe zhvillimi në një plan më të gjerë, të konvergencës midis tyre dhe bashkëveprimit me gjuhën standarde.**

Ndërsa përsa i takon bashkëpërkimeve midis çamërishtes dhe arvanitishtes, apo arbërishtes mund të themi se **këto janë bashkëpërkime me bazë tek tipari arkaik i secilës.**

**Edhe midis çamërishtes dhe të folmeve të tjera ndjehet një lloj diference pikërisht sepse ato qëndrojnë shumë më afër “ kodit të përparuar “pra, shqipes pas formimit të shtetit shqiptar, ritmi i së cilës ndryshon në lidhje me çamërishten dhe të folmet në fjalë pra arvanitishten dhe arbërishten. Për këtë arsye këto të folme kanë qenë, janë dhe do të jenë. Ato fliten, por janë ende shumë të ndryshme nga shqipja e përgjithshme, duke trashëguar bazën e përbashkët shqipe.**

Pra, janë variantet gjuhësore dhe dialektore në tërësi të tilla si të folmet e lartpërmendura, por edhe si e folmja që kemi marrë për studim dhe të tjera si këto, që mund të konsiderohen **thesare që e begatojnë trashëgiminë tonë kulturore dhe shpirtërore, por edhe atë shkencore në të njëjtën kohë.**

### **KREU III**

## **3. E FOLMJA E ÇAMËRISHTES SOT**

### **3.1. E folmja e çamërishtes në kuadrin e marrëdhënieve gjuhë standarde- dialekt**

Sociolinguistika ka bërë shpeshherë dhe vazhdon të bëjë objekt të saj të studimit marrëdhëniet gjuhë-dialekt.<sup>309</sup>Në atë hulli trajtimi jemi përpjekur të ecim edhe ne në disa prej trajtimeve të botuara<sup>310</sup> si dhe në faqet e këtij studimi.

Në studimin për çamërishten marrëdhënia gjuhë standarde- dialekt tërheq vëmendjen nga njëra anë për problematika të ngjashme të pranishme tashmë tek të gjitha të folmet (që bashkohen në një emërues të përbashkët për nga prirja e tyre për t'u orientuar kah standardit), dhe nga ana tjetër për ato veçori që janë karakteristike vetëm për të folmen e çamërishtes në veçanti.

Në këtë temë kemi trajtuar ndryshimet në sistemin e të folmes, duke i dhënë rëndësinë e duhur rolit të faktorëve jashtëgjuhësorë, vendimtar në ndryshimin e një të folmeje; në mënyrë të veçantë, faktorëve që kanë motivuar futjen e elementeve të reja gjuhësore dhe kanë mundësuar më pas orientimin e të folmes kah standardit, pa anashkaluar interferencat e tjera dialektore në të, si dhe tiparet e saj ruajtëse.

Përmes saj jemi munduar së fundmi të shpjegojmë sadopak edhe arsyet e mbijetesës dhe zhvillimit (sigurisht jo në të njëjtën masë) të dy poleve krejtësisht të kundërta,

**Nga njëra anë**, dygjuhësinë dhe gërshetimin etnolinguistik, raportet dhënëse-marrëse etnolinguistike të një grupi shoqëror të shprishur, pra, reagimin e së folmes çame kundrejt asaj prirjeje që përbashkon sot mbarë të folmet, orientimin e tyre kah standardit.

Dhe, **nga ana tjetër**, forca e saj ruajtëse, përpjekja për të mbajtur të gjallë çamërishten, si dhe kultivimin e dëshirës për çdo gjë fund e krye çame.

<sup>309</sup> Shkurtaç, GJ. *Sociolinguistika*, Tiranë 2003.

<sup>310</sup> Troplini, E. *E folmja e çamërishtes në kuadrin e marrëdhënieve gjuhë standarde- dialekt*, në “Seminarin e XXVIII për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën shqiptare, në Prishtinë, 2009.

Pra, duke shfrytëzuar të dhëna të vjela në terren nga çamët, si dhe duke u bazuar në shqyrtime sociolinguistike, kemi parë marrëdhëniet midis dy varieteteve; standardit dhe varietetit dialektor çam. Më pas kemi arritur në përfundime përgjithëse për të folmen çame në kuadër të marrëdhënieve gjuhë standarde-dialekt.

Sikurse e kemi përmendur në fillim të këtij punimi kemi shfrytëzuar të dhëna të mbledhura tek folës të brezave të ndryshëm, përkatësisht: folës të brezit të vjetër, folës të brezit të mesëm dhe folës të brezit të ri<sup>311</sup>

Lipset të përmendim edhe një herë faktin se përfundimet tona lidhur me një temë të tillë dhe jo vetëm, janë fryt i mbështetjeve të herëpashërëshme në boshtin e trajtimeve që shkon sipas formulës së J. Fishmanit: “*Kush flet, me kë, kur, për çfarë dhe në cilin varetet?*”<sup>312</sup>, duke e parë gjithmonë këtë formulë në bashkëpunim me tri elementet e tjera të Berrutos, “**si, pse dhe ku**”<sup>313</sup>.

Të gjitha këto, ndër të tjera kanë çuar në shpjegimin e arsyeve të mundshme, shkaqeve dhe pasojave të procesit të **ndryshimit gjuhësor**.

Kjo është më se e kuptueshme, po të kemi parasysh marrjet dhe dhëniet midis brezave, duke u përshtatur njëkohësisht me normat dhe rregullat që vendos bashkësia pritëse dhe duke iu nënshtuar trysnisë që ushtron zhvillimi shoqëror në tërësi dhe rregullave bashkëkohore të bashkësisë së sotme shqiptare etj. Të gjitha këto shpien në krijimin e situatave të larmishme që krijohen si pasojë e orientimit të brezave (natyrisht në masa të diferencueshme), kundrejt standardit, duke nxitur edhe diskutimin e problemeve sociolinguistike që lidhen me individualizmin apo konformizmin, **bilinguizmin dialektal** etj.<sup>314</sup>

Shkalla e njësisë së dialekteve me gjuhën letrare është e madhe. Sipas Gjinarit kjo shpjegohet me afërsinë midis tyre, konkretisht me numrin e madh të tipareve të përbashkëta që kanë ato në sistemet përkatëse, si dhe me dukuritë e veçanta në sistemin fonetik e morfologjik, të rëndësishme për formësimin e standardit.<sup>315</sup>

Pra, formësimi i gjuhës letrare është bërë mbi bazën e ngritjes në normë të dialektit të toskërishtes, në të cilën bëjnë pjesë elemente të dialektit jugor dhe një numër jo i vogël elementesh të dialektit verior.

E folmja e çamërishtes është pjesë e dialektit të toskërishtes jugore së bashku me labërishten. Në këtë mënyrë, lexuesit menjëherë mund t’i shkojë në mendje ai pohim që është bërë shpesh për të folme apo dialekte me të njëjtin “status”: studimi i të folmeve të tilla që janë pjesë e dialektit që pati fatin të normëzohej, konsiderohet jo dhe aq prurës. Hudson i trajton këto dialekte si bartës të një sëmundjeje që ai e quan patologjike.<sup>316</sup> Logjikisht për këtë fakt trajtimi i çështjes së konvergjencës midis gjuhës letrare dhe të folmeve të toskërishtes, duhet të jetë i vështirë. Por, praktikisht me çamërishten nuk ndodh kështu, pasi janë faktorët kontekstualë ato, që mundësojnë studimin e saj në një këndvështrim të gjerë sociolinguistik dhe, për më tepër, në pikëvështrimin tonë.

<sup>311</sup> Sikurse e dimë, në krahinën e Çamërisë kanë ekzistuar të folme të shumta, sipas bashkësive të vogla të kësaj krahine. Në punimet për çamërishten jemi bazuar në përgjithësi tek e folmja e zonës së Filatit.

<sup>312</sup> Shkurtaj, Gj. Po aty.

<sup>313</sup> Berruto, G. *La sociolinguistica*, Bologna, 1994

<sup>314</sup> Troplini, E. Disa tipare ruajtëse të çamërishtes, botuar në revistën në “Aktet” e Seminarit të II-të Ndërkombëtar të Albanologjisë, Tetovë 2008.

<sup>315</sup> Gjinari, J. *Marrëdhëniet e sotme të gjuhës letrare me dialektet*, S.F, nr.1, 1985; Gjinari & Shkurtaj: *Dialektologjia*, Shtëpia Botuese e Librit Universitar, Tiranë, 1997.

<sup>316</sup> Hudson, A. R. *Sociolinguistika* (përkthim, botimi i parë në shqip), Tiranë 2002.

“Dialektalizmat” janë pjesa më interesante e së folmes çame, pasi brëndapërbrënda ambjentit, rrethit, apo bashkësisë çame, nga pikëpamja shoqërore dhe psikologjike gjithashtu, ato mbrohen dhe ushqehen nga “konservacioni i ndërgjegjshëm”<sup>317</sup> që karakterizon këtë të folme. Sigurisht, kjo dukuri pasqyrohet ndryshe në breza. Moshat më të thyera janë konservues në një masë më të madhe sesa të rinjtë; nga ana tjetër, kjo s’do të thotë që të rinjtë nuk ruajnë ende tipare të vjetëruara.

Pa kaluar tek historia e kësaj të folmeje, le t’i përmbahemi dhe një herë konceptimit të Gjinarit, sipas të cilit: “Procesi i tretjes së dialektalizmave nuk ndodh në një kohë të shkurtër dhe me të njëjtin ritëm në të gjitha grupet, shtresat, dhe brezat shoqërorë. Qëndresa ndaj trysnisë së gjuhës letrare nuk është e njëjtë për të gjitha tipat e dialekteve.”<sup>318</sup> Duke u nisur nga ky pohim, përkundër gjithë asaj analize të hollësishme dhe mbi të gjitha të rëndësishme për të kuptuar, nga ana tjetër nuk mund të mohojmë faktin se çamërishtja është pjesë e nëndialektit të toskërishtes jugore.

Orientimi kah standardit dhe shqipes së përgjithshme nis që me brezin e vjetër. Ky është një proces në rritje që fillon nga folësit e moshave të thyera, deri tek folësit e moshave më të reja. Dukuritë që do të trajtojmë lidhur me këtë çështje mund të jenë pjesë e fondit të përbashkët të mbarë toskërishtes që patën fatin të normëzohen, sikurse mund të jenë edhe dukuri të reja të cilat janë përfshirë më vonë duke shmangur me vetëdije elementet e vjetra dhe duke iu nënshtruar një procesi të zëvendësimit me dukuri të standardit.<sup>319</sup>

Orientimin kah shqipes së përgjithshme si fenomen të vërejtur në brezin e vjetër, fillimisht e kemi vërtetuar nga krahasimi i të dhënave të çamërishtes së sotme me çamërishten e hershme.

Tek ky brez spikasin **disa** dukuri tipike çame, të cilat gjejnë përdorim të rrallë tashmë (të dysorësuar) përkrah trajtave gjegjëse të shqipes së përgjithshme, që ndër të tjera shfaqen të ngulitura.

- Per rrjedhojë, tek e folmja e tyre, spikat: kalimi i zanores **i** të dikurshme në **ë** të theksuar (*hingra/ hëngra*); këmbimi i **j**-së në **q** (*mi:jtë/ miqtë, fi:jtë/ fiqtë, ple: jtë, pleqtë, poqmë /pojme, doqmë/ dojmë*); vendosja në gjininë femërore të emrave femërorë që dikur përdorehin në gjininë mashkullore, si *evropi, tenxheri*<sup>320</sup>; bjerrja e formimit të shumësit me **-I**, në fjalët që në njëjës mbarojnë me **-II** (*kokall- kòkale*); bjerrja e formave të vjetëruara të përemrave të pacaktuar, *gjithëçili, shdononjë, akëç, shdo, dish*; bjerrja (nganjëherë) e trajtave sigmatike të foljeve, **shoh** (*paç/ pashë*), **jap** (*dhaç/ dhashë*), **bie** (*raç/ rashë*) etj;

Por, nga ana tjetër, në këtë të folme, **disa** dukuri janë bjerrë që me brezin e vjetër dhe janë zëvendësuar me fjalë të shqipes së përgjithshme. Duke mbrojtur idenë tonë të ndryshimit për të folmen çame dhe **orientimin e saj kah standardit që me brezin e vjetër**, po rendisim **disa** shfaqje të tjera nga ligjërimi i këtij brezi që

<sup>317</sup> Term i përdorur nga prof. Gjovalin Shkurtaç në *Dialektologjia*, Shtëpia Botuese e Librit Universitar, Tiranë, 1997.

<sup>318</sup> Gjinari, J. *Marrëdhëniet e sotme të gjuhës letrare me dialektet*, S.F, nr.1, 1985

<sup>319</sup> Kjo është një dukuri që nis që me brezin e vjetër, por që ndihmohet gjithnjë nga fakti i përkatësisë së kësaj të folmeje në toskërishte. Folësit e këtij brezi e kanë më të lehtë të huazojnë dukuri të standardit, sesa dukuri të bashkësive pritëse, aq më tepër që këtu bëhet fjalë jo vetëm për një dialekt të tjetrit, por për një dialekt tjetër.

Ka një diferencë të dukshme midis çamërishtes dhe të folmeve të tjera të ndryshme nga ajo. Kur flitet për të folmen e Labërishtes, çështja e ndryshimit shihet në një tjetër pikëvështrim. Duhet të masim mirë diferencën midis kësaj të folmeje dhe të folmeve të tjera me të cilat ajo është në kontakt.

<sup>320</sup> Shih: Haxhihasani, Q. “*Vështrim i përgjithshëm mbi të folmen e banorëve të Çamërisë*”, në « Dialektologjia shqiptare », vëll.I,Tiranë,1971, vëll.II,Tiranë



vertetojnë pikërisht një gjë të tillë. Nga ana tjetër, secila prej dukurive ka edhe përjashtimet e veta, pasi kufij të prerë midis dukurive nuk ekzistojnë, ato janë gjithmonë relativë.

1. Prania në të folmen e brezit të vjetër të zanores **-ë**, në serinë e zanoreve të theksuara, zanore së cilës gegërishtja i përgjigjet me **-a**;

2. Përdorimi i rregullt i togzanorëve **ua, ie** (jo gjithmonë, kujtojmë këtu fjalët *pies/ pyes, diel/ djem* etj);

4. Dukuria e rotacizmit (jo gjithmonë, kujtojmë këtu pjesoren *bënë/ bërë*, tek e cila nuk ka ndodhur kjo dukuri)<sup>321</sup>;

5. Qëndrueshmëria e togjeve **mb, nd, ng** (jo gjithmonë, kujtojmë këtu fjalët *baj/ mbaj, gas/ ngas, noonjë/ ndonjë* etj.);

6. Dukuria e formimit të shumësit me metafonizëm të **a**-së të theksuar të rrënjës, si dhe formimi i tij në rastet kur ndodh palatalizimi, *dash- desh, plak- pleq*, si në shqipen e përgjithshme.

7. Formimi i shumësit të gjinisë mashkullore më **-ë, -nj, -ër**, sikurse në mbarë shqipen e përgjithshme;

8. Formimi i shumësit të gjinisë femërore;

9. Formimi i shumësit më mbaresën **-a** duke humbur **ë**-në fundore të temës;

11. Ruajtja e trajtave të njëjta në shumës tek emrat që mbarojnë me **-i, -e, -a** të theksuar.

12. Shumësi i formuar me prapashtesën **-ra**: (jo gjithmonë, kujtojmë fjalët: *vëndërat, punërat, dasmërat* etj, tek të cilat shumësi nuk formohet si në mbarë shqipen) etj;

13. Formimi i pjesores së foljeve; (jo gjithmonë, kujtojmë mungesën e dukurisë së rotacizmit tek pjesorja *bënë*)

14. Disa forma të caktuara përemërore (sot në çamërishten e më të vjetërve hasim trajtat karakteristike të kësaj të folmeje, si: *atë, ajo, ai, ù* etj);

15. Ndërtimi i formave joveprore (jo gjithmonë, kujtojmë praninë e bashkëtingëllores **-n** tek mbaresat foljore të kësaj forme, si: *rregëlloneshin, shtroneshin, pajtoneshin* etj)<sup>322</sup>. Pjesë të pandryshueshme të ligjëratës (jo gjithmonë pasi sot në brezin e më të vjetërve hasim trajtat: *shklata, çish, eni, oj, nek, atje, kùtu* etj; *jo moj/ çish i strehōjv:m?*)

Pra, sikurse shihet, disa prej shembujve të lartpërmendur janë dëshmuar të përkatësisë së çamërishtes në toskërishte dhe, të tjerë përforcojnë atë prirje që përbashkon sot folësit (në rastin tonë të brezit të vjetër) për të pasuruar repertorin e tyre me dukuri të standardit. Secili prej shembujve shfaq edhe përjashtimet e veta, që lindin si pasojë e shfaqjeve bilinge të dukurive përkrah formave zëvendësuese të standardit.

## **E folmja në brezin e vjetër çam në thelb është konservuese.**<sup>323</sup>

<sup>321</sup> Sipas asaj çfarë kemi studiuar dukuria e rotacizmit në toskërishte ka ndodhur shumë vonë, gjë që e vërteton edhe e folmja çame.

<sup>322</sup> Sikurse tek Buzuku, Reinholdi, arbëreshët, arvanitasit; për më tepër shih temat përkatëse në këtë punim.

<sup>323</sup> Troplini, E.: *Disa tipare ruajtëse të çamërishtes*, në revistat: “Aktet..” (II), Tetovë 2009; “Universi” (XI), Tiranë 2009.

Shumë prej dukurive të vjetra të çamërishtes që përkojnë edhe me gjuhën Buzukut<sup>324</sup>, i gjejmë edhe tek brezi i vjetër sot<sup>325</sup>Pavarësisht kësaj, nga anketimet në terren kemi vënë re se, përkrah elementeve të ngulitura të fizionomisë çame, gjallojnë edhe elemente të standardit letrar në trajtë dysorësie.<sup>326</sup> Në përgjithësi ato favorizohen nga rrethana dhe kontekste të caktuara, të ndihmuara nga faktorë të ndryshëm jashtëgjuhësorë.<sup>327</sup>

Duke respektuar gjithmonë pikëvështrimin tonë, pra që ka të bëjë me procesin e tretjes së dialektalizmave që tek moshat e thyera dhe në vazhdim, po mundohemi t'i mbrojmë idetë tona duke sjellë edhe disa shembuj nga leksiku.

Tek brezi i vjetër çam krahas përdorimeve të ngulitura të dialektalizmave (këtu kemi përfshirë edhe greqizmat apo turqizmat që janë futur në të folmen çame si pasojë e kontakteve më këto gjuhë, të cilat, janë bërë me kalimin e kohës pjesë e fondit leksikor çam dhe janë ruajtur deri në ditët tona.) vërejmë edhe përdorime bilinge të përdorimeve të shqipes së përgjithshme me ndonjë ndërhyrje (me vështirësi) të së folmes së bashkësisë pritëse, si p. sh:

*Vorua / oborr, sendon/ çarçaf, papllom/ jorgan, vlad/ dybek, pampuar/ vaporr, cinura/ qerpikë, koca/ gërshet, thapë/ thonj, zahër/ sheqer, purtek/ bostan, thimilkua/ shalqin, mirgale/ bajame ,vrakazon/ ushkur, jatrua/ doktor, dhaskal/ mësues, evlat / fëmi, sabi / foshnje, i shkllarë / i çmendur, gërlak/ gurmaz, davet/ gosti, torriar/ rrugaç, umidh/ shpresë: ban umidh- mban shpresë, tumene/ dimiq, parathire/ dritare, farmak/ i hidhur, pelister/ pëllumb, stere/ tokë. Alltën/ flori, sufrà/ sofër, hanë/ shtëpi, llufë/ baluke, fahil/ gjellë, tëmël/ ëmbëlsirë, tharrtirë/ dhallë, potiçe/ pandofla/ shapka, vraka/ pantallona, konoxhup / xhup, feste/ qeleshe, kumbi/ sumbull, ledh/ mur, qaramidhe/ tjegulla, katua/ bodrum, kalive/ kasolle, qerreste/ ristela, azves/ gëlqere, gon/ nip, gone/ mbesë, çeç/ vëlla i madh , kër/ gomar, mjalca/ bletë, vurr/ iriq, karakaçe/ laraskë, skanjo/ karrige, buhar/ oxhak, postër/ potiçe, klidhonë/ drynit, lien/ legen.*<sup>328</sup>

Sikurse e shohim edhe nga këto shembuj, nuk mund të anashkalojmë edhe faktin që tek ky brez shfaqen herë pas here interferencat e të folmeve të bashkësive pritëse. Një shembull tipik i këtyre përzierjeve është edhe dialogu i mëposhtëm i dy të moshuarave, tek të cilat spikat aftësia e folësit për ta “dredhë giuhën”, sipas rastit e bashkëbiseduesit<sup>329</sup>

A. –Vjen non-jherë i shoqi i sat **bilë**?

B. –ëë..., ç'a the?

A. - Burri i **gocës** tënde vjen non-jherë?

B. – Po, po... vjen. Po **vajzën** tate ktu e ke apo jash shtetit?

A. –Kùtu, kùtu... etj

<sup>324</sup> Për më gjatë lidhur me këtë argument shih: Troplini, E. “Bashkëpërkime të elementeve gjuhësore të veprave më të hershme shqipe, me çamërishten e sotme” në “Alb- Shkenca” (Takimi i IV-ërt), Tetovë, 2009

<sup>325</sup> Sigurisht përdorimi i tyre herë shfaqet i ngulitur, herë në trajtë dysorësie dhe herë është mjaft i rrallë; e rëndësishme është që ato janë të pranishme dhe kjo e fundit bëhet edhe një herë dëshmuese e vlerave të së folmes në fjalë.

<sup>326</sup> Pra kemi format e ngulitura të standardit dhe format e ngulitura të boshtit dialektor çam (mbizotëruese) dhe në një masë të vogël trajtat bilinge për secilën nga këto forma.

<sup>327</sup> Troplini, E. *Ndikimi i disa prej faktorëve jashtëgjuhësorë në të folmen e çamërishtes*, në “Çështja çame dhe integrimi evropian”, Tiranë 2009

<sup>328</sup> Troplini, E. *Hulumtime sociolinguistike në disa mjedise çame të rrethit të Durrësit*, në “Aktet” e Seminarit II Ndërkombëtar të Albanologjisë, Shtator 2008.

<sup>329</sup> Shih: Rrota, J. “Gjuha shkon tue bam ato ndryshimet e veta”, në “Hylli i Dritës”, 1931, nr.3, f.121-133; sipas gj. Shkurtaç, në Sociolinguistika, Tiranë: ShBIU, 2003

A: I. Mehmeti (75 vjeç)

B: B. Sekurti (80 vjeç).

Për të qartësuar sadopak lexuesin po parashtrojmë një nëndarje të shkurtër përmes një tablele:

Brezi i vjetër

1	Dukuri të ruajtura të fizionomisë çame (mbizotëruese)
2	Prania e dukurive të standardit në të folmen e tyre
	a. Dukuri të çamërishtes që janë bjerrë dhe janë zëvendësuar me dukuri të standardit
	b. Dukuri të çamërishtes që përkojnë me ato të standardit.
3	Interferencat (ndërfutjet) nga e folmja e bashkësive pritëse.

Çfarë vërejmë në brezin e mesëm?

Edhe tek ky brez spikat përdorimi i ngulitur i elementeve të standardit të trajtuara më lart, të cilave i janë shtuar edhe një numër dukurish të fizionomisë çame që shkojnë drejt bjerrjes dhe që kanë prirje të zëvendësohen. Në përgjithësi elementet e ngulitura të fizionomisë çame, në brezin e mesëm përdoren përkrah dukurive të standardit në trajta bilinge. Kjo gjë konstaton një evoluim të së folmes me hapa të shpejtë, të cilën vështirë ta gjejmë në brezin e mesëm të rrethinave të labërisë, për shumë arsye që nuk mund t'i shpjegojmë dot në këtë studim të shkurtër. Në të njëjtat përmasa sa edhe ruajtjet, shfaqen tek ky brez edhe ndërfutjet nga e folmja e Shqipërisë së Mesme.

Më poshtë po rendisim disa dukuri që tek brezi i vjetër janë të ngulitura, por që tek brezi i mesëm janë zëvendësuar me gjegjëset e tyre sipas standardit.

Edhe shembujt e mëposhtëm karakterizohen nga përjashtimet e veta dhe, përkatësisht shënimimi në kllapa (jo gjithmonë) nënkupton shfaqjen në përmasa të vogla të trajtave bilige, por në këtë rast, të kushtëzuara gjithmonë nga rrethana, konteksti dhe faktorë të tjerë jashtëgjuhësorë:

1. Prania e fonemës *y* në sistemin fonetik (jo gjithmonë);
2. Përdorimi sipas standardit të foljeve **běj, është, vij** (*bij, isht, vite, bite*)
3. Mungon *l*-ja e vjetër ndërzanore, *fëmilë/fëmijë, vali/ vaji, palë/ pajë* (jo gjithmonë);
4. Mungon përdorimi i grupeve bashkëtingëllore **kl, gl, lk** me **q, k/q, gj/jk**: *klumusht/ qumësht, gluha/ gjuha, alka/ ajka, glëmbi/ gjëmbi, klisha/ kisha* etj; (jo gjithmonë)
4. Fjalët e huazuara nga turqishtja, kanë pësuar rregullimin mekanik të theksit, *tenxherë- tënxhere, kafë/ kàfe* etj;
5. Mungesa e zanoreve të gjata, (përveç interferimeve nga e folmja vendase, *pūn*)
6. Në asnjë rast nuk ruhet *ë*-ja fundore sikurse tek brezi i vjetër (*lekët-ë, kampet-ë*) etj;
7. Mungesa e diftongjeve ngjitës- zbritës dhe ngjitës, *pies/ pyes*; (jo gjithmonë)
8. Prania e dukurisë së rotacizmit tek pjesorja e foljes **běj, bërë** (*bënë*,- në kontekste të caktuara)
9. Ruajtja e grupeve **mb, nd, ng**.

10. Shquarsia sipas standardit tek gjinia femërore: *shoqe-shoqa* (brezi i vjetër); *shoqe-shoqja* (brezi i mesëm);

11. Shmangia e disa përdorimeve të veçanta të shumësit: *kuel, djel* etj;

12. Zëvendësimi i mbaresave të vjetra të kallëzores me mbaresat e kallëzores së shqipes së sotme, *shoknë-shokun*;

13. Shmangia në përdorim e numërorëve me dallime të ndryshme fonetike : *di, milë, milëra/dy, mijë, mijëra* etj;

14. Bjerrja e trajtave të hershme foljore , *kam, jam, thom*, përkatësisht *kesha, keshe , kish/ keshëm, keshët, kishnë ; jesha, jeshe, ish/ jeshëm jeshët, ishnë; kleva, kleve, kle ; trajta thom* etj, përdorimi i tyre sipas shqipes së përgjithshme;

15. Reduktimi i mbaresave të hershme të zgjedhimit të foljeve; *vinj, lenj, vineshim, gëzoneshim , bimë, bite, vite* etj.

17. Bjerrja apo zëvendësimi i disa pjesëve të pandryshueshme të ligjëratës me fjalë të të shqipes së përgjithshme. Kështu fjalët *shklata, eni* etj. janë bjerrë plotësisht, ndërsa fjalë të tjera si *nek, çish, ç* ( *çfarë, atë që, si* etj), *çilë, çili, çila, shdo* janë zëvendësuar.

Për sa u përket dukurive karakteristike të fizionomisë çame, tek ky brez vihet re<sup>330</sup> përdorimi i tyre, ose më mirë i asaj fizionomie që përdorin më të vjetërit, vetëm se ky përdorim bëhet në rrethana të caktuara, ku folësi gjendet gjithmonë i kushtëzuar nga e folmja, ambienti dhe i tërë konteksti çam.

Në brezin e mesëm janë të shumta edhe interferencat nga e folmja e bashkësisë pritëse në të cilën ato janë vendosur. Duke marrë si shembull bashkësinë pritëse të rrethit të Durrësit, është vënë re se përkarshi formave të ngulitura të standardit në brezin e mesëm gjejnë përdorim në trajta bilinge, disa interferenca nga e folmja gegërishtes së Shqipërisë së Mesme të Durrësit, si:

1. huazimi në këtë të folme i **gjatësisë kompensatore**<sup>331</sup> si pasojë e rënies së ë-së fundore;

2. dukuria e asimilimit paravajhtës në grupet **mb, ng, nd**;

3. shndërrimi i frikatives *s* në afrikaten *c* përpara një zanoreje të theksuar; dukuria e shurdhimit **f: v** (*kasolle>kacolle, njoh> njoft, ba(j)> maj*);

4. palatalizimi i **k-së** në **q** (tek burrat hasim: *maqin, paqet* etj);

5. përdorimi i mbaresës **-j** në vënd të mbaresës **-nj** të emrave mashkullorë.

6. përdorimi i trajtave të zhdrejta të përemrave, *neve, juve* etj;

7. përdorimi i disa përemrave sipas gegërishtes së Shqipërisë së Mesme (dukuri e vërejtur më shumë tek folës pa arsim shkollor), përkatësisht: *kto, kta, tat, tate*.

8. futja në përdorim i përemrit pyetës “ *çfarë*”, si dhe forma e tij e apokopuar “ *ça*”;

9. mungesa e mbaresave të pjesores: *shpëtu, punu, myll, hap* etj;

Brezi i mesëm

1	Prania e dukurive të standardit në të folmen e tyre
---	---

<sup>330</sup> Me ndonje përjashtim të vogël, të atyre dukurive që shfaqin shenja të theksuara bjerrjeje që në brezin e vjetër.

<sup>331</sup>Shih: Çabej, E. *Kuantiteti i zanoreve të theksuara të shqipes*, “Buletin i Universitetit shtetëror të Tiranës”, Seria, shkencat shoqërore, 1957, nr.2, f.207-213

Përpara prof. Çabejt, ai që ka folur për praninë e zanoreve të gjata, por edhe të shkurtra, kryesisht në dialektin e toskërishtes, ka qenë edhe Dilo Sheperi (1927).

Kjo është një dukuri e cila spikat më tepër tek folësit e brezit të mesëm të seksit mashkull, të cilët duke qenë më shumë në kontakt me shoqërinë, janë edhe më të ndjeshëm ndaj ndryshimit.

2	Dukuri të ruajtura të fizionomisë çame (në trajta bilinge dhe të kushtëzuara kontestualisht)
3	Interferenca ( ndërftujtjet) nga e folmja e bashkësive pritëse.

Tek brezi i ri

Dukuri të tjera të cilat janë bjerrë plotësisht dhe nuk gjejnë përdorim tek ky brez megjithë përdorimet e tyre bilinge në brezin e mesëm janë:

1. mungesa e zanores *y* në sistemin fonetik të zanoreve;
2. mungesa e *l*-së së vjetër ndërzanore;
3. bjerrja e grupeve bashkëtingëllore *kl, gl, lk* dhe zëvendësimi i tyre me gjegjëset

*q* ( *qumësht*), *k* ( *klishtë*) / *g* ( *glisht*), *gj* ( *gjuhë*) / *jk* ( *alkë*), *lg* ( *balgë*);

4. fjalët e huazuara nga turqishtja, kanë pësuar rregullimin mekanik të theksit;
5. mungesa e zanoreve të gjata ( përveç disa interferimeve të pakta nga e folmja vendase );
6. bjerrja e diftongjeve ngjitës, përkatësisht zbritës;
7. riaftësimi në përdorim i grupeve *mb, nd, ng* sipas standardit (përveç disa ndërhyrjeve të pakta nga e folmja vendase );
8. përdorimi i foljeve sipas standardit;
9. shmangia e të gjitha dukurive të ndryshme fonetike të çamërishtes në trup të fjalëve tek disa pjesë të pandryshueshme të ligjëratës ( *âtje, ài, kutu, àtë, ù*);
10. zëvendësimi i disa trajtave karakteristike për çamërishten me fjalë të shqipes së përgjithshme ( *çish, nek, eni, shkllata* etj)

**Çamërishtja puthuajse nuk përdoret fare në brezin e ri çam.** Të rinjtë çamë sot, përveç disa interferencave (ndërftujtjeve) të vogla nga bashkësitë pritëse **flasin gjuhë letrare standarde**.<sup>332</sup> Për këtë, folësit e këtij brezi ndihmohen edhe nga prirja që përbashkon sot mbarë brezat e rinj, -përpjekja për të normëzuar dhe pasuruar të folmen e tyre.<sup>333</sup> Faktorë motivues të këtij orientimi janë edhe, prestigji që gëzon gjuha standarde shqipe dhe, origjina e çamërishtes ( pjesë e nëndialektit të toskërishtes jugore). Këto dy faktorë veprojnë njëri me tjetrin në trajtën e dy enëve komunikuese<sup>334</sup>, duke arritur në të vetmin funksion: ndryshimin e së folmes çame kah standardit.

Në të folmen e çamërishtes së brezit të ri çam vërejmë edhe një dukuri tjetër që vështirë të haset në të folmet e tjera. Folësit e këtij brezi janë në shpirt mjaft konservator. Kjo e fundit lidhet me kultivimin shpirtëror të gjuhës, gjë që verifikohet me faktin se ato janë njohës të mirë të së folmes së origjinës. Kjo njohje nxitet edhe nga përdorimet e herëpashërshme të çamërishtes nga gjyshërit e tyre në familje dhe, në rrethana të caktuara nga prindërit apo motrat dhe vëllezërit e mëdhenj. Ato herëpashere retrospektojnë. Perceptimi i vuajtjeve të të parëve të tyre ka kultivuar tek ata revoltën, që shpërthen në ambiente të caktuara, folklorike, në mënyrën e jetesës, në fushën e veprimtarive të ndryshme atdhetare, politike, shpirtërore, etj. Të tëra këto më pas gjejnë deri diku edhe shfaqjet e veta në ligjërim.

Kështu, gjatë fushatës politike 2008- 2009 nga simpantizantë të P.D.I- së së sapoformuar (Partisë Demokratike për Integrim), na bie në sy një frazë e shkruar në të

<sup>332</sup> Kemi vënë re madje që, kur flitet për qytetin e Durrësit, interferencat nga e folmja vendase janë më të mëdha në qendrat urbane sesa ato rurale, për shkak të prestigjit që gëzon sot e folmja e qendrës.

<sup>333</sup> Shkurtaç. Gj: *Sociolinguistika*, SHBLU, Tiranë 2003.

<sup>334</sup> Parapëlqejmë këtu të përdorim një term të spikatur nga prof. Shkurtaç, në veprën e e studiuesit Selman Riza.

folmen çame prej të rinjve: *Oj nu Çamëri mos klaj se na ke ne* (O nënë Çamëri mos qaj se na ke ne). Ajo çfarë kuptojmë përmes këtij shembulli, është se **në brezin e ri çam nuk mund të flasësh për bjerrje të plotë të “dialektit”, për sa kohë që ato nuk janë mohues, por njohës të thellë të së folmes së familjes, paçka se ato paraqiten krejtësisht pasivë në përdorimin e saj.** Ky pasivitet favorizohet edhe nga diferenca e madhe midis të folmes antike çame dhe shqipes së evoluar. Ky faktor na krijon të gjitha mundësitë për ta studiuar këtë të folme, pavarësisht përkatësisë së saj në toskërishte.

Në brezin e mesëm pamë se ishte më e pranishme dukuria e përzierjes dhe ndërhyrja e fortë e faktorëve të jashtëm në ligjërim. Ato herë- herë tërhiqen nga e folmja e bashkësisë pritëse, herë nga ajo e origjinës dhe, në të shumtën e rasteve edhe kah e reja. Dukuria e bilinguizmit është jo thjesht e pranishme, por mbizotëruese në këtë brez. E folmja e tyre luan rol vendimtar për zhvillimin e **dy poleve të kundërta, të lartpërmendura; konservues dhe inovues në të njëjtën kohë.** Pra, në këtë brez **procesi i përzierjes shfaqet në formën e vet më të qartë**, në krahasim me dy brezat e tjerë.

Ne vërejmë që në kontekste çame, ato përdorin të folmen e çamërishtes. **Përmes komunikimit gjithmonë çamërisht me më të moshuarit, ky brez ndihmon jo vetëm në ruajtjen e elementeve çame tek më të vjetërit, por edhe në kultivimin e ndjenjës së fortë për çamërishten tek më të rinjtë.** Për këtë arsye të rinjtë e sotëm janë edhe njohës të mirë të kësaj të folmeje.

Sjellja gjuhësore e individëve të brezit të mesëm ka qenë më e kushtëzuar nga pikëpamja shoqërore. Nga njëra anë, mendësia e izoluar e sistemit diktatorial solli izolimin e të folmes, për rrjedhojë edhe ruajtjen<sup>335</sup> dhe nga ana tjetër në rrethana të caktuara kolektive ato ishin të detyruar ta moderonin atë. **Për këtë arsye edhe ndikimet e bashkësive pritëse kanë qenë më të mëdha tek ky brez.** Ky ka qenë një proces i cili ka ndikuar më pas edhe në ngushtimin e hapësirës së përdorimit të çamërishtes tek më të vegjëlit. Përmes këtij mospërdorimi, ato ndihmuan nga ana tjetër në përmirësimin e ndërgjegjshëm të së folmes së brezave pasardhës.

**Për rrjedhojë, sistemi prej dy enësh komunikuese i studiuesit Selman Riza<sup>336</sup>, mendojmë se do të ishte po aq i përshtatshëm jo vetëm për përshkrimin konvergjent midis gjuhës së shkruar dhe asaj të folur, por edhe në përshkrimin e të folmeve në breza dhe marrëdhëneve që ekziston midis tyre.**

Sikurse e thamë, e folmja e brezit të mesëm është dëshmuar e ndryshimit dhe e përzierjes. Në këtë mënyrë ajo ka shërbyer si urë kalimi midis dy poleve të kundërta ruajtjes dhe rinovimit. Janë pikërisht këto dy forca ato që e bëjnë gjuhën e tyre, sidomos të folmen e brezit të ri jo vetëm interesante, por edhe të ndryshme nga të folmet e tjera. Për vlerat e të folmes së çamërishtes dhe nevojën e saj urgjente për t'u studiuar, flasin qartë edhe dukuritë e mëposhtme:

Në çamërishten e sotme të brezit të vjetër çam, vërejmë ende dukuri të gjuhës së Buzukut, si: ruajtja e zanoreve të gjata; mungesa në sistemin fonematik të zanore-y; trajta e shkurtuar e përemrit vetor *ù* ( unë); ruajtja e l-së së vjetër ndërzanore; mungesa e j-së antihiatizuese; ruajtja e togjeve bashkëtingëllore *kl, gl*; shndërrimi i grupeve bashkëtingëllore *gjt, qt* në *jt*; prania e mbaresave të dhanores shumë, *-e/ ve*; prania e mbaresës inovuese *-imë*; ngjashmëria e disa trajtave foljore të së tashmes (mbaresat), të pakryerës (forma joveprore), të foljeve të zgjedhimit në *mi* etj.

<sup>335</sup> Mendojmë se izolimi është një faktor psikologjik i mbylljes në vetevete, për rrjedhojë edhe i kushtëzimit gjuhësor të të folurit.

<sup>336</sup> Term të cilin e kemi hasur për herë të parë në një prej kumtesave të prof. Shkurtajt- t:

Disa prej këtyre dukurive si: ruajtja e **zanoreve të gjata**, **l-ja** e vjetër ndërzanore, ruajtja e togjeve bashkëtingëllore **kl, gl, pl, bl, fl** etj, i gjejmë edhe tek të folmet e arbëreshëve të Italisë.<sup>337</sup>

E megjithatë, në mbyllje parapëlqejmë të citojmë diçka me vlerë, duke plotësuar atë çka përmendëm edhe pak më lart prej studiuesit Selman Riza:

“Në qoftë e vërtetë se gjuha e shkruar dhe gjuha e folur formojnë një lloj sistemi **dy enësh komunikuese**, herë e shkruara si model tërheqës duke pikuar në gojoren, herë gojorja si burim ushqyes duke rrjedhur në të shkruarën; është gjithashtu një fakt se këto të pikua e të rrjedhura, edhe në mos përfshifshin trupa të huaj të njërës gjuhë në tjetrën, përbëjnë shtresa të dallueshme në secilën prej tyre..... . . . . . Është e vërtetë se gjuhës deri atëherë vetëm gojore të çdo populli pasqyrimi shkrimor ia tejshkriu kufijtë e përdorjes... . Por është gjithashtu fakt se, edhe mbas krijimit të gjuhës së shkruar, gjuha gojore e çdo populli vazhdoi të përdoret gjithënjë makar në rrethana pa krahasim më pak botore, madje edhe të zhvillohet më tej makar në një masë pa krahasim modeste se gjuha e shkruar”.<sup>338</sup> **Autori pohon në këtë mënyrë se gjuha letrare dhe gjuha e folur kanë secila arsyet e veta pse ekzistojnë dhe rëndësinë e vet në sferën e kumtimit.**

### **3.2. Roli i standardit në unifikimin e gjuhës dhe rrafshimin e diferencave në sjelljen gjuhësore të individit.**

Sot janë mbajtur një sërë konferencash shkencore të cilat si temë bosht kanë pasur çështjen e standardit të shqipes dhe kryesisht shqipen nën rrjedhat e globalizimit në të cilat me të drejtë, gjithmonë brohoritet për mbrojtje të standardit, pasurim e përtëritje të tij.

Në këtë prizëm, nuk mund të anashkalojmë për asnjë çast vlerat e dialekteve. Pra, sot duhet marrë seriozisht edhe sëmundja globale e zhdukjes së tyre. Shumë studiues, të huaj dhe shqiptarë kanë pohuar dhe pohojnë rëndësinë e dialekteve si burime me vlerë për pasurimin e gjuhës letrare. Të të njëjtit mendim kanë qenë edhe mendimtarët me te shquar të kombit tonë, si Fishta, Konica, Mithat Frashëri kur kanë thënë se: “Tharmi i gjuhës shqipe ruhet në të folurit e popullit.”<sup>339</sup> Të të njëjtit mendim janë edhe studiues të huaj. Kështu Berruto thekson se “gjuhët dhe kulturat e ndryshme edhe ato minoritare duhen ruajtur dhe mbrojtur dhe jo t’i shtyjmë ato drejt zhdukjes.”<sup>340</sup>

Për vendin tonë mendojmë se “**mbrojtja e gjuhës simbol e kombit**” përfshin në vetvete “mbrojtjen e gjuhës simbol “**të krijuar**” dhe atë “**natyrale**”. Për këtë dhe vlera të tjera që dialektet mbartin, mendojmë se të luftosh për mbrojtjen e gjuhës simbol të një kombi, do të thotë që patjetër, të luftosh për mbrojtjen e dyjave njëkohësisht: gjuhës simbol të krijuar konvencionalisht dhe përmes një lufte të nëntëshme të luftohet për mbrojtjen e gjuhës natyrale dhe të lindur të kombit, me qëllim filtrimin e “mikroelementeve” të domosdoshme për një standard të mbrojtur mirë, që të na përfaqësojë denjësisht, **por edhe të bukur.**

Gjuha standarde luan një rol të rëndësishëm në unifikimin e gjuhës dhe rrafshimin e diferencave në sjelljen gjuhësore të individit. Një pohim të tillë e kemi argumentuar përmes dy shembujve: Së pari, përmes studimit të diferencave gjuhësore

<sup>337</sup> Për më tepër shih: Troplini, E, *Bashkëpërkime të elementeve gjuhësore të veprave më të hershme shqipe me çamërishten e sotme*, në Alb- Shkenca, (Takimi i IV-ët) Tetovë, 2009

<sup>338</sup> Riza, S. *Mbi kriteret e periodizimit të historisë së gjuhës shqipe*, në “ Studime albanistike”, Rilindja, Prishtinë, 1979, f.114-116 cituar nga Shkurtaç, në *Sociolinguistika shqiptare*.

<sup>339</sup> Hamiti, S. “*Letërsia moderne shqiptare*”, Tiranë 2000.

<sup>340</sup> Berruto, G. *Sociolinguistica*, Bologna 1974, 1994 ( ribotim).

midis të së ashtuquajturës “*shqipe zyrtare*” dhe “*e folme krahinore*”; së dyti, përmes shqyrtimit të diferencave që lidhen me fushën e paragjykimit gjuhësor.

Le t’i vëzhgojmë me radhë këto dy pika.

E para, vërtetohet më së miri gjatë vëzhgimit dhe studimit të të folmeve krahinore në kuadër të lëvizjeve mekanike të popullsisë së pas viteve ’90. Hendeku që krijohet midis variantit tradicional dhe atij letrar shpesh është bërë shkak për paragjykimë në sjelljen gjuhësore të individit.

Siç e theksuam në shembullin për çamërishten, por që është provuar prej shumë studiuesve që kanë marrë në shqyrtim të folme të tjera të bashkësisë tonë gjuhësore, folësi do të orientohet ndaj të folmes më **me prestigj që përkon me standardin**. Siç thotë edhe Hudson: “ në konfliktin midis vlerave të grupit me bazë krahinore, shoqërore dhe vlerave të kombit; -vlerat e kombit mund të triumfojnë në kurriz të grupit më pak të fuqishëm.”<sup>341</sup> Por, në këtë pikë nuk është për të mos u marrë në konsideratë edhe mendimi i Labovit sipas të cilit kjo gjë paguan një haraç të madh duke çuar në nënvlerësimin e shumë prej formave gjuhësore karakteristike të grupit të vet... Fëmijët që braktisin format e grupit lokal dhe bëjnë të vetat ato forma që përgjithësisht janë pranuar në nivel kombëtar, bëjnë të vetat në të vërtetë format që janë simbole identifikimi të një grupi tjetër.<sup>342</sup>

Duke mos mohuar kurrë ndihmesën e citimeve të sociolinguistëve për studimin e një të folmeje **theksoj se, pohimet e mësipërme ku më shumë dhe ku më pak janë të ndjeshme në përshtatje me jetën e secilës prej të folmeve. Të folmet krahinore nuk orientohen të gjitha njëjloj kah gjuhës standarde.**

Duke dashur të përgjithësojmë i rikthehem i folmes tonë.

Çamërishtja sot bashkohet me atë prirje që përbashkon mbarë të folmet, orientimin kah gjuhës me prestigjin më të madh. Në këtë drejtim ajo ndihmohet edhe sepse është pjesë e dialektit të toskërishtes. Por, nga ana tjetër, e folmja që ne kemi marrë si shembull mendojmë se është dëshmuar e atij pohimi që prof. Shezai Rrokaj ka bërë me të drejtë për të folmet dialektore “*Shqiptarët po lëvizin lirshëm brenda trojeve tona e, bashkë me ta , idetë, traditat, fjalët. Për shumë arsye, është thyer koncepti i enklavës gjuhësore dhe territori si koncept gjeografik nuk shërben më për përkufizimin e dialektit, i cili nën trysninë e shoqërisë globale, po hyn në një marrëdhënie sociolekti me standardin dhe gjithëgjuhën.*”<sup>343</sup> Mendojmë gjithashtu se ky pohim vendos një kufi ndarës midis dy disiplinave: dialektologjisë dhe sociolinguistikës, madje do të shtonim se përkufizon më së miri sociolinguistikën.

Është e vërtetë se, lëvizjet e shpeshta të kësaj popullsie në kohë shpjegojnë edhe gjendjen statike të së folmes së çamërishtes. Kjo gjë shpjegohet me vetë faktin se vetë rrafshet ( sinkronik dhe diakronik), i shërbejnë njëri- tjetrit) Nga ana tjetër, një ndër faktorët e jashtëm më të rëndësishëm me peshë të konsiderueshme për këtë të folme është **mënyra sesi kjo bashkësi e shpërndarë është integruar brenda bashkësive pritëse në Shqipërinë shtetërore pas 1944-ës.**

Pas një studimi të thelluar disavjeçar për çamërishten, kemi arritur në këto përfundime:

Tek e folmja e çamërishtes dallohen qartë tiparet e dy varianteve a llojeve të të folurit, variantit tradicional, ku spikat ruajtja e elementeve të qëndrueshme të sistemit

<sup>341</sup> Sipas Hudson, A. R. *Sociolinguistika* (botimi i parë në shqip), Tiranë 2002, f.233, cituar edhe në punimin *Teoria e deficitit gjuhësor në kuadrin e kontakteve të sotme të shqipes*, kumtuar dhe botuar në "Seminarin Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën shqiptare, f. 377, Prishtinë 2010"

<sup>342</sup> Hudson, A. R.: Po aty

<sup>343</sup> Rrokaj, SH: *Të gjithë shqiptarët duhet të flasin shqipen standarde*, në gazeta “Panorama”, dt. 15/ 12 / 2010



të vjetër dhe variantit të ri<sup>344</sup>, që pasqyron më gjerë shndërrimet dhe ndryshimet e sistemit nën trysinë e makrosistemit.<sup>345</sup>

Por, megjithëse në dukje dy kahet a anët e procesit të zhvillimit gjuhësor në mjedisin çam, si kudo në Shqipëri, janë ruajtja (konservimi) dhe përtëritja (rinovimi) e të folmes në drejtimin e rrafshimve standardizuese dhe globalizuese, siç e pohuam edhe më lart, **tek kjo e folme shfaqet dukshëm edhe një proces i tretë** i cili është po aq i rëndësishëm sa ai i pranisë së dy të parëve. Përsërisim edhe një herë çfarë kemi thënë, për të kuptuar më mirë temën në fjalë:

Në mënyrë konvencionale e kemi quajtur atë “një proces **përzierje (bashkëveprimi)**”, i cili luan rolin e një ndërlihdësi midis të folmes arkaike dhe të folmes së moderuar çame. Dukshëm ky lloj procesi shfaqet në brezin e mesëm tek i cili ruan edhe ekuilibrin më të madh. Roli i tij këtu përngjason me atë të një “kanali” (koridori) komunikues midis dy brezave. Pra, është një proces i tillë, i cili në vetvete përfshin risimin, përkatësisht **ndryshimin** e të folmes në brezin e vjetër, pak a shumë në atë masë sa brezi i ri **kultivon** elementin e vjetër çam, përkatësisht **ruajtjen** e të folmes në të. Prosesi i përzierjes apo i bashkëveprimit, ka të bëjë në vetvete me një proces hinkëzimi a shoshitjeje të vazhdueshme; një proces natyral dhe i nevojshëm që vendos për ato dukuri që do t’i nënshtrohen bjerrjes, ruajtjes, risive, shndërrimeve, ndryshimeve, situatave bilinge, shkeljeve në normën e të folurit etj. Këto të fundit gjithmonë janë të kontrolluara nga një normë zyrtare, por edhe qytetare.

Konkretisht tek brezi i mesëm vërejmë **ndërthurjen** midis dy të folmeve. E folmja e tyre është **ruajtëse** aq sa është edhe **rinovuese**, pasi atyre u lind si detyrë të përshtasin të folmen herë kah e folmja e më të vjetërve në moshë dhe, herë nga ajo e fëmijëve dhe e jetës jashtë familjes. Nga ana tjetër të tri këto procese shfaqen njëkohësisht në të folmen e secilit brez. Pra, e folmja e brezit të vjetër është konservative, por nuk ka mbetur e paprekur. Ajo priret drejt ndryshimit, motorit të evolucionit të gjuhës. Në të vërejmë fjalë të standardit letrar dhe më rrallë, fjalë të bashkësisë pritëse në të cilën ato janë vendosur.

E folmja e brezit të mesëm në bashkëpërshtatje me faktorë të ndryshëm jashtëgjuhësorë (ku rol të dorës së parë marin elementet e veprimtarisë ligjërimore në komunikim), herë përshtatet me të folmen dialektore, pra me variantin tradicional të brezit të vjetër dhe herë me variante të brezit të ri, që synojnë standardin. Në të folmen e këtij brezi, ndërfitjet (interferimet) e elementeve të bashkësisë pritëse janë më të shumta në krahasim me dy brezat përkatës.

E folmja e brezit të ri orientohet kryesisht nga standardi<sup>346</sup>. Megjithatë ajo nuk është krejtësisht standarde; kultivon edhe ruajtje; në të gjejmë edhe elemente të bashkësive pritëse.<sup>347</sup>

*Gjatë vëzhgimit në institucionet shkollore nxënësit me origjinë çame mund t’i identifikojë ose nga mbiemri i tyre, ose gjatë një vëzhgimi afatgjatë të së folmes nga ndonjë rrëshqitje e rastit e ndonjë dukurie kryesisht fonetike. Kjo do të thotë se standardi përmbush me sukses funksionin e tij në institucionet tona dhe prirja e tij unifikuese mbizotëron.*

<sup>344</sup> Shkurtaç, Gj: *Disa dukuri të së folmes së Kurbinit në dritën e sociolinguistikës*, SF, 1998.

<sup>345</sup> Shkurtaç, Gj: *Sociolinguistika*, SHBLU, Tiranë 2000.

<sup>346</sup> Troplini, E. *E folmja e çamërishtes në kuadrin e marrëdhënieve gjuhë standarde- dialekt*, në “Seminari i 28- të Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën shqiptare”, Prishtinë, 2009.

<sup>347</sup> Troplini, E. *E folmja e çamërishtes në kuadrin e marrëdhënieve gjuhë standarde- dialekt*, kumtesë e mbajtur në konferencën shkencore të albanologjisë, Prishtinë, Gusht- 2009; *Disa tipare ruajtëse të çamërishtes*, “Universi”, Tiranë 2009; *Ndikimi i disa prej faktorëve jashtëgjuhësorë në të folmen e çamërishtes*, në “Çështja çame dhe integrimi evropian”, Tiranë 2009

Proceset e lartpërmendura të argumentuara përmes të folmes çame, si dhe ky përfundim nuk përjashtohen edhe për të folme të tjera dialektore<sup>348</sup> por, siç e thamë, **ato janë të ndryshme në përshtatje me të folme të caktuara.**

Ajo çfarë na ka tërhequr vëmendjen tek e folmja në fjalë është edhe **ritmi** i ndryshimit. Siç e pohuam, një peshë të konsiderueshme në zhvillimin dhe ndryshimin e të gjitha varieteteve gjuhësore çojnë kryesisht faktorët jashtëgjuhësorë. Janë këto faktorë të cilët bëjnë që disa të folme, ta kenë zhvillimin kah shqipes së përgjithshme më të **ngadaltë, në krahasim me të folmet e tjera.**

Kështu, në lidhje me të folmen e çamëve dhe atë të arbëreshëve të Italisë, një ndër faktorët e jashtëgjuhësorë, me një forcë të konsiderueshme ndikuese në procesin e konservimit të këtyre dy të folmeve është faktori psikologjik, i cili lidhet me shkakun e shpërnguljes së këtyre popullsive me fate të njëjta, që padyshim nuk është i njëjtë, por që kushtëzon njëllot të folmet. Mendojmë gjithashtu se të folmet anësore në përgjithësi kurdoherë kanë trashëguar dhe trashëgojnë një bazë të përbashkët që i identifikon me shqipen dhe, zhvillimi kah shqipes së përgjithshme **përkufizohet më i ngadaltë, pasi këtyre të folmeve u kanoset nga dita në ditë edhe rreziku i zhdukjes.**

Forca që karakterizon të folmen e çamërishtes, të folmen arvanitase apo atë të arbëreshëve të Italisë, është nga njëra anë, -ruajtja, konservimi, pasi dukuritë karakteristike të fizionomisë së tyre gjallojnë ende sot; dhe nga ana tjetër, zhvillimi i këtyre të folmeve nën trysinë e faktorëve gjuhësorë dhe jashtëgjuhësorë etj. **Pra, ato karakterizohen nga dy pole të fuqishme dhe krejtësisht të kundërt: ruajtja dhe risimi, tërheqja e të cilëve sjell ekuilibër.** Kjo është edhe arsyeja pse këto të folme kanë qenë, janë dhe do të jenë, sigurisht nese ne arrijmë të kuptojmë siç duhet vlerat e tyre.

Sa më shumë thellohet hendeku midis gjuhës standarde apo shqipes së përgjithshme dhe të folmeve në tërësi, aq më të mëdha bëhen edhe dallimet semantike, për rrjedhojë rritet edhe vështirësia në komunikim. Të gjithë e dimë që me një arbëresh jo të shkolluar nuk është e lehtë të komunikosh, e njëjta gjë mund të ndodhë me një individ që i përket toskërishtes veriore apo jugore, me një arbëresh apo arvanitas etj.<sup>349</sup> Në vështirësi ndjehet edhe një shqipfolës i thjeshtë në komunikim me një çam të moshuar, **por shkalla e vështirësisë në komunikim midis këtyre folësve nuk është e njëjtë.**

Edhe një herë përsërisim si privilegj të këtyre të folmeve ekuilibrin: rinovues - konservues, me gjithë dyshimin që mund të kemi për disa prej tyre, siç është arvanitishtja. Mendoj se kjo duhet të jetë edhe arsyeja bazë pse studiuesit arbëreshë ngrënë me të madhe problemin e ruajtjes të së folmeve që rrezikojnë të zhduken. Sigurisht këtu futet edhe e folmja e çamërishtes.

Në këtë prizëm, mendojmë se edhe të folmeve brenda territorit shqiptar u kanoset sot një rrezik i madh, pasi nga dita në ditë ato po përfshihen përherë edhe më shumë nga rrjedha globalizuese dhe gati po bëhen njësh me standardin. Në këtë drejtim ato ndihmohen mjaft edhe nga fakti se dy kryedialektet tona kanë qenë shumë të afërt me njëri- tjetrin qysh herët dhe më pas ato janë larguar. Lidhur me gjë të tillë

<sup>348</sup> Gjatë vëzhgimeve në arsimin nëntëvjeçar dhe atë parauniversitar vëzhguam ndoshta pa ndonjë qëllim specifik të gjithë nxënësit dhe hasëm të njëjtën vështirësi në lidhje me identifikimin e origjinës së tyre.

<sup>349</sup> Shkurtaç, Gj. *Rreth ndryshimeve në gjuhën e fshatit të sotëm të Veriut*, në "St. fil." 4, 1969; *Vëzhgime mbi shtresat leksikore dialektore dhe letrare në të folmen e Lezhës*, në "St. fil." 3; (1984) *Shtresëzime dhe risi gjuhësore në qytetin e Lezhës*, në "St. fil." 2, 1984; *Disa dukuri të së folmes së Kurbinit në dritën e sociolinguistikës*, SF, 1998; *Sociolinguistika*, Tiranë 2003.

mendojmë se me gjithë largësinë ndërmjet tyre ato vazhdojnë të jenë të afërt me njëri tjetrin dhe, orientimi i tyre kah standardit bën që shqipja e përgjithshme të futet paksa në rrjedhat e një “kodi të përparuar”. Pra, diferenca “kod i ngushtë” dhe “kod i përparuar” nuk është dhe aq e dukshme në rastin e shqipes. Siç e vërtetë me lart, ndryshe ndodh me të folmet anësore, rajonale, të folmet e diasporës, ku ekziston një lloj difference midis dy kodeve e cila është më e dukshme. Jo më kot gjatë këtij kapitulli i kemi vendosur këto të folme në një emërues të përbashkët.

Lidhur me të folmet brenda e Shqipërisë shtetërore në tërësi duhet të kemi gjithmonë parasysh se standardi dhe dialektet duhet të shërbehen reciprokisht njëri nga tjetri. Sipas Berrutos, politika kulturore dhe gjuhësore rrezikon në çdo moment të imponojë modele dhe kultura të grupeve shoqërore të fuqishme në një bashkësi, përkundrajt grupeve më pak të fuqishme. Kështu unitet kulturor sipas tij do të thotë diskriminim dhe humbje të kulturave të nënvlefësuar për një kulturë zyrtare të përfaqësuar nga klasa më të fuqishme. Sipas këtij autori, por që me të cilin ndajmë të njëjtin mendim, uniteti gjuhësor nuk mjafton për një komunikim të suksesshëm. Andaj, për të përmirësuar komunikimin ndërmjet llojeve dhe grupeve të një bashkësie, nuk është e thënë që të mbështetemi vetëm tek një gjuhë unike për të gjitha grupet, por një bashkësi e caktuar duhet të mbështetet në grupe kulturore dhe gjuhësore të ndryshme që zhvillojnë vlerat e secilit prej tyre. Kjo sipas tij është garancia e vetme që një bashkësi të shquhet për një komunikim të vertetë dhe një zhvillim real socio-kulturor.

Kemi të bëjmë pra me një larmi faktorësh të cilët na çojnë në konkluzione me interes rreth marrëdhënieve të sotme: e folme krahinore e një tipi të caktuar (në rastin tonë, çame), e folme etnike etj. - gjuhë shqipe standarde.

**Nga ana tjetër, asnjëherë këto lidhje nuk janë parë jashtë raportit kulture krahinore- kulture qytetare, pasi gjuha nuk mund të shihet jashtë raportit gjuhë- kulturë, gjuhë – mendim.** Një tjetër shembull tipik për këtë, janë edhe diferencat gjuhësore që lidhen me fushën e paragjykimit gjuhësor.

Po vijojmë me një analizë të shkurtër edhe pse ndoshta nuk është në koherencën e gjithë punimit, por që është e udhës të bëhet lidhur me një temë të tillë.

Ndër pesë faktorët e diferencimit dhe të diversitetit të sjelljes gjuhësore të individëve në një bashkësi gjuhësore të dhënë (mosha, seksi, grupi etnik, klasa ekonomiko- shoqërore dhe niveli i arsimit)<sup>350</sup>, kemi parapëlqyer të bëjmë një sprovë, duke lëvruar në disa tema njërin prej faktorëve jo dhe aq të lëvruar nga pikëpamja empirike, pikërisht **klasën ekonomiko- shoqërore**. Fillimisht kemi parë sesi reflektohet ky dallim tek folësit çamë. Në aspektin gjuhësor ky është një dallim i cili është pasqyruar dukshëm edhe në gjuhë kryesisht në kohën e përplasjes së dy bashkësive, asaj çame e cila i përkiste një shtrese krejtësisht të dallueshme nga ajo e bashkësisë pritëse të varfër shqiptare. Pra, ky faktor jashtëgjuhësor social- ekonomik e kulturor, patjetër ka pasur pasqyrimin e vet edhe në gjuhë, dëshmitë e të cilit i vjelim edhe sot në brezin e vjetër.<sup>351</sup> Vetëm se, lidhur me çamërishten në shqyrtimet për një temë të tillë duhet marrë në konsideratë fakti se kemi një mospërputhje për sa i takon deficitit gjuhësor ku folësit e bashkësive pritëse janë në avantazh (çamërishtja paraqitet më arkaike, ndërsa shqipja më e evoluar); porse për sa i përket deficitit social ndodh e kundërta ( bashkësia pritëse ishte më e varfër në krahasim me bashkësinë çame). Një studim mjaft interesant do të ishte ky për sociologjinë e gjuhës,

<sup>350</sup> Shkurtaç, Gj. *Sociolinguistika shqiptare*, SHBLU Tiranë 2003

<sup>351</sup> Shih për më tepër në disertacion temën “ Roli i faktorëve jashtëgjuhësorë në të folmen e çamërishtes” f. 118.

megjithëse mbetet gjithmonë fakt që kemi të pranishëm një lloj deficiti social ekonomik dhe kulturor , si dhe gjuhësor (jo në të njëjtin kah).

I pari që ka studiuar një dallim të tillë është Basil Bershtajni i cili argumenton hipotezën e tij të **deficitit gjuhësor**. Ai niset nga niveli i ulët arsimor i fëmijve të klasës së thjeshtë punëtore dhe hedh idetë e tij të para socio- pedagogjike. Bershtajni i ka mbetur besnik tezës qendrore që gjuha e shtresës së ulët është më pak e kualifikuar dhe më e ngushtë se ajo e shtresës së mesme dhe jo vetëm kaq por, suksesi i individëve në një shoqëri të caktuar, të mirat dhe privilegjet sociale që ato gëzojnë varen padiskutuëshëm nga kuadri i një organizimi të mirë të përdorimit të tyre gjuhësor. Pra, kemi një sjellje gjuhësore të veçantë sipas shtresës dhe nga teoria e tij **del se shtresa e ulët** është në disavantazh për një përdorim gjuhësor të pamjaftueshëm dhe të ngushtë. Të gjitha këto diferenca konsolidohen në planin psikologjik të individit, duke tejkaluar kapacitetin njohës.

Pohimi i Bershtajnit për raportin ndërmjet kapacitetit shprehës gjuhësor dhe eksperiencës psiko-sociale nuk është i ri. Ai është i pranishëm tek tezat e relativitetit gjuhësor të Sapir- Ēhorfit. Këtu është fjala për lidhjen që ekziston midis gjuhës dhe mendimit, gjuhës dhe kulturës. Sipas Gabriela Klein,<sup>352</sup> Bershtajni u është referuar shpesh tezave të relativitetit gjuhësor dhe ajo çfarë i bashkon këta dy studiues është pikërisht fakti se që të dy shohin një lidhje të ngushtë ndërmjet gjuhës dhe funksionit të saj si formuese eksperiencash. Bershtajni arrin edhe në përfundimin se duhen hartuar prespektiva të qarta të politikës arsimore me qëllim që të jepet një farë kontributi në rrafshimin e disbarazive shoqërore.

Lidhur me rolin e gjuhës së shkruar dhe asaj të folur në rendimentin mësimor Hudson e kritikon teorinë e deficitit gjuhësor<sup>353</sup>, sipas së cilës fëmijët e klasave më të ulta kanë rendiment të ulët në mësim për shkak të mangësive të disa mjeteve veçanërisht gjuhësore të cilat nuk janë në nivelin që kërkon shkolla. Ai thotë gjithashtu se tezat e tij shkarkojnë nga përgjegjësia në radhë të parë mësuesit të cilët mund të jenë edhe shkak fillestar i kësaj pasoje. Ndërkohë, Hudson përmend të gjithë ato aspekte që ndikojnë në uljen e rendimentit mësimor dhe sipas tij gjuha nuk është i vetmi komponent vlerësues. Pra, në njëfarë mënyre ky sociolinguist hedh vështrimin edhe tek disa përbërës të tjerë të rëndësishëm që kanë lidhje me politikën arsimore në tërësi dhe ato gjuhësore që ndikojnë në rendimentin mësimor. Hudson shprehet se nëse mësuesit do t'i vlerësonin nxënësit duke u ndikuar nga diferencat në të folur sipas dallimeve etnike, dialektore, apo sipas shtresës dhe nëse marrim në konsideratë faktorët e tjerë psikologjikë, do të ishte humbje kohe për nxënësit që të synonin të përmirësonin mënyrën e tyre të të folurit, edhe sikur të donin.<sup>354</sup>

Nga ana tjetër, mendoj se të gjitha vendet më pak të zhvilluara, përfshirë edhe Shqipërinë karakterizohen jo vetëm nga mësues të tillë, por siç e përmendëm edhe më lart ato janë bërë objekte të paragjyqimeve shoqërore. Për këtë arsye, e gjithë kjo analizë e të ashtuquajturve sociolinguistë lidhur me një çështje të tillë s' do të kishte kuptim pa mendimin e Xhiliolit (Giliolit) se, është e vështirë të arrish në konkluzione të pëlqyeshme të politikës gjuhësore, për sa kohë që niveli i zhvillimit politik, ekonomik, dhe social është krejt i ndryshëm për vende të ndryshme. Programet dhe projektet e planifikimit gjuhësor duhet të jenë të tilla që t'u përshtaten vendeve të veçanta.<sup>355</sup>

<sup>352</sup> Klein, G., "La sociolinguistica": Orientamenti della ricerca negli Stati Uniti, in Gran Bretagna e nella Repubblica federale tedesca - Firenze : La nuova Italia, 1977.

<sup>353</sup> Richard . A. Hudson, *Sociolinguistika*, (përkthyer në shqip, nga M. Ymeri), Dituria Tiranë 2002.

<sup>354</sup> Richard . A. Hudson, po aty.

<sup>355</sup> Gilioli, P. P., *Linguaggio e società*, 2000.

**Kështu pra, edhe Shqipëria kërkon programe të posaçme që do të mund t'i përshtateshin kontekstit dhe situatës në të cilën ne ndodhemi.**

Në këtë mënyrë, sociolinguistika shqiptare duhet të njohë zhvillimin e saj përmes hulumtimeve në fushë të studimit dhe sigurisht s'ka si të jetë e njëjtë me atë të vendeve të tjera.

Gjithësesi lidhur me teorinë e dallimit sipas shtresave, nga përpjekja që kemi bërë rreth një sprove në trajtimin e problematikës gjuhë dhe shtresë shoqërore, duke u nisur fillimisht nga deficitit gjuhësor që u krijua prej kontaktit midis dy bashkësive: bashkësisë çame dhe asaj shqiptare ( të Shqipërisë shtetërore)<sup>356</sup>, vumë re se ky dallim nuk gjen sa duhet një terren të përshtatshëm për t'u trajtuar tek ne pasi vetë dallimi social në Shqipëri është i papërfillshëm. Por, si në shumë vende të botës edhe për Shqipërinë mund të jepet një përgjigje: ky dallim sipas shtresës në Shqipëri reflektohet qartë në dallimin midis të së ashtuquajturës shtresë qytetare dhe shtresë fshatare<sup>357</sup>, por pa bërë hulumtime të thella mendoj se kjo diferencë ndjehet në aspekte të tjera dhe jo në rendimentin mësimor, për të cilin bashkohemi me mendimin e Hudsonit dhe shumë të tjerëve.

Konkretisht, mendimi ynë lidhur me një çështje të tillë, është se vërtet ekziston njëfarë difference në sjelljen gjuhësore të nxënësve që kushtëzohet nga disbarazia shoqërore, por, përfundimi rreth kësaj teorie është se, **dëmi që ky deficit shkaktonte nuk është në atë masë që s'mund të përballohet.**<sup>358</sup> Marim shembullin e emigrantëve, të cilët studiuesi italian Don Milani i quan "të shkretë" në këtë drejtim pasi sipas tij ato janë viktima të një deficitit gjuhësor që i pengon nga mundësia e të marrit pjesë në mënyrë aktive në jetën shoqërore dhe politike të bashkësisë.<sup>359</sup> Të gjithë e dimë që shkalla e vështirësisë së një fëmije të huaj, apo një fëmije mysafir në një bashkësi tjetër pritëse (që vijnë nga familje të thjeshta punëtorësh), për t'ia përshtatur të folmen bashkësisë në të cilën ai shkon është e paevitueshme. Por, jeta ka provuar që fëmijë punëtorësh, emigrantë, fëmijë të shpërngulur nga zonat më pak të preferueshme në zona më të privileguara, **kanë shkëlqyer** pavarësisht deficitit të tyre gjuhësor, apo deficitit shoqëror, ekonomik, klasor (me të cilat gjuha lidhet). Dhe nga ana tjetër, ne jemi të bindur se ky deficit nuk ul rendimentin në shkollë, në punë, në jetë, në atë masë sa të bëhet faktor pengues. Sigurisht, **individët për të cilët po flasim, paguajnë një haraç të madh për ta mposhtur këtë lloj vështirësie, përkundrejt pjesës tjetër të privileguar.**<sup>360</sup>

Megjithëse Bershtajni qe mjaft i kritikueshëm, si zgjidhje për të gjitha çështjet e diskutuara deritanimë mbetet përsëri mendimi i tij se "duhen hartuar prespektiva të qarta të politikës arsimore me qëllim që të jepet një farë kontributi në rrafshimin e të gjitha disbarazive në ligjërim."

Nga ana tjetër, çdo politikë gjuhësore përfaqësohet përmes standardit dhe ky i fundit ka vlerë unifikuese për të gjitha diferencat. Llojet e pabarazive në ligjërim janë

<sup>356</sup> Pa iu nënshtruar studimeve të thelluara lidhur me një çështje të tillë.

<sup>357</sup> Një dallim midis këtyre dy shtresave e ka nënvizuar edhe prof. Shkurtaç në librin e tij të sociolinguistikës (Sociolinguistka shqiptare, shblu, Tiranë 2003)

<sup>358</sup> Troplini, E. *Problematika "gjuhë dhe shtresë shoqërore" në Shqipëri*, kumtesë e mbajtur në konferencën ndërkombëtare të Fakultetit të Edukimit, pranë Universitetit shtetëror të Durrësit.

Troplini, E. *Teoria e deficitit gjuhësor në kuadrin e kontakteve të sotme të shqipes*, kumtesë e mbajtur në Seminarin e XXIX të gjuhës, letërsisë dhe kulturës shqiptare në Prishtinë, 2010.

<sup>359</sup> Melone, E. & Poggiali, L. *Sperimentazione di testi a "scrittura controllata"* in *Unità didattiche di storia, temë diplome, nën drejtimin e Roberta Grassit, 2004/2005*. Sipas autoreve në fjalë shih edhe De Mauro, T., "La crisi della pedagogia linguistica tradizionale". *Scuola e società*, 1976.

<sup>360</sup> Troplini, E. *Teoria e deficitit gjuhësor në kuadrin e kontakteve të sotme të shqipes*, kumtesë e mbajtur në Seminarin e XXIX për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën shqiptare, Prishtinë, 2010.

të shumëllojshme, dhe, për këtë arsye dhe politikat standardizuese nuk mund të jenë vetëm politika arsimore, por **gjuhësore** në një rrafsh më të gjerë<sup>361</sup> me qëllim që të mbulojnë shkeljet në të gjitha regjistrat përfshirë edhe ligjërimin e shkujdesur dhe atë bisedor<sup>362</sup>

**Pra, norma letrare në këndvështrimin e ngushtë lidhet me planifikimin shkollor dhe në një këndvështrim më të gjerë, me planifikimin gjuhësor në tërësi.**

I pari, përfshin vetëm politikën gjuhësore që do të mund t'i shërbente më së miri nevojave të shkollës, ndërsa i dyti përfshin mbarë politikën gjuhësore që do t'i shërbente folësve jashtë këtij institucioni, në tërë hapësirën multidimensionale.

Megjithëse gjuha nuk mund të jetë kurrësesi njësi matëse e intelektit të nxënësit, studentit, apo të një individi në një shoqëri të dhënë, shpesh ajo përdoret edhe si një parametër vlerësimi. Sidomos në shoqërinë tonë ajo kushtëzohet nga konteksti, duke i mbivendosur asaj modele jashtë normës dhe duke krijuar një tendosje të sforcuar të saj. Kushtëzimet shoqërore janë të pashmangshme në gjuhë, saqë ndonjëherë në varësi të vendeve të ndryshme, por sidomos të vendeve në zhvillim, krijohen modele duke e modifikuar atë në kundërshtim me normën dhe si e tillë ajo kushtëzon më pas edhe sjelljen gjuhësore të individit. Kohët e fundit në Shqipëri janë vënë re dy lloj “shqipesh”: “shqipe e përgjithshme” dhe “shqipe moderne”.<sup>363</sup> Kjo e fundit bazohet krejtësisht tek ajo çfarë Hudson pohon: F thjesht ka thënë XXXX ; njerëzit që flasin kështu janë të tipit (T); njerëzit e tipit T janë të këndshëm, dhe prandaj F është i këndshëm.<sup>364</sup>

Në rrjedhën e pashmangshme të zhvillimit, gjuha duhet të shoqërohet herë pas here me politika të reja standardizuese **ripërtëritëse**. Ato duhet të përmirësohen shpesh, duke respektuar **zgjedhjet e lira** të gjuhës dhe normëzuar gjithçka çfarë nuk e dëmton atë. **Baza është norma gjuhësore e cila mban në kontroll ligjërimin**. Ajo vendos rregullat dhe udhëzon institucionet përkatëse arsimore dhe shtetërore në tërësi. Mjeti kryesor në përcimin e normës letrare është teksti. Teksti gjuhësor nuk duhet të përfshijë vetëm gjuhë shqipe, por duhet të jetë i pasur me literaturë gjuhësore. Pra, lipset një **edukim gjuhësor**<sup>365</sup> i cili e tejkalon tekstin.

<sup>361</sup> Troplini, E. *Mësimnxënia e gjuhës shqipe në shkollat tona. (Disa probleme të planifikimit gjuhësor)*, kumtesë e mbajtur në konferencën e organizuar pranë Fakultetit Histori- Filologji, Tiranë 2010.

<sup>362</sup> Doka, A.. *Në cilët regjistra rrezikohet shqipja ?*, kumtesë e mbajtur në Seminarin e XXIX për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën shqiptare, Prishtinë, 2010.

<sup>363</sup> Troplini, E. Po aty.

<sup>364</sup> Sipas Hudson, A. R. *Sociolinguistika*, Tiranë 2002.

<sup>365</sup> Në këtë përfundim u arrit edhe në konferencën me titull “Gjuha shqipe dhe letërsia në shkollë”, Fakulteti “Histori- Filologji, Departamenti i Gjuhësisë”, Tiranë 2010.

## **KREU IV**

### **4. VLERA DIALEKTOLOGJIKE DHE SOCIOLINGUISTIKE E TË FOLMES SË ÇAMËRISHTES**

#### **4.1. Leksiku në të folmen e çamërishtes.**

Sikundër dihet edhe nga trajtimet e bëra deritanimë, çamërishtja nuk njohu atë zhvillim që mori gjuha jonë pas formimit të shtetit shqiptar në fusha të ndryshme të veprimtarisë politike, kulturore, ekonomike e shoqërore dhe shkaku kryesor për këtë ishte shkëputja e Çamërisë nga atdheu për shkak të kufijve politikë të 1913-ës. Ndërsa, kushtet e krijuara para kësaj shkëputjeje në administratën shtetërore të huaj (shkolla, shtypi, administrata, ushtria etj.) i hapën udhën bilinguizmit.

Vendosja e popullsisë myslimane pas 1944-ës kryesisht në të gjithë Shqipërinë krijoi probleme interesante lidhur me procesin e shkrirjes së kësaj të folmeje me të folmet e ndryshme jugore, veriore e të mesme me të cilat u vu në kushte bashkëjetese. Në këtë kuadër, thelluam edhe hulumtimet në terren, me bindjen se sistemi leksikor i çamërishtes shfaq diferencime të dukshme në krahasim me sistemet e tjera.

Vjetërimi apo dalja nga përdorimi i termave të ndryshëm dhe përfshirja në leksik e terminologjisë së re, pra e risive dhe shtresëzimeve të ndryshme, si pasojë e zhvillimeve të reja në të gjitha fushat e veprimtarisë shoqërore, përbën edhe

pikëvështrimin e të folmeve dialektore sot.

Në brezin e vjetër është vënë re që shumë fjalë të bujqësisë dhe të blegtorisë të cilat përdoren dikur në Çamëri (vend dikur me bujqësi dhe blegtori të zhvilluar) përdoren më rrallë ose janë bjerrë plotësisht. Nga ana tjetër, ruajtjet leksikore në të folmen e çamërishtes janë të shumta edhe në ditët tona. Ato janë shumë më të mëdha në brezin e vjetër, pakësohen në brezin e mesëm dhe fare të pakta i gjejmë ato në brezin e ri.

Sikurse është pohuar edhe qysh herët nga dialektologët edhe për zona të tjera<sup>366</sup>, procesi i bjerrjes së dialektalizmave, ndonëse shfaqet më i fuqishëm në brezin e ri, nuk mungon as në brezin e vjetër. Me kalimin e kohës, nën veprimin e faktorëve jashtëgjuhësorë, po edhe të evolucionit të brendshëm e të raporteve gjuhë e shkruar-dialekt, gjithandëj nëpër krahina fillon të ngushtohet rrezja e përdorimit të fjalëve të ngushta dialektore, përfshirë këtu edhe rrafshim e përafrim të dukurive fonetike apo morfologjike të vjetra.

Megjithatë, fjalët dhe emërtimet tipike çame, të trashëguara në brezat pasardhës nuk janë të paktë në numër. Më të shumtë janë ato në fushën e antroponimisë, tek emrat e njerëzve, tek emërtimet farefisnore, emërtimet nga fusha e gatimit, emërtime barërash aromantike etj.

Natyrisht, shfaqen edhe disa huazime nga turqishtja e greqishtja, të cilat nuk ndeshen kudo njëlloj në hapësirat dialektore ku janë vendosur çamët, për shumë faktorë..

#### **4.1.1. Procesi i zhvillimit leksikor në mjedisin çam**

Edhe në sistemin leksikor, dy kahet a anët e procesit të zhvillimit gjuhësor në mjedisin çam, ashtu si kudo sot në Shqipëri, janë ruajtja (konservimi) dhe përtëritja (rinovimi) e të folmes nën drejtimin e rrafshimeve standardizuese dhe globalizuese.

Megjithatë, sikurse e kemi përmendur, në këtë të folme tërheq vëmendjen edhe një proces i tretë i cili është po aq i rëndësishëm sa këto; është ai i pranisë së dy të parëve (ruajtjes dhe risimit), në të njëjtën masë dhe njëkohësisht të pranishëm në të folmen e secilit brez, pra *procesi "ndërkomunikues" midis të resë dhe të vjetrës*, i cili shfaqet dukshëm në brezin e mesëm. Në sistemin leksikor ky proces është më i dukshëm.

Në ligjërimin e përditshëm të folësve çamë spikat zëvendësimi i fjalëve dialektore me fjalë të shqipes së përgjithshme, qoftë edhe të dialektit të tjetrit. Kjo dukuri nis të shfaqet që me brezin e vjetër dhe vazhdon me hapa më të shpejtë në brezin e ri, në të cilin vërshimi i fjalëve të reja është shumë i madh. Po sjellim disa të dhëna:

-Fjalët e vjetra dialektore si: *koca* (gërshet), *papllom* (jorgan), *pampuar* (vapor), *rafë* (plasaritjet, të çarat e mureve, dërrasave etj.), *ciurë* (brymë), *dhrimon* (shoshë), *fore* (me të lartë), *hamurë* (harxhi i gjellëve të ndryshme), *hosh* (mosrespekt kundrejt dikujt), *llufë* (baluke), *parathire* (dritare) etj, - zëvendësohen që në brezin e vjetër.

Në brezin e mesëm fjalë të së folmes çame priren drejt zëvendësimit me fjalë të shqipes së përgjithshme, të cilat zënë vendin më të madh në përdorim. Përkrah këtyre të fundit ndonjëherë zënë vend edhe gjegjëset e tyre dialektore, përdorimi i të cilave është gjithmonë i kushtëzuar nga rrethana të caktuara; më e rëndësishmja ndër

<sup>366</sup> Shkurtaç, Gj. *Vëzhgime mbi shtresat leksikore dialektore dhe letrare në të folmen e Lezhës*, në S.F, 3, 1981, si dhe *Shtresëzime dhe risi gjuhësore në qytetin e Lezhës*, në "Studime filologjike" 2, f. 75-93, 1984.



to është çasti i ligjërimit si dhe origjina çame e bashkëbiseduesit. Këtu, sikundër pohohet nga studimet sociolinguistike vepron parimi i njohur i formuluar nga J. Fishmani: “*Kush flet, me ke, kur dhe për çfarë, në cilin varietet*”. Këtu është e udhës të përmendim atë dukuri të mirënjohur tashmë për sociolinguistikën dhe mjaft të dukshme për të folmen tonë: bilinguizmin dialektal.<sup>367</sup> Ky proces, nuk i ka fillimet e veta as në të folmen e sotme të brezit të vjetër; ato s’mund të shihen as edhe si rrjedhojë e përplasjes midis të folmeve, por gjetkë; që me kontaktin midis çamërishtes dhe greqishtes.<sup>368</sup>

Tek brezi i ri zënë vënd më dukshëm përdorimet sipas shqipes së përgjithshme.

Nga ana tjetër, sistemi leksikor<sup>369</sup>, por edhe sistemet e tjera, sikurse e përmendëm, janë të lidhura ngushtë me një sërë faktorësh jashtëgjuhësorë. Kështu, në zhvillimet leksikore, rol parësor në ruajtjen e fjalëve të ndryshme marin edhe faktorë të tjerë si: rrethana, çasti i ligjërimit, situata, përdorimi për qëllime të ndryshme emotive, krenaria për origjinën, humori etj. Nuk mund të mos vlerësojmë edhe faktorë të tjerë siç janë lidhjet me arsimin, veprimtarinë prodhuese, veprimtarinë kulturore, shoqërore etj.; për rrjedhojë gjithçka që ka të bëjë me zhvillimin e një shoqërie të caktuar, shtypi, flukset e padukshme etj. Këto procese lidhen gjithashtu dhe me faktorë të tjerë shoqëror dhe natyror po aq të rëndësishëm, si: martesë, mosha, seksi.

Sigurisht të gjithë këto përbërës janë trajtuar me imtësi përgjatë disertacionit, ndërsa lidhur me këtë temë synimi ynë është të japim një pasqyrë fjalësh, me qëllim që lexuesi të krijojë një ide për leksikonin çam.

#### **4.1.2. Ruajtje leksikore në brezin e vjetër çam. Emërtime rreth disa fushave**

Në këtë mënyrë, po vijojmë me një pasqyrë të klasifikimit të fjalëve, të vjela përmes hulumtimeve konkrete në zona të ndryshme të populluara me çamë.

a. **Emërtime të fushës së gatimit:** *Papar* (bukëvale), *fahi* ( gjellë), *tëmël* (ëmbëlsirë), *sapun hallva* (hasude)<sup>370</sup>, *birian* ( tavë me oriz dhe mish), *musaka* ( kimeve në përgjithësi), *kallmar* (lloj ëmbëlsire e ngjashme në shije me bakllavanë), *qahi* ( byrek me djathë), *karkanaqe* (ëmbëlsirë,sheqerpare), *bazin* ( kaçamak), *dollma* (përshesh me gjel deti, ose me mish qingji), *cepë* ( peta byreku, por edhe me kuptimin e një pjese, psh : më jep një cep rrushi), *krunde* ( hime), *zahër* ( sheqer), *brrushtull* (tavë me miell misri dhe lakra të ndryshme prfshirë edhe qepë, presh), *përvëlatë* ( lloj ëmbëlsire me sherbet), *tharrtirë* (dhallë); *bllac* (një lloj byreku).

b. Emërtime të **frutave, perimeve, bimëve aromantike, luleve** etj: *skaminë* (mana), *stafidhe* (rrush i thatë), *thimilkua* (shalqin), *vasilikua* (borzilokut), *garufalë* ( karafil), *mirgale* ( bajame, në disa zona i thonë edhe

<sup>367</sup> Edhe në studimin dialektologjik të prof. Q. Haxhihasanit, është përmendur kjo dukuri, edhe pse dukuria nuk është trajtuar prej tij në aspektin e sotëm sociolinguistik; aty përmendet shprehimisht procesi i e shkrires së kësaj të folmeje me të folmet e ndryshme jugore e veriore me të cilat u vu në kushte bashkëjetese.

<sup>368</sup> Ky i fundit përligjet edhe sot për çamët ortodoksë, banorë të trojeve të tyre etnike në Greqi.

<sup>369</sup> Tek kjo temë kemi shqyrtuar leksikonin e përgjithshëm, fjalë të cilat kuptohen dhe përdoren në çfarëdolloj diskutimi pavarësisht nga shtresa, kategoria, klasa apo statusi.

<sup>370</sup> Në leksik kemi përfshirë edhe ato fjalë, të cilat ndonëse të huazura janë bërë pjesë e fondit leksikor çam.

*mingladhë*), *marrul* (sallatë jeshile), *dhjozmë* (nenexhik/ mentë), *maraj* (kopër), *kallamoq* (misër), *nenë* (lakër e egër), *llapsana* (rrap), *manxura* (lloj luleje me aromë të veçantë), *bòkale* (fiq të papjekur), *cukunidha* (hithra), *bahrata* (piper i zi), *livanua* (lloj fiku), *dardhë bridhë* (dardhë e papjekur, por që piqet me vete), *cullë* (dardhë e butë e pjekur mirë), *kokoliçe* (kokrra që bën lisi), *salangur* (pjepër i pabërë) etj.

c. Emërtime që në tërësi i shërbejnë **veshmbathjes**: *konde* (këmishë për burra), *polk* (bluzë për gra), *fuste* (fund), *potiqe* (pandofla/ shapka), *stromë* (dyshek), *jatak* (vënd për të fjetur), *sendon* (çarçaf), *papllom* (jorgan), *podhë* (përprëse pune), *skrapina* (takave), *tumane* (veshje karakteristike për femrat në kohë të hershme, tuta të gjera lart edhe poshtë), *vraka* (pantallona), *konoxhup* (lloj xhupi për gratë), *faqole* (shami e kokës që vënë plakat), *cohë* (veshje e kushtueshme për gratë), *sharkë* (xhokë prej leshi e bardhë e gjatë deri në gju) *shqepe* (vello), *takëm* (veshjes së kompletuar, kompletit), *qyrk* (veshje e zezë), *qemer* (brez me flori që gratë e vinin në brez), *zerdefi* (kumbi zerdefi/ kopsa zerdefi- kopsa të vogla të bardha që shkëlqejnë), *buruxhuk* (këmishë grash me mëngë të gjera), *buharaq* (cohë e mëndafshhtë), *feste* (qeleshe), mandile *faqole* (shami prej nape), *follë* (andër), *jun* (copë e mëndafshhtë me lule), *kambri* (kamrik), *mëngore* (këmishë), *pluhurë* (beze), *e simtë* (cohë kremi e hollë), *hindjan* (basmë), *harxh* (fije e mëndafshhtë që qendisin jelekët), *pullëz* (temina), *mahramà* (peshqir), *flokoti* (peshqir: zona e Paramthisë); *fasqe* (lidhëse që lidh fëmijën në djep), *çapraze* (kapse prej teli), *kaçibash* (mënyrë e veçantë që lidhin nuset e reja shaminë) etj. *vrakazon* (ushkur), *fasqë* (lidhëse që lidh fëmijën në djep).

d. Disa emërtime që lidhen me **mjedisin shtëpiak**, si dhe emërtime të **lëndës së ndërtimit**: *Ledh* (mur), *qaramidhe* (tjegulla), *qenef / avdes hanë* (banjo), *vorua* (oborr), *katua* (bodrum), *parathire* (dritare), *kalive* (kasolle), *qerrete* (ristela), *azves* (gëlqere), *hanë* (shtëpi), *baxhà* (dritare e vogël në çatinë e shtëpisë), *mes hori* (aneks i dhomës), *konak* (dhomë), *odë* (dhomë, por përdoret në përgjithësi kur ke shumë dhoma dhe në veçanti për dhomën e pritjes), *angon* (vendit në krye); *roxitë* (vend i sajuar në një cep të dhomës së gjumit, zakonisht në fund të derës, ku mund të laheshe), etj.

e. Emërtime të **marrëdhënieve gjinore familjare**: *xhixho* (xhaxha), *xhexhë* (nuses së xhaxhait), *nu* (gjyshes, megjithëse kjo fjalë ka marrë përgjithësim të gjerë për të gjitha moshat e vjetra të seksit femër), *teto* (tezes), *dajko* (dajë), *dajkël* (nuses së dajës), *nanë* (gjyshe), *nandajkua* (gjyshja- nëna e dajës), *gon* (nip), *gone* (mbesë), *progon* (fëmijëve të gjetur të burrit), *çeç* (vëllait të madh), *dada* (personi që i shërbente nuses me pagesë për dy- tri ditët e para të martesës), *kako* (motra e madhe), *nanëzonjë* (në shenjë respekti moshave të thyera nga ana e burrit), *lakà* (kushëri i largët), *aga* (vjehtërit)<sup>371</sup>, *zonjë* (vjehtërit)<sup>372</sup>, *bej* (nusja thërriste kunatin e vogël), *zonjë e vogël / e madhe* (nusja u thërriste motrave të burrit)<sup>373</sup>, *sabi*: (foshnje); *jenë* (kalama) etj.

f. Emërtime **kafshësh, shpendësh** dhe **gjallesash** të ndryshme: *arez* (grerëz), *kaciq* (kec), *spurik* (zog), *pulaqidh* (zog pule), *kër* (gomar), *pelister* (lloj zogu fluturimi), *curk* (akrep), *mjalca* (bletë), *vurc* (iriq), *karakaçe* (laraskë), *kaçòpull* (këlysh mace), *kollosuze* (një lloj zogu me bisht të gjatë),

<sup>371</sup> Ndonjëherë përdoren edhe emërtime të tilla si: aga i madh, aga vogël, për kunetërit.

<sup>372</sup> Në mungesë të vjerrës kështu thërritej nga nusja e re edhe kunata e madhe

<sup>373</sup> Kur burri kishte vetëm një motër, ajo thërritej nga nusja a nuset: *zonjë e vetme*

*kukuri* ( zekthi), *malltez* ( bagëtia me qumësht pas lindjes), *turriare* ( dele që ndahet nga tufa) etj.

g. Emërtime **sendesh** dhe **orendish** shtëpiake: *sufrà* (sofër), *petës* (tërhollës), *honì* (hinkë), *çube* (mjet për të shtypur kafe), *sini* (tepsi e madhe), *çonak* (tasi i vogël), *farfuri* (kanë uji), *magjerrì* (kuzhinë), *pinadhë* ( shoshë), *dhrimon* ( shoshë, me pak ndryshim nga e para), *cimith* ( mashë), *mashà* ( lopatës së prushit që shërben për të pjekur), *pirosti* ( mjet hekuri që vihet sipër zjarrit, për të vendosur enën ku gatuhet gjella), *poçe* ( enë e ngjashme me një qyp të vogël, prej balte, në të cilën gatuhet fasulet në zjarr), *mastrapa* (broke prej bakri për të pirë ujë) *skanjo* ( karrige), *foti* ( kandil), *lesa* ( portë e vogël), *buhari* ( vatër), *buhar* ( oxhak), *ikua* (vend në të cilin stivohen rrobat për të fjetur, shtrojet), *postër* ( postiqe), *klidhonè* (drynit), *kliç* ( çelës), *lien* ( legen), *kalistir* ( kep, mjet për të prashitur të mbjellat), *qepengji* ( derë e vogël); *llanar* ( ajo që kreh leshin), *dhimi* (tezgjah).

h. **Emërtime të trupit të njeriut:** *koca* (gërshet), *thapë* (thonj), *kòkale* (kocka), *gjordè* (trup i madh i bukur i lidhur), *llufë* ( baluke), *fulltak* ( mish i që ngrihet flluskë ), *gërlak* ( gurmaz), *leshëra* ( flok), *kaleshë* ( zeshkane, esmere), *beellè* ( bjonde, bardhoshe).

i. **Emërtime nga fusha e mjekësisë:** *jatrua* ( doktor) *namopirmë* ( etheve të qumështit), *dhilì* ( i ra dhili, i ra të fikët ), *baldi* (*kojdi pse m'bie si baldi*, nuk e di pse po më bie si vilani), *damlla* ( paralizë), *i xhindosur* ( budalla); *verem* ( turbekuloz) etj.

#### 4.1.3. Disa emërtime interesante të fushave të ndryshme

Në këtë pikë po paraqesim një pasqyrë tjetër emërtime të cilat për nga vështirësia që ato kanë për t'i klasifikuar sipas sferave të caktuara ( pasi janë të shumëllojshme ), ndofta pak jashtë vendit (me marrëveshje), po i klasifikojmë ato sipas pjesëve të ndryshme të ligjëartës.

a. **Disa mbiemra karakteristike për çamërishten:** *gërthël* ( e keqe), *i shklarë* ( i çmendur), *farmak* ( e hidhur), *hergjele* ( i papërmbajtur), *i lipsur* ( i humbur; kjo fjalë ka marrë edhe kuptime të tjera, si p.sh : lipsu atej ! - ik andej ); *i pingosur* ( i pezmatuar/ i zemëruar), *i zilepsur*( ziliqar); *gotì* ( frikacak), *dhjakonar* ( njeri rrugësh, “ barbon”), *i lapërguar* ( i liruar), *penesqar* (mburravec); *lakomë* ( e dobët fare e vështirë për t'u bërë ), *qibar* ( mendjemadh); *vllëngë* ( u ke bërë sa një vllëngë , e madhe ; me trup të madh, e rritur para kohe) *kserë* (jo e lagësht), *vrromë* ( e pisët). *ksekollomë* (ah ksekollomë e qerratait, ksekollomë, fjalë ofenduese : e përdalë, qelbësirë etj ), *e ndërsmë* (ana e përtejme, jo shumë privilegjuar), *i mënjër* ( në krahë të mënjër).

b. **Disa folje karakteristike për çamërishten:** *am* ( jepmë-epimë), *gaxhidet* ( tallet, bën shaka), *gjegj* ( dëgjoj), *llamburit* ( ndriçon), *qasem* ( afrohem), *llastis* (rradhvoj), *htarr* ( herr), *miris/ mris* ( nuhas), *cimis* ( kep, çukas: *pulat cimisin barin*), *hosh* ( me begenis, me respektuar dikë, por që përdoret më tepër me kuptim të kundërt, p.sh: *s'më bëri hiç hosh*, s'më begenisi, s'ma vari, s'më respektoi), *e katèha* (a.. ti e katehe – a.. ti e këptove, e kuptove); *i ksebëu* (i shpërdoroi me prish, me shkatërruar, me heq nga pasuria) *manaris* ( e afroj, vjen nga fjala *manar*, me e afruar me i dhënë arsye, qas) *ndes* (*ndesi në lum*, *ndesi në lerë*, *ndesi keq*( nga ndonjë hall ) me ngel keq a ngushtë për diçka ), *peneset* (lavdërohet, *penesqar* (mburravec); *pllaks* ( përplas); *poktis* ( u fiksua), *rrokanis*

( zdrukthtoj; *penesqar* (mburravec, peneset- lavdërohet) ; *rrupjas* ( prij përpara: *dashi qesim me kumborë* , *rrupjas kopenë përpara*), *tumë* ( me të shtyrë: *i dhe tumën, të japin tumën; po gjete nonjë derë të mirë vajzës jepi tumën*), *dorovit* ( peshqeros ), *karfos* (qep rrallë: *karfosi* takëmin, por edhe me kuptimin mbyll: *karfosi* llagëmin), *çel* ( përdorim që gjendet në të tri brezat)

**c. Disa emra të llojeve të ndryshme:** *dhogë* (dërrasë), *eksori* ( nizan), *dhaskal* ( mësues), *lazëme* ( vizitë), *teshqere/ tesxere* ( ftesa), *evlat* (fëmi), *bina* ( rrëzë e diçkaje, p.sh rrëza e ullirit), *skolio* ( shkollë), *hargalisje* (dalldi), *kahpë* ( e përdalë, prostitutë), *pampuar* ( vapor), *qostek* ( zinxhir i orës së xhepit), *pajgori* (ndihmë në para në raste fatkeqësish), *gular* ( gur të vegjël që lozin fëmijët), *alsiv* ( ujë me hi që lanin rrobat), *botë* (lloj dheu që përdoret për...), *bokshà* (grumbull me rroba i lidhur mirë me një tjetër rrobë të madhe), *davet* ( gosti), *torriar* ( rrugaç), *dup* ( monedhë më e madhe sesa floriri), *komë* (lidhja nyjë), *sorua* ( grumbull), *cimisqar* ( ngacaman); *penesqar* (mburravec, peneset- lavdërohet) *asqër* ( ushtar), *allahten* (*më erdhi allahten* e papritur, befas), *avolitër* ( plagë e madhe rrjedh e nuk mbyllet), *asklidhe* ( cifël druri, guri etj), *bekshi* ( rojtar fushe), *bokrrimë* ( vend i pjerrët, shpati i një kodre), *kasabà* ( qytet, *Ka jeni ju? Ka kasabaja e Durrësit*), *mahallà* (*na bure bolori me mahallà*, na turpërove me lagjen, lagjes), *ciurë* ( brymë), *kòkall* ( me ngri në vënd nga të ftohtët), *fore* ( me zë të lartë, me bërtit me furi, *mos fol me fore, pse flet aq me fore* ), *pramatar* (tregtar që tregton shtëpi më shtëpi, “ambulant”), *siri* (i kish gjërat *siri, siri*, lloj, lloj), *tramë* ( shkëmbim mallrash), *umith/ umidh* ( shpresë: *ban umidh- mban shpresë*), *pothë* ( lloj, *nuk kesh parë nonjëherë ka kjo pothë- nuk kisha parë ndonjëherë nga ky lloj; ka ajo pothë e bukur- nga ai lloj* ), *llagëm* (tunel), *hupe* (budallallëqe) etj. *rafë* ( plasaritje e çarë e murit e drrasës e derës etj. *ka rafëtë e llozeve hin pluhura e frin era*).

**d. Disa ndajfolje:** *muht* ( lirë: *e shiti muht klumushtin-* e shiti lirë qumështin), *bolori* ( *na bëri bolori*, - na turpëroi), *mërguar-* mërguar ( larg), *reposh* ( përposht), *nestër, dej* (pasnesër), *kasdej* (mbipasnesër). Lidhur me këto të fundit kemi edhe disa mbiemra të emëruar, si : *i prëmshmi, i tekseprëmshmi, i njënatshmi.....et.*

Dikur kjo e folme ka qenë shumë e pasur edhe me kompozita, si: *faqeftua, faqekartë, faqeklumushtuar, feste dalle*, ( feste e kuqe e qendisur me serm që e mbanin nuset), *golëgrisur* ( llafazane), *golëmbajtur* ( e urtë), *golëkeq* ( fjalëkeqe), *golëmirë* ( fjalëmirë), *hundëdash* ( hundëmadh), *gluhëkuq* ( e ka gjuhën të kuqe sikurse rraca e zezë), *kriethrime* ( kokëvogël), *kuqelarë* ( laroshe), *kokallbardhë* (kockëbardhë), *leshërakaçube* ( me flokë ngritura të shkatërruara), *vetullbërshime* ( vetulldredhur), *vetullnakatosur* (vetullzemëruar), *bishtashkunde* ( lloj zogu me bisht të gjatë) etj.

Nuk mund të lemë pa përmendur në këtë punim edhe disa të dhëna me vlerë për **etnografinë e të folurit** të banorëve çamë. Na tërheq vëmendjen mënyra sesi përsëndeten çamët e brezit të vjetër. Mendojmë gjithashtu se kjo është një pikë me të cilën në të ardhmen duhet të merremi më gjatë. Në këtë të folme na bëjnë përshtypje shprehjet me anë të të cilave çamët përsëndeten në çaste të caktuara të ditës: *çish u dive/ ç’u dive-* si u gdhive/ mirmëngjes; *çish vajte-* si shkuat/ si jeni; *ç’u verre, ç’u verrët-* si u erre, si u errët ( errësove) / mirëmbërma. *Selamaleqe-aleqëmë selam.*

#### 4.1.4. Disa dukuri fonetike dhe morfologjike në përbërje të fjalës

##### 1. Dallime fonetike

a. Theksi i disa emrave dhe ndajfoljeve, që është i ndryshëm nga ai i mbarë shqipes: *àjo, àj, àtej, tàni, tànja, kùtu, kijo, àt* etj.

b. Fjalë të huazuara nga turqishtja, vijojnë të përdoren edhe sot si theksfundore: *vëllahi, kāvè, qōshè, xhēzvè, bākshè, hīsè, sēhftè, çiftè, parà, sufrà, mashà* etj.

c. Fjalë tek të cilat ruhen ende **zanoret e gjata**: *vëlla:, ngrè:, flè:, vè:, përzè:, e ve:, e re:, uzengji:, kazma:, kallame:, dja:lè, ka:lè, pa:lè, undi:r, di:ll, he:ll, kërce:ll, shka:llè, se:ll, vra:rè, pre:rè, dhè:nër, të hë:në, na:tanë, ra:më, dë:njëm, ngrè:në, kë:më, dhë:më, rri:në, zi:jn, vi:n, shpi:j, ko:sht*, etj.

d. Fjalë në të cilat **ë-ja** e theksuar ka evoluar në **i**, ndonjëherë edhe në **u**: *bij, isht, bura, nji* etj.

e. Mungesa e zanores **y** në sistemin e saj fonetik dhe kompensimi i saj me **i** në disa fjalë si: *çish, ki, iti, ti, di, si, dizet, qitet, diqan, disheme, mbitem, mbille, krie* etj. Në disa raste **y-ja** ka dhënë **u** po tek të njëjtat fjalë, p. sh: *duqan, umur, undirë, dusheme* etj.

f. Fjalë në të cilat spikat ruajtja e **ë-së** fundore ( të patheksuar) që në shqipen e sotme ka rënë: *hismeqarëtë, lekëtë, kampetë, bukënë, shkozetitë, i vjetërë, i mshefëtë, i vuajturë* etj.

g. Disa fjalë ku **ë-ja** e patheksuar shndërrohet në **u** psh: *kushtu, rruguve, kushuri, kuture, rrumulë, kupucë, musus, kutu, sumur*.

h. Disa fjalë ku **u-ja** e patheksuar shndërrohet në **ë**: *pënoj, këptoj, dëroj, mbëloj, rregëlloj, pëshoj* etj ; *a > ë: pësaj*.

i. Fjalë të tilla në të cilat kemi përdorimin e diftongjeve zbritës dhe ngjitës sipas çamërishtes p. sh: *bjeç, zjeç, pjes, zjejmë, përziej* etj.

j. Disa fjalë në të cilat ruhet ende **l-ja** e vjetër ndërzanore: *fëmilë, bilë, kuel, rrumulë, milë, malë, palë, galë, valë* etj.

k. Disa fjalë në të cilat ruhen ende togjet bashkëtingëllore **kl, gl, lk**: *kle, kleçë, glisht, glishtëz, klumusht, klumushtuar, kliçe, gregli, glëmbi, i glatë, shklata, i shklier, i shklarë, klishë, zgldh, alkë, balgë, ulk, bulk*.

l. Fjalë në të cilat **r-ja** dyfishohet për qëllime ekspresive, p. sh: *prrish, i trrembur, i trrash, e trromaksur* etj.

j. Fjalë tek të cilat ndodhin këmbime të fonemave bashkëtingëllore, p. sh: *gregt, kado, ka, atej, prit* (prindërit), *jerman* etj.

k. Fjalë tek të cilat ndodh asimilimi prapavajtës dhe paravajtës i grupeve **mb, ng, nd**, p. sh: *bledh* (mbledh), *broj/ brojti/brojtëm* (mbroj); *dëjëm, dëjët, dëjën* ( ndënja); *dimoj* ( ndihmoj); *u grem* ( u ngrem); *xerr* (nxjerr); *nonjë* ( ndonjë), *veni* (vendi), *bërna* (brënda) etj.

l. Fjalë tek të cilat ndodhin asimilime paravajtëse, prapavajtëse, të pjeshme ( zanoresh dhe bashkëtingëlloresh) p. sh: *umur, rruguve, sumur, talaçe, mususi, budrum, dukumenta, kuput, nanave, thëmër, rrumulë, barangë, mblakur, bërna, vamë, mbenë, dhënër, kushuri, pamë* (tm>m), *zapo* (zaptoi), *belqete* (r>l), *njonjherë* (nd>nj), *natanë* (m>n), *veçëm* (t>ç), *njonjë* (nd>nj), *nartuar* (m>n), *rëpjetë* (t>r) etj.

m. Fjalë tek të cilat ndodhin disimilime në zanore: *mbëluar, qevërria, kërar* etj

n. Fjalë tek të cilat ka ndodhur dukuria fonetike e sinkopës, apokopës, metatezës etj: *ern* (erdhën), *ashpsua* (ashpërsua), *gjëm* (gjetëm), *zë* (zëri), *ip* (ipte/ jekte), *gerqi, mbëllirë* (mbyllur) etj.

m. Fjalë tek të cilat nuk zhvillohet *j*-ja epentitike p. sh: *gjënde* (gjëndje), *nusa* ( nusja), *Gjula/Gjulea* ( Gjylja), *Fatima/Fatimea* ( Fatimja), *qima* ( qimja ), *ima* ( imja), *jota* ( jotja), *lula* ( lulja) etj.

n. Fjalë të tjera të ndryshme si: *çep* ( sqep), *çorvë* ( çorbë ) etj.

## 2. Dallime morfologjike:

a. Fjalë të cilat dallojnë në trajtë me ato të standardit: *dajua*, *çeçua*, *Hazua*, *nusa*, *dela*, *lula*, *maca*, *lakruar*, *klumushtuar* etj.

b. Fjalë të cilat spikasin për mënyrën e formimit të shumësit, p.sh: *kuel*, *djel*, (djem), *these*, *rrethe* etj.

c. Disa emra femërorë që e formojnë shumësin me prapashtesat e zvogëlimit p. sh: *pulëza*, *mollëza*, *vashëza*, *hënza* etj.

d. Fjalë të cilat, të shquarën e kallëzores e formojnë me mbaresat e hershme, **-në, -n**, p. sh: *sinë*, *pënë*, *zanatçinë*, *ditnë*, *radhnë*, *konispolnë*, *fëmilnë*, *fshanë*, *surranë*, *pallanë*, *varrnë* etj

e. Megjithëse janë trajtuar për dukuritë e tyre fonetike sipas çamërishtes, rendisim edhe një herë disa fjalë të sistemit përemëror si, **vectorët**: *ù*, *nevet*, *ài*, *àjo*; **dëftorët**: *ki*, *kijo*, *këtitë*, *këtija*, *atitë*, *atija*, *këture*, *ature*, *kuturë*, *ature*, *këtire*, *këso*, *aso*; **pronorët**: *inë*, *it*, *i tire*, *i ture*, *ima*, *jota*; përemri **pyetës çish**; përemrat **e pacaktuar**: *nōnjë*, *çdon-jeri*, *sāqë*; **numërorët**: *di*, *milë*, *milëra*.

f. Disa folje në mënyrën dëftore, të cilat shfaqin format dhe mbaresat karakteristike të çamërishtes:

- folje në kohën e tashme : *pjesëm*, *pisni*, *pjesën*; *presëm*, *prisni*, *presën*; *marrëm*, *mirrni/mirri*, *marrën*; *ish/isht*, *kish*, *thom*, *baj* ( mbaj), *godit*, *kuput* etj.

- folje në kohën e pakryer: *hidhëm*, *hidhët*, *hidhën*, ; *hajëm*, *kalojëm*, *bijëm*, *marrim*, *nemitim*, *bīm* ( bijim,bënim), *lyejtim*, *mīrr*, *përcill*, *dīl* ( dīlte); *jësha*, *jëshë*, *ish*; *këshë*, *keshe*, *kish*; *jëshëm*, *jëshët*, *jëshën*; *këshëm*, *këshët*, *këshën*; *vineshin* (vinin), *vinej* ( vinte), *nisheshin*, *duhej* ( donte).

- folje në kohën e kryer të thjeshtë: *muarrmë*, *muarrtë*, *muarrn*; *folmë*, *foltë*, *folnë*; *nxuarrm*; *vualm*; *vata*, *vate*, *vamë*, *vatë*, *vanë* ; *kleva*, *kle*, *klemë*, *kletë*, *klenë*, *vdiqu*, *bërëm*, *bërët*, *blevëm*, *blevët* etj.

- disa forma të veçanta foljore për të ardhmen: *do them*, *do thesh*, *do t'e theç*, *d'e marrish*, *d'e punosh*, *d'e ujitish*.

a. Disa forma dhe mbaresa foljore të mënyrës lidhore sipas kohëve të ndryshme: *të pënoç*, *të shōç*, *të japç*, *të ngasish*, *të flasish*, *të presish*, *t'e thesh* etj.

g. Disa forma të veçanta të pjesores së foljes: *bënë* (bërë), *thertur* (therur), *vartur* (varur) etj.

h. Disa trajta foljore të aoristit sigmatik: *thāç*, *pāç*, *lāç*, *u prēç*, *hāç*, *u ngrōç* etj.

i. Përdorimi i disa ndajfoljeve të veçanta për çamërishten: *açhere* ( *aqhere/ athere*), *pësaj*, *pasandaj*, *njherë*, *nonjherë*, *non-jherë*, *kanjëherë*, *ganjëherë*, *ngahera*, *natanë*, *bërna*<sup>374</sup>, *àtej*, *àtaj*, *kùtu*, *àtje*, *siprazi*, *kādo*, *çish*.

j. Përdorimi i disa pjesëzave, parafjalëve, dhe pasthirmave: *nùku*, *veçëm*, *ka* , *njaram*, *javam*, *jām*, *nek*, *ne*, *jahë..*, *uë..*etj.

<sup>374</sup> Këtë fjalë e gjejmë edhe në trajtën *bërnda*, gjë që tregon përpjekjen e folësit për t'u përshtatur me të renë. Kjo është një dukuri e cila vihet re qartë edhe në shumë shembuj të tjerë të së folmes së brezave të ndryshëm. P.sh: fjalët *xhixhi* dhe *pōdhe* , të shquara me këtë theks në brezin e mesëm sot, dikur në brezin e vjetër shquptoheshin *xhixho*, dhe *podhë/ pothë*. Pra, verifikojmë ndryshime fonetike brenda fjalës. Sigurisht shembujt e përmendur nuk janë të vetmit .



k. Fjalë të tjera të ndryshme: *rrerë* (gënjeshtër), *qurshia*, *ngrënëla*, *priftëla*, *ngordhëla*, *prishëla*, *dorëla*, *milmangë*, *pehtua*, *serdà*, *nglas* ( ngjas/i ngjaj), *ris*, *nguq* (skuq), *gjëlpj* (gjarpërinj), *e njëte*, *rovi* (uroi), *kllosij* ( kullos), *gjuhum* ( gjym), *mbraz* (zbras), *ohnazë* (unazë), *fali*( faji), *dhez* (ndez), *hxe/hje* (hije), *vali* (vaji), *ródhez* ( rrodhe), *rarë* ( rënë), *dufeqi* ( dyfeku)<sup>375</sup>, *kullandris* ( kullundris), *kambri* ( kamrik), *vloj* ( mbuloj), *shtromet* ( shttrumet/ shtrojet), *fshahazi* ( fshehurazi), *i malltuar* (i përmalluar), *i psuar* ( i msuar).

l. Nga krahasimi që i kemi bërë të folmes së sotme të çamëve të Durrësit, me të dhëna të hershme <sup>376</sup> të kësaj të folmeje si dhe me të dhëna nga studimi dialektologjik i Q. Haxhihasanit<sup>377</sup>, kemi renditur një sasi fjalësh të cilat kanë humbur. Ato nuk i gjejmë në të folmen e brezit të vjetër sot, me gjithë mundimin e tyre për ta trashëguar të pastër këtë të folme. Këto fjalë mund të jenë zëvendësuar me fjalë të tjera ose kanë dalë fare nga përdorimi, p. sh:

*xhedilë*, *xhelben*, *qotì*, *qepengjì*, *xhevre*, *xërre*, *bridhë*, *bakàje*, *ushez*, *jun*, *purthëlë*, *piker*, *pikrangadh*, *vrojnë*, *çuta*, *çukat*, *dilmi*, *fushqi*, *fagullate*, *gone*, *gurdhu*, *hazinë*, *hap*, *istrikat*, *indat*, *kopërr*, *krahura*, *kathur*, *kullaqi*, *katehela*, *lagjin*, *otra*, (mandile) *thellupe*, *kollosuze*, *kukuri*, *monoricë*, *karvò*, *llahtër*, *llother*, *mendall*, *ndërçe*, *pejda*, *par*, (mandile) *poshe*, *rahq*, *rale*, *rrokan*, *rrusfal*, *strevël*, *skopua*, *shehleza*, *gravell*, *màndall*, *kòcenosh*, *dedikè*, *moraza*, *organa*, *shtarame*, *gërrnde*, *hondrale*, *anuria*, *grinjat*, *rrushqule*, *i gjezër*, *gravall*, *cigure*, *prrari*, *thermelira*, *sunidhe*, *tonidhio*, *sirokafa*, *dauxha*, *rëkuall*, *langua*, *barkare*, *dhikan*, *karaf*, *kuvël*, *bahçivanë*, *barball*, *zabitër*, *kamabre*, *camurat*, *ohalit*, *koç*, *koçi*, *azrei*, *llaj*, *ajman*, *bumbuleshë*, *cariqe*, *cepëzi*, *ciaro*, *çeleng*, *dajllar-i*, *dugra*, *dulme*, *dhiallupi*, *dhragat(i)*, *festedalle*, *firar*, *flapë*, *gazi*, *gërxhemadhe*, *hastane*, *haxheti*, *hos*, *hundëza* etj.

<sup>375</sup> Nuk kemi përjashtuar tek kjo e folme edhe fjalë të huazuara nga turqishtja, por që tashmë janë bërë pjesë e fondit.

<sup>376</sup> Këtu flitet për disa të dhëna të mbledhura qysh më 1978/ën nga historiani Z. Hajredin Isufi të pashfrytëzuara ndonjëherë.

<sup>377</sup> Shih : Haxhihasani, Q. *Vështrim i përgjithshëm mbi të folmen e banorëve të Çamërisë*, në « Dialektologjia shqiptare », vëll.I,Tiranë,1971, vëll.II,Tiranë 1973

## 4.2. Ruajtje, bjerrje dhe risi në kuadër të shqyrtimeve sociolinguistike.

Në këtë përmbledhje të shkurtër veçojmë një pjesë fjalësh të cilat na tërheqin më shumë vëmendjen. Këto fjalë i përkasin fushës së blegtorisë në veçanti, pasi Çamëria dikur shquhej për një vend me blegtori të zhvilluar. Të tilla fjalë kemi:

*barzë-a* ( lloj dhie e verdhë), *galbë-a* (dhi e përhime), *bushkëzë-a* ( dele ose dhi me fytyrë të mbëluar), *cicë-a* ( lloj deleje..), *florë-a* ( lloj dhie e bardhë), *kacen-i* ( sheleg që e ka faqen të kuqe), *lanomi* ( kec, qengj, viç etj), *llojë-a* ( dele e zezë), *milore-a* ( dele motake gjer në dy vjeç, që s'ka lindur), *varvak-u* ( dash, cjan, apo dem) etj.

Çamëria dikur shquhej edhe për **një pemëtari a bimësi** të zhvilluar. Na kanë tërhequr më shumë vëmendjen një sasi emërtimesh të cilat pas shpërnguljes së çamëve në Shqipërinë shtetërore kanë dalë nga përdorimi ose janë përdorur fare pak. Të tilla janë:

- Disa emërtime të llojeve të ndryshme **fiqsh**, p. sh: fik *livanua, buhar, perdhikul, vursik, maca* (kur fiku piqej shumë e thahej në degë), *llabovit, bishtash, delvinjot, bukuq*.
- Disa emërtime të llojeve të ndryshme **dardhash**, p. sh: dardhë *kuqela, rushunica, verdhëla, llabovite, thertjate*.
- Disa emërtime të llojeve të ndryshme **ullinjsh**: ulli *nisqot, reshaqot, kaçulerë korfjat, kotmëdhi*.
- Disa emërtime të llojeve të ndryshme të **grurit**: grurë *zhulicë, halëz, tremujor, karpua, pllakatuar, therti, buluk, insan etj*.

Fjalët çamërishte pak nga pak filluan të zëvendësohen, ose dalëngadalë, përkrah tyre filloi të përdoret po e njëjta fjalë sipas zhvillimit të gjuhës së përditshme, por edhe duke treguar interes për t'u integruar me bashkësinë pritëse. P. sh, në vënd të fjalëve, *potiqe, tumane, parathire/ penxhere, sendon, dhaskal, jenë, bilë, sabi, stromë, def, thimilkua, podhë*, etj; sot, krahas tyre, përdoren tek ky brez, fjalët e tyre gjegjëse si: *shapka/pandofla, çitjane/ dimiq, dritare, çarçaf, mësus/ musus, fëmilë, vajzë/ gocë, foshnjë, dushek/ dishek, dajre, shalqin, përparëse etj*.

Me sa kemi konstatuar ritmi i ndryshimit nuk është i njëjtë. Shumë i shpejtë është ai tek folës të brezit të mesëm dhe akoma më i shpejtë paraqitet ai tek më të rinjtë.



Në këtë pikë, shtrohet pyetja se cilat nga fjalët e grupuara më lart i kanë rezistuar kohës dhe kanë mbërritur deri në brezin e mesëm?

Ruajtjet më të mëdha në leksik për brezin e mesëm do t'i vërejmë konkretisht në disa sfera si: ajo e **gatimit, disa emërtime lulesh dhe bimësh të ndryshme aromantike; do të verehen gjithashtu disa emërtime të marrëdhënieve gjinore familjare dhe lloje të tjera të ndryshme emërtime, si:** *musaka, birian, papar, kallmar, sapun hallva, qahi, karkanaqe, klloshër, dollma, cepë, krrunde, brrushtull, përvëlatë, vasilikua, garufale, jozmë, miraj, llapsana, manxura ; xhixhì ( xhaxha), xhexhè (xhaxheshë-nusja e xhaxhait), nu (gjyshe, nane), teto (teze), dajkël, ( nusja e dajës), petës ( tërhohës), cepë ( petë), nakatosur ( i përzier), dorovis ( peshqeros), i shklarë ( i çmëndur), ikua (vëndi ku stivohen rrobat), pajgori ( vizitë ngushëllimi), papllomë ( jorgan), stromë ( dyshek), potiqe ( pandofla), pōdhe ( përparëse)... etj.*

Edhe tek brezi i ri do të ruhen disa fjalë nga fusha e gatimit, disa emërtime të bimëve të ndryshme aromantike, marrëdhënieve gjinore familjare, disa antroponime të ndryshme etj. (këto të fundit gjithmonë në rrethana të kushtëzuara)<sup>378</sup>, si: *papar, sapunhallva, birian, musaka, nu, teto, xhexhè, dajkël* (ndonjëherë), *dorovitje, pajgori, lazëme* etj.

Për folësit e brezit të ri vërejmë se përdorimet e mësipërme ose kanë dalë nga përdorimi (kur kemi të bëjmë me fjalë të vjetëruara që për arsye të ndryshme nuk përdoren më ), ose janë zëvendësuar me fjalë të shqipes standarde. Në disa raste gjejmë edhe ndërhyrje nga e folmja e bashkësive pritëse. Numri i paktë i ruajtjeve të fjalëve në brezin e mesëm dhe të ri, flet qartë për rinovime, përtëritje, risime apo shtresëzime të ndryshme në të folmen çame. Siç e thamë s'mund të anashkalojmë edhe interferencat nga e folmja vendase, për të cilat flasin qartë shembuj të tillë si: *oborr* për *vorua*, *çarçaf* ( sendon), *jorgan* ( papllom), *hasude* (sapun hallva), *petë* (cepë), *mentë/nenexhik* (jozmë), *vaporr* ( pampuar), *teze* ( teto), *bakllava* ( bakllahì), *gërshet* ( koca), *thonj* ( thapë), *sheqer* ( zahër), *hime* (krrunde), *mana* ( skaminè), *shalqin* (thimilkua), *bajame* (mirgale/ mingladhè), *sallatë jeshile* ( marrul), *shapka/pandofla* ( potiqe), *dyshek* ( stromë), *krevat* (jatak), *përparëse* (podhe), *tjegulla* ( qeramidhe), *bodrum* ( katua), *restela/ ristela/rristela* ( qerreeste), *sofër* (sufra), *karrige* (skonio), *oxhak* (buhar), *doktor* ( jatrua), *fëmijë* (evli/ jenë/ fëmilë), etj.

Këto shembuj flasin për procesin e tretjes së dialektalizmave në këtë të folme dhe se ndikimi nga rrethinat anas është i padiskutueshëm, **madje do të shtonim reciprok.**<sup>379</sup> Kemi vënë re gjithashtu se krahas përdorimeve të standardit, tek folësit e brezit të ri gjejmë vënd edhe përdorime të cilat janë në kundërshtim me normën, por që i përkasin të folmeve të bashkësive pritëse. Kështu tek çamët e Shqipërisë së Mesme në brezin e mesëm dhe të ri na tërheqin vëmendjen fjalë të tilla si: *ça* ( çfarë), *mi* ( me – pasthirmë), *çun* ( djalë), *gocë* ( vajzë), *qyqa* ( pasthirmë që në të folmen çame nuk ekziston), *e nejse*, *bjere* ( stille), *shpina* (kurrizi), *nenexhik* ( jozmë) ....etj.

Të gjitha këto përdorime apo zëvendësime lidhen edhe me faktorë të tjerë jashtëgjuhësorë<sup>380</sup>. Megjithatë e folmja e brezit të ri dëshmon sot orientimin kah standardit. Këtu bëhet fjalë për prekje të sistemit leksikor në të tri brezat, por më shumë në brezin e mesëm dhe me një ritëm më të shpejtë në brezin e ri. Në brezin e mesëm kemi një shtresëzim të ri fjalësh që lidhen me zhvillimin e kulturës,

<sup>378</sup> Këto ruajtje janë më të pakta në numër sesa ruajtjet në brezin e mesëm.

<sup>379</sup> Në përmasa jo të njëjta.

<sup>380</sup> Troplini, E. *Ndikimi i disa prej faktorëve jashtëgjuhësorë në të folmen e çamërishtes*, në “Çështja çame dhe integrimi evropian”, Tiranë 2009.

veprimtarisë prodhuese, veglave, dhe mjeteve të reja teknike, jetës politike- shoqërore dhe ideologjike etj. Përparimi i shkencës, teknikës, elektronikës solli edhe shtimin e disa termave të tjerë që vazhdojnë të rriten në përshtatje me shpejtësinë e zhvillimit të fushave të caktuara, të cilat ndër të tjera ndikuan drejtpërsëdrejti në zhvillimin e kulturës dhe përparimin e bashkësisë shoqërore.

Të gjitha këto vërtetojnë edhe një herë atë fakt të dëshmuar tashmë prej sociolinguistëve, me të cilin janë në një mendje edhe studiuesit e gjuhës në tërësi se, ndryshimet më të mëdha në sistemin gjuhësor të një të folmeje nisin më së pari në fushën leksikore.

## KREU V

### 5. Ndikimi i faktorëve jashtëgjuhësorë në të folmen e çamërishtes.

Në veçanti, përgjatë kësaj teme ashtu si edhe më parë në disa prej kumtesave a artikujve që janë botuar<sup>381</sup>, do të trajtojmë rolin e disa prej faktorëve të rëndësishëm jashtëgjuhësorë me mjaft peshë për një të folme të tillë, duke mos përjashtuar rrethanat, kontekstet e ndryshme, kontaktet etj.

Lëndën e parë e kemi vjelë gjithmonë përmes kërkimeve empirike në terren. Një ndër burimet më të rëndësishme që na ka ndihmuar për realizimin e temave të trajtuara në tërësi, ka qenë regjistrimi i drejtpërdrejtë i materialit, duke vëzhguar me imtësi shkaqet e mundshme që favorizojnë ndryshimin gjuhësor, ruajtjet në planin gjuhësor, qofshin ato dialektologjike, etnografike dhe etnologjike.<sup>382</sup> Ajo që gjithmonë kemi konstatuar përmes shembujve është se, me kalimin e kohës, me gjithë përpjekjet e brezit të vjetër për të trashëguar gjuhën e tyre dhe nëpërmjet saj gjithë trashëgiminë kulturore të bashkësisë çame, në të folmen e këtij brezi vihet re përsëri një lloj prirje kah normave të rregullta të shqipes së sotme.

E folmja e çamërishtes është një ndër të folmet më jugore të shqipes. Siç edhe jemi shprehur, ky është një faktor ndihmues por jo me peshë në orientimin e çamërishtes kah standardit. Këtu ndërfiten disa elemente njëkohësisht, më e rëndësishmi prej të cilëve lidhet me vetë folësit e çdo brezi. Folësit çamë qofshin ato edhe të brezit të vjetër, me vetëdije dallojnë elementet e të folmes së tyre që përkojnë me standardin, si dhe elemente të tjera të po kësaj të folmeje që nuk janë pjesë e normës. Ky dallim favorizohet nga hendeku që ndan këto dy të folme megjithëse që të dyja pjesë të toskërishtes: njëra është toskërishte e normëzuar dhe tjetra toskërishte e hershme. Pikërisht kjo ka qenë edhe pikënisja e të gjitha studimeve tona gjuhësore lidhur me të folmen e kësaj krahine.

Nga hulumtimet tona disa- vjeçare, kemi pare që folësit çamë sidomos më të vjetërit janë shumë konservatorë ( ruajtës ).<sup>383</sup> Megjithatë edhe tek ato vihet re ndonjëherë përshtatja me normat dhe zakonet kulturore të bashkësive pritëse në të cilat ato janë vendosur. Pra, nuk mund të anashkalojmë kurrësesi në një studim të tillë përplasjen e të folmes çame me shqipen e evoluar të bashkësisë shqiptare pas shpërnguljes së tyre në Shqipërinë shtetërore, që siç e theksuam edhe më lart përbën një kundërshti në vetevete: nga njëra anë kemi shqipe arkaike, bashkësi më e zhvilluar

<sup>381</sup> Troplini, E. *Ndikimi i disa prej faktorëve jashtëgjuhësorë në të folmen e çamërishtes*, në “Çështja çame dhe integrimi evropian”, Tiranë 2009.

<sup>382</sup> Troplini, E. *Hulumtime sociolinguistike në disa mjedise çame të rrethit të Durrësit*, në Aktet e Seminarit II Ndërkombëtar të Albanologjisë, Shtator 2008.

<sup>383</sup> Troplini, E. *Disa tipare ruajtëse të çamërishtes*, revista shkencore “Aktet e Seminarit të II- të Ndërkombëtar të Albanologjisë”, Tetovë 2009.

ekonomikisht e për rrjedhojë më e përparuar kulturalisht dhe nga ana tjetër shqipe e evoluar, bashkësi më e prapambetur ekonomikisht e kulturalisht. Në këtë kuadër nuk përjashtohet edhe ndikimi që kanë pësuar prej bashkësive të vogla çame të gjitha ato zona pritëse në kontakt të vazhdueshëm me to.

Ligjërimi ynë si akt i identitetit, vetë përvoja jonë gjuhësore, përbën diversitet nga një individ tek një tjetër dhe nga ana tjetër ajo gjithmonë lidhet ngushtë me faktorë të jashtëm shoqërorë, me të cilët ai shpesh solidarizohet.

“Gjuha dhe sjellja gjuhësore janë faktorë të fortë të shprehjes së identifikimit dhe të kohezionit të një grupi shoqëror qoftë brenda, qoftë jashtë. Kush flet në mënyrë të ndryshme, të dallueshme nga zakonet dhe normat e njohura të një grupi, në përgjithësi u nënshtrohet sanksioneve shoqërore....Ai që dëshiron të theksojë përkatësinë e vet në një grup, përshtat” in toto” zakonet dhe vlerat normative gjuhësore, duke i theksuar ato po qe se është rasti.”<sup>384</sup>

Në këtë kapitull po përpiqemi të flasim pikërisht për këta faktorë.

## 5.1. TRAJTIMI I NDRYSHORËVE SOCIOLOGUJISTIKË

### 5.1.1. Moshë

Individi e gjen veten në një hapësirë multidimensionale.<sup>385</sup> I krahasuar me qelizën në biologjinë qelizore ai karakterizohet nga përvoja e vet gjuhësore, e cila ndryshon me atë të një individi tjetër<sup>386</sup> dhe që shumësia e të cilave strukturojnë një shoqëri të dhënë. Këta individë brenda kësaj shoqërie mund të klasifikohen në bazë të faktorëve pak a shumë të pavarur si: moshë, vendi i origjinës, klasa shoqërore, përkatësia gjinore etj. sipas të cilëve u lind nevoja të zgjedhin se ku duhet ta vendosin veten. Gjuha luan një rol të rëndësishëm në këtë drejtim pasi ajo i jep individit një rrjet të strukturuar simbolesh të cilat ai mund t'i përdorë për të vendosur veten në këtë lloj hapësire”<sup>387</sup>

Një prej këtyre faktorëve të rëndësishëm jashtëgjuhësorë me karakter natyror, me vlera të rëndësishme sociolinguistike është “**moshë**”. Kujtojmë këtu që ndarjen në breza e kemi bërë duke u bazuar pikërisht tek faktori moshë<sup>388</sup>. Kështu, më të vjetërit në moshë janë gjithnjë më ruajtës sesa të rinjtë, të cilët kanë prirje të jenë përtëritës dhe inovativë në të folur, përfundim ky të cilit i bashkëngjiten edhe normat kulturore, zakonet, traditat, mënyra e jetesës etj. Nuk duhet të harrojmë se kemi të bëjmë me “një treg kulturor dhe me një treg gjuhësor ku shkëmbimet janë të ndryshme për breza, shtresa, mjedise, dhe individë të ndryshëm”<sup>389</sup>

Pavarësisht nga përfundimet dhe të dhënat tona në lidhje me ndryshimin e të folmes sipas brezave, për të kuptuar edhe më mirë vlerën e faktorit “moshë” në sociolinguistikë, mjafton të krahasojmë folës të moshave të ndryshme qoftë edhe brenda të njëjtimit brez, për të parë ndjeshmërinë e gjuhës ndaj këtij faktori.

*Folësi 1: Joo... / mir u kish sëllë/ me greg u kish sëll mirë// edhe kur u trazua axhere Shqipëria me Itali e me këto/ ish gregu atje/ i mblodhi eksori/ i ngriti të gjithë ka shtatëmbëdhjetë e rëpjetë/ i mblodhi eksori/ i shkuli të gjithë// kufi.../ kufi me*

<sup>384</sup> Shkurtaj, Gj. *Sociolinguistika shqiptare*, 2003.

<sup>385</sup> Shkurtaj, gj. “Sociolinguistikë e shqipes”, Morava, Tiranë 2009.

<sup>386</sup> Hudson, R. *Sociolinguistika*, ( i përkthyer) Dituria Tiranë 2002 .

<sup>387</sup> Berruto, G. *Sociolinguistika*, Bolonjë 1994.

<sup>388</sup> Sipas idesë së prof. Shkurtajt në *Sociolinguistika* , Tiranë 2003.

<sup>389</sup> Shkurtaj, Gj. *Disa dukuri të së folmes së Kurbinin nën dritën e sociolinguistikës*, S.F 2000

*Turqi/ e këto... s̄a (saq̄e) kur ishën atje këndojën edhe zōjt e turkut// i ndijën këta atje ku i kish shpënë gregu// p̄esaj i m̄irr i kap gregu ayhere bëri kërdinë.... U sillte mirë më përpara/ si vëllezër ata/ si nevet/ vëllezër gjithë// edhe vineshin / vineshin kur na holënë/ kur i muarrnë vëllezër/ baballarë/ çish kishnë/ eksori i thojëm ne/ kùшту ....*

N. Habibi 79 vjeç, plazh-Durrës  
(folëse e paarsimuar)

#### *Folësi 2*

*Neve rrugës kur u nisëm sehften e pare / erdhëm në krikohuar / ja thonë njirit fshat atje // d̄enjëm atje sa d̄enjëm/ nuk na pranuan ata / çam ishin ka neve// na lanë atje në katua / i thomi katua b̄udrumit neve // na lanë atje ato // erdhëm me kuel rrugës / ngarkuar me plaçkë / me ushqim që hajëm rrugës // erdhëm në Sajavë / në Sajavë ndenjëm thuaj njëzet ditë në bina t'ullinjve // atje bëmë çadre me velënxa i thomi ne/ i thoni batanije ju / po ne i thoshim velënxa leshi// me velënxa në bina t'ullirit / ndenjëm njëzet dit atje....*

B. Habibi, 68 vjeç

(folëse me arsim 4- vjeçar)

Nënvizimet në tekstet e mësipërme, flasin qartë për praninë e dukurive të vjetra çame, fonetike, morfologjike, apo leksikore në të folmen e këtyre individëve . Por siç vihet re, numri i dukurive ruajtëse tek folësja me moshë më të vjetër është shumë herë më i madh sesa numri i tyre tek folësja tjetër në moshë më të re; pavarësisht përkatësisë së tyre në të njëjtin brez, në të njëjtën familje etj.

Ndërsa, dysorësia në përdorim është më e madhe në tekstin e dytë . Siç e shohim edhe nga shembulli ynë, kemi përdorime të së njëjtës fjalë, por të ndryshme nga pikpamja fonetike: *denjëm* dhe *ndenjëm*, *atje* dhe *atje*; apo fjalë të ndryshme në formë dhe të njëjta nga pikpamja kuptimore ( të paktën kjo është ajo çka nënkuptohet ), p.sh: *katua* dhe *budrum*, *velënxa* dhe *batanije*; të gjitha këto flasin qartë për shfaqjen e dukurisë së bilinguizmit<sup>390</sup> në të folur, si edhe për trysinë e madhe që kjo e folme ka pësuar në varësi të faktorit të lartpërmendur. Po të vërejmë me vëmendje, kjo dukuri megjithëse në një rast të vetëm, është e pranishme edhe në ligjërimin e folëses së parë, edhe pse më e thyer në moshë. Aty spikat me përdorim dysor, fjala *atje/ atje*.

Nga ana tjetër, folësja e dytë në moshë më e re, i është përshtatur më mirë ndryshimit gjuhësor, dhe, që të dyja bashkë në një farë mënyre janë përpjekur të integrohen (përshtaten) në bashkësinë pritëse.

Pra, shkurtimisht dukuritë që vërejmë janë ruajtje, bjerrje e ripërtëritje të cilat vertetohen më së miri përmes dysorësisë në të folur.

### 5.1.2 Përkatësia gjinore

Një faktor tjetër mjaft i rëndësishëm po i karakterit natyror është edhe përkatësia gjinore. Një ide për “*të folët e grave*” nën kuadrin e disa shqyrtimeve të eufemizmave të shqipes, ka bërë qysh herët edhe prof. E. Çabej<sup>391</sup>, nëpërmjet së cilës mbahet edhe si pararendës i sociolinguistikës shqiptare në përgjithësi. Hudson ka trajtuar gjithashtu një temë interesante mbi seksizmin në sistemin gjuhësor i cili

<sup>390</sup> Ky term është përdorur për të karakterizuar përdorimet dysore në të folur, por siç e dimë me BILINGUIZËM ose PLURILINGUIZËM kuptojmë rastin e një bashkësie folëse, repertori i së cilës është i përbërë prej dy ose më shumë sistemesh gjuhësore (konceptim i gjerë), ose thënë ndryshe (të gjithë folësit që zotërojnë dy a më shumë sisteme gjuhësore (konceptimi i ngushtë).

<sup>391</sup> Po aty.

trajton edhe disa mënyra referimi të ndryshme.<sup>392</sup> Një analizë të hollësishme për ndarjen në sekse ka bërë prof. Gjovalin Shkurtaç duke analizuar dhe thënien e bukur popullore “ punë grash dhe fjalë grash”.<sup>393</sup> Të gjithë studiuesit e kësaj disipline kanë rënë në një emërues të përbashkët për sa i takon prirjes konservuese apo ruajtëse, inovative apo rinovuese të së folmes tek meshkujt dhe femrat. Sipas tyre, të folurit dallohet dukshëm edhe sipas seksit. Pa dyshim edhe ne duke e parë edhe përmes këtij studimi, mendojmë se dallimi sipas përkatësisë gjinore është gjithmonë i pranishëm në çdo të folme apo gjuhë njerëzore.

Sipas këtyre të dhënave, tek e folmja çame kemi vënë re pikërisht këtë dallim: diferencat midis të folmes së grave dhe të folmes së burrave janë të dukshme.

Konkretisht, në brezin e vjetër sot vërejmë se, e folmja e grave është më konservuese sesa ajo e burrave. Duke iu rikthyer përsëri folëses së parë mjafton që të shohim vetëm rreshtat e para të regjistrimit dhe aty vërejmë disa dukuri të cilat spikasin më tepër. Kështu tek kjo e folme ruhet ende ajo dukuri e rrallë e çamërishtes, *χ*-ja greke që përkon me grupin *hj>hq* të shqipes. Ndër të tjera, kjo është një dukuri e cila i ka ndihmuar studiuesit edhe për të bërë kronologjinë e huazimeve greke në shqipe, sipas refleksit të saj tek fjalë të ndryshme.<sup>394</sup> Gjithashtu tek e folmja e grave vërejmë edhe përdorimin e fonemës *j* në vënd të fonemës *gj*, -një dukuri mjaft e rrallë për çamërishten, apo asimlimin në fjalën *grek>greg .....etj*.

Gjithashtu tek gratë e brezit të mesëm gjejmë të trashëguar nga çamërishtja e të parëve një dukuri të rrallë, zgjatimin e fonemës *rr*. Kjo gjë bën që ajo të fitojë një timbër të veçantë të ndryshëm në shqiptim nga ai i fonemës *rr* të shqipes. Mendojmë se ky është një përdorim i cili bëhet për arsye të caktuara emotive, ndofta për të nxjerrë në pah një fjalë përkatëse që përbën dhe bazën kuptimore të thënies.

Gjithashtu, tek e folmja e grave kemi vënë re edhe fjalë leksikore të veçanta që lidhen me sfera të caktuara, si ajo e gatimit, orendive shtëpiake; fjalë dhe shprehje të folklorit çam si, këngë çame të dasmave etj., të cilat nuk janë pjesë e fjalorit të meshkujve.<sup>395</sup> ( mbushe me shembuj)

Të gjitha këto dukuri nuk i vërejmë aspak në të folmen e seksit tjetër **të po këtij brezi**. Ruajtjet tek femrat, më tepër sesa tek meshkujt, lidhen edhe me vetë faktin se gratë çame kurdoherë kanë qenë më të mbyllura sesa meshkujt. Të vjetrat çame përpiqen të ruajnë edhe sot e kësaj dite zakonet e të parëve. Dikur, ato në Çamëri ishin përshtatur me rolin e tyre të amvisës shtëpiake. Duke qenë se Çamëria ndodhej nën sundimin e një shteti tjetër, atij grek, i cili dallohej në zakone, tradita etj., kjo gjë i detyronte më shumë ata të kufizoheshin brenda për brenda jetës familjare. Meshkujt në këtë mënyrë ishin të detyruar të kontaktonin më shumë me botën e jashtme, për të plotësuar nevojat ekonomike të familjeve të tyre. Ruajtjet në planin jetik kanë lënë gjurmë të thella në të folmen e brezit të vjetër sot.

Ndërsa, tek e folmja e brezit të ri nuk ka sesi të vërehet e njëjta gjë. Për sa i përket ndryshimeve shoqërore, politike e për rrjedhojë ekonomike, në sistemin diktatorial, ato kanë peshuar më shumë tek brezi i e mesëm. Në Shqipëri, sistemi në fjalë, bënte që gratë t'i nënshtroheshin ligjeve të tij të rrepta sipas të cilit “ gruaja duhet të punonte krahe për krahe me burrin”. Kjo parullë u vu menjëherë në zbatim dhe bëri që gratë çame të brezit të mesëm pavarësisht nga zakonet e trashëguara, të dilnin paksa nga vorbulla e mbylljes brenda mureve të shtëpisë dhe të frekuentonin të njëjtat ambjente që frekuentonin dhe burrat. Në këtë mënyrë ai diferencim që

<sup>392</sup> Hudson, A. R. *Sociolinguistika* ( përkthyer nga M. Ymeri, botimi i parë në shqip), 2002.

<sup>393</sup> Shkurtaç, Gj. *Sociolinguistika*, Tiranë 2003.

<sup>394</sup> Çabej, E. *Studime Gjuhësore*, f. 98, Rilindja, Prishtinë 1976.

<sup>395</sup> Shih në disertacion temën: “Leksiku në të folmen e çamërishtes”, f. 107.

ekzistonte ndërmjet burrit dhe gruas u thye. E folmja e tyre tashmë filloi të gërshetohej në shumë drejtime. Njerëzit filluan t'i përshtateshin sa më shumë formave bashkëkohore të të folurit, duke i dhënë përparësi ndryshimit të saj në përshtatje me veprimtaritë e ndryshme prodhuese, kulturore e shoqërore.

Megjithatë, edhe tek ky brez, e folmja e grave nuk ka sesi të jetë e njëjtë me atë të burrave. Dallimi ndërmjet tyre do të jetë gjithmonë i dukshëm, pavarësisht evoluimit të kohës. Dhe kjo është e kuptueshme, pasi edhe nëse ato gëzojnë një status të lartë dhe kanë një karrierë të shkëlqyer, atyre u lind nevoja të jenë edhe amvise të zonjat, të krijojnë një familje me baza të shëndosha për të cilën kanë përgjegjësi parësore.

Që meshkujt e brezit të mesëm janë më të prirur për ndryshim, e kemi vërtetuar në studimin që i kemi bërë kësaj të folmeje në disa prej zonave të Gegërishtes së Shqipërisë së Mesme. Për rrjedhojë, kjo është vërtetuar më së miri me futjen në repertorin e meshkujve të disa elementeve të veçanta të së folmes së gegërishtes qëndrore, më lehtë sesa tek gratë, siç është rasti i përdorimit të infinitit sikurse në gegërishte: “*ai e kërkonte babën me kamqulje me e taku/ nuk muji me e gjet*”<sup>396</sup>; asimilimi i grupeve bashkëtingëllore *mb, nd, ng* sipas të folmes vendase ( asimilim paravajtës ). “*Për zotin nuk ja maj mend// masi e përsëriti një miku i tij/ për arsye se baba i ka pas bo një ner atij*”; në sistemin foljor vëmë re përdorimin e foljes në të pakryerën me mbaresën *sh* ( *ftoshin*, kjo dukuri vihet re më tepër në brezin e ri ); përdorimi i pjesores së foljes sipas gegërishtes ( *ka ardh, ka bo* ), disa forma përemrash të ndryshëm sipas gegërishtes ( *kta, kto, tate, tat* ) etj.

Duhet të shpjegojmë se, të gjitha këto nuk përbëjnë përdorime të ngulitura. Përdorimi i tyre lidhet edhe me faktorë të tjerë siç është p.sh. niveli i arsimit, pasi siç do ta sqarojmë më poshtë, folësit pa arsim e kanë më të lehtë të hidhen drejt formave të parregullta.

Duke bërë një krahasim midis grave dhe burrave të brezit të mesëm, vërejmë se gratë e kanë gjithmonë më të vështirë të imitojnë format e parregullta të dialektit të mesëm. Ato i përmbahen më shumë rregullave. I tillë ka qenë dhe vlerësimi i Labovit për të folmen e grave “*gratë i përshtaten normës së gjuhës standard më mirë sesa burrat*” ; apo i Lambercit për të folmen e arbëreshëve të Molizes: “*gjuha e grave është disa gradë më e pastër nga elementi Italian sesa ajo e burrave*”<sup>397</sup>

### 5.1.3. Arsimi

Arsimi është një kriter social mjaft i rëndësishëm, i cili luan rol vendimtar në përmirësimin e të folmeve në përgjithësi dhe afrimin e tyre me normën letrare.

Pavarësisht nga mosha, përkatësia gjinore etj., apo dhe nga elemente të tjera të rëndësishme jashtëgjuhësore, ky është një kriter i padiskutueshëm, mjaft i rëndësishëm në krijimin e diferencave të sjelljes gjuhësore të individit. Për shembull, diferencat në ligjërimin e një folësi të brezit të vjetër pa arsim dhe një folësi të po këtij brezi me arsim, janë gjithmonë të dukshme, sikurse janë po aq të dukshme edhe diferencat midis një folësi të brezit të mesëm me arsim dhe një folësi tjetër të po këtij brezi pa arsim; midis një adoleshenti të arsimuar dhe një adoleshenti të paarsimuar; midis një fëmije të vogël që frekuenton rregullisht kopshtin dhe një fëmije që rritet në ambientin familjar; midis një intelektualit dhe një punëtori të thjeshtë; midis një rektori, profesori, drejtori dhe një të punësuarit pa ndonjë status të caktuar etj.

<sup>396</sup> R. Mehmeti 50 vjeç.

<sup>397</sup> Shkurtaj, Gj. Po aty, f. 232, Tiranë.

Meqenëse më lart përmendëm edhe diferencat gjuhësore sipas përkatësisë gjinore, për të bërë një shqyrtim sa më të qartë të çështjes, kemi krahasuar të folme të ndryshme të së njëjtës gjini me arsim, përkatësisht pa arsimin e duhur shkollor, pasi siç edhe e kemi konstatuar më lart të gjitha këto kritere dhe të tjera si këto që do të trajtojmë më poshtë veprojnë të gërshetuar njëri me tjetrin.

#### Folësi 3

*Po ecnim më posht/ edhe aty ishte e zënë// ecëm nevet në Hoxhaj.. një stacion mas Barit/ shikoi numrin aty/ çohuni tha...// ù kam hip n'Leçe i tha Ramadani/ e kam pre biletën që dje // Ramadani shqip ajo italishte // vesh s'merreshin// e kuptum ne kshu// shkova u ula aty pësaj..//as nga Hamideja nuk shkova / do lëk mi / është larg n'fund dunjas.. //Eva kishte shpia t'mira / ça vila// kto shpia / kto modelet që janë marrë / andej jan marrë// Eva është ku isht Haxhiu/ d'e pys Nepen kur t'vi kët verë// shkum në dy tre fshatre/ në supermarketa kshu me makinë // kan punu mi dynjaja ....etj*

L. Mehmeti 55 vjeç, me arsim shkollor 7- vjeçar

#### Folësi 4

*Siç tregon mamaja ime/ nëna( gjyshja) ime është fejuar e vogël// gjatë kësaj kohe u fejuua vetë / u fejuua edhe vëllai vet// vllai ishte më i madh/ se ishte martuar njëherë/ e kishte nda nusen// ngaqë kishte nda nusen nuk i jepnin nuse tjetër/ dhe donin t'i gjenin nuse patjetër/ se nuk ishte ndonjë moshë shumë e madhe // gjetën mënyrën/ e fejuan me motrën e dhëndrit që bënë/ domethënë nëna u fejuua/ u fejuua dhe motra e babait tim // erdhi dita e dasmës / simas zakonit hypnin në kalë/ siç tregon nëna/ u mbulua fare me duvak/ quhej ai/ me një copë beze t'kuqe / dhe u martuan në një ditë.*

M. Jaho 50 vjeç, me arsim të lartë shkollor

Siç e shohim më lart të gjitha nënvizimet tregojnë shmangie nga norma. Në shembullin e parë kemi më shumë çrregullime në të folur të cilat lidhen me dialektin gegë ( të folmen e Shqipërisë së Mesme).

Në rastin e dytë, folësja ka shmangur në përgjithësi çrregullimet dialektore, duke ruajtur nga dialekti i origjinës format e rregullta të standardit dhe duke përmirësuar të folmen sipas normës standarde.

Pra, duke vëzhguar me imtësi tekstet, vërejmë se folësit në përgjithësi kanë prirje të rregullojnë format e parregullta të dialektit të tyre. Ato ruajnë ato forma që përkojnë me standardin e sotëm; ndryshojnë të folmen e tyre sipas normave të shqipes së përgjithshme ( këtë gjë e vërtetojmë mjaft mirë nëse krahasojmë këto tekste me tekste të moshave më të vjetra që kemi shqyrtuar tek faktori “ moshë”); dhe në fund të fundit ato janë imitues qoftë edhe të disa formave të parregullta të dialektit të tjetrit ( nga kontakti midis dy të folmeve marrdhëniet janë gjithmonë të pranishme).

Nga ana tjetër, arritjet intelektuale të individëve shoqërohen gjithmonë dhe më tepër me pjesmarrjen e tyre nga dita në ditë në veprimtari të ndryshme politike, shoqërore, kulturore etj. Sipas këtyre të fundit, folësit gëzojnë edhe statuse të caktuara, që në vetvete kërkojnë një lloj përmirësimi të të folurit dhe përdorimit të një gjuhe më të moderuar.

Kështu, përgjatë një mbledhjeje zyrtare të një zone të caktuar e planifikuar nga shoqata “ Çamëria” , nënkryetari i kësaj shoqate gjatë ligjëratës së tij përdori gjuhën letrare, edhe intelektualët e tjerë çamë ia përshtasin gjuhën situatës. Në çastin kur ky individ diskuton me një tjetër pjesmarrës pranë tij ( diskutim miqësor), del shpejt

jashtë qerthullit zyrtar dhe përdor një çamërishte të pastër: *Isht ka Kurtesi ài mo?* (Kurtesi, - fshat në Çamëri, *ka- nga, isht- është, ài- ai*).<sup>398</sup>

Në një vizitë miqësore tek njëri prej studiuesve të njohur të historisë së Çamërisë, z. Hajredin Isufi, më bëri përshtypje mënyra e prezantimit që na bëri tek bashkëshortja e tij: “... *këtë e kemi një nuse çame ka “Troplintë” , ndërsa këtë tjetrin, e kemi një çam ka Vërsela.*”

Këto shembuj përveçse tregojnë sesi folësi e dredh gjuhën sipas rastit dhe bashkëbiseduesit, janë gjithashtu dëshmuar të faktit sesa e pëlqyeshme është të flasësh në gjuhën e familjes.

Roli i arsimit është i pashmangshëm edhe në të folmen e adoleshentëve çamë. Tek të paarsimuarit vërejmë shumë dukuri që i përkasin të folmes së bashkësive pritëse, ndërsa adoleshentët e arsimuar janë zbatues më të mirë të normës letrare.

## 5.2. Dukuri të tjera që kushtëzojnë ligjërimin tonë si akt identiteti.

### 5.2.1. Ndryshimi dhe pasojat që solli ai në bashkësinë çame.

Ritmi i ndryshimit në përgjithësi, në gjuhë, kulturë, zhvillim etj. tek çamët ka qenë dhe vazhdon të jetë më i ngadalshëm si proces, në krahasim me të folmet e bashkësive të tjera.

Çamët, kanë qënë të izoluar dhe për rrjedhojë të bashkuar me njëri- tjetrin që në Greqi, në gjuhë, zakone, rite, kulturë, në gjithçka. Historia e dhimbshme e dëbimit të tyre nga vendi, forcoi edhe më shumë lidhjen midis tyre, lidhje e cila po përçohet deri në ditët tona. Shpërngulja e pas viteve 44-ër shkaktoi një plagë të madhe shpirtërore, gjë e cila solli një afrim edhe më të madh sa ai që kishte ekzistuar dikur midis çamëve në vendin e origjinës. Ky është një faktor i rëndësishëm jashtëgjuhësor i cili ka çuar në ruajtjen e kulturës çame, zakoneve, riteve dhe gjithë etnografisë së tyre të bukur. Kjo ka sjellë gjithmonë edhe mosparapëlqimin prej çamëve të përzierjeve racore.

Bashkëjetesa me bashkësinë shoqërore shqiptare ka qenë e vështirë. Kjo diasporë e brendshme u ndesh me shumë probleme. Ishin shqiptarë dhe quheshin të ardhur, “jabanxhinj” të paqenë. Përplasja nga pikëpamja gjuhësore ishte më se e kuptueshme. Kështu një nënë çame thotë: “ Kur erdhëm ne këtu, u thoshim vajzave të rea të mbëluara me çarçaf<sup>1</sup>: “ *çu dive? Mirmëngjes! – Ata na thoshin ne, - s’kemi thes ne jooo....., s’kemi thes.*”<sup>399</sup>.

Siç duket edhe nga ky shembull, çamët u përplasën jo vetëm me një shqipe të evoluar por edhe me një Shqipëri mjaft të varfër nga pikëpamja ekonomike, për rrjedhojë përshtatja e tyre më e vështirë fillimisht ka qenë bashkëjetesa me varfërinë. Një tjetër folëse (që s’është e vetmja), tregon sesi kishin mësuar në “Shqipëri” nga “shqiptarët” të bënin kasolle me kashtë, pasi në Çamëri nuk kishin parë ndonjëherë të tilla. I gjithë ky parashtrim social gjen pasqyrimin e vet në të folmen e tyre. Të gjithë këta faktorë çojnë dashje pa dashje në një “mbyllje” në vetvete në të gjitha drejtimet, që favorizojnë ruajtjen.

Ndër elementet e veprimtarisë ligjërimore të para prej nesh si të domosdoshme për t’u trajtuar, janë: koha dhe vendi në të cilin kryhet akti i komunikimit, folësi që komunikon, ligjërimi si akt shoqëror, situata në të cilën kryhet ligjërimi, qëllimi për

<sup>398</sup> Të dhënat janë vjelë në lagjen 13 Plazh- Durrës.

<sup>399</sup> Folësja në fjalë është B. Habibi, Arapaj Durrës.



të cilin komunikohet, konteksti, rrethana, mënyra sesi trasmetohet mesazhi, roli i bashkëbiseduesit etj.<sup>400</sup> Të gjithë këto elemente përngjajnë pak a shumë me variabilitetet e Fishmanit në formulën e tij: “*Kush flet, me kë, në cilin varietet, të cilës gjuhë, kur, për ç’arsye dhe me çfarë mjetes interlokutive?*” duke e kompletuar këtë formulë edhe me tre elemente të tjera të rëndësishme të cilat janë “*Si, pse dhe ku*”<sup>401</sup>

Për ta bërë sa më të kuptueshëm secilin prej këtyre elementeve, po i ilustruam ato me disa shembuj përmes të folmes së çamërishtes.

Sikurse e vumë në dukje më lart, në të folmen e çamëve të brezit të vjetër me gjithë karakterin e tyre ruajtës, gjuha e ligjërit të përditshëm preket nga ndryshimi. Si pasojë e këtij procesi merr rrugë edhe shfaqja përtëritjeve të vazhdueshme apo e risive në të folmen e individëve të caktuar. Në të tre brezat vërejmë që në përshtatje me elementet e lartpërmendura ligjërimore, në funksion të realizimit të nevojave komunikuese apo të një akti të caktuar komunikues, ndryshimi i të folurit krijon edhe situata të larmishme të përzierjes së kodeve, të zëvendësimit të kodit, të cilat ndër të tjera janë edhe rrjedhim i pashmangshëm i bilinguizmit dialektal.

Shembulli i parë është ai i komunikimit midis dy folëseve, njëra përfaqësuese e brezit të vjetër çam dhe tjetra përfaqësuese e brezit të vjetër të së folmes së Shqipërisë së Mesme, gjatë të cilit do të shohim në një “koktei” gjuhësor përzierjen e ekuilibruar midis dy të folmeve (çamërishtes dhe Shqipërisë së Mesme).

A. – *Vjen non-jherë i shoqi i sat bilë?*

B. – *ëë..., ça the?*

A. – *Burri i gocës tënde vjen non-jherë?*

B. – *Po, po... vjen. Po vajzën tate ktu e ke apo jash shtetit?*

A. – *Kùtu, kùtu... etj*

A: I. Mehmeti (75 vjeç)

B: B. Sekurti (80 vjeç).

Në këtë shembull vërejmë tre sinonime për fjalën *vajzë*<sup>402</sup> Njëri prej tyre i përket standardit dhe dy të tjerët të folmeve përkatëse. Kështu, nga njëra anë kemi zëvendësimin e fjalës çame *bilë* nga përfaqësuesja e dialektit të çamërishtes (A) me fjalën *gocë* të dialektit të tjetër; dhe nga ana tjetër, kemi zëvendësimin e kësaj të fundit me fjalën *vajzë*, pra përdorimin sipas standardit tek përfaqësuesja e brezit të vjetër të së folmes së Shqipërisë së Mesme (B). Thënë ndryshe, nga njëra anë kemi përpjekjen që bën folësja çame për të realizuar aktin e ligjërit, duke iu përshtatur sa më mirë të folmes së gegërishtes së Shqipërisë së Mesme, dhe nga ana tjetër, kemi përpjekjen e folëses tjetër për t’u orientuar sa më mirë drejt asaj që quhet normë.

Gjatë këtij akti kuptohet se që të dyja folëset kanë dijeni për hendekun e madh që gjendet midis dy varianteve dhe në mënyrë të vetëdijshme ato mundohen ta kapërcejnë këtë hendek për të përçar **mesazhet** e njëra tjetër.

## 5.2.2. Martesat e përziera

Një tjetër faktor i rëndësishëm, që favorizon ndryshimin dhe çon në krijimin e situatave bilingve në të folur është edhe martesat e përzier.

<sup>400</sup> Rrokaj, Sh. *Hyrje në gjuhësinë e përgjithshme*, shblu, Tiranë 2000

<sup>401</sup> Berruto, G. “*La sociolinguistika*”, Bolonjë, 1994.

<sup>402</sup> Diferenca midis dy të folmeve duket qartë edhe nga prania e fjalëve të tjera.

Për arsye të ditura tashmë, çamët gjithmonë janë tërhequr edhe nga dëshira e madhe e mbylljes nën atë guackën e vet, ku çdo gjë të ishte fund e krye çame. E megjithatë, izolimi brenda vetes filloi të marrë të tjera përmasa. Çamët tashmë kanë dalë jashtë asaj korace të dikurshme të më të vjetërve. Një shembull tipik i këtij ndryshimi janë edhe martesat e përziera. Kjo valë “përparimi” përfshiu brezin e mesëm dhe sidomos atë të ri. Nuk mund të mohojmë që shumica e martesave parapëlqehen ende të bëhen brenda për brenda origjinës, por nuk janë të pakta gjithashtu edhe rastet e martesave të përziera ku, për rrjedhojë njëra prej gjuhëve, e nënës apo e babait, është **alogjene**<sup>403</sup>

Sigurisht, brezi i vjetër shfaq një farë keqardhjeje për të tilla raste, por megjithatë dashje pa dashje i është nënshtruar fatit. Ndërsa përfaqësuesit më të rinj pajtohen me këtë ndryshim, duke mos mohuar nga ana tjetër edhe ato, dëshirën e një bashkëshorti a të një bashkëshorteje çame.

Më poshtë po paraqesim mendimin e dy të moshuarve çamë lidhur me këtë çështje.

1. *“tani ...ajo isht..../ po t’na piesish ne t’vjetve //qeji na ka kshu n’dorën tonë/ po megjithatë s’ka asnjë gjë kjo punë// unë kam qenë fanetik/ edhe pse ...ne t’vjetët jemi me brumin e vjetër/ ne kemi pas ato koncepte....// Lata isht ka vëndi ktu/ Gjula është kosovare/ kjo e Arapit isht çame....* **F. Hyseni 75 vjeç**

2. *“Kët kam çame ù / nusen e Ethemit// pse nuk i kam nusët ù vëndalesha// Bija isht ka Arapaj/ një nuse e muarmë ka Kavaja/ edhe një nuse tjetër e kemi ka ata të Shkozetitë... F. Jaho 70 vjeç*

Mjaft interesante në të tilla raste shfaqet gjuha e fëmijëve, me larmi përzierjesh dhe zëvendësimesh të ndryshme. Tek e folmja e fëmijëve të tillë vemë re se gjatë ligjëritimit të tyre disa prej dukurive kanë një përdorim më të zbutur në trajtë dysorësie, ndërsa disa të tjera spikasin më fort në përdorim. Ajo çfarë na ka bërë përshtypje është fakti se edhe pse fëmijët mund të vijnë nga prindër të njëjtë, dukuritë çame që ato përdorin mund të ndryshojnë për sa i takon përdorimit më të shpeshtë të njërit apo tjetrit dukuri.

Nga një studim për së afërmi i të folmes së dy motrave Denadës dhe Irenës (1999) dhe i të folmes së dy vëllezërve (2010), të cilët kanë jetuar me gjyshërit, vërejmë se fëmijët e parë shquhen për dallime fonetike, morfologjike e leksikore, ndërsa tek të dytët reduktohen këto dallime duke ruajtur ndonjë dallim të vogël kryesisht leksikor të cilët nga ana tjetër përvetësohen më shpejt nga modeli paraprak por edhe ai kontekstual në familje. Kjo ndodh pasi ato kanë imituar në radhë të parë gjuhën e motrës apo të vëllait të madh në fazën kur këta e kanë rregulluar të folmen në sajë të frekuentimit të sistemit parashkollor, apo këmbënguljes për ndryshim nga ana e prindërve, veçanërisht nënës etj.

Po radhisim disa prej tyre të cilat në raste të tilla përzierjesh janë mjaft të larmishme dhe të shumta në numër.

**Denada Dahriu 5 vjeç** (babai çam): shfaqet mbizotëruese, si dëshmi e përzierjes së dy të folmeve (Shqipëri e Mesme : çamërishte) **dukuria e theksit sintaktik** (logjik): *“ mos me shtyj ashtu ( theksi logjik) / se më dhemb koma. Në fjalinë e parë kemi theksin logjik të pranishëm, ndërsa në të dytën kemi përdorimin e fjalës këmbë sipas të folmes së nënës.*

**Irena Dahriu 4 vjeç** ( nga të njëjtët prindër): shfaqen disa dallime leksikore, më të thjeshta : e folmja e saj është mjaft e pasur në fjalë leksikore çame, si: *papar, xhixhi, xhexhe* etj.

<sup>403</sup> E njëjtë ose jo me atë të mjedisit apo bashkësisë shoqërore ( në rastin tonë me atë të mjedisit ku ato jetojnë).

**Omar Abdurahmani** 3- 4 vjeç ( babai çam): mbizotërojnë dallimet fonetike, morfologjike dhe leksikore, si: *gjish, si, ki, isht, çish, u volla (volla)* etj. *babi/ Vlora isht kjo // Vlora ( me theks sintaktik)*

Ndërsa, ndërmjet Omarit ( dy vjeç e gjysëm) dhe Altinit (10 vjeç), ky i fundit i shpërngulur nga zonat veriore të Shqipërisë, kemi regjistruar këtë dialog të shkurtër:

A. *Çfarë a ky Omari?*

B. *Ki, ki ..kamioni, kamioni.*

A. *Kush ta ka ble ty kte Omari?*

B. *Gjishi, Gjishi... ka ble gjishi.*

A: Altini, 10 vjeç

B: Omari, 2 vjeç e gjysëm.

Dyndjet mekanike të popullsisë pas ndërrimit të sistemit nga ai diktatorial në atë demokratik, u bënë edhe objekt kërkimi ku mund të gjesh të dhëna të larmishme për sociolinguistikën e sotme. Këto hulumtime kanë përfshirë më shumë qytetet e mëdha, sidomos ato që përkojnë me qendrën, ku ndër të tjera vërshimet kanë qenë edhe më të mëdha. Zhvillimi ekonomik e kulturor që pësoi Shqipëria e këtyre viteve, dashje pa dashje ka lënë dhe po len ende gjurmë të thella në të folmen e çdo individit. Pra, thënë ndryshe, për sa kohë që Omari do të luajë me Altinin dhe Altini me Omarin ( pavarësisht nga shembulli që dhamë), do të kemi patjetër marrëdhënie e ndikime të ndërsjellta.

**Hedi Abdurahmani** 3-4 vjeç ( nga të njëjtët prindër ): mbizotëruese ngulitja e disa fjalëve në toskërishte që nuk përdoren pothuajse fare nga brezi i ri urban i Shqipërisë së Mesme. E pamundur të zëvendësohen tek ky fëmijë folja *çel* (ndez), parafjala *ne* (tek) me fjalët gjegjëse *ndize, tek .. : çele dritën, çele zjarrin; babi, do ikim ne ky dyqani?*

### **5.2.3. Krenaria për origjinën e të parëve, si faktor i jashtëm ndikues në këtë të folme**

*Bashkësia shoqërore është një grup individesh që kanë të përbashkët një farë kulture dhe që për disa motive ndjehen bashkë dhe ruajnë lidhjet ndërmjet tyre...*<sup>404</sup> Nga ana tjetër, individët e rinj në moshë përpiqen që të përshtaten me atë lloj kulture që për to është e re, bashkëkohore, që në rastin tonë përkon pak a shumë me kulturën gjithëshqiptare.

Për të rinjtë është mjaft e rëndësishme që të dalin nga kornizat e ngushta dhe normat zakonore të më të vjetërve, por që në rastin tonë është dhe mjaft e vështirë, pasi të rinjtë çamë tërhiqen shumë edhe nga trysnia që ushtron tek to “ konservacioni shpirtëror”. Ky i fundit, afron të rinjtë me më të vjetërit e tyre dhe që të dyja palët ushqehen përherë e më shumë nga krenaria e të qenit çam nga Çamëria.

Krenaria për origjinën është një tipar mjaft i rëndësishëm me rrënjë të thella. Ajo është kultivuar në breza mjaft mirë dhe vazhdon të kultivohet edhe sot e kësaj dite, duke shërbyer edhe si lëndë e parë e konservacionit të gjithanshëm tek të gjithë çamët në përgjithësi. Të jesh krenar për origjinën tënde është në radhë të parë shenjë respekti për vetveten. Çamët kanë ditur mjaft mirë ta mbrojnë veten në shekuj, si dhe të gjitha virtytet e mira që i kanë karakterizuar ato gjithmonë. Të mbijetuarit, përkundrejt gjithë asaj historie që i ndjek, forcoi ndër ta një lloj lidhje të fortë, të qëndrueshme, të cilën është e vështirë ta shpërbësh. Kalimi i viteve nuk bëri gjë tjetër

<sup>404</sup> Shkurtaj, Gj. “Sociolinguistikë e shqipes”, Tiranë 2009

veçse forcoi gjithnjë e më shumë atë tipar të vyer që çamët e ruajnë si një gur të çmuar, krenarinë për rrënjët e të parëve.

Nëse i pyet të gjithë të vjetërit çamë sot “ nga cili vënd i Çamërisë je?” Ato thonë: “ ka vëndi më i bukur dhe më i mirë i Çamërisë ( Vola, Filati, Vërsela, varet nga vëndi i tij i origjinës ) ” dhe, ajo ç’ka është më interesante, është se **që të gjithë të përgjigjen në të njëjtën mënyrë.** Ndërsa pyetjes: “ Cila është dëshira jote më e madhe? -Ato në këtë moment harrojnë fëmijët, familjen e tyre dhe përgjigjen: “ Të vete njihër në Çamëri dhe pastaj të vdes”

Malli për vendlindjen ka qënë dhe është kaq i madh për të moshuarit çamë, saqë ka rritur brenda tyre nga dita në ditë tej mase dashurinë për gjithçka që është çame; për gjuhën e tyre të bukur, traditat e vjetra, me pak fjalë krenarinë e të qenit çam.

Një emigrant<sup>405</sup>, i cili kishte emigruar në Greqi dhe kishte parë vëndin e të parëve, Çamërinë, pas kthimit në Shqipëri, tregon sesa të interesuar ishin çamët e moshuar për vendlindjen e tyre. Me mall ato e pyesnin: “ A ishte ende atje ai pusi i madh në mes të fshatit? ”; “Po atë lutërvinë (punishte vaji) a e pe në Filat? ” ; “Kur ishte ti atje, lumi Kalama kishte pak ujë apo shumë?”... Nga këto pyetje kuptohet qartë se çfarë kanë trashëguar ato: lot dhimbjeje dhe krenarie, të cilën u munduan ta ruajnë si thesar.

Është mjaft interesante të vëzhgojmë sesi prezantohen për herë të parë çamët e brezit të vjetër, ndonjëherë edhe ato të brezit të mesëm. Ja një shembull i tillë:

A. -Ka cilli fshat të kemi ?

B. -Ka Vërsela. Zotrote, ka cilli fshat je?

A. -Ka vëndi më i bukur i Çamërisë, – Volë i thonë

Të dy folësit janë të brezit të vjetër,

A. -Sh. Dahriu 67 vjeç , B.- A. Abdurahmani 68 vjeç.

A. -Ku e keni martuar vajzën?

B. -Unë vajzën e kam dhënë në Vërselë , në fshat të Filatit

A. -Po vetë nga jeni?

B. -Ka Spàtari, edhe unë ka Filati jam.

Folësit janë: i pari, i brezit të ri

A- B. A 36 vjeç/ i dyti i brezit të mesëm, M. R 57 vjeç)

Siç e shohim, çamët edhe sot e kësaj dite prezantohen përmes emrave të vendeve nga kanë ardhur, i cili gjithmonë është më i bukur i Çamërisë. Të gjitha këto e kanë burimin tek dëshira e madhe e të gjithë çamëve të çfarëdolloj moshe ato qofshin, që ndër të tjera do të ishte dhe dëshira e gjithkujt: **të jetojnë atje ku kanë rrënjët e tyre, ku kanë lindur të parët, -në Çamëri.**

Krenaria për origjinën është trashëguar pëlqyeshëm edhe tek brezat më të rinj. Ato mundohen të ruajnë gjithçka të vyer, të trashëguar nga më të vjetërit, madje ato janë bartës të asaj dhimbjeje të madhe që kanë përjetuar nga dita në ditë së bashku me prindërit dhe gjyshërit. Ato janë bartës të atij mllefë të krijuar nga pamundësia për t’ia realizuar atyre të vetmen ëndërr që kanë : **“të shohin Çamërinë dhe pastaj të vdesin”.**

Më të rinjtë në moshë, nuk kanë sesi ta mbushin atë boshllëk të krijuar nga dhimbja, përveçse përmes ndonjë emisioni të bukur për çamët, ndonjë kënge të bukur për Çamërinë, të ndonjë improvizimi në ambjente të gëzueshme, apo nëpërmjet

<sup>405</sup> B. Abdurahmani, Elbasan

ndonjë libri për historinë e çamëve dhe gjuhën e tyre të bukur dhe së fundmi, përmes ruajtjes dhe kultivimit të gjithçkaje që fund e krye është çame: traditave, zakoneve, mënyrës së jetesës, **mbi të gjitha gjuhës.**

Mjaft prekëse tingëllojnë këngët, “ *Mall për Çamërinë*”, “*Çamëri, nuse me halle*”, *Djemtë e Camërisë* etj. që kanë mundur të prekin çdo zemër çame. Mjaft mallëngjyeshme ishte improvizimi i tre adoleshenteve të origjinës në fjalë në një dasëm të zakonshme <sup>406</sup>, të cilat të veshura me kostumet e tyre popullore, vallëzuan nën tingujt melodioz të kësaj kënge, vallen e bukur çame. Nga sa kemi konstatuar, krenaria për origjinën çame kapërcen kufijtë e çdo faktori tjetër: moshë, arsim, status, etj. Në përrurimin e njëres prej këngëve të lartpërmendura mësuam se djalin e vogël në videoklip kur e pyesin në jetën e përditshme: *Si të quajnë?* -Ai përgjigjej, -*më quajnë Eno Çami.*

### **5.3. A ndikon e folmja e çamëve në të folmen e banorëve (vendas) anas?**

Çamët dhe gjuha e tyre karakterizohen nga veti të tilla të cilat ia vlen që të imitohen nga të tjerët. Për asnjë çast të mos harrojmë që ato vijnë nga Çamëria, vënd i cili kohët e fundit të parashpërnguljes gëzonte të mira materiale dhe ekonomike të pëlqyeshme. Në këtë mënyrë ato kishin një zhvillim kulturor të të jetuarit. Pas shpërnguljes ato janë karakterizuar gjithmonë nga aftësia për ta trashëguar dhe përmirësuar edhe më shumë këtë faktor, duke lartësuar gjithmonë imazhin për veten.

Sigurisht gjatë një periudhe më se pesëdhjetë vjeçare, edhe e folmja e mjedisit pritës nuk mund të mos pësonte ndonjë ndikim nga çamërishtja. Çamët në përgjithësi kanë parapëlqyer të jenë të vendosur në grupe. Grupimi i tyre ka treguar gjithmonë se, përveç përpjekjes për t’u integruar, ato kanë lënë edhe shenja në kah të kundërt. Natyrisht, këto ndikime janë shfaqur më shumë në zonat përreth tyre. Çamët kanë depërtuar në disa aspekte të veçanta të mënyrës së jetesës tek vendasit. Një grua e brezit të vjetër, e cila jeton në një lagje çame shprehimisht thotë: “*çamët flasin bukur, gatuajnë mirë, njohin mirë normat e respektit, bëjnë shumë për njëri tjetrin dhe janë të dashur. Ato nuk janë si ne*”<sup>407</sup>, - vazhdon ajo. Dhe me të vërtetë, çamët nuk janë si vendasit, pasi e folmja e tyre nuk i përket dialektit të gegërishtes, por dialektit të toskërishtes; pasi u shpërngulën në Shqipërinë shtetërore ato kishin qenë ekonomikisht më të pasur dhe kjo gjë i kishte ndihmuar të ishin më të emancipuar në mënyrën e të menduarit dhe të jetuarit; fundi i mendimit (*ato nuk janë si ne*), do të thotë që kjo folëse i vlerëson kaq shumë, sa që i duken më të mirë sesa bashkëvendasit e vet, madje më të mirë sesa vetë vetja.<sup>408</sup>

Duke iu rikthyer çështjes, mendojmë se çamët jo vetëm kanë marrë, por kishin edhe shumë gjëra të bukura për t’ua lënë të tjerëve. Këtë gjë e vërtetojnë më së miri shumë fjalë leksikore nga fusha e gatimit, të cilat janë huazuar edhe nga vendasit përreth, duke qenë se çamët shquhen për një traditë të pasur në këtë fushë. Fjalë të tilla si: *birian* ( mish i gatuar në tepsi me oriz), *musaka*, *kallamar* ( kallmar,- lloj ëmbëlsire ), *çomlek* ( mish me qepujka); disa emra erëzash dhe barishtesh të ndryshme, si: *maraj* (kopër), *nenë* (nenexhik), *llapsana* ( rrap) etj, kanë gjetur përdorim të përditshëm tek një pjesë e mirë e familjeve në zonat përreth çamëve.

<sup>406</sup> Ceremonia martesore e B. Arifit me origjinë çame.

<sup>407</sup> Sh. Troplini, Arapaj Durrës.

<sup>408</sup> Sh. Troplini , 63 vjeç

Huazimet nuk përfshijnë vetëm fjalë nga fusha e gatimit. Folklori i bukur çam filloi të pëlqehet nga vendasit përreth, siç janë vallet dhe këngët e bukura çame etj.

## KREU VI

### 6. KUNDRIME DHE PËRQASJE FONETIKE

#### 6.1. Dukuri të ndryshme sociolinguistike që lidhen me skemat e theksimit.

##### Zanoret e theksuara dhe të patheksuara.

Në të folmen e çamëve, na tërheqin vëmendjen disa elemente ligjërimore të cilat spikasin për veçantinë e tyre dhe që janë shenjues të rëndësishëm në të folmen e çdo brezi, duke shërbyer edhe si tregues të origjinës. Ato janë pjesë e fizionomisë së kësaj të folmeje.

Sikurse e thamë, ndonëse elemente arkaike, disa prej tyre përveçse në brezin e vjetër çam, përçohen edhe në brezat aktivë, madje edhe tek e folmja e më të rinjve të cilët ruajnë ende një “ngjyresë” a timbër të çamërishtes. Siç thoshte dikur Laroshfuko

(La Roschefoucault): “*Theksi i vendit ku ke lindur jeton në shprehje dhe në zemër, ashtu si edhe në të folur*”.

Shqiptimi konsiderohet si një dukuri mjaft e rëndësishme për sociolinguistikën, pasi është mjaft i ndryshëm ndaj dallimeve krahinore, shoqërore, duke na lënë hapësirë të hetojmë rreth të folmeve të ndryshme. Kështu, një nga veçoritë fonetike që na ka tërhequr vëmendjen në sistemin e saj zanor, është mënyra e veçantë e theksimit të disa fjalëve.

Fizionomia e dialektit çam përbën edhe bazën e punimit tonë tek e cila jemi mbështetur gjatë gjithë kohës dhe që e kemi filtruar përmes anketimeve dhe hetimeve tona gjatë gjithë këtyre viteve. Kësaj të folmeje i kemi bërë edhe një studim të hollësishëm dialektologjik (1998- 2000), për të parë gjendjen aktuale të saj përmes hulumtimeve në brezin e vjetër çam.

E nisim fillimisht me dukurinë e theksit.

### 6.1.1. Theksi sintaktik

Një dukuri e veçantë që ruhet mirë tek kjo e folme sot, madje më karakteristikja në skemat e saj të theksimit është theksi **sintaktik**.

Për herë të parë, dukuria në fjalë është trajtuar nga prof Q. Haxhihasani në studimin dialektologjik të tij për këtë të folme.<sup>409</sup> Shprehimisht ai thotë: “Rrokja e fundit në fjalitë pyetëse merr në këtë të folme një farë gjatësie, ngjyre dhe ngritje të veçantë zëri... Në raste të tjera, fjala merr dy theksime të njëpasnjëshme, duke arritur pikën më të lartë të ngritjes së zërit në rrokjen fundore. Një ngjyrë, gjatësi dhe ngritje të tillë të zërit merr rrokja fundore edhe tek plotësi thirrur, në çdo pozicion që të jetë ky”<sup>410</sup> Ajo çfarë prof. Q. Haxhihasani konstaton na duket plotësisht e drejtë. Fatmirësisht këtë gjë e vërteton më së miri edhe e folmja e brezit të vjetër sot.

Ndër të tjera, mendojmë se kjo është një dukuri me rëndësi të veçantë për këtë të folme, pasi përmbledh në vetvete një tërësi elementesh. Jo vetëm kaq, por ne shtojmë në përshkrimin e saj edhe disa të dhëna që ndofta ndihmojnë në një të kuptuar më të mirë. Përshembull, megjithëse është rrokja e fundit ajo e cila përcjell ngjyresën e veçantë të theksit sintaktik, mendojmë se kemi të bëjmë me një kombinim veçorish në tërësi: të theksit të fjalisë, të intonacionit të saj, timbrit të veçantë të zërit së bashku me ngritjen e këtij të fundit ( që luan edhe rol vendimtar), si dhe, zgjatja e zanoreve, veçanërisht në rrokjen fundore të fjalës.

Nga të dhënat tona shohim që ky është një theks karakteristik jo vetëm për fjalitë pyetëse, por edhe për lloje të tjera fjalish, jo vetëm tek thirrori por edhe në gjymtyrë të tjera. Nëse kemi të bëjmë me fjali pyetëse, ato në të shumtën e rasteve mbartin edhe nuanca plotësuese përkatësisht: *habi*, *dëshirë*, *urdhër* etj. Më e rëndësishmja është, se të tëra këto dukuri nuk mund të shihen veçmas, por në kompleks me njëra tjetrën. Mjerisht, në një hulumtim të tillë, pa mjete të fonetikës akustike, çdo përshkrim mbetet gjithsesi i zbehtë. Një përshkrim sa më të qartë dhe bindës të kësaj dukurie, mendojmë ta japim në të ardhmen në një punim studimor më vete.

*nan mò:j / sado/ nan ì:sht // Po çì jetë isht kìjo nus' e Petritit // Çish do flas t ànjà?kur kem ardhur kètëj // kur kem ikur àtëj // n'çi vì:t?/çi thòtë:? Po ti qe njëzet*

<sup>409</sup> Kjo është një dukuri e cila na ka tërhequr vëmendjen qysh në fëmijërinë e hershme, e gjendur në një lagje çamësh, pasi e gjeje atë të pranishme vetëm tek çamët; tek të gjithë pa përjashtim, përfshirë fëmijët.

<sup>410</sup> Haxhihasani, Q. *Vështrim i përgjithshëm mbi të folmen e banorëve të çamërisë*, në « Dialektologjia shqiptare », vëll.I,Tiranë,1971, vëll.II,Tiranë 1973 .

e ca vjeç mo **bàbë**? Po merre e ti **njv**? S'erdh **nònji** a erdh **nònjt**? E ka marrë nusen ki i vogli i **Bashkìmit** // ç'ish do flas **tànt**? n'çi **vì:t**? Ç'i **thòtë**? Se ish behar **ò:j**? Ç'u **èrrë**? Ç'u **dìvë**? Thuaj dhe ktë ti plak? Pësaj në çish sene/ muaj i solli **bùrrüt**? Tashi/ n'**Çàmërt**?.../ jo, **mò:j** // ç'i i **strehòjë:m** ?; ka gjenda **ekonomikë**? Lekët na mbenë atje neve **mo:j** // Do të Greqisë **tì**: // ç'i i ka thertur **çàmtë**? Ç'ii ke **djè:lt** ? .....etj.<sup>411</sup>

Ajo çka merr më tepër rëndësi për një punim si ky i yni, është përcjellja e kësaj dukurie deri në ditët tona. Ajo shfaqet e ngulitur tek brezi i vjetër sot. Tek brezat pasardhës kryesisht tek folës të brezit të mesëm edhe pse dukuria ruhet, e gjejmë atë disi më të rrudhur. Gjatë ligjërimit të përditshëm kemi vënë re që fjalitë që përmbajnë theksin sintaktik, dukuritë fonetike, morfologjike dhe leksikore të këtij dialekti, në përgjithësi i karakterizon bjerrja si dukuri.

Megjithatë si dukuri ajo përcillet edhe tek brezi i mesëm dhe me ndonjë lëkundje të vogël e gjejmë atë edhe tek më të rinjtë. Shfaqet dukshëm tek fëmijët e vegjël deri në moshën parashkollore.

Po japim disa shembuj nga brezi i mesëm meqenëse ky brez përbën edhe pikën kyçe për sa i takon ruajtjes dhe risimit pasi, ai është bartës i konservacionit dhe inovacionit në të njëjtën kohë. Ky brez ka trashëguar ruajtjen nga brezi i vjetër dhe ka përçarur bjerrjen dhe përtëritjen e të folmes në brezin e ri. Mendojmë se është brezi në të cilin aspekti konjitiv i gjuhës është mjaft i zhvilluar.

Në të folmen e këtij brezi dukuria në fjalë shfaqet vetëm në fjalitë pyetëse si dhe tek ato fraza të shkurtra që mbartin një thirrur brenda. Megjithatë, pavarësisht nga kjo, ajo ruhet pastër dhe mirë nga folësit. Psh: ....në këto dy qytete u bë më shumë **rrumùjë**? Tre vjet martes ke bërë ti **hà:llë**? Po çfarë i thua mor **bù:rrë**? Hë mir **ishnë** ?

Dukuria e theksit sintaktik shfaqet ende sot edhe në ligjërimin e brezave të rinj, sigurisht shumë më e redaktuar, por ajo gjendet. Në këtë brez ajo shpesh ka shërbyer edhe si mjet identifikimi i folësve edhe atëherë kur nuk kemi pasur asnjë të dhënë për origjinën e tyre.<sup>412</sup>

Përveç kësaj, duke u nisur edhe nga hulumtimet e bëra, themi se pavarësisht se folësit e këtij brezi përmirësojnë frazat e tyre me fjalë të standardit, apo ndërpusin në fjalorin e tyre fjalë të dialektit të bashkësisë “pritëse” (në të cilën ndër të tjera, kanë lindur), gjatë ligjërimit të folësve, ndeshim praninë e këtij theksi, i cili ndër të tjera shërben edhe si sinjal i origjinës prej nga vijnë. Psh: *do vish me tì*? Ça do **mò:j** ?

Sikuse e përmendëm pak më lart, mjaft e këndshme është të vëresh shqiptimin e theksit sintaktik mirë dhe pastër tek parashkollorët çamë, sidomos tek ata që rriten me gjyshërit e tyre dhe patjetër që janë imituesit më të mirë të së folmes çame.

### 6.1.2. Theksi i fjalës

a. Sot në të folmen çame është vënë re që ruhen ende fjalë tek të cilat theksi bie në rrokjen e parë. Kryesisht këtu spikasin përemrat dëftorë dhe disa ndajfolje me theks parafundor që gati në mbarë toskërishten dalin me theks fundor (okston) si: **àjo**, **àj(i)**, **àtej**, **tàni**, **tànja**, **kùtu**, **kùjo**, **àt** etj. *nuku e kish vajz në pashaportë àjo*; *kùtu/ e kemi kùtu djalin*; *i çoi àtej ka kufiri turk/ mori àta pleq/ në muajin Maj u lëruan kùto.. tòn-ja si në kët kehe e mba mënd; edhe veshjen/àt veshje që bëjmë àte /àt veshje kemi edhe kùtu*; *do iki kùjo tani*; *po kùtu tani u përziën*; *që e mori gregu àt pjesë/ kùjo jota/ kùjo ima* etj.

<sup>411</sup> Dy pikëshi në këtë rast shërben si shenjues i gjatësisë së zanores.

<sup>412</sup> Gjatë ushtrimit të profesionit si mësuese, por edhe si kërkuese në të njëjtën kohë, identifikimin e origjinës çame të nxënësve e bëja përmes dukurisë në fjalë dhe mbiemrit të tyre.



Duke bërë krahasimin e çamërishtes së sotme të vjetër me çamërishten tradicionale, (dialektin) vërejmë që kjo dukuri ishte shumë më tepër e pranishme. Pra, një numër i konsiderueshëm fjalësh tek të cilat ishte i pranishëm theksi nistor, ose kanë marrë theksim si në mbarë shqipen, ose kanë pësuar “rrafshim” me të folmet përkatëse ku ato bashkëjetojnë. Këto fjalë janë bjerrë plotësisht si të vjetëruara dhe nuk kanë mbërritur deri në ditët e sotme. Kështu përshembull, ndajfolja *sivjet* e cila dikur shqiptohej me theks në rrokjen e parë, *sivjet*, sot ajo shqiptohet si në mbarë shqipen.

b. Kanë pasur **theks parafundor** dikur:

- disa fjalë që ndiheshin si oksitone: *fàrmëk, ròdhez, màngan, kùel, kèleme, dhòkan*.

-disa emra që mbarojnë me **-all**: *çàkall- çàqale, bòkall- bòkale, dhàskall- dhàskale, gràvall- gràvale etj.*

- disa emra topikë si: *Prèveza, Jànjari, Vràstava, Spàtari, Shqëfari etj.*

- patronimet që mbarojnë me **-anj**: *Kùrtanj, Hùsanj, Vèlanj, Rùsanj, Mànanj*  
Nga të gjithë këta shembuj vetëm fjalët *kùel, Spàtari, Shqëfari* shqiptohen si në çamërishten e moçme. Dukuria në fjalë shfaqet e pastër vetëm tek përemrat dhe ndajfoljet, megjithëse nga të dhënat e hulumtuara në terren kemi vënë re shenja bjerrjeje edhe brenda këtyre kategorive.

Për sa u takon më të rinjve në moshë mund të themi se, që me brezin e mesëm dukuria e theksit nistor shfaqet me një bjerrje të dukshme. Në pjesën më të madhe të shembujve, theksi përdoret sipas shqipes së përgjithshme. Nëse do të vërenim ndonjë përdorim të parregullt, ai motivohet gjithmonë nga disa rrethana dhe situata të caktuara. Përshembull, në më të shumtën e rasteve, format e parregullta të dialektit çam do të vihen re vetëm atëherë kur ato komunikojnë me më të vjetërit e tyre: *Çish thotë kijo mò:j?*

**Në brezin e mesëm të çamëve, një pjesë e madhe e shkeljeve në normë i përkasin të folmeve pritëse, gjë që tregon se, faza e integritit me bashkësitë pritëse është shumë herë më e madhe tek ky brez sesa në brezin paraardhës.** Kjo shpjegohet me kontaktet e vazhdueshme të këtij brezi, në shkolla, qendra të ndryshme veprimtarish, gjatë punës në grup etj. Kjo interferencë në të folmen e këtij brezi shfaqet dukshëm edhe për dukuri të tjera të së folmes çame, sigurisht në ato dukuri tek të cilat ndryshimi mund të depërtojë më lehtë.

**Tek brezi i ri vërejmë që dukuria në fjalë është bjerrë plotësisht, edhe atëherë kur e folmja e tyre kushtëzohet nga rrethana apo kontekste të caktuara.** Tek pasardhësit vërejmë prirjen për t'i rregulluar këto forma sipas rregullave të standardit të sotëm, por herë- herë duke u ndikuar edhe nga e folmja e dialektit të tjetrit. Kjo gjë ndodh, kur ata kërkojnë të bëhen imitues të bashkëmoshatarëve të tyre.

c. Në brezin e vjetër vërejmë ende qëndrueshmërinë e theksit të palëvizshëm tek disa emra që zgjerohen me prapashtesën **-zë** si: *kùmbëza, çàlëza, zgjèbëza, còpëza, vàshëza*; tek ndajfoljet, *sìprazi, pòshtazi etj.* P.sh: *jeshëm e vàshëza të tëra; dhe bum ktë còpëzë shtëpi q'isht kaq e bukura; sìprazi isht si fushë / kështu duhej t'ish gregu sìprazi/ çamt t'ish poshtë.*

Tek brezat më të rinj nuk i gjejmë këto përdorime.

d. Tek fjalët e formuara me prapashtesa, vërejmë që tek e folmja çame dikur theksi qëndronte i palëvizshëm, konkretisht tek fjalët e formuara me prapashtesën, **-osh**, si: *bàrkosh, çàlosh, krìmosh*; në disa emra fisesh që mbarojnë me **-ej, -enj** si: *Bàcenjtë, Bènejtë, Hòxhenjtë, Màlenjtë, Dùrenjtë, Vèrsenjtë etj.*; në disa emra fisesh që mbarojnë me **-at**. Për sa i përket këtyre përdorimeve, sot është vënë re që theksi

tërhiqet në prapashtesë<sup>413</sup>: *Zejnàtë, Zenjelàtë, Haskàtë etj.* Më shumë e pranishme kjo dukuri është tek emrat që mbarojnë me *enj, ej, at*. Pra shohim se, qëndrueshmëria e theksit megjithëse i ka rezistuar kohës si dukuri dhe është ende e pranishme, gjejmë edhe raste ndryshimesh të mundshme në të, gjë që flet qartë për një evoluim të së folmes çame.

e. Si një e folme e vjetër me karakter ruajtës, çamërishtja karakterizohet nga disa **huazime**, të cilat kanë depërtuar në të prej kontakteve të saj të kahershme me gjuhë të tjera, konkretisht nga turqishtja dhe greqishtja. Kontakti me turqishten ka filluar qysh herët si në mbarë shqipen e përgjithshme. Pas vitit 1821 pas shpalljes së pavarësisë së Greqisë, krahina e çamërisë në vitet në vazhdim mbeti nën drejtimin e Turqisë. Kjo ishte edhe arsyeja pse çamët u quajtën *allvanos* dhe jo *arvanitas*.<sup>414</sup>Për këtë arsye si dhe për shkak të afërsisë gjeografike me etnikumin grek dhe gjendjes së saj nën protektoratin e këtij shteti, ruajtjet e huazimeve turke në të folmen çame janë shumë herë më të mëdha sesa ato të shqipes së sotme. Pra, një ndër faktorët e jashtëm gjuhësor që ka ndikuar në ruajtjen e këtyre huazimeve ka qenë mbyllja në vetvete. Nuk mund të përjashtojmë një tjetër faktor të rëndësishëm që ka ndikuar drejtpërsëdrejti në ruajtjen e huazimeve turke siç ka qenë ai i kultivimit të besimit islam.

Pra, periudhat kohore në të cilat këto depërtime kanë qenë më të mëdha apo më të vogla në këtë të folme janë të ndryshme, si dhe arsyet e këtyre depërtimeve. Më pas brezi i vjetër çam i është nënshtruar edhe një lloj kontakti tjetër, konkretisht atij me shqipen e evoluar dhe për më tepër në vazhdim me të folme të ndryshme të dy dialekteve, ku prania e huazimeve turke ishte e madhe.

Shumë fjalë turke apo greke janë bërë pjesë tashmë e fondit leksikor çam. Në repertorin e tyre spikasin këto fjalë të shqiptuara **me theks fundor** si: *evli, vëllahi, sitaxhë, teshqerë, kàvë, qòshë, qìblë, gjulë, xhëzvë, bākshë, hīsë, sēftë, çiftë, parà, sufrà, lllapà, mashà, kazmà, misìr, bakwrr, eksorì, jabanxhì, kòshì ( komshì)* etj.: *Fton burri me këso/ me tesxerë; galorë të tërë me kual me sitaxhë të shtruara; hem jabanjxhì / hem me bagti; ka shtatmjet vjeç e deri në gjazhdhjet vjeç i mori eksorì burrat; zulluhi e madhe/ ë ish evli*. Kjo dukuri vihet re edhe tek disa antroponime që theksohen në fund, të cilat ndër të tjera janë edhe dëshmi e besimit fetar që çamët praktikonin dhe praktikojnë ende edhe sot e kësaj dite. P.sh *Nailë, Esmà, Hasimë, Habib, Shabanë, Bahjë, Hidajët, Sadàt, Ahmèt, Ramadàn* etj. Me të njëjtin theks shqiptohen edhe disa fjalë nga fusha e gatimit: *fāhì, musakà, bakllahì, hāllvā, pāçà, revanì, qāhì etj.* Në të dëgjuar kemi vënë re se, tek disa prej këtyre fjalëve gjendet edhe zanorja e gjatë e cila diferencohet mjaft mirë në të folmen çame nga zanorja që mbart theksin e fjalës.

**Brezi i mesëm** është trashëgues i mirë i emërtimeve nga fusha e gatimit, por edhe bartës i antroponimeve të mësipërme. Kjo për dy arsye: e para, lidhet me traditën e bukur të gatimit çam, ndërsa e dyta lidhet me kulturën fetare të brezit të vjetër të vendosjes së emrave sipas besimit përkatës.

Në këtë brez vërejmë edhe një kategori tjetër dukurish që ruhen të pastra në brezin e vjetër dhe janë trashëguar pjesërisht edhe në brezat pasardhës. Gjithashtu nga studimet tona tashmë disavjeçare rreth dialektit çam, kemi vënë re edhe raste

<sup>413</sup> Këtu përjashtojmë fjalët e formuara me prapashtesën *osh* e cila gjen ende përdorim tek çamët e vjetër, kryesisht me kuptim përkeqësues, tallës etj.

<sup>414</sup> Llalla, A.: *Arvanitasit – Çamët në etnikumin shqiptar në Greqi (arvanitasit themeluesit dhe drejtuesit e greqisë moderne 1821-2005)*, kumtesë e mbajtur në Seminarin Ndërkombëtar të Albanologjisë, Tetovë-Ohër, 16-23 Shtator 2007.

përdorimesh të hershme që nuk gjejnë vend madje edhe tek më të moshuarit sot.

Gjithçka sa pohuam, nuk u referohet vetëm skemave të theksimit në të folmen çame, por pothuajse të gjitha dukurive, si atyre fonetike dhe atyre morfologjike e leksikore etj.

Pra, ndryshimi në këtë të folme është pjesë e një zinxhiri të gjatë, që ka lidhje me jetëgjatësinë e vetë të folmes në fjalë dhe çdo lëvizje brenda sistemit i referohet një arsyeje të caktuar. E ilustruam këtë me anë të një shembulli: ruajtja e theksit karakteristik sintaktik në çamërishten e sotme, mendojmë se lidhet me vetë mënyrën e ndërtimit të kësaj dukurie. Fakti që ajo paraqitet e qëndrueshme në të tre brezat, shpjegohet me vetë natyrën e elementeve të saj përbërës të cilët, ndër të tjera, mbartin edhe një ndër karakteristikat e të folmes së çamërishtes siç është emfaticiteti i saj që pasqyrohet përmes intonacionit, timbrit, ngjyresës në të folur, zgjatjes së zërit përmes zanoreve, theksit në rrokjen e fundit etj. Duke qenë se formimi i kësaj dukurie lidhet me kombinimin e të tërave është e qartë që edhe shpërbërja vjen nga prishja e po këtij kombinimi dhe, kjo e fundit është e vështirë të ndodhë për shkak të numrit të madh të këtyre elementeve si dhe mënyrës së ndërlikuar të lidhjes së tyre me njëri tjetrin (që do të thotë se, edhe nëse mënjanohet një element i vetëm kjo nuk mund të sjellë zhdukjen e mbarë dukurisë).

Ndërsa, po të analizojmë një dukuri tjetër mjaft interesante të këtij dialekti, siç është ajo e ruajtjes së theksit në rrokjen e parë të fjalëve (kryesisht tek përemrat dëftorë dhe ndajfoljet), që sot zakonisht theksohen në rrokjen e fundit, do të arrinim në të tjera përfundime. Kështu megjithëse tek brezi i vjetër kjo dukuri shfaqet e qëndrueshme, përsëri rastet e prekjes së saj nuk mungojnë gjatë të folmes së tyre. Shpeshherë vërejmë përdorime dygjuhëshe (bilinge), që siç do ta shohim nuk janë karakteristike vetëm për këtë dukuri. Le t'i konkretizojmë me disa shembuj këto përdorime:

*E more vesh **tani**, kur qepeshim ne(tek) ajo v:la? Ja thonë një fshati ninat **atjè**; ndenjëm njëzet dit **atjè/ kshu** tavani; do marri malli e **kùtu**... saa kur ishën **àtje/ këndojn** edhe zojt e turkut/ i ndijën **kùta** àtje; Po ooo.. me kristjanë s'kish gjë me kristjanë / ai e kish me ne; **kjo** isht vajza jote nus' e Petritit?Nga Kavaja erdhëm **ktu** përsaj; na lanë **àtje** ato/erdhëm me kuel rrugës/ ngarkuar me plaçkë ....*

Siç e shohim nga shembujt, edhe pse tek moshat më të vjetra vihet re një farë mbyllje e ndërjegjshme në vetvete që nuk favorizon ndryshim brenda të folmes, rastet e një përdorimi të dyfishtë të dukurive, pra të një dysorësie<sup>415</sup> në të folur (*atjè* dhe *àtje*; *kùtu* dhe *ktu* etj.), bjerria apo futja e elementeve të reja, vërtetojnë ndryshim në ligjërimin e tyre. Të gjitha këto vërtetohen përmes dukurisë së theksit në rrokjen e parë të fjalëve ( sidomos tek përemrat dhe ndajfoljet) . Vendosja e këtij theksi sipas shqipes së përgjithshme në disa raste apo sipas të folmeve të bashkësive pritëse në raste të tjera, tregon se prekja e kësaj dukurie është e dyanshme.

Përfundimisht, lidhur me dukuritë e mësipërme si edhe me dukuritë e tjera në vazhdim, një rëndësi të veçantë merr raporti i përdorimit të tyre në breza (nga njëri brez në tjetrin ose edhe brenda të njëjtit brez). Kështu, nëse një dukuri shfaqet e pastër në brezin e vjetër, për të kemi deklaruar ruajtje, pavarësisht se tek folës të veçantë kemi vënë re edhe përdorime dysore të saj, pa të cilat nuk kanë sesi të shpjegohen edhe bjerret e dukurisë në fjalë tek pjesa më e madhe e folësve në brezat pasardhës. Tek këto të fundit, nga ana tjetër, kemi vënë në dukje mënjanimin e dukurive të moçme, por nuk kemi lënë pa përmendur edhe ato pak raste të ruajtjeve të trashëguara nga brezi i vjetër, ndonëse të kushtëzuara nga elemente të tjera gjuhësore dhe

<sup>415</sup> Term i huazuar nga prof. Shkurtaj.

jashtëgjuhësore. Pra, ndonëse brezat në mënyrë konvencionale i kemi ndarë në tre, nuk mund të vendosim kurrësesi kufij të prerë në të folmet e tyre, për rrjedhojë, edhe për dukuritë e ndryshme që hasen në këto të folme.

### 6.1.3. Gjatësia e zanoreve

Studiuesi Ibrahim D. Hoxha në enciklopedinë e tij<sup>416</sup> përmend disa zanore “zëzgjatëse” siç i quan ai, për të folmen e çamërishtes, ndër të cilat spikasin: Â/ â; Ê/ ê; Î/ î; Ô/ ô; Û/ û; Ý/ ý:

Mendojmë se simbolet që shënojnë këto zanore duhen rishikuar nga fonetikanët, pasi nuk jemi shumë të bindur për njohuritë e tij në fushën gjuhësore. Por, mesazhi që ai përcjell është i qartë: çamërishtja është e pasur me dukuri të tilla që rrisin përherë e më shumë emfaticitetin e kësaj të folmeje, për të cilën mendojmë se është një dukuri e shqipes së vjetër.

Këtë të fundit, siç e kemi përmendur edhe në fillim të mikrotezës, e gjejmë edhe tek Buzuku, të spikatur nga studiuesi Selman Riza, që ndër të tjera mendon se kjo dukuri ka të bëjë me një shqiptim individual të Buzukut dhe për të cilin nuk ndajmë të njëjtin mendim, duke parë se edhe çamërishten e karakterizon e njëjta dukuri. Për të njëjtën dukuri flet edhe Klosi për të cilën mendon se ka të bëjë me shqiptimin e patër Vasilit<sup>417</sup>; e njëjta gjë thuhet edhe për fjalorin e Marko Boçarit ..etj

Lidhur me zanoret zëzgjatëse po japim disa shembuj nga trajtimi që ky studiues bën:

Â- zanore zëzgjatëse. Pashirmë. Përdoret për të theksuar një gjykim të caktuar : Â, ajo punë mori funt! Â, atë ( fjalë, punë, njeri) mos e zërë në golë! Â, atë mos e nga, se ke të biò me mua! Â, nuk e këshëm kështu fjalën! Â, mos m’u ngarkos më shumë! Â, këtë doje ti!? <sup>418</sup>

**Sigurisht zanoret zëzgjatëse që autori trajton nuk janë të njëjta me zanoret e gjata.**

Nga kundrimi dialektologjik që i kemi bërë disa dukurive fonetike të së folmes çame sot, vërejmë që në të ruhen ende zanoret e gjata. Ruajtja e zanoreve të gjata e kushtëzuar nga rrethana të ndryshme fonetike, dëshmon edhe një herë për atë faktor mjaft të rëndësishëm të historisë së gjuhës shqipe, afrinë midis dialekteve tona në kohë të hershme. Për këtë arsye ajo ka tërhequr vëmendjen e shumë studiuesve shqiptarë dhe të huaj, midis të cilëve ka pasur gjithmonë diskutime të shumta. Njëqind e pesëdhjetë e katër vjet më parë diskutimet nisin me Hahn- in (1854). Këto diskutime vazhdojnë më pas me Altamarin (1985); teori mbështetëse dhe thelluese kanë dhënë më pas Çabej (1957,1977), Çeliku (1972), Gjinari (1989) etj.

Sipas E. Çabejt përpara se të bëhej diferencimi midis dy dialekteve të mëdha të shqipes, gjuha shqipe ishte mjaft homogjene. Afria midis dialekteve të saj ishte e madhe. Pikërisht kësaj periudhe arkaike i përkasin edhe ruajtjet e zanoreve të gjata. Megjithatë përbashkësia midis këtyre të folmeve nuk vërtetohet vetëm nëpërmjet zanoreve të gjata, por përmes një numri të konsiderueshëm dukurish, që sipas rastit dhe vendit të duhur do t’i trajtojmë, duke nxjerrë në pah më në fund vlerën e të folmeve sot për gjuhën shqipe. Ato nuk janë gjë tjetër përveçëse trashëgimtare të fazave më të hershme të saj.

<sup>416</sup> Hoxha.D, Ibrahim: *Enciklopedi Jug- shqiptare I ( A-H)*, f. 7; Shoqata kulturore shqiptaro- turke, Tiranë, 2006.

<sup>417</sup> Mbledhësi i teksteve të Reinholdit

<sup>418</sup> Hoxha.D, Ibrahim, po aty f. 12

Në çamërishte, zanoret e gjata përkojnë në këtë të folme me zanoret e theksuara, sipas disa pozicioneve të caktuara në të cilat bie edhe theksi i fjalës. Kështu si zanore të gjata na shfaqen:

- a. Zanoret e theksuara në rrokje fundore të hapura në fjalët: **vëllà:, binà:, ngrè:, flè:, vù:, përzù:, zù:, bolori: xhexhè:, e vè:, e rè:, si:, uzengji:, sufrà:, kazmà:, kallamè:, eksori:, erremi,** p.sh.: *ka shtatëmbëdhjetë e rëpjete i mblodhi eksori:, di motra ishëm ne e një vëllà:, edhe Habibi pësjaj se dëroi,u ngrè:/ e bëri bolori:, pëno këtëj që na sill bukën ngji:/ që na rriti na dha një shtëpi:* etj. Gjatësia e zanoreve në këto shembuj, ruhet edhe kur ato marin trajtat e shumësit psh: **si:** *të(sytë) mbëluar deri këtu( tregon me gjeste),vajzat.*
- b. Zanoret e theksuara përpara bashkëtingëlloreve lëngëtoare **-r, -l, -ll:** tagdi: **r, buha:r, cihu:r, ka:lë, dja:lë, pa:lë, ma:lë, bi:lë, go:lë, undi:r, di:ll, he:ll, kërce:ll, mësa:llë, shka:llë, fëmi:lë, galo:rë, mi:lë, vra:rë, pre:rë, agonja:r,** etj. P.sh: *fëmi:lë e ndarë/ shtëpia ka shtëpia; joo...mi:r u kish se:llë/ me greg u kish se:llë mi:rë; kemi shkuar njëmi:lë halle rruguve;për vajzën bijëm pa:lë// sidomos në beha:r zakonisht bëneshin dasmat/ me ka:lë merrshim nusen; Do t'them prishjen nj'he:r si u prishëm ka çamëria?; sa ta:laçe ka pas kjo kokë.., keshëm u:lli edhe toka ,posi...; s'kishte tu:llë n'ato kohëra; atje vineshin ushtartë e vrarë etj.*
- c. Zanoret e theksuara në rrokje të mbyllura ose të hapura para bashkëtingëlloresh të tjera, sidomos para dhëmboreve dhe hundoreve: **tu:mene, dhë: nër, të hë:në, na:tanë, ra:më, dë: jëm, ngrë:në, kë:më, dhë:më, a:në, i di:të, i fto:të** etj. P.sh: *dë:njëm atje sa dë:njëm,/ me tu:mene jeshëm; vijën/prisjën rrobat e dhë:nërrit// të hë:në e të një:te (enjte) i marrëm neve nuset...; mbe:më që na:tanë Llogarait// ra:më në një fshat/ kish bën një tepsit të madhe ajo gruaja me di copa dja:thë ka( nga) kaq/ e kemi grë:në buk aqhere.; poo.. tani / do u kenë ga:tërruar e atje tani/ ka: të katrat a:në që të veje, luftë.*
- d. Zanoret e gjata të cilat përkojnë me zanoret e theksuara në trajtat foljore të aoristit sigmatik, në rrokje të mbyllura: **tha:çë, pa:ç, la:ç, u tha:ç, u pre:ç, ha:ç, , u ngro:ç;** në vetën e dytë të së ardhmes( do+ lidhore): **do t'ja:pç,do t'inçizo:ç, do t'la:ç, etj.** P.sh: *jo i tha:ç ù/ do t'ja:pç karar // do t'vesh me kët/ a do vi:ç me mua; do ha:ç bu:kë: // i tha babës ai çami...; morri si ta tha:çë...;do t'inçizo:ç ti:?: t'e tha:çë / ù më përpara n'Kavaj qëndrova*

Shfaqje të tjera të kësaj dukurie kemi edhe tek disa trajta të ndryshme foljore, sikurse:

- e. Në trajtat e shumësit të disa foljeve, të cilat tashmë dalin në rrokje fundore të hapura, psh. **pa: më, pa:të, pa:në; dha:më, dha:të, dha:në** etj;
- f. Në vetën e tretë shumës të së pakryerës së disa foljeve ku kanë ndodhur ç'rregullime të ndryshme: **rri:në, zi:jn, hi:jn, vi:n, ndë:jn, pri:sjën, shpi:j,** etj. P.sh: *që (me qëllim që) të na za: pojnë vënin...; ...edhe kalamajt në lum i hi:dhën moj të kegen...; vineshin katër- pesë kaurrë që rri:në në fshatin tonë...; këta na zi:jn (zinin) ne; .. s'vi:jn (s'vinin) milt (miqtë) të pri:sjën rrobat e dhënërrit; ..atje vi:neshin ushtart e vrarë // edhe i shpi:j gjith e kush në vënd të tij për t'i varrosur*
- g. E njëjta gjë ndodh edhe me vetën e tretë njëjës: **vëzhdri:n** (vështronte), **lëpi:n** (lëpinte)

- h. Në trajtat e vetës së dytë njëjës dhe të tretë shumës të lidhore, si dhe në rastet e shfaqjes së dukurisë së aoristit sigmatik, p.sh: *të këpto:ç, të the:t, të the:ç, të the:n, të de:ç, të de:t, të ke:sh, të je:sh* etj. *Të the:n qind vetë bëne/ ù se e bëj* (nuk e bëj).
- i. Zanoret e gjata gjenden në këtë të folme në disa trajta të ndryshme foljore dhe emërore të përfuara nga dukuri të ndryshme fonetike, konkretisht rënie e asimilime tingujsh, p.sh: *mbe:në* (mbetën), *va:në* (vajtën), *va:te* (vajti), *mo:në* (motnë), *ko:sht* (kopësht), etj. P.sh: *Kur kemi ardhur neve kem gjetur ko:shinjët; mbe:në këto/ ne jemi tha për t'va:tur në det të mbitemi; ..çish arrëng* (çfarë ahengu) *do të valles ti// dua kët/ e mi:rr atë//, se e mba: mënd ù se kam ikur 10 vjeçe. Ne nuset i marrim me kafe e me ku:l* (kuel-kuaj); .. *ikëm va:më në Ninat.../ qem të zo:t'e vetes vetë neve; ..ja va:te një moshatarja ime // me kacolle/ me ko:sht ishin.; t'shkojm t'bi:m shkollë...; ..kesh kushri:n e parë atje* etj.

Në të tilla raste gjatësia e zanoreve kompenson mungesën e tingujve. Pra, bëhet fjalë për atë lloj gjatësie të quajtur gjatësi kompensatore (nga Çabej).

Të folmet toske që e ruajnë ende këtë dukuri janë shumë të rralla. Konkretisht ruajtjen e zanoreve të gjata e gjejmë ende në ato të folme që paraqesin afri me çamërishten, siç janë: disa zona të izoluar të toskërishtes; labërishtja, arvanitasit, arbëreshët etj. Kështu për arbëreshët e Greqisë prof. Qemal Haxhihasani në punimin e tij dialektologjik<sup>419</sup>, ka sjellë shembuj nga Reinholdi që më vonë u bë e mundshme t'i shtojmë e t'i pasurojmë më tej dhe me shembuj të tjerë nga "Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar" (1635-1912, Instituti i folklorit), si edhe në botimin e bërë nga A. Klosi.<sup>420</sup> E njëjta dukuri vihet re edhe tek arbëreshët e Italisë etj.<sup>421</sup> Nga ana tjetër mjafton të vëzhgojmë letërsinë e autorëve tanë arbëresh dhe shohim praninë e kësaj dukurie në këtë të folme.

Lidhur me **zanoret e gjata në të folmen çame** duhet thënë se gjatësia e këtyre zanoreve kur ato përkohet me theksin, ka raste që edhe ndryshon nga fjala në fjalë. Tek fjalët e mësipërme gjatësia pothuaj është e njëjtë: gjatësi e cila duke u favorizuar nga theksi bie në sy, por nuk është dhe aq larg përdorimit të shqipes së përgjithshme. Në këtë të folme ka edhe raste të shfaqjes së saj dukshëm, kryesisht zanoret e gjata përpara bashkëtingëllores lëngëtore -r , p.sh: *tagdiir, undiir, cihuur , buhaar* etj. E njëjta gjatësi gati gati vihet re edhe tek e pakryera e vetës së tretë të foljes tek e cila nuk kemi shfaqjen e mbaresës së sotme të kësaj vete, por që bashkimi i dy zanoreve të njëjta ka marrë trajtën e një diftongu: p.sh: *do vii*<sup>422</sup>(do vente), *i shpiu* bukën, *i lii* (diçka).

Të gjitha këto dukuri fonetike nuk janë asgjë tjetër veçse dëshmi të ruajtjes së zanoreve të gjata në brezin e vjetër.

Nga ana tjetër, zanoret e gjata ruhen vetëm tek ky brez, në brezin e mesëm dhe të ri prirjet e rrafshimeve normëzuese të formave dialektore janë të mëdha. Sikurse do ta shohim edhe në trajtimet e mëposhtme, pjesa më e madhe e dukurive bosht të fizionomisë çame nuk janë trashëguar tek pasardhësit. Në më të shumtën e rasteve, ato janë orientuar kah formave të rregullta të standardit, gjë që është realizuar duke mënjanuar plotësisht fjalë dhe forma të vjetëruara, ose duke i rregulluar ato sipas

<sup>419</sup> Haxhihasani , Q. *Vështrim i përgjithshëm mbi të folmen e banorëve të Çamërisë*, në « Dialektologjia shqiptare », vëll.I,Tiranë,1971, vëll.II,Tiranë 1973

<sup>420</sup> Klosi, A: *Netët Pellazgjike të Karl Reinholdit* ( Tekste të vjetra shqipe të Greqisë mbledhur nga Karl Reinholdi 1850-1860, (K&B), Tiranë, 2005.

<sup>421</sup> Shkurtaç, Gj. "Ligjërimet arbëreshe" ( shqyrtime dialektologjike dhe sociolinguistike në ngulimet arbëreshe të Italisë), f. 151, Tiranë, 2006.

<sup>422</sup> Shembulli i përket të ardhmes të së shkuarës.

shqipes së sotme letrare. Megjithatë sikurse shpesh e kemi përmendur që në fillim të temës këto janë pohime që bëhen edhe në përshtatje me jetën e secilës prej të folmeve.

Në rastin e çamërishtes, përveç kësaj, shtojmë edhe përshtatjen me të folmet e bashkësive pritëse. Përshembull, në të folmen e çamërishtes në kontakt me bashkësinë pritëse të Shqipërisë së Mesme është vënë re një tjetër dukuri: tek brezi i mesëm dhe i ri zanorja e gjatë nuk është bjerrë plotësisht, por ajo në vënd që të trashëgohet nga paraardhësit e tyre, huazohet nga e folmja vendase me të cilët ato kanë qenë në kontakt të vazhdueshëm. Gjatësinë e zanores në këto zona, si dhe gjatësinë në shqipen e moçme, Çabej e ka quajtur “gjatësi kompensatore”<sup>423</sup>, e cila shkaktohet nga rënia e -ë-së fundore të fjalëve. Madje, sipas tij, gjatësia kompensatore e dialektit gegë nuk përbën risi, por ruajtje të asaj faze të vjetër të shqipes kur të gjitha të folmet e saj ishin mjaft të afërta midis tyre<sup>424</sup>.

Këtu shtrohen pyetjet: Pse folësit e brezave më të rinj kanë prirje të largohen nga format e “çrregullta” të dialektit të tyre duke i bjerrë ato plotësisht dhe hidhen kah formave të rregullta të shqipes së përbashkët? Dhe, si shpjegohet që ato e kanë ndonjëherë më të lehtë huazimin nga e folmja e bashkësive pritëse edhe nëse ato janë forma të konsideruara jashtë norme?

Një shembull tipik triumfi i konformizmit është fusha e morfologjisë së parregullt.<sup>425</sup> Forma të parregullta bëhen pjesë e sistemit, forma të rregullta dalin nga sistemi. Shpesh kemi thënë për fëmijët e vegjël se ato nuk janë bartës të kësaj dukurie, shpesh dëgjojmë tek to format, pava (pashë), bëva (bëra) etj.

Megjithëse të rriturit janë më të qëndrueshëm në aspektin gjuhësor..., tek të cilët ekziston qëllimi për të mësuar mirë një standard...<sup>426</sup> tek ato është mjaft i dukshëm fakti i asimilimit edhe të shkëlqeve në normë për të qenë pjesë e grupit.

Orientimi i folësve të një bashkësie të tillë, kryesisht ruajtëse si ajo çame, drejt formave të standardit, shpjegohet edhe me veprimin e faktorëve të tillë të rëndësishëm, si: prestigji social i standardit, si variant i gjuhës zyrtare kombëtare i mbarë bashkësisë shoqërore shqiptare, i cili nga dita në ditë, po ligjërohet e ngrihet mbi variantet e tjera të folura, si shprehës i trysnisë dhe i forcës unifikuese shtetërore, por edhe si simbol i bashkësisë shpirtërore e kulturore të të gjithë shqiptarëve;<sup>427</sup> prania e disa organizmave të rëndësishëm me të cilët folësit e të gjitha dialekteve a të folmeve krahinore janë në kontakt të vazhdueshëm si, mediat, veprimtaritë e institucioneve të ndryshme arsimore, kulturore, etj. Veçojmë gjithashtu mjetet e teknikës së komunikimit të shpejtë si, telefoni celular dhe fiks, faksi, interneti etj.; origjina e folësve. Siç dihet çamërishtja është pjesë e nëndialektit të toskërishtes jugore, pra në thelbin e vet ajo është jo larg variantit standard që zbatohet sot në Shqipëri.

Lidhur me këtë të fundit themi se duke u nisur nga vetë zhvillimi historik i kësaj të folmeje, për rrjedhojë dhe nga prurjet e mëdha sociolinguistike që na ofron ajo, askush nuk na pengon që çamërishten ta quajmë gjuhë diglote dhe, në krahasim me standardin mund të shpreheshim për dy varietete funksionalisht të ndryshëm, megjithëse i përkasin të njëjtit sistem gjuhësor. Prania e disa dukurive të bashkësisë pritëse në brezin e vjetër flet qartë për dëshirën e këtij brezi për t’u integruar, dëshirë

<sup>423</sup> Çabej, E. *Kuantiteti i zanoreve të theksuara të shqipes*, “Buletin i Universitetit shtetëror të Tiranës”, Seria shkencat shoqërore, 1957, nr.2, f.207-213

<sup>424</sup> Para Çabejt, ai i cili ka folur për praninë e zanoreve të gjata, por edhe të shkurtra, kryesisht për dialektin e toskërishtes, ka qenë edhe Dilo Sheperi (1927).

<sup>425</sup> Labov, Hudson, Berruto, Shkurtaj..

<sup>426</sup> Berruto, G. “Sociolinguistica”, Bologna 1994.

<sup>427</sup> Shkurtaj, Gj. *Sociolinguistika*, Tiranë 2003.

kjo që lind më tepër nga nevoja për komunikim ( ato mbeten pak a shumë në kuadrin e **refuzimit** të ligjeve shoqërore, gjuhësore, kulturore, të bashkësisë në të cilën janë vendosur).



Tek brezat më të rinj kemi të bëjmë me pranimin me dëshirë deri diku të normave shoqërore dhe të kulturës së bashkësive të vogla përkatëse.

Kështu, nga kontakti me bashkësitë e tjera, çamët e brezit të mesëm dhe të ri ndiejnë të domosdoshme përfshirjen (integrimin) brenda grupit shoqëror, për ta gjetur veten në këtë shprehje kolektive. Si mjet të parë për t'u solidarizuar me ta, ata shohin gjuhën, të folmen e kësaj bashkësie që ndër të tjera, gëzon prestigj më të madh në krahasim me bashkësitë e tjera shqiptare, pasi ajo përkon me gjuhën e qendrës. Kjo është pak a shumë edhe arsyeja pse folësit arrijnë të huazojnë disa elemente të veçanta, ndonëse edhe të parregullta të dialektit tjetër. Këto huazime, nga ana tjetër, nuk mund të bëhen gjithmonë me sukses, pasi gjurmët e origjinës prej nga vijnë janë të pashmangshme, sado të rinj në moshë qofshin ata.

I tillë është edhe rasti, i së ashtuquajturës gjatësi kompensatore, dukuri e cila gjendet në gegërishte, folësit e brezave më të rinj në përgjithësi kanë prirje ta huazojnë nga bashkësitë pritëse të këtyre zonave. Kjo gjë tregon se dialekti i çamërishtes ka ndryshuar mjaft tek brezat pasardhës. Madje ndryshimi në këtë drejtim i ka fillimet e veta që me brezin e vjetër dhe nga dita në ditë ka evoluar edhe më tepër. Ndryshimi në këtë të folme lidhet ngushtë me mbarë zhvillimin shoqëror të bashkësisë shqiptare. Sjellja gjuhësore e individëve është gjithmonë e kushtëzuar nga pikëpamja shoqërore. Pikërisht në çastin kur folësi fillon të kushtëzojë të folmen e tij, pra ta kufizojë atë fonetikisht, gramatikisht, si dhe nga pikëpamja leksikore, këtu fillon dhe dukuria e ndryshimit gjuhësor.

Nga ana tjetër, sikurse do të vërtetohet edhe për të tjera dukuri, kufijtë midis ruajtjeve dhe ndryshimeve, pra shndërrimeve të shumta, risive, brenda kësaj të folmeje nuk janë të prerë. Kështu, me të vërtetë më lart ne theksuam ruajtjen e zanoreve të gjata tek brezi i vjetër, por, po nga të dhënat tona, vërejmë që ruajtja (konservimi) e tyre nuk është dhe aq e pastër, pasi nuk ka sesi të shpjegohet më pas edhe ai ndryshim i prerë dhe i menjëhershëm tek brezat pasardhës.

Vetë ndryshimi i dukurive vjen gradualisht. P. sh. trajtat e së kryerës së thjeshtë me *sh* (aoristit sigmatik) e kanë filluar bjerren e tyre që në të folmen e brezit të vjetër (sigurisht tek moshat më të reja të këtij brezi dhe në vazhdim), për të arritur më pas në një bjerre përfundimtare në brezat pasardhës. Kështu, bashkë me humbjen e kësaj dukurie, humbet edhe gjatësia e zanoreve karakteristike për këto trajta.

Sipas Q. Haxhihasanit në të folmen e çamërishtes, një gjatësi të veçantë jepte edhe bashkimi i trajtës së shkurtër të përemrit vector (e) me urdhëroren, p.sh: *vëzhdro+e = vëzhdree*, ku zanorja e gjatë dëgjohet dyfish; *lëshee, vree* etj. Nga të dhënat tona vërtetohet se një gjatësi e tillë zanoresh e përftuar nga një bashkim i tillë në të folmen e çamëve është bjerrë. Zgjatja e zanoreve dhe për rrjedhojë dyfishimi i tyre ruhet vetëm tek disa fjalë të veçanta që kanë mbërritur sot, por si një dukuri e përftuar nga shkrirja e disa tingujve, apo zhdukja e tyre nën ndikimin e fenomeneve të ndryshme fonetike, përkatësisht rënie tingujsh etj. Konkretisht spikasin fjalë të tilla si: *jaam (jaram), kaa (kaha), kooshti (kopshti), qaafire, kaave, daavet* etj. Këto fjalë gjenden tek moshat më të vjetra të këtij brezi.

Gjithashtu edhe dukuria e përkimit të zanoreve të gjata me zanoret e theksuara ka përjashtimet e veta. P.sh, në fjalët me prejardhje turke mendojmë se në zgjatjen e zanoreve ka luajtur rol të rëndësishëm analogjia. Analogjia në të folmen çame në përgjithësi, është dukuri mjaft e rëndësishme që meriton të trajtohet, për vetë faktin se ajo kurdoherë ka qenë e pranishme. Kështu, ajo vihet re në fjalët me prejardhje turke si: *ja:rabi, ja:llah, fa:hi, va:llahi, ka:dife, du:shemè, za:lluhì, fe:rexhè, ka:vé, da:vèt, qa:fir,psh: Ja:llah!- tha nana / jeshën e vashëza të tëra...; ne u thoshim fa:hi.; rrobat ka:dife i keshëm...; ...i mbante si hamall/ za:lluhì e madhe / hem ja:banxhi/ hem me bagti etj.*

Zgjatjen e zanoreve në fjalët me prejardhje turke për analogji, tek çamët e Shqipërisë së mesme e shpjegojmë edhe nëpërmjet pranisë së disa fjalëve të tjera po me prejardhje turke, por që nuk janë pjesë e atyre huazimeve të lashta që kanë depërtuar dikur në çamërishten e hershme. Ato janë pjesë e huazimeve të mëvonshme, nga kontakti midis dy të folmeve: çamërishtes dhe gegërishtes së Shqipërisë së Mesme.

Shpeshherë folësit çamë të brezit të vjetër japin shenja të njohjes së fjalëve të dialektit vendas duke bërë edhe zëvendësime në kompetencën e tyre të të folurit, ndër të cilat spikasin disa fjalë me prejardhje turke, që në dialektin gegë konsiderohen si huazime të hershme p.sh: fjalët: *budrum, penxhere, dimiq* etj. Këto fjalë do t'i gjejmë më tepër tek moshat më të reja të këtij brezi. Tek më të vjetërit në vend të këtyre fjalëve do të gjejmë gjegjëset e tyre: *katua, parathire, tumene* etj.

Ajo ç'ka tërheq më tepër vëmendjen është fakti se këto fjalë i janë përshtatur rregullave fonetike të së folmes çame. Pra, për analogji të pranisë së zanoreve të gjata në gjuhën çame edhe këto fjalë shfaqin zanoret e gjata në brendësi të tyre, p.sh: *bu:drun, di:miq, pe:nxhere* etj. Kujtojmë këtu se fjalët e mësipërme të huazuara dikur nga turqishtja tek e folmja e gegërishtes së Shqipërisë së Mesme i janë nënshtruar edhe këto, rregullave fonetike të kësaj të folmeje siç është rasti i rregullimit mekanik të theksit: *pènxhere, tènxhere, kàfe* etj.

#### 6.1.4. Zanoret e theksuara

Zanoret e theksuara në të folmen e çamërishtes paraqesin disa dukuri me interes, të cilat bëhen dhe dëshmuese të proceseve të cilat shpesh i kemi përmendur tashmë si, ruajtjeve, risive dhe shndërrimeve, nën trysninë e shqipes standarde a të mjediseve në të cilat ato janë vendosur.

- a. Një tipar dallues i dy dialekteve tona, toskërishtes dhe gegërishtes është kalimi i **-à-së** hundore gege në **-ë** të theksuar të toskërishtes. Edhe në çamërishte vërejmë një përdorim të njëjtë me toskërishten, për rrjedhojë me standardin. Pra, për sa i përket kësaj dukurie dhe zanoreve të theksuara në tërësi, çamët kanë përparësinë të jenë më pranë formave të standardit. Madje vihet re një tjetër fenomen: pavarësisht se folësve çamë ndonjëherë u lind e nevojshme (për të qenë konformistë me grupin) të imitojnë edhe forma të parregullta të dialektit të tjetrit, në më të shumtën e rasteve kemi vënë re se atyre nuk u intereson të shkëputen nga format e rregullta të së folmes çame, (nëse ato përkrijnë me normën), dhe të përdorin një tjetër formë të parregullt të dialektit të tjetrit, me gjithë prestigjin social që mund të gëzojë ky i fundit. E njëjta gjë ndodh edhe nëse bëhet fjalë për një formë të parregullt të së folmes së tyre, ku folësit në përshtatje me faktorë të rëndësishëm jashtëgjuhësorë i përdorin dukuritë e çamërishtes në përshtatje me normën.

- Në të folmen e çamërishtes, sikurse në mbarë toskërishten, ka vepruar shndërrimi i zanores –à të theksuar në –ë, përpara bashkëtingëlloreve hundore. Tek brezi i vjetër ajo ruhet mjaft mirë në fjalë të tilla si: *këmbë, zëri, përi, thënë, ngrënë, njënë, zënë, dhënë, vënë etj.* Psh: *Nu na lanë gjë pa bënë..; ja, si bënen ktu/ bënen e atje...; çamt kan zënë vëndin më të mirë; pa t'e ngriti këmën/bap!- e thjeu gjith atë/ dishemenë..; Xhevdeti ka thënë / ka kohë që m'thotë ....; të hënë e të njëte(enjte)i mirrshim nuset ne; u ka bën sëmure ..; kur na holënë(hoqën)/ mazah se bën këg njënë...; se m'ka zënë e kolla sot., na ka dhënë katër muaj bukën pa lekë ..., vejim në një burim/ binte një burim ka mali.etj.*

- Lidhur me këtë zanore, na kanë tërhequr vëmendjen edhe disa fjalë të veçanta, tek të cilat *a-ja* e theksuar ka mbetur e pandryshuar, p. sh. në fjalët: *tumane, havan, pelivan*, konkretisht në disa antroponime si, *Sulejman, Osman*, të cilat ndërkaq , si huazime nga turqishtja nuk e kanë kthyer *a-në* në *ë* as në toskërishte.

Shembuj të tillë flasin qartë për zhvillimin e vonshëm të dukurisë së shndërrimit të –a-së theksuar në –ë, për rrjedhojë, edhe njëherë për përbashkësinë e dialekteve tona dikur në kohë të hershme. Me interes në këtë të folme na duket përdorimi kësaj zanoreje në fjalën *nanë*. Siç shihet ajo ka mbetur e pashndërruar, si në gegërishte që, ndër të tjera përkon edhe me shqipen e arkaike, p. sh: *Nanë moj/ sado nanë isht..; këtej na krehin nanatë/ këtej vuuu..morri...*

Pra, siç e shohim, në këtë të folme, në ligjërimin e sotëm spikasin qartë dukuri të shqipes së vjetër.

Tek brezi i mesëm dhe i ri, dukuria e shndërrimit të zanores *a* të theksur në *ë*, me përjashtim të ndonjë ndërhyrjeje të vogël nga dialekti gegë, shfaqet e pastër. Folësit çamë të brezit të mesëm dhe të ri udhëhiqen nga prirja për të ruajtur dhe trashëguar format e rregullta të së folmes çame. Nga ana tjetër, nëse ato përbëjnë parregullsi për shqipen e sotme, shohim përpjekje të vazhdueshme të folësve për të mënjeluar dialektalizmat dhe, për t'u orientuar drejt normës. Këto përpjekje fillojnë që me brezin e vjetër, gjë që shpesh vërtetohet me përdorimet dysore që ato shfaqin p.sh, *ishalla i bën zoti hajir Kujtimit t'bij n'cop shtëpi..(-shprehet një nënë çame, gjatë diskutimit të problemeve të veta.)* Në këtë rast kemi përdorimin e dysuar të foljes **bëj**, ndërsa tek brezat më të rinj vihet re sot një lloj prirjeje për të ruajtur dhe trashëguar nga brezat më të vjetër dukuritë tipike të dialektit që përkojnë me standardin dhe nga ana tjetër për të eliminuar format e parregullta të tij.

b. Në –ë ka përfunduar rregullisht edhe –e-ja e theksuar para një bashkëtingëlloreje hundore. Kjo dukuri shfaqet natyrshëm tek brezat e vjetër sot në fjalët : *ndënja, vënd, zëmër; kuvënd, mënd, dhëntë, gjëj, vëndar, thëmër, qënë,, qënë(folje),P.sh. ù kam qënë nxënës shkolle; dënjëm nja di tre vjet pësaj....; gjersa gjëm kufirin..., t'e shoh at vëndintim atje..; àtje brëna/ me dhën e me kafshë; ku të gjëni vënd të jetonitha..; të vete tani!?- thëmër më thëmëre mba mënd..; lidhe që:n(qenin)i tha...; ju jeni vëndare...(vendas) etj.* Dukuria në fjalë nuk gjen përdorim sot tek brezat e mesëm dhe të rinj.

c. Në të folmen e brezit të vjetër çam, vihet re përdorimi i dendur dhe i veçantë i foljes *běj*. Tek kjo folje *ě*-ja e theksuar, përveçse është përfutur nga një *a* e theksuar, ka pësuar zhvillime të mëtejshme, -ajo ka evoluar në *i*, në disa raste të veçanta edhe në *u*. Këto shndërrime vihen re për kohë dhe mënyra të ndryshme të kësaj foljeje p.sh: *bij, bijmë, bim, bijnë / bija, bije, bin, bijmë, binit, bijnë, / të bij, të bish(biç), të bijë,, të bimë, të binë, të bijnë, etj.* Ndonjëherë spikasin edhe forma të tilla më të vjetra si: *bijëm, bijët, bijën, / të bijëm, të bijët, të bijën, etj.*, të cilat përkojnë me faza të kapërcyera të gjuhës shqipe. P.sh: *bijën pun kshu..nëpër punëra me kazma..; i bijëm/ i çojëm n'san t'vegjël/ çish i thonë..., ç'të biç/ nëntë fëmilë/ t'shkojm t'bijm shkollë..; i bijim si çimento dhe i lyejtim ato..., na binte gregu/ na therte...; s'keshëm ku t'i bijim/çelim furrën e bijëm bukë/ bijëm bukë e vitit// bijëm pësj ëmbëlsira/ bijëm qeshjek me grurë etj.*

- Në të kryerën e thjeshtë dhe në dëshirore vërejmë tek kjo folje edhe kalimin e *-ë-së* në *-u* p. sh, *bura, bure, buri, bumë, butë, bunë/ bufsha, bufsh, buftë, bufshim, bufshit, bufshin: bum ktë copëzë shtëpi/ u bu shpirtmirë nji...*

- Kalimin e *ë-së* në *u* e ndeshim dendur dhe në ndonjë të folme arbëreshe të Italisë, si në atë të Horës së Arbëreshëve ( Piana degli Albanesi)<sup>428</sup>

Prof. Q. Haxhihasani në punimin e tij e shpjegon këtë dukuri me veprimin e analogjisë me të kryerën e thjeshtë të foljeve: *zë- zura, vë- vura, bie- prura*. Dukuria e shndërrimit të zanores së theksuar *-ë* në *-i* ( apo) *-u* është një dukuri interesante në të folmen tonë, pasi shfaqet e ngulitur mirë, megjithëse prek një sasi të vogël fjalësh.

d. Një folje tjetër që na tërheq vëmendjen dhe që meriton të trajtohet në veçanti përkrah foljes “*běj*”, në kuadrin e *-ë-së* në *-i*, është dhe veta e tretë njëjës e së tashmes së dëftores së foljes “*jam*”( isht). Edhe kjo është një trajtë e vjetër që haset në përdorim jo vetëm tek e folmja e çamërishtes, por edhe në të folmet arbëreshe të Italisë, çka tregon më shumë konservacion sesa inovacion, p. sh: *histori e Çamërisë kjo isht..; epo ja!- në ndjekje isht ajo punë... , fshatrat na ndihmuann'çik ç'isht e vërteta... ..se në luftë kshu isht..; / ç'të kapin vritej.., po ç'i jetë isht kijo nusa Petrëtit? – fëmilë e ndarë/ shtëpia ka shtëpia; .u ka bën sëmure po isht mirë.., ajo ish pesëqind metra e gjatë, bum ktë copëzë shtëpi.../... qi ish kaq e bukura.*

- Përveç këtyre dy foljeve, në ligjërimin e këtij brezi, fjalë të tjera tek të cilat e gjejmë dukurinë në fjalë janë fjalët, “*nji*”( një), “*qi*”( që), por sigurisht që këto përdorime janë më të rralla.

- Dikur kjo dukuri vihej re edhe tek disa folje të tjera të së kryerës së thjeshtë si, *hingra* ( hëngra), *gjimë* (gjetëm); tek disa fjalë si *vihërr* (vjuhërr); tek shumësi i mbiemrave, *të mëdhinj, të vogjij*. Sot vërejmë që përdorimi i saj tek këto fjalë nuk ekziston ose është tepër i rrallë vetëm për persona të veçantë . Ato përdoren sipas formave të rregullta të gjuhës së sotme me përjashtim të ndonjë ndërhyrjeje nga dialekti vendas, siç është psh, fjala *vjuhërr*, që në disa raste e gjejmë në trajtën *vjerra*.

- Nga ana tjetër, nuk kemi vetëm zanoren *-ë* që jep *-i* , por në raste të rralla shohim që edhe *-o* jep *-i*: *vështroj> vëzhdri:n*.

- Nëse do t'i shqyrtonim mirë shembujt më lart vemë re se në të shumtën e rasteve bëhet fjalë për një zanore të theksuar *-ë* e cila ka dhënë *-i*, por nuk mund të përjashtohet edhe rasti i kundërt : një *-ë* e patheksuar jep *-i*: *përpjeti*

<sup>428</sup> Për më tepër shih në të njëjtin punim temat: *Bashkëpërkime midis çamërishtes dhe të folmes së arbëreshëve*, f. 74; *Ngjashmëri midis të folmes allvanitase dhe asaj arvanitase.*, f. 88

- Në të kryerën e thjeshtë dhe në dëshirore tek folja bëj kemi kalimin e ë-së në –u, p. sh: *bura, bure, buri, bumë, butë, bunë/ bufsha, bufsh, buftë, bufshim, bufshit, bufshin: bum ktë copëzë shtëpi/ u bu shpirtmirë nji...*

Të gjitha këto pohime i përkasin brezit të vjetër, ndërsa në brezin e mesëm përdorimin e mësipërm të dukurive sipas çamërishtes e vërejmë vetëm në disa kontekste të veçanta të komunikimit me më të vjetërit e tyre, apo me bashkëfolës të së njëjtës origjinë në funksion të bisedës, situatës, rrethanave etj. Në rastet e një ligjërimi të zakonshëm, kemi përdorime të këtyre fjalëve sipas shqipes së përgjithshme. Tek folësit e brezit të ri nuk gjejmë gjurmë të përdorimit të dukurive të lartpërmendura.

e. Përkrah dukurive të tjera karakteristike të çamërishtes, na terheq vëmendjen mungesa e zanores *y* në sistemin e saj fonetik. Ajo zëvendësohet me zanoren – *i* në këtë të folme, psh: *çish, ki, iti, ini, ti, di, dizet, si, qitet, diqan, disheme, mbitem, mbillem, etj. Në tetor të dizetësë filloi lufta itallo-greke..., dënjën nja di tre vjet sa i gënjen/ sa i futën bërna i vranë ata; të gjithë me shpia dikaçe/ dikaçe me gur/ n'at qitet qi t'hash u ti, ki krah kushtu na zijnne....hëngri buk ki nikoqiri dhe ma vuri mua në si tepsinë/ n'si t'babës/ n'si t'vellait..., s'të frinte era...; sit deri ktu/dhe nuk i hapin sitë.*

- Në të folmen e brezit të vjetër, tek fjalët me prejardhje turke, zanorja *y* zëvendësohet me zanoren –*u*. Përderisa kjo është një dukuri e cila gjendet edhe në shqipen e përgjithshme mendojmë se kemi të bëjmë me një huazim nga turqishtja, por duhet të theksojmë se në çamërishte dukuria paraqitet shumë më e spikatur, p. sh: *...epo mirë shuqur / umur të na kenë ; na ra dushemeja në kokë...; ajo ish pesëqind metra e gjatë dhe duzet metra e gjerë...; babaim hapi duqan etj.*

- Sikurse në pjesën më të madhe të dukurive të përmendura, edhe këtu vërejmë herë pas here dysorësinë e saj në përdorim. Vihet re pra, që për fjalë të njëjta nga pikëpamja formale folësi të përdorë në vend të fonemës *y*, fonemat, *i* dhe *u*, pra herë njëerën dhe herë tjetrën, psh: *Baba im hapi duqan/ në dark e billëm duqanin...; na ra dushemeja në kokë...; për inat greku e thjeu atë/ ..dishemenë...deri n'nji t'natës diqenet hapur ...; keshëm dizet dilim tokë...; isht bën me undirë shumë...etj. ( mos ndofta shkaku shumësi ?)*

- Nga njohuritë që kemi tashmë, mungesa e fonemës *y* nuk është karakteristike vetëm për të folmen e çamërishtes. Përkrah saj në dialektin jugor veçohen edhe të folme të tjera, si ajo e Labërishtes, e Kurveleshit dhe e Bregdetit të Poshtëm<sup>429</sup>, të cilat sikurse çamërishtja karakterizohen si nga mungesa e kësaj foneme në sistemin e tyre fonetik ashtu edhe nga ruajtja e zanoreve të gjata në sistemin e zanoreve të theksuara.<sup>430</sup>

- Mungesa e zanores *y* vërehet gjithashtu mjaft mirë edhe tek të folme të ndryshme të arbëreshëve të Italisë.<sup>431</sup> Lidhur me këtë dukuri një punim të posaçëm dhe përgjithësues për të gjitha të folmet arbëreshe të Italisë ka bërë La Piana, në vitin 1949, i cili në veçanti ka studiuar të folmen e arbëreshëve të Sicilisë.<sup>432</sup> Edhe sot e kësaj dite tek e folmja e arbëreshëve të brezit të vjetër, fjalë të tilla si, *sy, dyllë, dy* etj., shqiptohen, *si, dillë, di* etj. Ngjashmëria midis këtyre dy të folmeve sot (çamërishtes dhe arbërishtes), përforcon më shumë pohimet e gjuhëtarëve në lidhje me afrinë midis dialekteve dikur, si dhe rëndësinë e madhe

<sup>429</sup> Totoni, M. *E folmja e Bregdetit të Poshtëm*, në “S.F”, 1, 1964; *Vëzhgime rreth të folmeve të Kurveleshit*, në “Dialektologjia shqiptare”, I, Tiranë, 1971.

<sup>430</sup> Gjinari, J. & Shkurtaç, Gj. *Dialektologjia*, Shtëpia Botuese e Librit Universitar, Tiranë, 1997.

<sup>431</sup> Shkurtaç, Gj. “Ligjërimet arbëreshe” (shqyrtime dialektologjike dhe sociolinguistike në ngulimet arbëreshe të Italisë), f. 151, Tiranë, 2006.

<sup>432</sup> Shkurtaç, Gj: po aty

që ato paraqesin për vlerat e mëdha studimore të këtyre të folmeve për gjuhësinë shqiptare.

Në të folmen e brezit të mesëm dhe të ri, zëvendësimi i zanores *y* mund të vihet re vetëm në disa raste të rralla, konkretisht në brezin e mesëm në varësi të rrethanave, me funksione emotive, në lidhje me variante të ndryshme të aktit të të folurit. P.sh, një meso nënë gjatë bisedës me një bashkmoshataren e saj të së njëjtës origjinë shprehet kështu për fëmijën e saj të vogël: *aman moj aman, unë vërtet e doja këtë djalë me një si n'ballë ( shumë të shkathët ) por ki më duket se nuk ka asnjë si hiç.*

Tek brezat më të rinj nuk gjejmë gjurmë të kësaj dukurie, atje vërejmë shfaqjen e zanores *y* mjaft qartë në sistemin e fonemave, sikurse në mbarë shqipen letrare sot.

Lidhur me këto shembuj, të cilët në vetvete paraqesin vlera të rëndësishme, si nga pikëpamja e ruajtjes së një dialekti mjaft të vjetër shqiptar, por edhe për vlerat e mëdha studimore që kjo e folme mbart në ditët tona, gjithashtu, duke marrë parasysh faktin që këto dukuri nuk përkojnë me standardin e sotëm të shqipes me gjithë përkatësinë e këtij dialekti në toskërishte, mendojmë se është e udhës të përmendim një mendim me peshë të prof. Shkurtajt i cili na ndihmon jo vetëm në qartësimin e ideve lidhur me këtë çështje, por na shërben edhe si faktor ndihmues për të kuptuar standardin dhe polemikat e shumta të formimit të tij.

Pra, është fjala për atë çka studiuesi e ka quajtur “**identifikimi shpërdorues**”, që do të thotë se, për disa forma toske qoftë edhe të tipit të hipertokizmave, shumëkush do të mendojë se ato janë edhe të standardit. E vërteta është se standardi mbart edhe disa forma jotokse ose, së paku, është i qethur nga disa hipertokizma. Studime të shumta kanë treguar që edhe toskët, përfshirë këtu edhe folësit çamë shfaqin në kompetencën e tyre jo pak elemente dialektore që në vetvete nuk janë të pranueshme për standardin e sotëm. Dukuritë e lartpërmendura nuk janë gjë tjetër veçse dëshmi e një pohimi të tillë.

- f. Në sistemin e çamërishtes **mungon seria e zanoreve hundore**. Përsa i përket pranisë së zanoreve të theksuara në tërësi në këtë të folme, shtrohet pyetja: A janë të pranishme ndërhyrjet nga të folmet pritëse?

E ilustruon më përgjigjen përmes kontaktit të kësaj “diaspore të shthurur” me të folmen e bashkësive pritëse kryesisht atë të Shqipërisë së Mesme..

Siç e përmendëm pak më lart, folësve të tre brezave nuk u intereson shumë që trajtat e parregullta të dialektit të tyre t’i zëvendësojnë me trajtat e parregullta të një dialekti tjetër, p. sh. nga *-bij, -isht*, në *-bâ°j, â°sht* etj. Kjo ndodh pasi vetë folësit, sidomos ata të një shtrese të mesme, me një nivel sado pak të ngritur kulturor e arsimor, por edhe përgjithësisht breznitë më të reja, bëhen të vetëdijshëm për rëndësinë që ka norma letrare. Kështu duke pasur parasysh bjerrjen e dialektalizmave tek brezi i mesëm dhe i ri dhe përdorimin e dukurive sipas shqipes letrare, del në pah edhe një herë faktori i “prestigjit”, si një faktor me rëndësi në komunikimin midis folësve dhe me mjaft peshë për disiplinën e sociolinguistikës.

Një gjë e tillë i ka fillesat që në brezin e vjetër, tek i cili kemi verifikuar bjerrje të dukurive të çamërishtes dhe zëvendësimin e tyre me forma të rregullta të standardit, apo përdorime dysore të së njëjtës dukuri etj. P. sh: *që mos bënin kërdinë ..., ishalla i bën zoti hajir Kujtimit t’bij n’cop shpi...; .. hë me zbulohuni i thoshim ne / t’u shohmi fytyrën...; ..se qyteti më i madh Janina është/ Paramthia, Korfuzi, Preveza/ kto ishin...; i bim si çimento dhe i lyejtim ato...; të mbyllura sytë/ jo me perçe/ me çarçafin deri kutu...; në dyzetën/n’dyzetën thash un?- n’dystenjishin/ të gjitha dimnat atje i kaluam..etj. Pra siç e shohim, tek kjo folëse kemi futjen në kompetencën e saj të zanores –y. Këto shembuj vërtetojnë se çamërishtja sot është rezultat i një bashkimi a shkrirjeje të vazhdueshme ruajtjeje dhe përtëritjeje.*

Mendojmë ndër të tjera se ky është një tipar që përfaqëson të gjitha të folmet anësore sot. Të njëjtën gjë vëren edhe Hamp (2000) gjatë studimit që ai i ka bërë foljes *është*, konkretisht vetës së tretë të foljes ndihmëse *jam*, tek arbëreshët e Italisë. Ajo sipas tij shfaqet në trajtën *isht* në disa zona periferike të Molizes, të Pulias, Siçilisë etj. Në disa zona të Bazilikatës dhe të Kalabrisë, ndonëse me mënyra të ndryshme shqiptimi, atë e gjejmë në formën *është* si në mbarë shqipen e sotme.<sup>433</sup>

Për sa u përket ndërhyrjeve të dialektit pritës, lidhur me trajtimet e mësipërme, në brezin e mesëm nuk vërejmë një numër të konsiderueshëm dukurish. Edhe nëse ato janë të pranishme ato nuk janë kurrësesi të ngjashme me dukuritë e mirëfillta. Vërtet e folmja gege në sistemin e saj të fonemave ka edhe zanoren y dhe në këtë mënyrë shumëkujt mund t’i shkojë në mendje që përdorimi i saj nga folësit çamë mund të ketë edhe njëfarë ndikimi nga kjo e folme. Por ky lloj huazimi nuk është i mundshëm, pasi në përbërjen e fjalëve që mbartin këtë fonemë, nuk vërejmë asnjë gjurmë të dialektit të Shqipërisë së Mesme. P.sh, për pjesën më të madhe të brezit të vjetër gegë fjala *fytyrë* nuk përdoret; në ligjërimin e tyre gjejmë gjegegësen e saj *surrat* ose tek fjala *mbyll* p.sh, ndodh dukuria e asimilimit, atë e gjejmë në trajtën *myll*, gjë që nuk e vërejmë kurrësesi në çamërishten e brezit të vjetër çam. Përdorime të kësaj natyre mund të ndihmohen nga të dy kahet, pra edhe nga e folmja e bashkësive pritëse, por nuk janë huazime që u përkasin këtyre të folmeve.

<sup>433</sup> Shkurtaç, Gj. “Ligjërimet arbëreshe”, ” ( shqyrtime dialektologjike dhe sociolinguistike në ngulimet arbëreshe të Italisë), f. 151, Tiranë, 2006.

Nga ana tjetër, për brezin e mesëm dhe të ri nuk mund të shmangen edhe ndikimet e këtij lloji, megjithëse edhe këtu ato nuk janë të natyrshme. Kështu p.sh, nëse do të analizonim foljet *běj* dhe *është* sipas dialektit vendas, do të pohonim se huazimi i dukurive që bartin këto fjalë është i vështirë. Tek këto fjalë është e pranishme zanorja hundore **a** si dhe timbri i saj i veçantë buzor. Pra, konkretisht do të kemi: *â°sht, bâ°j, mâ°ll, knâ°qem*. Pra, zanorja karakteristike e dialektit tjetër në brezin e mesëm huazohet nga çamët në formën e një **-o-**je të thjeshtë dhe zakonisht gjatë kontaktit me vendasit ( në punë, shkollë, shoqëri etj) , ndërsa për brezin e ri këto lloj huazimesh i shohim më tepër si fenomene që kanë filluar të bëhen si të modës.

Në leksik ky lloj huazimi është më i suksesshëm. Ndryshimet janë më të mëdha në fushën e leksikut, ndërsa sistemet e tjera fonetike e morfologjike shfaqin më shumë tipare ruajtëse.

### 6.1.5. Zanoret e patheksuara

Vëzhgimet rreth zanoreve të patheksuara në të folmen e çamëve na shpjen në vlerësimin e disa dukurive e pikërisht:

**a.** Zanorja **ë** e patheksuar **ruhet** në pozicionin e saj fundor, konkretisht:

- **Tek emrat në pozita proparoksite**, psh: *Na mbenë atje lekëtë...; Në tetor të dizetësë...; .... një vajzë atje n'at fshat....; nëpër kampetë grek...; ù kam vëndlindjenë...; .... vajë e kshu / kishim për ca kohë...; ..... atje u kam martuar ù n'fshat Kavajësë...; .....edhe një zonjë e kemi ka ata të shkozetitë...; ... sikur të keshë shtëptë lart ne ata Hastë/ ja kshtu ishim ne atje...; .....atje na pritën disa njerëz ka ata të fshatit / e nxorri bukënë ajo zonja e shtëpisë ../ do haç buk? - i tha etj.*

- **Tek foljet dhe pjesoret e foljeve**, p. sh: *ikurë, folnë, vamë, bënë, kishnë, rrinë, ruajnë, lajmë, shplajmë, sellë, vrarë, qenë, marrë, etj.* P. sh: *këtu janë ata a kan ikurë; folnë nja dy ushtarë; vamë në delvinë; nuku bënë gjë; morën çish kishnë...; rrinë në fshatin tonë që ruajnë ... mbenë këta ...; .. i lajmë , i rrijmë, i shplajmë.; vamë në Ninat/ në Ninat ishnë.....; na dhanë sapun të zes që u lamë...; vranë një plak / e thertënë...; me Greg u kish sellë mirë...; ramë bubrrum /s'u vramë / veçëm një gocë u ka vrarë...; kishim marrë miell/ ushqime...; sa kam vuajturë...etj.*

- **Tek mbiemrat**, p. sh: *i çalë, i ndarë, i tërë, i prerë, i gjatë, i gjerë, e parë, e dytë, e tretë, i urtë, i mirë, i vjetërë, i mshefëtë, etj.* P. sh: *burrat më t'mirë/ isht pjekur njerz t'urtë/ njerz t'mirë ...; veçëm një gocë u ka vrarë/ që i ka gishtat të prerë...;.. pesëqind metra e gjatë dhe duzet metra e gjerë..; erdhën tre aroplanë ditn e parë..../ filloi dor e dytë/ dor e tretë...; fëmilë e ndarë...; le t'ish burri i çalë...etj*

- **Tek ndajfoljet:** *njëherë, natanë (matanë), poshtë, atëherë, shumë mirë, mirë, vetëmë etj.* P. sh: *këta ish natanë...; ka shtatëmbëdhjetë e rëpjjetë i mori turku eksori...; ...kur kemi ardhur njëherë...; ..mazah s'e bën këg njënjë...; vetëm kalamaj nga tre- katërmjet vjeç e poshtë.. ...; ..që mbeti Çamëria matanë ...;jo..jo.. shkoshim shumë mirë.....;sa u kishte hapur qevërria atherë...; ...prandaj thash/ që të shkruesh mirë.....; me uj n'shpatulla ù vetëmë...etj.*

- Sipas studiuesit Q. Haxhihasani **ë**-ja fundore ruhet edhe tek përemrat (*këtitë, atitë*), gjë që nuk e shohim tek brezi i vjetër sot, por në të dhënat e 78-ës, ajo ruhet.

Në brezin e mesëm ruajtja e **ë**-së fundore vihet re kryesisht tek emrat, foljet, mbiemrat vetëm në raste të tilla kur përdorimet janë të njësuara me standardin. si p.sh në fjalët, *kohë, bukë, kripë, djathë, shtëpitë, ramë, vramë, vrarë, marrë, blerë, i çalë i ndarë, i gjatë, i gjerë, matanë, poshtë, shumë, shumë mirë, atëherë etj.* E njëjta gjë vlen edhe për brezin e ri.

**b.** Zanorja **-ë** e patheksuar ruhet tek brezi vjetër ende edhe në pozicione të tjera, si:



- Në pozicion semiprotonik në fjalët: *dasmëra, shkallëza, vashëza, mollëza, punëra, milëra etj.* P. sh: *Jallah tha nana/ jeshën e vashëza të tëra..., bijën pun kshu/ nëpër punëra/ me punëra me gjëra...etj.*

- Në pozicion protonik: *shtëpia, njerëzia, vëllavrasja, emëri, gatërroj, dimëroj.*

- Nga të dhënat e mbledhura, në brezin e vjetër kemi edhe raste të kthimit të – ë- së protonike në –u nën ndikimin e dukurisë së **asimilimit**, në fjalë të tilla si: *kùshtu, kuture, rrumulë, turkuza, kupucë, musus, kutu, sumur etj.* P. sh: *merree ti një kushtu..., kemi shkuar njëmilë halle rruguve..., me turkuza,- i thoshim neve...; ... u kuput ajo dhe ra ...; se iku n'Durrës/ ish musus..., ... umur të na kenë( ymër, umër, umur) ...; ...pshëmull, që mbjellin duhan tokat kutu..., ...atje na u sumur baba neve..., ...na thotë ai mususi na foli grekçe..., nuku mbaj mënd asnjë shtëpiu që t'ish me tullë...*

Dikur kjo dukuri nuk shkaktohej vetëm përmes asimilimit. Q.Haxhihasani jep shembuj të tillë si, *vulla, pushtij, murzis, mulshi, rrupirë.*<sup>434</sup> Sot qarkullojnë ende në përdorim fjalët *murzis, pushtij*, ndërsa fjalët e tjera janë bjerrë dhe nuk gjenden më.

c. Tek e folmja e brezit të vjetër ruhet mjaft mirë edhe dukuria e shndërrimit të **u-së së patheksuar në ë**: *Pënoj, këptoj, dëroj, mbëloj, rregëlloj, pëshoj.* P.sh: *edhe Habibi pësj se dëroi..., pënojëm moj ktu/ ku kishim lekë ne...; ...vineshin të mbëluara ..., deri n'pezetegjashtën që u bë koprativa pënova privat..., kesh rregëlluar gjenden që kalojëm mir neve...etj.* Kjo është një dukuri që vihet re vetëm tek foljet, ndonëse dikur ajo vihet re edhe tek emrat. Më tepër brenda kësaj kategorie përfshiheshin emrat foljorë.

d. Një dukuri tjetër që dikur gjendej tek shumë fjalë, është dhe shndërrimi i **a-së së patheksuar në ë**. Në ligjërimin e brezit të vjetër hasim përdorimin e fjalës, *pësj-pastaj*. Në këtë brez është e vështirë të gjesh përdorimin e kësaj fjale ndryshe, p.sh: *kur vranë pësj edhe këta.../...edhe kshtu pësj filloi ajo..vëllavrasja .../ plasi lufta pësj ...; filloi qevërria greke pësj...etj.*

Në brezin e mesëm e vetmja dukuri që bën përjashtim është ruajtja e zanores ë- të patheksuar në pozicion protonik, gjë që përkon edhe me standardin e sotëm. Ndërsa tek brezi i vjetër ajo ndjehet qartë gjatë ligjëritimit të zakonshëm, tek brezi i mesëm dhe i ri kjo gjë bën përjashtim. Ruajtje të tjera si: **ë**-ja e patheksuar në pozicion semiprotonik, shndërrimi i **ë**-së protonike në **u**, shndërrimi i zanoreve të patheksuara **u, a** në **ë** etj., janë krejt të huaja për ligjërimin e tyre. Këto dukuri janë të vjetra dhe si të tilla, përdorimi i tyre nuk vihet re, pavarësisht rrethanës, motivit apo qëllimit ligjërimor, pra thënë ndryshe edhe pse folësit mund të kushtëzohen nga faktorë të ndryshëm jashtëgjuhësor. Pra, ajo çfarë trashëgojnë brezat më të rinj nga pararendësit e tyre është **njohja e dukurive të mësipërme, por ato kurrësi nuk mund ta trashëgojnë çamërishten e të parëve, me gjithë fizionominë dialektore që ajo mbart**; për të mos diskutuar më pas për moshat e reja të cilët përkrah këtyre përdorimeve e kanë shumë herë më të lehtë përdorimin e standardit letrar.

<sup>434</sup> Haxhihasani, Q. *Vështrim i përgjithshëm mbi folmen e banorëve të Çamërisë*, në « Dialektologjia shqiptare », vëll.I,Tiranë,1971, vëll.II,Tiranë 1973

- e. Nga gramatika e gjuhës shqipe<sup>435</sup> dimë se, që të gjithë emrat femërorë që mbarojnë me grupet e tingujve: **-ël,-ëz**, si dhe emrat femërorë e mashkullorë me **-ër, -ël**, e bjerrin **ë**-në në numrin shumës, p. sh: *gogël- gogla, mollëz- mollza, litër- litra, motër- motra, cilindër- cilindra, pupël- pupla* etj. **Ë**-ja në këtë pozicion tek folësit e brezit të vjetër ruhet, sikurse edhe e pamë, ndërsa tek brezat më të rinj shfaqen përdorimet e rregullta, gjë që tregon ndikimin e tyre prej gjuhës letrare.
- f. Nuk mund të themi që tek e folmja çame nuk vihen re edhe raste të rënies së **ë**-së së patheksuar, pasi nuk do të ishte e besueshme. Kështu në të folur spikasin raste të tilla të rënies së saj sidomos para bashkëtingëllores **r**, p. sh: *e shroi* (e shëroi), *e droi* (dëroi, duroi) etj.
- g. Nga ana tjetër, tek ky brez nuk përjashtohet mundësia e ndikimit nga e folmja vendase, si ndërhyrje të natyrshme gjuhësore nga kontakti midis dy të folmeve. Tek dialekti gegë kemi rënien e zanores në pozicionin e saj protonik, p. sh në fjalët: *shpi, vlla* etj. Një gjë të tillë e vërejmë edhe tek folësit çamë të brezave të ndryshëm, tek të cilët do të kemi përdorime të tilla si, *shpia, njerzia, prrua, vlla, të mdhenj* etj. Sigurisht këto përdorime janë më të rralla në brezin e vjetër, tek të cilët **-ë**-ja bie ndonjëherë edhe në rastet e shndërrimit të saj në **-u** (*msus, ktu, kput, smur*) etj. Ndërsa, tek brezat pasardhës ndonëse, përdorime të tilla janë të shumta, ato nuk mund të jenë kurrësesi më të shpeshta sesa përdorimet sipas standardit dhe shqipes së përgjithshme.

### 6.1.6 Togjet zanore dhe diftongjet

Tek folësit e brezit të vjetër na tërheqin më shumë vëmendjen togzanorët **ua** dhe **ie**. Me disa prej këtyre përdorimeve jemi familjarizuar, pasi përkojnë me standardin e gjuhës shqipe, ndërsa disa të tjera na e vrasin veshin për veçanësinë e tyre dialektore, p. sh: *e muarrnë, duallë, gënjien* etj. *Ditn' e parë që e mësuajtëm neve/ e këptuam neve që u hap lufta/ ern tërë aroplanët e shkuajtën mbi fshatin tonë// dualm përjashta ...; ...përfunduam pastaj neve.../ i ka çuar i ka vrarë në Selan.../ ju mos u tundni se neve nuk u prekim me duar ...; do të shkruaç ti?Bagtin e muarrm me vete..., u muarrsh me bujqsi ù deritani...; ..ramë në katua neve..., ..na nxuarrnë matanë; tani i mirrën të dielat nuset...; s'iu shtie pushkë këtyre ....; .i kam ndier ka pri:t ù; jesh përgjegjës blektorie...ku ka jetuar njeriu i bie mall....; ...pak ishim të përzier, ..e çova aty n'Krievidh...; sa i gënjien / si puna e serbvet' erdhën e u kthien njher.*

Po t'i shohim me kujdes shembujt e mësipërm, ndër të tjera na tërheq vëmendjen togzanori **ie**, i cili nga pikëpamja funksionale i përgjigjet togzanorit **je**, duke qënë se **y**-ja nuk është pjesë e sistemit të fonemave të këtij dialekti. Sigurisht nuk mund të anashkalojmë për asnjë çast faktin që sipas eptimit fjalët ndryshojnë formë. Kështu tek folja **thiej** togzanori **ie** në çamërishte në të pakryerën reduktohet në diftong **îe**: **thîeja, thîeje, thîente**; madje ndonjëherë e gjejmë edhe në trajtën **thente**, pasi jo rrallë në çamërishte **i**-ja jep **e**: **çelte, thente** etj.

Një përdorim të rregullt të togzanorëve të mësipërm në brezin e mesëm dhe të ri, e gjejmë vetëm në rastet kur ato përkojnë me standardin letrar. Ruajtjet e formave dialektore nuk vihen re tek ky brez, përveçse në raste të veçanta të ndonjë përdorimi të rrallë sidomos tek brezi i mesëm, në harmoni me disa rrethana të veçanta, sikurse mund të veçojmë, p.sh. përdorimin në disa raste të togzanorit **-ie**.

<sup>435</sup> Agalliu, Angoni, Dhrimo, Hysa, Lafë, Likaj ( grup autorësh) “Gramatika e gjuhës shqipe”, vëll I Morfologjia, Akademia e Shkencave e Shqipërisë ( Institut i Gjuhësisë dhe i letërsisë), Tiranë 1976, 1995, 2002.

Pa dashur të kalojmë tek një tjetër shembull në të folmen çame vihet re ndonjëherë edhe ruajtja e togut *uo*: (*po duo një njeri që të ruoj ne dera*), si tek Buzuku. Këto shfaqje i kemi vënë re edhe tek të dhënat e 78-ës, por rrallë herë tek moshat krejt të thyera vihen re edhe sot.

Diftongjet zbritëse **aj, oj**, të cilët përdoren zakonisht tek foljet në përgjithësi, si dhe tek përemri **ai**, p.sh: *edhe aj iku që at dit/ a mnesmet nuk e di...*; *mbenë këta/ i lajmë / i rrijmë/ i shplajmë ...*, edhe *Habibi pësjaj se dëroj...*, *jermani na shpëtoj neve ...*, *..morri binte në ujë ikte prrojt...*; *..si serbi që erdhi..ai na shkatrroj...*; *...nuku duhej Mehmet Shehu t'na pranoj...*; *i liroj t'burgosurit...*; *..na dimoj/ vendi na dimoj., i rrijmë/*

Diftongu ngjitës **-ie**, i përdorur gjithmonë tek folja *pyes* sipas kohëve dhe mënyrave të ndryshme, p.sh: *Do t'pies m'tha mua..*; *..n'at kohë s'piesëm uj t'mirë/ uj t'keq...*; *..po t'na pjesësh ne t'vjetve qejfi na ka kshu/ n'dorën tonë; po ti e din/ po ti m'pjet kot mua*. Nuk mund të anashkalojmë faktin që me ndryshimin e kohës së foljeve është vënë re edhe një përdorim dyfish i grupit **-ie** jo vetëm si diftong ngjitës (*bjeç, zjeç, zjejmë, përzejmë* etj.), por edhe si togzanor (*bie, ziej, përziej* etj.) Edhe për përdorimin e këtyre diftongjeve në brezin e mesëm, mund të themi që ato janë gjithmonë të kushtëzuara nga rrethana të caktuara, më specifika prej të cilave është momenti kur ato komunikojnë me të vjetrit. Në ligjërimin e tyre të zakonshëm do të vërejmë përdorim të thjeshtë të togzanorëve.

Tek diftongjet na bëjnë përshtypje edhe **raste krejt të rralla** të cilët në pamje të parë na duket sikur kemi të bëjmë me dyfishim të zanores, pra me një zanore të gjatë, në të vërtetë këtu kemi të bëjmë me një zanore dhe një gjysmë zanore *i* që në rastin tonë i afrohet *j*-së. E njëjta gjatësi vihet re edhe tek e pakryera e vetës së tretë të foljes tek e cila nuk kemi shfaqjen e mbaresës së sotme të kësaj vete: p.sh: *do vi*<sup>436</sup>(do vente), *i shpii bukën, i lii* (diçka).

### 6.3. Sistemi bashkëtingëllor

Në të folmen e çamëve, në sistemin e fonemave bashkëtingëllore vihet re inventari prej 29 fonemash. Edhe në këtë sistem spikasin dukuri të larmishme fonetike, me

<sup>436</sup>E ardhme e së shkuarës.

vlerë për sociolinguistikën dhe shqipen e sotme.

- a. Tek fjalët, në të cilat shumica e të folmeve të shqipes së sotme si dhe gjuha letrare standarde kanë në përbërjen e tyre fonemën *j*, e folmja e çamërishtes në brezin e vjetër ruan ende *l*-në e vjetër ndërzanore.<sup>437</sup> Me gjithë trysnitë e ndryshme përballë të cilave e folmja çame është gjendur gjithmonë, prania e kësaj dukurie në të folmen e tyre nuk është asgjë tjetër veçse tregues i një veçorie tipike të një të folmeje konservuese në ditët tona. Konkretisht na tërheqin vëmendjen fjalë të tilla si: *fëmilë* ( fëmijë), *bilë* ( bijë), *kuel* (kuaj), *rrumulë* (rrëmuje), *milë* (mijë), *palë* (pajë), *valë* (vajë), *golë* (gojë) etj., të përdorura gjatë ligjërimit të brezit të vjetër. P. sh: *Poçi jetë isht kjo nus' e Petritit/fëmilë e ndarë /shtëpia ka shtëpia; vjen non jherë i shoqi i sat bile?; vargan/ armë /kuel-Allah/ rrumulë/ ja / tan-ja si n'kët kehe e mba mënd/ kemi shkuar njëmilë halle/// (Këndon) Kjo s'isht rej'e bardhë/ janë krushqit me palë (këngë).....se vinin krushqit me pala/ hapnin palat kushtu....; ..dolëm fëmilën / e rritëm / e martuam ..// kish nëntë fëmilë baba...//atje kemi dalë me kuel/ di kuel të shtruar me velënxa kuelt.*
- b. Tek më të moshuarit e këtij brezi, ndonëse në raste të rralla, vihet re përdorimi i kësaj dukurie edhe tek shumësi i emrave mashkullorë, që në njëjës in e pashquar dalin me **-ll**, si dhe tek disa prapashtesa emrash foljorë ose jofoljorë. P.sh: *kokall-kokale, hell-hele, kërcell-kërcele, lëngëla, priftëla, ngordhëla, bishtëla* etj.
- c. Përveç zhvillimit të kësaj dukurie në fjalë të fondit leksikor mirëfilli çam, vërejmë edhe disa përdorime analogjike në fjalë të tilla si: *daule, portokale* etj.
- d. Dukuria e shndërrimit të *l*-së ndërzanore në **-j** vihet re shumë qartë edhe tek të folmet e arbëreshëve të Italisë, kryesisht në fjalë të tilla të ngjashme me ato të çamërishtes së sotme , si: *valë- vaj; palë- pajë* etj.

Bjerrja e kësaj dukurie fillon që me brezin e vjetër: tek e njëjta folëse, përgjatë ligjërimit të saj, hasim edhe përpjekjen për një përdorim të dukurive sipas standardit: *..në fillim kwta na mbrojn fëmijt/ që t'kalajn fëmijt dhe gretë...Kjo është edhe arsyeja, pse nuk gjejmë asnjë gjurmë të dukurisë në fjalë tek brezat pasardhës.*

- e. Një tjetër dukuri tipike në sistemin bashkëtingëllor të fonemave, është edhe ruajtja e togjeve bashkëtingëllore **kl, gl** kryesisht në fjalë të tilla si: *kle- qe* ( ishte), *kleçë- qeshë, glisht-gisht, glishtër-gishtëz, klumusht-qumësht, klumushtuar-qumështor, kliche* (kyçe), *klafë* (qafë), *gregli* ( greqi> grekli> gregli), *glëmbi* ( gjëmbi), *shklata* ( shkle ata), *i shklër* ( i shqyer), *shklarë* ( i shqarë- i shkarë), *klishë* ( qishë-kishë), *zglidh* ( zgjidh>zgidh) etj.

Edhe ruajtja e këtyre togjeve vihet re tek arbëreshët e Italisë.<sup>438</sup> I pari që e ka konfirmuar një gjë të tillë ka qenë Solano më 1979, i cili në tri bashkësitë arbëreshe të Siçilisë; në pesë bashkësitë e Katanaxarës dhe pesë bashkësitë arbëreshe të provincës së Potencës, spikat pikërisht ruajtjen e togjeve të vjetra bashkëtingëllore **kl, gl, pl, bl, fl**.

Dukuritë më të spikatura të fizionomisë çame i gjejmë edhe në librin e parë të letërsisë shqiptare, tek **“Meshari”** i Gjon Buzukut.<sup>439</sup> Një ndër këto dukuri është edhe ruajtja e këtyre togjeve

<sup>437</sup> Nga ndikimi i zanoreve palatale-*l*-ja ndërzanore ka përfunduar në **-j** në shqipen e sotme.

<sup>438</sup> Lidhur me këtë çështje, nuk po zgjatemi për të gjitha dukuritë me radhë, pasi ato i kemi përmbledhur në një studim më vete. Për më tepër shih në të njëjtin punim temën: *Bashkëpërkimet midis çamërishtes dhe të folmes së arbëreshëve*, f. 73; *Ngjashmëri midis të folmes allvanitase dhe asaj arvanitase*, f. 88

<sup>439</sup> Shih në të njëjtin punim temën me titull: *Bashkëpërkime të elementeve gjuhësore të veprave më të hershme shqipe me çamërishten e sotme*, f. 164.

Këtë tipar e gjejmë edhe në tekstet e Reinholdit<sup>440</sup>

**Ruajtja e *l*-së së vjetër ndërzanore si dhe ruajtja e togjeve bashkëtingëllore *kl, gl* janë dy dukuri për të cilat ka pasur edhe diskutime ndërmjet studiuesve..** Kështu nga njëra anë, kemi pohimin e prof. Q. Haxhihasanit për timbrin e fonemës së vjetër |l|, sipas të cilit ajo nuk shfaq ngjyra të ndryshme të timbrit të saj, ndërsa studiues të ndryshëm arbëreshë të Italisë, Greqisë dhe të folmeve të tjera shqiptare dallojnë tre tipa të tingullit l, si: Majeri, Reinholdi, Pedersen ( tek e folmja arvanitase ), Ëëigand ( elbasanishtja), etj. Në përgjithësi pra studiuesit pohojnë se *l*-ja tek grupet *kl, -gl*, është më e butë se tek fjalët e tjera.<sup>441</sup>

Pavarësisht nga këto diskutime, në këndvështrimin tonë sot dhe hetimin nga dita në ditë të kësaj të folmeje nga afër, me rëndësi është se këto dukuri janë pjesë e boshtit dialektor të së folmes. Ato shfaqen ende shumë qartë, pastër dhe tingëllojnë bukur nga folës të vjetër çamë. Gjithsesi nuk mund të anashkalojmë edhe përpjekjen për ndryshim tek ky brez, gjë të cilën prof. Q. Haxhihasani e ka përmendur kohë më parë duke pohuar se brezi i ri i popullsisë çame ( kujtojmë që ky brez përkon me brezin e vjetër sot), në përpjekje të vazhdueshme me gjuhën letrare dhe me të folmet vendore të viseve ku banojnë, ka filluar t'i nxjerrë nga përdorimi këto togje. Sipas tij në vënd të togjeve *kl, gl*, kemi përkatësisht *q, gj*. Si shembuj ai ka dhënë fjalët *qisha, gjishti*.

Pavarësisht se këto arkaizma nuk mungojnë edhe sot në të folmen çame, përveç një përdorimi të vazhdueshëm të dukurive të boshtit dialektor, nuk përjashtohet asnjëherë edhe mundësia e shmangies nga e folmja. Në të folmen e individëve në moshë të thyer hasim edhe fjalë të tilla si: *maqina, paqeta, qisha gjishti, qumushti etj*. Mendojmë se ekzistojnë disa mundësi të këtij përdorimi:

E para, ato shqiptohen si të tilla në analogji me disa fjalë si, *sokaq, dufeq* tek të cilat ndodh palatalizimi i velares *k* në *q*;

E dyta, duke kujtuar se këto shembuj janë vënë re tek çamët e vendosur në një bashkësi të gegërishtes së Shqipërisë së Mesme, mendojmë se mund të jenë ndërfitje nga dialekti me të cilin bashkëjetojnë çdo ditë, pasi në të folmen e Durrësit, *q*-ja në disa raste jep *gj: gjisht*.<sup>442</sup>;

E treta, nuk përjashtohet mundësia e një analogjie me ato fjalë të shqipes së sotme ku grupi *gl* jep *gj* dhe *kl* jep *q*, p.sh: *klaj- qaj, klumusht -qumësht* ( pasi kemi edhe *kl>k*, *kliç-kyç*, *klisla- kisha*) *gluha- gjuha* etj. Madje, për të përforcuar këtë lloj arsyetimi përmendim edhe një lloj dysorësie në të folur. Psh: *i ka gishtat të prerë/ gjishtrat e këmbëve.....* Kjo na ndihmon të kuptojmë edhe faktin e zhdukjes së këtyre dukurive plotësisht tek brezat më të rinj, përveçse në ato raste përdorimi me vetëdije të plotë në funksion të ndonjë qëllimi.

E katërta, mendojmë se mundësia më e madhe e këtij përdorimi tek brezi i vjetër nuk lidhet me asnjërën prej tyre, pasi në 78-ën kemi fjalën shqelb , gjë që tregon se fjalët *maqinë* edhe *paqetë* te 90-vjeçarët, kanë lidhje me një përdorim të çamërishtes. **Në këtë pikë aludohet jo vetëm me një atakim skajesh, ku *y-ja>i, -në Dibër, Mirditë; y-ja >i, - në çamërishte, apo kl, gl, në Mirditë( herët)*<sup>443</sup> , *kl, gl, në çamërishte; por edhe k>q në te folmen e hershme te Shqipërisë së Mesme (edhe***

<sup>440</sup> Në të njëjtin punim shih temën: *Ngjashmëri midis të folmes allvanitase dhe asaj arvanitase*, f. 88.

<sup>441</sup> Për më tepër shih: Ajeti, I. *Studime dialektore dhe etimologjike*, Akademia e Shkencave Shqiptare, Tiranë , 2005.

<sup>442</sup> Një ndër faktorët e jashtëm ndihmues në këtë pikë është fakti se këto ndryshime vihen re më shumë tek burrat e brezit të vjetër.

<sup>443</sup> Ajeti, I. *Studime dialektore dhe etimologjike*, Akademia e Shkencave Shqiptare, f. 28, Tiranë , 2005.

**sot); k>q edhe në çamërishten e hershme.**

- f. Një tjetër tog bashkëtingëllor që tërheq vëmendjen po në të njëjtën masë tek kjo e folme, është edhe togu *-lk* (lg), i cili sot ka përfunduar në **jk**. Psh: *alkë-ajkë, balgë-bajgë, ulk-ujk, bulk- bujk*. Për këtë tog vërejmë të njëjtat vërejtje si për togjet e tjera të lartpërmendura. Edhe togun *jk* e vërejmë tek arbëreshët, arvanitasit, Buzuku etj.

Në brezat më të rinj vihet re një lloj shmangie në përdorim të këtyre togjeve bashkëtingëllore.

- g. Si të gjitha të folmet e tjera të toskërishtes edhe e folmja e çamëve ka karakteristikë të vetën dukurinë e **rotacizmit**, tipar dallues i rëndësishëm për dy dialektet e shqipes. Kjo është një dukuri e cila ruhet e pastër në brezin e vjetër, për rrjedhojë një tipar i fortë dallues midis të folmes çame dhe të folmeve të bashkësive pritëse të dialektit gegë. *Û zura vënd në Kavaj...; unë i shita që m'sa hira n'Konispol/ sa hira andej dhe i shita që atje n'vënd...; e kam bërë shpin/ca ktu/ ca jan n'Lushnje ata...; një vit shkoll bëra ne Gregu...; u vu kufiri/ u vu kufiri atej...n'kufi të Shqipërisë...; një kushërira ime...; të tërë me kasolle ishin.*
- h. Në të folmen e çamëve të vjetër, kemi vene re edhe disa raste të veçanta në të cilat fonema **-n** qëndron e parotacizuar. Kjo vihet re sidomos tek pjesorja e foljes *běj*. P. sh: *ja / këtë bëni ai ; nu na lanë gjë pa bën; ja / si bënen kutu /bënen e atje*. Verifikimi i kësaj ruajtjeje sot dëshmon edhe një herë atë fakt të rëndësishëm të zhvillimit të dukurisë së rotacizmit mjaft vonë në të folmen e toskërishtes.

Sipas dëshmisë së historianëve të gjuhës, dikur në kohë të hershme dukuria e rotacizmit nuk ka ekzistuar. Përdorimi i pjesores së foljes *běj*, në formën *bënë*, është i shpeshtë tek e folmja e brezit të vjetër. Edhe ky është një tipar themelor që i bashkangjitet të tjerave, tregues arkaik i të folmes çame, por nuk përjashtohet edhe mundësia e përdorimit ndonjëherë të pjesores sipas standardit të sotëm edhe në këtë brez. Kjo është një dukuri të cilën e gjejmë edhe tek brezat pasardhës; deri tek parashkollorët e së njëjtës origjinë. Tek brezat më të rinj ajo shfaqet në kuadrin e gjuhës së familjes.

- i. Edhe përdorimi i fonemës *rr* në vend të fonemës *r*, trashëgohet tek folës të brezit të mesëm ( kryesisht tek femrat), në raste të rralla edhe tek brezi i ri. Por, në dallim me dukurinë e mësipërme, përdorimi i kësaj foneme karakterizohet nga funksioni ekspresiv që ajo ka. Ajo shfaq një timbër të veçantë në të shqiptuar që ndryshon me fonemën *rr* të shqipes së sotme. *E kishte bërë byrekun të trrashë kaq...; e prrishi ajo; kujdes se është e krrimbur*. Përdorimi i kësaj dukurie në kundërshtim me normën tek brezat më të rinj, mendojmë se lidhet me vetë bashkëtingëlloret *-r/ rr*, të cilat në shqipe kanë qenë gjithmonë shumë të ndjeshme. Madje, në sociolinguistikën shqiptare nga prof. Shkurtaj është hedhur një hipotezë për dallimin e ligjërimit sipas përkatësisë gjinore lidhur me këtë fonemë, për të cilën me sa duket prurjet në sociolinguistikë janë nga më të shumtat.
- j. Në këtë të folme në sistemin e fonemave bashkëtingëllore na bën përshtypje edhe një dukuri tjetër mjaft e rëndësishme , **-këmbimi i fonemave bashkëtingëllore**. Pra, një fonemë këmbëhet me një tjetër e kushtëzuar nga rrethana të caktuara ose jo. Ndër rastet e mundshme të këtyre këmbimeve, ato që na tërheqin më shumë vëmendjen në ligjërimin e brezit të vjetër çam janë:
- k. Këmbimi i buzoreve **b** dhe **v**, p.sh: *ka:live* ( kolibe)

- l. Shndërrimi i fonemës **k** në **h** në disa raste të veçanta, si tek fjalët, *pehtua* (patkua), *vaht* (vakt) etj. Megjithatë në shumicën e rasteve fonema **h** shfaqet e qëndrueshme në çamërishte në çdo pozicion të fjalës. Ndonjëherë vërejmë që ajo do të shtohet përpara ndonjë fjale, apo qoftë dhe në mes të saj, sikurse tek Buzuku, psh, *na dhanë hilaxhe....; ..na shtihijnë me litarë ..; ..i kemi rrihur vetë.*
- m. Edhe bashkëtingëllorja **-nj** në përgjithësi paraqitet e qëndrueshme, megjithëse tek brezi i vjetër çam sot vërejmë ndonjëherë shqiptimin e saj në dy forma:a) **nj-ja** zbërthehet në **n+j**, si përshebull në fjalët, *çdon-jeri, n-jonjherë,tan-ja, n-jaj etj;*
- n. Dukuria e këmbimit të fonemave bashkëtingëllore është një proces që i ka fillimet e veta qysh herët. Kështu nga krahasimi i çamërishtes tradicionale me të folmen e çamërishtes sot, vërejmë që disa këmbime nuk kanë mundur t'i rezistojnë kohës:
- o. Dikur, **q-ja** nistore ka qenë e sonorizuar në **-gj; q-ja** para bashkëtingëlloreve – **t,-n,-m,-r** kthehej në **-j**: *i pajtë, mijtë, fjtë, plejtë, hojnë, dojnë, vdiqnë, u përpojme, u dojç, u përpojç etj.* Nga këto dukuri dhe të tjera si këto, ndonjë përdorim i rrallë do të vërehet tek mosha shumë të vjetra. Në këtë mënyrë vërejmë disa fjalë të veçanta në të cilat qiellzorja e zëshme **-gj** është kthyer në **-j**, p. sh: *kallojer, jerman, etj.*
- p. Të njëjtën gjë vërejmë gjithashtu me **-h-në** velare të palatalizuar që i përgjigjet **ç** greke në disa fjalë si, *ahjere-açere, hje* (hije)-*çe, teshjere* (ftesë) *tesçere, Dahjriu- Daxriu* (patronim) *etj.*
- q. Viojmë edhe me një përdorim tjetër të veçantë të frikatives greke **ğ**, që tek të vjetërit shqiptohet vetëm kur ato këndojnë këngë çame, tek të cilat me sa duket ndryshimi nuk ka vepruar. “*ğarufale kuqelarë*”..
- r. Dikur, qiellzorja alveolare e pazëshme **-ç**, dilte shpeshherë në **-sh**: *çdo*(shdo), *çkishinë* (shkishinë)....etj.

Të gjitha këto dukuri të mirëqena në punimin dialektologjik të studiuesit Qemal Haxhihasani janë bjerrë në çamërishten e sotme. Ato janë zëvendësuar me forma të rregullta të shqipes së përgjithshme. Pra, zëvendësimi i dukurive i ka rrënjët e thella, për rrjedhojë, edhe ndryshimi i së folmes. Pavarësisht kësaj, shkëmbimi i fonemave bashkëtingëllore është një dukuri e veçantë e brezit të vjetër çam.

- s. Një dukuri tjetër që meriton të trajtohet lidhur me fonemat bashkëtingëllore, është edhe ajo e asimilimit të grupeve bashkëtingëllore **-mb, -nd,-ng**. Asimilimi në togjet bashkëtingëllore **-mb, -nd, -ng**, karakterizohet nga një lëkundje e cila shkon në dy drejtime të ndryshme:
  - **e para**, ka të bëjë me asimilim të pjesshëm paravajtës, në të cilin elementi hundor ka asimiluar elementin mbylltor. Përveç të tjerash, përgjatë studimit tonë është vënë re që ky lloj asimilimi gjendet vetëm tek grupi **-nd**. Për dy grupet e tjera nuk kemi shfaqje të kësaj dukurie përveçse në raste huazimesh nga e folmja vendase p. sh: *...kutu ne Bashkimi s'erdh nōnjë .; vjen nōnjherë i shoqi i sat bile*(vajzës tënde) *.; në Paramthi mbajti bërna...., a na ka shitur nōnjë i madh ka tantë tani...; ..n'at kohë qi u çlirua vēni...; ..e derisa ra gjermani pasanaj...; gjermani na vinej me tankse mrapa...; ndejm nja pesmjet ditë..etj*
  - **e dyta**, ka të bëjë me asimilim të pjesshëm prapavajtës. Kjo dukuri shfaqet në të tria grupet bashkëtingëllore dhe është më e shpeshtë në këtë të folme. Ndër të tjera është një dukuri tipike që e bën çamërishten të dallueshme prej të folmeve të tjera: *..për ulli vejën gretë i bledhën...; kur ishte koha për të brojtur ata/ na brojti neve ata// kur ishte koha për të brojtur ne / nga gregët atej lart / na brojtin*

*ata neve...; ..dejëm katërmëdhjet muaj në Delvin neve//ka( ka> nga> ga> ka) Delvina prap pastaj u grem atej n'Berat...; pastaj kshu/ na dimoi/ vendi na dimoi...; ...të gjitha shpit të gritura....; e kutu tani të vesh gjakundi humb mëden e kokës...., kemi bledh misir /kokrra//kemi grënë kokoshare grrrrrup....grrrrrup...; atje çadrën nëna ime e bante të pastër ...; denjëm në Kavaj/ atje denjëm katër vjet me qira...; as na gis / as i gasim.*

- t. Nuk mund të mohojmë edhe të kundërtën për çamërishten: në të shumtën e përdorimeve, në të folmen e brezit të vjetër, këto togje shfaqen të qëndrueshëm. Këtë tipar të tyre e vërejmë edhe tek Buzuku. Duke qënë se kemi të bëjmë me një dukuri të standardit të sotëm, një përdorim i rregullt i këtyre grupeve vihet re edhe nga folës të brezave më të rinj. Po japim disa shembuj të qëndrueshmërisë së tyre në brezin e vjetër: *Rrugat u kan mbëllirë...; ..i mba mënd të gjitha .; ..i mblodhi eksori e i ngriti të gjithë ...; ..se e keshëm shtëpinë permby rrugë...; s'kish vënd atje të uleshe të haje..., edhe Habibi pësaj se dëroi / u ngre ai...; sa tre vëndeveja ndrrojëm ..., vejëm në mal mbledhim gështënja...;.. ngroh ujë nana/ atje na lante kokën / morri në Delvin/ të mbahet mend ..., ndenjëm në Gjirokastër...; vineshin të mbëluara me çarçaf Kavajsetë...; ti do një bllok kaq të madh / që ta mbushësh...; ..jo mos u tundni se neve nuk u prekim me duar...; me ku:l ngava tokën...; edhe mbaj mënd unë!- mbaj mënd më un tek ato...; s'kishe ku t'qëndroje / u kthem mbrapsht...; iku turku pësaj si e thashë / që ngeli pjesa e çamërisë/ ngeli natan / qi u vendos kufiri ktu që mbetëm natan ne.*
- u. Ka raste kur dukuria e asimilimit vihet re edhe në disa togje të tjera p.sh: *ù xerri tavolinën / si puna që shesin ktu n'pazar/ xerrin në një vënd...; ...atje Enver Hoxha xorri kontroll për pastërti...; kshu njerëz nëpër shatrat/ kshu na dimuan; gjesh-ngjesh, jaram ose jām- ngjaram (ngjaram-gjaram-jaram-jām).* Vini re togjet **nx, fsh, ngj.**
- v. Një tjetër tog që na tërheq vëmendjen është edhe togu bashkëtingëllor **st**, i cili shpesh përfundon në **s**. Ky tog shfaq një përdorim dysor ku herë ruhet dhe herë asimilohet. Mendojmë se ruajtja e këtij togu përbën risi në këtë të folme, ndërsa asimilimi është një dukuri ruajtëse: *Plasi lufta pësaj/ plasi lufta...;..e katra ishte pasaj / që mblodhi pleqt atje n'arrest...; ...i premë kusum/ kusum (per analogji) nuses...; mbusheshin plot vorronjat me njerëz/me arkesa(orkestra)( per analogji)...;..pësaj i mi:rr/i kap greku aḫhere ( athere).*

Nga ana tjetër, në kuadrin e kontaktit të çamërishtes me të folmet pritëse secila prej dukurive lë vend për t'u sqaruar imtësisht. Për rrjedhojë, nga kontakti me Shqipërinë e Mesme për të cilat kemi bërë një hulumtim të hollësishëm, vihen re këto dukuri: dukuria e asimilimit të pjesshëm paravajtës bën pjesë edhe në të folmen e Shqipërisë së Mesme. Atëherë lind pyetja: ku dallohen këto dy dukuri të njëjta për nga pikëpamja gjuhësore, por që i përkasin dy të folmeve të ndryshme? Përgjigjja më e saktë do të ishte: - **në përbërje të fjalës**. Tek fjalë të dialektit të gegërishtes, asimilimi i këtyre togjeve shoqërohet me ngjyresa të veçanta karakteristike të këtij dialekti, të cilat i bëjnë ato të dallueshme prej gjegjëseve të tyre në fjalë të së folmes krahinore çame, të cilat nga ana tjetër, shoqërohen nga dukuri të tjera tipike të kësaj të folmeje, duke u dhënë kështu ngjyresa të veçanta të timbrit karakteristik çam. Pra, megjithëse kemi të bëjmë me të njëjtat dukuri në përgjithësi, elemente tipike brenda fjalës që përfaqësojnë njëren apo tjetrën të folme, ndihmojnë për dallimin e dukurive në to. (në rastin tonë të togjeve bashkëtingëllore). Mendojmë se i njëjti shpjegim mund të jepet edhe për kontakte të çamërishtes me bashkësi të tjera pritëse.



Tek brezi i mesëm dhe i ri shohim një përdorim të qëndrueshëm të togjeve bashkëtingëllore. Nëse pikasim ndonjë shkelje në normë, përdorim më të shpeshtë gjen asimilimi i pjesshëm paravajtës. Në këtë pikë, mund të themi se, me gjithë ruajtjen e këtyre togjeve, ekzistojnë shumë ndërfitje të dukurive fonetike në sistemin bashkëtingëllor nga të folmet pritëse, të cilat i gjejmë të pakta në numër në brezin e vjetër dhe më të shumta janë ato në brezat pasardhës. Lidhur me këto shqyrtime vërejmë se edhe tek brezi i vjetër në raste të rralla bashkëtingëllorja frikative *s* përpara një zanoreje të theksuar në një numër të kufizuar fjalësh është kthyer në afrikaten *c*: *Të gjithë me kacolle ishin...*; -ndonjëherë ndodh edhe dukuria e shurdhimit, ku bashkëtingëllorja e zëshme *v* në fillim të fjalës, do të shndërrohet në frikativën e shurdhët *f*, karakteristike për të folmen e Shqipërisë së Mesme: *Fërtet atje isha...*; apo dukuria e asimilimit sipas drejtimit të të cilit elementi mbylltor asimilon elementin hundor, në fjalë të tilla si: *masanaj, mrapa etj.*

Të gjithë këto shembuj flasin qartë për pasojat e kontaktit midis të folmeve.

Gjithmonë duke analizuar kontaktin midis të folmes çame me atë të Shqipërisë së Mesme po paraqesim edhe disa shqyrtime të tjera në lidhje me brezat pasardhës. Një nga dukuritë tipike është dukuria e asimilimit të pjesshëm paravajtës tek brezi i mesëm, madje mund të themi që kjo dukuri përdorimin e saj më të madh e ka tek ky brez, p.sh: *...për Zotin nuk ja maj mënd; për arsye se baba i ka pas bo një ner atijt.../ në nënqin e njistekatrën...; masi e përsëriti një miku i tij...; ..kemi bo nërmen..etj.* Në veçanti këtu na duket gati e pabesueshme shfaqja e dukurisë së asimilimit të grupit – *ng* në –*η* (tek meshkujt): *...ai e kërkonte babën me kamqulje me e taku/ nuk mujti me e gjet...; honrën / pin ata/ masanej dola unë.*

Ndërsa tek brezi i ri do të vihet re që mënjanohej jo vetëm dukuritë e vjetra fonetike të dialektit të origjinës, konkretisht ato që nuk gjejmë përkim me standartin, por edhe ato dukuri të vjetra të dialektit të tjetrit. Megjithatë edhe tek ky brez, megjithë vetëdijen e tij për rolin e standardit, kemi ndonjë rrëshkitje jashtë norme si është rasti i kalimit të bashkëtingëllores glotale –*h* në bashkëtingëlloren shtegore –*f*: *...shif çfarë shpirti...; ...siç shifej biografia ktu dikur...etj.* Pavarësisht kësaj mund të themi me bindje të plotë, që brezi i mesëm ka shfaqur gjithmonë shkallën më të madhe të ndërfitjeve nga e folmja vendase e Durrësit, po ashtu edhe të ruajtjeve nga e folmja e origjinës. **Shohim gjithashtu se, ato pak dukuri të huazuara nga të folmet e bashkësive pritëse tek të vjetrit çamë, nuk trashëgohen aspak tek brezat pasardhës, pasi ato janë karakteristike për brezin e vjetër pritës dhe për folësit e brezit të mesëm dhe të ri konsiderohen si arkaizma.**

### 6.3.1. Dukuritë fonetike

Të tilla përmendim:

- a. Zëshmerinë dhe shurdhimin nën efektin e bashkëtingëlloreve të zëshme a të shurdhëta brenda fjalës, p.sh: *...nganjëherë > ganjëherë* ( asimilim paravajtës) *>kanjëherë* ( shurdhimi i *g*-së në *k*); *gurbeti* ( ndodh e kundërta, *k>g*); *i prëmshmi* ( i mbrëmshmi , *mb>b>p*)...*gjazhdhjet e tetë* ( e shurdhëta *sh* është shndërruar në e zëshme nga prania e së zëshmes *dh*); *...nënd* ( bashkëtingëllorja e shurdhët *t* prapa hundores *n*, zëshmohet), po kështu edhe tek fjala *barangë*, *...pas pes dite ern prapa/ q'i ven vajzz* (vajzës, -ë-ja e patheksuar bie), *vajzës > vajzs > vajzz* ( *s* –ja zëshmohet në *z* nga prania e bashkëtingëllores *z*).
- b. Asimilimin e zanoreve., ku ndër të tjera kemi të bëjmë me një sërë asimilimesh, si:

- asimilime paravajtëse (progresive), si psh në fjalët: *umur*

( ymër>umër>umur); *rruguve* (rrugëve);..*kutu jan edhe ata kushurijtë e mi* ( kushërinjtë); ...*nuku dilshin gratë* (nuk). Këto asimilime janë më të rralla;

- asimilime prapavajtëse (regressive): *Sa talaçe ka pas kjo kokë* ( talaçe>telaçe= telashe); ...*atje na u sumur baba neve* ( sëmur> sumur),..*na thot ai mususi/ na foli grekçe* (mususi> mësusi, mësuesi); ...*një javë mu duket* ( mu>më);...*kutu jam rritur* ( kutu< këtu); *njirit* ( njërit);*budrumit* ( bodrumit); *turkuza* ( tërkuza); *dukumentat* (dokumentat);*kushtu* ( kështu); *kuput* ( këput); *nanave* ( nënave); *rrumulë* (rrëmulë); *thëmër* ( themër) etj.

c. Asimilimin e bashkëtingëlloreve.

Edhe këtu kemi të bëjmë me një sërë asimilimesh, si:

- Asimilime të pjesshme, p.sh.:...*ata gregt ishin më shumë* ( kt>gt);...*në një barangë jeshëm* ( nk>ng); *mblakur* (mp>mb), këto asimilime i gjejmë në breza shumë të vjetër.

- Asimilime të plota me rënie në togje bashkëtingëlloresh, p. sh: *bërna* ( nd<n); *vamë* ( tm<m); *mbehtë* ( tn>n); *dhënërit* ( nd>n); *kusum* ( st>s); *mbemë* (tm>m); *pamë* ( tm>m); *zapo* (pt>p); *belqete* (r>l).

- Kemi raste asimilimesh bashkëtingëlloresh jo në togje: *natanë* ( m>n); *koushtë* (p>k); *budrunit* ( m>n); *veçëm* (t>ç); *njonjë* (nd>n-j); *nartuan* (m<n); *nonjë* (nd>nj,nj>n: nonjë-njonjë-nonjë); *rëpjete* (t>r).

d. Disimilimi.

- Në këtë të folme të bien në sy më tepër disimilimet në zanore, ndërsa ato në bashkëtingëllore janë në zhdokje e sipër. Tek këta të fundit vërejmë disa shembuj si: *birbil* ( bilbil); *bërthet* ( bërtet); *rëpjete* ( tëpjete)etj.

- Disimilimet në zanore janë më të shpeshta: *mbëloj/mbëluar* (mbuluar); *velënxa* (velenxa); *çadre* (çadra); *qevëria* (qeveria); *pësaj* (pastaj), *kërar* (karar); *pënoj/ pënuar* (punuar); *rregëlloj/rregëluar* (rregulluar); *vëllahi* ( vallahi); *këptoj/ këptuar* ( kuptuar).

e. Sinkopa

Dukurinë e **sinkopës** e vërejmë shpesh, porse për të pohuar origjinën e saj është paksa e vështirë, pasi është një dukuri që shfaqet tek të dyja të folmet, si në atë të Durrësit ashtu edhe tek e folmja çame. Siç edhe e theksuam, për dallimin e kësaj dukurie do të mbështetemi tek dukuri të tjera që gjenden brenda fjalës, fjalisë, tekstit etj. : ...*u ashpsua gjënda* (gjendja) *pësaj*...;...*ern* (erdhën) *tërë aroplant/ e shkuejtën mbi fashatin tonë*; *gjersa gjëm kufirin ...*; *pshëmull*.../ *fshatartë jan shqiptar / vllëzt e mi*....

f. Apokopa.

Është një dukuri fonetike që vihet re shumë në këtë të folme, pasi vetë e folmja e çamerishtes karakterizohet nga rënia e fonemave, p.sh: *ka thën tri-kat* ( katër) *herë këto dit/ që mba mënd*...; *zë se* (zëre se) *se kishin* .....; ... *nu* ( nuk) *na tha nōnjë*...; ...*sa u hap lufta itallo-greke/ ai nuk na jip neve asnjë drejt/ që t'na ip* (që t'na jepte) *si shqiptar etj.*

g. Metateza

Çoroditja e fonemave brenda fjalës, është karakteristikë e së folmes çame. Kjo bëhet shkas për shfaqjen e një tjetër dukurie, atë të **metatezës**. Dukuria e metatezës është një dukuri interesante e kësaj të folmeje, të cilën e gjejmë jo vetëm në fonetikë, por edhe në morfologji, sidomos tek kohët e foljeve apo trajtat e ndryshme të emrit. *Sa i gënjen / sa i futën bërna* (brënda)/ *i vranë ata*;... *të ish të mir/ rrijëm atje neve/ rrijëm n'Gërqi*..., *epo siqëdo* ( sidoqë) *që jan grek janë*...; *mbëllirë* (mbyllur>mbillur>mbullirë>mbëllirë); *të njëte* ( të enjten); *sitaxhe* ( sixhade).

h. Një dukuri tjetër e rëndësishme fonetike është moszhvillimi i **j**-së epentitike.

Sipas Q. Haxhihasanit kjo dukuri shfaqet tek emrat femërorë që mbarojnë me **i**-të theksuar, kryesisht para nyjës së sprasme **a**, si dhe tek emrat që mbarojnë me **e** të theksuar. Ndërsa sot në çamërishte gjejmë të përfshira edhe fjalë të tjera: *qime – qima, gjënde- gjënda* (gjëndje), *nuse- nusa* (nusja), *Fatimë- a; Gjulë- a ose Gjula, Lume-a ose Luma; e vjeme- a, e sivjeme-a* etj.

- Tek përemrat pronorë të vetës së parë dhe të dytë njëjës: *ima, jota etj*; është bjerrë kjo dukuri tek përemri vetor i vetës së tretë njëjës të gjinisë femërore: **àjo**; dikur kemi pasur **ao**

i. Edhe **elizioni** është një dukuri që përdoret dendur në të folmen tonë: p.sh: *kisha tufn' e kafshvet// e shitëm pasandaj/ se ku d'e mbajëm...; ...si puna e serbve q'erdhën e u kthien njiher...; ..me ferexhë/ kur dilshin me perçe/ m'ato kohë...; ...e di kush e ka vrarë/ kjo..ç'e ka/ e shoq'e Medi Xhelilit...; ..po ç'i jetë isht kijo nus' e Petritit?...erdhën tre aroplanë d'itn' e parë/ atje në Kazat / në rrethn'e Paramthisë.*

- Gjithashtu nga bashkimi i pjesëzës **të**, me trajtën e shkurtër të vetës së tretë njëjës të kallëzores **e**, **togu zanor ëe nuk jep a**. P.sh: *t'ikte kapaku i kokës/ t'e digjosh librin; t'e shoh at vendin tim atje; vajta n'vën tim/ e t'e hedh poshtë ktu.../ ose t'e urrej ktë vënd../joo...; pa t'e ngriti këmën...bap...e thjeu gjith atë ... dishemenë.*

Të gjitha dukuritë fonetike të mësipërme, janë verifikuar në ligjërimin e sotëm të brezit të vjetër. Kështu, shumë dukuri të çamërishtes së vjetër apo tradicionale, nuk i gjejmë në ditët tona. Shumë fjalë brenda të cilave këto dukuri përdoren kanë dalë nga përdorimi. Përshembull, zëshmëria (sonorizimi) e fonemës **s** gjendet si dukuri fonetike, por në disa fjalë të veçanta tek të cilat ajo dikur përdorej, nuk e gjejmë më: *s'dua* (z'dua), *s'vete* (z'vete) etj. Gjithashtu shumë rrallë gjendet sot, madje edhe në moshat më të vjetra, shtimi i fonemave. Këtu kemi vetëm disa raste të rralla të përdorimit të disa fjalëve tek të cilat vërejmë shtimin e fonemave **-b, -r, -m, -n, -t, -i, -ë, -g** etj, si p, sh: *zëmbra, shëngjeta, murzika, mblakur, akomi, menati, t'shkomi, djelm, ognazë- ohnazë, etj.* Dukuria e aferezës gjendet vetëm në rastet e grupeve bashkëtingëllore ( sikurse edhe e pamë më lart), pra, afereza e shkaktuar nga rënia e zanores nistore nuk gjendet më. Kjo do të thotë që edhe kjo dukuri është në zhdukje e sipër. Këto shembuj flasin qartë për bjerrje të dukurive fonetike në brezin e vjetër. Megjithatë, nuk mohojmë dot faktin që prania e tyre në ligjërimin e folësve sot përforcon edhe më shumë idenë e konservimit të së folmes çame, në ditët tona.

#### **Ndërkohë ç'mund të themi për brezin e mesëm dhe të ri ?**

Natyrisht përdorimi i këtyre trajtave të lidhura me dukuritë e lartpërmendura, do të merrte më tepër rëndësi nëse ato do të shkonin drejt ngulitjes së mëtejshme, por me sa pamë ato po shkojnë drejt bjerrjes. Sikurse për çdo rast tjetër të tillë, brezat e rinj nuk parapëlqejnë sot pasurimin e repertorit të tyre me dukuri të tilla që për të rinjtë konsiderohen tepër të rëndomta. Me pak fjalë rëndësia e dukurive të lartpërmendura mbetet vetëm brenda kuadrit të konservimit dhe rëndësisë që ato mund të kenë për probleme që lidhen me historinë e gjuhës.

Ndërsa ndërhyrjet nga e folmja vendase vihen re vetëm tek dukuri të të njëjtit lloj, siç është përshembull dukuria e sinkopës, e cila gjendet edhe në të folmen e bashkësisë pritëse. Ndryshimi midis kësaj dukurie nga njëra e folme në tjetrën, lidhet me ndryshimin e formës së fjalëve tek të cilat ndodh sinkopimi. Pra, dashur pa dashur këtu na del edhe një herë në pah leksiku, si fushë e ndryshimeve të mëdha. Po e ilustruam këtë me një shembull fare të thjeshtë: Kështu, në çamërishten e brezit të vjetër, përemri **çfarë** nuk shfaqet me këtë formë. Atë e gjejmë në trajtën e thjeshtuar **çish**, e cila sinkopohet më tej në trajtën **çi** ( *Po, ç'i jetë isht kijo moj?*) Ndërsa, forma e

sinkopuar për të folmen e Durrësit, kryesisht në brezin e vjetër, por që është trashëguar edhe tek pasardhësit e tyre, është trajta **ça**. Në brezat çamë, gjenden edhe përdorime dysore të kësaj fjale, pra të dyja trajtat karakteristike të të folmeve. Në brezin i ri çam, konkretisht në mosha shumë të reja të këtij brezi vërejmë ngushtimin e kësaj dukurie, por me një ndryshim të madh, eliminimin e formës së huazuar **ça** ose **çish** apo **çi** dhe përdorimin e trajtës **çfarë**, sipas standardit.

Të gjithë këto shembuj janë tregues në tërësi sesi ndodhin lëvizjet brenda sistemit të një të folmeje dhe për rrjedhojë kahun dhe mënyrën e ndryshimit të saj brez pas brezi.

## KREU VII

### 7. TIPARE MORFOLOGJIKE TË SË FOLMES ÇAME

#### 7.1. Veçori të pjesëve të ndryshueshme të ligjëratës, sipas kategorive gramatikore.

##### 7.1.1. Gjinia asnjane

Studiuesit ndajnë afërsisht të njëjtin mendim për ekzistencën e tri gjinive në dialektin e çamërishtes. Këtë do ta gjejmë të konfirmuar nga studiues si, Pedersen (gjeje këtu), Çabej si dhe Q. Haxhihasani në studimet për këtë të folme. Përdorime të fjalëve të ndryshme në gjininë asnjane vihen re edhe sot e kësaj dite në të folmen e çamëve. Sigurisht kjo gjini nuk mund të merret sot si argument bindës për ekzistencën e saj, pasi edhe në këtë të folme ajo është në zhdukje e sipër. Një shumicë fjalësh të gjinisë asnjane që dikur përdorehin, sot nuk gjenden më. Nga ana tjetër, gjen ende përdorim një pakicë fjalësh, konkretisht në shprehje të tipit: *ç'mu ngjeth **misht**; vdiqa ka të **ftohët**; plasi ka të **klarët**; bën të **bardhët** e vesë etj.* Shprehje të tilla janë dëshmi e plotë e pranisë së kësaj gjinie në ditët e sotme.

Emrat femërorë që në njëjës in e pashquar dalin më **-e**, kur shquhen e humbasin zanoren **-e** të nyjës së sprasme. Kështu gjejmë në përdorim fjalë të tilla si: *nuse-nusa, dele- dela, lule- lula, mace- maca.* Ky rregull vlen më tepër për emra femërorë me theks parafundor, ndërsa, tek disa emra të përveçëm me theks fundor e-

ja fundore ruhet, p. sh: *Gjule- Gjulea, Fatime- Fatimea* etj. Kjo është një dukuri e cila ruhet e pastër në moshat më të vjetra

Në brezin e mesëm vërejmë një përdorim dysor të fjalëve, njëri prej të cilëve anon kah formave të standardit letrar dhe tjetri ka të bëjë me ruajtjen e formës së vjetër, porse me një ndryshim të vogël: dukuria në fjalë shfaqet vetëm e kushtëzuar nga disa rrethana të caktuara, njëra prej të cilave ka të bëjë me ligjërimin e kushtëzuar nga një kontekst folësish të së njëjtës origjinë. Sigurisht, edhe këto përdorime janë të rralla, çka do të thotë që po zëvendësohen nga dita në ditë me forma të rregullta të standardit tek ky brez, për t'u bjerrë më pas plotësisht në brezin i ri të sotëm çam

### 7.1.2. Kategoria e numrit

- a. Një dukuri karakteristike për këtë të folme është **formimi i shumësit** me anë të dukurisë së metafonisë, konkretisht të **a-së** së theksuar të rrënjës. Ndonjëherë fjalët njëkohësisht me zhvillimin e kësaj dukurie, marrin edhe prapashtesa apo mbaresa të ndryshme, madje tek disa emra me temë në **k, g**, ndodh edhe dukuria e palatalizimit në **g** apo **gj**, p. sh: *duqan-duqene, çoban-çobenë, jorgan- jorgenë, sahan –sahenë, filxhan-filxhenë, lak-leqe, sokaq-sokeqe, djalë-djel, plak-pleq, kòkal-kòkele, vath-vethë, çurap-çurepe, dash-deshë, maç-meçër, dullap-dullepe, vllah-vllehë, qitap-qitepë, çarçaf- çarçefë, kulaç-kuleçë, jatrua-jatrenj, katua-katenj, përrua-përrenj, ikua-ikenj* etj.
- b. Dikur, në këtë të folme, emrat që mbarojnë me **ll**, e formojnë shumësin e tyre duke reduktuar **ll**-në në **l**. Sot, përveçse në ndonjë fjalë të veçantë tek ndonjë folës i veçantë, nuk e gjejmë më të përdorur këtë dukuri.
- c. Përdorime të tilla në brezin e vjetër si: *varr-verre*, por edhe *varre*; *zjarr-zjerre*, por edhe *zjarre*, vijojmë: *bark-berqe*, por edhe *barqe*; *prag-pregje*, por edhe *pragje*; *lak- leqe* (formë e rregullt), por edhe *laqe* (formë e gabuar); *mal-mele*, por edhe *male*; *dhaskal-dhesqelë*, por edhe *dhaskalë*; *maç, meçër*, por edhe *maçër*; *dullap, dullepe*, por edhe *dullape*; *vath, vethë*, por edhe *vathë*; *çurap, çurepe*, por edhe *çurape*; *çoban, çobenë*, por edhe *çubanër*<sup>444</sup> etj; fjalë të tilla si, *çarçefë, jorgenë* etj, që dikur në dialektin çam nuk kanë ekzistuar, (gjegjëset e të cilave në çamërishte kanë qenë: *sendon, papllomë*).....; të gjitha këto tregojnë se megjithëse e folmja çame ka evoluar, dukuria e shumësit me metafonizëm është mbartur, pavarësisht përdorimit dysor, bjerrjes, apo risimit në këtë të folme. Folësit e brezit të mesëm dhe të ri, janë të prirur t'i rregullojnë këto forma, duke ia përshtatur shqipes së përgjithshme.
- d. Një lloj tjetër shumësi që na tërheq vëmendjen tek kjo e folme është edhe ai i disa patronimeve. E veçojmë këtë dukuri pasi trashëgohet edhe tek brezi i mesëm. Në ligjërim ajo vihet re sidomos tek burrat, e megjithatë e gjejmë edhe tek gratë, në momentin kur ato bashkëbisedojnë për fisin, familjen, prindërit, të afërmit, të njohurit e tyre etj. Këto emërtime marrin në shumës **-enj, -ej**: *Hoxhenjtë ose Hoxhejtë, Malenjtë ose Malejtë, Abdurrahmenjtë ose Abdurahmejtë, Dahrenjtë, Dahrejtë, Rokenjtë* etj.
- e. Afritë e kësaj të folmeje me të folmen e arbëreshëve të Italisë vihen re edhe tek shumësi i emrave. Tek arbëreshët është ende i pranishëm shumësi me metafoini të **a-së** në **-e**, si: *plak* (pjak)~*pleq*(pjeq), në këtë rast kemi edhe dukurinë e palatalizimit. Prania e kësaj dukurie në arbërishte shihet edhe tek disa fjalë të huazuara nga italishtja të cilat përdoren në përshtatje me rregullat fonetike të

<sup>444</sup> Të dhënat janë vjelë nga e folmja çame e rrethit të Durrësit.

shqipes së tyre të vjetër. Kështu vërehen fjalët, *matarac- matareca* ( materasso), *stivall-stivel* (ll-l) *stivale, uqel* (occhiali) etj. Edhe për gjininë asnjansë tek arbëreshët vërehet e njëjta gjë: *kafet* ( kaffe), *pitrolt* ( il petrolio), *stanjt* (lo stagno) etj.

- f. Për emrat kemi vërenjtur edhe dukurinë e shumësit me anë të palatalizimit të bashkëtingëllores fundore **k** në **g**. Kjo është një dukuri që përkon me shqipen e sotme standarde dhe si e tillë më e lehtë për t'u trashëguar në breza. P.sh: *fik-fiq, zog-zogj, bark-barqe, lak-leqe, varg- vargje, peshk-peshq, krushk-krushq, turk-turq, ulk-ulq*(ulqër), *shirk-shirqe, sokak-sokaqe, prag-pragje, shteg-shtigje* etj.
- g. Në këtë kuadër në të folmen e çamëve na tërheq vëmendjen edhe shumësi në trajtën e pashquar të emrave që mbarojnë me prapashtesat, **- e, -ë, -a, -nj**:
- Në brezin e vjetër në përgjithësi ruhet formimi i shumësit të pashquar me mbaresën **e, p**. sh: *ledh-ledhe, tanks-tenkse, tërrnit- tërrnite, top-tope, mitraloz-mitraloze, avion-avione, bereqet-bereqete, aheng-ahenge, koosht-kooshte, vend-vende, qitet-qitete, vendim-vendime, brisk-brisqe, aeroplan-aeroplane: gjermani na vinej me...çu thonë .. me tankse...; ....i binte me tope...; marrim tërrnite ne pastaj dhe i presim me tërrnite...; ...vrau aqhere pësjajme ajroplane...; ...ajo ishte qevërr/ kishte tope/ mitraloze/ tanke/ avione...; ..në përgjithësi fshatrat kishin belqete/ kishin toka...; ...plot me ahenge...; vendasit ishën me kacolle/ ledhe/ kushtu... me balt...etj*

Kjo dukuri trashëgohet tek brezi i mesëm vetëm në ato raste të bashkëpërkimeve të kësaj dukurie me standardin, p. sh: *kopësht-kopshte, vend-vende, kanal-kanale, qytet-qytete, vendim-vendime*. Në të tjera raste, në të folmen e brezit të mesëm, emrat gjatë shumësit marrin mbaresat e shqipes. Pra, brezat e rinj kanë prirje të rregullojnë format e vjetra të shumësit. Kështu, tek këto breza kemi: *top- topa dhe jo tope, mitraloz-mitralozë dhe jo mitraloze, tërrnit-tërrnitë dhe jo tërrnite, aeroplan-aeroplanë dhe jo aeroplane* etj.

- Emra që në shumësin e pashquar marrin mbaresën **ë**:

Në këtë të folme sikurse në mbarë shqipen e përgjithshme prapashtesën **ë** e marrin vetëm emrat mashkullorë. Zakonisht këto fjalë theksohen në rrokjen e tyre të fundit: *filaqotë, margëlliçotë, volotë, gjerdanë, çengelë, kulishë, kaciqë, fanarë, manarë, pamporë* ( pampuar), *klumështorë* ( klumështuar), *lakrorë* (lakruar). Si një dukuri e mbarë shqipes, këtë e gjejmë të rregullt edhe tek brezat e rinj, por sigurisht **në shtresat më të reja të leksikut**.

Ajo çka na ka tërhequr vëmendjen tek këto breza është fakti se megjithëse disa fjalë të leksikut çam janë trashëguar edhe tek brezat më të rinj, ndodh që brenda këtyre fjalëve nuk janë trashëguar dukuritë fonetike apo morfologjike të së folmes çame. Kështu p. sh. tek brezat e rinj janë trashëguar shumë fjalë nga fusha e gatimit, por brenda fjalës shohim se dukuritë karakteristike fonetike a morfologjike janë bjerrë.<sup>445</sup>

- Emra që në shumësin e pashquar marrin mbaresën **-a**.

Sikurse në shqipen e sotme, ndonëse në brezin e vjetër, do të vihet re përdorimi i shumësit më **-a**, konkretisht tek emrat e gjinisë mashkullore që mbarojnë me bashkëtingëllore: *glëmb-glëmbe, rremb-rremba, dimër-dimra, emër-emra, plesht-pleshta, marr-morra, emër-emra* etj.

- Emra që në shumësin e pashquar marrin mbaresën **-nj**.

Edhe tek emrat mashkullorë që mbarojnë me këtë prapashtesë, kemi përkim të

<sup>445</sup> Troplini, E.: *Leksiku në të folmen e çamërishtes*, në revistën “Malësia”, Podgoricë 2010; shih për më tepër temën me të njëjtën titull në të njëjtin punim, f. 99.

plotë me normën në përdorimet e këtij shumësi, p. sh: *hu-nj, bari-nj, dru-nj, katua-katenj, ftua- ftonj, thua-thonj, përrua-përrenj*, ndërsa për fjalën *krua* do të kemi shumësin **kronj**, (*kroje*, në shqip), sikurse në shumë të folme të toskërishtes.

Në brezin e mesëm kjo mënyrë formimi trashëgohet e pastër, ndërsa për brezin e ri mund të themi që vërejmë një farë devijimi nga norma të cilat vijnë si rrjedhojë e interferencave të së folmeve të bashkësive pritëse: *ftua- ftoj, thua-thoj, përrua- përroj*.

- Emra që në shumësin e pashquar marrin mbaresën **-ër**

Në të folmen e çamëve të vjetër, kemi një shumicë emrash që temën e njëjësit e zgjerojnë me prapashtesën **-ër**, p. sh: *grekër, jetimër, majmunër, matufër, glishtër, bufër, bandillër, gonër, kunetër, ulqër, halldupër*.

Kjo është një dukuri që është trashëguar edhe tek brezi i mesëm për vetë ngjyresën stilistike që merr kjo prapashtesë, herë përbuzëse, herë miratimi. Kjo gjë nuk vihet re tek të gjitha fjalët, por vetëm tek ato fjalë që i përkasin shtresës së re leksikore. Tek të rinjtë shumësin me prapashtesën **-ër** e formojnë vetëm ato pak emra që shënojnë frymorë, si në shqipen letrare: *prindër, nipër, skllëvër, kunetër* etj.

h. Kemi gjithashtu disa forma shumësash që përdoren vetëm tek brezi i vjetër dhe nuk trashëgohen tek brezat më të rinj, pasi ato konsiderohen si përdorime të vjetëruara, psh. ***kalë-kuel, djalë-djel, thes-thesë, rreth-rrethë***;

i. disa emra që shumësin e formojnë me anë të prapashtesave të turqishtes, siç janë prapashtesat **-llarë, -lerë**: *hoxhallarë, agallarë, baballarë, shehlerë*, etj.

Shumësi i emrave femërorë përftohet në këtë të folme sipas rregullave të standardit të përgjithshëm të gjuhës shqipe.

j. Ndër lloje të ndryshme shumësash të kësaj gjinie na kanë bërë më tepër përshtypje tek më të vjetërit përdorimi i emrave femërorë të zvogëlimit, si: *pulëz, arrëz, vashëz*, etj. Këto emra e ruajnë prapashtesën e zvogëlimit edhe në numrin shumës, p. sh: *pulëza, arrëza, vashëza*. Përdorime të këtij lloji nuk vihen re tek brezat me të rinj, qoftë edhe kur ligjërimi i tyre kushtëzohet nga rrethana të ndryshme.

k. Formimi i shumësit me anë të mbaresës **-a**, duke humbur **-ë** në fundore të temës së njëjësit në fjalë të tilla si, *velënxa, lundra, drrasa, gështenja, koca, pula, kupa, çala, vdekëla*;

l. Emrat që në njëjës mbarojnë me **i, ë, à** të theksuar, ruajnë të njëjtën trajtë edhe në shumës: *parà, shtëpi, dhì, bagëti, avlli, ferexhë, perçë, tesxere, sitaxhë*;

m. Shumësi i formuar me prapashtesën **-ra**: *dasmëra, bakllahira, punëra, kripëra, barëra, leshëra* etj.

Të gjitha këto dukuri flasin qartë për përkatësinë e këtij dialekti në toskërishte.

Tek brezat më të rinj shohim një lloj varfërie të përdorimit të shumësit me prapashtesën **-ra**. Ato bashkohen me prirjen e të rinjve që përbashkon sot të gjitha të folmet, për të qenë shqipfolës të rregullt si dhe përdorues të mirë të standardit.

### 7.1.3. Trajtat rasore.

a. Ndër trajtat më interesante të së folmes së brezit të vjetër sot janë mbaresat **e rasës kallëzore**.

- Emrat mashkullorë që në të pashquarën e njëjësit **mbarojnë me zanore**, e formojnë të shquarën e kallëzores nga trajta e pashquar e kësaj rase me mbaresën **në/ n** , p. sh: *mullinë, sinë, pënë, sufranë, kruan, ftuan , zanatçinë etj. mazah se bën këg njënë; ne shtrojëm sufranë që hajëm bukë..; i qërroi greku sinë pësaj etj.*
  - Emrat që **mbarojnë me bashkëtingëllore** e formojnë trajtën e shquar të kallëzores duke marrë zanoren **-i** midis temës dhe mbaresës, si : *emërin, fshatin, ballin, glishin, lumin etj*, sikurse në mbarë shqipen. Lidhur me këtë rregull bëjnë përjashtim në këtë të folme disa trajta të pranishme pa zanoren **-i**. Ato dalin njëlloj me mbaresën **-në** , por të shoqëruara nga dukuri të ndryshme fonetike, p. sh: *fshanë, baragnë, surranë, pallanë, varrë, djalë, etj. ja theri djalnë*. Në brezin e vjetër sot ky përdorim zë vendin më të madh.
  - Një gjë e tillë vërtetohet edhe më mirë prej emrave të gjinisë femërore, të cilët si ato me temë në bashkëtingëllore ashtu edhe ato me temë në zanore, marrin në kallëzore të njëjtën mbaresë **-në/ -n**.
  - Kujtojmë këtu edhe format e vetës së tretë të foljeve në veprorë: *rrahnë, hapnë etj* , të cilat sot i gjejmë në trajtën *rrahën, hapën etj*. Këto mbaresa flasin për një formë të hershme, por kemi dhe raste kur përdoren edhe forma të evoluara p.sh: *Konispolën, fëmilën, djalën, burrën etj*. Në të tilla raste siç e shohim ë -ja fundore ka rënë dhe kemi një ë mbështetëse, midis temës dhe mbaresës. Po japim nga një shembull për secilin rast: *ditnë e parë/ radhnë e parë/ fillova bujqsinë ù për vete time...; Konispolën e keshëm tehu nevet..., ..do iki se kam fëmilën pa bukë. do marton djalën e madh ; ftoi edhe burrën e saja*.
- Të gjithë këto shembuj tregojnë se formimi i trajtave rasore, është tregues i rëndësishëm i trajtave arkaike nëpër të cilat ka kaluar gjuha shqipe.
- b. Në këtë të folme na bën përshtypje prania e rasës **vendore** p.sh. *iknë me pushkë maleve, e thertënë e vartën n'fikt , morri ikte prroit etj.*
  - c. Në rasën **gjinore** do të vihen re disa trajta të hershme, si p.sh: *kishte tuf'n(ë) e kafshve-t* , ku mbaresa e hershme **-t**, sot ka rënë në format e lakimit. E njëjta gjë ndodh edhe për dhanoren: *u tha djelmvet*.
  - d. Dikur në çamërishte ka ekzistuar forma e shumësis me **-m**: *një djalë / disa djelm*, ndërsa sot **-m**-ja ka rënë.
  - e. Siç e theksuam edhe në fonetikë, në këtë të folme vihet re një farë **parregullsie** që bëhet shkas për lindjen e disa dukurive të ndryshme fonetike. Të njëjtën gjë do të vërejmë edhe në sistemin e eptimit, p. sh: *edhe i shpij gjith e kush në vënd të tij; ishim burr e gra/ disave u dhanë punë qevërri n'at kohë; fanatik shumë çamëria*.

#### 7.1.4. Shquarsia e emrave

- a. Në këtë të folme, vërejmë se një sasi emrash femërorë kryesisht emra frymorësh, me theks parafundor, që dalin më *o*, këtë të fundit do ta shndërrojnë në *u* dhe fjala do të marrë nyjen e sprasme *a*. Pra, thënë ndryshe: zanorja *o* do të zberthehet në togzanorin *ua*, p.sh: *çeço- çeçua, dajo-dajua, Hazo-Hazua, Ziko-Zikua etj*. E kundërta ndodh me emrat mashkullorë tek të cilët dyzanori *ua*, mblidhet në *o*, dukuri kjo që përkon edhe me standardin e sotëm, p. sh: *pampuar- pampori, klumushtuar- klumushtori, lakruar- lakrori*, sikurse të gjithë emrat e tjerë që mbarojnë me *ua*: *krua -kroi, ftua- ftoi, përrua- përroi*.
- b. Lidhur me këtë dukuri, për brezin e mesëm mund të themi se, përveç përdorimeve



sipas standardit të sotëm, gjejnë vënd edhe përdorime sipas së folmeve të bashkësive pritëse, si p. sh në disa emra me lidhje farefisnore, si, *dajo* por edhe *daja* dhe jo *dajua*; përdorime të tjera : *qumështor* dhe jo *qumështuar*, *lakror* dhe jo *lakruar* etj.

- c. Nuk kemi verifikuar në brezin e vjetër raste te tilla të zëvendësimit të gjinisë femërore me gjininë mashkullore, të cilat janë konstatuar më parë në punimin tradicional të Q. Haxhihasanit, si *Evropi*, *tenxheri* etj.
- d. Në këtë të folme vlen të përmendet shquarsia e emrave **në shumës**, mbaresat e të cilave nuk përputhen me ato të shqipes së sotme; edhe këtu gjejmë trajtat e hershme të gjuhës sonë.
- e. Nga gramatika historike dimë, se nyjat shquese kanë ardhur nga peremrat dëftorë, kur ato ishin në trajtën e tyre të thjeshtuar dhe i janë prapangjitur emrit për ta shquar atë: p.sh: *vineshin ushtartë e vrarë; ata gregt(ë) / na përzunë ka shtëpitë; të gjithë fëmiltë atje i linda ù ; ern(erdhën) tërë aroplantë; ikte gjaku vu.. / nek mi:rr avdes hoxhallartë; hizmeqarëtë bijën punëra për ne*. Kjo është një dukuri të cilën e gjejmë edhe tek Buzuku, për të cilën nuk ndajmë të njëjtin mendim me studiuesin Selman Riza, kur këtë dukuri e sheh si huazim të gjuhëve të huaja. Kështu ai shkruan: “*Emravet të porsahuazuar nga latinishtja apo italishtja Buzuku ka pasur prirje që t’ua ruajë gjininë e gjuhës origjinare, p.sh: lekciona e pestë, pasiona e tinë zot, endëditët tëh transfiguracionësë etj. ( përmëtepër: en virgjinitetit sote).Emravet të këtillë Buzuku trajtën e shumësit ua ka lënë të pandryshuar nga ajo e njëjësit p.sh.: xhakontë, soldattë etj.*”<sup>446</sup>

Nga ana tjetër, duke qenë se kemi të bëjmë me forma tashmë të vjetëruara, këto përdorime nuk janë trashëguar tek brezat më të rinj, tek të cilët do të vërejmë një rregullim të tyre sipas standardit.

- f. Për sa u përket rasave gjinore, dhanore e rrjedhore, ato formohen sipas rregullave të standardit të sotëm, vetëm se në këto rasa është e nevojshme të veçojmë disa dukuri të cilat spikasin për vjetërsinë e tyre. Ato i gjejmë në brezin e vjetër sot dhe janë bjerrë plotësisht në brezat pasardhës:
- g. Emrat e gjinisë femërore që në trajtën e pashquar të emërores së njëjësit dalin më **e**, do të ruajnë formë të njëjtë edhe në rasa të tjera. Kështu kemi: *mish dele* dhe jo, *mish deleje*.
- h. Trajtat e vjetra të gjinore dhe dhanore dalin pa **v-** në epentitike, p. sh: *në dasmë të djelmet ( djelmëvet)*. Kujtojmë se bjerrja e kësaj dukurie ka filluar që me brezin e vjetër. Herë- herë ajo edhe shfaqet, por mbaresa mbetet, p. sh: *kishte tuf’n(ë) e kafshve-t*. Pra, mbaresa e hershme **-t**, sot ka rënë në trajtat e lakimit.

Nga trajtimi aktual i rasave, na bie në sy mënjanimi i formave të vjetëruara, si prirje karakteristike e mbarë të folmeve sot.

### 7.1.5 Nyja

Një tjetër element i rëndësishëm që duhet trajtuar në morfologjinë e së folmes çame është edhe nyja.

Gjatë ligjërimit të brezit të vjetër çam vihet re rënia e nyjës së prapme *a* ose *i*, e emrave, para nyjës së përparme ( zanores) të mbiemrave, si dhe përpara emrit në gjinore. Po japim disa shembuj për secilin rast: *e shoq’ e Medi xhelilit...*, *..nuk di si ka qën/ që filloi dor’e parë.....; ...mosh’ e ksaja...; ...po çu jetë isht kijo nus’ e*

<sup>446</sup> Riza, S. *Gjon Buzuku/ Nga veçoritë morfologjike buzukiane*, f. 387, në “Pesë autorët më të vjetër të gjuhës shqipe ....”, Tiranë

*Petritit? ...bobobo moj rej'e bardhë ...; se luan zonj'e shtëpisë...; ...të ngjethej qim'e krumit...; ...shkonte gjaku njerzve/ çamve lum.....; dilte siu robit/ që piqej koka n'furrë / pllauuu...; Miftiu Paramthisë...; i par' i Paramthisë.*

Një dukuri të tillë e kemi trajtuar edhe në rastin e rënies së zanores së patheksuar –ë.

Tek shembujt e përshkruar më lart, vërejmë një tjetër dukuri të rëndësishme: përdorimin e trajtës së pashquar me kuptimin e së shquarës. P. sh, krahaso në shembujt e mësipërm: *dor' e parë: dora e parë; mosh'e ksaja: mosha e ksaja; nus'e Petritit: nusa e petritit; rej' e bardhë: reja e bardhë; zonj' e shtëpisë: zonja shtëpisë; qim'e krumit: qima e krumit; i par' i Paramthisë: i pari i Paramthisë etj.*

Në të folmen e sotme çame nuk ndjehet nyja e përemrave pronorë të vetës së parë dhe të dytë njëjës, si dhe nyja e rasës gjinore tek emrat e farefisnisë. P. sh: *jo kjo toka jote / jo kjo toka ime / kjo jota / kjo ima ...; ...ia shpuri kunatës ...; ...ia thashë jenës saj..*

Si risi në këtë të folme ( jo me përdorim të ngulitur mirë) do të konsiderohen:

- shfaqja e nyjës të, pas një emri mashkullor, në gjinoren e shquar njëjës: *gruan e vëllait të madh* (krahaso: *gruan e vëllait madh*); *nusen e vëllait të vogël* ( nusen e vëllait vogël)etj;
- mospërdorimi i nyjës e tek emrat femërorë të gjinores dhe dhanores së njëjësit të shquar si dikur në çamërishten e vjetër p.sh: *ditës e parë* dhe përdorimi në vënd të saj të nyjës së e cila ndër të tjera eliminohet, p. sh: *vajzës bukur, ditës dasmës etj.*

Për sa i përket kategorisë gramatikore të mbiemrit, pak a shumë vlejné të njëjtat vërejtje që kemi përmendur tek emri. Për mbiemrin na ka tërhequr vëmendjen përdorimi i tij në ligjërimin e zakonshëm përpara emrit, duke mbartur kështu një ngarkesë emocionale të madhe, si shenjë e emotivitetit në këtë të folme, p. sh: *të madhe hata që i bëri moj të keqen! Ama të keqe nuse që kish marrë Esmaja?! Të bukur ligjëratë që na ligjërove!* Kjo është një dukuri të cilën nuk e gjejmë në ligjërimin e përditshëm të brezit të ri.

## 7.2. Disa veçori të përemrave

### 1. Përemri vetor

**Përemri vetor në të folmen çame ka këto veçori:**

- i. Veçojmë përemrin vetor të vetës së parë njëjës **-unë**, i cili në emërore del në formën e tij të thjeshtë fonetike, në trajtën arkaike **-û**. Ky përdorim ka qenë i pranishëm pothuajse në të gjithë shembujt e trajtuar deri tani, çka vërteton praninë e padiskutueshme të kësaj dukurie në ditët tona. Lidhur me këtë lloj përemri, shkojmë më tej përmes hulumtimeve tona. Përmendim fillimisht trajtimin që gramatika historike i bën kësaj dukurie, sipas së cilës, forma e hershme **-û** e ka prejardhjen nga një vetor **“sëe”** e indoevropianishtes. Siç është pranuar nga studiuesit, por edhe nga hulumtimet tona, kjo formë përkon me fazat më të hershme të shqipes. Si dokument për këtë shërben libri i parë në gjuhën shqipe **“Meshari”** i Gjon Buzukut, tek i cili shohim praninë e saj, madje që në hyrje të këtij teksti *Û Doni Gjoni, biri i Bdek Buzukut... etj*<sup>447</sup> Po japim disa shembuj konkretë të këtij përdorimi: *û të kam si vajzat e mia tashi; ..û kam qënë nxënës shkollë n'atë kohë; Shkoi n'at fshat q'thom û / n'Dragoj etj.*
- Duke shkuar më tej, këtë trajtë e gjejmë edhe tek disa të folme të tjera, si p.sh.

<sup>447</sup> Buzuku, Gj.: *Meshari*, 1555.

tek të folmet arbëreshe, të folmet arvanitase<sup>448</sup>, si tek disa të folme të anëve të Tiranës, apo në disa dialekte ekstreme të Veriut (në disa të folme të Malësisë së madhe)<sup>449</sup>.

Pavarësisht nga përdorimi i natyrshëm dhe i shpeshtë i kësaj dukurie, nuk mungojnë në këtë të folme edhe disa raste devijimi të saj. Megjithëse ato zënë një vënd mjaft të vogël në përdorim, këtë gjë e vërejmë që tek brezi i vjetër, gjuhën e të cilit e kemi marrë si pikënisje për të të folmen e çamërishtes sot. Pra, ndonjëherë tek kjo e folme gjejmë edhe formën e rregullt *unë* e cila përkon me shqipen standarde: *...unë n'fshat t'Kurtesës kam lindur/ un.....*<sup>450</sup>

Tek brezat e rinj nuk gjejmë aspak formën e shkurtuar të përemrit vetor, ky përemër do të përdoret sipas shqipes standarde, pra në formën e tij të gjatë. Është paksa e çuditshme **bjerrja e plotë** e kësaj dukurie tek brezat pasardhës, **qoftë edhe kur ata kushtëzohen nga rrethana që favorizojnë përdorimin e të folmes së origjinës**, çka tregon se brezat e rinj për disa dukuri tregohen të ndjeshëm ndaj formave arkaike ndërsa disa të tjera përdoren prej tyre si tregues të origjinës, siç është rasti i pjesores *bënë*, parafjalës *ne* etj.

j. Në të folmen e brezit të vjetër ndjehet gjithashtu një përdorim i përzier i trajtës së vetës së parë shumë të përemrit vetor. Atë e gjejmë, si në trajtën shkurtuar *ne*, ashtu edhe në trajtën e gjatë *neve*. E njëjta gjë vërehet edhe për vetën e dytë *ju* dhe *juve*.

k. Të tjera trajta karakteristike që vërehen vetëm tek më të vjetërit në moshë, janë edhe trajtat, *nevet* dhe *na*. ...i mbrojtëm *nevet/ kush pieste për na* ; ..... *ne ia kemi thënë copa-copa...*; ... *dejëm katërbëdhjetë muaj në Delvinë neve*; ...një motër *na ka lind ktu ne dhe një vëlla*.

Përdorimi i trajtave të shkurtuara tek këto shembuj tregon prirje ndaj standardit, ndërsa përdorimi i gjatë i rasave të zhdrejta *neve, juve* është karakteristikë e së folmes, duke mospërrjashtuar edhe të gjitha të folmet e tjera të jugut në përgjithësi. Kështu, përdorimi i varianteve *nevet, juvet* tregon përbashkësi me të folmet e Gjirokastrës. Ndërsa, përdorimi i variantit *-na* tregon përbashkësi me disa të folme skajore të gegërishte, të labërishtes dhe të disa të folmeve arbëreshe të Italisë.

Por kjo rregullsi nuk vihet re vetëm tek trajtat e lartpërmendura. E folmja e çamërishtes shquhet për një përdorim të rregullt të trajtave të shkurtra. Një përdorim i shpeshtë vihet re në prapangjitjen e tyre: *Thuejna! -i thanë ata, nuk ua thom*

Tek më të vjetërit shohim se forma të tilla që tashmë konsiderohen si shkelje në normë nga të gjithë shqipfolësit, të përdoren mjaft saktë. Kështu në përdorimin e trajtave të shkurtra spikat forma e rregullt e trajtës së shkurtër të përemrit vetor (veta e tretë) *u*, p.sh: *u tha djelmet; u thotë babajt e nanës*. **Jo vetëm tek shqipfolësit por edhe tek folësit çamë të brezave pasardhës do të gjejmë format e gabuara : *i tha.... ; i thotë....***

Tek pasardhësit janë eliminuar format e vjetëruara, ndërsa format e gjata të përemrit vetor të përmendura më lart përdoren rregullisht. Për këto të fundit nuk përjashtohet mundësia e huazimit të tyre edhe nga dialekti vendas.

Përdorime karakteristike të së folmes çame janë edhe format e vetës së tretë të përemrit vetor, konkretisht trajtat *ai, ajo, atire, ature*. Sikurse e shohim, dukuritë fonetike brenda këtyre fjalëve që mundësojnë edhe një lloj spikatje të veçantë të këtyre përemrave, i kemi trajtuar hollësisht në kapitullin e fonetikës.

<sup>448</sup> Shih temën përkatëse në punim f, 74

<sup>449</sup> Gjinari, J. & Shkurtaç, Gj.: *Dallimet në inventarin e fonemave*, f. 112, në *Dialektologjia*, shblu, 1997.

<sup>450</sup> Një përdorim të tillë risues e kemi vënë re më shumë tek meshkujt e brezit të vjetër.

Një tjetër dukuri karakteristike është edhe larmishmëria e formave të trajtave të shkurtra gjatë ligjërimit.

Trajtat e shkurtra të dhanores *më, të*, kur bashkohen me trajtën e shkurtër të kallëzores *-e*, dalin në format e tyre përkatëse *m'e, t'e*, p. sh: të *m'e theriç, do m'e març, të m'e damkosni.. m'e mori ka dora, t'e dhashë, t'e thashë* etj.

Gjithashtu përpara trajtës së shkurtër të kallëzores *e*, elidohet zanorja *o* e pjesëzës *do*, e cila vendoset përpara foljeve në lidhore për të formuar kohën e ardhme, p. sh: *do t'e rrahish -d'e rrahish; do t'e marrish -d'e marrish* etj.

Po ashtu, pjesëza *më* e cila vendoset përpara mbiemrave në përgjithësi apo para ndajfoljeve me funksionin tregues të kategorisë së shkallës, më konkretisht, të shkallës krahasore të pabarazisë (të sipërisë relative), si dhe pjesëza *të* e foljes në lidhore, duke u bashkuar që të dyja me trajtën e shkurtër të kallëzores *e*, elidohen: *pak m'e madhe, ishalla t'vete njher t'e shoh at vëndin tim, atje çamërinë*.

Edhe këtu nuk mungojnë bashkëpërkatësitë me të folmet arbëreshe të Italisë dhe të Greqisë, me një ndryshim të vogël që tek këto të folme nuk kemi ndonjë shkrim të trajtës së shkurtër në pozicionin e saj fundor (*mirmë*), ndërsa në çamërishte nuk ndodh kështu, trajta e shkurtër shkrihet pas urdhërores së foljes: *bjerma, tregoma*, përdorimet e të cilave janë të shpeshta gjatë ligjërimit të përdishëm.<sup>451</sup>

Dukuria e mosshkrirjes së trajtave të shkurtra të dhanores me kallëzoren si dhe dukuria e elidimit, janë kaq të forta tek ky brez, saqë ndonjëherë janë trashëguar edhe tek brezi i mesëm. Kësaj radhe me një ndryshim, pasi flitet për **përdorime të natyrshme** të këtyre dukurive, siç kemi folur tek theksi sintaktik dhe jo për përdorime të kushtëzuara nga faktorë të jashtëm, rrethana apo kontekste të caktuara gjatë ligjërimit. Kemi vënë re se folësit nuk mund t'u fshihen këtyre dukurive gjatë ligjërimit edhe nëse ato do të përpiqen të fshihen pas petkut të dialektit të tjetrit apo nëse kërkojnë të përsosin të folmen sipas rregullave të standardit.

## 2. Përemri vetvetor

Nuk gjejmë asnjë gjurmë të formës së vjetëruar *vètëhe* të këtij përemri. Në përshkrimin dialektologjik të prof. Q. Haxhihasanit, gjejmë këtë shembull: *e bëri fukaranë vëlla me vètëhe*.<sup>452</sup> Përdorime të këtij lloji tashmë kanë humbur. Nga të dhënat tona do të kemi: *i kemi rrihtur vetë; se e bijëm bukën vetë ne / gatuajmë vetë; qevërrri ka qen e (edhe) vetë e prrishur n'at kohë*.etj.

## 3. Përemri dëftor.

Edhe tek përemrat dëftorë sikurse tek vetvetori, në të folmen e brezit të vjetër, vihen re larmi përdorimesh të ndryshme, konkretisht: forma të rregullta të përemrit dëftor; forma të hershme të përemrit dëftor; forma me dallime të ndryshme të karakterit fonetik; përemra dëftorë në funksion të mbiemrit etj. psh: *ki(ky), kijo(kjo), kwta, kwto, kta, kto, këtitë, këtija, atitë, atija, këture, kuture, këtire, atyre, atire, ature, këso, aso* etj. ....qepeshim ne(tek) ajo vila; ç'janë këto me rroba t'zeza...; ...na thotë ai mususi nevet/ vate në fshatin tonë kjo vajzë; ... do të iki kijo tani( kijo/këjotrajtë e hershme. ...; të thoshte hëngri kijo s'më fliti mua ; fton burri me këso...me tesxere...; ..i mblodhi kto..burrat atje n'arrest/kish thurur gjith kët zonë...; ishën bërë motra kto., këso stohë të leshtë kishim ne,.. . atje coj gështenja që kish( aso>coj) ,....kto ishin/ kto di un tani.

<sup>451</sup> Haxhihasani , Q: *Vështrim i përgjithshëm mbit ë folmen e banorëve të Çamërisë*, në « Dialektologjia shqiptare », vëll.I,Tiranë,1971, vëll.II,Tiranë 1973

<sup>452</sup> Haxhihasani , Q. Po aty.

Shembujt e trajtuar flasin qartë për një përdorim të përzier të përemrave dëftorë. Ato janë dëshmi e ruajtjeve të shumta si dhe të një orientimi të qartë kah formave të rregullta të shqipes standarde, apo të interferencave të pashmangshme nga e folmja vendase etj. Bëjmë të ditur gjithashtu se ngjyresa ruajtëse pasqyrojnë edhe dukuritë fonetike të pranishme në trajtat e këtyre përemrave.

Në brezat më të rinj spikat përdorimi i drejtë i përemrit dëftorë, por ndonjëherë verehen edhe luhatje të cilat kanë të bëjnë me shkelje në normë: *kto shpia / kto modelet që jan marr/ andej jan marr/lart nga Veriu ...; jooo me(moj) tani kët muaj me raport jan akoma, e kam megjimen kët muhabet etj.*

#### 4. Përemri pronor.

Përemri pronor spikat dendur në përdorim përmes dukurive të ndryshme fonetike, karakteristike për të folmen dhe dëgjuesin, p. sh: *inë( ynë), it( yt), i tire( i tyre), i ture( i tyre), ima( imja), jota( jotja)*. Përdorimi i këtyre përemrave në brezin e vjetër sot është tregues i qartë i gjallërisë që kjo e folme mbart në ditët tona.

Ndërsa, për llojet e tjera të përemrave pronorë, mund të themi se çamërishtja përkon me format e standardit, p. sh: *n'si tonë / u rrahën di kushërinjtë e mi, .. u të kam si vajzat e mia...; sa veta janë ka fshati jonë...; ...i shpij gjith e kush në vënd të tij për të varrosur...; nëna ime thoshte .; jo kjo toka jote / jo kjo toka ime //kijo jota/ kijo ima... .* Vini re shembullin e fundit, të cilin jo më kot e kemi sjellë. Edhe këtu vërejmë atë dukuri fort të spikatur tashmë të dysorësisë në përdorim (sikurse e kemi trajtuar si veçori përmes pjesës më të madhe të shembujve). Kjo do të thotë se, megjithë ruajtjen e madhe që shfaqin moshat e vjetra, spikat ndjeshëm tek këta folës edhe lëkundja midis formave të vjetra të çamërishtes dhe formave të rregullta të standardit. Megjithëse ato anojnë kah origjinës së tyre, është vërtetuar shpesh përmes shembujve dhe prirja për ndryshim.

Tek përemri pronor i emëruar vihet re gjithashtu edhe ruajtja e përdorimit të anasjelltë të kategorisë së trajtës, ku trajta e shquar përdoret në vënd të së pashquarës. Psh: *Në Itali kishte një shtëpi të tijën; Kish një kushërirë të sajën....etj.*

Në brezin e mesëm nuk trashëgohen aspak këto dukuri. Folësit e këtij brezi përdorin më shumë format sipas standardit( një shembull: *siç tregon mamaja ime / nëna( gjyshja) ime/është fejuar e vogël*).

Nuk mund të lëmë pa përmendur edhe ndërfitjet nga e folmja vendase: *t'kam pru i( një) mik i tha/ nipçen tat...// më bëri ca pyetje provokuse babai jot/ thoshte*<sup>453</sup>

Të njëjtat vërejtje vlejnë edhe për brezin e ri.<sup>454</sup>

#### 5. Përemrat pyetës.

Të gjitha dukuritë e dialektit çam, përbashkohen në sajë të disa tipareve të veçanta, të cilat i kasifikojnë ato të veçanta për këdo që i dëgjon dhe të rëndësishme për studiuesin e gjuhës shqipe.

Jo më kot e nisëm me këtë pohim trajtimin e këtij përemri, pasi përemri pyetës spikat për veçantinë dhe për një përdorim të shpeshtë në këtë të folme.

Dy janë përemrat pyetës që na tërheqin vëmendjen më shumë: *ç* dhe *çish* ndonjëherë edhe përemri *çilë*. Format *ç* dhe *çish* herë- herë të krijojnë idenë e ngjashmërisë nga pikëpamja kuptimore, herë – herë të krijohet përshtypja sikur kemi të bëjmë me të njëjtën formë të apokopuar, siç ndodh me formën e apokopuar të tij *çi* shumë e spikatur në të folmen çame.

<sup>453</sup> Folësi në fjalë ( i seksit mashkull) ka ndryshuar në ekstrem të folmen kah bashkësisë pritëse, gjë që s'ndodh me pjesën më të madhe të bashkëfolësve.

<sup>454</sup> Edhe tek ky brez nuk mungojnë rastet ekstreme.

Një tjetër element është edhe lokucioni *me se* (parafjalë+ përemër, se= çfarë), që vihet re dendur në ligjërimin e çamëve.

Po rendisim disa shembuj për të gjitha këto: *ç'rënd të kam/ i tha ...çish thatë? Po ç'i jetë isht kijo? ...marrim këtë ç'i thonë...; ...çish veni/ si jeni...// çish do vemi/ i tha baba...; në çish sene muej i solli burrat? See ... çish do na bën baba / me ç'i do na mbahej? Me se do i bini? Me se do jetoni? Me se e do bukënë? Me se d'e marrish? çila isht e vjemea, çila e sivjemea; çish ke baba i thanë; shikoni çish hanë ata zagarë atje; eee çish thua ti; çila isht nana, çila isht bila etj.*

Siç e shohim edhe nga larmishmëria në përdorim të formave të përemrit pyetës *çish*, semantika e këtij përemri nuk është e njëjtë qoftë edhe brenda së njëjtës formë. Herë e gjejmë atë të barazvlefshme me fjalën *çfarë*, herë me fjalën *qysh* dhe ndonjëherë me fjalën *si*. Kjo gjë flet qartë jo vetëm për një përdorim të shpeshtë të këtij përemri, por edhe për një përdorim të lirë të tij.

Trajtat e vjetra të këtij përemri, *çilë, çili, çila*, si dhe trajta e vjetër e tij *shdo* (e cila vjen nga ndryshimi fonetik i përemrit pyetës *ç* nën ndikimin e bashkëtingëlloreve të zëshme), janë në bjerrje e sipër në të folmen e brezit të vjetër.

Forma e përemrit pyetës *çfarë* nuk ka ekzistuar kurrë në të folmen çame. Kjo formë është e pranishme fare pak sot në të folmen e brezit të vjetër. Megjithëse më rrallë tek brezi i vjetër dhe më shpesh në brezat pasardhës, këtë formë, do ta gjejmë ose në trajtën e saj të rregullt *çfarë*, ç'ka tregon risi në të folmen e tyre kah standardit; ose në trajtën e apokopuar të saj *ça*, çka tregon interferencat e dialektit të tjetrit.

Në brezin e mesëm dhe të ri është e vështirë të saktësosh se cila prej këtyre formave gjen përdorim më të madh. Për sa i përket përemrit *çish*, nga të dhënat tona nuk vërejmë ndonjë përdorim të natyrshëm, përveçse emotiv tek folësit e brezave pasardhës. Kjo formë nuk është lënë aspak në harresë nga folësit e brezit të mesëm, tek të cilët përdoret shpesh i kushtëzuar nga disa rrethana të caktuara, më e rëndësishmja prej të cilave, është komunikimi midis bashkëfolësve të së njëjtës origjinë. Ruajtja e saj vihet re madje edhe në disa raste ekstreme, kur folësit gëzojnë një farë prestigji, në sajë të një arsimimi të detyrueshëm.

Ndonëse brezi i ri **zotëron një njohje të mirë të kësaj forme**, siç është ndër të tjera edhe njohës i mirë i dialektit çam, me vetëdije ka eliminuar dukuri të tilla arkaike të origjinës, duke i zëvendësuar ato me dukuri më të reja, sikurse funksionon sot në çdo të folme a variant krahinor. Por, brezin e ri çam e karakterizon edhe prirja e fanatizmit për gjuhën e të parëve, e ndihmuar kjo prirje nga faktorë të jashtëm të mirëkuptueshëm, për të cilët jemi zgjatuar mjaft në trajtimin që i kemi bërë faktorëve jashtëgjuhësorë.

Ndryshe ndodh me lokucionin mjaft të përdorur *me se*, i cili vihet re tek të tërë folësit e të gjithë brezave. Kjo gjë ndodh sepse ky përdorim qëndron më pranë standardit, madje mund të thoshim i njëjtë me standardin, veçse përdorimi i tij në këtë të folme është mjaft i shpeshtë dhe nuk mund gjejë kurrë përdorim trajta “me çfarë”

## 6. Përemri lidhor

Përemrat e lartpërmendur pyetës *ç, çish; çilë, çili, çila* në të folmen çame përdoren edhe me funksionin e përemrave lidhorë. P. sh: *...i muarrnë vëllezër/ baballarë/ çish kishnë ...; t'u rrojnë gjith sa ç'keni! Çish arrëng( aheng) do të valles ti ...; ...në Janinë e në Paramthi../ ça...ça zuri ai vrau //ç'i zuri vrau/ se në luft kshu isht/ ç'të kapin vritej, shit vaj-e/ shit sheqer e/ ç'i ka duqani të gjitha; çish të më lipset kutu e pesë vjet do m'i sillni; harroi çish kish vënë atje/ nuk kish parë çish kish vënë jati poshtë.*

Këtu përfshijmë edhe trajtat e rregullta *çfarë* dhe *si*, si dhe huazimin e apokopuar *ça* të së folmes tjetër. Ndonjëherë kemi edhe shfaqje të formës së vjetër të përemrit lidhor ***çil*: çil kapi greku i therë**; apo në trajtën e tij të apokopuar, ***çi*: çl zuri vrau**.

## 7. Përemri i pacaktuar

Tek përemri i pacaktuar na bie në sy bjerrja e formave të vjetëruara të këtyre përemrave në të folur. Kështu disa përemra si, ***gjithëçili, shdononjë, akëç, dish, shdo***, kanë humbur sot në këtë të folme. Tek të dhënat tona të viteve '78 gjejmë format ***dish*** (*dish ish*) dhe ***zhdo*** (*zhdo njëri*)<sup>455</sup>

Ai që na bie më tepër në sy këtu, është përemri i pacaktuar ***asnjë***, më konkretisht trajta e veçantë e tij ***asnji***, të cilën e hasim tek të tre brezat. Më parë kujtojmë se ekzistojnë gjithashtu disa trajta karakteristike të çamërishtes së këtij përemri, të cilat spikasin më tepër për dallimet e tyre fonetike dhe si të tilla nuk janë trashëguar tek brezat më të rinj. *P. sh: nōnji, çdon-jeri, asnji. Kùtu ne ( tek) Bashkimi s'erdh nōnji) a erdh nōnji? ....mos bëj shaka me çdon-jeri....;*

Tek folësit e brezit të vjetër forma ***asnji*** shpjegohet me praninë e një tjetër përemri të pacaktuar, me formën e përemrit të pacaktuar ***një***, i cili gjendet në trajtën e tij ***nji*** të çamërishtes tradicionale. Prania e këtij përemri në brezat pasardhës mendojmë se është më tepër ndërhyrje nga e folmja vendase. Kjo mendojmë se ndodh nga prania e madhe në numër e elementeve të huazuara tek këto breza. Ja si shprehet një përfaqësuese e brezit të ri çam sot: ***asnji nga fisi jon se ka vazhdu gjimnazin/ asnji/ asnji se ka vazhduar.*** (*Lubiana, 15 vjeç*).

Lidhur po me këtë përemër na tërheq vëmendjen edhe prania nga ana tjetër e një përdorimi të dyfishtë të tij në brezin e vjetër: *jo /jo s'keshën kaurr asnjë ...; nuku mbaj mënd asnji shtëpi ù që t'ish me tullë..., ...ai nuk na jip neve asnjë të drejt...* Ky është një shembull tipik i cili flet për vetëdijen e folësit ndaj standardit. Një formë tjetër e vjetër e çamërishtes është edhe forma ***tjatër*** (*dergoi një tjatër..*), e cila përdoret më shumë sot në folmet më jugore të shqipës<sup>456</sup>

Nga shqyrtimi që i bëmë përemrit në përgjithësi, vumë re jo vetëm disa forma të veçanta, të cilat nuk i hasim në asnjë të folme tjetër, por edhe praninë e disa përemrave të tjerë, të cilët bëhen mjaft interesante falë dallimeve fonetike të tyre. Lidhur me këtë pohojmë, që nga analizat e hollësishme që i kemi bërë gjuhës së çamëve sot, kemi arritur në përfundimin që pas leksikut, dallimet më të rëndësishme të saj shfaqen në sistemin e saj fonetik.

### 7.3. Numërori

Për sa u përket numërorëve do të vihen re disa karakteristika:

- Për numërorin 1000 (një mijë) përdoret fjala, ***milë*** (për njëjës) dhe fjala milëra (***për shumësin***). Kjo dukuri do të vihet re edhe tek të gjithë ata numërorë që kanë në përbërje numërorin 1000 (një mijë)
- Numërorë të tjerë të rëndësishëm janë: numërori ***dy***, i cili shfaqet në formën ***di*** (si dhe të gjithë ato numërorë që kanë në përbërjen e tyre numërorin dy); numërori ***tre***, i cili ndër të tjera është i veçantë për një përdorim të saktë të kategorisë së gjinisë. Ky është i vetmi numëror që e ka këtë kategori. Për

<sup>455</sup> Këto të dhëna i kemi pasqyruar në fund të mikrovezës, me qëllim që të mund të shfrytëzohen nga studiuesi. Edhe ato në vetvete përbëjnë risi në këtë punim

<sup>456</sup> Totoni, M: "E folmja e bregdetit të poshtëm" në S.F Nr. 2, Tiranë 1964, Instituti shkencor i Historisë dhe i Gjuhësisë.

rrjedhë, kemi numërorin *tre* për gjininë mashkullore dhe numërorin *tri* për gjininë femërore, sikurse dhe në shqipen standarde, p. sh: *di goca ke ti, a tri*; *di motra ishëm ne e një vëlla/ ë ... tri / harrova / ern tre aropllanë*. Në brezin e vjetër gjejmë bashkëpërkime me standardin përsa i takon këtij numërori, gjë që nuk ndodh me brezat pasardhës. Këto breza në vënd që të trashëgojnë formën e rregullt të origjinës së tyre e kanë më të lehtë të hidhen në një formë të parregullt, jo vetëm të dialektit tjetër, por që i përket një forme të gabuar që ka marrë zgjerim të madh tek të gjithë shqipfolësit sot. Pra, si tek të gjithë brezat e rinj sot edhe tek brezi i ri çam vihet re përdorimi i anasjelltë i numërorit tre për gjinitë përkatëse ose eliminimi i formës së rregullt *tri* dhe përdorimi i formës tre për të dyja gjinitë.

## 7.4. Sistemi foljor

Për koherencë, po rimarim edhe një herë disa çështje që lidhen me sistemin foljor. Dukuritë e saj më të spikatura, mjaft interesante të sistemit morfologjik, çamërishtja i shfaq tek folja. Sistemi foljor është një nga sistemet më të ndërlikuara, brenda të cilit gjejmë dukuri me mjaft interes për shqipen. Siç e kemi trajtuar edhe në punimin studimor me temë “*Sistemi foljor i çamërishtes në diakroni*”, tek foljet në përgjithësi na tërheqin vëmendjen temat dhe mbaresat e tyre gjatë zgjedhimit, si dokument i qartë i fazave të kapërcyera të shqipes së hershme. Ndryshimet fonetike karakteristike për këtë të folme i japin ngjyresa të veçanta kategorisë së foljes. Karakteristike për të është edhe këmbimi i kohës së foljeve me njëra tjetrën. Kjo gjë nuk është aspak e re po të kemi parasysh kontraktimet që ndodhin brenda të folmes çame lidhur edhe me dukuri të tjera që nuk i përkasin vetëm kësaj kategorie leksiko-gramatikore.

### 7.4.1. Mënyra dëftore. Koha e tashme e mënyrës dëftore

Në të folmen çame në përgjithësi dhe veçanërisht për kohën e tashme, interes paraqesin të ashtuquajturat folje të zgjedhimit në *mi*: *kam, jam, thom*. Sipas gramatikës historike të gjuhës shqipe, në gjuhën indoevropiane ka patur dy tipa zgjedhimesh, të mbështetura në mbaresën e vetës së parë të numrit njëjës të së tashmes së dëftores: zgjedhimi në *mi* dhe zgjedhimi në *ō* ose *īō*.

Në përgjithësi do të vërejmë se në vetën e tretë folja *jam* nuk del në trajtën e saj *është*, por ajo do të dalë në trajtën *isht* dhe *ishtë*, pra ku herë- herë ë-ja fundore ka rënë. Këtë përdorim e kemi spikatur fillimisht rreth viteve 1978- të: *ú do te dergoj di kobeza mollë / po i njohe çila isht e vjema / çila e sivjema/ nuk do hapim luftë .. ú do te dergoj di pela/ po i njohe çila isht nana çila ishtë bila nuk kemi luftë / drishe do nis luftë; ku isht/ i tha ai / merre selle kutu; ç'ishtë ajo i tha Veizi/ ishtë gugusha e bukrës dheut*.

Edhe pse në këto vite, nuk mungojnë edhe rastet e tilla të shfaqjes së dukurisë së “bilinguizmit dialektal” ( dysorësisë) e cila në kuadrin e të folmeve në kontakt është e pashmangshme, si: *të mari një kazan me ujë e ti hedhi / ajo që të vejë në fund është e sivjeme / ajo që do betej bi ujë është e vjema*.

Në çamërishten e ditëve tona, kemi spikatur përkarshi këtyre trajtave edhe trajtën *ish*, tek e cila kemi një rënie të bashktingëllores *t* gjatë ligjërimit. Kjo, mendojmë se shkaktohet si një kontraktim me të pakryerën, për analogji me vetën e tretë të kësaj kohe që del po në të njëjtën formë. Nga ana tjetër, format *ishtë*, *isht* dhe



*ish* përkojnë me vetën e tretë të së pakryerës së shqipes së lashtë P. sh: *e kemi kutu djalin .../ nuku e di në çish datlindje ish...*; *...nanë moj e shkrreta/ sado nanë isht*.

Arsyet e kësaj trajte mund të shpjegohen edhe përmes analogjisë me disa folje të tjera tek të cilat ka ndodhur ndërrimi fonetik i-ë-së në **-i ( bëj/ bij- bin; është-ishtë-isht -ish)**. Pse jo edhe këto të dhëna mbase jo fort bindese duhet të merren në konsideratë dhe nuk duhen anashkaluar nga gjuhëtarët.

Një tjetër mënyrë arsytimi për vetën e tretë të foljes jam, formën e vjetër të saj, - **isht**, që e gjejmë dendur në të folmen çame është edhe ky: siç e dimë, trajta e hershme e formës foljore **jam** në vetën e tretë, në periudhën e dokumentuar të shqipes ka qenë forma **anshtë** për gegërishten<sup>457</sup>, së cilës në toskërisht i përgjigjet forma e saj gjegjëse **është**. Mirëpo ekziston edhe një arsyetim tjetër, i mbështetur tek ligjet e gjuhës shqipe, sipas të cilit kemi **isht > ishtë > estë**. Pra *estë* është bërë **ishtë**, **-ë**-ja bie dhe do të na mbetet tema **isht** që përkon edhe me formën e vetës së tretë të çamërishtes së sotme. Nëse ky arsyetim është i drejtë, atëherë del se forma **isht** e çamërishtes, ndonëse nuk është më e hershmja, ajo u përket fazave të kapërcyera të shqipes.

Për foljen *kam* nuk vihet re ndonjë dukuri e veçantë. Format foljore të kësaj foljeje përkojnë si me format e dokumentuara ashtu edhe me format e sotme foljore të shqipes. *Ej i tha djali / ç'shikon i tha/ kam treqind vjet q'e kam hedhur purtekën e dufeqin e tani pres t'e bije*.

Për foljen *them* mund të themi se në të folmen e çamërishtes gjallon forma e hershme *thom* e ngjashme me fazat e kapërcyera të shqipes, e cila tek disa folës të brezit të vjetër ruhet ende sot. P. sh: *i thomi katua budrumit neve...*; *...sebeq thomi neve/ u bu një kristian/ seee ka edhe çam kristian atje; ...shkoi n'at fshat q'thom u/ ça t'them u ti ...etj*. Në kohë më të hershme kemi vënë re një përdorim edhe më të ngulitur të saj, p. sh: *në saba grihet u thotë babajt e nanës/ kam parë një nëndër/ u tha / thuejna/ i thanë ata / nuk ua thom*.

Kjo formë është e ngjashme me fazat e kapërcyera të shqipes dhe ndryshimi i ka filluar që me brezin e vjetër. Në shembujt më lart spikasin edhe forma të ndryshme të së njëjtës fjalë (*thom-them*), njëra prej të cilave i përket shqipes së hershme dhe tjetra shqipes së sotme.

Në aspektin sociolinguistik me interes na duket edhe shqyrtimi i foljes **mbaj**. Në përgjithësi, në vetën e parë njëjës dhe shumës, atë e gjejmë pa mbaresën *j*, si dhe me një temë të shkurtuar tek e cila bashkëtingëllorja **n** ka rënë, si dhe me asimilim të grupit bashkëtingëllor *mb: mbaj > ba*. Pra shkurtimisht, *nj*-ja e hershme e cila përfaqëson në një farë mënyre edhe temën edhe mbaresën, ka rënë. Evoluimi i mbaresës për të tashmen ka ndodhur si në mbarë shqipen, me përjashtim të një ndryshimi që ne e kemi vënë re në të dhënat e '78-ës. Në raste tepër të rralla shohim se folja *mbaj* në vetën e parë del me mbaresën **-j**. Mendojmë se **në çamërishte nj**-ja e kohës së Buzukut ka rënë dhe rishfaqja e saj nuk ka të bëjë me evoluimin e *nj*-së në *-j*, por *-j*-ja e këtyre foljeve, është një ndërhyrje nga shqipja e përgjithshme nga kontakti i mëvonshëm midis dy të folmeve.<sup>458</sup>

Të njëjtën gjë vërejmë edhe tek folja *bëj*, që në çamërishte e gjejmë në trajtën **bi ( bij)**. Të njëjtat vërejtje vlejné edhe për foljen **vij**.

Tek folja *mbaj* kemi gjithashtu edhe asimilimin e grupit *mb* në *b* dhe, trajta

<sup>457</sup> Pedersen, Çabej...etj.

<sup>458</sup> Pas shpërnguljes së 44-ës, çamërishtja ishte ruajtur mirë nga folësit e kësaj krahine, siç ndodh në raste të tilla apo siç ka ndodhur me të folmet anësore shqipe të cilat kanë bashkëjetuar dhe vazhdojnë të bashkëjetojnë nën trysninë e një gjuhe tjetër. Me shpërnguljen e çamëve në Shqipërinë shtetërore tashmë ajo u gjend përballë një shqipeje të evoluar.

karakteristike e foljes *mbaj* për të tria vetat e njëjësit, në çamërishten e sotme është forma *ba*. Për të qenë më bindës po rendisim disa shembuj: Ç' *bën?* – *I tha djali, – ja bi* (bëj) *dru, -i tha.*<sup>459</sup>; *E ba* (mban) *mend Durdul ku u ka qorruar babai?*; *Uaa! -tha Moskovi, me shtatë vetë do bi* (do bëj) *luftë ki (ky) me mua?*<sup>460</sup>; *Të bjell* (mbjell) *spinaq me surratin tënd në sabah e të bi* (bij/ bëj) *bureq në aksham...* *Ja ba* vesh/ *tha kali djalit/ tani do biç prapë çish të then ti; ...edhe u me ti do vi i tha ai burri; ç' bën i tha djali/ ja bi dru i tha / ku i merr dot ti/ i tha djali/ ke të më veç nja di akoma/ i tha ai.*

Folja *mbaj* bën pjesë në grupin më të madh foljor të gjuhës shqipe, tek foljet që dikur dilnin me temë në *n*. Në kohë të hershme, si të gjitha foljet e tjera të këtij grupi kjo folje ka qenë me temë në *n* edhe në vetën e parë ( sikurse ato dalin në dy vetat e tjera të njëjësit). Kështu duke ndjekur evoluimin e formave hap pas hapi, për njëjësën do të kemi: (unë) *mban*+ *iō* ( mbaresë e indoevropianishtes). *Ō-* ja përgjithësisht ka rënë dhe *i*-ja ka dhënë *-j*: *mbanijō*> *mbani*> *mbanj*> *mbaj* ( sot). Më konkretisht, në çamërisht: *mbanijō*> *mbani*> *mbanj*> *banj*> *ba*. *Nj*-ja e cila luan rolin e temës dhe të mbaresës njëkohësisht, bie. Në këtë mënyrë mbetet forma e thjeshtuar *ba* për të tria vetat e njëjësit.

Vijojmë më tej: në gjuhën e sotme çame, për tri vetat e shumës, kemi sipas radhës trajtat, (m)*bamë*, (m)*bani*, (m)*banë*. Po t'i krahasojmë këto trajta, me trajtat e shqipes së hershme, *mbanjëmë*, *mbani*, *mbanjënë*, arrijmë në konkluzionin se, nuk ka rënë vetëm *nj*-ja e vetës së parë njëjës dhe shumës, por edhe bashkëtingëllorja *n* e këtyre vetave, sikurse ka ndodhur me vetën II/III të njëjësit. Duhet të kemi parasysh që kemi të bëjmë me një të folme të vjetër, prandaj edhe në arsyetimin e mësipërm, jemi mbështetur sipas të dhënave të gramatikës historike dhe nuk i jemi përmbajtur aq sa duhet të dhënave të gramatikës së sotme shqipe, sipas së cilës bashkëtingëllorja *n*, të cilën më lart e kemi trajtuar si pjesë të temës, konsiderohet pjesë e mbaresës foljore (për kohën e tashme të dëftores kemi: *-j, -n, -n/-jmë, -ni, -jnë*). Pra, kemi një zhvendosje të vijës së kufirit të morfemave dhe *n*-ja e temës së dikurshme ka kaluar me funksionin e mbaresës ( në shqipen e hershme flitet për *n*-në e vetës së tretë njëjës tek grupi i foljeve që dalin me temë në *n*, e cila më pas është përgjithësuar në shumës.

Përkrah përdorimit të trajtave të tilla të vjetra foljore në ditët tona, nuk mungojnë edhe rastet e dysorësisë në përdorim, të cilat janë dëshmi e pashmangshme e inovacionit gjuhësor. Kështu në brezin e vjetër ndonjëherë kemi shfaqjen e *n*-së fundore të temës në vetën e dytë dhe të tretë njëjës, si edhe praninë e mbaresave të shumës dhe të vetës së parë njëjës. Në këtë mënyrë nuk mungojnë në ligjërim trajta të tilla si: (m)*baj*, (m)*ban*; (m)*bajmë*, (m)*bani*, (m)*bajnë*. *E ban mën mirë ai at histori.*

Të gjitha format e hershme të trajtuara deritanimë të sistemit foljor nuk gjenden tek brezat pasardhës. Trajta e vjetër *isht*, në ligjërimin e brezit të mesëm shfaqet vetëm e kushtëzuar nga rrethana të tilla në të cilat folësi është i detyruar të përdorë dialektin e origjinës. Megjithatë edhe një herë theksojmë se, folësit e brezit të mesëm janë njohës të mirë dhe përdorues të mirë sipas rrethanave, ndërsa brezi i ri është vetëm njohës i mirë i së folmes së çamërishtes..

Ndryshe nga foljet e lartpërmendura, foljet e tjera të po këtij zgjedhimi marin rregullisht mbaresën *-j*: *hij, klaj, pënoj, lëftoj, thiej* etj.

Nëse do të bënim një krahasim me të folmet më të hershme, kryesisht ato arbëreshe a arvanitase si dhe me të folmet e autorëve më të vjetër, do të shohim se atje ruhet ende mbaresa e hershme *nj*, ndërsa në të folmen çamërishtes ajo bie dhe, për më tepër, kemi rimarrjen e fonemës *j*, për të cilën mendojmë se është inovacion. Por nga

<sup>459</sup> Nga përralla “ Plaku dhe plaka”, 1978

<sup>460</sup> Nga përralla “ E bukura e dheut”, 1978.

ana tjetër për përdorimin e tingullit grek X që në shqipe reflekton në trajtatë ndryshme shohim se çamërishtja është më arkaike.

Foljet e zgjedhimit të dytë, në shumës marrin mbaresat *-ëm, -ni, -ën*: *pjesëm, pisni, pjesën; presëm, prisni, presën; marrëm, mirrni, mirri/marrën; flasëm, flisni, flasën; flasën shqip edhe sot flasën shqip ata*. Edhe pse një e folme krahinore, tek foljet e zgjedhimit të dytë në brezin e vjetër çam ndjehet dysorësia në përdorim e trajtave me *t/s* si në mbarë shqipen e përgjithshme. P. sh: *godis* dhe *godit*, *fus* dhe *fut*, *kupus* dhe *kuput*, *godisim* dhe *goditim*, *kupusim* dhe *kuputim*, *piesim* dhe *pietim*, *rrisim* dhe *rritim* etj.

Një formë e veçantë që gjendet vetëm tek të moshuarit sot është prapangjitja e pjesësëz *te* tek folja *bëj, vij* të cilat marrin formën *bite, vite*. Dikur këtë pjesëz e merrnin shumë folje, përkatësisht ato njërrrokëshe, në vetën e parë të kohës së tashme dhe të kohës së ardhme të mënyrës dëftore. Sot kjo dukuri gjendet shumë rrallë.

#### 7.4.2. Koha e pakryer e mënyrës dëftore.

Në sistemin foljor ajo çka meriton një studim të hollësishëm më vete, janë mbaresat foljore në tërësi. Që në studimet e hershme dialektologjike, nga studiues që janë marrë me këtë çështje, mbaresat paraqiten tejet të paqëndrueshme. Një përshtypje të tillë na lë tërë sistemi foljor, po të shohim kontraktimet e shumta të kategorive gramatikore të, kohës, vetës, numrit, zgjedhimit, diatezës etj. Gjithçka të jep përshtypjen e një sistemi aspak të qëndrueshëm e, megjithatë, gjatë një studimi të hollësishëm që kemi bërë, vërejmë që edhe ky sistem vërtitet rreth disa rregullave. Në të ne dallojmë qartë foljet, sipas llojit, formës, diatezës, zgjedhimeve, mënyrave dhe kohëve të ndryshme. Mendojmë se të shpeshta në çamërishte kanë qenë përdorimet me kuptime të caktuara foljore pavarësisht formës së tyre. Pra, në formë foljet mund t'i përkisnin një kohe të caktuar, ndërsa në kuptim një kohe tjetër. Këto përdorime të cilat nuk mund t'i shmangim dot edhe në shqipen e përgjithshme, kanë qenë shumë të shpeshta në të shkuarën në çamërishte: *të veni dhe të vini shëndoshë* ( lidhore me kuptimin e dëshirores).

Nga krahasimi i teksteve të 1978 – ë, me tekste nga çamërishtja e sotme, me evoluimin e gjuhës ne vëmë re që përdorimet e mësipërme kanë marrë një trajtë të çrregullt, sigurisht duke u favorizuar nga faktorë të jashtëm të ndikimit për rrjedhojë të ndryshimit të së folmes. Koha e pakryer është më problematike në këtë drejtim. Ajo çfarë na tërheq vëmendjen tek e folmja e çamëve lidhur me këtë kohë janë mbaresat e shumësit. Nëse dikur në çamërishte mund të bëje një ndarje të foljeve duke u nisur nga mbaresat që ato merrnin, sot është tepër e vështirë në të folmen çame të bësh një identifikim të tyre sipas zgjedhimeve përkatëse.

Përsa i përket njëjësit të kohës së pakryer, e folmja çame në përgjithësi ka evoluar më shumë. Vihet re një lloj orientimi nga format e standardit, me përjashtim të ndonjë ruajtje në disa fjalë të veçanta lidhur me këto mbaresa.

Në përgjithësi dukuritë ruajtëse spikasin më tepër tek foljet e zgjedhimit të dytë, përkatësisht në vetën e parë dhe të tretë njëjës. Kështu, foljet *pyes, flas, marr, hap* etj., në vetën e parë të kohës së pakryer dalin në format e tyre përkatëse, *pjesi, flasi, marri, hapi*. Ajo çka vërejmë është se, temat e këtyre foljeve mbeten të pandryshuara si në shqipen e hershme (format e sotme të këtyre foljeve për të pakryerën janë: *pyesja, flisja, mirrja, hapja* etj).

Mbaresat *-i* e çamërishtes mendojmë se shpjegohet përmes analogjisë me mbaresën *-i* të shumësit. Ndërsa veta e tretë e këtyre foljeve përkon me vetën e tretë të njëjësit të shqipes së hershme, p.sh: *se mi:rr dot ajo..., ..s'di:l ajo e fejuara...:...i*

*përci:ll./ duheshin po s'vi:n milt (miqtë).*

**Edhe tek kjo kohë ndodhin shumë kontraktive.**

**Koha e pakryer** sikurse e kemi dëshmuar 10 vjet më parë në temën e diplomës<sup>461</sup>, preket më shumë nga kjo dukuri. Rrallë mund të ndodhë që ajo të përdoret saktë tek më të moshuarit: *Ikë e ikë/ e gjen një burrë që dizet mulli bluajnë (bluante) e dizet furra pijnë (piqte)/ e ai nuk gopej/ lëpin (lëpinte) fillaqinë e mullirit // çbën more / i tha djali / ha/ sh'nuk gopej (ngopesh, forma joveprore) mor derr i tha / që dizet mulli bluajnë (bluan) e dizet furra pjekin (pjek) // mos ke nonjë copë t'më japiç.*

Nga këto shembuj vërejmë që foljet *bluajnë* dhe *pijnë*, përdoren në të njëjtat forma edhe në të tashmen. Folja *gopej* e vetës së tretë, që është në formën joveprore është një përdorim i saktë, ndërkohë që më poshtë, e njëjta formë përdoret edhe për vetën e dytë njëjës. Për foljet e vetës së tretë të së pakryerës nuk gjejmë aspak gjurmë të formantit *-t* indoevropian, si dhe mbaresën e re të shqipes *-(n)te*. Kjo do të thotë që kemi të bëjmë me një fazë të kapërcyer të shqipes e cila dëshmohet edhe sot, p. sh: *Erdhi nek ai qe vëzhdrin (vështronte) përpjeti / një grusht lira edhe atij ; ai breti kish një mall mërguarë edhe bum ktë copëzë shtëpi.../... qi ish kaq e bukura/// o merre selle bërna / vete bërna/ e she gjithë ata që duej (donte) ajo// Djali pa gënë pa pirë / atje ai// ka ligësia ajo/ kur i shpi (shpinte) bukën i jati asaj / ajo i lli (linte) ka një çikë pjesë të haj (të hante) breti.*

Mjaft interesante duket forma e së pakryerës *duaj* (donte), pasi nxjerr në pah edhe një herë përdorimin e shpeshtë të togzanorit *ua* në këtë të folme.

Në të folmen çame na tërheqin vëmendjen mbaresat e shumësit të së pakryerës. Në përgjithësi mbaresat e shumësit të së pakryerës në të folmen e çamëve sot janë: *jëm, jët, jën*, për foljet me temë në zanore dhe *ëm, ët, ën*, për foljet me temë në bashkëtingëllore. P. sh: *...edhe kalamajtë në lum i hidhën / që s'do hidhën lekat// nuku thirrëm nonji neve kur prisëm rrobat e dhënërrit/ prisjën rrobat e dhënërrit...* (vini re dysorësia në përdorim); *... e bijëm bukën vetë/ gatuajm(ë) vetë// bëjën bukë të mira aqhere...; ...me ushqim që hajëm rrugës ...; ....kalojm me lundra;... me hi lajëm/ na lajën nanat në darkë aq morr zijëm...;...dojëm të hajëm...*

Pavarësisht këtyre shembujve, nga të dhënat tona të viteve 78-të, por edhe në çamërishten e sotme, në shqyrtimin e shumësit vërejmë se *ë*-ja fundore ka rënë, *nj*-ja ka rënë. Kjo e fundit është zëvendësuar në rrjedhë të viteve me *j*-në e shqipes së përgjithshme, ndërsa *ë*-ja e theksuar ka dhënë *-i* si në mbarë çamërishten. Pra, tek disa folje vërejmë tingullin mbështetës *i* midis temës dhe mbaresës së foljes, p.sh: numri njëjës (unë) *bija*, (ti) *bije*, (ai/ajo) *bi*/ (ne) *bijim*, (ju) *bijit*, (ata) *bijin*.

Nëse do të shkonim përsëri më tej në kohë dhe të bënim një krahasim me mbaresat e hershme të shqipes, arrijmë në konkluzionin se mbaresat e mësipërme foljore nuk janë asgjë tjetër veçse ruajtje apo evoluim i këtyre mbaresave. Në të dyja rastet, mbaresat e çamërishtes qëndrojnë më pranë formave të vjetëruara sesa mbaresat e sotme të shqipes së përgjithshme.

Kështu mbaresat e shumësit të së pakryerës së hershme kanë qenë: **-(i)më** (**-mos/-mes** e indoevropianishtes), **-(i)të** (**-tha** e indoev.), **-(i)në** (**-nti** e indoev.) E folmja çame sot është një dokument me vlerë e këtyre mbaresave që vertetohet përmes dukurive të ndryshme. Në rastin tonë një dukuri tipike është prania e zanores *i*

<sup>461</sup> Studimi për të folmen e çamërishtes ka nisur që më 1997, temë kjo e këshilluar fillimisht si një detyrë e thjeshtë kursi nga **prof. Gjovalin Shkurtaç**, duke vijuar më pas si një temë diplome e suksesshme. Gjithmonë nën udhëheqjen dhe nxitjen e e profesor Shkurtaç vazhduam me të njëjtën temë edhe për mbrojtjen e mikrotezës për gradën "Master në gjuhësi" më 2003. Gjatë kësaj pune parashtruam një varg idesh të reja që kërkonin zgjidhje.

tek disa folje ende në ditët tona, p.sh: *vejim në mal / mbledhim gështenja; marrim tërrnite ne pastaj/ marrim bagla dhe i nëmitim.. / ..i bëm si çimento dhe i lyejtim ato etj.* Nëse do të veçonim foljen *gatuajm(ë)* nga shembujt e mësipërm, forma e saj nuk është asgjë tjetër veçse evoluim i gjuhës në të cilën zanorja *ë* ka rënë, veçse me një ndryshim të vogël, këtu kemi të bëjmë me kohë të tashme.

Mjaft interesante për këtë kohë janë edhe foljet e zgjedhimit në **mi: kam, jam, thom.**

Në të dhënat për çamërishten, kemi vënë re përdorimin e formave më të hershme të trajtave foljore që shqipja ka dokumentuar deri tani. Kështu për të pakryerën kemi trajtat: *jasha, jasha, ish/ jeshëm, jeshët, jeshën; kasha, kasha, kish/ keshëm, keshët, keshën.* Nëse i krahasojmë këto trajta me çamërishten e hershme, janë po të njëjta, me përjashtim të vetës së tretë shumës. Vini re: *jeshën/ ishnë; keshën/ kishnë.* Po japim disa shembuj të këtyre trajtave: *...dokumentat i kish e motra/ po nuku e kish vajzë në pashaportë ajo.....; ... ish më mirë...; .. e rrëmihë ish...; jeshëm e vashëza të tëra ..; keshën vrarë pësaj...;.. në dasmëra atje kasha qejf të shōje (shō(h), shomi, mendojmë se përdoren për analogji me trajtën e vjetër thomi).....; .....kur keshëm neve të vajzës nuku thirrëm nōnjë neve.....; kadife i keshëm ./tumene keshëm / me tumene jeshëm ....; tri –kat dit jeshëm pa ngrënë ....; ..di orë jeshën larg...;.. ne jeshëm më pak / ata grejt ishnë më shumë ...; duhej t'ish greku siprazi / çamt t'ish poshtë ; ...thoshi ù me vehten time.*

Përdorimi i këtyre foljeve me format përkatëse të vetës së tretë, mendojmë se bëhet për analogji me vetat e tjera: *jasha, jasha, ish/ jeshëm, jeshët, jeshën ; kasha, kasha, kish/ keshëm, keshët, keshën.* (këtu i referohemi temës foljore). Gjithashtu nuk përjashtohen raste të tilla të shumës, në të cilat *ë*-ja mbështetëse ka rënë: *jeshmë, jeshët, jeshnë/ keshmë, keshët, keshnë.*

Nga njëra anë mendojmë se kjo gjë mund të ketë ndodhur si pasojë e evoluimit të kësaj të folmeje, mirpo duke u nisur nga fakti, që nuk ka rënë *ë*-ja fundore që ndër të tjera është edhe e patheksuar, por *ë*-ja mbështetëse, e cila sipas gjuhëtarëve nuk është e patheksuar pasi në shqipen e përgjithshme është ruajtur, mendojmë se ky përdorim duhet shqyrtuar më tej.

Një dukuri tjetër, që ndër të tjera, konsiderohet nga ne mjaft e rëndësishme është edhe përdorimi nga më të vjetërit i **mbaresave foljore të formës joveprore në vënd të formës përkatëse vepore.** *...vineshin katër pes kaurrë që rrinë në fshatin tonë...; ...nuku duhej Mehmet Shehu t'na pranoi...; vinej vahti .../ kur vineshin që niseshin.../ e ngriheshin ikin vejin në dasmë .../.. vinej nusa pësaj...; atje vineshin ushtart e vrarë*

Përveç këtyre përdorimeve, që flasin për ruajtje karakteristike të së folmes çame me mjaft rëndësi edhe për shqipen, tek e folmja e brezit të vjetër vërejmë tek-tuk edhe ndonjë ndryshim të vogël që anon kah formave të rregullta të standardit, apo të folmeve të bashkësive vendase, p. sh: *ku dilte grua ka të Kavajës përjashta/ me ferexhe kur dilshin/ me perçe...* Vini re tek ky shembull foljet *dilte* dhe *dilshin!* Tek forma *dilte*, kemi praninë e mbaresës së sotme të vetës së tretë **-te**, ndërsa forma **dilsha** si dhe të tjera përdorime si kjo (*pënoshim, kërkoshim* etj) flasin qartë për interferencë nga gjuha e bashkësisë pritëse të Shqipërisë së Mesme, në të cilën ato janë vendosur.

Megjithatë, pavarësisht se folësit çamë kanë të pranishëm në kompetencën e tyre format e vjetëruara, nuk mendojmë se përdorimet në fjalë kanë të bëjnë me këtë fakt. Nëse do të ishte e mundur një gjë e tillë, do të ishte tepër interesante, por prania e pakët e këtyre foljeve, si dhe rritja e këtij numri në përdorim tek brezat pasardhës, tregon se ky formant është tregues i qartë i interferencave nga e folmja e bashkësisë

pritëse.

Tek më të rinjtë e brezit të vjetër, vihet re ndonjëherë, edhe ndonjë përdorim i rregullt i foljeve gjysmëndihmëse. Pra, në disa raste vërejmë përdorime dysore të trajtave foljore, ku përkarrshi formave të hershme, përdoren edhe format e reja sipas shqipes standarde: *isha, ishe, ishte/ ishim, ishit, ishin; kisha, kishe, kishte/ kishim, kishit, kishin.*

Ruajtjet në brezin e mesëm për kohën e pakryer, lidhen me disa rrethana të caktuara në kontekstin e të cilave ndodh ligjërimi. Shembulli që kemi sjellë, tregon që folësi përdor mbaresat e vjetra foljore të së pakryerës, në çastin që ai ritregon ndonjë histori të rrëfyer më parë prej të moshuarve, p. sh: *ishëm/ tha/ duke ngrënë bukë/ ishëm ulur// kishëm ulur sufranë /suфра i thoshin/që uleshin të gjithë// kishën bërë shumë gjellë dhe po hajën në qetësinë e tyre ..etj*

Pasi e kemi analizuar mirë këtë shembull, çamërishtja e saj nuk tingëllon kurrë si çamërishtja e të parëve. Pra, në këtë mënyrë ajo mbetet thjesht një njohëse e mirë e së folmes çame, por jo një përdoruese e mirë e kësaj të folmeje (vini re temën e foljeve përkatëse). Për sa i përket kësaj kohe, brezi i mesëm anon më tepër kah norma letrare. Kjo flet për një ndryshim shumë të madh që gjuha ka pësuar tek këto folës. Tek ky brez nuk mungojnë edhe ndërhyrjet nga dialekti vendas.

Një vënd të rëndësishëm zë përdorimi i trajtave foljore të së pakryerës tek brezi i ri në të cilat në përbërje të mbaresave të tyre kanë fonemën **sh**. P. sh: *dasmat më përpara u bëshin kshtu: njerëzit tanë e kërkoshin .....ku i shifshe athere.....etj.* Edhe tek ky brez do të gjejmë të njëjtat ndërftje. Megjithë përpjekjet e tij të pareshtura për të përmirësuar të folmen, vini re zëvendësimin e trajtave foljore tek folësja e brezit të ri: *në atë kohë shihej biografia../ siç shifej biografia dikur ktu...; ..gratë rrishin brenda / burrat përjashta ...nuk e shikoshin nusen burrat ....drisa e merrshin vesh.* Megjithatë, pavarësisht nga këto interferenca, tek folësit e rinj vihet re një përdorim i rregullt i foljeve në të pakryerën: *Probleme kishim me vendasit../ problemi u kishte ngrit gjithandej/ se ishte vetë sistemi që i kishte ngritur çamët goxha /// kur ishim në shkollë / unë thoja që jam çame // kur thoja/ unë jam çame/ ato ja bënin/ uaaaa/ku ka çam kshtu si ty// ndërsa unë i thoja/ por unë ndonjë t'shëmtuar çame nuk njof..etj*

#### 7.4.3. Koha e kryer e thjeshtë e mënyrës dëftore

Mbaresat foljore të njëjësit të së kryerës së thjeshtë në përgjithësi përkrijnë me ato të standardit të sotëm. Megjithatë, tek folës të zonave të caktuara edhe tek njëjësi vihen re disa bashkëpërkime me forma të shqipes së hershme. Kështu vërehen trajtat: *kleva, kleve, kle, pava, pave..etj.*

Për njëjësën e së kryerës së thjeshtë të foljes *jam* vërejmë gjithashtu të pranishme dukurinë e asimilimit të grupit bashkëtingëllor *kl* në *q*. Kjo është një dukuri të cilën e hasim mjaft edhe tek autorët e vjetër, Buzuku, Bogdani.

Për sa i takon foljes *thom*. Vetës së parë i përgjigjet forma foljore *thashë> thaçë* dhe vetës së dytë forma *the*. Në çamërishte pra për këtë kohë janë ruajtur trajtat e hershme të aoristit sigmatik, por në këtë të folme *sh-ja* e aoristit sigmatik në bashkëveprim me temën ka dhënë ç. Kjo është ndër dukuritë më të spikatura të çamërishtes, të cilën e gjejmë jo vetëm tek foljet e kësaj mënyre ( ato janë mjaft të pranishme edhe në lidhore). Po rendisim disa shembuj për secilin rast:

*Ja shih more arap, i thotë e bila hoxhës/ foli edhe ti e hamallos edhe ti/ se mos qesh edhe ai/ se po kle zoti inë/ ka një dhëmb të florimtë në golë.*

*Në saba grihet u thotë babajt e nanës / kam parë një nëndër u tha / thuejna i thanë ata/ nuk ua thom.....Kam parë një nëndër*

*Kam parë një nëndër e nuk ja thaçë gjithëve / nuk ua the/ mua do t'ma thesh/ po edhe breti nuk i tha hajr etj.*

Tek format e numrit shumë gjejmë një bashkëpërkim midis çamërishtes dhe formave të hershme të dokumentuara. Përkrah mbaresave të së kryerës së thjeshtë të shqipes së sotme (**ëm/ më/ m; ët / të/ t ; ën / në/ n**), tek e folmja e çamëve përdoren edhe mbaresat e hershme të shumësit, përkatësisht: **-më, -të, -në**, p.sh. vini re këto mbaresa: *Bagtin e muarrmë me vete...; ...kur i muarrnë vëllezër/ baballarë çish kishnë ...; ...na nxuarrnë matanë ....; kur duallm në rrugë të Konispolit murrm(ë) veten vetë...; duallm përjashta....; ..më përpara që vranë atje vranë atë..vran një plak/ e thertënë/ e vartën në fikt në Kaicaj...; ...hecëm mirë neve ./ folnë nja dy ushtarë.....; ....vranë / por nuku vranë.../ kur ikmë neve u bë kërdua...; ...mbenë pësaj jetimër..etj.*

Prania e këtyre shembujve, na çon në përfundimin se, kjo e folme ruan ende mbaresat e hershme të shqipes, por që nga ana tjetër, nuk janë të vetmet që përdoren nga folësit e brezit të vjetër; sikurse e thamë, përkrah tyre gjejmë edhe mbaresat e së kryerës së thjeshtë të shqipes së sotme. Siç shihet nga shembujt, edhe diftongëzimi i zanores **o** në **ua**, i përfutur nga apofonia, është një tjetër argument i rëndësishëm. Ai shkaktohet tek foljet që dalin më **-l, -ll, -r**, para mbaresave të shumësit të hershëm dhe trajtohet në këtë të folme si dukuri ruajtëse.

Në veçanti mund të trajtojmë foljen **vete**, të cilën në të folmen çame e gjejmë përkatësisht në trajtat: **vata, vate, vate/ vati; vamë, vatë, vanë**.

Në punimin dialektologjik kushtuar të folmes çame të prof Q. Haxhihasanit<sup>462</sup> foljet, *shoh, jap, bie, thom*, në vetën e parë njëjës dalin në trajtat e tyre sigmatike, *paçë, dhaçë, raçë, thaçë*. Këto forma i gjejmë edhe në të dhënat e viteve '78-të. Sot në brezin e vjetër përkrah këtyre trajtave përdoren edhe format e rregullta të shqipe, *pashë, rashë, dhashë, thashë*.

Nuk duhet të anashkalojmë në këtë brez edhe praninë e disa trajtave paralele kryesisht arkaike si: **kleva/ qeva**: qeshë , **qeve/ kleve, kle/ klemë, kletë, klenë dhe pava/ pave** : pashë. Trajta **kleva kleve** etj është një trajtë e hershme e cila gjendet tek Liku, Reinholdi, arvanitasit, arbëreshët, e folmja e Buzukut etj, ndërsa trajta **qeva, qeve** , që e gjejmë sot në çamërishte është mjaft interesante, pasi kjo formë përbën risi në këtë të folme konkretisht ka të bëjë me një zhvillim të brendshëm të saj

Tek folësit e brezit të mesëm, nuk hasim ndonjë rast përdorimi të hershëm të së kryerës së thjeshtë siç ndodh me brezin e vjetër. Pra, për folësit e këtij brezi, mbaresat e shumësit, dukuria e apofonsë dhe gjithçka sa përmendëm më lart janë krejt të huaja në ligjërim. Kështu megjithëse në të folmen e tyre është e pranishme folja **vete**, në asnjë lloj rasti nuk gjejmë tek këto folës format e vjetëruara **vata, vate, vate/vati; vamë, vatë, vanë**. E njëjta gjë ndodh edhe me foljen **jam**. Ajo shfaqet me trajtat e saj të zakonshme, *qeshë, qe, qe/ qemë, qetë, qenë* etj.

Tek e folmja e brezit të vjetër vërejmë që do të marrin mbaresën **-i** disa folje të cilat në vetën e tretë të së kryerës së thjeshtë në të folmen e çamërishtes dalin pa mbaresë. Mbeturina të kësaj dukurie do të gjejmë ende në brezin e ri çam sot tek disa folje të veçanta, siç është rasti i foljes **vdes** të cilën tek shumë folës të këtij brezi e gjejmë në trajtën (ajo) **vdqi**. Nga ana tjetër, theksojmë edhe një herë se këto përdorime kanë të bëjnë me zhvillime të brendshme të së folmes që vihen re që me brezin e vjetër. Tek ky brez ato shpjegohen me përpjekjet e ndërgegjeshme të folësve për të rregulluar format e fjalëve sipas normës, pra për analogji të vetës së tretë të atyre foljeve që dalin me të njëjtën mbaresë. Mirëpo kjo dalje jashtë “normës” të së

<sup>462</sup> Haxhihasani, Q: *Vështrim i përgjithshëm mbi të folmen e banorëve të Çamërisë*, në « Dialektologjia shqiptare », vëll.I,Tiranë,1971, vëll.II,Tiranë 1973

folmes së tyre në brezin e vjetër shohim që është trashëguar brez pas brezi dhe është ngulitur aq shumë, saqë neve na duket se kemi të bëjmë me një dukuri të çamërishtes, por që nga ana tjetër bëhet fjalë kryekëput me një zhvillim të brendshëm të së folmes çame.

Një tjetër zhvillim i brendshëm konsiderohet prej nesh mbaresa **-vi** e vetës së tretë, për analogji me dy mbaresat e para të së kryerës së thjeshtë: **-va**, **-ve** të foljeve me temë në zanore Edhe kjo e fundit është e pranishme në të tri brezat, për më tepër, në brezin e ri ndodh që, duke përdorur si të rregullt një trajtë të tillë, ajo shtrihet padashje edhe në shumës (pra mbaresat shtrihen edhe në shumës), konkretisht, *bleva*, *bleve*, *blevi/ blevëm*, *blevët*, *blevën*. E njëjta gjë ndodh edhe për foljet e tjera, *bëra*, *bëre*, *bëri/ bërëm*, *bërët*, *bërën*. Këtu saktësojmë edhe diçka tjetër, që, këto përdorime janë karakteristike vetëm për folësit çamë. Për të folmet e bashkësive pritëse këto trajta janë krejt të huaja. Sigurisht përkrah tyre përdoren edhe format e standardit të sotëm letrar.

#### 7.4.4. Koha e ardhme e mënyrës dëftore

Për **kohën e ardhme**, vërejmë se nuk shfaqet pjesëza *të* (me ndonjë përjashtim të rrallë, siç është rasti i trajtës së eliduar). Folja *them* p.sh, në kohën e ardhme bën, *do them*, në vënd të formës së saj të rregullt, *do të them*, kështu kemi përkatësisht: *do thesh*, *do thetë/ do themi*, *do theni*, *do thenë*. Shembuj të tjerë: *do sillni*, *do lemë*, *do ikni*, *do hapet*, *do veç* etj.

Karakteristike shfaqet gjithashtu edhe e ardhmja e së shkuarës, p. sh: *do vii* (do vente); *do lii* (linte); *do marton* (martonte) etj

Për këtë arsye edhe argumentimi sipas gramatikës së Akademisë së Shkencave se e ardhmja formohet nga folje në lidhore plus pjesëzën *do* nuk mendojmë se është i saktë. Ndoshta do të ishte më mirë të thonim nga pjesëza **do të** plus një folje në dëftore siç e kemi mësuar edhe ne në fëmijërinë tonë të hershme.

Një tjetër dukuri për këtë kohë është edhe ajo e **aoristit sigmatik** në vetën e dytë njëjës, që është karakteristike edhe për lidhoren: *po të hedhiç nigjah...*, *të biç*, *të viç*, *të deç*, *të theriç*, *të sjelliç*.

Po japim disa shembuj në përgjithësi: *Kam kohë që më ka zënë agusa ( sikleti, halli)/ e do dal në bretëri të tjera; hajde tani Durdul se do dalim bashkë një herë i tha breti..; do vete u tha djali madh; do vete u tha djali mesëm ; do vete u tha i vogli; tani/ tha kali do më bāç vesh mua; këtë do njohiç për zot. Po më munde do më xeriç sitë, po të munda do të krej di sitë. Hënëza në krahun e djathët / do maç vajzën time / diellin në krahun e mënjër do maç vajzën e Moskovit// ku do veç/ i tha breti / do vete të marr vajzën e Moskovit i tha//do më japiç shtat mushka// Breti që erdhi ka gurbeti do marton djalën e madh// ù do shkoj një vërdallë Saraive e do hegëllij/ ajo do dalldisi / ti ti hedhiç dorën në feste e t'ja maaç ( marrish)/ se ù do higëllij aq fort/ sa do bien podhet e shtëpisë bedhe ( mbedhe> mbidhe,- përtokë); Pse e xore në mejdan ti / i tha kali, tani do biç prap çish të then ti / ëë .../tha djali / tani do veç ka vate të mirr kutinë ka xhepi i feksi gugusheja; tani do veç si musafir e do flasiç arap//*

Siç e përmendëm pak më lart, tek e ardhmja bie në sy edhe bashkimi i trajtës së shkurtër të përemrit vector të rasës kallëzore, veta e tretë njëjës *atë (të) e*, me pjesëzën **të** të së ardhmes, ku ndër të tjera nuk kemi shkrirje si në mbarë shqipen. Për rrjedhojë na formohen trajtat karakteristike, *do t'e marrish*, *do t'e theç*, *d'e presish*, *d'e ujitiç* etj. (jo më kot shembujt i kemi vendosur në vetën e dytë, pasi këtu kemi hasur një përdorim të gjerë të foljeve).

E veçantë për këtë kohë është shfaqja e këtyre ruajtjeve në brezin e mesëm dhe të ri. Në brezin e mesëm ruajtja është më e pastër e, megjithatë, edhe këtu do të kemi



përpjekje për ndonjë rregullim të vetëdijshëm të mbaresave foljore. Në brezin e ri këto ruajtje janë më të pakta, por pa diskutim shenjues të qartë të origjinës prej nga vijnë.

#### 7.4.5. Mënyra lidhore

Sikurse në mbarë shqipen, pjesëza *të* është e pranishme për foljet në mënyrën lidhore. Në këtë të folme për foljet në kohën e tashme ruhet ende mbaresa *-ç*, si dhe vërehet zhvillimi i fonemës *i* para mbaresës tek foljet me temë në bashkëtingëllore. P. sh: *të pënoç, të shoç, të japç, të keç, të vëç, të haç; të presish, të fshehish, të ngasish, të flasish* etj. Theksojmë që raste të tilla përdorimi janë në bjerrje e sipër, jo më kot edhe shembujt tanë janë konkretisht folje të vetës së dytë pasi edhe ruajtjet në përgjithësi i përkasin kësaj vete.

Interesante për këtë mënyrë është folja *them* e cila në kohën e tashme të lidhores del në trajtat e saj karakteristike: *- të them/ të thom, -të theç/thesh, -të thetë; -të themi/ të thomi, -të theni, -të thenë*. Folja *the-m* del me temë në *-e* në të gjitha vetat. Ky përdorim është paksa i veçantë, nëse krahasojmë format e kësaj teme me shqipen standarde, sipas së cilës në vetën e dytë njëjës ajo del me temë në *-ua*, kurse në të tjerat me temë në *-o* (*thua/ thotë, thoni, thonë*). Mirëpo përveç kësaj teme për vetën e parë njëjës dhe shumës ndoshta më rrallë dhe për më tepër si një përdorim dysor del edhe trajta e vjetër foljore *thom/ thomi*, pra tema më *o*. Kjo gjë tregon ruajtje dhe dëshmon vjetërsinë e të folmes. Kjo formë përkon me temën e shqipes së hershme.

Mbaresat foljore në përgjithësi përkojnë me standardin, përveç vetës së dytë të aoristit sigmatik, të cilin e gjejmë në trajtën e dysorësisë në përdorim, si edhe mbaresës së vetës së tretë në të pakryerën (*të diil, të lii, të punon-* të dilte, të linte, të punonte).

Mendojmë se ruajtja e zanores *e* të temës bëhet për analogji me format foljore të njëjtës kohë të foljeve ndihmëse *kam* dhe *jam* (*të jem, të jesh, të jetë/ të jemi, të jeni, të jenë; të kem, të kesh, të ketë/të kemi, të keni, të kenë*).

Më se e kryera: *të jesh mërguar* .....( të isha larg); *të kesh vënë* (të kisha vënë). Edhe këtu bie në sy bashkimi i trajtës së shkurtër të përemrit vector të rasës kallëzore, veta e tretë njëjës *atë (të) e*, me pjesëzën *të*, ku ndër të tjera nuk kemi shkrimje si në mbarë shqipen. Për rrjedhojë na formohen trajtat karakteristike: *t'e sjelliç, t'e shoh/ t'e shote, t'e biç, t'e marrish, t'e theç, t'e presish, t'e ujitish* etj.

Vihet re edhe ndonjë shkarje në përdorim të formave të mësipërme tek brezat pasardhës, por gjithmonë të kushtëzuara nga rrethana të caktuara, njëra prej të cilave lidhet me bashkëfolësit e së njëjtës origjinë. Për folësin çam merr rëndësi origjina e bashkëbiseduesit. Ja se ç'ndodh me një ligjëruer gjatë të folmes së tij: ai e nis fjalinë me foljen në të pakryerën sipas së folmes çame dhe menjëherë kujtohet që bashkëfolësi nuk është i së njëjtës origjinë. Kështu, menjëherë, përkrah përdorimit të parë përdor të dytin (sipas shqipes standarde) për ta korrigjuar atë në mënyrë të vetëdijshme. *Të thesh.. / të thuash që nuk e di është një gjë / të mos e bësh është një gjë tjetër.*<sup>463</sup> Shembuj të tillë në gjuhën e çamëve sot janë të panumërt. Gjithçka sa shpjeguam ndoshta do të ishte më mirë ta përkufizonim me një thënie të Atë Justin Rrotës rreth mundësisë që ka njeriu për ta “*dredh gjuhën*” sipas rastit dhe bashkëbiseduesit<sup>464</sup>

<sup>463</sup> Për njohuri më të zgjeruara lexuesi mund t'i kthehet edhe një herë temës “Sistemi foljor i çamërishtes në diakroni”

<sup>464</sup> Shkurta, Gj: *Sociolinguistika*, Tiranë 2003

#### 7.4.6. **Format e pashtjelluara foljore.**

Shihet një përdorim i formave të pashtjelluara foljore si në mbarë shqipen e përgjithshme: *për t'i bënë* ; *pa gënë* , *pa pirë* , *duke pënuar* etj.

Siç e shohim edhe nga këta shembuj tek disa pjesore, shohim disa dallime fonetike të rëndësishme të cilat megjithëse në kapitullin përkatës të fonetikës i kemi trajtuar, mendojmë se një rikujtim i tyre është mjaft i vlefshëm. Duken interesante disa forma të veçanta pjesorësh, konkretisht: pjesorja e foljes *jam*, trajta e saj, *bënë* (bërë); dikur në të folmen e çamërishtes ka ekzistuar edhe pjesorja e foljes *kam*, forma e saj *klënë* (qënë), gjurmë të së cilës sot është e vështirë të gjenden; tek disa pjesore foljesh kemi shtimin e bashkëtingëllores *t* midis temës dhe mbaresës. *E kish thertur/ e kish vartur në fikt.*

Lidhur me këto trajta pjesorësh, që nuk janë të vetmet, tek brezat pasardhës vihet re një tjetër dukuri: folësit shmangin atë çka është e gabuar (konkretisht përdorimet e mësipërme) dhe trashëgojnë format e rregullta të formimit të pjesores, të ndihmuar edhe nga zhvillimet e shqipes së sotme.

Tek përdorimi i pjesores së foljes, interferencat e bashkësive pritëse nuk mund të jenë të papërfillshme; aq më tepër nëse bëhet fjalë për të folme që gëzojnë “prestigj” më të madh. Përdorimet më të shpeshta të këtyre rasteve vërehen tek folës pa arsim: *...për arsye se baba i ka pas bo një nder atij/ e ka pas shpëtu nga vrasjet.....;..... t'kam pru një mik , - i tha....., ..kemi bo ndërmend me mor gocën e filanit./ e ka pagu...; kan punu mi dynjaja...; çunat e Haxhiut jan martu të gjithë ëëë.....( brezi i mesëm). Folësit e arsimuar, si gjithkund tregohen më të kujdesshëm në përdorimin e formave të pjesores. Më të rregullt në përdorimin e saj janë folësit e brezit të vjetër.*

#### 7.4.7. **Forma joveprore e foljeve**

Sikurse e kemi përmendur më lart, në të folmen e çamëve vihet re një përdorim i shpeshtë i formës joveprore të foljeve në vënd të formës veprore, ku në përbërje të disa formave foljore përgjatë zgjedhimeve, është karakteristik këmbimi i *h*-së antihiatizuese me fonemën *n*: *vineshin (vinin), bënej (bënte), kthenemi (kthehemi), martonej (martohej), dinej (dinte), bënej (bëhej)* etj. *vineshin krushqit me kuel kur martonej vajza.*

Forma joveprore në këtë të folme formohet me anë të mjeteve si në mbarë shqipen. *Vineshin, U kthenë ka rruga, u ka bënë* (formë e cila bën përjashtim: *janë bërë*). Në përgjithësi trajtat joveprore të foljeve në çamërishten tradicionale si dhe në të folmen e sotme çame marrin mbaresat e shqipes së sotme, vetëm se në çamërishte përdoren me kuptime të ndryshme kohore, nga ato të shqipes standarde.

Në këtë të folme spikasin gjithashtu dendur disa trajta karakteristike foljore, konkretisht trajtat analitike të kohës së shkuar të foljeve, të cilat formohen nga veprorja duke u paravënë pjesëzën *u* përpara, p. sh: *u ka bënë*. Pra, këto forma ndërtohen me anë të foljes ndihmëse *kam + pjesore* dhe jo *jam + pjesore*. P. sh: *u*

*ka bënë, u kish sellë, u ka rritur, u ka gritur, u ka sumurë* etj. ....*siç u ka bënë e kutu tani...*; ..*rrugat u kan mbëllirë ..*; *mir u kish sellë / me grek u kish sellë mirë...*; *u ka rritur me hälle?* .... *u kan nartuar ata/ veçëm një gocë u ka vrarë...*;...*atje u kam martuar ù; ... u kish derdhur misir.*

Këto forma janë trashëguar edhe tek brezat pasardhës, madje ato parapëlqehen në përdorim edhe nga brezi i ri. Por nuk duhet të anashkalojmë faktin se tek brezat pasardhës ato përdoren duke iu nënshtruar disa dallimeve fonetike brenda fjalëve. Kryesisht përdorimet e lartpërmendura i gjejmë në këto breza si më poshtë:

Në brezin e mesëm e të ri spikat zëvendësimi i pjesores së foljes *bëj- bënë* me gjegjësen e shqipes letrare, *bërë* etj. Bën përjashtim vetëm rasti kur ligjërimi kryhet në rrethana të ngushta familjare apo farefisnore.

Forma joveprore e formuar me mbaresat *hem/em, hesh/ esh* etj; *hesha/ esha, heshe/ eshe* etj., përdoren tek këto breza sipas shqipes së përgjithshme.

Forma joveprore e formuar me anë të pjesëzës *u* (e tipit *u kthenë*), përdoret gjithashtu sipas shqipes së përgjithshme, sigurisht duke bjerrë me vetëdije dukuritë fonetike brenda fjalës. E njëjta gjë vlen edhe për trajtat *u kish sellë, u ka ngritur, u ka sëmurë* etj.

## 7.5. Veçori të fjalëve të pandryshueshme të ligjëratës.

Me interes në këtë të folme duken edhe pjesët e pandryshueshme të ligjëratës.

### 1. Ndajfolja

Ndajfolja siç e dimë është e vetmja nga kategoritë e pandryshueshme të ligjëratës e cila ka edhe kuptim leksikor të mëvetësishëm. Përsa u përket **ndajfoljeve të kohës**, ajo që na bie më tepër në sy për përdorimin e saj të dendur, është ndajfolja **atëherë**, të cilën e gjejmë në disa forma: formën **axhere** e gjejmë tek disa folës shumë të vjetër, çka do të thotë që kjo formë është në bjerrje e sipër; forma tjetër **aqhere** përdoret tek pjesa dërrmuese e këtij brezi; ndërkohë gjejmë edhe formën e re **atëhere**, të shfaqur fillimisht po tek ky brez, e cila është pak a shumë e ngjashme me atë të shqipes standarde sot (**atëherë**). P. sh: ...**axhere** pënojëm tokën me kuel...; ....**aqhere** s'kish doktorra...; .....**athere** s'kishim parë aroplan para lufte....

Ndajfoljen e kohës **pastaj** e gjejmë në trajtën mbizotëruese për brezin e vjetër, - **pësaj**, por ndonjëherë edhe në formën e vjetër, **pasandaj**, apo në atë të re, **pastaj**. Nuk mungojnë edhe përdorimet dysore të këtyre formave. P. sh: **ajroplane pësaj / soj e soj ajroplane// u nisëm ne pastaj ka Delvina...**;... **erdhi gjermani athere pësaj...**; ...**u futëm n'kufi pasandaj... etj.**

Edhe ndajfolja **tani** paraqet interes të madh. Trajtat e saj mbizotëruese janë: **tàni, tòn-ja**. Në të rrallë spikat edhe forma letrare **tani**, p. sh: *do iki kijo tani....; tòn-ja si n'kët kehe e mba mënd ...; tòn-ja/ e kshu bëheshin dasmat...; ..paa... tani më shumë malli më merr për at vëndin tim atje...*

Ndajfoljen **njëherë** e gjejmë tek brezi i vjetër në trajtën **njherë** ( *..do t'them prishjen njherë...*); ndërsa ndajfolja **nganjëherë** shfaqet në trajtat: **kanjëherë, ganjëherë** (*..diku bënej shaka kanjëherë...*).

Nga **ndajfoljet e vendit** më të spikatura në çamërishte tërheq vëmendjen ndajfolja **nek** të cilën e gjejmë edhe si parafjalë: *nek mirr abdes hoxhallartë...; nek dahej rruga; nek viit ne babai etj*. Ndajfolja **ngaherë** përdoret shpesh në trajtën **ngahera**: *..do vete ngahera/ tha...*

Ndajfolje të tjera gjithashtu të spikatura janë: **matanë**, në trajtat, **natanë** dhe **matanë** ; **brënda**, në trajtën **bërna**; **kënde** në trajtën **kwtëj**; **andej**, në trajtën **àtej**; **sipër** në trajtën **siprazi**; **ngado** në trajtën **kādo/ gado**; **atje, këtu**, në trajtat **àtje, kùtu**, si edhe në format e rregullta letrare, **atje, kutu**. P. sh:.. **natan** kufirit në *Qaf Molls...*; *...matan ka Krievidhi...*; *...këta ish natanë rrugës/ ne jeshëm kwtëj...*; në *Paramthi i bajti bërna...*; *kur kem ardhur kwtëj/ se n'dystepesën u futëm kwtëj*; *vajta àtje n'vënd/ ku keshëm shtëpitë* ( vini re edhe formën vajta, që në këtë brez e gjejmë në trajtën vata)...; *e di un/ inçizon atje àjo...; ..pooo../ kutu, tani ..../ e kemi kùtu djalin...*; *kado që të veje/ tha/ plot/ plot me njerëz që largoneshin*.

**Ndajfoljet e mënyrës kështu, ashtu** i gjejmë në trajtat **kùshtu, àshtu**, si edhe në shqipen letrare **kushtu, ashtu**. Në *dasmëra hapin palat kushtù// hapin papllomat àshtu...*

## 2. Pjesëza

Këtu veçojmë pjesëzën **nuk** me të gjitha trajtat e saj karakteristike për çamërishten, **nùku, se: nuku** bënë gjë ... *vallāhì se na mbanë, vallāhì se të fal etj*. Pjesëza karakteristike të çamërishtes të cilat hyjnë në grupin e pjesëzave emocionuese shprehëse janë pjesëzat **pa** dhe **një**. Ato i gjejmë shpesh në ligjërimin e përditshëm sidomos kur më të vjetërit rrëfejnë diçka në shpjehje të tipit *një të gritur bëri, pa t'ia ktheu mbë* (sipër), *një të gritur, një t'i shkumuar, një t'ia hedhur*, etj.

Përdorime të tilla na japin mundësinë e një lëvrimit të çamërishtes edhe nga pikëpamja sintaksore në të ardhmen.

## 3. Parafjala

Në këtë të folme spikasin parafjalët: **ka ( nga); njaram> javam> jām ( deri); nek, ne ( tek)**. P. sh: *që na nxirr ka lumi/ çam ishin ka neve...; jām n'nji t'natës diqenet hapur...; ..ne ( tek)Mirashi kush kish vdekurë?...*

## 4. Lidhëza

**A( apo); sã ( saqë)**: *...kufi/ kufi me Turqi ....sã kur ishëm atje këndojën edhe zojt e turkut*

## 5. Pasthirrma

**Hoj, oj, ja hë, me**, si edhe përdorime të tjera sipas standardit si **uë, ua, moj, mo, a, u** : *po çdo themi oj...;... ja hë tërbonjëla / ka ipur mbali kalit; ..uë..po çit jetë isht / ua.... Habib mos bëj shaka/ e di si shejtani uë...* Siç shihet nga shembulli i fundit, edhe pasthirrmat kanë filluar të futen në udhën e dysorësisë.

Tek pjesët e pandryshueshme të ligjëratës, e kemi përqendruar vëmendjen vetëm tek elementet karakteristike dialektore. Rastet e përkimit me standardin letrar, mendojme se nuk është e udhës të trajtohen përmes shembujve.

Tek brezat më të rinj, vihet re në ligjërim, eliminimi i formave fonetike karakteristike të së folmes çame, që ndër të tjera konsiderohen si mjaft të vjetëruara. Ato mundohen që fjalët e pandryshueshme t'ia përshtasin sa më shumë shqipes së

përgjithshme, kjo, për vetë faktin se ato janë fund e krye pjesë e çamërishtes së hershme, të veçanta dhe dalluese.

Por nuk mund të anashkalojmë faktin që tek këto breza kemi edhe ruajtje, siç ndodh me brezin e mesëm, sidomos brënda për brënda familjes, ku shohim se ruhen qartë konkretisht: ndajfoljet, **njherë, kanjëherë**; ndajfolja e vendit, **kado**; ndajfolja e mënyrës, **është**; pjesëza, **se**; parafjalët, **ka, jām, ne**; lidhëza, **a**; pasthirrma, **moj, oj, jahë, me**. P. sh: *shko ne nana merr pak kripë; oj e çmëndur më dëgjo se të vdiqa...; jahë fytyrë / thuaje dhe një herë atë fjalë* etj.

Edhe tek brezi i ri gjejmë gjurmë të përdorimit të pjesëve të pandryshueshme. Shpesh ato të japin përshtypjen e shkarjeve të natyrshme përgjatë të folmes. Këtu vihen re përshebull pasthirrmat, të cilat shoqërohen edhe me ngjyresa të theksit sintaktik. *Nane mōj? ...hë me tiëë?* ; parafjala *ne: isha ne nana mbrëmë*; lidhëza *a: Aaaaa(apo)* , *do vijë dhe babi nesër në Elbasan* ..

Edhe tek fjalët e pandryshueshme të ligjëratës janë të pashmangshme **interferencat** nga të folmet pritëse ( shembull: kontakti me Shqipërinë e Mesme).

Tek brezi i vjetër na tërheqin vëmendjen: ndajfoljet e mënyrës, **kshtu/ kshu, ashtu/ashu**; ndajfoljet e vendit, **atje, ktu, ktej**; ndajfoljet e kohës, **prap, masandaj, tashi, përher**; parafjala, **ke** ( tek); lidhëza, **hem**. P. sh: *...kshu/ të mbaruar / se në luftë kshu isht; ..përherë kshu copa- copa...; ...atje n'arrest/ erdhëm ktu../ ndenjëm ktej n'Konispol// n'Kavaj fillova bujqsin masandaj...; ..para se t'hapej lufta/ prap filloi edhe dorn'e tretë; ù të kam si vajzat e mia tashi; ....përher kshu copa-copa; ..ka çam ke pallati jot? S'kishe ku t'qëndroje me bagti / hem/ hem jabanxhi...; ...nqofse ka pas të kqijat e veta.*

Tek brezi i mesëm me përjashtim të disa përdorimeve paksa të vjetra, fjalët e mësipërme përdoren të gjitha. Përveç këtyre shembujve kemi edhe shfaqjen e disa fjalëve të tjera si: **mi** ( me/ moj), **hala** (dikur *ajla* / akoma)

Edhe në brezin e ri spikasin gjithashtu një tërësi përdorimesh të huazuara nga dialekti vendas. P. sh: *... isha mburjtur ashu...; ..t'jen çamët kshu si ty/ thoshin...; ..zurën vënd ktej n'Shqipëri ..., se kshu ka qen feja athere...;...gjyshi im më pas strehohet ke nji familje...etj.*

Në kërkimet tona rezultojne edhe fjalë të pandryshueshme të ligjëratës të cilat, duke filluar që në ligjërimin e brezit të vjetër njihen mirë nga ky brez, porse janë bjerrë plotësisht ose përdoren fare pak, p. sh: **ndajfoljet**, *caherë* ( pas dreke), *ajla* (për këtë kemi formën e huazuar hala/ akoma); *mënjë* ( për pak); *dej* ( pasnesër), *kasdej* (pas pasnesër ), *kasmot* ( pas dy vjetësh), *kehë* ( tutje), *rëposhtë* ( përposhtë), *aradha* ( rrotull); **parafjalët** *kaj* (nga), *azrei* (kundrejt) etj.

## KREU VIII

### PËRFUNDIME

**Studimi për të folmen e çamërishtes është një sprovë e parë në këndvështrimin sociolinguistik.**

Çamëria është krahina më jugore e trojeve shqiptare.<sup>465</sup> E folmja e çamërishtes është pjesë e dialektit të toskërishtes jugore. Kjo trevë shtrihet në Jugperëndim të Gadishullit të Ballkanit, gjatë brigjeve lindore të detit Jon, nga liqeni i Butrintit dhe lumi i Pavllës në Veri dhe deri në Gjirin e Artës në Jug. Brenda këtyre kufijve shtrihen rrethet e Filatit, Gumenicës, Margëlliçit, Paramithisë, Pargës, Prevezës, Filipiadhës (Llurit) etj....<sup>466</sup> Në aspektin etnologjik, ajo është një vazhdimësi e popullit shqiptar në drejtim të jugut, apo një nënnyjësi e tij, e cila së bashku me Myzeqenë, Labërinë dhe Toskërinë, formojnë Jugun e Shqipërisë. Lidhjet më të ngushta dhe afritë më të mëdha Çamëria i ka me Labërinë, me të cilën kufizohet në Veri.<sup>467</sup>

E. Çabej përmes ligjeve fonetike të shqipes përmend vazhdimësinë midis dy termave Thyamis – Çam: “*Çam – në Çamëri, Çam, Çamërisht, emri i krahinës më jugore të Shqipërisë, i banorëve të saj e i dialektit të tyre. Sikundër e pa së pari M. Leake*<sup>468</sup> ( *Researches in Greece. 1814, f. 13*) është refleksi i *Thyamis, emri antik i lumit Kallama të sotmë. Një nga emrat topikë që vërtetojnë autoktoninë e*

<sup>465</sup> Çabej, E. *Studime Gjuhësore*, f. 98, Rilindja, Prishtinë 1976.

<sup>466</sup> Sheme, S. *Veçori të përgjithshme Fiziko- gjeografike, - Kufijtë natyrorë gjeografiko- etnologjikë të Çamërisë* në “Monumente natyrore dhe kulturore të Çamërisë”, f. 19 ( ideart), Tiranë 2008

<sup>467</sup> Sheme, S. Po aty

<sup>468</sup> Hoxha, Sh. *Kontributi i Uilljëm Martin Likut në fushën e studimeve albanologjike*.f. 66, Prishtinë 2007.

*Shqiptarëvet në vendbanimet e sotme ; sh. Bul. I Univ. Shtet. të Tiranës. Seria. Shk. Shoqërore 2 ( 1958) 61.*<sup>469</sup>

Çamëria u coptua nga ndarja e kufijve në Konferencën e Londrës, në Qershor të vitit 1913. Në Maj të 1944-ës në Çamëri u përdor një terror i paparë dhe u bënë krime të padëgjua. Pas këtyre masakrave, familjet e shqiptarëve të shumë qyteteve të Çamërisë u detyruan të largohen për në Shqipëri.<sup>470</sup> Tragjiciteti i ka shoqëruar dhe vazhdon t'i shoqërojë banorët e kësaj krahine edhe kur ato endeshin në trajtën e një *diaspore të shprishur*<sup>471</sup> anekënd Shqipërisë shtetërore.

Si një e folme konservuese, çamërishtja na krijoi mundësi të shumta përqsasjeje. Pas vëzhgimit të gjendjes statike të së folmes kemi arritur në përfundime se çamërishtja në thelb është konservuese. Ky tipar i saj u bë edhe pikënisja e disa studimeve që kanë pasur si objekt përqsajen e kësaj të folmeje me të folme të tjera të ngjashme me të, si, të folmen e autorëve më të vjetër shqiptarë<sup>472</sup>, të folmen e avanitasve të Greqisë, të folmen e arbëreshëve të Italisë<sup>473</sup> etj.

Në studimin për këtë të folme iu referuam përkufizimit të J. Lyons-it, sipas të cilit me bashkësi bashkësi gjuhësore përkufizojmë *“të gjithë njerëzit që përdorin një gjuhë të dhënë.”* (John Lyons 1970), dhe verifikuam se, kriteri gjeografik në identifikimin e një të folmeje jo gjithmonë është një kriter funksional<sup>474</sup>

Historia e dhimbshme e çamëve ka qenë edhe pika kyçe e **intervistave**, anketave etj., pasi vetëm kur ato rikujtonin vitet e dhimbshme, harronin gjithçka, **duke rrëfyer me një çamërishte që i rridhte natyrshëm.**

Për të arritur në këto përfundime kemi shkuar drejt së panjohurës, përmes vjeljes nga burime të sigurta. **Hulumtimet e bëra i përkasin kryesisht viteve, 1978, 1998, 2003, 2007, 2010, 2011, 2012.** Ky burim i gjerë informacioni shpesh është pasuruar edhe nga pjesmarrje të vazhdueshme në: biseda me çamë që ende jetojnë në Çamëri; përrurime librash të autorëve çamë; përrurime këngësh çame; pjesëmarrja në dasma çame; në mbledhje të ndryshme të organizuara nga shoqata çame dhe më vonë partia çame; në konferenca shkencore të organizuara nga intelektualë çamë; në shkolla verore të organizuara prej tyre me studentë çamë; duke mos përjashtuar ndofta padashur edhe të dhëna të memorizuara që në fëmijëri në lagjen time çame në plazhin e Durrësit; nuk mund të përjashtoj gjithashtu të dhëna të vlefshme që më ka dhuruar dhe më dhuron nga dita në ditë familja e re çame etj.

Për rrjedhojë disa prej këtyre përfundimeve janë:

Përveç lëvizjeve të herëpashërshme mekanike të kësaj popullsie<sup>475</sup>, pamë se **një rol vendimtar kanë luajtur edhe faktorë të tjerë jashtëgjuhësorë**, më i rëndësishmi prej të cilëve është mënyra sesi çamët u **integruan** brenda bashkësive pritëse. Procesi i integritimit me bashkësitë e tjera, veçanërisht në aspektin gjuhësor ka qenë mjaft i vështirë, pasi bëhet fjalë për integrim brenda një bashkësie tjetër folëse.

<sup>469</sup> Çabej, E. *Studime Gjuhësore*, f. 98, Rilindja, Prishtinë 1976.

<sup>470</sup> Për të dhëna më të hollësishme nga fusha e historisë mund të shihni veprat e historianit Z. Hajredin Isufi.

<sup>471</sup> Term i përdorur nga Shkurtaj, Gj: *Vlera dialektologjike dhe etnolinguistike të së folmes së Çamërisë*, në “Çështja çame dhe integrimi evropian”, Tiranë 2008.

<sup>472</sup> Troplini, E: *Bashkëpërkime midis të folmes së çamërishtes dhe të folmes së autorëve të vjetër të shqipës*, në “Alb- Shkenca”, Tetovë 2009.

<sup>473</sup> *Disa përqsasje midis çamërishtes, arbërishtes dhe arvanitishtes në kuadër të gjuhës letrare standarde*. konference nderkombetare, Tiranë 2012, organizuar nga Universiteti “Sapienza” i Romës.

<sup>474</sup> Rrokaj, Sh. *“Të gjithë shqiptarët duhet të flasin shqipen standarde”*, në gazetën “Panorama”, dt. 15/ 12 / 2010

<sup>475</sup> Kjo edhe për arsye se çamët shpesh janë karakterizuar nga lëvizje të pandërprera edhe brenda Shqipërisë shtetërore.

Një tjetër faktor me një peshë të konsiderueshme në procesin e konservimit të së folmes së çamëve, arvanitasve apo arbëreshëve të Italisë etj., është **faktori psikologjik i shpërnguljes** së këtyre popullsive me fate të njëjta që ( megjithëse nga qëllimi i shpërnguljes nuk është i njëjtë), kushtëzon njëllor këto të folme.

Për sa i përket procesit të trejtjes së dialektalizmave për t'ua lënë vendin tipareve të gjuhës letrare, ose<sup>476</sup>; në këtë lloj tërheqjeje tek e folmja e çamërishtes (me shumë humbje, pasi e folmja çame është konservuese, **por edhe integruese** në bashkësitë pritëse), fiton ndryshimi, si dhe orientimi kah gjuhës me prestigjin më të madh, siç është gjuha zyrtare standarde.<sup>477</sup>

Në këtë drejtim çamërishtja bashkohet me atë prirje që përbashkon mbarë të folmet sot, por duhet të theksojmë se **të folmet krahinore nuk orientohen të gjitha njëllor kah gjuhës standarde.**

Ndryshimi gjuhësor nxitet e përcaktohet nga zhvillimi i kulturës, veprimtarisë prodhuese, mjeteve të reja teknike, jetës politike-shoqërore, përparimit e shkencës, elektronikës etj., nën tryshinë e të cilit është edhe vetë gjuha standarde. Dhe, për sa kohë **gjuha standarde “do të jetojë” së bashku me dialektet, gjithmonë do të ekzistojë një lidhje bashkëveprimi midis tyre.** Me gjithë dallimet që kanë midis tyre **ato do të shërbehen reciprokisht njëri nga tjetri.**

Ajo çfarë na ka tërhequr vëmendjen tek kjo e folme është **ritmi i ndryshimit.** Pas procesit të hinkëzimit nga brezi në brez, ndodh edhe e ashtuquajtura dukuri e filtrimit të dukurive në secilin prej tyre. Përcjellja e fjalëve të dialektit në brezat pasardhës është e mangët, gjë që flet qartë për ato procese të ripërmendura shpesh: përtëritjes, risimit, rinovimit apo shtresëzimeve të ndryshme në të folmen e banorëve çamë.

Por, përveç këtyre dy proceseve të përmendura deritanimë, **ruajtjes (konservimit) dhe përtëritjes (rinovimit)** të së folmes në drejtimin e rrafshimve standardizuese dhe globalizuese, do të shtonim se, tek kjo e folme shfaqet dukshëm edhe një proces i tretë i cili është po aq i rëndësishëm sa ai i pranisë së dy të parëve. Në mënyrë konvencionale e kemi quajtur atë, **“një proces “ndërkomunikimi”, i cili luan rolin e një ndërlihdhësi midis të folmes arkaike dhe të folmes së moderuar çame.** Dukshëm ky lloj procesi shfaqet në brezin e mesëm, i cili luan rolin e një rregullatori në ligjërimin e brezit paraardhës dhe pasardhës.<sup>478</sup>

Gjatë vëzhgimit në aspektin sociolinguistik, pamë tek çamërishtja pikërisht atë që prof. Çabej e theksonte shpesh nëse flitej për dialektet,- lëndën e parë, përmes rifreskimit të fazave të hershme të shqipes së dokumentuar. Çamërishtja gjallon sot si një e folme e cila dëshmon jo vetëm fazat e kapërcyera të shqipes, **por me anë të saj zbulohen edhe mjaft çështje të karakterit historik.** Vetë formësimi i sociolinguistikës si disiplinë pas viteve '60-të është ndër të tjera edhe një sprovë e qartë e bashkëveprimit që ekziston midis gjuhës dhe shkencave të tjera, në sajë të së cilës ato shërbehen reciprokisht. Përmes çamërishtes arritëm në përfundimin se, në shërbim të gjuhës së një kombi **duhet të hetojmë mirë ndërlihdhjet dhe ndihmën e ndërsjelltë midis disiplinave të së njëjtës fushë,** për të arritur në përfundime mbi afritë dhe pikëtakimet midis shkencës gjuhësore dhe shkencave të tjera. Studimi i **sistemit foljor** të çamërishtes në këtë këndvështrim është objekt dhe argument i mirë për analiza të tilla. Rreth këtij studimi po rendisim disa përfundime:

Folja **ban(j)** e vetës së parë të shqipes së hershme, në çamërishten e sotme del

<sup>476</sup> Gjinari, J. *Marrëdhëniet e sotme të gjuhës letrare me dialektet*, S.F., 1985.

<sup>477</sup> Shkurtaj, Gj. Po aty

<sup>478</sup> Për më tepër shih në disertacion , përkatësisht në temat: “Vlerat studimore të çamërishtes për kundrimet sociolinguistike” ( 1.2.1.), si dhe “Procesi i zhvillimit leksikor në mjedisin çam”, f 100.



në trajtën **bi**, dhe në raste më të rralla ajo del edhe në trajtën **bij**. Për rrjedhojë mendojmë se,<sup>479</sup> në **çamërishte** *nj*-ja e kohës së Buzukut ka rënë dhe rishfaqja e saj nuk ka të bëjë me evoluimin e *nj*-së në *-j*, por *-j*-ja e këtyre foljeve, është një ndërhyrje nga shqipja e përgjithshme nga kontakti i mëvonshëm midis dy të folmeve.<sup>480</sup>

Po kështu kemi edhe foljen **mbaj**, e cila shfaqet në trajtën **ba** (*e ba mënd? / e mbaj mend*); tek kjo folje pamë edhe një tjetër dukuri: rënia e *n-së* fundore e temës (pak a shumë si tek *zâ* (*zan-ë*), rishfaqja e së cilës mendojmë se ndodh për të njëjtat arsye, pra nga kontakti me shqipen e përgjithshme. Të njëjtat vërejtje vlejné edhe për foljen **vij**.

Një dukuri fonetike e cila i ka rezistuar kohës (siç shihet edhe nga shembujt e trajtuar) dhe gjallon ndër çamë sot është, ndryshimi i zanores *-ë* të theksuar në *-i*: *běj: bi*

Në sistemin foljor të çamërishtes, një tjetër folje që tërheq vëmendjen përkrah foljes “*běj*”, në kuadrin e *-ë-së* në *-i*, është dhe veta e tretë njëjës e së tashmes së dëftores së foljes “*jam*” (isht). Kjo është një trajtë e vjetër e cila haset në përdorim jo vetëm tek e folmja e çamërishtes, por siç e kemi përmendur gjatë disertacionit, ruhet edhe sot e kësaj dite në ndonjë nga të folmet arbëreshe të Italisë, çka tregon edhe vetinë konservuese të tyre. Megjithë ndryshimet e mundshme, kjo dukuri shfaqet dukshëm edhe në çamërishten e ditëve tona: *histori e Çamërisë kjo isht...; epo ja!- në ndjekje isht ajo punë... , fshatrat na ndihmuan n'çik ç'isht e vërteta... ..se në luftë kshu isht...; / ç'të kapin vritej... , po ç'i jetë isht kjo nusa Petrëtit? – fëmilë e ndarë/ shtëpia ka shtëpia; u ka bën sëmure po isht mirë... , bum ktë copëzë shtëpi.../... qi ish kaq e bukura.*<sup>481</sup>

Për kohën e tashme të dëftores së foljes *jam*, duke bërë një përjasje jo vetëm me format e sotme të shqipes, por edhe me ato të dokumentuara të saj, vumë re se në vetën e tretë folja *jam* nuk del në trajtën e saj *është*, por në trajtën *isht* dhe *ishtë*, ku në më të shumtën e rasteve *ë*-ja fundore bie. P. sh: *ú do te dergoj di kobeza mollë / po i njohe çila isht e vjema / çila e sivjema/ nuk do hapim luftë .. ú do te dergoj di pela/ po i njohe çila isht nana çila ishtë bila nuk kemi luftë / drishe do nis luftë; ku isht/ i tha ai / merre selle kutu; ç'ishtë ajo i tha Veizi/ ishtë gugusha e bukrës dheut.*

Në studimet dialektologjike për çamërishten, për foljen **ngrij**, deri tani kemi këto të dhëna. *unë ngrij, ti/ ai ngrin, ne ngrinë, ju ngrini, ata ngrinë*. Është e pashmangshme të mendohet folja në fjalë pa asimilim të grupit **ng**. *Û grij/gri...; gopej për ngopej. E njëjta vërejtje vlen edhe për foljen ndjell të cilën sot ndër çamë të vjetër e gjejmë në trajtën (unë/ ti) djell, ai djell/ dill, (ne) djellëm, (ju) dillni, ata/ato djellën*. Format e ndryshme të mbaresave foljore sipas paradigmatës së zgjedhimit i kemi marrë si të mirëqena, me të vetmin dyshim në lidhje me mbaresën foljore *-j* e cila në të dhënat tona, ndonjëherë nuk shfaqet. Sigurisht, duke ditur se *j*-ja është një zhvillim i mëvonshëm i shqipes dhe duke pasur parasysh faktin që foljet me temë në zanore, në të tashmen e dëftores në këtë të folme, në përgjithësi dalin pa mbaresën *-j*,

<sup>479</sup> Më gjatë të dhënat rreth këtij sistemi janë pasqyruar në temën me titull “ Sistemi foljor i çamërishtes ”, ose shih Troplini, E: *Sistemi foljor i çamërishtes në diakroni*, në Aktet e Seminarit të III-të Ndërkombëtar të Albanologjisë, Tetovë 2010; *Çamërishtja në kuadrin e shqipes standarde*, në “Seminari XXIX Ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare”, Prishtinë 2010;

<sup>480</sup> Pas shpërnguljes së dhimbshme të çamëve më 1944 çamërishtja ishte ruajtur mirë nga folësit e kësaj krahine, siç ndosh në raste të tilla apo siç ka ndodhur me të folmet anësore shqipe të cilat kanë bashkëjetuar dhe vazhdojnë të bashkëjetojnë nën trysninë e një gjuhe tjetër. Me shpërnguljen e çamëve në Shqipërinë shtetërore tashmë ajo u gjend përballë një shqipeje të evoluar.

<sup>481</sup> Këto shembuj janë shfrytëzuar edhe për punimin *Disa tipare ruajtëse të së folmes së çamërishtes*, botuar në revistën “AKTET” e Seminarit të Dytë Ndërkombëtar të Universitetit Shtetëror të Tetovës.

arrijmë ne përfundimin se dikur në çamërishte kjo mbaresë nuk ka qenë e pranishme edhe tek kjo formë foljore.

Në çamërishten e sotme spikat ruajtja e mbaresës së hershme. Kujtojmë nga gramatika historike: *banj-ë-më*; në çamërishte (për foljet e vetës së parë shumës, të kohës së tashme, mënyrës dëftore, diatezës veprorë) kemi sikurse tek Buzuku mbaresën inovuese *-imë* ( e cila gjendet edhe sot në të folmen e brezit të vjetër çam). Kështu tek Buzuku kemi: *na qi baimë* 11a4, *porsi edhe na liroimë*<sup>482</sup>; ndërsa tek çamët kemi: *bimë, pënoimë, klaimë, droimë, griimë* etj.

Prapangjitja karakteristike e pjesëzës *-te*, vihet re sot kryesisht tek foljet *běj, vij, shoh, pres*, në kohën e ardhme të mënyrës dëftore, si: *do bite, do vite, do preste, do shote*; foljet *běj* dhe *vij* me këtë prapashtesë i hasim edhe në të tashmen e lidhores, *të bi-te, të vi-te*. Më të rralla janë këto përdorime në kohën e tashme të dëftores: *e bite ù ; vite ù* . Për kohën e tashme spikat folja *shoh: Pse, shote u?* (Pse shoh une ). Kjo dukuri ka ardhur duke u bjerrë po të krahasojmë çamërishten e sotme me shembujt nga punimi i Prof. Q. Haxhihasanit. Kështu kjo prapashtesë nuk përdoret më në fjalët, *them* ( *-te*), *jam* ( *-te*), *los* ( *-te*), *kam* ( *-te*).

Shpesh në çamërishte ndodh që e pakryera del në të njëjtën formë me të tashmen: *bluajnë/ bluan* (°78) , *bluanin* (sot) , *pijnë/ piqte* (°78), *piqnin* (sot).

Për kohën e ardhme (f. 52) na tërheq vëmendjen ruajtja e mbaresave të **hershme të shumësit: më, të, në**, si: *igmë, igtë, ignë, grinë, shpunë, pinë, dersinë, vanë, pjenë, hamnë* ( hapnë), *prinë* etj;

Në vetën e tretë shumës, sidomos tek foljet me temë në bashkëtingëllore, **n**-ja e mbaresës bie, p. sh: *muarrë, suallë* etj;

Disa forma karakteristike foljore të hershme që përdoren rregullisht sot në të folmen çame janë: *hegëlliti, pijti* etj., tek të cilat na kanë bërë përshtypje mbaresat vetore. Për këtë të fundit mendojmë se tingulli *-t*, është një tingull fundor i temës së foljeve *mat, mat-a* etj., që me kalimin e kohës është bërë pjesë e mbaresës, *ma-ta*<sup>483</sup>

Të tjera dukuri të trajtuara prej nesh si të rëndësishme janë: e kryera e thjeshtë e foljes *vete: vata, vate, vate/ vati; vāmë, vātë, vānë*; trajtat e hershme *dolla, duallë* etj.; dukuritë e ndryshme fonetike në temat dhe mbaresat e formave foljore, përkatësisht: *xora* (nx>x), *prinë* ( tn>n), *hamnë* ( pn>mn), *sellkëdis* ( sekëlldis) etj; dukuria e aoristit sigmatik në disa kohë dhe mënyra foljore: *të lëç, të vëç, pāçë, lāçë, u qorruaç* (joveprorë) etj.

Tek kjo e folme spikasin **zhvillimet e vetvetishme të brendshme të saj**. Kështu na ka bërë përshtypje folja *běj*, e cila në të kryerën e thjeshtë në vetën e tretë del në trajtën *bëri*. Në të folmen çame pamë se përdorej e njëjta formë, me të njëjtin kuptim gramatikor por jo leksikor. Le të krahasojmë: *i hodhi dorën në feste/ ja merr asaj / e/ hëë bëri ; prof e prof u bëri duarve nja di herë / e bëri brup pallatin e ri*. Dy format e para zëvendësojnë kuptimin gramatikor dhe leksikor të ndonjë foljeje tjetër, p.sh: *u bëri duarve = fërkoj duart*.

Në të kryerën e thjeshtë dhe në dëshirore kemi vënë re tek kjo folje edhe kalimin e ë-së në *-u*, p. sh: *bura, bure, buri, bumë, butë, bunë/ bufsha, bufsh, buftë, bufshim, bufshit, bufshin: bum ktë copëzë shtëpi/ u bu shpirtmirë një....*

Një tjetër dukuri në këtë drejtim është edhe mbaresa foljore e vetës së tretë e së kryerës së thjeshtë ( e foljeve me temë në zanore) që përdoret për analogji me dy të

<sup>482</sup> Të dhënat dhe shembujt e trajtuar nga gjuha e Buzukut prej nesh, janë marë nga vepra me vlerë studimore e albanologut Selman Riza, *Pesë autorët më të vjetër të gjuhësisë shqiptare, \_Krestomati thjesht gjuhësore*, “Gjon Buzuku” ( 1555). Tiranë, 1961/ 66.

<sup>483</sup> Likaj, E. *Zhvillimi i Eptimit në Gjuhën Shqipe*, ShBLU, Tiranë, 2003

parat, p. sh: *punova, punove, punovi; mësova, mësove, mësovi; luftova, lutove, luftovi*. Analogjia është një dukuri e cila vihet re shpesh në të folmen e çamërishtes. Ky është një zhvillim i cili gëzon një përdorim të shpeshtë edhe tek çamët e brezit të ri.

Për **kohën e ardhme**, na ka bërë përshtypje fakti që për asnjë rast ( me ndonjë përjashtim të rrallë) nuk shfaqet pjesëza të. <sup>484</sup> Siç e përmendëm, një tjetër dukuri për këtë kohë është edhe ajo e **aoristit sigmatik** në vetën e dytë njëjës, që është karakteristike edhe për lidhoren: *Kam kohë që më ka zënë agusa ( sikleti, halli)/ e do dal në bretëri të tjera; hajde tani Durdul se do dalim bashkë një herë i tha breti..;*

Tek forma joveprore e foljeve në përgjithësi, spikasin mbaresat e së tashmes dhe të së pakryerës së foljeve me temë në zanore, **ku h-ja e mbaresës zëvendësohet gjithmonë me n**. Kjo është një dukuri e ngulitur, saqë ajo shpesh është përgjithësuar edhe për fjalë që s'mund të marin një mbaresë të tillë, P.sh: *thermë more vëlla hallall ti bënet gjaku im babait ; tani burazer/ i tha ai i shkëmit/ u do kthenem .. / një grusht lira atij // erdhën ne mulliri / do kthenem u tani se më ka marë uja ( uria) / një grusht lira edhe atij// kthenemi kutu të flemë Xhiko/ si të deç hoxhë / i thotë xhiko.*

Pjesorja e foljes *bëj* ruan sot trajtën e hershme të shqipes. Ajo bëhet **dëshmuere e asaj faze në të cilën dukuria e rotacizmit nuk ishte shfaqur ende**. P.sh: *Ç'ke bënë / jam mërztitur, se kam kaq koho me si billur. Po ti xerë i keshe baba. Ai ishte hoxha që më ka bënë mua të gjitha këto hupe*. Shumë e fortë shfaqet kjo dukuri edhe në çamërishten e sotme.

Ndryshe nga format e dokumentuara, foljet *kam* dhe *jam* në vetën e tretë shumë të së pakryerës shfaqen në format: *jeshën, keshën / jeshnë, keshnë*. Këto janë forma të hershme të cilat i gjejmë tek e folmja e Buzukut dhe e arbëreshëve siç edhe do ta trajtojmë më poshtë.

Në të pakryerën e foljes *them*, ndërmjet mbaresave të hershme të vetës së parë dhe të dytë të shumësit dhe temës përkatëse, shfaqet tingulli mbështetës –i në vënd të tingullit mbështetës –ë. Pra tek çamët kemi: *thoshi , thoshe, thosh, thoshimë, thoshitë, thoshinë*. Në folës të zonave të caktuara vërehen edhe trajtat *kleva, kleve, kle, pava, pave etj*.

Pas studimit për këtë të folme kemi arritur edhe në përfundime përgjithësuese: **konservacioni është një tipar i cili i bashkon kryekëput të gjitha të folmet anësore në një emërues të përbashkët**. Forca që karakterizon të folmen e çamërishtes, të folmen arvanitase apo atë të arbëreshëve të Italisë, është nga njëra anë, -ruajtja, konservimi dhe nga ana tjetër, -zhvillimi i këtyre të folmeve nën trysinë e faktorëve gjuhësore dhe jashtëgjuhësorë etj. Ky tipar nuk është një tipar i këtyre të folmeve, por i të gjitha pakicave shqiptare kudo qofshin.

Për të gjitha këto kemi mëshuar fort në vlerat që ato konservojnë, për t'i përkapur para se t'i nënshtrohen procesit të zhdukjes në të ardhmen.

Mëshojmë fort edhe në përfundimet tona rreth këtij studimi se, pavarësisht faktit që dialektet a të folmet mund të zhduken dhe të reja dialekte do të lindin, në kuadrin e një shqipeje të dokumentuar vonë dhe të gjitha problemeve ende të pazgjdhshme sidomos në fushë të historisë gjuhësore; për vlerat që këto të folme ende i mbartin, ne duhet t'i paraprijmë këtij rreziku. Siç thotë edhe Berruto, "Gjuhët dhe kulturat e ndryshme edhe ato minoritare duhen ruajtur dhe mbrojtur dhe jo t'i shtyjmë ato drejt zhdukjes."<sup>485</sup>

<sup>484</sup> Për këtë arsye edhe argumentimi se e ardhmja formohet nga folje në lidhore plus pjesëzën *do* nuk mendojmë se është i saktë. Ndoshta do të ishte më mirë të thonim nga pjesëza *do të* plus një folje në dëftore siç e kemi mëshuar edhe ne në fëmijërinë tonë.

<sup>485</sup> Berruto, G.: *Sociolinguistica*, Bolonjë, 1994 ( ribotim i 1974-es)

**Në çamërishten e sotme gjallojnë sot elemente të shqipës së hershme.** Për të verifikuar një gjë të tillë bëme një përjasje midis të folmes së çamërishtes dhe të folmes së autorëve më të vjetër shqiptarë, konkretisht *Mesharit* të Gjon Buzukut (1555). Nga kjo përjasje vumë re këto dukuri të përbashkëta:<sup>486</sup>

- Ruajtjen e zanoreve të gjata. Buzuku: *Chaa meh chleneh* 188/31; *baasi* 4b28; *teh paah lih tatti tpaemenit* 29b42 etj; çamërisht: *tagdiir, undiir, cihuur, buhaar; i shpiù (i shpinte), do viù (do vent), i liù (i linte)*

- Mungesën e zanores y: Buzuku: *sutë emii* 4b41; *jo ata ta ç hin për gojë pëgan nierinë, por ata qish del* 74a15; Çamërisht: *n'at qitet qi t'thash ù ti.*

- Trajtën ù të përemrit vector *unë* sikurse në çamërishte. Pra në të dyja të folmet e gjejmë atë pa epitezën - në: *atah nëh janë xhudhi edhe u jam...* (Buzuku); *ù të kam si vajzat e mia tashi* (çamërisht);

- Ruajtjen e l-së së vjetër ndërzanore: *fëmilë* (fëmijë), *bilë* (bijë), *kuel* (kuaj), *rrumulë* (rrëmuje), *milë* (mijë), *palë* (pajë), *valë* (vajë), *golë* (gojë) etj.

- Mungesën e j-së antihiatizuese tek disa fjalë me theks fundor, si: *shtëpi-shtëpia, qevërri- qevërria, Çamëri- Çamëria, Parmëthi- Parmëthia,*<sup>487</sup> *Hasimea, Gjulea, Fatimea nuse- nusa, dele- dela, lule- lula, maçe- maça* etj; Buzuku e- në enklitike me o-në e foljes në urdhërore e bashkon edhe pa bashkëtingëlloren antihiatizuese j: *huchoe.*

- Ruajtjen e togjeve bashkëtingëllore *kl, gl* kryesisht në fjalë të tilla si: *kle- qe* (ishte), *kleçë- qeshë, glisht- gisht, klumusht (qumësht), i glatë* (i gjatë), *kliçe* (kyçe), *glëmbi* (gjëmbi), *i shklier* (i shqyer), *i shklarë* (i shqarë- i shkarë), *klishë* (qishë-kishë) etj. Buzuku: *i glatë, endiglo, gluhë, clissë, klai/ klanjinë, glunjë (me zdrtonë mendetë e atyne qi të ndiglonjinë);*

- Bashkëpërkime të mbaresave foljore: *nvrasmë, shohmë, flitëni, shihëni, viedhënë* etj; mbaresa *imë*, e cila trajtohet si inovuese tek Buzuku<sup>488</sup>, gjendet edhe sot në të folmen e brezit të vjetër çam: (Buzuku) *na qi baimë* 11a4, *porsi edhe na liroimë;* (çamërishte) *bimë, pënoimë, klaimë* etj; mbaresat e formës joveprore: Buzuku: *ù nçonem* 69b8, *a do të pagëzonesth* 34b6; Çamërishte e sotme: *rregullonesthin, shtronesthin pajtonesthin* etj.

- Bashkëpërkime të dukshme midis dy të folmeve tek e pakryera e foljeve të zgjedhimit në *mi*: *kam, jam, thom*, konkretisht tek format: *jeshe, ish/ jeshëm, jeshët, ishnë; kesha, keshe, kish/ keshëm, keshët, kishnë, kleva, kleve, kle,* etj.

- Trajtat e aoristit sigmatik të pranishme tek të dyja të folmet: (Buzuku) *u mbeç, gjegjsh, erdhshë, ù paçë, u gëzuoshë, u mplakshë* etj. ; (çamërishte) *i thaçë, ia thaçë ù, t'e thaç ù më parë, do viç me mua; do të shkruaç ti; do t'inçizoç ti..; u bëç (u bëra), u mplakç, u merruaç, u lodhç, u poqç* etj

- Prania e foljes *gjegjem* dhe përdorimi i shpeshtë i saj në çamërishten e sotme.

Sikurse studiuesi Selman Riza veçon në të folmen e Buzukut disa elemente tipike buzukjane edhe në të folmen e çamërishtes kemi vërejtur disa elemente karakteristike tipike vetëm për çamërishten si: prania e theksit sintaktik (*jo moj/ çish i*

<sup>486</sup> Dukuritë nuk janë pasqyruar të gjitha. Për më tepër shih temën përkatëse në disertacion, ose Troplini, E: *Bashkëpërkime midis të folmes së çamërishtes dhe të folmes së autorëve të vjetër të shqipës* “, “Alb- Shkenca”, Tetovë 2009.

<sup>487</sup> Tek çamërishtja shohim se megjithëse kanë depërtuar fjalë të reja leksikore, dukuritë fonetike janë ruajtur. Shumë fjalë të reja i janë nënshtruar fondit gramatikor të së folmes së çamërishtes.

<sup>488</sup> Riza, S: *Pesë autorët më të vjetër të gjuhës shqipe,- krestomati thjesht gjuhësore*, Tiranë, 1961/ 66.

*strehōjw:m?)*<sup>489</sup>; disa fjalë të pandryshueshme të ligjëratës, si: *shklata, çish, eni, oj, nek etj.*

Të gjitha përqsjet e trajtuara më lart dëshmojnë afrinë midis dy të folmeve, për rrjedhojë, atë çfarë kanë dëshmuar kurdoherë studiuesit në vite: **afrinë midis dy dialekteve tona në fazat më të hershme parabuzukiane.**<sup>490</sup>

Një tjetër përqsje e trajtuar është edhe përqsja **midis të folmes së çamërishtes dhe të folmes arvanitase.**

Fillimisht kemi cituar prej M. Likut disa të dhëna rreth emërimit të hershëm të shqiptarëve: “me emrin *Albanoi / Alvanoi, Albanites* ose *Arvanites* grekët quanin më parë të gjitha fiset ilire fqinje, të cilat flisnin një dialekt të përbashkët, kishin të njëjtat zakone dhe mënyrë të njëjtë të jetesës me fisin *Albanoi*. Më vonë emrin *Albania, Albani* e morën italianët prej grekëve dhe pastaj prej këtyre të fundit popujt e tjerë të Evropës”.....<sup>491</sup> e të tjera si këto..

Na ka tërhequr vëmendjen gjatë punës edhe emërtimi i arvanitasve, për të cilin kemi dhënë disa shpjegime duke iu referuar autorëve që janë marrë me këto çështje “Dallimi i emërtimeve të shqiptarëve, *arvanitas- allvanos*, lidhet me një fakt historik, atë të mbetjes jashtë territorit të Greqisë së sotme pas shpalljes së Pavarësisë së saj më 1821-in, të krahinës së Çamërisë, e cila në vitet në vazhdim mbeti nën drejtimin e Turqisë. Kjo qe edhe arsyeja pse çamët u quajtën *allvanos* dhe jo *arvanitas*.<sup>492</sup> Nga ana tjetër, emërtimi *arvanitas* dhe jo *arbëresh* shpjegohet me faktin se grekët shkronjën B të alfabetit latin e lexojnë V. Ndërsa, turqit arvanitasit i quajtën *arnaut* ose *arnavud*, kurse arvanitasit ortodoksë të Kostandinopojës dhe të Egjiptit i quajtën *greci*.

Si pikë referimi për të folmen e arvanitasve kemi pasur tekstet e Reinholdit , pranë Institutit shkencor të Tiranës, por edhe këto tekste të transkriptuara prej A. Klosit

Disa dukuri të përbashkëta gjuhësore midis **teksteve të Reinholdit dhe çamërishtes së sotme**<sup>493</sup> janë:

- *H-ja* e fortë ( $\chi$ ) , e ndryshme nga një *h* e fortë e shqipes të cilën Reinholdi e shënon herë me  $\chi$  dhe herë me *ch*.
- Grupi *ng* , të cilin, Reinholdi herë e shënon me  $\check{c}$  e herë me *k*, por që transkriptuesi<sup>494</sup> e ka shënuar thjesht me *ng*: *nga, ngalkonj*. Lidhur me këtë dukuri, ne mendojmë se këtu bëhet fjalë për asimilim të grupit *ng*, gjë që ndodh edhe në çamërishte, si rezultat të të cilit kemi herë *k* e herë *g*: *nga > ka, ngarkoj > garkonj, ngas > gas etj.*;
- Përdorimi i rregullt i një *-i-je* në vend të fonemës *y*, ndodh në të dyja të folmet, me përjashtim që, tek Reinholdi ndonjëherë në raste të rralla kjo zanore

<sup>489</sup> I pranuar konvencionalisht si term

<sup>490</sup> Çabej, Riza, Ajeti, ismajli, Demiraj, Topalli, Shkurtaç, Lafe, Beci etj. Për më shumë shih Shih revistën Buzuku

<sup>491</sup> Hoxha, Sh. *Kontributi i Uilljëm Martin Likut në fushën e studimeve albanologjike*.f. 66, Prishtinë 2007.

<sup>492</sup> Llalla, A. *Arvanitasit – Çamët në etnikumin shqiptar në Greqi (arvanitasit themeluesit dhe drejtuesit e Greqisë moderne 1821-2005, kumtesë e mbajtur në Seminarin Ndërkombëtar të Albanologjisë, Tetovë-Ohër, 16-23 Shtator 2007*

<sup>493</sup> Si pikë referimi, lidhur me këtë çështje kemi pasur tekstet e Reinholdit të transkriptuara në shqip nga studiuesi Klosi, A: *Netët Pellazgjike të Karl Reinholdit* ( Tekste të vjetra shqipe të Greqisë mbledhur nga Karl Reinholdi 1850-1860, (K&B), Tiranë, 2005.

<sup>494</sup> Klosi, A. *Netët Pellazgjike të Karl Reinholdit* ( Tekste të vjetra shqipe të Greqisë mbledhur nga Karl Reinholdi 1850-1860, (K&B), Tiranë, 2005.

- shfaqet: *tharëtyrë, vërtyt, fëndyell, detyrë* etj; kujtojmë se në çamërishte në vend të saj ndonjëherë gjejmë zanoren *u*: *dusheme, duqan* etj;
- Ruajtja e *ë-së* së patheksuar në pozicion fundor: *dhelpërë, këmbëtë, gjatorëtë, të parëtë* etj;
  - Shndërrimi i zanores *-ë* në *-i*, në rrënjë të fjalës: një,- njëut , njëra etj. Nga të dhënat sot në çamërishte kemi *njira, një-it*.
  - Ruhen grupet *gl, kl*: *i glatë, klishë, klumësht* etj.
  - Për sa i takon dukurisë së asimilimit njëlloj si tek Reinholdi kemi asimilimin e grupeve bashkëtingëllore: *mb > b* ( R: *banj*; çamërishte: *bi* ); *nd > d* ( *donjë*), *nx > x* ( *xuar*) *xv > x* ( *xarris*). Për sa u takon grupeve, *mb > m* ( mërda), *pm > m* ( jammë); në çamërishte kemi *mb > b*( bërna), *pm > mn* (jamnë).
  - Edhe në çamërishte *q < ç* dhe *c > ç* (*qysh- çish; cili- çili*)
  - Metafonia është një dukuri po aq vepruese edhe në çamërishte madje tek të njëjtat fjalë, p.sh: *kulaç- kuleçe, çurap- çurepe, shatë- shetër, peshq- pishq, i glatë- të glet* etj.
  - Edhe në çamërishte kemi shmangie e rasave dhanore dhe rrjedhore si: *vuante ka uria, e muarë sish* (Reinholi: *jashtë nga mëkati*);
  - Mbaresa e rasës kallëzore për emrat mashkullorë është *në*. Kjo e fundit shpesh asimilohet në *ë*, sikurse në çamërishte: *ciapnë, varrnë, gjatorë, burrë* etj.
  - Foljet joveprorë të së kryerës së thjeshtë sikurse tek Reinholdi kanë shpesh mbaresën *sh*: *u dogjsh, u poqsh, u zushë* etj, trajtë e cila dëshmohet edhe tek Buzuku.<sup>495</sup>
  - Mbaresa e së pakryerës në vetën e tretë ka mbetur po ajo e shqipes së Peloponezit edhe sot ndër çamë të vjetër: *lij*, ( *linte*), *mbaj* (mbante), *vej* ( *vente*), *vdis* ( *vdiste*), *piq* (piqte) etj.<sup>496</sup>
  - Përsa i përket të kryerës së thjeshtë, mbaresa 0 e vetës së tretë njëjës del në çamërishte sot tek foljet që dalin me diftong *xuar, muar, suall* etj.
  - Përsa i përket ndërtimeve me *pa* ato janë mjaft të pranishme edhe në çamërishte. Mendojmë se nga shembujt e trajtuar të Reinholdit *pa të pienj, pa t'e ndiejmë*, nuk bëhet fjalë për trajtat *pa pyetur* , *pa ndierë* ( siç shpjegohet nga autori), por për një trajtë të veçantë të çamërishtes të cilën e dëgjojmë mjaft mirë edhe sot : *pa t'e ndoqi me vrap, pa t'ia dha të qarit* ( *pa* = menjëherë), *pa t'e qëlloi* etj.

Përgjatë studimit të këtyre të folmeve, analizave dhe përjasjeve kemi vënë re se shpesh është folur nga studiuesit, kryesisht transkriptuesit *për shqiptim individual të Buzukut* ( Selman Riza), *gjallëri dhe ritëm të Patër Vasilit* ( A. Klosi), mënyrë e të folurit e Marko Boçarit (Liku) ...etj.

Nga ana tjetër, si njohëse dhe studiuese prej vitesh e çamërishtes, kam arritur në përfundimin se nuk kemi të bëjmë as me shqiptim individual të Buzukut<sup>497</sup>, as me gjallëri dhe ritëm të Patër Vasilit<sup>498</sup>, apo të Marko Boçarit, **por me një veçori karakteristike të shqipes së vjetër.**

Kemi vënë re në studimet për këtë të folme edhe shumë fjalë të ngjashme ( të njëjta tek të gjitha këto të folme, si: *Botë* ( dhe), *çep* ( sqep), *dreq*( drejt),

<sup>495</sup> Klosi, A. Po aty f.19

<sup>496</sup>Troplini, E. *Sistemi foljor i çamërishtes në diakroni*, në Aktet e Seminarit të III-të Ndërkombëtar të Albanologjisë, Tetovë 2010

<sup>497</sup> Riza, S: “Gjon Buzuku (1555)”, *Pesë autorët më të vjetër të gjuhësisë shqiptare, \_Krestomati thjesht gjuhësore* , f.378.

<sup>498</sup> Klosi, A: *Netët Pellazgjike të Karl Reinholdit* ( Tekste të vjetra shqipe të Greqisë mbledhur nga Karl Reinholdi 1850-1860, (K&B), Tiranë, 2005.

*nglaturë*( shtrirë), *nguq*( skuq), *fëmilë* ( R.-fëmiljë: familje), *glanë* ( ngjanë), *gjator* ( gjahtar), *gjegj* ( dëgjoj), *nuku* ( R. nëkë: nuk), *njegulli* ( R. mnjegull: mjergull), *parë* ( përpara), *pluhurë* (R. plëhurë: pëlhurë), *pishq* (peshq, -tek çamët në Çamëri), *qesh* ( vë në lojë), *thom* ( them), *u* (unë), *u-ja* ( urija) etj.

**Shumë dukuri të ngjashme shfaq e folmja e çamërishtes me të folmet arbëreshe**<sup>499</sup> Një toponim interesant që i përbashkon arvanitasit dhe arbëreshët, për rrjedhojë dy të folmet përkatëse, si dëshmuese të fazave të kapërcyera të shqipes, është Shën Mitri i Koronit, toponim i ruajtur prej arbëreshëve të Italisë së Jugut me origjinë More-në, apo të ashtuquajturin Peloponezin e sotëm në Greqi.

Disa fjalë të përbashkëta midis të folmes së Lekë Matrëngës, shqipes së Peloponezit perëndimor<sup>500</sup>, dhe çamërishtes së sotme, përfshirë këtu edhe disa dukuri fonetike brenda tyre, janë fjalët: *glas* ( gas, ngas), *helmonem* (helmohem), *ishtë* ( është), *klënë* ( qënë), *psonj* (M. mbsonj, R. mbsonj, mpsuaritë,- mësoj), *nuku* (M/R. nëkë, nuk), *përzierë* ( takuar) *pra* ( pasataj), *rerazë* ( gënjeshtër), *sherti* ( M. sherëtinj, R. sherëti, psherëtij), *dergjej* ( lengonte), *thom* ( them), *u* ( unë), *u-ja* (urija), *vashëzë* (vajzë), *vetëhe* ( veten), *jatri* ( barë, ilaç, në çamërishte kemi edhe jatro<sup>501</sup>, - mjek), *kurm* (trup), *pisë* ( i zi sterr).....etj

Me interes për t'u trajtuar janë edhe greqizmat e përbashkëta midis dy të folmeve që **përdoren në çamërishten e sotme**, si: *aguridhe* (e papjekur), *allonar* ( korrik), *dhaskal* ( mësues), *dhimon* (R/ B. dhemon, - shosh ), *dhipllo* ( dyfish), *fahji* ( h-X , B. /R: faji/fagi,- gjellë), *farmëk* (e hidhur), kallmar (B./ R. kallamar,- lloj ëmbëlsire), *kallathe* ( shportë), *karfos* B./R. mbërthej, gozhdoj ; çamërishte qepje me gjilpërë të madhe gjëra të trasha : *i karfosa dushekët*), *kurm* ( trup), *lavomë* ( plagë, nuk shihet me sy), *migladhë* ( B./R: migdhale), *nikoqir* (i zoti shumë ), *pis* ( skëterrë), *qerdhes* ( fitoj, e qerdhese- e fitove), *taks* ( taks diçka dikujt).

Në të folmen e çamërishtes spikasin edhe disa fjalë për të cilat mendojmë se dikur mund të kenë qenë njëlloj si në të folmen e Buzukut, Reinholdit, Boçarit etj., por që sot në këtë të folme ato kanë ndryshuar sipas shqipes së përgjithshme. I tillë është rasti i fjalës *qell*, të cilën në çamërishte e gjejmë në trajtën *sell* ( shqip folja *sjell*), *shtrenjtirë* / të *shtrenjtëtë*; në çamërishte: *ngursier* ( i kursyer, kursimtarë), *fufjuakë/ fufjuvajkë*; në çamërishte: *kukumjaçe* ( kukumjaçkë); *i halkomtë*; në çamërishte, *bakvër* ( bakër); *amarti*: në çamërishte: *gjulah* ( gjynah, mëkat) etj. Këto shembuj por edhe shumë të tjerë si këto, tregojnë se nuk mund të shmangen zhvillimet brenda të folmeve.

Gjithmonë duke iu referuar përfundimeve rreth çamërishtes, rendisim më poshtë disa prej dukurive të përbashkëta midis të folmes në fjalë dhe të folmes së arbëreshëve.<sup>502</sup> Për rrjedhojë midis dy të folmeve vihen re këto ngjashmëri:

- Mungesa e fonemës *y* dhe përdorimi në vënd të saj i fonemës *i*: *grika*, *frin*, *gjims*, *bin* etj (Lamberci, Demiraj, Solano, Altimari)
- Ruajtja e grupeve të vjetra *kl*, *gl*: *gluha*, *glishti*, *klisha*, *kliçi*, *kloft* etj. ( Lamberci, Demiraj, Solano)
- Ruajtja e tingullit *l* në fjalë të tipit *bilë*, *golë*, *ndëlesë* etj, dukuri kjo e cila paralelisht shfaq risi në të dyja të folmet: si në të folmen e çamërishtes ashtu edhe në të folmen e arbëreshëve të Horës.

<sup>499</sup> Kjo e folme nuk qëndron pranë të gjitha të folmeve njëlloj.

<sup>500</sup> Të spikatura prej A. Klosit po aty.

<sup>501</sup> Shumë fjalë të tjera si kjo janë huazime greke në të tri të folmet.

<sup>502</sup> Shkurta, Gj. "Ligjërimet arbëreshe" ( shqyrtime dialektologjike dhe sociolinguistike në ngulimet arbëreshe të Italisë), f. 151, Tiranë, 2006.

- Lidhur me dy dukuritë paraprijëse, si areale ruajtëse Solano konsideron edhe ruajtjen bashkëtingëllores *l* në grupet *pl, bl, fl, pl: plak, plëh, bluanj, blenj, flutur, flamur* (Solano)
  - E ashtuquajtura rasë vendore: *ndë dhet, ndë kamaret* (Demiraj)
- Të tjera dukuri të përbashkëta midis të folmeve arbëreshe dhe çamërishtes sipas të folmeve të caktuara arbëreshe., janë: <sup>503</sup>
- Tek e folmja e **Marçeduzës** vihen re këto bashkëpërkime<sup>504</sup>: mungesa e fonemës /y/; fonemat /a/, /e/, /i/, /o/, /u/ në pozicione para dhe pastheksore janë të shkurtra edhe në çamërishte; të gjata vihen re ato kur janë të theksuara; fonema /ë/ në pozicion paratheksor ka të njëjtën prirje edhe në çamërishte , të kalojë në /i/ (kijo); edhe në çamërishte ruhet ende –ë-ja fundore: *bukënë, ditënë* etj; në përbërje të fjalës spikat togu *ua* me theks tek *u-ja: dual, martuarë, ndërtuarë, grua, duamë* etj; *ie* me theks tek *i-ja: shërbier, krietë, ngrie (grie- çamërishte), thier, shklier* etj.; ruajtja e grupeve të vjetra *kl, gl*; përdorimi i trajtës së shkurtuar *-u* të përemrit vektor “*unë*”<sup>505</sup>.
  - Tek e folmja e **San Marcanos** përveç dukurive në fjalë vihen re këto bashkëpërkime: kalimi i *e-së* së theksuar në –ë: *dhëmb, brënda (bërna), gjëmb (glëmb), zëmbra* etj; kalimi i – ë-së paratheksore në –*u* dhe i –*o-së* së patheksuar në –*u*: *shurbej, kushtu*; urizi etj.; ruajtja e gjatësisë së hershme të zanoreve të theksuara, sidomos tek rrokjet e hapëta fundore; ruajtja e gjinisë asnjane në disa fjalë si: *të parët, të klarët*; disa paradigma zgjedhimi të formave foljore krejtësisht të ngjashme me çamërishten e sotme (të cilat nuk janë të vetmet): *u vata, ti vate, ai/ajo vati ; ne vatëm, ju vatët, ata/ ato vatën; u pava , ti pave, ai/ajo pavi; ne pavëm, ju pavët, ata/ ato pavën; U trëmbemë, ti trëmbë, ai/ajo trëmbetë; ne trëmbemi, ju trëmbeni, ata/ato trëmbenë etj.*; trajtat e se shkuarës në pësore: *u ka bënë*<sup>506</sup>; ngjashmëri tek ndajfoljet, para-fjalët, numërorët, lidhëzat etj. <sup>507</sup>; ngjashmëri në leksik<sup>508</sup>: *Dhez, gjegj, dërsinj, duami, frin, glemb, glisht, klumusht, klič, krie, kushtu, ljip (lip), nguqet ( skuqet), nxiret ( nxihet), si, shomi, urja ( uja, uria), valje ( valë, vaj), ve: ( vezë), ble:t (koshere), gjellë ( jetë), se di:j ( se dinte) etj.* Afria midis këtyre të folmeve vërteton edhe një herë atë fakt të shumëpohuar prej studiuesve : afrinë midis dialekteve tona në kohë të hershme.<sup>509</sup>

Pas kësaj këtyre përjasjeve kemi arritur në analiza konkrete lidhur me të folmet. Shkurtimisht ripërsërisim disa prej tyre:

Nuk mbështesim kurrësesi mendimin se arbërishtja është një formë dialektore më vete, por mendojmë se kemi të bëjmë me një variant të një të folmeje. Edhe ky i fundit është një emërtim konvencional nëse do t’i referoheshim *fondit të saj kryesor* të krijuar, duke e dalluar atë nga *elementi i sjellë me vete*, siç pohon edhe prof. Shkurtaç: *dokumentet historike përmendin shtegtime drejt Italisë së shqiptarëve nga Kruja, Shkodra, Durrësi etj.....*<sup>510</sup>

<sup>503</sup> Shkurtaç, Gj. “Ligjërimet arbëreshe” ( shqyrtime dialektologjike dhe sociolinguistike në ngulimet arbëreshe të Italisë), f. 151, Tiranë, 2006.

<sup>504</sup> Shkurtaç, Gj. Po aty, f. 153

<sup>505</sup> Në këtë të folme sipas autorit vihet re edhe përdorimi një trajte tjetër të përemrit vektor *unë* , trajta *ure*.

<sup>506</sup> Edhe këtu pjesorja e foljes *bej* del njëlloj si në çamërishte.

<sup>507</sup> Shkurtaç, Gj. Po aty , f. 181.....

<sup>508</sup> Këtu kemi përfshirë edhe fjalët që dallohen nga tipare fonetike karakteristike të të dyja të folmeve.

<sup>509</sup> Çabej, Riza, Ismajli, Ajeti, Lafe, Topalli, Demiri, Shkurtaç, Beci, Mansaku..... etj.

<sup>510</sup> Shkurtaç, Gj. “Ligjërimet arbëreshe” ( shqyrtime dialektologjike dhe sociolinguistike në ngulimet arbëreshe të Italisë), Tiranë, 2006.



Pas një përpunimi të dhënash prej çabejt, Demirajt dhe këtij citimi të sapo bërë nga Shkurtaj, kemi arritur në përfundimin se kjo çështje mjaft delikate vazhdon ende të kërkojë përgjigje **dhe se problemi duhet trajtuar që në origjinë të shpërnguljeve**. Mendojme gjithashtu se elementet gege nuk janë gjë tjetër veçse refleksi i situatës së depërtimit të arbëreshëve matanë kufijve në faza të ndryshme kohore. Megjithatë, një gjë e tillë provohet vetëm përmes studimeve të thelluara që lidhen me një çështje të tillë.

**Lidhur me të folmen e çamërishtes në kuadër të shqipes standarde kemi arritur në këto përfundime:**

Edhe pse e folmja e brezit të vjetër në **thelb është konservuese**<sup>511</sup>, **orientimi kah standardit dhe shqipes së përgjithshme nis që me brezin e vjetër**. Ky është një proces në rritje që fillon nga folësit e moshave të thyera, deri tek folësit e moshave më të reja. Orientimin kah shqipes së përgjithshme si fenomen të vërejtur në brezin e vjetër, fillimisht e kemi vërtetuar nga krahasimi i të dhënave të çamërishtes së sotme me çamërishten e hershme. Tek ky brez spikasin disa dukuri tipike çame, të cilat gjejnë përdorim të rrallë tashmë (të dysorësuar) përkrah trajtave gjegjëse të shqipes së përgjithshme, që ndër të tjera shfaqen të ngulitura, si: kalimi i zanores **i** të dikurshme në **ë** të theksuar (*hingra/ hëngra*); këmbimi i **j**-së në **q** (*mi:jtë/ miqtë, fi:jtë/ fiqtë, ple: jtë, pleqtë, poqmë/ pojmë, doqmë/ dojmë*); vendosja në gjininë femërore të emrave femërorë që dikur përdorshin në gjininë mashkullore, si *evropi, tenxheri*<sup>512</sup>; bjerrja e formimit të shumësit me **-l**, në fjalët që në njëjës mbarojnë me **-ll** (*kokall- kòkale*); bjerrja e formave të vjetëruara të përemrave të pacaktuar, *gjithëçili, shdononjë, akëç, shdo, dish*; bjerrja ndonjëherë edhe e trajtave sigmatike të foljeve, *shoh (paç/ pashë), jap (dhaç/ dhashë), bie (raç/ rashë)* etj.

Theksojmë se shumë dukuri të së folmes, janë bjerrë që me brezin e vjetër dhe janë zëvendësuar me dukuri të shqipes standarde. Kështu tek ky brez vihet re, përdorimi i togzanorit **ie**, në vënd të diftongut *ie: pìes/ pyes, diel/ djem* etj); shfaqja e dukurisë së rotacizmit tek folja *bëj*. Tek ky brez gjejmë të përdorur në trajtë bilinge format *bënë/ bërë*. Duke mos dashur të përmendim me radhë dukuritë për arsye të kufizimit në numër faqesh që na vendos ky autoreferat, po ilustrojmë vetëm përmes shembujve: tek brezi i vjetër përdoren në trajta bilinge: *baj/ mbaj, gas/ ngas, noonjë/ ndonjë* etj.); *atë/ atë, ajo/ ajo, ai/ ai, ù/ unë* etj.

Tek ky brez, përdorimet bilinge të shqipes së përgjithshme me ndonjë interferencë prej të folmeve të bashkësive pritëse, vihen re edhe në fushën leksikore, p. sh: *Vorua / oborr, sendon/ çarçaf, papllom/ jorgan, vlad/ dybek, pampuar/ vaporr, cinura/ qerpikë, koca/ gërshet, thapë/ thonj, zahër/ sheqer, purtek/ bostan, thimilkua/ shalqin, mirgale/ bajame, vrakazon/ ushkur, jatrúa/ doktor, dhaskal/ mësues, evlat / fëmi, sabi / foshnje, i shklarë / i çmendur, gërlak/ gurmaz, davet/ gosti, torriar/ rrugaç, umidh/ shpresë: ban umidh- mban shpresë, tumene/ dimiq, parathire/ dritare, farmak/ i hidhur, pelister/ pëllumb, stere/ tokë. Alltën/ flori, sufrà/ sofër, hanë/ shtëpi, llufë/ baluke, fahi/ gjellë, tëmël/ ëmbëlsirë, tharrtirë/ dhallë, potiqe/ pandofla/ shapka, vraka/ pantallona, konoxhup / xhup, feste/ qeleshe, kumbi/ sumbull, ledh/ mur, qaramidhe/ tjegulla, katua/ bodrum, kalive/ kasolle, qerreste/ ristela, azves/ gëlqere, gon/ nip, gone/ mbesë, çeç/ vëlla i madh, kër/ gomar, mjalca/ bletë, vurc/ iriq,*

<sup>511</sup> Troplini, E. *Disa tipare ruajtëse të çamërishtes*, në revistat: “Aktet..” (II), Tetovë 2009; “Universi” (XI), Tiranë 2009.

<sup>512</sup> Shih: Haxhihasani, Q. “Vështrim i përgjithshëm mbi të folmen e banorëve të Çamërisë”, në «Dialektologjia shqiptare», vëll.I, Tiranë, 1971, vëll.II, Tiranë

*karakaçe/ laraskë, skanjo/ karrige, buhar/ oxhak, postër/ postiqe, klidhonë/ drynit, lien/ legen.*<sup>513</sup>

Për të qartësuar lexuesin rezultatet i kemi paraqitur përmes një tablele:

Brezi i vjetër

1	<b>Dukuri të ruajtura të fizionomisë çame. (mbizotëruese)</b>
2	Prania e dukurive të standardit në të folmen e tyre
a	Dukuri të çamërishtes që janë bjerrë dhe janë zëvendësuar me dukuri të standardit
b	Dukuri të çamërishtes që përkojnë me ato të standardit.
3	Interferencat (ndërfutjet) nga e folmja e bashkësive pritëse.

Çfarë vërehet në brezin e mesëm?

Për sa i takon dukurive karakteristike të fizionomisë çame, tek ky brez vihen re<sup>514</sup> ruajtjet vetëm nëse ky përdorim bëhet në rrethana të caktuara, ku folësi gjendet gjithmonë i kushtëzuar nga e folmja, ambienti dhe i tërë konteksti çam.

Në brezin e mesëm janë të shumta edhe interferencat nga e folmja e bashkësive pritëse në të cilën ato janë vendosur. Duke marrë si shembull bashkësitë pritëse të Shqipërisë së Mesme, është vënë re se përkarshi formave të ngulitura të standardit në brezin e mesëm gjejmë përdorim në trajta bilinge disa interferenca nga e folmja gegërishtes së Shqipërisë së Mesme, si:

Brezi i mesëm

1	Prania e dukurive të standardit në të folmen e tyre
2	Dukuri të ruajtura të fizionomisë çame (në trajta bilinge dhe të kushtëzuara kontestualisht)
3	Interferenca ( ndërfutjet) nga e folmja e bashkësive pritëse.

Tek brezi i ri përveç ndonjë ruajtje si: theksi sintaktik, dukuria e elidimit apo mosshfaqja e rotacizmit tek pjesorja e foljes bëj etj., (që ndër të tjera do të trajtohen më poshtë në vendin përkatës); dukuritë e tjera megjithë përdorimet e tyre bilinge në brezin e mesëm janë bjerrë plotësisht.

**Çamërishtja puthuajse nuk përdoret fare në brezin e ri çam.** Të rinjtë çamë sot, përveç disa interferencave (ndërfutjeve) të vogla nga bashkësitë pritëse **flasin gjuhë letrare standarde.**<sup>515</sup> Për këtë, folësit e këtij brezi ndihmohen edhe nga prirja që përbashkon sot mbarë brezat e rinj, -përpyekja për të normëzuar dhe pasuruar të folmen e tyre.<sup>516</sup>

Faktorë motivues të këtij orientimi janë edhe, prestigji që gëzon gjuha standarde shqipe dhe, **origjina e çamërishtes, si pjesë e nëndialektit të toskërishtes jugore.** Këto dy faktorë veprojnë njëri me tjetrin në trajtën e dy enëve

<sup>513</sup> Troplini, E. *Hulumtime sociolinguistike në disa mjedise çame të rrethit të Durrësit*, në "Aktet" e Seminarit II Ndërkombëtar të Albanologjisë, Shtator 2008.

<sup>514</sup> Me ndonje përjashtim të vogël, të atyre dukurive që shfaqin shenja të theksuara bjerrjeje që në brezin e vjetër.

<sup>515</sup> Kemi vënë re madje që, kur flitet për qytetin e Durrësit, interferencat nga e folmja vendase janë më të mëdha në qendrat urbane sesa ato rurale, për shkak të prestigjit që gëzon sot e folmja e qendrës.

<sup>516</sup> Shkurtaj. Gj: *Sociolinguistika*, SHBLU, Tiranë 2003.

komunikuese<sup>517</sup>, duke arritur në të vetmin funksion: ndryshimin e së folmes çame kah standardit.

Në të folmen e çamërishtes së brezit të ri çam kemi vënë re edhe një dukuri tjetër që vështirë të haset në të folmet e tjera. Folësit e këtij brezi janë në shpirt mjaft konservator. Kjo e fundit lidhet me kultivimin shpirtëror të gjuhës, gjë që verifikohet me faktin se ato janë njohës të mirë të së folmes së origjinës. Kjo njohje nxitet edhe nga përdorimet e herëpashërshme të çamërishtes nga gjyshërit e tyre në familje dhe, në rrethana të caktuara nga prindërit apo motrat dhe vëllezërit e mëdhenj. Ato herëpashere retrospektojnë. Perceptimi i vuajtjeve të të parëve të tyre ka kultivuar tek ata revoltën, që shpërthen në ambjente të caktuara, folklorike, në mënyrën e jetesës, në fushën e veprimtarive të ndryshme atdhetare, politike, shpirtërore, etj. Të tëra këto më pas gjejnë deri diku edhe shfaqjet e veta në ligjërim.

Në brezin e mesëm pamë se ishte më e pranishme dukuria e “ndërkomunikimit”, përzierjes dhe ndërhyrja e fortë e faktorëve të jashtëm. Ato herëherë tërhiqen nga e folmja e bashkësisë pritëse, herë nga ajo e origjinës dhe, në të shumtën e rasteve edhe kah e reja. Dukuria e dysorësisë në të folur (një lloj bilinguizmi dialektal) e cila është e pranishme në të tre brezat, tek brezi i mesëm është mbizotëruese. E folmja e tyre luan rol vendimtar për zhvillimin e **dy poleve të kundërta, të lartpërmendura; konservues dhe inovues në të njëjtën kohë**. Pra, në këtë brez **procesi i tretë** shfaqet në formën e vet më të qartë, në krahasim me dy brezat e tjerë. E folmja e brezit të mesëm është dëshmuar e ndryshimit dhe e përzierjes. Në këtë mënyrë ajo ka shërbyer si urë kalimi midis dy poleve të kundërta ruajtjes dhe rinovimit. Janë pikërisht këto dy forca, që e bëjnë gjuhën e tyre, sidomos të folmen e brezit të mesëm jo vetëm interesante, por edhe të ndryshme nga të folmet e tjera. Në vërejmë që në kontekste çame, ato përdorin të folmen e çamërishtes. Përmes komunikimit gjithmonë çamërisht me më të moshuarit, ky brez ndihmon jo vetëm në ruajtjen e elementeve çame tek më të vjetërit, por edhe në kultivimin e ndjenjës së fortë për çamërishten tek më të rinjtë. Për këtë arsye të rinjtë e sotëm janë edhe njohës të mirë të kësaj të folmeje.

**Përmes çamërishtes kemi arritur në përgjithësime edhe për të folme të tjera të diasporës.**

Për të folmen e arbëreshëve mendoj se gjithçka thuhet prej Kostallarit në këto rreshta: *...arbëreshët janë shquar dhe do të shquhen në përpjekjen e tyre për të ruajtur gjuhën mëmë....., për të ruajtur vlerat kombëtare të trashëguara të traditës dhe, në veçanti përpjekja për të asimiluar sadopak gjuhën letrare kombëtare, një gjuhë e unifikuar dhe e përbashkët për të gjithë, duke e bërë atë mjet të pazëvendësueshëm të vetkonservimit etnik ..... duke ndjekur gjithnjë shembullin e traditës kombëtare.”*<sup>518</sup>

Ndërsa për të folmen e arvanitasve çështja paraqitet më e ndërlikuar pasi, duke bërë një krahasim midis arbëreshëve të Italisë dhe arvanitasve të Greqisë, mendojmë se këto të fundit me të vërtetë janë “të pafat”<sup>519</sup>: *...arvanitasve u munguan dy kushte: Dallimi fetar me grekët, me të cilët ata bashkëjetojnë dhe një mit përforcues dhe themelues identitar, siç ka qenë për arbëreshët miti i Skënderbeut.....*<sup>520</sup> Pra, pavarësisht fateve të njëjta, jeta e dy të folmeve nuk ka qenë e njëjtë:

<sup>517</sup> Parapëlqejmë këtu të përdorim një term të studiuesit Selman Riza, të spikatur nga prof. Shkurtaj.

<sup>518</sup> Kostallari, A.: *La diaspora albanese, il dialetto e la lingua letteraria nazionale unificata*, Kongresi I (4/7), Palermo 1985.

<sup>519</sup> Term i përdorur prej Altimarit

<sup>520</sup> Altimari, F. *Arvanitasit e greqisë, më të pafat se arbëreshët e italisë*, intervistuar nga, Lorenc Rabeta, gazeta “SHQIP”

**Pas këtyre trajtimeve pavarësisht rrethanave që shoqërojnë këto të folme, kemi arritur në perfundimin se, gjuha standarde luan një rol të rëndësishëm në unifikimin e gjuhës dhe rrafshimin e diferencave etnike në të folur.** Kemi arritur në këtë përfundim jo vetëm duke shqyrtuar raportin “*shqipe zyrtare*” dhe “*e folme krahinore*”, por edhe përmes një sprove të shqyrtimit të diferencave në sjelljen gjuhësore të individit, rendimentin që mund të ketë ai, si bartës i një deficiti të dukshëm gjuhësor, si pjesë e një bashkësie të tillë shoqërore.

Gjithmonë kemi qenë të bindur për rolin vendimtar të faktorëve jashtëgjuhësorë në jetën e të folmes, një prej të cilëve me një forcë të konsiderueshme në procesin e konservimit të të folmeve në fjalë, është faktori psikologjik i shpërnguljes së këtyre popullsive. Sigurisht në ruajtjen e një të folmeje ndikojnë pashmangshëm edhe faktorë të tjerë jashtëgjuhësorë me rrënjë tek i pari, po aq vendimtar për këtë proces, si: dashuria për vendin e të parëve, krenaria e të qenit arbëresh, arvanitas, shqiptar, çam etj. Pas kësaj, problemet më të larmishme për t’u trajtuar mbeten: çështje të bilinguizmit dialektal, mënyra e integritit, llojet e pabarazive gjuhësore, konformizmi dhe individualizmi, problemeve sasiore të ligjëritit etj. Kemi të bëjmë, me një larmi faktorësh të cilët na çojnë në konkluzione me interes rreth marrëdhënive të sotme, *e folme krahinore* e një tipi të caktuar (në rastin tonë, çame), *e folme etnike*. etj: *-gjuhë shqipe standarde*.

Standardi përmbush me sukses funksionin e tij në institucionet tona dhe prirja e tij unifikuese mbizotëron. Gjatë vëzhgimit në institucionet shkollore nxënësit me origjinë çame mund t’i identifikojë ose nga mbiemri i tyre, ose gjatë një vëzhgimi afatgjatë të së folmes nga ndonjë rrëshqitje e rastit të ndonjë dukurie kryesisht fonetike. Edhe tek të folmet në fjalë, dallohen qartë tiparet e dy varianteve a llojeve të të folurit, variantit tradicional, ku spikat ruajtja e elementeve të qëndrueshme të sistemit të vjetër dhe variantit të ri<sup>521</sup>, që pasqyron më gjerë shndërrimet dhe ndryshimet e sistemit nën trysninë e makrosistemit.<sup>522</sup> Sa më i dukshëm paraqitet hendeku midis variantit tradicional dhe atij letrar, aq më të shpeshta janë edhe paragjykimet në sjelljen gjuhësore të individit. Deficiti gjuhësor (shoqëror) është më i theksuar për të folmet në shqyrtim.

Vërtetë, *në konfliktin midis vlerave të grupit me bazë krahinore, shoqërore dhe vlerave të kombit, vlerat e kombit triumfojnë në kurriz të grupit më pak të fuqishëm*<sup>523</sup>, por nga ana tjetër, ky pohim është i ndjeshëm ku më shumë dhe ku më pak në përshtatje me jetën e secilës prej të folmeve. Në rastin tonë flitet për të folme të gjendura në mesin e ambienteve të ndryshme, të një kulture, gjuhe dhe mënyre jetese të ndryshme, nën trysninë e një situatë bilinge, a diglosie të vazhdueshme,

Si përfundim mund të themi se për studimin e gjuhës shqipe luan një rol të padiskutueshëm secila prej të folmeve të saj. Për gjuhën shqipe dhe historinë e zhvillimit të saj, aty ku na vjen në ndihmë arvanitishtja, nuk mund të na vijë në ndihmë arbërishtja dhe aty ku na vjen në ndihmë çamërishtja nuk mund të na ndihmojnë të folmet e tjera krahinore. Mbështesim mendimin e prof. Altimarit, apo prof. Kostallarit etj. kur pohojnë se, në këto të folme nuk ka faza, nuk ka zhvillim kah shqipes së përgjithshme siç ndodh me të gjitha të folmet dialektore të gjuhës shqipe në

<sup>521</sup> Shkurtaj, Gj: *Disa dukuri të së folmes së Kurbinit në dritën e sociolinguistikës*, SF, 1998.

<sup>522</sup> Shkurtaj, Gj: *Sociolinguistika*, SHBLU, Tiranë 2003.

<sup>523</sup> Sipas Hudson, A. R. *Sociolinguistika* (botimi i parë në shqip), Tiranë 2002, f.233, cituar edhe në punimin *Teoria e deficitit gjuhësor në kuadrin e kontakteve të sotme të shqipes*, kumtuar dhe botuar në "Seminarin Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën shqiptare, f. 377, Prishtinë 2010"

tërësi, por nga ana tjetër mendojmë se zhvillimi kah shqipes së përgjithshme tek këto të folme nuk mungon, por ku më shumë dhe ku më pak ai **përkufizohet i ngadaltë**.

Dhe së fundmi themi se **raporti e folme krahinore – e folme standarde nuk mund të shihet jashtë raportit kulture krahinore- kulture qytetare, pasi gjuha nuk mund të shihet jashtë raportit, gjuhë- kulturë, gjuhë – mendim**.

Një tjetër shembull tipik për këtë janë diferencat gjuhësore që lidhen me fushën e paragjyqimit gjuhësor. I pari që ka studiuar një dallim të tillë është Basil Bershtajni i cili argumenton hipotezën e tij të deficitit gjuhësor, duke hedhur idetë e tij të para socio- pedagogjike.<sup>524</sup> Pohimi i Bershtajnit për raportin ndërmjet kapacitetit shprehës gjuhësor dhe eksperiencës psiko-sociale nuk është i ri. Ai është i pranishëm tek tezat e relativitetit gjuhësor të Sapir- Ehorfit.<sup>525</sup>

Bartës të këtij deficieti kanë qenë edhe çamët për 50- vjet radhazi tek ne. Ata quheshin jabanxhinj të paqenë. Bartës të këtij deficieti vazhdojnë të jenë edhe sot e kësaj dite pakicat shqiptare kudo qofshin , emigrantët etj. Por kjo gjë kurrë nuk i ka penguar ato të integrohen dhe të mbijetojnë, apo të jenë të suksesshëm.<sup>526</sup> Ky deficit nuk ul rendimentin në shkollë, në punë, në jetë, në atë masë sa të bëhet faktor pengues. Sigurisht, individët për të cilët po flasim, paguajnë një haraç të madh për ta mposhtur këtë lloj vështirësie, përkundrajt pjesës tjetër të privilegjuar. Arrijmë në këto përfundime pa mohuar aspak forcën ndikuese të faktorit shtresë në gjuhë.

Analiza e të ashtuquajturve sociolinguistë lidhur me këtë çështje s’do të kishte kuptim pa mendimin e Xhiliolit (Giliolit) *se, është e vështirë të arrish në konkluzione të pëlqyeshme të politikës gjuhësore, për sa kohë që niveli i zhvillimit politik, ekonomik, dhe social është krejt i ndryshëm për vende të ndryshme. Programet dhe projektet e planifikimit gjuhësor duhet të jenë të tilla që t’u përshtaten vendeve të veçanta*.<sup>527</sup>

Llojet e pabarazive në ligjërim janë të shumëllojshme dhe për këtë arsye politikat standardizuese nuk mund të jenë vetëm politika arsimore, por gjuhësore në një rrafsh më të gjerë me qëllim që t’u shërbejnë të gjithë folësve, përfshirë edhe diasporën.

**Pas përfundimeve e folme krahinore – shqipe standarde, po rendisim disa të tjera përfundime rreth trajtimit të ndryshorëve sociolinguistikë.**

Një faktor i rëndësishëm me karakter natyror, me vlerë sociolinguistike është **“mosha”**.

Kujtojmë këtu që ndarjen në breza e kemi bërë duke u bazuar pikërisht tek faktori moshë<sup>528</sup>. Kështu, më të vjetërit në moshë janë gjithnjë më ruajtës sesa të rinjtë, të cilët kanë prirje të jenë përtëritës dhe inovativë në të folur, përfundim ky të cilit i bashkëngjiten edhe normat kulturore, zakonet, traditat, mënyra e jetesës etj. Për të kuptuar edhe më mirë vlerën e faktorit “moshë” në sociolinguistikë, kemi krahasuar folës të moshave të ndryshme qoftë edhe brënda të njëjtit brez, për të parë ndjeshmërinë e gjuhës ndaj këtij faktori.<sup>529</sup>

<sup>524</sup> Bernstein , B. *Sociokulturelle Determinanten des Lernens* në “Kölner Zeitschrift für Soziologie und Sozialpsychologie”, sipas Klein, G: “La sociolinguistica”: *Orientamenti della ricerca negli Stati Uniti, in Gran Bretagna e nella Repubblica federale tedesca* - Firenze, La nuova Italia, 1977.

<sup>525</sup> Po aty

<sup>526</sup> Troplini, E.: *Mësimnxënia e gjuhës shqipe në shkollat tona.(Disa probleme të planifikimit gjuhësor)*, kumtesë e mbajtur në konferencën e organizuar pranë Fakultetit Histori- Filologji, Tiranë 2010

<sup>527</sup> Gilioli, P. P., *Linguaggio e società*,

<sup>528</sup> Sipas idesë së prof. Shkurtajt në *Sociolinguistika* , Tiranë 2003.

<sup>529</sup> Për më tepër shih shembujt përkatës në disertacion

Një faktor tjetër mjaft i rëndësishëm po i karakterit natyror është edhe **përkatësia gjinore**. Hudson ka trajtuar një temë interesante mbi seksizmin në sistemin gjuhësor i cili trajton edhe disa mënyra referimi të ndryshme <sup>530</sup> Një ide për “*të folët e grave*” nën kuadrin e disa shqyrtimeve të eufemizmave të shqipes, ka bërë qysh herët edhe prof. E. Çabej<sup>531</sup>, nëpërmjet së cilës mbahet edhe si pararendës i sociolinguistikës shqiptare në përgjithësi.; ndërsa, një analizë të hollësishme për ndarjen në sekse ka bërë prof. Gjovalin Shkurtaj duke analizuar dhe thënien e bukur popullore “*punë grash dhe fjalë grash*”.<sup>532</sup> Të gjithë këta studiues kanë rënë në një mendje për sa i takon prirjes konservuese apo ruajtëse, inovative apo rinovuese të së folmes tek meshkujt dhe femrat. Sipas tyre, të folurit dallohet dukshëm edhe sipas seksit dhe jo vetëm, **e folmja e grave është më konservuese sesa ajo e burrave. Kështu tek më të moshuarat çamë shfaqet ende** ajo dukuri e rrallë e çamërishtes, *ç*-ja greke që përkon me grupin *hj>hq* të shqipes. Gjithashtu vërejmë edhe përdorimin e fonemës *j* në vënd të fonemës *gj*; edhe kjo është një dukuri mjaft e rrallë për çamërishten, apo asimlimin në fjalën *grek>greg*. Të gjitha këto dukuri nuk i vërejmë aspak në të folmen e seksit tjetër të po këtij brezi. Ruajtjet tek femrat, më tepër sesa tek burrat, lidhen edhe me vetë faktin se gratë çame kurdoherë kanë qenë më të mbyllura sesa meshkujt. Të vjetrat çame përpiqen të ruajnë edhe sot e kësaj dite zakonet e të parëve. Dikur, ato **në Çamëri** ishin ambjentuar me rolin e tyre të amvisës shtëpiake. Duke qenë se Çamëria ndodhej nën protektoratin e një shteti tjetër, atij grek, i cili dallohej në zakone, tradita etj., kjo gjë i detyronte më shumë ata të kufizoheshin brenda për brenda jetës familjare. Meshkujt në këtë mënyrë ishin të detyruar të kontaktonin më shumë me botën e jashtme, për të plotësuar nevojat e familjeve të tyre.

Ndërsa **në Shqipëri** sistemi totalitar, bënte që gratë t’i nënshtroheshin ligjeve të tij të rrepta sipas të cilit “*gruaja duhet të punonte krahë për krahë me burrin*”. Kjo “*moto*” bëri që gratë çame të brezit të mesëm pavarësisht nga zakonet e trashëguara, të dilnin paksa nga vorbulla e mbylljes brenda mureve të shtëpisë dhe të frekuentonin të njëjtat ambjente që frekuentonin dhe burrat. Në këtë mënyrë ai diferencim që ekzistonte ndërmjet burrit dhe gruas u thye. E folmja e tyre tashmë filloi të gërshetohej në shumë drejtime. Njerëzit filluan t’i përshtateshin sa më shumë formave bashkëkohore të të folurit, duke i dhënë përparësi ndryshimit të saj në përshtatje me veprimtaritë e ndryshme prodhuese, kulturore e shoqërore.

E folmja e grave nuk ka sesi të jetë e njëjtë me atë të burrave. Dallimi ndërmjet tyre do të jetë gjithmonë i dukshëm, pavarësisht evoluimit të kohës. Dhe kjo është e kuptueshme, pasi edhe nëse ato gëzojnë një status të lartë dhe kanë një karrierë të shkëlqyer, kurdoherë u lind nevoja të jenë edhe amvise të zonjat, të krijojnë një familje me baza të shëndosha për të cilën kanë përgjegjësi parësore.

Meshkujt çamë të brezit të mesëm janë më të prirur për ndryshim. Kjo është vërtetuar më së miri në përzgjedhjen prej meshkujve të disa elementeve të veçanta të të folmeve të bashkësive pritëse, më lehtë sesa femrat, siç është rasti i përdorimit të infinitit sikurse në gegërishte; përdorimin e foljes në të pakryerën me mbaresën *sh* (*ftoshin*); përdorimin e pjesores së foljes sipas gegërishtes (*ka ardh, ka bo*), disa forma përemrash të ndryshëm sipas gegërishtes (*kta, kto, tate, tat*) etj<sup>533</sup>.

Gratë gjithashtu e kanë më të vështirë të huazojnë format e parregullta të dialektit durrësak. Ato i përmbahen më shumë rregullave. I tillë ka qenë dhe

<sup>530</sup> Hudson, A. R. *Sociolinguistika* (përkthyer nga M. Ymeri, botimi i parë në shqip), 2002.

<sup>531</sup> Po aty.

<sup>532</sup> Shkurtaj, Gj. *Sociolinguistika*, Tiranë 2003.

<sup>533</sup> Nga kontakti me bashkësinë pritëse të Shqipërisë së Mesme.

vlerësimi i Labovit për të folmen e grave “*gratë i përshtaten normës së gjuhës standard më mirë sesa burrat*” ; apo i Lambercit për të folmen e arbëreshëve të Molizes: “*gjuha e grave është disa gradë më e pastër nga elementi Italian sesa ajo e burrave*”<sup>534</sup>

Gjithashtu tek gratë e brezit të mesëm gjejmë të trashëguar nga çamërishtja e të parëve një dukuri të rrallë, **zgjatimin e fonemës rr**. Kjo gjë bën që ajo të fitojë një timbër të veçantë të ndryshëm në shqiptim nga ai i fonemës **rr** të shqipes. Mendojmë se ky është një përdorim që lidhet me emotivitetin e së folmes në funksion të bazës kuptimore të thënies. Gjithashtu, tek e folmja e grave kemi vënë re edhe fjalë leksikore të veçanta që lidhen me sfera të caktuara, si ajo e gatimit, orendive shtëpiake; fjalë dhe shprehje të folklorit çam si, këngë çame të dasmave etj., të cilat nuk janë pjesë e fjalorit të meshkujve.

**Arsimi** është një kriter social i rëndësishëm, i cili luan edhe ky rol vendimtar në përmirësimin e të folmeve në përgjithësi dhe afrimin e tyre me normën letrare. Diferencat në ligjërimin e një folësi të brezit të vjetër pa arsim dhe një folësi të po këtij brezi me arsim, janë gjithmonë të dukshme, sikurse janë po aq të dukshme edhe diferencat midis një folësi të brezit të mesëm me arsim dhe një folësi tjetër të po këtij brezi pa arsim; midis një adoleshenti të arsimuar dhe një adoleshenti të paarsimuar; midis një fëmije të vogël që frekuenton rregullisht kopshtin dhe një fëmije që rritet në ambientin familjar; midis një intelektualit dhe një punëtori të thjeshtë; midis një rektori, dekani, drejtori dhe një të punësuarit pa ndonjë status të caktuar etj.

Kështu kemi krahasuar folës të ndryshëm të së njëjtës gjini me arsim dhe pa arsimin përkatës.<sup>535</sup> Gjatë një vëzhgimi me imtësi të teksteve të krahasuara, vërejmë se folësit me arsim në përgjithësi kanë prirje të rregullojnë format e parregullta të dialektit të tyre. Ato ruajnë ato forma që përkojnë me standardin e sotëm dhe ndryshojnë të folmen e tyre sipas normave të shqipes së përgjithshme. Nga ana tjetër, rritja profesionale e individëve shoqërohet gjithmonë dhe më shumë me pjesëmarrjen e tyre nga dita në ditë në veprimtari të ndryshme politike, shoqërore, kulturore etj. Sipas këtyre të fundit, folësit gëzojnë edhe staturë të caktuara, që në vetvete kërkojnë një lloj përmirësimi të të folurit dhe përdorimit të një gjuhe më të moderuar.

Roli i arsimit është i pashmangshëm edhe në të folmen e adoleshentëve çamë. Tek të pashkolluarit vërejmë më shumë interferenca nga e folmja e bashkësive pritëse.

Për të arritur në përfundime të sakta rreth kësaj të folmeje, jemi munduar ta shohim atë në kontekstin e të gjithë elementeve të veprimtarisë ligjërimore, si: **koha** dhe **vendi** në të cilin kryhet akti i komunikimit, **individit folës**, **ligjërimi** si akt shoqëror, **situata** në të cilën kryhet ligjërimi, **qëllimi** për të cilin komunikohet, **konteksti**, **rrethana**, **mënyra** sesi trasmetohet mesazhi, **roli** i bashkëbiseduesit etj.<sup>536</sup>

Megjithë dëshirën e madhe të mbylljes në vetvete, për të pasur çdo gjë fund e krye çame, izolimi brenda vetes filloi të marrë përmasa të tjera. Një shembull tipik i këtij ndryshimi janë edhe **martesat e përziara**. Kjo valë “përparimi” përfshiu brezin e mesëm dhe sidomos atë të e ri. Nuk mund të mohojmë që shumica e martesave parapëlqehen ende të bëhen brenda për brenda origjinës, por nuk janë të pakta gjithashtu edhe rastet e martesave të përziara ku, për rrjedhojë njëra prej gjuhëve, e nënës apo e babait, bëhet **alogjene**.<sup>537</sup> Sigurisht, brezi i vjetër shfaq një farë keqardhjeje për të tilla raste, por megjithatë dashje pa dashje i është nënshtruar fatit.

<sup>534</sup> Shkurtaç, Gj. Po aty, f. 232, Tiranë.

<sup>535</sup> Për me tëpër shih temën përkatëse në temën e disertacionit.

<sup>536</sup> Rrokaj, Sh. *Hyrje në gjuhësinë e përgjithshme*, shblu, Tiranë 2000

<sup>537</sup> E njëjtë ose jo me atë të mjedisit apo bashkësisë shoqërore ( në rastin tonë me atë të mjedisit ku ato jetojnë).

Ndërsa përfaqësuesit më të rinj pajtohen me këtë ndryshim, duke mos mohuar nga ana tjetër edhe ato, dëshirën e një bashkëshorti a të një bashkëshorteje çame.

Kemi vënë re se mjaft interesante në të tilla raste shfaqet gjuha e fëmijëve, me larmi përzierjesh dhe zëvendësimesh të ndryshme.

**Krenaria për origjinën e të parëve, është faktor i jashtëm ndikues në të folmen e çamëve.**

**Bashkësia shoqerore është një grup individesh që kanë të perbashket një fare kulture dhe që për disa motive ndjehen bashke dhe ruajnë lidhjet ndërmjet tyre; përmes një organizimi shoqëror dhe kulturor të diferencueshem nga një grup tjetër individesh, për rrjedhojë nga një bashkësi tjetër shoqerore.**<sup>538</sup> Pra, një bashkësi e caktuar shoqërore shoqërohet edhe nga një kulturë përkatëse, e cila është e dallueshme nga ajo e bashkësive të tjera. Në këtë mënyrë individët e rinj në moshë përpriqen që të përshtaten me atë lloj kulture që për to është e re, bashkëkohore, që në rastin e brezit të ri çam përkon pak a shumë me kulturën gjithëshqiptare. Nga njëra anë, për të rinjtë është mjaft e rëndësishme që të dalin nga kornizat e ngushta dhe normat zakonore të më të vjetërve, por që në rastin tonë është dhe mjaft e vështirë, pasi ato tërhiqen shumë edhe nga trysnia që ushtron tek to “konservacioni shpirtëror”. Ky i fundit, afron të rinjtë me më të vjetërit e tyre dhe që të dyja palët ushqehen prej krenarisë për vendin e origjinës dhe të qenit banor i saj.

Krenaria për origjinën është një tipar mjaft i rëndësishëm me rrënjë të thella. Ajo është kultivuar në breza mjaft mirë dhe vazhdon të kultivohet edhe sot e kësaj dite, duke shërbyer edhe si lëndë e parë e konservacionit të gjithanshëm tek të gjithë çamët në përgjithësi. Nëse i pyet të gjithë të vjetërit çamë sot “nga cili vënd i Çamërisë je?” Ato thonë: “ka vëndi më i bukur dhe më i mirë i Çamërisë (Vola, Filati, Vërsela, varet nga vëndi i tij i origjinës)” dhe, ajo ç’ka është më interesante, është se që të gjithë të përgjigjen në të njëjtën mënyrë. Ndërsa pyetjes: “Cila është dëshira jote më e madhe?” -Ato në këtë moment harrojnë fëmijët, familjen e tyre dhe përgjigjen: “Të vete njëherë në Çamëri dhe pastaj të vdes”. Në promovimin e njërës prej këngëve çame, e pyesin djalin e vogël të videoklipit: *Si të quajnë?* - Përgjigjet: *Më quajnë Eno Çami.*

Këto konstatime mbartin me vete dëshirën e të gjithëve: **të jetojnë, të shohin, por edhe të njohin rrënjët e të parëve.**

Kemi vënë re gjithashtu se çamët dhe gjuha e tyre karakterizohen nga veti të tilla të këndshme të cilat imitohen prej të tjerëve. Çamët në përgjithësi kanë parapëlqyer të jenë të vendosur në grupe. Grupimi i tyre ka treguar gjithmonë se, përveç përpjekjes për t’u integruar, ato kanë lënë edhe shenja në kah të kundërt. Natyrisht, këto ndikime janë shfaqur më shumë në zonat përreth tyre. Çamët kanë depërtuar në disa aspekte të veçanta të mënyrës së jetesës tek vendasit. Martesa e përzier është një faktor prurës në konvergjiencën midis dy bashkësive, asaj çame dhe asaj pritëse. Një gjë e tillë është vërtetuar prej pohimeve të drejtpërdrejta të folësve të bashkësive pritëse; një gjë e tillë vërtetohet më së miri përmes disa fjalëve leksikore të huazuara prej tyre, kryesisht nga fusha e gatimit, si: *birian* ( mish i gatuar në teps me oriz), *musaka*, *kallamar* ( kallmar,- lloj ëmbëlsire ), *çomlek* ( mish me qepujka); disa emra erëzash dhe barishtesh të ndryshme, si: *maraj* (kopër), *nenë* (nenexhik), *llapsana* ( rrap) etj, kanë gjetur përdorim të përditshëm tek një pjesë e mirë e familjeve në zonat përreth çamëve. Gjithashtu folklori i bukur çam filloi të pëlqehet dhe të praktikohet nga vendasit përreth; përmendim këngët dhe vallet e bukura në dasmat çame.

<sup>538</sup> Berruto, G. Sociolinguistica, Bologna, f.20



**Të gjitha përfundimet e mësipërme që në pamje të parë duken teorike i kemi nxjerrë nga një vëzhgim i detajuar i kësaj të folmeje në të tri sistemet: në sistemin leksikor, fonetik, dhe morfologjik.**

**Sistemi leksikor i çamërishtes shfaq diferencime të dukshme në krahasim me sistemet e tjera.**

Në brezin e vjetër është vënë re që shumë fjalë të bujqësisë dhe të blegtorisë të cilat përdorshin dikur në Çamëri (vend dikur me bujqësi dhe blegtori të zhvilluar) përdoren më rrallë ose janë bjerrë plotësisht. Nga ana tjetër, ruajtjet leksikore në të folmen e çamërishtes janë të shumta edhe në ditët tona. Ato janë shumë më të mëdha në brezin e vjetër, pakësohen në brezin e mesëm dhe fare të pakta i gjejmë ato në brezin e ri. Tek ky i fundit, ruajtjet vihen re kryesisht tek emrat e njerëzve, emërtimet farefisnore, ne fushën gatimit, disa emërtime bimësh të ndryshme, lloje pemësh etj. Natyrisht, trashëgohen edhe disa huazime nga turqishtja e greqishtja, të cilat ndryshojnë në varësi të bashkësive të ndryshme pritëse. Po paraqesim një pasqyrë të leksikut çam, sigurisht duke e reduktuar shumë atë, thjesht për të krijuar një ide rreth tij.

E nisim fillimisht me disa fjalë që zëvendësohen që në brezin e vjetër, si: *koca* (gërshet), *papllom* (jorgan), *pampuar* (vapor), *rafë* (plasaritjet, të çarat e mureve, dërrasave etj.), *ciurë* (brymë), *dhrimon* (shoshë), *fore* (me të lartë), *hamurë* (harxhi i gjellëve të ndryshme), *hosh* (mosrespekt kundrejt dikujt), *llufë* (baluke), *parathire* (dritare)..... etj

**Si ruajtje leksikore në brezin e vjetër çam konsiderohen:**

- **Disa emërtime nga fusha e gatimit:** *Papar* (bukëvale), *fahi* (gjellë), *tëmël* (ëmbëlsirë), *sapun hallva* (hasude)<sup>539</sup>, *birian* (tavë me oriz dhe mish), *musaka* (kimeve në përgjithësi), *kallmar* (lloj ëmbëlsire e ngjashme në shije me bakllavanë), *qahi* (byrek me djathë), *karkanaqe* (ëmbëlsirë, sheqerpare), *bazin* (kaçamak), *dollma* (përshesh me gjel deti, ose me mish qingji), *zahër* (sheqer), *brrushtull* (tavë me miell misri dhe lakra të ndryshme prfshirë edhe qepë, presh), *përvëlatë* (lloj ëmbëlsire me sherbet), *bllac* (tip byreku).....etj.;
- emërtime të **frutave, perimeve, bimëve aromatike, luleve të ndryshme si:** *skaminë* (mana), *stafidhe* (rrush i thatë), *thimilkua* (shalqin), *vasilikua* (borzilokut), *garufalë* (karafil), *mirgale* (bajame, në disa zona i thonë edhe *mingladhë*), *marrul* (sallatë jeshile), *dhjozmë* (nenexhik/ *llapsana* (rrap), *bòkale* (fiq të papjekur), *cukunidha* (hithra), *bahrata* (piper i zi), *livanua* (lloj fiku), *salangur* (pjepër i pabërë)..... etj.;
- emërtime të cilat në tërësi i shërbejnë **veshmbathjes dhe mirëmbajtjes së njeriut, si:** *konde* (këmishë për burra), *polk* (bluzë për gra), *fuste* (fund), *potiqe* (pandofla/ shapka), *stromë* (dyshek), *jatak* (vënd për të fjetur), *sendon* (çarçaf), *papllom* (jorgan), *podhë* (përprëse pune), *skrapina* (takave), *tumane* (veshje karakteristike për femrat në kohë të hershme, tuta të gjera lart edhe poshtë), *vraka* (pantallona), *konoxhup* (lloj xhupi për gratë), *faqole* (shami e kokës që vënë plakat), *cohë* (veshje e kushtueshme për gratë), *sharkë* (xhokë prej leshi e bardhë e gjatë deri në gju) *shqepe* (vello), *takëm* (veshjes së kompletuar, kompletit), *qyrk* (veshje e zezë).....etj. ;
- emërtime **mjedisore, si dhe emërtime të lëndëve të ndërtimit**, si: *Ledh* (mur), *qaramidhe* (tjegulla), *vorua* (oborr), *katua* (bodrum), *parathire* (dritare), *kalive* (kasolle), *qerrete* (ristela), *azves* (gëlqere), *hanë* (shtëpi),

<sup>539</sup> Në leksik kemi përfshirë edhe ato fjalë, të cilat ndonëse të huazura janë bërë pjesë e fondit leksikor çam.

- baxhà* (dritare e vogël në çatinë e shtëpisë), *mes hori* (aneks i dhomës) .....etj.;
- emërtime të **marrëdhënieve gjinore familjare**: *xhixho* (xhaxha), *xhexhë* (nuses së xhaxhait), *nu* (gjyshes, megjithëse kjo fjalë ka marrë përgjithësim të gjerë për të gjitha moshat e vjetra të seksit femër), *teto* (tezes), *dajko* (dajë), *dajkël* (nuses së dajës), *nanë* (gjyshe), *nandajkua* (gjyshja- nëna e dajës), *gon* (nip), *gone* (mbesë), *progon* (fëmijëve të gjetur të burrit), *çeç* (vëllait të madh), *dada* (personi që i shërbente nuses me pagesë për dy- tri ditët e para të martesës), *kako* (motra e madhe), *nanëzonjë* (në shenjë respekti moshave të thyera nga ana e burrit), *lakà* (kushëri i largët), *aga* (vjeçrit)<sup>540</sup>, *zonjë* (vjeçrës)<sup>541</sup>, *bej* (nusja thërriste kunatin e vogël), *zonjë e vogël / e madhe* (nusja u thërriste motrave të burrit)<sup>542</sup>, *sabi*: (foshnje); *jenë* (kalama)..... etj.;
  - emërtime **kafshësh, shpendësh** dhe gjallesash të ndryshme: *arez* (grerëz), *kaciq* (kec), *spurik* (zog), *pulaqidh* (zog pule), *kër* (gomar), *pelister* (lloj zogu fluturimi), *curk* (akrep), *mjalca* (bletë), *vurc* (iriq), *karakaçe* (laraskë), *kaçòpull* (këlysh mace), *kollosuze* (një lloj zogu me bisht të gjatë), *kukuri* (zekthi), *malltez* (bagëti me qumësht pas lindjes), *turriare* (dele që ndahet nga tufa) .....etj.;
  - emërtime objektesh apo **orendish** shtëpiake: *sufrà* (sofër), *petës* (tërhollës), *honi* (hinkë), *çube* (mjet për të shtypur kafe), *sini* (tepsi e madhe), *çonak* (tasi i vogël), *farfuri* (kanë uji), *magjerri* (kuzhinë), *pinadhë* (shoshë), *dhrimon* (shoshë, me pak ndryshim nga e para), *cimith* (mashë), *mashà* (lopatës së prushit që shërben për të pjekur), *pirosti* (mjet hekuri që vihet sipër zjarrit, për të vendosur enën ku gatuhet gjella), *mastrapa* (broke prej bakri për të pirë ujë) *skanjo* (karrige), *foti* (kandil), *lesa* (portë e vogël), *buhari* (vatër), *buhar* (oxhak), *ikua* (vend në të cilin stivohen rrobat për të fjetur, shtrojet), *postër* (postiqe), *klidhonë* (drynit), *kliç* (çelës), *lien* (legen), *kalistir* (kep, mjet për të prashitur të mbjellat), *qepengji* (derë e vogël); *llanar* (ajo që kreh leshin), *dhimi* (tezgjah).....etj.;
  - **emërtime të trupit të njeriut**: *koca* (gërshet), *thapë* (thonj), *kòkale* (kocka), *gjordë* (trup i madh i bukur i lidhur), *llufë* (baluke), *fulltak* (mishi që ngrihet filluskë), *gërlak* (gurmaz), *leshëra* (flok), *kaleshë* (zeshkane, esmere), *beellë* (bjonde, bardhoshe).....etj.;
  - **emërtime nga fusha e mjekësisë**: *jatrua* (doktor) *namopirmë* (etheve të qumështit), *dhili* (*i ra dhili*, i ra të fikët), *baldi* (*kojdi pse m'bie si baldi*, nuk e di pse po më bie si vilani), *damlla* (paralizë), *i xhindosur* (budalla); *verem* (turbekuloz)..... etj.

Disa emërtime interesante të fushave të ndryshme, të klasifikuara sipas fjalëve të ndryshueshme a të pandryshueshme të ligjëratës:

- **Disa mbiemra karakteristike për çamërishten**: *gërthël* (e keqe), *i shkllarë* (i çmendur), *farmak* (e hidhur), *hergjele* (i papërmbajtur), *i lipsur* (i humbur; kjo fjalë ka marrë edhe kuptime të tjera, si p.sh : lipsu atej ! - ik andej ); *i pingosur* (i pezmatuar/ i zemëruar), *i zilepsur* (ziliqar); *goti* (frikacak), *dhjakonar* (njeri rrugësh, “barbon”), *i lapërguar* (i liruar), *penesqar* (mburravec); *lakomë* (e dobët fare e vështirë për t'u bërë), *qibar*

<sup>540</sup> Ndonjëherë përdoren edhe emërtime të tilla si: *aga i madh*, *aga vogël*, për kunetërit.

<sup>541</sup> Në mungesë të vjerrës kështu thërritej nga nusja e re dhe kunata e madhe

<sup>542</sup> Kur burri kishte vetëm një motër, ajo thërritej nga nusja a nuset: *zonjë e vetme*

( mendjemadh); *vllëngë* ( u ke bërë sa një vllëngë , e madhe ; me trup të madh, e rritur para kohe) *kserë* (jo e lagësht), *vrromë* ( e pisët). *ksekollomë* (ah ksekollomë e qerratait, ksekollomë, fjalë ofenduese : e përdalë, qelbësirë etj ), e *ndërsme* (ana e përtejme, jo shumë e privilegjuar),

- **Disa folje karakteristike për çamërishten:** *am* ( jepmë-epimë), *gaxhidet* ( tallet, bën shaka), *gjegj* ( dëgjoj), *llamburit* ( ndriçon), *llastis* (rradhøj), *htarr* ( herr), *miris/ mris* ( nuhas), *cimis* ( kep, çukas: *pulat cimisin barin*), *hosh* ( me begenis, me respektuar dikë, por që përdoret më tepër me kuptim të kundërt, p.sh: *s'më bëri hiç hosh*, s'më begenisi, s'ma vari, s'më respektoi), e *katëha* (a.. ti e katehe – a.. ti e këptove, e kuptove); i *ksebëu* (i shpërdoroi me prish, me shkatërruar, me heq nga pasuria) *manaris* ( e *afroj*, vjen nga fjala *manar*, me e afruar me i dhënë arsye, qas) *ndes* (*ndesi në lum* , *ndesi në lerë*, *ndesi keq*( nga ndonjë hall ) me ngel keq a ngushtë për diçka ), *peneset* (lavdërohet, *penesqar* (mburravec); *pllaks* ( përplas); *poktis* ( u fiksua), *rrokanis* ( zdrukthtoj; *penesqar* (mburravec, peneset- lavdërohet) ; *rrupjas* ( prij përpara: *dashi qesim me kumborë* , *rrupjas kopenë përpara*), *tumë* ( me të shtyrë: *i dhe tumën*, *të japin tumën*; *po gjete nonjë derë të mirë vajzës jepi tumën*), *dorovit* ( peshqeros ),
- **Disa emra të llojeve të ndryshme:** *eksori* ( nizan), *dhaskal* ( mësues), *lazëme* ( vizitë), *teshqere/ tesxere* ( ftesa), *evlat* (fëmi), *bina* ( rrëzë e diçkaje, p.sh rrëza e ullirit), *skolio* ( shkollë), *hargalisje* (dalldi), *kahpë* ( e përdalë, prostitutë), *pampuar* ( vapor), *qostek* ( zinxhir i orës së xhepit), *pajgori* (ndihmë në para në raste fatkeqësish), *gular* ( gur të vegjël që lozin fëmijët), *alsiv* ( ujë me hi që lanin rrobat), *botë* (lloj dheu që përdoret për...), *bokshà* (grumbull me rroba i lidhur mirë me një tjetër rrobë të madhe), *davet* ( gosti), *torriar* ( rrugaç), *dup* ( monedhë më e madhe sesa floriri), *komë* (lidhja nyjë), *sorua* ( grumbull), *cimisqar* ( ngacaman); *penesqar* (mburravec, peneset-lavdërohet) *asqër* ( ushtar), *allaçten* (më *erdhi allaçten* e papritur, befasi), *avolitër* ( plagë e madhe rrjedh e nuk mbyllet), *asklidhe* ( cifël druri, guri etj), *bekshi* ( rojtar fushe), *bokrrimë* ( vend i pjerrët, shpati i një kodre), *kasabà* ( qytet, *Ka jeni ju? Ka kasabaja e Durrësit*), *mahallà* (*na bure bolori me mahallà*, na turpërove me lagjen, lagjes), *ciurë* ( brymë), *kòkall* ( me ngri në vënd nga të ftohtët), *fore* ( me zë të lartë, me bërtit me furi, *mos fol me fore*, *pse flet aq me fore* ), *pramatar* (tregtar që tregton shtëpi më shtëpi, “ambulant”), *siri* (i kish gjërat *siri, siri*, lloj, lloj), *tramë* ( shkëmbim mallrash), *umith/ umidh* ( shpresë: *ban umidh-* mban shpresë), *pothé* ( lloj, *nuk kesh parë nonjëherë ka kjo pothè-* nuk kisha parë ndonjëherë nga ky lloj; *ka àjo pothé e bukur-* nga ai lloj ) etj.
- **Disa ndajfolje:** *muht* ( lirë: *e shiti muht klumushtin-* e shiti lirë qumështin), *bolori* ( *na bëri bolori*, - na turpëroi) etj

Në këtë të folme na bëjnë përshtypje disa shprehje tipike me anë të të cilave çamët përsëriten në çaste të caktuara të ditës: *çish u dive/ ç'u dive-* si u gdhive/ mirmëngjes; *çish vajte-* si shkuat/ si jeni; *ç'u verre, ç'u verrët-* si u erre, si u errët ( errësive) / mirëmbrëma. *Selamaleqe- Aleqëmë selam* ( paqja dhe bekimi i Zotit qofshin mbi ty - Edhe mbi ty)

Nga krahasimi që i kemi bërë të folmes së sotme të çamëve, me të dhëna të hershme<sup>543</sup> të kësaj të folmeje si dhe me të dhëna nga studimi dialektologjik i Q.

<sup>543</sup> Këtu flitet për disa të dhëna të mbledhura qysh më 1978-ën nga historiani Z. Hajredin Isufi të cilat shfrytëzohen për herë të parë në këtë punim.

Haxhihasanit<sup>544</sup>, kemi renditur një sasi fjalësh të cilat kanë humbur. Këto fjalë nuk i gjejmë në të folmen e brezit të vjetër sot. Ato mund të jenë zëvendësuar me fjalë të tjera ose kanë dalë fare nga përdorimi, si: *xhedilë, xhelben, qotì, qepengjì, xhevre, xërre, bridhë, bakàje, ushez, jun, purthëlë, piker, pikrangadh, vrojnë, çuta, çukat, dilmi, fushqi, fagullate, gone, gurdhu, hazinë, hap, istrikat, indat, kopërr, krahura, kathur, kullaqi, katehela, lagjin, otra, (mandile) thellupe, kollosuze, kukuri, monoricë, karvò, llahtër, llother, mendall, ndërxe, pejda, par, (mandile) poshe, rahq, rale, rrokan, rrusfal, strevël, skopua, shehleza, gravell, màndall, kòcenosh, dedikë, moraza, organa, shtarame, gërrnde, hondrale, anuria, grinjat, rrushqule, i gjezër, gravall, cigure, prrari, thermelira, sunidhe, tonidhio, sirokafa, dauxha, rëkuall, langua, barkare, dhikan, karaf, kuvël, bahçivanë, , barball, zabitër, kamabre, camurat, ohalit, koç, koçi, azrei, llaj, ajman, bumbuleshë, cariqe, cepëzi, ciaro, çeleng, dajllar-i, dugra, dulme, dhiallupi, dhragat(i), festedalle, firar, fllapë, gazi, gërxhemadhe, hastane, haxheti, hos, hundëza etj.*

Çamëria dikur shquhej edhe për një pemëtari të zhvilluar. Na kanë tërhequr vëmendjen një sasi emërtimesh të cilat pas shpërnguljes së çamëve në Shqipërinë shtetërore kanë dalë nga përdorimi ose janë përdorur fare pak, të tilla si:

1. Disa emërtime të llojeve të ndryshme **fiqsh**, p. sh: (fik) *livanua, buhar, perdhikul, vursik, maca* (kur fiku piqej shumë e thahej në degë), *llabovit, bishtash, delvinjot, bukuq*;
2. disa emërtime të llojeve të ndryshme **dardhash**, p. sh: (dardhë) *kuqela, rushunica, verdhëla, llabovite, thertjate*.
3. Disa emërtime të llojeve të ndryshme **ullinjsh**: (ulli) *nisqot, reshaqot, kaçulerë korffat, kotmëdhi*.
4. Disa emërtime të llojeve të ndryshme të **grurit**: (grurë) *zhulicë, halëz, tremujor, karpua, pllakatuat, therti, buluk, insan etj.*

Dikur kjo e folme ka qenë shumë e pasur edhe me kompozita të tilla si: *faqeftua, faqekartë, faqeklumushtuar, feste dalle*, ( feste e kuqe e qendisur me serm që e mbanin nusët), *golëgrisur* ( llafazane), *golëmbajtur* ( e urtë), *golëkeq* ( fjalëkeqe), *golëmirë* ( fjalëmirë), *hundëdash* ( hundëmadh), *gluhëkuq* ( e ka gjuhën të kuqe sikurse rraca e zezë), *kriethrime* ( kokëvogël), *kuqelarë* ( laroshe), *kokallbardhë* (kockëbardhë), *leshërakaçube* ( me flokë ngritura të shkatërruara), *vetullbërshime* ( vetulldredhur), *vetullnakatosur* (vetullzemëruar), *bishtashkunde* ( lloj zogu me bisht të gjatë) etj.

Fjalët në çamërisht pak nga pak filluan të zëvendësohen, ose dalëngadalë, përkrah tyre filloi të përdoret po e njëjta fjalë sipas zhvillimit të gjuhës së përditshme, por edhe duke treguar interes për t'u integruar me bashkësitë përreth. Kështu p. sh, në vënd të fjalëve, *potiqe, tumane, parathire/penxhere, sendon, dhaskal, jenë, bilë, sabi, stromë, def, thimilkua, podhë, etj.*, përdoren tek ky brez, fjalët e tyre gjegjëse *shapka/pandofla, çitjane/dimiç, dritare, çarçaf, mësus/ musus, fëmilë, vajzë/ gocë, foshnjë, dushek/ dishek, dajre, shalqin, përparëse etj.*

Në këtë pikë, shtrohet pyetja: cilat prej fjalëve të grupuara më lart i kanë rezistuar kohës dhe kanë mbërritur deri në brezin e mesëm? Ruajtjet më të mëdha në leksik për brezin e mesëm do t'i vërejmë konkretisht në këto sfera:

- Në sferën e gatimit vërehen disa emërtime lulesh dhe bimësh të ndryshme aromantike, si: *musaka, birian, papar, kallmar, sapun hallva, qahi, karkanaqe, klloshitër, dollma, cepë, krrunde, brrushtull, përvëlatë, vasilikua, garufale, jozmë,*

<sup>544</sup> Shih : Haxhihasani, Q. *Vështrim i përgjithshëm mbi të folmen e banorëve të Çamërisë*, në « Dialektologjia shqiptare », vëll.I, Tiranë, 1971, vëll.II, Tiranë 1973

*miraj, llapsana, manxura ....* etj. Këto ruajtje shpjegohen me traditën e bukur të gatimit çam.

- Disa emërtime të marrëdhënieve gjinore familjare dhe lloje të tjera të ndryshme emërtime, si: *xhixhi* ( xhaxha), *xhexhè* (xhaxheshë-nusja e xhaxhait), *nu* (gjyshe, nane), *teto* (teze), *dajkël*, ( nusja e dajës) ....etj.

- Disa emërtime të tjera të ndryshme , si: *petës* ( tërhohës), *cepë* ( petë), *nakatosur* ( i përzier), *dorovis* ( peshqeros), *i shklarë* ( i çmëndur), *ikua* (vëndi ku stivohen rrobat), *pajgori* ( vizitë ngushëllimi), *papllomë* ( jorgan), *stromë* ( dyshek), *potiqe* ( pandofla), *pōdhe* ( përparëse)... etj.

Për folësit e brezit të ri të gjitha fjalët e grupuara sipas nëndarjeve të ndryshme ose kanë dalë nga përdorimi (kur kemi të bëjmë me fjalë të vjetëruara që për arsye të ndryshme nuk përdoren më ), ose janë zëvendësuar me fjalë të shqipes standarde. Do të ruhen tek ky brez disa fjalë nga fusha e gatimit (për të njëjtin motiv që sqaruam tek brezi i mesëm); disa emërtime të bimëve të ndryshme aromantike, marrëdhënieve gjinore familjare, disa antroponime etj.<sup>545</sup>, përkatësisht: *papar*, *sapunhallva*, *birian*, *musaka*, *nu*, *teto*, *xhexhè*, *dajkël* (ndonjëherë), *dorovitje*, *pajgori*, *lazëme*.... etj.

Në këtë këndvështrim s'mund të anashkalojmë edhe interferencat prej të folmeve pritëse, p. sh: *oborr* për *vorua*, *çarçaf* ( sendon), *jorgan* ( papllom), *hasude* (sapun hallva), *petë* (cepë), *mentë/nenexhik* (jozmë), *vapor* ( pampuar), *teze* ( teto), *bakllava* ( bakllahì), *gërshet* ( koca), *thonj* ( thapë), *sheqer* ( zahër), *hime* (krrunde), *mana* ( skaminë), *shalqin* (thimilkua), *bajame* (mirgale/ mingladhè), *sallatë jeshile* ( marrul), *shapka/pandofla* ( potiqe), *dyshek* ( stromë), *krevat* (jatak), *përparëse* (podhe), *tjegulla* ( qeramidhe), *bodrum* ( katua), *restela/ ristela/ristela* ( qerreeste), *sofër* (sufra), *karrige* (skonio), *oxhak* (buhar), *doktor* ( jatrua), *fëmijë* (evli/ jenë/ fëmilë), etj. Zëvendësime të tilla flasin qartë për procesin e tretjes së dialektalizmave në këtë të folme.

Lidhur me këtë çështje themi me bindje se e folmja e çamëve ndikohet edhe në leksik nga rrethinat anas.<sup>546</sup> Kjo është një dukuri e skajshme. Për shembull, përkrah përdorimeve të standardit, tek folësit e brezit të ri zenë vënd edhe përdorime të tjera sipas të folmeve të bashkësive pritëse, të cilat janë në kundërshtim me normën. Kështu tek çamët e Shqipërisë së Mesme në brezin e mesëm dhe të ri na tërheqin vëmendjen fjalë të tilla si: *ça* ( çfarë), *mi* ( me – pasthirmë), *çun* ( djalë), *gocë* ( vajzë), *qyqa* ( pasthirmë që në të folmen çame nuk ekziston), *e nejse*, *bjere* ( sille), *shpina* (kurrizi), *nenexhik* ( jozmë)..... etj.

Për rrjedhojë, ndryshimet më të mëdha në sistemin gjuhësor të një të folmeje nisin më së pari në fushën leksikore. Tek e folmja e çamërishtes bëhet fjalë për prekje të sistemit leksikor në të tri brezat, por më shumë në brezin e mesëm dhe me një vërshim marramendas në brezin e ri. E folmja e brezit të ri dëshmon sot orientimin kah standardit. Në brezin e mesëm kemi një shtresëzim të ri fjalësh që lidhen me zhvillimin e kulturës, veprimtarisë prodhuese, veglave, dhe mjeteve të reja teknike, jetës politike- shoqërore dhe ideologjike etj. Përparimi i shkencës, teknikës, elektronikës etj., solli edhe shtimin e disa termave të tjerë që janë në rritje e sipër tek brezi i ri në përshtatje me shpejtësinë e zhvillimit të fushave të caktuara, të cilat ndër të tjera ndikojnë drejtpërsëdrejti në zhvillimin e kulturës dhe përparimin e bashkësisë shoqërore.

### **Dukuri të ndryshme në sistemin fonetik të së folmes ( zanoret e theksuara)**

Në këtë të folme spikat dukshëm një lloj theksi të cilin ne kemi preferuar ta quajmë

<sup>545</sup> Këto ruajtje vihen re më të pakta në numër sesa ruajtjet në brezin e mesëm.

<sup>546</sup> Kjo është një temë të cilën mendojmë ta trajtojmë në të ardhmen

me gjuhën e prof. Q. Haxhihasanit si “theks sintaktik.” Vetë trajtimi i këtij theksi na lë të hapur mundësinë e trajtimeve në fushë të sintaksës në të ardhmen.<sup>547</sup> Ky lloj theksi (logjik), mendojmë se është një ndër dukuritë më të rëndësishme të së folmes së çamërishtes, pasi unifikon në vetvete një tërësi elementesh, si: ngjyresa e veçantë e rrokjes së fundit; theksi i fjalisë; intonacioni; timbri i veçantë i zërit së bashku me ngritjen e këtij të fundit (që luan edhe rol vendimtar); zgjatja e zanoreve, veçanërisht në rrokjen fundore të fjalës. Nga të dhënat tona shohim që ky është një theks karakteristik jo vetëm për fjalitë pyetëse, por edhe për lloje të tjera fjalish, jo vetëm tek thirrori por edhe në gjymtyrë të tjera. Nëse kemi të bëjmë me fjali pyetëse, ato në të shumtën e rasteve mbartin edhe nuanca plotësuese përkatësisht: habi, dëshirë, urdhër etj. Më e rëndësishmja është se, të tëra këto dukuri nuk mund të shihen veçmas, por në kompleks me njëra tjetrën.

Ajo çka merr më tepër rëndësi për një punim si ky i yni është trashëgimia e kësaj dukurie deri në ditët tona. Ajo shfaqet e ngulitur tek brezi i vjetër sot. Tek brezat pasardhës kryesisht tek folës të brezit të mesëm edhe pse dukuria ruhet, e gjejmë atë disi më të rrudhur. Gjatë ligjërimit të përditshëm në brezat pasardhës, kemi vënë re se brenda këtyre fjalive bartëse të theksit sintaktik, dukuritë arkaike çame në përgjithësi i karakterizon bjerrja si dukuri. Megjithatë si dukuri kjo përcillet edhe tek brezi i mesëm dhe me ndonjë lëkundje të vogël e gjejmë atë edhe tek më të rinjtë. Shfaqet dukshëm tek fëmijët e vegjël parashkollorë.

- Sot në të folmen çame është vënë re që ruhen ende fjalë tek të cilat theksi bie në rrokjen e parë. Kryesisht këtu spikasin përemrat dëftorë dhe disa ndajfolje me theks parafundor etj. si: *àjo, àj(i), àtej, tàni, tànja, kùtu, kvjo, àt* etj. Theksi parafundor tek disa fjalë sot është bjerrë: *fàrmëk, ròdhez, màngan, kùel, kèleme, dhòkan; çàkall- çàqale, bòkall- bòkale, dhàskall- dhàskale, gràvall- gràvale; Kùrtanj, Hùsanj, Vèlanj, Rùsanj, Mánanj*

- Si një e folme e vjetër me karakter ruajtës, çamërishtja karakterizohet nga disa **huazime**, të cilat kanë depërtuar në të prej kontakteve të saj të kahershme me gjuhë të tjera, konkretisht nga turqishtja dhe greqishtja. Një faktor i rëndësishëm në ruajtjen e huazimeve turke ka qenë ai i kultivimit të fesë islame. Sot spikasin këto fjalë të shqiptuara **me theks fundor** si: *evli, vèllahi, sitaxhè, teshqerè, kàvè, qòshè, qìblè, gjulè, xhèzvà, bàkshè, hìsè, sèftè, çìftè, parà, sufrà, llapà, mashà, kazmà, misìr, bakwrr, eksorì, jabanxhì, kòshì (komshi)* etj. Ky lloj theksi vihet re edhe tek disa antroponime të tipit: *Nailè, Esmà, Hasimè, Habìb, Shabanè, Bahjè, Hidajèt, Sadàt, Ahmèt, Ramadàn* etj. Me të njëjtin theks shqiptohen edhe disa fjalë nga fusha e gatimit, si: *fàhì, musakà, bakllahì, hàllvà, pàçà, revanì, qàhì* etj.

- Lidhur me dukurinë e **gjatësisë së zanoreve** studiuesi Ibrahim D. Hoxha në enciklopedinë e tij<sup>548</sup> përmend disa zanore “zëzgjatëse” siç i quan ai, për të folmen e çamërishtes, ndër të cilat spikasin: *Â/ â; Ê/ ê; Î/ î; Ô/ ô; Û/ ù; Ÿ/ ý*: Mendojmë se simbolet që shënojnë këto zanore duhen rishikuar nga fonetikanët, pasi nuk jemi shumë të bindur për njohuritë e tij në fushën gjuhësore. Por, mesazhi që ai përcjell është i qartë: çamërishtja është e pasur me dukuri të tilla që rrisin përherë e më shumë emfaticitetin e kësaj të folmeje, për të cilën mendojmë se është një dukuri e shqipes së vjetër. Lidhur me zanoret zëzgjatëse kemi dhënë disa shembuj nga trajtimi që ky studiues bën: “*Â- zanore zëzgjatëse. Pasthirmë. Përdoret për të theksuar një gjykim të caktuar : Â, ajo punë mori funt! Â, atë ( fjalë, punë, njeri) mos e zërë në golë! Â, atë*

<sup>547</sup> Një sprovë të së cilës e kemi bërë edhe nga një përqasje e elementeve sintaksore të teksteve të Reinholdit të trajtuara prej Klosit.

<sup>548</sup> Hoxha, D. Ibrahim: *Enciklopedi Jug-shqiptare I (A-H)*, f. 7; Shoqata kulturore shqiptaro-turke, Tiranë, 2006.

mos e nga, se ke të biò me mua! *Á*, nuk e këshëm kështu fjalën! *Á*, mos m'u ngarkos më shumë! *Á*, këtë doje ti!? <sup>549</sup> Sigurisht zanoret zëzgjatëse që autori trajton nuk janë të njëjta me zanoret e gjata.

Në këtë të folme si zanore të gjata na shfaqen:

- Zanoret e theksuara në rrokje fundore të hapura në fjalët: *vëllà:, binà:, ngrè:, flè:, vù:, përzù:, zù:, bolori: xhexhè:, e vè:, e rè:, sì:, uzengji:, sufrà:, kazmà:, kallamè:, eksori:, erremi; ù...etj;*
- zanoret e theksuara përpara bashkëtingëlloreve lëngëtore *-r, -l, -ll: tagdi: r, buha:r, cihu:r, ka:lë, dja:lë, pa:lë, ma:lë, bi:lë, go:lë, undi:r, di:ll, he:ll, kërce:ll, mësa:llë, shka:llë, fëmi:lë, galo:rë, mi:lë, vra:rë, pre:rë, agonja:r..... etj.;*
- zanoret e theksuara në rrokje të mbyllura ose të hapura para bashkëtingëlloresh të tjera, sidomos para dhëmboreve dhe hundoreve: *tu:mene, dhë: nër, të hë:në, na:tanë, ra:më, dë: jëm, ngrë:në, kë:më, dhë:më, a:në, i di:të, i fto:të ....etj.;*
- zanoret e gjata të cilat përkojnë me zanoret e theksuara në trajtat foljore të aoritit sigmatik, në rrokje të mbyllura: *tha:çë, pa:ç, la:ç, u tha:ç, u pre:ç, ha:ç, , u ngro:ç; të këpto:ç, të the:t, të the:ç, të the:n, të de:ç, të de:t, të ke:sh, të je:sh..... etj.;*
- në trajtat e shumësit të disa foljeve, të cilat tashmë dalin në rrokje fundore të hapura, p. sh. *pa:më, pa:të, pa:në; dha:më, dha:të, dha:në..... etj;*
- në vetën e tretë shumës të së pakryerës së disa foljeve ku kanë ndodhur ç'rregullime të ndryshme: *rri:në, zi:jn, hi:jn, vi:n, ndë:jn, pri:sjën, shpi:j, e njëjta gjë ndodh edhe me vetën e tretë njëjës: vëzhdri:n (vështronte), lëpi:n (lëpinte).....etj;*
- zanoret e gjata gjenden në këtë të folme në disa trajta të ndryshme foljore dhe emërore të përfutuara nga dukuri të ndryshme fonetike, konkretisht rënie e asimilime tingujsh, p.sh: *mbe:në* (mbetën), *va:në* (vajtën), *va:te* (vajti), *mo:në* (motnë), *ko:sht* (kopësht)..... etj;
- tek moshat më të vjetra të këtij brezi spikasin fjalë të tilla si: *jaam (jaram), kaa (kaha), kooshti (kopshti), qaafire, kaave, daavet .....etj...;*

Lidhur me zanoret e gjata në të folmen çame duhet shtuar se gjatësia e këtyre zanoreve nese ato përkojnë me theksin, ka raste që edhe ndryshon nga fjala në fjalë. Tek fjalët e mësipërme gjatësia pothuaj është e njëjtë: gjatësi e cila duke u ndihmuar prej theksit bie në sy, por nuk është dhe aq larg përdorimit të shqipes së përgjithshme. Në këtë të folme ka edhe raste **të shfaqjes së saj dukshëm**, kryesisht zanoret e gjata përpara bashkëtingëllores lëngëtore *-r* , p.sh: *tagdiir, undiir, cihuur , buhaar etj.*

E njëjta gjatësi gati gati vihet re edhe tek e pakryera e vetës së tretë të foljes tek e cila nuk kemi shfaqjen e mbaresës së sotme të kësaj vete, por që bashkimi i dy zanoreve të njëjta ka marrë trajtën e një diftongu: p.sh: *do vi*<sup>550</sup>(do vente), *i shpi* bukën, *i li* (diçka). Pra, zanoret e gjata jo vetëm që janë të pranishme, por ato janë edhe të larmishme.

Sigurisht ekzistojnë edhe raste të bjerrjeve të kësaj gjatësie. Sipas Q. Haxhihasanit në të folmen e çamërishtes, një gjatësi të veçantë jepte edhe bashkimi i trajtës së shkurtër të përemrit vetor (e) me urdhëroren, p.sh: *vëzhdro+e = vëzhdree*, ku zanorja e gjatë dëgjohet dyfish; *lëshee, vree etj.* Nga të dhënat tona vërtetohet se një gjatësi e tillë zanoresh është bjerrë.

<sup>549</sup> Hoxha.D, Ibrahim, po aty f. 12

<sup>550</sup> Shembulli i përket të ardhmes të së shkuarës.

Nga ana tjetër, dukuria e përkimit të zanoreve të gjata me zanoret e theksuara ka përjashtimet e veta. P.sh, në fjalët me prejardhje turke mendohet që në zgjatjen e zanoreve ka luajtur rol të rëndësishëm analogjia. Kjo, vihet re në fjalët me prejardhje turke si: *ja:rabi, ja:llah, fa:hi, va:llah, ka:difè, du:shemè, za:lluh, fe:rexhè, ka:vè, da:vèt, qa:fir* etj. Në këtë drejtim, është mirë të studiohet kronologjia e këtyre huazimeve. Siç e theksuam edhe në sistemin leksikor, fjalët *bu:drun, di:miq, pe:nxhere* etj., i gjejmë tek brezi i vjetër, por tek më të moshuarit do të gjejmë gjegjëset e tyre: *katua, parathire, tumene* etj.

- Tek folja *běj, ě*-ja e theksuar, përveçse është përftuar nga një *a* e theksuar, ka pësuar zhvillime të mëtejshme, -ajo ka evoluar në *i*, në disa raste të veçanta edhe në *u*: *bij, bijmë, bim, bijnë / bija, bije, bin, bijmë, binit, bijnë...* etj. *bura, bure, buri, bumë, butë, bunë...* etj.

- Nga ana tjetër, nuk kemi vetëm zanoren *-ë* që jep *-i*, por në raste të rralla shohim që edhe *-o* jep *-i*: *vështroj > vëzhdri:n*. Nuk mund të përjashtohet edhe rasti i kundërt : një *-ë* e patheksuar jep *-i*: *përtpjeti*

- Përkrah dukurive të tjera karakteristike të çamërishtes, na terheq vëmendjen mungesa e zanores *y* në sistemin e saj fonetik. Ajo zëvendësohet me zanoren *-i* në këtë të folme, p.sh: *çish, ki, iti, ini, ti, di, dizet, si, qitet, diqan, disheme, mbitem, mbillem*, etj. Në të folmen e brezit të vjetër, tek fjalët me prejardhje turke, zanorja *y* zëvendësohet me zanoren *-u*: *umur, dusheme* etj.

- Në sistemin e çamërishtes mungon seria e zanoreve hundore.

**Vëzhgimet rreth zanoreve të patheksuara në të folmen e çamëve, na shpien në vlerësimin e disa dukurive e pikërisht:**

- Zanorja *-ë* e patheksuar në pozicionin e saj fundor në çamërishten e sotme ruhet: **në pozita proparoksitone**<sup>551</sup>, p.sh: *lekëtë..., dizetësë... vetëmë, i çalë, i ndarë, i tërë, i prerë, i gjatë, i gjerë, e parë, e dytë, e tretë, i urtë; njëherë, natanë (matanë), poshtë, atëherë, shumë mirë, mirë ..... etj; në pozicion semiprotonik në fjalët: *dasmëra, shkallëza, vashëza, mollëza, punëra, milëra etj.; në pozicion protonik: shtëpia, njerëzia, vëllavrasja, emëri, gatërroj, dimëroj ...etj**

- Tek e folmja e brezit të vjetër ruhet mjaft mirë dukuria e shndërrimit të *u*-së së patheksuar në *ë*: *Pënoj, këptoj, dëroj, mbëloj, rregëlloj, pëshoj*. Kjo është një dukuri që vihet re vetëm tek foljet, ndonëse dikur ajo vihej re edhe tek emrat.

- Nuk mund të themi që tek e folmja çame nuk vihen re edhe raste të rënies së *ë*-së së patheksuar, pasi nuk do të ishte e mundur. Kështu në të folur spikasin raste të tilla të rënies së saj sidomos para bashkëtingëllores *r*, p. sh: *e shroi* (e shëroi), *e droi* ( dëroi, duroi) etj. Theksojmë gjithashtu se edhe kjo është një dukuri e cila megjithese duket se është pjesë e fizionomise, mendojme se ka të beje me një zhvillim të brendshëm të folmes.

- Për sa u takon **togzanoreve**, tek folësit e brezit të vjetër na tërheqin më shumë vëmendjen togzanorët *ua* dhe *ie*: *e muarrnë, duallë, gënjen ....etj*. Nuk kemi anashkuar për asnjë çast faktin që fjalët ndryshojnë formë sipas eptimit. Kështu tek folja *thiej*, togzanori *-ie* në çamërishte në të pakryerën reduktohet në diftong *îe*: *thîeja, thîeje, thîente*; madje ndonjëherë e gjejmë edhe në trajtën *thente*. Në të folmen çame vihet re ndonjëherë edhe ruajtja e togut *uo*: (*po duo një njeri që të ruoj në dera*), si tek Buzuku. Këto shfaqje i kemi vënë re edhe tek të dhënat e 78-ës, por jo rrallë i vërejmë edhe sot tek moshat krejt të thyera.

<sup>551</sup> Termat janë huazuar nga vështrimi dialektologjik I studiuesit Q. Haxhihasani.



- Ndër diftongjet përmendim: diftongjet zbritëse *aj, oj*, të cilët përdoren zakonisht tek foljet në përgjithësi, si dhe tek përemri *ai*, p.sh: *edhe aj iku që at dit/ a mnesmet nuk e di...; mbenë këta/ i lajmë / i rrijmë/ i shplajmë ...etj.*; diftongu ngjitës *-je*, i përdorur gjithmonë tek folja *pyes* sipas kohëve dhe mënyrave të ndryshme, p.sh: *do t'pjes m'tha mua...; ..n'at kohë s'pjesëm uj t'mirë/ uj t'keq...; . po t'na pjesëshetj.*; tek diftongjet na bëjnë përshtypje edhe raste të tilla krejt të rralla të cilët në pamje të parë na duket sikur kemi të bëjmë me dyfishim të zanores, pra me një zanore të gjatë, në të vërtetë këtu kemi të bëjmë me një zanore dhe një gjysmëzanore *i* që në rastin tonë i afrohet një *j*-je. E njëjta gjatësi vihet re edhe tek e pakryera e vetës së tretë të foljes tek e cila nuk kemi shfaqjen e mbaresës së sotme të kësaj vete: p.sh: *do vi*<sup>552</sup>(do vente), *i shpii* bukën, *i lii* (diçka).

### Bashkëtingëlloret

- Tek fjalë (që shumica e të folmeve të shqipes së sotme si dhe gjuha letrare standarde) që kanë në përbërjen e tyre fonemën *j*, e folmja e çamërishtes në brezin e vjetër ruan ende *l*-në e vjetër ndërzanore.<sup>553</sup>: *fëmilë* ( fëmijë), *bilë* ( bijë), *kuel* (kuaj), *rrumulë* (rrëmujë), *milë* (mijë), *palë* (pajë), *valë* (vajë), *golë* (gojë) ..... etj.

- Një tjetër dukuri tipike në sistemin bashkëtingëllor të fonemave, është edhe ruajtja e togjeve bashkëtingëllore **kl, gl** kryesisht në fjalë të tilla si: *kle- qe* ( ishte), *kleçë- qeshë*, *glisht-gisht*, *glishtër-gishtëz*, *klumusht-qumësht*, *klumushtuar-qumështor*, *kliçe* (kyçe), *klafë* (qafë), *gregli* ( greqi> grekli> gregli), *glëmbi* ( gjëmbi), *shklata* ( shkle ata), *i shklier* ( i shqyer), *shklarë* (i shqarë- i shkarë), *klishë* ( qishë-kishë), *zglidh* ( zgjidh>zgidh) etj.

Ruajtja e *l*-së së vjetër ndërzanore si dhe ruajtja e togjeve bashkëtingëllore *kl, gl* janë dy dukuri për të cilat ka pasur edhe diskutime ndërmjet studiuesve. Kështu nga njëra anë kemi pohimin e prof. Q. Haxhihasanit për timbrin e fonemës së vjetër *ll*, sipas të cilit ajo nuk shfaq ngjyra të ndryshme të timbrit të saj, ndërsa studiues të ndryshëm arbëreshë të, Italisë, Greqisë, H. Pedersenit, Çabej etj, pohojnë se *l*-ja tek grupet *kl, -gl*, është më e butë se tek fjalët e tjera.

- Në të folmen e individëve në moshë të thyer, hasim edhe fjalë të tilla si: *maqina, paqeta, qisha gjishti, qumushti etj.* Mendojmë se ekzistojnë disa mundësi të këtij përdorimi: ose shqiptohen si të tilla për analogji me disa fjalë si, *sokaq, dufeq* tek të cilat ndodh palatalizimi i velares *k* në *q*; ose mund të jenë interferenca nga e folmja e bashkesive pritëse.( përsëmbull në të folmen e Shqipërisë së Mesme *q*-ja në disa raste jep **gj**: gjisht.)<sup>554</sup>; ose për analogji me fjalë të shqipes së sotme ku grupi *gl* jep *gj* dhe *kl* jep *q*, p.sh: *klaj- qaj, klumusht –qumësht* ( pasi kemi edhe *kl>k, kliç-kyç, klisha- kisha) gluha- gjuha* etj; së fundmi mendojmë se mundësia më e madhe e këtij përdorimi tek brezi i vjetër nuk lidhet me asnjërën prej tyre, pasi në 78-ën kemi fjalën *shqelb*, gjë që tregon se fjalët *maqinë* edhe *paqetë* te 90-vjeçarët, kanë lidhje me një përdorim të çamërishtes. Në këtë pikë aludohet jo vetëm me një atakim skajesh, ku *y-ja>i, -në Diber ; y-ja >i , - në çamërishte*; por edhe *k>q* në te folmen e hershme te Shqipërisë së Mesme (edhe sot); *k>q* në çamërishten e hershme.

- Një tjetër tog bashkëtingëllor që tërheq vëmendjen po në të njëjtën masë tek kjo e folme, është edhe togu *-lk* ( lg), i cili sot ka përfunduar në **jk**. Psh: *alkë- ajkë, balgë-bajgë, ulk-ujk, bulk- bujk*.

- Përsa i përket dukurisë së rotacizmit, në të folmen e çamëve të vjetër, kemi

<sup>552</sup> Shembulli i përket të ardhmes të së shkuarës.

<sup>553</sup> Nga ndikimi i zanoreve palatale-*l*-ja ndërzanore ka përfunduar në *-j* në shqipen e sotme.

<sup>554</sup> Një ndër faktorët e jashtëm ndihmues në këtë pikë është fakti se këto ndryshime vihen re më shumë tek burrat e brezit të vjetër.

vene re edhe disa raste të veçanta në të cilat fonema **-n** qëndron e parotacizuar. Kjo vihet re sidomos tek pjesorja e foljes *běj*. P. sh: *ja / këtë bëni ai ; nu na lanë gjë pa bën; ja / si bënen kutu /bënen e atje*

-Në disa raste, çamërishtja karakterizohet nga përdorimi i një *rr*-je disi të veçantë (në vend të fonemës *r*), dukuri e cila trashëgohet tek folës të brezit të mesëm, në raste të rralla edhe tek brezi i ri. Përdorimi i kësaj foneme karakterizohet nga funksioni ekspresiv që ajo ka. Ajo shfaq një timbër të veçantë në të shqiptuar që ndryshon me fonemën *rr* të zakonshme. *E kishte bërë byrekun të trrashë kaq...; e prrishi ajo; kujdes se është e krrimbur.*

- Në këtë të folme në sistemin e fonemave bashkëtingëllore vihet re edhe **këmbimi i fonemave bashkëtingëllore, si:** këmbimi midis buzoreve **b** dhe **v**, p.sh: *ka:live* ( kolibe); shndërrimi i fonemës **k** në **h** në disa raste të veçanta, si tek fjalët, *pehtua* (patkua), *vaht* (vakt) etj.; edhe pse bashkëtingëllorja **-nj** në përgjithësi paraqitet e qëndrueshme, tek brezi i vjetër çam sot vërejmë ndonjëherë që **- nj-ja** zberthehet në **n+j**: *çdon-jeri, n-jonjherë, tan-ja, n-jaj etj*;

- Në të folmen e çamërishtes vërejmë gjithashtu **h-në** velare të palatalizuar që i përgjigjet **ç** greke në disa fjalë si, *ahjere-axere, hje* (hije)-*çe, teshjere* (ftesë) *tesçere, Dahjriu- Daxriu* (patronim) etj; herë- herë palatalizimi humbet dhe për rrjedhojë kemi një **h** dhe një **j** të shqiptuar pranë njëra tjetrës për të cilën mendojmë se ka të bëjë me një risi të mëvonshme.

- Viojmë me një përdorim tjetër, të frikatives greke **ğ**, që tek të vjetërit shqiptohet vetëm kur ato këndojnë këngë çame, tek të cilat me sa duket ndryshimi nuk ka vepruar. “*ğarufale kuqelarë*”;

- Dikur, qiellzorja alveolare e pazëshme **-ç**, dilte shpeshherë në **-sh**: *çdo/shdo, ç'kishinë/ sh'kishinë.*

- Një tjetër dukuri që meriton të trajtohet lidhur me fonemat bashkëtingëllore, është edhe ajo e asimilimit të grupeve bashkëtingëllore **-mb, -nd,-ng**, pa mohuar të kundërtën për çamërishten: që në të shumtën e përdorimeve, në të folmen e brezit të vjetër, këto togje shfaqen të qëndrueshëm. Për rrjedhojë, tek çamërishtja vihen re: asimilime paravajtëse: *nōnjë, bërna*); prapavajtëse: *bledhën... , brojtur, grem, denjëm, gasim*. Ka edhe raste kur kjo dukuri vihet re edhe në disa togje të tjera p.sh: *ù xerri, gjesh, jaram, ose jām- ngjaram (ngjaram-gjaram-jaram-jām)*; vini re togjet **nx, fsh, ngj**. Në këtë kuadër, një tjetër tog që na tërheq vëmendjen është edhe togu bashkëtingëllor **st**, i cili shpesh përfundon në *s. kusum/ kusum* (per analogji) *arkesa(orkestra)( per analogji)...;..pësaj*

- **Disa dukuri të tjera fonetike që lidhen si me sistemin bashkëtingëllor dhe atë zanor janë:**

- Zëshmeria dhe shurdhimi nën efektin e bashkëtingëlloreve të zëshme a të shurdhëta brenda fjalëve: p.sh: *...nganjëherë > ganjëherë* ( asimilim paravajtës) *>kanjëherë* ( shurdhimi i **g**-së në **k**); *gurbeti* ( ndodh e kundërta, **k>g**); *i prëmshmi* ( i mbrëmshmi, **mb>b>p**)...*gjazhdhjet e tetë* ( e shurdhëta **sh** është shndërruar në e zëshme nga prania e së zëshmes **dh**); *...nënd* ( bashkëtingëllorja e shurdhët **t** prapa hundores **n**, zëshmohet), po kështu edhe tek fjala *barangë*.

- Dukuri fonetike që lidhen me sistemin zanor, si: asimilime paravajtëse (progresive), si psh në fjalët: *umur* ( ymër>umër>umur); *rruguve* (rrugëve);- asimilime prapavajtëse (regresive): *talaçe, sumur, mususi, mu duket, kutu, budrum, turkuza, dokumentat, kushtu, kuput, rrumulë, thëmër etj.*

- një sërë asimilimesh të bashkëtingëlloreve, si: asimilime të pjesshme, p.sh: *barangë* ( **nk>ng**); *mblakur* (**mp>mb**); asimilime të plota me rënie në togje bashkëtingëlloresh, psh: *bërna* ( **nd<n**); *vamë* ( **tm<m**); *mbenë* ( **tn>n**); *dhënërit*

( nd>n); *kusum* ( st>s); *mbemë* (tm>m); *pamë* ( tm>m); *zapo* (pt>p); *belqete* (r>l); raste asimilimesh bashkëtingëlloresh jo në togje: *natanë* ( m>n); *koushtë* (p>k); *budrunit* ( m>n); *veçëm* (t>ç); *njonjë* (nd>n-j); *nartuan* (m<n); *nonjë* (nd>nj,nj>n; nonjë-njonjë-nonjë); *rëpjetë* (t>r).

- **Disimilime** bashkëtingëlloresh, si: *birbil* ( bilbil); *bërthet* ( bërtet); *rëpjetë* ( tëpjetë)...etj.

- Disimilime zanoresh: *mbëloj/mbëluar* (mbuluar); *velënxa* (velenxa); *çadre* (çadra); *qevëria* (qeveria); *pësaj* (pastaj), *kërar* (karar); *pënoj/ pënuar* (punuar); *rregëlloj/rregëlluar* (rregulluar); *vëllahi* ( vallahi); *këptoj/ këptuar* ( kuptuar).

- **Dukuria e sinkopës**:...*u ashpsua*, *ern*, *gjëm etj*; **apokopës**: *nu* ( nuk), *t'na ip* (që t'na jepte); **metatezës**: *bërna* (brënda) *Gërqi...*, *siqëdo* ( sidoqë), *mbëllirë* (mbyllur>mbillur>mbullirë>mbëllirë), *të njëte* ( të enjten), *sitaxhe* ( sixhade).

- Një dukuri e rëndësishme fonetike është moszhvillimi i **j**-së epentitike. Kjo dukuri vihet re në: fjalë të huazuara nga shqipja e përgjithshme: *qime – qima*, *gjëndegjenda* (gjëndje), *nuse- nusa* (nusja), *Fatimë- a*; *Gjulë- a ose Gjula*, *Lume-a ose Luma*; *e vjeme- a*, *e sivjeme-a* ....etj.; tek përemrat pronorë të vetës së parë dhe të dytë njëjës: *ima*, *jota etj*. Është bjerrë kjo dukuri tek përemri vetor i vetës së tretë njëjës të gjinisë femërore: **ajo**; dikur kemi pasur **ao**

- Gjithashtu shumë e rrallë si dukuri shfaqet tek më të moshuarit sot edhe dukuria e shtimit të fonemave. Kështu vihet re shtimi i fonemave *-b,- r ,-m,- n,- t,-i,- ë,-g* tek disa fjalë si: *zëmbra*, *shëngjeta*, *murzika*, *mblakur*, *akomi*, *menati*, *t'shkomi*, *djelm*, *ognazë- ohnazë*, *etj*.

### Tipare morfologjike të së folmes çame

Përsa i takon kategorisë gramatikore të gjinisë, studiuesit ndajnë afërsisht të njëjtin mendim për ekzistencën e tri gjinive në dialektin e çamërishtes. Këtë do ta gjejmë të konfirmuar nga studiues si, Pedersen (gjeje këtu), Çabej si dhe Q. Haxhihasani në studimet për këtë të folme. Në çamërishte, gjen ende përdorim një pakicë fjalësh, konkretisht në shprehje të tipit: *ç'më ngjeth misht*; *vdiqa ka të ftohtët*; *plasi ka të klarët*; *i bëri të bardhët e vesë etj*.

Një sasi emrash femërorë kryesisht emra frymorësh, me theks parafundor, që mbarojnë më *–o*, këtë të fundit do ta shndërrojnë në *–u* dhe fjala do të marrë nyjen e sprasme *–a*, thënë ndryshe: zanorja *–o* do të zërthehet në togzanorin *–ua*, p.sh: *çeço- çeçua*, *dajo-dajua*, *Hazo-Hazua*, *Ziko-Zikua* etj. E kundërta ndodh me emrat mashkullorë tek të cilët dyzanori *–ua*, mblidhet në *o*, -dukuri kjo që përkon edhe me standardin e sotëm, p.sh: *pampuar- pampori*, *klumushtuar- klumushtori*, *lakruar-lakrori*, sikurse të gjithë emrat e tjerë të shqipes që mbarojnë me *–ua*: *krua –kroi*, *ftua- ftoi*, *përrua- përroi*.

Një dukuri karakteristike për këtë të folme është formimi i shumës me anë të dukurisë së metafonisë, konkretisht, të **a**-së së theksuar të rrënjës: *duqan-duqene*, *çoban-çobenë*, *jorgan- jorgenë*, *sahan –sahenë*, *filxhan-filxhenë*, *dullap-dullepe*, *jatrua-jatrenj*, *katua-katenj*, *ikua-ikenj etj*. Fjalë të tilla si, *çarçefë*, *jorgenë etj*, që dikur në dialektin çam nuk kanë ekzistuar, (gjegjëset e të cilave në çamërishte kanë qenë: *sendon*, *papllomë*), tregojnë se megjithëse e folmja çame ka evoluar, dukuria e shumës me metafonizëm është mbartur, pavarësisht përdorimit dysor, bjerrjes, apo risimit në këtë të folme.

Në çamërishte kemi disa patronime që e formojnë shumësin me **-enj, -ej**: *Hoxhenjtë ose Hoxhejtë*, *Malenjtë ose Malejtë*, *Abdurrahmenjtë ose Abdurahmejtë*, *Dahrenjtë*, *Dahrejtë*, *Rokenjtë etj*.

Na tërheq vëmendjen në kete të folme edhe shumësi në trajtën e pashquar të

emrave që mbarojnë me prapashtesat, - **e**, -**ë**, -**a**, -**nj**, si në mbarë shqipen: *ledh-ledhe, tanks-tenkse, tërrnit- tërrnite, top-tope, mitraloz- mitraloze, avion-avione, bereqet-bereqete, aheng-ahenge, koosht-kooshte, qitet-qitete, aeropllean-aeroplplane; filaqotë, margëlliçotë, volotë, gjerdanë, çengelë, kulishë, kaciqë, fanarë, manarë, pamporë* ( pampuar), *klumështorë* ( klumështuar), *lakrorë* (lakruar); *glëmb-glëmba, rrembrremba, dimër-dimra, emër-ëmra, plesht-pleshta, morr-morra, emër-emra, hu-nj, bari-nj, dru-nj, katua-katenj, ftua-ftonj, thua-thonj, përrua-përrenj*;

Karakteristike për këtë të folme sot janë edhe disa lloje të tjera shumëfish, si: shumësi i pashquar me mbaresën -**ër**: *grekër, jetimër, majmunër, matufër, glishtër, bufër, bandillër, gonër, kunetër, ulqër, halldupër* etj.; disa lloje shumëfish që përdoren vetëm tek brezi i vjetër dhe nuk trashëgohen tek brezat më të rinj, pasi ato konsiderohen si përdorime të vjetëruara, p.sh: *kalë-kuel, djalë-djel, thes-thesë, rreth-rrethë* etj.

Shumësi i emrave femërorë përftohet në këtë të folme sipas rregullave të standardit të përgjithshëm të gjuhës shqipe. Specifike për këtë lloj gjinie janë: disa përdorime të emrave femërorë të zvogëlimit, si: *pulëz, arrëz, vashëz*, etj, të cilët e ruajnë prapashtesën e zvogëlimit edhe në numrin shumëfish, si: *pulëza, arrëza, vashëza*; shumësi i formuar me prapashtesën -**ra**: *dasmëra, bakllahira, punëra, kripëra, barëra, leshëra* etj. Ndër të tjera këto janë dukuri të cilat flasin qartë për përkatësinë e këtij dialekti në toskërishte.

Për sa i përket **trajtave rasore**, spikasin për veçantinë e tyre mbaresat **e rasës kallëzore**. Kështu, emrat mashkullorë që në të pashquarën e njëjësit **mbarojnë me zanore**, e formojnë të shquarën e kallëzores nga trajta e pashquar e kësaj rase me mbaresën **në/ n** , p. sh: *mullinë, sinë, pënë, sufranë, fshanë, baragnë, surranë, pallanë, varrë, djalë*, etj. *ja theri djalnë*. Këto shembuj na kujtojnë format e vetës së tretë të foljeve në veprime: *rrahnë, hapnë* etj , të cilat sot i gjejmë në trajtën *rrahën, hapën* etj.

Në të folmen e çamërishtes nuk përjashtohen edhe rastet kur emrat që **mbarojnë me bashkëtingëllore** e formojnë trajtën e shquar të kallëzores duke marrë zanoren -**i** midis temës dhe mbaresës, si : *emërin, fshatin, ballin, glishtin, lumin* etj, sikurse në mbarë shqipen. Në brezin e vjetër sot ky përdorim zë vendin më të madh. Një gjë e tillë vërtetohet edhe më mirë prej emrave të gjinisë femërore, si ato me temë në bashkëtingëllore ashtu edhe ato me temë në zanore, të cilët marrin në kallëzore mbaresat **në/ n**. Këto mbaresat flasin për një formë të hershme, por kemi dhe raste kur përdoren edhe forma të evoluara p.sh: *Konispolën, fëmilën, djalën, burrën* etj. Në këto raste siç e shohim ë -ja fundore ka rënë dhe kemi një ë mbështetëse, midis temës dhe mbaresës. Si përfundim mund të themi se duke qenë se flitet për të njëjtën formë , pra *burrnë/ burrën – hapnë/ hapën*, mendojmë se kjo është një dukuri fonetike më shumë sesa morfologjike, e cila flet për rënie të ë-së së patheksuar dhe shfaqje të – ë së ndërmjet dy bashkëtingëlloreve.

Në këtë të folme na bën përshtypje prania e rasës **vendore** p.sh. *iknë me pushkë maleve, e thertënë e vartën n'fikt* , *morri ikte prroit* etj. Në rasën **gjinore** do të vihen re disa trajta të hershme, si p.sh: *kishte tuf'n(ë) e kafshve-t* , ku mbaresa e hershme -**t**, sot ka rënë në format e lakimit. E njëjta gjë ndodh edhe për dhanoren: *u tha djelmvet*

Kontraktimet kanë ndodhur edhe në sistemin e eptimit, p. sh: *edhe i shpij gjith e kush në vënd të tij; ishim burr e gra/ disave u dhanë punë qevërrri n'at kohë; fanatik shumë çamëria.*

Emrat e gjinisë femërore që në trajtën e pashquar të emërores së njëjësit dalin më **e**, do të ruajnë formë të njëjtë edhe në rase të tjera. Kështu kemi: *mish dele* dhe jo,

*mish deleje.*

Tek **mbiemri** na ka tërhequr vëmendjen përdorimi i tij në ligjërimin e zakonshëm para emrit, duke mbartur kështu një ngarkesë emocionale të madhe si shenjë emotiviteti në këtë të folme, p. sh: *të madhe hata që i bëri moj të keqen! Ama të keqe nuse që kish marrë Esmaja?! Të bukur ligjëratë që na ligjërove!*

**Nga përemrat vetorë**, kemi veçuar vetorin e vetës së parë njëjës **-unë**, i cili në emërore del në formën e tij të thjeshtë fonetike, në trajtën arkaike **-ù**. Tek gramatika historike për këtë dukuri gjejmë këto të dhëna: forma e hershme **-ù** e ka prejardhjen nga një vetor **“sëe”** të indoevropianishtes. “ ky përemër është i pranishëm që në rreshtat e para të “Mesharit”: *Û Doni Gjoni, biri i Bdek Buzukut... etj*<sup>555</sup>, por siç e kemi vërejtur nuk mungojnë shfaqjet e këtij përemri tek arvanitasit dhe arbëreshët.

Të tjera trajta karakteristike që vërehen vetëm tek më të vjetërit në moshë, janë trajtat, *nevet* dhe *na*. Përdorimi i trajtave të plota të përemrave vetorë *neve*, *juve* është karakteristikë e të folmes, duke mospërzjashtuar edhe disa të folme të tjera të jugut në përgjithësi. Përdorimi i varianteve *nevet*, *juvet* tregon përbashkësi me të folmet e Gjirokastrës. Ndërsa, përdorimi i variantit *-na* tregon përbashkësi me disa të folme skajore të gegërishtes, të labërishtes dhe të disa të folmeve arbëreshe në tërësi.

E folmja e çamërishtes shquhet për një përdorim të rregullt të trajtave të **shkurtra**. Një përdorim i shpeshtë vihet re në prapangjitjen e tyre: *Thuejna! -i thanë ata, nuk ua thom.*

Në këtë të folme, tek më të moshuarit, shohim se, forma që tashmë konsiderohen si shkëlje në normë nga të gjithë shqipfolësit, përdoren mjaft saktë. Gjatë përdorimit të trajtave të shkurtra spikat forma e rregullt e trajtës së shkurtër të përemrit vetor (veta e tretë) **u**, p.sh: *u tha djelmet; u thotë babajt e nanës*. Jo vetëm tek shqipfolësit por edhe tek folësit çamë të brezave pasardhës do të gjejmë format e gabuara : *i tha.... ; i thotë....etj.*

Pjesëza **më** e cila vendoset përpara mbiemrave në përgjithësi apo ndajfoljeve me funksionin tregues të kategorisë së shkallës, më konkretisht, të shkallës krahasore të pabarazisë (të sipërisë relative), si dhe pjesëza **të** e foljes në lidhore, duke u bashkuar që të dyja me trajtën e shkurtër të kallëzores **e**, elidohen: *pak m'e madhe, ishalla t'vete njher t'e shoh at vëndin tim, atje çamërinë.*

Në këtë të folme nuk gjejmë asnjë gjurmë të formës së të vjetëruar të **përemrit vetvetor: vëtëhe**.

- **Përemrat dëftorë** më të rëndësishëm janë: *ki(ky), kjo(kjo), këta, këto, kta, kto, këtitë, këtija, atitë, atija, këture, kuture, këtire, atyre, atire, ature, këso, aso etj.* Këto shembuj janë dëshmi e qartë e disa proceseve njëherësh, si: e ruajtjes; e orientimit kah formave të rregullta të shqipes standarde; e interferencave të pashmangshme nga e folmja e bashkësive pritese etj.

**Përemrat pronorë** më të spikatur janë: *inë(ynë), it(yt), i tire(i tyre), i ture(i tyre), ima(imja) jota(jotja) etj.* Përdorimi i këtyre përemrave në brezin e vjetër sot, është tregues i qartë i gjallërisë që kjo e folme mbart në ditët tona. Tek përemri pronor i emëruar vihet re gjithashtu edhe ruajtja e përdorimit të ansjelltë të kategorisë së trajtës, ku trajta e shquar përdoret në vënd të së pashquarës. P. sh: *Në Itali kishte një shtëpi të tijën; Kish një kushërirë të sajën....etj.* Në brezin e mesëm nuk trashëgohen aspak këto dukuri. Folësit e këtij brezi përdorin më shumë format sipas standardit.

Dy janë **përemrat pyetës** që na tërheqin vëmendjen më shumë: **ç** dhe **çish**

<sup>555</sup> Buzuku, Gj. Meshari, 1555.

ndonjëherë edhe përemri **çilë**. Format *ç* dhe *çish* (forma e apokopuar *çi* shumë e spikatur në të folmen çame.) Një tjetër element është edhe lokucioni parafjalor **me se** (parafjalë+ përemër, se= çfarë), që vihet re dendur në ligjërimin e folësve. Po rendisim disa shembuj për të gjitha këto: *ç'rënd të kam/ i tha ...çish thatë? Po ç'i jetë isht kijo? ....marrim këtë ç'i thonë..; ....çish veni/ si jeni...// çish do vemi/ i tha baba...; në çish sene muej i solli burrat? See ... çish do na bën baba / me ç'i do na mbahej? Me se do i bini? Me se do jetoni? Me se e do bukënë? Me se d'e marrish? çila isht e vjemea, çila e sivjemea; çish ke baba i thanë; shikoni çish hanë ata zagarë atje; eee çish thua ti; çila isht nana, çila isht bila etj. Siç e shohim edhe nga larmishmëria në përdorim të formave të përemrit pyetës **çish**, herë e gjejmë atë të barazvlefshme me fjalën **çfarë**, herë me fjalën **qysh** dhe ndonjëherë me fjalën **si**.*

Trajtat e vjetra të këtij përemri, *çilë*, *çili*, *çila*, si dhe trajta e vjetër e tij *shdo* (e cila vjen nga ndryshimi fonetik i përemrit pyetës *ç* nën ndikimin e bashkëtingëlloreve të zëshme), janë në bjerrje e sipër në të folmen e brezit të vjetër. Forma e përemrit pyetës *çfarë* nuk ka ekzistuar kurrë në të folmen çame. Më rrallë tek brezi i vjetër dhe më shpesh në brezat pasardhës, do të gjejmë të përdorur si trajtën e rregullt **çfarë**, gjë që tregon risi në këtë të folme, ose trajtën e apokopuar të saj **ça**, çka tregon interferencat e dialektit të tjetrit.

Për sa i përket përemrit **çish**, nga të dhënat tona nuk vërejmë ndonjë përdorim të natyrshëm, përveçse emotiv tek folësit e brezave pasardhës. Ndryshe ndodh me lokucionin e njohur **me se**, i cili vihet re tek të gjithë folësit e të gjithë brezave.

Përemrat e lartpërmendur pyetës *ç*, *çish*; *çilë*, *çili*, *çila* në të folmen çame përdoren edhe me funksionin e **përemrave lidhorë**, Ndonjëherë kemi edhe shfaqje të formës së vjetër të përemrit lidhor **çil**: *çil kapi greku i therte*; apo në trajtën e tij të apokopuar, **çi**: *çi zuri vrau*.

Tek **përemrat e pacaktuar** na bie në sy bjerrja e formave të vjetëruara të këtyre përemrave në të folur. Kështu disa përemra si, **gjithëçili**, **shdononjë**, **akëç**, **dish**, **shdo**, kanë humbur sot në këtë të folme. Tek të dhënat tona të viteve 78 gjejmë format **dish** ( *dish ish*) dhe **zhdo** (*zhdo njëri*)<sup>556</sup> Disa trajta karakteristike të çamërishtes së këtij përemri, spikasin më tepër për dallimet e tyre fonetike: Psh: *nōnji*, *çdon-jeri*, *asnji*. Një formë e vjetër e së folmes është edhe forma *tjatër* ( *dergoi një tjatër..*) , e cila përdoret sot edhe në të folmet e tjera të toskërishtes jugore<sup>557</sup>

Për sa u përket **numërorëve** do të vihen re disa dallime fonetike: mijë- **milë** (njëjës); mijëra- **milëra** (shumës); numërori **dy** , i cili shfaqet në formën **di** ( si dhe të gjithë ato numërorë që kanë në përbërjen e tyre numërorin dy); numërori **tre** dallon për një përdorim të saktë të kategorisë së gjinisë.

**Në sistemin foljor shkurtimisht po përmendim vetëm ato dukuri të cilat nuk i kemi përmendur më lart.**<sup>558</sup>

Në sistemin foljor gjithçka, të jep përshtypjen e një sistemi aspak të qëndrueshëm e, megjithatë, gjatë një studimi të hollësishëm që kemi bërë, vërejmë që edhe ky sistem vërtitet rreth disa rregullave. Në formë foljet mund t'i përkasin një kohe të caktuar, por që realisht përdoren me kuptimin e një kohe tjetër.: *të veni dhe të vini shëndoshë* ( lidhore me kuptimin e dëshirores). Koha e pakryer është më problematikja në këtë drejtim. Kështu, foljet *pyes*, *flas*, *marr*, *hap* etj., në vetën e parë të kohës së pakryer dalin në format e tyre përkatëse, *pjesi*, *flasi*, *marri*, *hapi*. Rrallë

<sup>556</sup> Këto të dhëna i kemi pasqyruar në fund të mikrotezës, me qëllim që të mund të shfrytëzohen nga studiuesi. Edhe ato në vetvete përbëjnë risi në këtë punim

<sup>557</sup> Totoni, M: e folmja e bregdetit të poshtëm; S.F Nr. 2 , Tiranë 1964, instituti shkencor i Historisë dhe i Gjuhësisë.

<sup>558</sup> Shih në autoreferat, f 5- 8.

mund të ndodhë që koha e pakryer të përdoret saktë tek më të moshuarit: **pijnë** ( *piqte*; **gopej**; **lëpin (lëpinte)**; **pjekin**( *pjek*); *erdhi nek ai qe vëzhdrin* (vështronte) përpjeti / një grusht lira edhe atij ; ai breti **kish** një mall mërguarë edhe bum ktë copëzë shtëpi..../... qi **ish** kaq e bukura; o merre selle bërna / vete bërna/ e she gjithë ata që **duej ( donte)** ajo// djali pa gënë pa pirë / atje ai// ka ligësia ajo/ kur i **shpÿ** ( **shpinte**) bukën i jati asaj / ajo i **liÿ** (linte) ka një çikë pjesë **të haj** ( të hante)breiti. Mjaft interesante duket forma e së pakryerës **duaj** (donte ), pasi nxjerr në pah edhe një herë përdorimin e shpeshtë të togzanorit **ua** në këtë të folme.

Interesante duken disa shembuj në të ardhmen e së shkuarës: *do viÿ* (do vente); *do liÿ* (linte); *do marton* (martonte), ku vihet re mungesa e pjesëzës të, si dhe një lloj tjetër gjatësie e zanores.etj

Mbaresat foljore në lidhore në përgjithësi përkojnë me standardin, përveç vetës së dytë të aoristit sigmatik, të cilin e gjejmë në trajtën e dysorësisë në përdorim, si edhe mbaresës së vetës së tretë në të pakryerën (*të diÿl, të liÿ, të punon-* të dilte, të linte, të punonte)

Interesante na është dukur edhe më se e kryera: *të jesh mërguar* ....( të isha larg); *të kesh vënë* (të kisha vënë).

Në çamërishte shihet një përdorim **i formave të pashtjelluara foljore** si në mbarë shqipen e përgjithshme: *për t'i bënë ; pa gënë , pa pirë , duke pënuar etj*

Në këtë të folme spikasin dendur disa trajta karakteristike foljore, konkretisht trajtat analitike të kohës së shkuar të foljeve, të cilat formohen nga veprorja duke u paravënë pjesëzën **u** përpara, p. sh: **u ka bënë**. Pra, këto forma ndërtohen me anë të foljes ndihmëse **kam + pjesore** dhe jo **jam + pjesore**. P. sh: **u ka bënë, u kish sellë, u ka rritur, u ka gritur, u ka sumurë** etj.

Forma joveprore në këtë të folme formohet me anë të mjeteve si në mbarë shqipen. *Vineshin, U kthenë ka rruga, u ka bënë*, formë e cila bën përjashtim pasi përdoret në vend të formës *janë bërë*. Këto forma janë trashëguar edhe tek brezat pasardhës, madje ato parapëlqehen në përdorim edhe nga brezi i ri.

Përveç ç'rregullimeve të trajtuara në fillim të kësaj përmbledhjeje, çamërishtja shquhet edhe për një përdorim të rregull (më të rrallë) të kësaj forme: *Ai nuk gopej*. Pra, format joveprore të formuara me mbasesat *hem/em, hesh/ esh* etj; *hesha/ esha, heshe/ eshe* etj., si dhe forma e formuar me anë të pjesëzës **u** (e tipit *u kthenë*), përdoren në brezin e ri sipas shqipes së përgjithshme. Tek kjo e fundit ky brez bjerr me vetëdije dukuritë fonetike brenda fjalës.

**Me interes në këtë të folme duken edhe pjesët e pandryshueshme të ligjëratës.**

**Ndajfoljet e kohës:** *açhere, pësjaj, tani, tani-ja, njherë, kanjëherë, ganjëherë;*  
**ndajfoljet e vendit:** *nek, ngaherë, natanë* (dhe *matanë*), *bërna, kÿtej, atej, siprazi, kado, atje, kÿtu*, si dhe format e rregullta letrare, *atje, kutu;* **ndajfoljet e mënyrës:** *kÿshtu, ashtu*

**Pjesëzat:** *nÿku, se, pa, një.*

**Parafjalët:** *ka* ( nga); *njaram > javam > jām* ( deri); *nek, ne* ( tek).

**Lidhëzat:** *A* ( apo); *sā* ( saqë):

**Pasthirrmat:** *Hoj, oj, ja hë, me, uë, ua, moj, mo* .....etj.

## KORPUS TEKSTESH NË ÇAMËRISHT

### Tekste të viteve 1978 ( përralla)

#### Prallëza e Xhikos

Na ish një bret/ kish tre djelm edhe një vajzë// asaj vajzës ja thoshin Xhiko// ai breti kish një mall mërguarë edhe do vii të punon me të tre djelt pesë vjet ne ai malli/ e i thonë djeltë/ me çilë de lemë Xhikon baba / do i lëmë Veqil hoxhën/ imamin/ i thotë Xhikua// Veqil hoxhën se dua baba// i tha/ ju do ikni/ të veni e të vini shëndoshë / edhe mua çish të më lipset kutu e pesë vjet do m'i sillni bërna kutu// të m'e damkosni portën / kur të vini ju do hapet porta//

Ata ignë dhe çish i lipseshin ja suallë bërna/ damkosën portën e mori djelt e iku ai// ka shkoi breti i tha hoxhës/ ki mendjen ka xhikua je Veqil/ mirë mirë i tha hoxha. Erdhi java qi do vī t'i pshonis asaj edhe vate ne Xhikua// tang tang / i ra portës/ kush i bije portës / ù hoxha/ amë zhdo në Pazar / hape portën i tha hoxha/ s'hapet porta sa të vi breti / i tha ajo// do m'e māj një kamë me mish / do t'i hedh paratë me turkuzë //

E solli hoxha kamën me mish/ hape portën Xhiko/ i tha / një të hedhur turkuzën Xhikua/ lidh kamën me mish hoxha/ lidh mesin e tij / një të gritur i bën Xhikua/ në heva hoxha / e kuput Xhikua/ hoxha ra rëposh me gjith mish// atëj hoxha në shtëpi të tij// çish ke baba i thanë / kushtu e kushtu më bëri Xhikua u tha djelmve/ mirë ta bëri/ i thanë/ se u tërbove për xhikon ti i thanë/

Një ditë e ka ditë Xhikua/ ditë xhumaje bën haman / mirpo shtëpi e hoxhës edhe e bredit vineshin karshi për karshi// hoxha e pa kur vate në haman ajo/ hoxha zuri vënd që të mos dil Xhikua// Xhikua e kuptoi që ish hoxha përjashta// ikë atëj hoxhë i tha// atje do të lë Xhiko njëqind vjet nuk iki// ajo një ti shkumuar bëri shkumë sapuni e ja hodhi me tullumne në si përjashta// hoxha i verbuar vate në shtëpi // hoxha për t'i bërë keq Xhikos na bën një llagëm në shtëpi të Xhikos e në shtëpi të tij// edhe llagëmit e llagëmit na i vete xhikos në katua e i bije qepengjisë / kjo hap qepengjinë / e sheh hoxha e i thotë / më do tani xhiko/ tani që erdhe kutu të dua i tha ajo / po do vë ujë të biç haman/ i tha ajo/ edhe do të laj vetë i tha xhikua// Xhikua valoj një kazan me ujë / pa t'ja kthen hoxhës mbë// hoxha thotë/ e merr ka këmët e e hedh poshtë// venë e u thonë djelmve të hoxhës// ikë e mirrni babanë m n parathire të Xhikos se e ka zier me ujë glluk xhikua// e muarn e çuan ne jatroi / e shrojnë hoxhën// Xhikua mori dhogë e vate karfosi llagëmin se mos vinej prapë// hoxha u shrua/ qëndron i bën një kartë bredit/ po pjete edhe për Xhikon / pesë i hinë e dhjetë i dalin// breti i thotë djalit madh/ do veç të m'e theriç Xhikon/ të më sjelliç një filxhan gjak të pi/ jo nuk vete i tha djali / do vesh ti i tha të mesmit/ jo edhe ù nuk vete dot baba i tha/ po ti i tha të



voglit do veç/ do vete i tha ai// u nis vate përjashta natën e i ra portës// kush i bie portës / i tha ajo/ ù i prëmsmi i tha ai/ nuk ka të prëmsëm e tekseprëmsëm kutu ne portë të bredit / se po i dërgova një copë kartë bredit do i veri zjarrë kasabajt// ndenji prapë një çikë e i ra portës prapë// kush i bije portës i tha ajo/ ù i njënatshmi / i tha ai/ he qerratarët e qerratajt/ kutu ne portën e bredit nuk ka të njënatë// e la nja di sahat e prapë i ra portës ai// kush i bije portës i tha ajo/ ù vëllai it i vogël jam// po je vëllai im më hedh ognazën t'e shoh/ pra të hapet porta/ ki i hodhi ognazën/ e pa ajo e i hapi portën/ vëllai po klante// pse klan more vëlla/ mos ka vdekur babaj i tha/ jo/ mos ka vdekur nonjë ka vëllezërit/ jo / po më ka dërguar babai që të të ther tī / se kushtu e kushtuna dërgon hoxha// thermë more vëlla/ hallall ti bënet gjaku im babajt// po do të presh glishtin e vogël/ ti shpie një filxhan gjak babajt / pastaj edhe ti t'ikiç këtej edhe ù t'iki// ja preu glishtin e vogël/ bushi një qelq të vogël e e mori pas// dënjën nja katra pesë ditë sa xuar mallë motrevëlla atje në shtëpinë e ture/ e duallë e iknë të di / damkosën portën/ muarën e qitapët e saj e iknë në një vënd nek dahej rruga / një këtëj e një atej// nek vī ne babaj i thotë vëlla it ajo/ qëndro vëlla mos ikë me merak// atje na ish kroi i fshatit/ qëndroi i vëllai/ ajo vërdalla kroit/ hapu dhe të hī xhikua/ hapu dhe të hī xhikua/ hapu dhe të hī xhikua // u hap dhe e hiri Xhikua// xhikos i kish betur një çep ka të sedres përjashta asaj// djali e shpuri qelqin me gjak/ breti e piu e tha/ ha moj xhiko nuk ma tha mendja të më turpëroje// për tri katër ditë na shkon një bret tjetër atje ne krua të pin ujë / me zagarë edhe gjatorë// ne kroi ish një rrap i madh e bën hqe// zagarët lehin kaf/kaf/ kaf/ ne ajo copa e sedres që i kish betur përjashta // i thotë breti njëit ka ature/ shkoni çish hanë ata zagarë atje/ vate gjatori po nuk u qas se e shtin një erë// dërgoi një tjetër breti/ ai beti me tuhu ka ai që kish vatur më përpara// dërgoi një tjetër edhe ky beti akoma më tuhu/ nuk qasej dot// edhe breti e kuptoi se dish ish/ e u thotë gjatorëve/ mirrni zagarët e ikni se do rri akoma një çikë në hqe// u nis ki e vate atje/ e zuri çepin e tha / ee çje ti kutu/ një i jaradisur i perëndis jam/ i tha ajo// del këtej i tha breti// dal/ po me tagdir të Allahut/ dil me tagdir të Allahut// hapu dhe të dalë Xhikua/ hapu dhe të dalë Xhikua/ dheu u hap e Xhikua top dolli// e mori breti me kalë e shpuri në shtëpi/ e u tha njerëzve që kish pas breti që de bi motër me qitap// ne nuk e thomi munaasip ashtu po t'e hedhiç nigjah// pieteni Xhikon një herë tha ai/ e Xhiko çish thua ti/ si të urdhëroni zotria juaj / po me tagdir të Allahut// po edhe ù kushtu e shoh munaasip// u martuan e bëri di djelm edhe një vajzë ajo // erdhi i jati e të vëllezrit e hamnë shtëpinë e ture//

Breti që erdhi ka gurbeti do marton djalën e madh/ hapi dasmë ki / ftoi gjithë bretëritë/ ftoi edhe burrën e Xhikos si bret që ish se nuk dinej gjë// breti i thotë Xhikos/ ù do iki përpara/ ti filan ditë merr peshqeshnë / hizmeqarëtë e të viç// u nis kjo në mes të rrugës/ na i del hoxha përpara/ më do tani Xhiko a të të ther djalën e madh/ there i tha ajo/ ja theri djalnë// më do tani Xhiko a të ther edhe tjetrin djalë/ there i tha ajo/ ja theri edhe atë // me do tani Xhiko/ a të të ther edhe vajzën/ there i tha ajo / ja theri edhe vajzë// më do tani Xhiko a të të prish bakllavanë ( risi) / prishe/ e prishi edhe bakllavanë// më do tani Xhiko a të të ther edhe ti/ thermë hoxhë i tha ajo// jo ti nuk të ther/ do vemë në dasmë// i hoqi turkuzën kalit e mori përpara e vate në dasmë// ignë për në dasmë// i zuri nata në një vënd berrjaba// kthenemi kutu të flemë Xhiko / si të deç hoxhë i thotë Xhikua/ u kthenë// dal një çikë përjashta hoxhë / jo i thotë hoxha/ po bëre Xhubëka/ të lidha me turkuzë ka dora// fët i bëri ognaza e shkoi me turkuzë / e lidhi ka dega e ullirit / e iku ajo e s'dha nishan// hilq hoxha e s'vinej ajo/ kur vete atje s'gjeti Xhiko gjakundi// vete hoxha në dasmë// Xhikon e zuri dita/ piqet me një kallanxhi/ ndrojnë rrobat / i tha kallanxhiu/ ah moj zonjë të mijat janë të vjetra/ ashtu i dua //mori rrobat e kallanxhiut/ thesin / kapellon e vate në kasaba të babajt të saj / atje ku bënej dasma// vate ne porta e babajt e flet// kush ka enë

për të kallaisur// del djali e sheh/ baba i thotë djali/ kemi enë për të kallaisur// o merre selle bërna/ vete bërna e i she gjithë ata që duaj ajo // thuajna kallaxhi i tha babaj/ do u them një histori/ po duo një njeri që të ruajë në derë// do vë tani i thotë breti/ e nis historinë siç e kam zënë ù e jaam në fund// ai isht hoxha që m'i ka bënë mua të gjitha këto hupe// Ai isht vëllai im i vogël që më ka prerë këtë glisht// e muarnë hoxhën e e grrinë si duhanin në havan.

### PLAKA DHE PLAKU

Na ish një plakë dhe një plak// na kishin një djalë pesmet vjeç// djali na she një nëndër një natë/ hënzën në krahë të djathtë e djellin në krahë të mënjër// në saba grihet u thotë babajt e nanës/ kam parë një nëndër u tha/ thuejna i thanë ata/ nuk ua thom// e shtërguan shumë / se nuk i thanë hair ata/ zunë e rrahinë/ djali iku/ hë këtu/ hë atje/ kudo që i thoshin thuaje nuk e thosh/ se nuk i thosh njeri hair// arrin e vate ne breti/ aq e shtërnguan mileti // pse të rrahin bota i tha breti / se kam parë një nëndër e nuk ja thaçë gjithëve //nuk ua the/mua do t'm'e thesh/ po edhe breti nuk i tha hair// do m'e theç se do të vë në haps// le të më veç/ nuk ta thom// e mori e vuri në hapsane// atje nek e vuri në haps përsiprazej ish vajza e bretit// i jati nuk e kish parë çish kish vënë jati poshtë/ ashtu bëri/ e hapi qepengjinë e sheh atë atje// pse je kutu orece/ i tha / këtu më ka vënë babaj it / i tha // pse të ka vënë në burg/ nuk e di i tha djali// djali pa gënë pa pirë atje ai / ka ligësia ajo kur i shpii bukën i jati asaj/ ajo i lii ka një çikë pjesë të haj / breti e vuri djalin atje e harroj çish kish vënë atje// një ditë e ka ditë i dërgon Moskovi bretit: ù do të dërgoj di kobëza mollë / po i njohe çila isht e vjemea çila e sivjemea nuk do hapim luftë / ndrishe do të hap luftë // edhe qi u murzit se nuk i njuh dot çila ish e vjemea e çila e sivjemea// vajza i tha: ç'ke baba që je sellkëdisur// A moj vajzë kutu e kutu/ më ka dërguar Moskovi// u mërzi edhe vajza / e vate në dhomën e saj e e harroi edhe djalin pa pjesë buke// të vesh t'i thesh babait po mos ja thuaj që të thash ù/ të marri një kazan me ujë e t'i hedhi/ ajo që ø të vejë në fund është e sivjemea/ ajo që do betet bi ujë është e vjemea// breti e bëri këtë e ja dërgoi bretit të Moskovit// për di tre muaj i dërgon prapë breti i Moskovit/ do të dërgoj di pela po i njohe çila isht nana/ çila ishtë bila/ nuk kemi luftë / drishe do nis luftë// vate vajza e sheh t'anë të mërziur// pse je mërziur prapë baba i tha/ kutu- kutu i tha ai/ ku do i njoh ù këto i tha babai/ edhe ka boj edhe ka qima jan barabar// iku vajza e mërziur e e harron pa bukë djalin// pse më harrove pa bukë i tha djali/ kutu kutu i tha vajza djalit// i thotë djali t'i theç babait/ veri di pelat në avlli/ të veri pajtarët t'i rrahi pot e pot e pot/ do dersinë ato/do vejë e bila t'i veri hundët në gji s'ëmës/ babai t'i veri simadhin e t'ia dërgoj Moskovit..... etj/ e beri kete breti e ja dergoi Moskovit// Moskovi e la prape 2-3 muaj/ e i dergoi një hekur e i tha / po ka njeri të shpojë me glisht hekurin nuk kemi luftë drishe do të hap luftë/ u mërzi më shumë breti/ vate vajza prapë/ aaa humba ù / i thaj jati / më dërgoi ai qafiri hekurin // iku ajo më e sellkëdisur akoma// djali i tha vajzës/ pse më le pa bukë/ kushtu kushtu tha ajo/ Moskovi ka dërguar një copë hekur ta shpoj me glisht / shponet hekuri/ aaa tani vate babai im/ i tha vajza// ti theç babait se edhe di të tjerat ai i ka gjetur / edhe hekurin e shpon ai që ka vënë në haps/ nën maje// pse i tha breti ku kam vënë njeri në haps ù/ ahu i tha vajza/ ù e baj me bukë/ ku isht i tha ai / merre selle kutu// e shpien djalin ne breti//

Pse të kesh vënë në haps ti more djalë/ më kesh vënë efandi/ kesh parë një nëndër e nuk ta thashë / hajr ishalla// ç'nëndër keshe parë// kesh parë hënzën në krahun e djathtë / diellin në krahun e mënjër// hënzën në krahun e djathët / do març

vajzën time / diellin në krahun e mënjër do març vajzën e Moskovit// po hekurin e shpon dot ti/ po e shpoj / i tha djali// ja shpëmë hekurin// bismilahi/ tha djali/ tag një herë më një vënd/ tag më një tjetër/ / tag më një tjetër/ e shpoi më tre vënde / e lidhi glishtin me rrocek/ ja dërgoi Moskovit// ë hë tha Moskovi/ ka njerëz të fortë ki// djali u bë dhëndëri i bredit//

Vate nja 5-6 muaj/ do iki ù i tha bredit/ ku do veç / i tha breti / do vete të marr vajzën e Moskovit i tha // more ù të bëra edhe dhëndër / ku do veç i tha / do vete i tha djali//

Do më japiç 7 mushka e parà e do vete// ja dha // të mirë mbeç// ja hipi njëjt mushke/ 6 kish prapa// vete jaam në një vënd ashtu/ gjen një njeri që vëzhdrin përpjeti me një si// ej/ i tha djali/ ç' shikon i tha/ kam 300 vjet q'e kam hedhur purtekën e dufeqit e tani e pres të bijë// o i keq e derr je / i tha// më derr ka ai që shpoi hekurin e Moskovit nuk jam ù// ù e shpova / i tha djali// edhe ù me ti do vi/ i tha ai njeriu// ja hipi njëjt mushke edhe ki e u bënë di vetë//

Vate prapë në një vënd e gjeti një njeri që kish vënë veshnë dhe e ban vesh // ç'bën këtu i tha/ kam lënë fëmilën ne dun-ja të reposhme / më klajnë/ i baj vesh// o i keq e derr je i tha / më derr ka ai që shpoi hekurin e Moskovit nuk jam/ ù jam i tha djali// do vi edhe ù me ti/ i tha ai burri// ja hipi mushkës tretë e u nisën të tre//

Iku më përtej që kish lënë dhemotin me dru// këtej kish çelur zjarrë/ e vetë kish hir anamesa flakës/ e zjarri çelej këtej e këtej// e mo ç'bën i tha djali nuk u do gjë i tha// ke dru të hedhiç// o kam i tha ai që ish në zjarr // o keq derr je o/ i tha// më derr ka ai që shpoi hekurin e Moskovit nuk jam i tha// ja ù e shpova/ i tha / edhe ù me ti do vi / i tha ai burri / ja hipi edhe ai njëjt mushke u bënë katër//

Iku më tutje/ e gjeti një njeri që kish vënë një dhemot të madh me dru sa mali i glatë// ç'bën i tha djali/ ja bi dru i tha// ku i merr dot ato ti i tha djali // ke të më veç nja di akoma i tha ai// i keq derr je// më derr ka ai që shpoi hekurin e Moskovit nuk jam ù// ù jam i tha djali// epo do vi dhe ù me ti / i tha ai burri // ja hipi edhe ai njëjt mushke / e u bënë pesë//

Ikë e ikë e gjen një burrë që dizet mulli bluajnë e dizet furra pijnë e ai nuk gopej / lëpin fillaqinë e mullirit // ç'bën more i tha djali // ha /// shnuk gopej mor derr i tha që dizet mulli bluajnë e dizet furra pjekin // mos ke nonjë copë të më japiç / i tha ai// e derr je i tha // më derr ka ai që shpoi hekurin e Moskovit nuk jam// ù jam i tha// edhe ù me ti/ nuk dua të ha pi/ i tha/ u bë vet i gjashtë ai//

Ikën/ vete më përtej / nuk t'e bëj dot terçube / kish marr një shkëmb sa një mal i vogël/ e i tha djali / ç'bën i tha/ e thente në fund ka një çikë/ hëp i bi me shqelb ai/ jaam ( jaram , deri) në Gumenicë vi ( shkonte) guri// i keq derr je // më derr ka ai që shpoi hekurin e Moskovit me glisht// u jam// do vi edhe ù me ti// iku edhe ai me mushkën e shtatë//

vanë në kufi të Moskovit// ua tha Moskovi/ me shtatë vetë / do bi luftë ki me mua// shpejt tha Moskovi t'u bie// lëshuan mushkat me çaziz të Moskovit/ eee... i tha atij që vështronej përpjeti / hazërllëk binë ( bëjnë) të na bien/ eeee...i tha atij të veshit/ na vranë i tha ai / eeeee.. i tha atij të tërkuzës// fët i bëri litarit ai e tundi tri- katër herë/ Pardon tha Moskovi // grin duart lart / u jam ka ata që kam shpuar hekurin tënd me glisht i thotë nëndërën djali Moskovit// mora vajzën e bredit // tani kam ardhur të marr vajzën tënde // do ta jap vajzën me një husus ( kusht)//kam një furrë bejlleke/ sa ha ordhija ime / da haç ti me këto të shtatë / aher do ta jap vajzën // e i tha atij të furrës /vdiqa i tha ai po shpejt bukë // sill bukë ai / ha ki/ hë, ëhë/ ëhë kat' ditë radhë // Pardon s'kam më i tha Moskovit/ tani i tha Moskovi kam një furrë bejlleke/ një ka te tutë/ një ka të mitë/ kush të drojë më shumë//Ai i Moskovit rrinej mërgur se nuk e dron zjarrin/ vete ai i furrës gap e merr ka krahu/ e fut në furrë me gjithë atë// ai u

dogj u bë shkruar//ki hëë e hidh dru/ hëë e hidh dru// pardon i tha Moskovi / s'kam më dru/ kam edhe një akomi i tha Moskovi// kam një krua në filan vend/ kush të vejë më përpara të marri një// e nisi më përpara Moskovi të tinë/ e bushi ai edhe vinej// u nis ki e gjeti nek vinej// një shkelb i jep atij nuk e pa se ka vate//bushi ki e vinej// mos pe atë timin gjakundi / i tha Moskovi/ nuk e pashë i tha ki// Pardon i tha Moskovi/ ma more vajzën more djalë// u himen mushkave e ikën //

Tani burazer i tha ai i shkëmbit do kthenem ù t'e tund një çikë se e kanë zënë atë // një grusht lira atij/ u da (nda) ai//

Erdhen ne mulliri // do kthenem ù tani se më ka marrë ù-ja// mor aman hajde/ jo i tha ai// një grusht lira iku edhe ki//

Erdhën ne turkuza // do kthenem edhe ù i tha ai// një grusht lira edhe atij/ iku edhe ai//

Erdhën ne i zjarrit// edhe ù do kthenem burazer se më griti/ më preu// një grusht lira edhe atij/ iku edhe ai//

Erdhi ai i veshit// edhe ai u kthe// një grusht lira edhe atij //

Erdhi nek ài që vëzhdrin përpjeti // një grusht lira edhe atij//

Beti vetë më vajzën e Moskovit/ vate drej e ne breti// e priti breti me murzika// u bë dhëndër i di bretërive djali i plakut e i plakës//

Tani do më japish rusat(afat) të vete të marr babanë e nanën// i dha breti kalë të shaluar// bënej njëzet vjet / e kish harruar i jati e jëma// foli/ më njihni mua kush jam// jo i thanë ato nuk të njohim// jam djali juaj që më rrahët e më gjuajtët (përzutë) // tani do vini me mua/ do vimë e ne// i mori nanën e babanë e vanë // u rrua e u trashëgua ne sarajet e bredit//

## DURDULI

Na ish e diç na ish / na ish një bret na kish tre djelm/ kish edhe një kal/ ja thoshin Durdul// do u them një llaf u tha breti djelmve//kam kohë që më ka zënë agusa e do dal në bretëri të tjera// ikë baba i thanë djeltë//

Hajde tani Durdul se do dalim bashkë një herë i tha breti// ja hipi e u nis// vate jaam në sinuar të bukrës dheut/ atje na e she e bukura dheut e qorrohet ka sitë breti // ktheu Durdul i thotë breti / pse/ i tha kali//paaç të bukurën e dheut e u qorruaç/ po ktheu të vete në shtëpi//

Pse u ktheve baba/ i thanë djeltë // paçë të bukurën e dheut e u qorruaç// do vete ù tha djali madh të gjej ilaç// iku djali madh po nuk gjeti gjë// u kthe prap në shtëpi/ nuk gjeta baba// mirë tha ai// do vete ù tha djali mesëm// vate edhe ai po u kthe pa gjë//do vete ù tha i vogli/ spaçë ka sitë do shoh ka vetullat/ i tha babai//

Iku i vogli/ vate ne kali// e ba mend Durdul / ku u ka qorruar babai/e baj tha ai//ja hipi kalit/ ikë e ikë sosi në kufi të bukrës dheut// tani i tha kali do t'më baç vesh mua// me gugushet e saj shëronen sitë e babajt tënd / ajo ka dalë në ballkon dhe festen e ka në kokë// ù do shkoj një vërdallë saraive e do hegëllij/ ajo do dalldisi/ ti ti hedhiç dorën në feste e t'ia marriç / se ù do hegëllij aq fort sa do bien podhëtë e shtëpisë bedhe ( mbidhe , përdhe- *pëdhe*)// ti hidhja dorën në feste se ka aramanë ne porta/ e po i foli arapit/ na hëngri na piu//

Një herë hegëlliti kali/ u hamnë podhetë e pallatit/ i hodhi dorën në feste/ ja merr asaj e hëë bëri/duall ka kufia//

Aramnë moj u tha hizmeqarëve/ se ma muarrë gugushenë//

Ikë e ikë/ në mes të dhromit / e zuri nata djalin me Durdulë// pjesin ku ka nonjë vend për dënjël/ se të gënë e të pirë kemi vetë u thonë//e priti Veziri/ e shpunë bërna/ hëgrën e pinë// djali ka vate të mirr kutinë ka xhepi i feksi gugusheja// ç'ishtë

ajo/i tha Veziri// ishtë gugusha e bukrës dheut // m' u ka qorruar babai/ d'ja shpie t' e sheroj// ja ta shoh një çikë/ e pa e e vuri në xhep Veziri/ mor aman i tha djali se kam babanë sëmurë / jo nuk ta jap/ mor aman// pa selle të bukrën e dheut / zonjën e kësaj kutu/ nuk t' e jap/ i tha veziri//

Djali vate ne kali në katua prapë// pse e xore në mejdan ti i tha kali// më pa kur bëra duhan // mos u sellkëdis i tha kali// vanë prapë në kufi të bukrës dheut // ja ba vesh i tha kali djalit // tani do biç prapë çish të them ù/ ëë.. tha djali// tani do veç si musafir e do flasiç arap/ ajo arapin e ka lidhur në portë// do dalin hismeqarët të të presin/ do veç bërna/ ajo nuk do të tundet ka qoshëja /do vesh atje të përshendosheç/ ajo do u thotë hismeqarëve/ një kaalive një nargjule beut// një tjetër do u thotë ajo/ nuk dua më thuaj ti//

E bej/ i tha ajo// urdhëro zotrote i tha beu//kush vjen kutu nek mua e haj//do i theç ti/ edhe ù po të munda do të marr për gjisej// ashtu i tha ajo//

Po e pee që u munde ne kartra / i tha kali // kthe krahun drej qiblesë / thuaj tri herë kuluvallahun//

E pa djali që e mundi ajo / krahan drej qiblesë ai / e drej e mundi të bukrën e dheut // nestër të viç prap bej/ peqe tha ai//

Më të neseet në saba i tha kali çish vajte// dolla mirë i tha djali// të nesërmen vate prap djali që meraba// so i tha kali do të presi në mes të shtëpisë/ ajo do të grihet// vete djali ne porta e flet // arap/ arap// ne porta u gjendën hismeqarët/ bujur bej bujur/ berna//hiri djali/ ajo u gjend në mes të shtëpisë / e poqi djalin// tri kaalive/ tri nargjule beut u tha ajo hismeqarëve// një tjetër tha ajo/ nuk dua më u thotë djali/ zakonë që kem tani bej i thotë ajo/ mirë i thotë djali//

Filluan kartrat // djali e pa qe e thjeu ajo/ krahun drej qiblesë ai/ tri herë kuluvallahun/ i dolli prapë ai asaj//një bocë këtej ai / një bocë në faqen tjetër/ u ngre ki e iku//nesër të viç prapë bej i tha ajo// peqe i tha ai//

Eee tha kali/ çish vajte sot// mirë dolla edhe sot // nestër je akoma keq/ po e munde edhe nestër / e more//

Sot ajo do dali në ballkon të të presë// do biç tri kaalive / tri nargjule/ i tha kali djalit//

Atej ( andej) e vete ne porta djali// arap/ arap/ bujur/bujur/ i thonë hismeqarët/drej e bërna// dolli në ballkon ajo / e vanë bërna// tri kaalive / tri nargjule beut u tha ajo /një tjetër tha ajo/ jo nuk dua më/ havllën që kemi bej i tha ajo/kemi edhe sot akoma bej/ kemi eni// krahun drej qiblesë djali dhe i dolli prapë// pardon bej i tha e bukura dheut / arap i tha e bukura dheut//urdhro zonjë i tha arapi/ pardon i bëra ù këtite / këtej e tutje këtë do njohiç për zot/ prap prap prap u bëri duarve kjo/ e blodhi mall e gje seshkish ( gjithë çfarë kishte) me një koqe arrë edhe ja dha djalit koqen e arrës/ e ja vuri në xhep//

Arap i me një si në ballë/ i lidhur ne porta nuk li njeri as të as të hin e as të dil ka porta//merr kaln e saj ajo e djali të tinë // e nisën rrugën për ne Veziri// dhromit i tha djali/ e di pse të mora i tha/ të mora për Vezirin / se gugushenë tënde ma ka marrë Veziri/ e po nuk të shpura ti nuk ma ep//mirë mirë i tha ajo e drej ù Vezirin// s' më hidh dot në dorë mua veç se ti/ i tha ajo// amë tani / i tha Vezirit djali/ amanetin që të kam dhënë// ia dha Veziri// e mori djali gugushen e vuri në xhep// pse kushtu do të marr ù ti/ i tha ajo Vezirit/ të bjell spinaq me surratin tënd në sabah e të bi bureq në aksham// do lahem ù i tha Veziri/ merr një kazane të madhe me ujë / e vë në zjarr / e e lë sa zien glluk// shko tani i tha ai se do lahem vetë// jo jo bej i tha ajo do të laj ù // një të kthene kazanin me një glluk e përvëloi// mori beun/ ajo kalin e saj/ ki të tinë/ shkuan// i zuri prapë nata në një vënd// pjenë për vend ku do flinë// ka i thanë vend në një hoxhë// i priti mirë hoxha/ ajo fjeti ne gratë/ djali ne burrat// hoxha kish një vajzë

të bukur si e bukura e dheut/ja vuri sitë ajo// i foli beut e bukura dhe u ul// hoxha ka një vajzë të bukur si u i tha ajo/ do mos m'e japi moj / i tha ai// e hidhet ne hoxha bërna ajo/ efendi i tha /urdhëro i tha hoxha// pa vajzën tënde nuk iki këtej/korban t'u bëftë i tha hoxha// e bëri hazër vajzën hoxha// i mori beu të dija e qëndroi në Stamboll// ko ka ( ku e ka) pallatin babai it i tha e bukure dheut djalit/ ja i tha djali// ajo zgloodhi një vënd të bukur/ prof e prof u bëri duarve nja di herë/ e bëri brup pallatin e ri// ndenji tre –katër ditë ai me to // do m'imni leje / u thotë ature / do vete ne babai ti shpie gugushen// do veç i thanë ato/ po me mendje se do të bij noonjë punë babai/ do të humbi/ se babait nuk i vjen mirë që më solle kutu ti mua// atej e ne i jati// e prinë//i thanë babajt që të erdhi djali// erdhe / erdha//paç uratën / na gugushen e të bukrës dheut/ e mori/ fërkoj sitë / i erdhën menjëherë e pa dunia me si// uratën e perëndisë paç or djalë / ndenji djali di a tri ditë //

Tani u thotë djali/ u do iki se kam nuse të zonjën/ çke bënë / jam martuar// lena një ditë akoma çamella të rrimë se jam i agusepsur// do bredhim/ se kam kaq kooho me si billur/ bredhim i tha djali // me një husus ama i tha babai/ po më munde do më xeriç sitë / po të munda do të krej sitë// po ti xerrë i keshe baba e s'denje dot ç'ishtë ki llaf që më thua// ja të shohim tha djali zhdo bij babaj/ të le të më munsh një herë// dolli babai/ i suallë një fendike/ gllap një si/ gllap e tjetrin // merreni u tha asqerit e shpini në një pill/ e plakoseni me gurë// e shpunë e bënë hazer ta plakosin në një prosile ( faqe kodre a mali që e zë dielli)// leneni ore tha njeri ka ato / ki i vdekur e i vdekur ishtë / pse të vdesi me ibret// e lenë atje të shtrirë e ikin// djali denji nja pesmet ditë i gjellë// u bënë di si pelistere ( thëllënxa) e atij ju kumisën pranë/ një këtej e një atej// ja tha njëra/ ki goxha djalë kutu // kush d'ja ketë xerë sitë// tjetra tha/ ko di ki që të vejë në ato pendezat tona atje të fërkojë sitë t'i vinë/ç'ka di vii tha tjetra/ të vejë atje ku lahemi ne / apo t'i vinë gjisej sitë//u humnë ato s'dhanë nishan//ki kutraz/ kutraz (bithazi- rreshqanthi) gjeti pendëzat e ature/ fërkoj sitë e i erdhë përgjisëm// vate e gjeti e ujët nek laheshin ato / opo i erdhën gjisej sitë // iku ki i baldisur pa bukë// na pjek një vllah në dhrom/ i drojmë plashkat i thotë vllahut ky// plashkat e mija janë të vjetra bej i thotë vllahu/ s'ka gjë merri i thotë djali//u druan/ iku djali e zuri dhromin// ra në fshat e gjeti një plakë// moj nane i thotë/ mos ke noonjë kapshore bukë se më zu të shuar//më raftë pika kam eni/ kam bënë di kuleçë se do më vejë djali asqer / i tha ajo//ç'bëri breti mor të pastë na i tha ajo/ u qërrua ka sitë kur pa të bukrën e dheut//vate djali i tij i gjeti ilaç e shëroi/ kur mori vesh se kish sellë të bukrën e dheut/ brodhi në baz me djalin pastaj i xori sitë//ami mua di kuleçet e di vete/ që ke bënë për djalin tënd/ e të vete u ( e përsëritur ) në këmë të djalit tënd asqer// atej djali e në breti// breti kish bledhur gjithë ushtrinë/ po nuk gjen dot njerëz// që të hidh në dorë arapin që ish ne porta me një si n'ballë// thuaj ti i thotë plakës së ishtë një çoban që e kreu në dorë arapin// atej plaka e ne breti / e i thotë kutu kutu //vete djali e pret breti/ punë e madhe// merr i thotë 7-8 vetë e hajde pas meje të vemë ne arapi/ u nisën / ikë ikë u afruan// tani u thotë djali ju do rrini murguar/ sa t'i hedh dorën u arapit// të di gratë ishin veshur e kishin dalë në ballkon e po t'i hidh dorë noonjë arapit kishin bërë hazër të pinë farmëkun// si e panë që u shkëput ki ka këta/ i thotë njëra/ shi arap se mos të hedh njeri në dorë //afrohet pak edhe më afër arapit djali edhe i flet// Araaaaaap bëri ki një herë// arapi nuk ju përgjegj me një herë po u gjeth //ja shih more arap i thotë e bila hoxhës/ foli edhe ti/ e hamallos edhe ti se po kle zoti inë ka një dhëmb të florimtë në golë// djali u afrua akoma më afër e i foli edhe një herë Araaap e solli buzën në gaz / e kur qeshi djali i feksi dhëmbi i florimtë që kish bërna// mos u tremni zonja u thotë arapi se ishtë im zot// afrohet djali ne porta/ brup ul kokën arapi/ e gremisi më një anë// breti u thotë ature që kish atje/ ai u fut ne gratë hipi në shkallë e u poq me ato ///

Hidhni filxhanin e farmëkut poshtë / veshni më të mirin takëm se do të prisni bletin// të na shpini te qoshqi më i mirë/ u thotë grave//merr një copë fiskomë( spango)/ i heq alsin arapit// e ja lidh qafën me fiskomë//del djali ne porta e i thotë bredit/ urdhro me ato që ke atje të të bii teslim Sarain// breti e kthen bi si festen / vete bët e bët / vete në shkallë e akoma pa hirë bërna i thotë të bukrës dheut // ku je moj e shkretë// urdhro bërna / po jota jam/ ju përgjegj ajo// teslim i thotë bredit Sarain me gjithë të bukrën e dheut/ po kam një histori për të thënë //

Si ta kam zënë prallëzën që të thaçë e jaram sa të sosa / ia tha bredit djali///

Araaap/ i bëri një herë djali/ ki e kuput atë palo pere e vjen bërna në qoshq nek ish breti këm bi këmë// e sheatë atje këmë bi këmë / i tha djali/ pikë gjaku mos t'i leshojç bedhe (mbi dhe)//

Një i jep Arapi me gjith rroba / e rrufisi të gjallë// djali mori di gratë e vete ne pallati i babajt e bënet vetë bret///

## **Korpus tekstesh nga çamërishtja e sotme (pjesë nga regjistrime të ndryshme)**

### **Tekste nga brezi i vjetër**

Joo mir u kish sellë/ me greg u kish sellë mirë// edhe kur u trazua axere Shqipëria me Itali e me këto/ ish gregu atje/ i mblodhi eksori / i ngriti të gjithë/ ka shtatëmbëdhjetë e rëpjetë i mblodhi eksori i shkuli të gjithë// kufi/ kufi me Turqi e këto/ saa kur ishën atje këndojën edhe zojt e turkut/ i ndijën këta atje ku i kish shpënë gregu//

pësaj i mirr i kap gregu axere// bëri kërdinë axere gregu / bëri kërdinë/ u sillte mirë më përpara/ si vëllezër/ ata si nevet/ vëllezër gjithë/ edhe vineshin kur na holënë/ kur i muarnë vëllezër baballarë / çish kishnë / eksori i thojëm ne kushtu// vineshin kaurrt e fshatit / vineshin katër- pesë kaurrë që rrinë në fshatin tonë/ që ruajnë që mos bënin kërdinë/ pa me kristianë / s'kish gjë me kristianë / ai e kish me ne//

kur bëri luftë me Italinë gregu axere / ajropllanë pësaj /soj e soj ajropllane // vrau axere pësaj me ajropllane//.....ëhë me Italinë/ kle jermani na shpëtoi neve / nji ushtar jerman të ishte / qind të ishte gregu / maaza s'e bën këg njënjë// ranë pësaj / ranë Italia / ranë greqia pësaj ra / kufijt pësaj u aso / u trazuan//

gregu vargan/ armë/ kuel/ allah/ galorë të tërë të tërë/ mbushur xhadëtë/ vendet// axere u e tremb nevet/ kur shikuam rrugës / se e keshëm shtëpinë përmbi rrugë neve7 rrugën e keshëm poshtë// ka të katrat anë që të veje / greg që shkuan rrugës jo që vinin / rrumulë / ja tan-ja si n'kët kehe e ba mënd// ..... etj.

Naile Habibi (80 vjeçe)

Neve rrugës kur u nisëm sehften e pa:rë/ erdhëm në Grikohuar/ ja thonë njiit fshat atje// dënjëm atje sa dënjëm/ nuk na pranuan ata// çam ishin ka neve// edhe na lane ne katua/ i thomi katua bu:drunit neve// na lanë atje ato/// erdhëm me kuel rrugës/ ngarkuar me plackë/ me ushqim që hajëm rrugës// erdhëm në Sajavë// në Sajavë ndënjëm thuaj njëze dit në bina t'ullinjve//(kollitet) se m'ka zën e kolla// atje bëme çadre me velënxa i thomi ne/ ju i thoni batanije/ po ne i thoshim

velënxa leshi// me velenxa në bina të ullirit/ ndënjëm njizet dit atje/// atje erdhi  
 gjermani/ i prishi urat gjermani/ i prishi urat// ne kalojëm me  
 lundra// erdhi gjermani i prishi urat// edhe na shtiheshim me lundra me drrasa/ na  
 shtihijnë në lum/// lumi ../ dallga të na mi:rr ku të na përplaste// na shtihijnë me litarë/  
 me turkuza i thoshim neve// lidhur drrasa:të/ e na shtijnë pes e pese/ pes e pese qe na  
 nxi:rr ka lumi// na xuarnë matanë// Gjermani vinej me .. / çu  
 thonë/ me tankse mrapa/ na vinej mrapa me tankse/// erdhëm në Ninat/ ja thonë një  
 fshati Ninat// atje ishin kacolle/ të Çamerise posi/// erdhëm në Konispol// u ulëm në  
 një fushë të Konispolit atje// vineshin ushtart e vrarë/ që i vriste Gjermani me tope/// e  
 prrishi Sajadhën/ fshat i Greqisë// i binte me tope/ i prrishi shpitë/ por ama ... frika  
 jone// kur duallm në rrugë të Konispoli/ vineshin  
 ushtartë e vrarë// vër llamarinën/ teneqë/ vënë mbi kalë edhe shtrire ushtrinë të  
 vrarë/ edhe i shpij gjith e kush në vënd të tij për të varrosur..... etj.

Vahje Habibi 68 vjec

Në Tetor të dizetësë/ filloi lufta itallo-greke// në Tetor u kam qënë nxënës  
 shkollë// erdhën tre aeroplane/ ditn' e parë që e mësuajtëm neve/ e këptuam neve që u  
 hap lufta// ern tër aeroplant e shkuajtën mbi fshatin tonë/// ishim në shpi/ që msojëm  
 neve/ se shkoll s 'kishim/ e dualm përjashta/ se athere s'kishim parë aroplan para  
 lufte// para se t'hapej lufta s'kishim parë aroplan// e dualm  
 përjashta/ na thotë ai mësusi/ ishte grek/// u trondit shtëpia/ u tronditën gjith toka ka  
 zhurmat e aroplanvet/// na thotë ai mususi/ na foli grekçe/ nesër nuku kemi shkollë/  
 ikni m'shpiat tuaja// ikëm neve/ edhe ai iku që at dit a .. // iku dhe ai mususi// edhe  
 kshu u hap lufta/ filloi lufta/// filloi qeëerria greke pëstaj/ filloi t'i arrestonte çamrit/  
 muslimant/ neve muslimanvet/// filloi mblodhi njhere dorn'e  
 pare// iku mas nja dy jav a njize dit a sa shkoi// filloi dor'e dytë// pas një muji/ prap  
 filloi edhe dor'e tretë/ deri n'të fundit pastaj/ mori ata pleq/ fare pleq kshu t'mbaruar/  
 edhe cunakër të rinj// i çoi atëj nga kufiri turk/ greko-turk// atëj nëpër ishuj i coi të  
 gjithë burrat// neve ngelëm n'shpi/ burrë s'kishte më/// erdhi  
 gjermani athere pësaj që shkeli Greqinë/ edhe i lroi t'burgosurit që gjeti në Greqi//  
 dënjëm nga di-tre vjet pësaj/ dystenjë/ distedi/ distetre/ n' distekatrën pësaj që qe ajo e  
 fundit// qe ajo e fundit// u ashpsua gjendja pësaj/ edhe u vu kufiri// u vu kufiri atëj/ ne  
 s'keshëm ne pushk/ ajo ishte qeveri/ kishte  
 tope/ mitraloze/ tanke/ avione/ si pun e Kosoves/ t'paktën Kosova kishte diçka/  
 armë .. / po ne keshëm pak..... etj.

Feim

Hyseni 72 vjec

Do t'them prishjen njhe:r/ si u prishmë ka Çamëria// ikën miftiu i Paramthisë/  
 miftiu i Paramthis edhe Sali Hafuzi/ një i par' i Paramthis// ajo Paramthia qi themi  
 neve ish qitet si Durrësi// gjisma ishte kaurr/ gjisma ishën myslimanë// edhe ... këta  
 ikën vënë atëj në popull i thomi ne/ në popull në një vënd të mshefetë që ishte zerva/  
 ishte zerva grek atje bërna// edhe që të pajtohejn punë/ që të rregulloheshin kto/ dhe  
 grek dhe kta/ të rrishin më një vënd që të mos vriteshin/ mos priteshin// mirëpo ata i  
 prîn kur vënë/ edhe u  
 rreglluan// jo mos u tundni se neve su prekim me duar/// Greket pësaj më përpara që  
 vran atje/ vran atë miftin dhe Sali Hafuz/ /ata di që vënë atëj/ ata di që vënë atëj që bënë



pajtimin me grekë// / e plasi lufta vrasja që u bë/ plasi vrasja/ vëllavrasja// histori e Çamërisë kjo ishtë// ( vijon e shoqja) plasi lufta pësaj/ plasi lufta/ ne jeshëm më pak/ ata gregt ishnë më shumë// si pun' e serbit me kosovën// na përzunë ka shpit moj t'keqen nana/ edhe kalamajt në lum i hidhën/ që s'do hidhën lekat/ u shpëtojnë kalamajt në lum ka frika// se vineshin prapa ato t'na gjëmoj neve// po ù kam qën e vogël/// ( vijon përsëri i shoqi) ju bani mënd ma mirë/ ku e di ù/ sa talaçe ka pas kjo kok// un kam qen njëzet vjec xham// kush me lih mua/ kish tufn'e kfshvet// ruajmë kafshët// bari kafshësh kemi qen neve atje/ po me kafshet tona .....etj.

Ramadan dhe Fatime Jaho 80 dhe 69 vjeç

### **Tekste nga brezi i mesëm.**

Po ecnim më posht/ edhe aty ishte e zënë/ ecëm nevet në Hoxhaj// në Hoxhaj/ një stacion mas Barit// edhe tha /// shikoj numrin aty// çohuni tha/ ù kam hip n'Leçe i tha Ramadani/ e kam pre biletën që dje/ Ramadani shqip/ ajo italishte// vesh s'merreshin// e kuptum ne kshu../ shkova u ula aty pësaj....etj/// edhe Eva kishte shpia t'mira/ ça vila../ kto shpia/ kto modelet që jan marrë/ andej jan marrë/ lart nga veriu/ se ktu n'Lece jan shpiat/ t'gjitha taraca// kurse atje jan me çati nga bora// as nga Hamideja nuk shkova// do lek mi/ ësh larg n'fund dunjas// vllëzt e mi m'thon mua/ do vish/ nuk po vi gjo jo i thash/ thash zuri dimri/ jam e vet pa qef thash// Eva është ku ishtë Haxhiu// d'e pys Nepen kur t'vi ket vër /// shkëm ne dy- tre fshatre/ ne supermarketi kshu/ me makinë// kan punu mi dynjaja ..... etj.

Luto Mehmeti ( pa arsim) 45 vjeçe

Sic tregon mamaja ime/ nëna ime është fijuar e vogël// Gjatë kësaj kohe u fijua vetë/ u fijua dhe vllai vet// i vllai ishte më i madh se nëna/ ishte i martuar njëhere/ e kishte nda nusen// ngaqë kishte nda nusen/ nuk i jepnin nuse tjetër// dhe donin t'i gjenin nuse patjetër/ se nuk ishte ndonjë moshë shumë e madhe// gjëtën mënyrën/ e fejuan me motrën e dhëndrit që bënë//domethënë/ nëna u fejua/ u fejua dhe motra e babait tim// erdhi dita e dasmës// simas zakonisht hypnin në kalë// sic tregon nëna/ u mbuluan fare me duvak quhej ai/ me një cop beze t'kuqe/ dhe u martuan në një ditë.....etj///

tashi mund tregoj ndonji rast tjetër/ kur greku u binte shumë në qafë/// njëher ishte koh'e luftës/ por i bie afërsisht tre vjet përpara// ishëm tha duke ngrën bukë/ ishën ulur/ kishën ulur sufranë/ sufrā i thoshin që uleshin të gjithë/ kishën bërë shumë gjellë/ edhe po. hajën në qetsin e tyre// kur vjen një/ lajmëron gjyshin dhe i thot që/ ç'bëni ju/ ngrehuni thot t' ikni/ se do vijn grekrit edhe do ju vrasin// menjher habiten/ ngrihen/ i lenë ashtu të gjitha ç'kishin/ bukën/ ushqimet/ domethën shtëpinë// morën fmit/ më tepër kishën rëndësi fmija ..... etj.

Mereme Jaho 46 vjeç (me arsim)

N' gjazdhët e shtat gjazdhët e teta/ vin një grek n'Sarandë edhe kërkon babën// baba ato dit nuk ishte ktu/ ishte n'Çërrik //edhe kur vin/ i thon kshu kshu/

mirpo s'mujti me e taku atë// Ai e kërkonte me komnulle babën/ për arsye se baba i ka pas bo një ner atijt/e ka pas shpëtu nga vrasjet// tamam/ se siç vran Grekt vran edhe çamt/ dihet ajo punë/ pyll pa derra nuk ka/ edhe dasëm pa mish nuk ka II ai e kërkonte babën me kamnulle me e taku/ mirpo nuk mujti me e gjet// un tashi e kam megjithmen kët muhabet/// kët vit që vjen/ jo kët verë që do vii tashi/ kismet nga zoti verën tjetër// un kam qef t'marr nanën po qem shnosh/ se nga Italia kalon shumë rehat n'Greqi/ edhe do shkoj ta kërktoj se pak a shumë adresen atij grekut ia kam edhe n'mos qoft gjallë ai/ djali duhet t'jetë..... etj.

Ramadan Mehmeti ( pa arsim)50 vjec

Dajo i babait tim kishte ikur qysh në vitin njimijë e nënqin e njizet e katër nga Çameria/ problem hasmërie/ problem vrasje// edhe për tu strehuar erdhi në Shqipëri/// në fillim shkoi ushtar n'kohën e Zogut/ ne Shkoder// mos ta sorolloj shumë un tashti/ pastaj meqe ishte tip impulsiv kshtu/ tip domethënë që nuk duronte ta ngacmonin tjerët/ ta vrisnin n'sedër// ai vrau dhe një serb atje n'kufi// edhe u largua pastaj nga kufiri/ erdhi n' zonën e Kavajës/ Pat Milot quhesh ai fshati ose Vil Bashtov// bëri një kacolle atje n'breg t'lumit// shpi e par qe ishte// ishte shpia atit// Kjo ishte e Ramazan Zeqir Kasës// mirpo i vetmi fshatar që e mbuloi shpin me tjegulla s 'kish asnjë tjetër shpi me tjegulla// gjith shpiat mbuluar me kashtë/ ky i mbuloi me tjegulla//mbas disa kohësh kur e konstatoi beu/ Qazim Beu Tuni quhesh ai i Kavajës// i dërgoi qahjain dhe i thotë//do ta prishësh shpin/ Kush t'ka dërgu ty thot ai/ beu// i thot/shpin nuk e prish un/ se e kam bere vet/ i përgjigjet dajo/// mas katër ditësh / i dërgon xhandarë/ edhe e morin dajon shkojn n'Kavaj// e thërret beu// beu ishte ulur atje n'atë qoshen e vet po pinte duhan/ ky ndenji ke dera..... etj.

Ethem Jaho 49 vjeç (me arsim)

### **Tekste nga brezi i ri**

Problemi u ka pas ndier/ por un nuk para e kam folur/ se edhe me shpi../ jo se s 'kemi dash ta folim/ po si duket ka ecur gjuha dhe nuk është folur shumë// vetëm kur thoja se jam çame/ sepse nuk e besonte njeri/ jo/ me t'vërtet qe nuk je/ biles kishte plot që ..../ se është një pjesë ktu n'hekurudha që e flasin goxha/ dhe kishte plot vendalije që flisshin çamshe// unë nuk e di ...//probleme kishim me vendasit/ problemi u kishte ndier gjithandej se ishte vetë sistemi qe i kishte ngrit çamët goxha// dera e merrshin vesh// edhe kur e merrshin vesh/ t'jenë çamët kshu si ty thoshin mir është// se ç'kishin çamët që nuk e kisha un/ nuk e di/ kur thoje çame//ua .. ku ka çame kshu t'bukur si ty/ po un thoja ndonjë t'shëmtuar nuk njof çame/ t'bukra gati njof shumë// unë kam katër vëllezër// dhe nusët i kemi perzier/ nuk i kemi të gjitha çame/ .....etj.

Qamile Hasani 28 vjeçe

Kur nana ime ka ardh nga Greqia/ babi ka qenë një vjeç// ato tregojnë që kanë vuajtur shumë rrugës// unë do tregoj një histori qe ma ka treguar nana (gjyshja) kur

isha e vogël/ nana ime ka pasur dy fmi/ njëri ka qen më i madh dhe tjetri më i vogël//  
më i madhi ka qen katër vjeç/ halla ime/ / më i vogli një vjeç/ babi im/// mirëpo nga  
rruga e gjatë/ vajza e madhe lodhej dhe ndanjiherë ajo i mbante që të dy në krah//  
mirpo mbeti shumë mbrapa/ dhe po shkëputej nga turma// kunata e saj i thosh/ po çfarë  
bën Ildizi hidhe djalin/ hidhe sepse iku turma// imagjino që ajo vetë nuk kishte asnjë  
fmi dhe në vend që ta ndihmonte/ ajo i thoshte të hidhte djalin/ shif çfarë shpirti//  
megjithatë gjyshja ime i mbajti që të dy fmitë//  
kur arriti brenda kufirit në Ksamil/ ajo ngaqë kishte fëminë e vogël/ ndenji mbrapa  
dhe e humbi familjen// më pas strehohet ke një familje tjetër që e ndihmuan  
shumë.....etj.

Xhemile Mehmeti 16 vjeçe

## **Bibliografia**

- Ajeti, I. *Studime dialektore dhe etimologjike*, Akademia e Shkencave Shqiptare, f. 28, Tiranë , 2005.  
Ajeti, I. *Çështje të gjuhës letrare shqipe*, në “Studime gjuhësore në fushë të shqipes” , 1989.  
Baylon/ Xavier Mignot, *La communication, publie par editions Nathan Universite*, 2003.  
Bellusci, A. *Gli arbërori- arvaniti, un popolo invisibile* (Ricerche etnografiche nell’ Elade,-  
1965- 2000), Cosenza 2004.  
Bernstein , B. *Sociokulturelle Determinanten des Lernens* në “Kölner Zeitschrift für  
Soziologie und Sozialpsychologie”, sipas Klein, G.  
Bernstein, B. *Classe sociale , linguaggio e socializzazione*, in “Linguaggio e societa” ,  
Bologna, 1973.

- Berruto, G. *Sociolinguistica*, Bolonjë, 1994 ( ribotim i 1974-es)
- Braga, G. *La comunicazione sociale* ( me një përshtatje të Franco Ferrarotit), 1969
- Çabej, E *Kuantiteti i zanoreve të theksuara të shqipes*, “Buletin i Universitetit shtetëror të Tiranës”, Seria shkencat shoqërore, 1957, nr.2, f. 207-213
- Çabej, E. *Për historinë e konsonantizmit në gjuhën shqipe*, “Buletin i Universitetit shtetëror të Tiranës”, Seria shkencat shoqërore, 1958, nr 1, f. 31-75
- Çabej, E. *Hyrje në Historinë e gjuhës shqipe*, ( 1962, ribotuar më 1988 si tekst mësimi nga Universiteti i Tiranës), pjesa e parë , Gjerdan librash drejtuar nga L. Shkreli- Shamku, Tiranë 2008.
- Çabej, E. *Meshari i Gjon Buzukut*, transliteruar dhe pajisur me shënime nga ky autor.
- Çabej, E. *Studime Gjuhësore*, Rilindja, Prishtinë 1976.
- Çeliku, M. *E folmja e qytetit të Durrësit dhe e rrethinave të tij*, në “Dialektologjia shqiptare” 4, 1990
- De Mauro, T. *Guida all'uso delle parole: parlare e scrivere preciso per capire e farsi capire*, 2003
- De Mauro, T. *Idee e ricerche linguistiche nella cultura italiana*, 1980
- De Mauro, T. *La crisi della pedagogia linguistica tradizionale*. Scuola e società, 1976
- De Saussure, F. *Kurs i gjuhësisë së përgjithshme*, përkthyer nga Rexhep Ismajli 1977
- Demiraj, Sh. *Gramatikë Historike e gjuhës shqipe*, Universiteti i Tiranës , Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë.
- Eco, U. *La ricerca della lingua perfetta nella cultura europea* ( 1992-93), mbajtur në kolegjin francez; 1993- Romë; 1994- Milano ; 1996-Romë; 2001)
- F. Agalliu, E Angoni, Sh. Demiraj, A Dhrimo, E Hysa, E. Lafe, E. Likaj, *Gramatika e gjuhës shqipe*, Tiranë 1995
- Ferguson, Ch. *Diglossia*, in “Linguaggio e Societa”, 1971
- Fishman, J. *La sociologia del linguaggio*, in “Linguaggio e societa”, 1973.
- Giglioli, P. P. *Guida alla laurea in scienze della comunicazione*, 1995
- Giglioli, P.P. *Linguaggio e contesto sociale* , 2000
- Giglioli, P. P., *Linguaggio e società*, 2000
- Gumperz, J. *La comunità linguistica* , in “ Linguaggio e societa”, 1973
- Gjinari, J. & Shkurtaç, Gj. *Dialektologjia*, Shtëpia Botuese e Librit Universitar, Tiranë, 1997.
- Gjinari, J. *Marrëdhëniet e sotme të gjuhës letrare me dialektet*, S.F, nr.1, 1985
- Gjinari, J. *Për zhvillimin e grupeve - kl, -gl, në të folmet e gjuhës shqipe*, në “Gj.A” 1, 1971
- Haxhihasani, Q. *Vështrim për të folmen e banorëve të Çamërisë*, “Dialektologjia Shqiptare”, vëll.I, Tiranë 1971, vëllimi II, Tiranë 1973
- Hoxha, Sh. *Kontributi i Uilljëm Martin Likut në fushën e studimeve albanologjike*, Prishtinë 2007.
- Hudson, A. R. *Sociolinguistika* (botimi i parë në shqip), Tiranë 2002.
- Hymes, D. *Antropologia radikale* ( përshtatur nga Matilde Callari Galli )
- Internet: [http: / ëëë.comunicazionidimassa.net/](http://ëëë.comunicazionidimassa.net/)
- Isufi, H. *Çamëria* (nëpërmjet kronikave të kohës), Tiranë 2007
- Isufi, H. *Çamëria* (studime historike- sociologjike shek XIII-XX ), Tiranë 2006
- Isufi, H. *Musa Demi dhe qëndresa çame*, Tiranë 2002
- Jakupi, M. *Integrimi ndërdisiplinor në tekstet për letërsinë - çështje të diskutueshme*, kumtesë, Elbasan , 2010
- Jubani, A. “*Gjuha shqipe e njohim apo e zotërojmë?*”, Gazeta Panorama Prill, 2010.
- Katedra e gjuhës shqipe, *Studime rreth historisë së gjuhës shqipe*, 1973.
- Klein, G., “*La sociolinguistica*”: *Orientamenti della ricerca negli Stati Uniti*, in *Gran Bretagna e nella Repubblica federale tedesca* - Firenze : La nuova Italia, 1977.

- Klosi, A: *Netët Pellazgjike të Karl Reinholdit* ( Tekste të vjetra shqipe të Greqisë mbledhur nga Karl Reinholdi 1850-1860, (K&B), Tiranë, 2005.
- Kostallari, A.: *La diaspora albanese, il dialetto e la lingua letteraria nazionale unificata*, Kongresi I (4/7), Palermo 1985.
- Labov, Ë. *Il meccanismo di mutamenti linguistici*, in "Rassegna Italiana di Sociologia", 1968
- Likaj, E. *Eptimi emëror indoevropian*, shblu, 1999
- Likaj, E. *Format analitike në gjuhën shqipe*, 1997
- Likaj, E. *Gramatika historike e gjuhës shqipe*, leksione universitare 2000
- Llalla, A. *Arvanitasit – Çamët në etnikumin shqiptar në Greqi (arvanitasit themeluesit dhe drejtuesit e Greqisë moderne 1821-2005*, kumtesë e mbajtur në Seminarin Ndërkombëtar të Albanologjisë, Tetovë-Ohër, 16-23 Shtator 2007
- Martinet, A. *La considerazione funzionale del linguaggio*, 1984
- Mbledhës të folklorit, *Këngë popullore nga Çamëria*, Tiranë.
- Melone, E. & Poggiali, L. Sperimentazione di testi a "scrittura controllata" in Unità didattiche di storia, temë diplome, nën drejtimin e Roberta Grassit, 2004/2005.
- Memushaj, R. "*Shqipja Standarde/ Si ta flasim dhe ta shkruajme*", Botimet Toena, Tirane 2005. Ismajli, R. *Gjuhë standarde dhe histori identitetesh*, 2005
- Muçaj, F. *E folmja e Konispolit*, "Dialektologjia shqiptare", IV.
- Murati, Q. *Gjuha e medieeve / Fjalori i gabimeve gjuhësore*, Prishtinë 2008
- Pellegrini, P. *Tra lingua e dialetto*, 1960
- Reinhold. C. H. T. *Këngë popullore të arbëreshëve të Greqisë* "Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar", Instituti i Folklorit, 1961.
- Riza, S. "Gjon Buzuku (1555)", *Pesë autorët më të vjetër të gjuhës shqipe,- krestomati thjesht gjuhësore*, Tiranë, 1961/ 66
- Rrapaj, M. F. "*Këngë popullore nga Çamëria*" (botim i Institutit të Kulturës Popullore) Tiranë 1983.
- Rrapaj, M. F. "*Fjalori onomastik i Epirit*", vëll. I, Çamëria, 1995.
- Rrokaj, Sh. "*Të gjithë shqiptarët duhet të flasin shqipen standarde*", në gazetën "Panorama", dt. 15/ 12 / 2010
- Rrokaj, Sh. *Strukturalizmi klasik në gjuhësi*, 2002 ( ribotim)
- Rrokaj, Sh. *Gjuhësia e përgjithshme*, leksione universitare, Tiranë 2000
- Rrokaj, Sh. *Hyrje në gjuhësinë e përgjithshme*, Tiranë 2000
- Sapir, E. *Il linguaggio*, 1969
- Sobrero, A. *Una societa fra dialetto e lingua- appunti Di italiano contemporaneo*, 1978.
- Solano. F. *I dialetti albanesi dell' Italia Meridionale*, I, 1979
- Stylos, N. *Fjalori i marko Boçarit*, Tiranë, 2007.
- Sheme, S. "*Monumente natyrore dhe kulturore të Çamërisë*", Tiranë 2007
- Shkurtaj, Gj. *Etnografi e të folurit të shqipes*, Tiranë 2004
- Shkurtaj, Gj. *Si të shkruajmë* ( nga drejtshkrimi te shkrimet profesionale), Tiranë 2008.
- Shkurtaj, Gj. *Disa dukuri të së folmes së Kurbinit në dritën e sociolinguistikës*, SF, 1998.
- Shkurtaj, Gj. dhe Gjinari, J. *Dialektologjia*, SHBLU, Tiranë 1997.
- Shkurtaj, Gj. *Ligjërimet arbëreshe* ( shqyrtime dialektologjike dhe sociolinguistike në ngulimet arbëreshe të Italisë), Tiranë, 2006.
- Shkurtaj, Gj. *Nga gjeolinguistika tek dialektologjia urbane*, (Hapat e parë të sociolinguistikës në Shqipëri), në "St. Albanologjike", nr. 1, 1995.
- Shkurtaj, Gj. *Onomastikë dhe etnolinguistikë* , Tiranë 2001
- Shkurtaj, Gj. *Rreth ndryshimeve në gjuhën e fshatit të sotëm të Veriut*, në "St. fil." 4, f. 162, (1969)
- Shkurtaj, Gj. *Sociolinguistika shqiptare*, SHBLU, Tiranë 2009.
- Shkurtaj, GJ. *Sociolinguistika*, Tiranë 2003.

- Shkurtaj, Gj. *Shtresëzime dhe risi gjuhësore në qytetin e Lezhës*, në “Studime filologjike” 2, f. 75-93, 1984.
- Shkurtaj, Gj. *Vëzhgime mbi shtresat leksikore dialektore dhe letrare në të folmen e Lezhës*, në “St. fil.” 3, f. 155-163, 1981
- Shkurtaj, Gj: *Vlera dialektologjike dhe etnolinguistike të së folmes së Çamërisë*, në “Çështja çame dhe integrimi evropian”, Tiranë 2008.
- Topalli, K. *Grupet bashkëtingëllore me sonanten hundore*, në “Studime filologjike” 1999
- Topalli, K. *Për kronologjinë e disa dukurive fonetike në të folmen e arbëreshëve të Zarës*, S.F. 3/ 4, 2006.
- Totoni, M. *E folmja e bregdetit të poshtëm*; S.F Nr. 2 , Tiranë 1964, Instituti Shkencor i Historisë dhe i Gjuhësisë.
- Totoni, M. *Vëzhgime rreth së folmes së Gjirokastrës*, në “Studime filologjike”
- Totoni, M. *Vëzhgime rreth të folmeve të Kurveleshit*, në “Dialektologjia shqiptare” 1, 1971
- Troplini, E. *Disa përjasje midis çamërishtes, arbërishtes dhe arvanitishtes në kuadër të gjuhës letrare standarde*. konference ndërkombetare, Tiranë 2012, organizuar nga Universiteti “Sapienza” i Romës.
- Troplini, E. *“Bashkëpërkime të elementeve gjuhësore të veprave më të hershme shqipe, me çamërishten e sotme”* në revistën albanologjike të Institutit shkencor ” Alb- Shkenca” ( Takimi i IV-ërt), Tetovë, 2009
- Troplini, E. *E folmja e çamërishtes në kuadrin e marrëdhënive gjuhë standarde- dialekt*, në “Seminarin e XXVIII për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën shqiptare, në Prishtinë, 2009.
- Troplini, E. *Problematika “gjuhë dhe shtresë shoqërore” në Shqipëri*, kumtesë e mbajtur në konferencën Ndërkombëtare të Fakultetit të Edukimit, pranë Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës.
- Troplini, E. *Disa tipare ruajtëse të çamërishtes*, në, Aktet e Seminarit të II –të Ndërkombëtar të Albanologjisë, Tetovë 2009;
- Troplini, E. *Mësimnxënia e gjuhës shqipe në shkollat tona.(Disa probleme të planifikimit gjuhësor)*, kumtesë e mbajtur në konferencën e organizuar pranë Fakultetit Histori-Filologji, Tiranë 2010.....etj.
- Troplini, E. *Ndikimi i disa prej faktorëve jashtëgjuhësorë në të folmen e çamërishtes*, në “Çështja çame dhe integrimi evropian”, Tiranë 2009.
- Troplini, E. *Teoria e deficitit gjuhësor në kuadrin e kontakteve të sotme të shqipes*, kumtesë e mbajtur në Seminarin e XXIX për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën shqiptare, në Prishtinë, 2010.
- Troplini, E: *Sistemi foljor i çamërishtes në diakroni*, në Aktet e Seminarit të III-të Ndërkombëtar të Albanologjisë, Tetovë 2010.
- Troplini, E. *Vëzhgime për të folmen e çamëve të rrethit të Durrësit*, (risi dhe ruajtje,) temë diplome, Tiranë 2000.
- Troplini, E. *Vëzhgime sociolinguistike në një mjedis çam të rrethit të Durrësit*, (mikrotezë për gradën « Master »), Tiranë , Tetor 2005.
- Troplini, E. *Roli i standardit në unifikimin e gjuhës dhe rrafshimin e diferencave në sjelljen gjuhësore të individit*, konference ndërkombetare, Shkup, Tetor 2011.
- Troplini, E. *E folmja e çamërishtes në kuadër të zhvillimit të të folmeve dhe realiteteve të reja shoqërore*, Qendra e Studimeve Albanologjike ( Q.S.A) , Tiranë, Dhjetor 2011.
- Troplini, E. *Të dhënat për çamërishten përmes figurave të shquara të shkencës shqiptare dhe asaj të huaj*, konferencë shkencore, Tiranë, Dhjetor 2011.
- Troplini, E. *Mësimnxënia e gjuhës shqipe në shkollat tona*, konferencë ndërkombëtare e Fakultetit Histori- Filologji, Tirane 2010.

Troplini, E. *Leksiku në të folmen e çamërishtes*: artikull i botuar në revistën shkencore “Malesia”, Podgorice, 2010.

Troplini, E. “*Si nuk duhet ta shkruajmë dhe ta mbrojmë gjuhën shqipe? “SOS” për gjuhën tonë të bukur”.....*”Gjuha shqipe”, Instituti Albanologjik i Prishtinës, 2009.

### ***e FOLMJA E ÇAMËRISË DJE DHE SOT***

*“Shqyrtime dialektologjike, etnolingustike dhe sociolingustike rreth gjuhës shqipe të shkruar dhe të folur prej çamëve”*

Përmbledhje.

Ky studim është fryt i një pune të thelluar, me të folmen e krahinës më jugore të trojeve shqiptare,

Çamërisë, **si një ndër studimet e para në këndvështrimin sociolingustik.**

Hulumtimet e bëra i përkasin kryesisht viteve 1978, 1998, 2003, 2007, 2010, 2011, 2012.

Përveç, dy proceseve që shfaqen në të, “konservimit” dhe “rinovimit”, tek kjo e folme shfaqet edhe **një proces “ndërkomunikimi”**, i cili luan rolin e një ndërlidhësi midis të folmes arkaike dhe të folmes së moderuar çame.

Roli i **faktorëve jashtëgjuhësorë** në jetën e kësaj (çdo) të folmeje **është vendimtar**, më i rëndësishmi prej të cilëve është mënyra sesi çamët janë integruar brenda bashkësive pritëse, apo faktorë të tjerë si ai psikologjik i shpërnguljes etj.

Pas studimit për çamërishten, kemi arritur në përfundimin se kjo e folme orientohet kah gjuhës standarde, por **si një e folme konservuese ky orientim është më i ngadalshëm** në krahasim me të folme të tjera.

Si dëshmuese e fazave të kapërcyera të shqipes, përmes çamërishtes zbulohen edhe mjaft çështje **të karakterit historik.**

Në këtë të folme nuk mund të anashkalojmë edhe **zhvillimet e brendshme të saj.**

Me rëndësi duket edhe **trajtimi i ndryshorëve sociolingustikë** në kontekstin e të gjithë elementeve të **veprimtarisë ligjërimore.**

E folmja e çamëve **ndikon edhe në të folmen e banorëve (vendas) anas të bashkësive pritëse.**  
Të gjitha përfundimet dalin pas një pune të thelluar me këtë të folme në të tri sistemet: në **sistemin leksikor, fonetik, dhe morfologjik.**

Fjalët çelës: çamërishtja, bashkësi pritëse, sociolinguistikë, proceset, dukuritë, e folme krahinore, gjuhë standarde.

### ***THE CHAM DIALECT OF THE PAST AND TODAY***

***“Dialectological, etnolinguistic and sociolinguistic studies of written and spoken Albanian language of Chams”***

Summary

This study is the result of a thorough work with the province of the southern dialect of Albanian lands, Cham, **as one of the first studies in sociolinguistic perspective.**

The researches refers mainly to the years 1978, 1998, 2003, 2007, 2010, 2011, 2012.

Besides two processes that appear to be the "conservation" and "renewal" this dialect presents **“an intercommunication process”**, which plays the role of a communicator between the archaic and modern Cham dialect.

Role of **extralingual factors** in the life of this (any) dialect **is crucial**, most important of which is the way the Chams are integrated within the host communities, or other such psychological factors, the deportation etc.

After Cham dialect study, we concluded that it is oriented towards the standard language dialect, but as **a conservative dialect this orientation is slower** compared to the other dialects.

As evidence of the overcoming stages of Albanian language, through Cham dialect are revealed many issues **of historic character.**

In this dialect we can not skip **its internal developments.**

It seems to be important the **treatment of sociolinguistic variables** in context of all elements of **discursive activity.**

The Cham dialect affects also the dialect of residents of the host communities.

All conclusions emerge after a thorough work with this dialect in three systems: **in the lexical, phonetic, and morphological ones.**

Key words: Cham dialect, host community, sociolinguistics, processes, phenomena, regional dialect, standard language.